

KALOSH ÇELIKU
XHADIA

Biblioteka

XHA DERALLA

Redaktor letrar

REMZI SALIHU

Redaktore gjuhësore

LAURA ÇUKA

Ballina

FITORE DERALLA

karikaturat

ZENI BALLAZHI

DHIMITËR LIGORI

CUN GELI (ADEM KASTRATI)

Copyright by Asdreni

Xhadia

KALOSH ÇELIKU

XHADIA

(Dyluftime gjatë rrugës për në Baba Tomorr)



Asdreni

Shkup, 2011

Në 60 vjetorin e lindjes të Autorit në Katund. Dhe,
51 vjetorit të luftës me penë...

***Moskokëçarës, përqeshës,
të egër – ashtu na do Urtësia:
ajo është grua
dhe gjithmonë e do vetëm
luftëtarin...***

Friederich Nietzsche

Prolog

DON KISHOTI SHQIPTAR

Don Kishoti Shqiptar duke u mahnitur me Luftën e Kaçakut të maleve për liri, vendosi edhe ky të dalë maleve kaçak për të drejtat e shqiptarëve, Shqipëri Etnike. E thirri një Hoxhë dhe i tha: ti do të jesh Sanço Panço im, besnik në fushëbetejat që do t'i bëj unë me mullinjt e erës anë e mbanë Mëmëdheut.

- Mirë, Zotëriu im, i tha Sanço Panço. Po, çka do të fitoj unë si shpërblim, nëse bie dëshmorë pas luftës çlirimtare?

- Eh, Sanço Panço im! Pas lufte ty do të të shpërblej me një post në Qeveri: Ministër të Kulturës Shqiptare.

- Po, Imzot unë nuk kam shkollë, vetëm katër klasë fillore.

- Nuk prish punë kjo, Sanço Panço im. Shpërblimi fitohet me luftë.

- Zoti Komandant, a ta marr edhe Qenin e Sharrit me vete në luftë?

- Patjetër, Sanço Panço! Edhe atij i kemi dhënë pak bukë.

Dhe, Don Kishoti ynë Shqiptar i hipi kalit... Më falni, lexues i nderuar, harrova t'ju them se, kalin e tij e pagëzoi me emrin: DorZiu. Sanço Panço gomarit të tij me shalë. Armët i futën në Brez si trima. Mburojet në kokë. Qen Sharri pas tyre si shok lufte në çetë.

Dhe, iu ngjitën dhiareve malit Çelvjollcë për liri. Buçën e Katundit e lanë me fëmijë në gji në mes të lëmës.

Rrugës, papritmas Don Kishoti Shqiptar e pa ushtrinë armike. Kodrës i ngjiteshin barkas me armë në dorë. Vojvodën e tyre me shpatë mbi një kalë të bardhë me këmbë të thyer në ballë të ushtrisë pushtuese.

- Sanço, bërtiti si i çmendur sa kishte në kokë! Ushtria armike ngjitet tinës kodrës, do në befasi të na rrethojë. Luftë! Dhe, u sul kundër armikut me gjithë DorZiun me armë në dorë.

- Mos, Imzot! Mos u ngut, ajo nuk është ushtria armike, po “Makedonska enciklopedija” e shkieve?!

- Hesht, budalla! Ku di ti çka është ushtria armike. Urdhërin prano, dhe mos ia kthe fjalën Komandantit. Përndryshe, herën tjetër të pret dënimi.

Sanço Panço deshi s’deshi u turr pas Komandantit me armë në dorë. Don Kishoti Shqiptar iu sul me të gjitha forcat “Makedonska enciklopedisë” së shkieve. Sanço Panço me një legen në kokë e shpatë shelgu pas tij tyme-flakë. Edhe Qen Sharri me bishtin nën këmbë lehu pas tyre si në ujë.

Akademikët e shkieve, kur i panë kalorësit e arratisur se si u sulën mbi “vepër historike”, përulanë jataganët dhe e zdepën qotek Don Kishotin Shqiptar. Pastaj, edhe Sanço Pançon. I lanë me pak shpirt në fushën e betejës. DorZiut ia ndalën taxhinë në torbën e tij përqafe. Qen

Sharrit, që të mos lehë më pas tyre, i hudhën një copë buke.

Don Kishoti Shqiptar, kur e mori pak veten, i tha Sanço Panços:

- Edhe për këtë betejë të madhe duhet t'i tregohet Buçës së Katundit. Edhe në romanin tim të ardhshëm duhet t'i lëmë pak vend luftës heroike si fitore.

- Si urdhëron, Imzot. Edhe do të thërras në minare! Dhe, i ndihmoi Don Kishotit Shqiptar të hipë mbi kalë.

Matanë kufijve të Mëmëdheut, Don Kishoti Shqiptar i hetoi dy Bajloza të Zi, që posa kishin dalë nga Deti duke nxjerrë tyme flakë nga goja.

- Sanço, sulm mbi armikun, bërtiti Komandanti. Unë gjallë e këto troje në dorë të shkaut, kurrë! Shpatën e nxorri nga brezi dhe u sul me të gjitha forcat ushtarake. Tashti, do të na njohin mirë ata ne si kalorës të arratisur edhe në këtë copë "Shqipëri të Maqedonisë"!

- Imzot, mos u ngut! Nuk janë Bajloza të Zi, po janë mullinjt e erës të Mëmëdheut! E luti Sanço Panço dhe i mbylli sytë me dorë.

Don Kishoti Shqiptar, nuk dinte çka është frika. Armikut me një të rame ia nguli shpatën e tij famëmadhe mu në gjoks. Turbinat e Mëmëdheut u rrotulluan dhe e hudhën "patriotin" tonë bythekrye në përrua.

Sanço Panço vrapoi dhe e ngriti komandantin e tij me pak frymë. Qen Sharri ia lëpiu me gjuhë plagët e marra në luftë.

- Edhe për këtë betejë të përgjakshme duhet t'i tregohet Buçës së Katundit! Mezi i shqiptoi nga

plagët e marra, fjalët komandanti. Dihet Sanço, edhe kjo betejë duhet të gjej pak vend në romanin kryevepër botërore!

- Si urdhëron, zoti komandant, iu përgjigjë Sanço Panço. Dhe, e hapi një fletore që e mbante me vete t'i shënojë betejat e përgjakshme që i bënte Komandanti i tij për Buçën e Katundit. Qen Sharri me shputë i vuri vulë mu në mes të faqes.

- Edhe në minare, nësër do të thirr ezan, tha Sanço Panço.

- Patjetër, Sanço Panço! Betejat e përgjakshme që bëj unë me shpatë në dorë për këtë "copë Shqipëri të Maqedonisë" duhet t'i marr vesh edhe Buça e Katundit atje, në Akademinë e Shkencave dhe Arteve, në Shkup.

Një ditë në mal, Don Kishotit Shqiptar i dërgoi bukë Buça e Katundit. Zonja e rëndë e salloneve me një tepsi me fli në kokë e një vorbë me qumësht, ia shtroi drekën përpara mbi bar nën hije të lisit Komandantit.

Don Kishoti Shqiptar, gjatë drekës plot krenari i tha, Buçës së Katundit:

- Hë, çka thotë Katundi për trimëritë e mia maleve për liri?!

- Katundi as që ka marrë vesh se ti ke dalë kaçak. Po, ktheu te fëmijët! Tjerë burra pushke janë ata të armatosur deri më dhëmbë që dalin kaçakë maleve për liri.

Don Kishoti Shqiptar, kur pa se Katundi i tij, as që ka marrë vesh se ky "burrë" mejdani ka dalë kaçak maleve për liri, vendosi me gjithë Sanço Panço të kthehet në Katund te gruaja dhe fëmijët.

Edhe Qen Sharri me zgjebe pas tyre me një
asht në gojë...



I KALI TROJËS NA POLLI NË BIT - PAZAR

UJKESHA NUK E DO PËR BURRË KËLYSH MELEZIN ME ZGJEBE

Ujk Mal Çuka e kishte vështirë të zbres nga majat me lisa kokë më kokë që preknin qiellin me dorë, në Katund. Shkaku: I kishte të gjitha shërbimet aristokrate. Nuk kishte nevojë as për grua, as për kontejnerë bërlloku, as për pula të cofura, as për qëngja asht e lëkurë e as për këlyshë me zgjebe që “luftojnë” për Liri. Edhe pse, një Këlysh Melezi me zgjebe matanë gardhit në Katund, herë pas here ia dëgjonte të lehurat pas shpine. Nuk prish punë, thoshte Ujk Mal Çuka: Edhe atij “trimi” në Katund ia kam hedhur një asht qengji ta lëpi në Lëmë. Tekefundit, historikisht dihet se kush kanë qenë ujqërit, nuk kanë qenë këlyshë me zgjebe me një asht në gojë.

Ujk Mal Çuka, vërtetë është ujk, po e ka një burrëri të trashëguar nga të parët brez pas brezi: nuk të hanë pas shpine, nuk shpif dhe nuk leh në Iriq. E dini tashti ku është dallimi në mes të Ujk Mal Çukës dhe Këlysh Melezit me zgjebe?! Jo, nuk e dini. Shkaku: është këlysh me zgjebe. Fatkeqësi e madhe kombëtare: Këlysh Melezi me zgjebe ka lehur gjithë jetën në Iriq. Edhe më keq: I ka mësuar “vëllezërit” e tij se, vetëm me lehje pas shpine arrihet deri te Liria, kontejnerët e bërllokut në Bit - Pazar.

Ujk Mal Çuka nuk di për lehje pas shpine, nuk di për ndërsimin e “vëllezërve”, edhe atë: vetëm për një asht shpërblim. Besomëni, nuk ia ka inatë Këlysh Melezit me zgjebe. Edhe lakmi. E ka atë punë fakiri dhe nuk ka tjetër zanat. Zoti ia

ka nda lehjen pas shpine. Mençuri do të ishte, ky Këlysh Melez me zgjebe të kishte gjetur një grua nëpër livadhe, ndonjë strehë të ngrohtë për Dimër. Po, ku mund të gjejë ky këlysh me zgjebe strofull, përveçse t'i ngrej bythët në hava në kontejnerët e bërllokut.

E lihte sa mundej ky Këlysh Melez me zgjebe në Katund se, Ujk Mal Çuka ia hante natën rrunzat në vathë te Ara e Beshirit. E tureshte pas shpine plot pordhë e piskamë me të katra, shpifte çka t'i teket në kokë atij “asgani” me zgjebe. Këlysh Melezi me zgjebe me bishtin ndër këmbë, herë pas here dilte edhe te porta në rrugë, po kurrë nuk e merrte guximin të dalë edhe në male. Shkaku: I shpëtonte në brekë.

E vërtetetë: Ujk Mal Çuka i hante rrunzat kur ia prisnin rrugën te Lugu i Ymerit, i dilnin vullnetare para syve dhe e provokonin që të bienin si dëshmore. E dinë këtë punë të gjithë banorët e Pyllit. Edhe ndonjë qengj “me një zile në qafë varë”, kur ia turbullonte ujin te Lumi i Zajazit. Vetëmse ja, nuk e hante Këlysh Melezin me zgjebe. Ku ta di unë pse?! Ndoshta, pse kishte frikë mos i mbes nëpër dhëmbë, apo...

E Këlysh Melezi me zgjebe si këlysh katundi, plasi edhe sot e kësaj dite që ta haj Ujk Mal Çuka. E trimëronte veten në Katund. Ditën dilte edhe te Mulliri i Arapit. Gojën plot akuza e shpifje, i lihte pas shpine Ujk Mal Çukës. Ia priste rrugën nga pusia te burimi. E akuzonte ditënatë me thashetheme te Ujkësja. E çka nuk bënte Këlysh Melezi me zgjebe, që Ujk Mal Çukën ta nxjerrë si fajtor te dajallarët e tij në katundin,

Ferrëkërrocë. Përsëri, Ujk Mal Çuka kur e shikonte kaq të mjerë e të pafuqi, e shkundte vetëm kokën dhe vazhdonte rrugën dhiareve për në Baba Tomorr..

Gjatë kohë priti Ujk Mal Çuka, që ky Këlysh Melez me zgjebe me një asht në gojë, të pushojë së lehuri një ditë pas shpine. E njihte moti sojin e këtij këlyshi me zgjebe, që dikur kur kishte zbritur në Katund te Mulliri i Arapit t'i tregoj haramit kufinjt e Atdheut: Arat e Babait, Zabelet e Babait, Livadhet e Babait. Edhe atëherë, i kishte lehur tinëz pas shpine, por kur e kishte kthyer prapa kokën, e kishte parë se është këlysh me zgjebe, ende përjaget ferrave dhe iu dhimb, pasi e shikoi egër me sy vazhdoi rrugën. Tha: Ndoshta një ditë edhe ky i mjerë do të pushojë të lehi pas meje si këlysh me zgjebe. E fali fodullin bythëgrisur në Katund.

Përçudi, ky Këlysh Melez me zgjebe edhe sot vazhdon të leh pas Ujk Mal Çukës. E dinë të gjithë se ky Këlysh Melez me zgjebe, kurrë nuk u rritë një ditë në qen. Gjithë jetën mbeti këlysh me zgjebe. Përmëkeq, edhe i leh tinëz pas shpine Ujk Mal Çukës. E sulmon me shpifje fisin e Ujk Mal Çukës: Stërgjyshin, Gjyshin, Babain, Vëllain, Ujkeshën, ujqërit e vegjël... Përmëtepër, merret edhe me dukjen e Ujk Mal Çukës, e jo me veprimtarinë e tij artistike: çfarë kësule mbanë në kokë, mjekrën e tij, miket e tija që pushojnë gjatë verës në Bregliqen. E harron se ky fis malesh, brez pas brezi kanë qenë ujqër e jo këlyshë me zgjebe me një asht në gojë.

Edhe, për çdo “betejë të përgjakshme” që bënte me Ujk Mal Çukën, të nesërmen kërkonte që t’i tregojnë Pashterkëkuqes. E di Ajo: të gjitha betejat e përgjakshme i kam bërë për moralin e saj të fshehur nën ferexhe dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Shkaku: kurrën e kurrës nuk do t’i shkeli ato pasuri të tundshme nëpër fushë shkau. Edhe Rebel Rrapi që e ka nxjerr shpatën nga brezi në Bit - Pazar. E pret nën hije me dy shtamba verë në pusi.

Pashterkëkuqen, unë e solla nga malet me koçi, e jo Rebel Rrapi. Edhe kam qitë pushkë në Katund, kur zbriti Nusja në Lëmë. Tjetër është ajo se, Natën e Madhe kur hyra dhëndër dhe ia hoqa duvakun më doli kurvë. Fajin për këtë e ka Rebel Rrapi nën hije. Mjekroshi, që Nuses sime me pashterkë të kuqe i kishte vënë pusi me shtambaverë nën Rrap. Dhe, të nesërmen pasi e kishte provuar vetë si verën e kuqe në shtrat, ma dha mua patriotit me dy kobure në brez, tha: merre ti se është kurvë! Patriotit i ka hije kurva, e jo mua Rebel Rrapit me dy shtamba verë nën hije. Edhe, merreni me mend, më tha rebeli: ia pafsh hajrin! Dhashtë Zoti ta mbush Lëmën plotë me kopila! Edhe ata, t’i dalin zot si ti Atdheut. Luftë të bëjnë për Liri.

Dhe, e dini punën e qenëve dhe këlyshëve me zgjebe?! Jo, nuk e dini. Pyetmëni mua, Ujk Mal Çukën: Unë kam qenë në jetë edhe bari delesh. Qenëve nuk duhet t’u ikësh kur të ndërsehen pas shpine. Edhe më keq: këlyshëve të tërbuar me një asht në gojë. Ndaluni! Dhe, vetëm i shikoni drejtë në sy. Papritmas, do të pushojnë

të lehin, ndërsehen si kafshë të buta, bishtin nga frika do ta fusin ndër këmbë. E them këtë se: I kam kullotur dhentë me vite te Përroni i Thanës. Edhe i kam mjelë me kusi te Jasakët e Tikeve nën hijen e Dardhave Gorrice të Xha Derallës.

Ujk Mal Çuka si ujk, patjetër një ditë duhet të zbresi nga malet e Çelvjollcës në Katund. Edhe atë: vetëm e vetëm me një qëllim, që të shihet sy më sy me Këlysh Melezin me zgjebe. Nuk është larg ajo ditë. Gjeli, sot heret ka hipur në gardh dhe e thirrë agimin. Dita vjen, vëllezër! Dita.

Tekefundit, edhe, këtë nuk e dini? Jo, ë? Patjetër, duhet t'ua rrëfej edhe fyndin e këtij rrëfimi fantastiko - shkencor. Rrënjët, që i ka te përrallat e gjyshes sime plakë kur na i rrëfente netëve të gjata të Dimrit. Qoftëlargu, kur pasmesnate na trokiste te porta, e ajo përpiqeshte me përralla të na vë në gjumë. E përkundte djepin me shqiponjën dykrenare mbi kokë. Edhe ndonjë ninulë trimërie na këndonte në Katund. Trokitjet e Qoftëlargut, të mos i dëgjojmë ne hutaçët te porta. Nesër, heret në mëngjes t'i hipim kalit me shalë. Lapsin ta nxjerrim nga brezi.

E, çka u bë me Këlysh Melezin me zgjebe, do të më pyesni ju lexuesit në këtë rrëfim?! Të lehurat e tij plot jargë pas shpine me bishtin ndër këmbë. “Trimëritë” e tia këlyshçe për Liri, që u është ngjitur si rriqër për herdhesh heronjëve kombëtar me shkrime patetike. Merreni me mend, personalitetve tona kombëtare, që në kohën e komunizmit më së tepërmi i ka spiunuar te “vëllezërit” dhe u ka lehur tinëz pas shpine. E sot, plot tym e zjarr i përkujton me himne teknefese

patetike: Skënderbeun, Bajram Currin, Isë Boletinin, Kalosh Zajazin, Sulltanë Qafën, Adem Jasharin, Jusuf Gërvallën...?!

Asgjë më shumë se vajtime patetike. Ende vazhdon të leh i përjagur me bishtin ndër këmbë pas Ujk Mal Çukës, në Katund. Që, e ka amanet nga të parët një ditë të zbresi në Katund, vizitohet Këlysh Melezin me zgjebe te Mulliri i Arapit, t'ia mbyllë gojën. Portën krah më krah t'ia hapë Lirisë. Vetëm, e di një gjë: Këlysh Melezi me zgjebe një ditë me diell posa ta shoh Ujk Mal Çukën në sy, është aq trim i madh, sa që aty për aty do t'i shpëtojë në brekë, në mes të Lëmës.

Këlysh Melezin me zgjebe mund ta bëjë çkado të dojë ai në jetë, vetëm nuk mund ta bëjë poet dhe t'ia gjej një grua asgane. E them këtë se: Vite me radhë ia kam hapur të gjitha dyert, u përpoqa ta bëjë edhe shkrimtar. Përmëtepër, t'ia gjejë një grua. E kotë.

E, ku di ky Këlysh Melez me zgjebe çka është gruaja?! Pashterkëkuqja, Ujkësja ajo Muzë mali. Ose Liria, që e ka lidhur Këlysh Melezin me zgjebe natë e ditë në zingjirë te Mulliri i Arapit. E para: Ujkësja nuk është për këlysh me zgjebe. E dyta: Buça e Katundit me pashterkë të kuqe do qen Sharri. Dhe, e treta: Këlysh Melezi me zgjebe, nuk është i aftë për grua asgane me dy shtamba verë...

MAZI KUR DEL PARA PELËS

E ka thënë populli. Dhe, unë si shkrimtar s'kam çka t'i shtoj kësaj mençurie antologjike. Shkaku: sot shumë maza dalin para pelës. E ngrej në bishtin mbi shpinë Turren me të katra këmbët nëpër livadh. Edhe shesin mend, patriotizëm. Pordhë e piskamë. Thonë: janë “vepra artistike”.

O Imzot! Çfarë mendësh mund të shes mazi para pelës?! Bishtin kur e ngre mbi shpinë. Turret me të katra para pelës me bythën plot bajga. Përpiqet ta ngrejë pas vetes pluhurin mjegull rrugës nëpër Katund. E fëmijët, si fëmijët më, me brekët nëpër këmbë, dalin te porta dhe u bien duarve. Urraaa: Mazi ynë azgan ia kaloi Pelës. Tjetri, me barkun jashtë lakuriq, bërtet me këmbë e duar me një copë buke në dorë: Biro, ky është maz azgan e jo i yti që mezi ecë zvarrë rrugës pas Çuke. Ky maz ia kalon edhe kalit të Skënderbeut, që rri më këmbë mbi shalë në Sheshin “Skënderbeu”, në Shkup. Heroit tonë legjendar me shpatën në brez, që e pret një të nesërme ta kaloj Urën e Gurit, matanë Vardarit. Jo, shton tjetri: Ky maz ia kalon edhe gjokut të Gjergj Elez Alisë. E dini kush ka qenë Gjoku i Gjergj Elez Alisë? Jo, nuk e dini. Burreca, ka qenë gjoku që tym e mjegull me gjithë kreshnikun tonë në shpinë ka fluturuar mes mjegullave në qiell. Heshtni, nuk dini ju gjë për kreshnikët e Jutbinës, bërtetë tjetri majë një avlie. Ky maz hip edhe në Çelvjollcë. E, që nga ajo majë fluturon në Baba Tomorr. Ose, tjetri me kalë shelgu pa i zbritur fare nga shpina ua pret: mazi juaj azgan i hap

këmbët të pjellë në livadh ndonjë “vepër artistike”. Asgjë. E dini edhe pse?! Edhe këtë nuk e dini. E ka torbën me taxhi për qafe, që në kohën e Baba Dovletit.

Pela si pelë, i ka dhënë tambël në livadh. Zotëriu një torbë taxhi në grazhd. Që të nesërmen, kur të rritet t’i vë samarë. E ju si lexuesë të këtyre rreshtave do të thoni: pse jo edhe shalë?! Eh, këtu është problemi. Ende është i vogël për shalë. Hije i ka samari këtij mazi. E jo shala, që i rri bukur në shpinë vetëm atit. Samari ngarkohet me dru në mal, e jo shala. Edhe, thasët me drith t’i bluaj miell te Mulliri i Arapit. Po, pela nuk i ka dhënë fuqi mazit që të dalë para saj, t’i pri në rrugë përmes fushës me të katra në livadhe. Majave me dëborë. Dhiaret mes shkurreve kërkojnë trimëri dhe fuqi të ngjitesh në Çelvjollcë. E mazi ynë azgan vetëm ka dëgjuar për këto rrugë shkëmbore. Edhe atë: pela kur ia ka rrëfyer përralla patriotike rreth grazhdit, në Katund. E ka vënë në gjumë me ninulla netëve të gjata të Dimrit.

Qesharake, ë?! Mazi i pri pelës. Shenja Kiameti, do të thoshin hoxhallarët në xhami. Nesër, mund të ndodh Përmbytja e madhe. E Varka e Noes na mbeti në mesin e gojëdhanave popullore. Librave të historisë. Librave të këndimit. Fletoreve të poetëve “patriotë”, në Katund. Nuk kemi varkë e as Noe të na nxjerrë matanë në breg. Lumi rritet, del nga shtrati. Edhe vërshon arave. Plot dru e gurë hyn edhe në Katund. Lëmë. Katundarët më kot i kanë vënë prita te xhamia. Hoxha ka hip në minare, e thirrë

ezanin. I kërkon ndihmë Allahut. Ose, Poeti me këto vargje në libër:

*Urrejtja na i ka mbyllur sytë
Njerëzit o Zot i shoh pa kokë.
Dexhalli i tërheq rrugës zvarrë.*

*Një ditë mbi varre do të dalin të vdekurit
s' do të ketë kisha e xhamia të politizuara
do të flenë qafë për qafe nën shtrojë me yje
do të lahen në lumë e dritë të hënës
do të dashurojnë...*

*Ngutuni se një ditë do të përmytet toka
të vdekurit do të kthehen nëpër shtëpia...*

Peshqit do të na hanë të gjallë nëpër hurdha një ditë. Peshqit. Shpëtona, o Zot!. E përmëqej: kur ky maz “azgan” nuk e di se, kush i ka kërcyer nënës së tij në shpinë... Kali apo gomari...

**BOZAXHIU KUR VENDOS PËR VLERAT
E SHKRIMTARIT DHE KULTURËN**

SHQIPTARE

Ditë vere me vapë. Gjinkallat politike, kur t'i shkërdhejnë trutë, e ti nuk ke vend ku ta fusësh as kokën për strehim nën çati. Kohë, kur edhe asfalti është shkrirë në rrugë dhe të rrëshqet si akull në këmbë. Bërlloku pas porte të ka vënë pusi, të turret pas shpine. Toka digjet flakë, qielli mbi kokë vjellë zjarr. Populli thotë: “hyp se të vrava, zdryp se të vrava!...” Vend i nemur, ku ndërtesat gjatë ditës i gëlltisnin rrezet e diellit e gjatë natës i vjellin si kuçedra. E ti, i larë në djersë gjithë natën e gjatë rrotullohesh lëmsh nëpër shtrat. Ëndrra të tmerrshme: Bolla me flokë, Lugati, Tollosuni, Dexhalli... Djersë. Jerm. Xhinet të hedhin dorë më dorë gjithë natën majë lisave. Çative. Nën Rrap e “mbi Rrap”, siç thoshte njëherë moti nëpër Orët tona letrare deri në agim Xhaxhi Kuqezi. E pak para agimit të kthejnë në shtrat.

Ditës i ke hipur në shpinë. Matanë Urës së Gurit ia ke lidhur me një shami sytë. E ke shaluar me të katra Gjokun e Gjergj Elez Alisë rrugëve të Bit Pazarit. Pavetëdije se, rrugës me gurë mund t'i bien patkojtë si Kalit të Skënderbeut te Sheshi “Skënderbeu”, në Shkup. E ti më kot e kërkon nëpër sokaqe Lirinë, në gjithë Qytetin nuk ke nallban t'ia mbathish këmbët kalit. Rrugën ta vazhdosh me shokë. Tanushën e Krajlit ta sjellësh me koçi në Katund.

Dhe, një ditë Gjokut tim i ranë patkojtë. Nallban nuk gjeta në Qytet. Mezi e gjeta një ëmbëltore të marrë pak frymë. E pyeta

bozaxhiun: ç'po ndodh me këtë Qytet?! Nuk kemi nallbanë, nuk kemi bozaxhinjë, nuk kemi çobanë?! Buzëqeshi, dhe m'u përgjigjë: Banorët e këtij Qyteti të gjithë janë në fakultet. I përgatisin provimet e studimeve. I madh e i vogël duan të bëhen profesorë universiteti. Doktorë shkence. Politikanë. Ministra. Shkrimtarë. Këngëtarë. Analistë politik...

E çuditshme, i them pronarit. Po, ne nuk kemi nallbanë. Nuk ka kush të ma mbathë kalin me shalë. Nuk kemi bozaxhi. Çobanë të na i ruajnë dhentë. Baresha që t'i mjelin delet me kusia nën hijen e dardhave gorrice. Bujk të na i lëvrojë arat. E di, më përgjigjet me ironi. Fajin e ka Partia. Çobanët i ke në universitet. Bozaxhinjtë në Ministrinë e Kulturës. Kamarierët në Ministrinë e Arsimit. Rrugaçët kuqezi, këmbëkryq në Parti.

E hajdutët, e pyes unë?! Hajdutët?! Nuk kemi as hajdutë?!

Eh, hajdutët nuk rrinë më në Katund. Ikën. Rehat jemi gjatë këtyre viteve të “demokracisë”, kanë zbritur në Qytet. Na i mori Partia në Qeveri. I dalin zot Atdheut. E ruajnë nga intelektualët... Shkrimtarët... Gazetarët...

- Mos Zot më keq, i them. Dhe, m'u kujtua Bozaxhiu i Minsistrisë së Kulturës. E kishte dërguar Partia të vendosë “kritere, rend dhe rregull” për librin shqip dhe kulturën shqiptare. E ky burri i botës, kurrë në jetën e vet nuk kishte shkruar së paku një varg. E për sa u përket librave, nuk e di a ka ndonjë libër në shtëpi. Bibliotekë jo se jo, këtë e them me plot gojën. Edhe më keq, ky Bozaxhi i nxjerrë në dritë edhe

dy revista letrare për fëmijë. Shokëve të Katundit të tij, “Kryeqendrës kulturore të shqiptarëve” me dy universitete do t’ua kalojë në botimin e revistave për fëmijë. Shkaku se, në Katundin e tij, merreni me mend, dalin dhjetë revista për fëmijë????!!!... Nuk flasim këtu për vlera artistike, këtë më së miri e dinë mësuesit e atyre shkollave ku shpërndahen revistat dhe vetë nxënësit e pafajshëm, që janë mbi nivelin e këtyre trusakatëve. Inspektorët e arsimit. Unë sa për vete e di, nuk ka nevojë të më bindni se çka mund të pjellë ky tru bozaxhiu. Po, përsëri si duket kot: “ i bie samrit, që t’i teket gomarit”. Partia i do trusakatët. Shkaku meritave patritotike, që ishte fotografuar para kamerave televizive krahu për krahu me Vetëranin e luftës në mesin e varrezave të dëshmorëve, e kishin emëruar inspektor të arsimit Tollumbaxhiun. Trusakatin që mezi e kishte kryer fakultetin të një profesor, shok i imi me dy najlona specia. E shi, tashti Tollumbaxhiu përgatiste tezën e doktoraturës të një profesor i dëgjuar edhe matanë Atdheut, që në kohën e komunizmit, gjatë kohë kishte qenë edhe ambasador i “vëllazërim – bashkimit”.

E kanë pyetur deven: kur e ka pasur më vështirë në jetë? Është përgjigjur: kur më ka pri gomari. E po të më pyetni mua, do t’u përgjigjem: kur më pri Bozaxhiu...

HOXHA KUR THËRRET NË MINARE

Populli shqiptar ka krijuar me mijëra anekdota për hoxhën. Ndoshta, dhe letërsia popullore shqiptare është më e pasura në këtë zhanër. Ku ta dish?! Mundet. Filip Papajani një shkritmtar rilindas shqiptar ka thënë për hoxhën: *Njeri i soçëm me tru të moçëm*. Vaso Pasha: ka shkuar edhe më larg: *Feja e shqiptarit është shqiptaria...* Xha Deralla satirist i madh shqiptar i fshatit Cërvicë të Kërçovës, me anekdotat e tija të dëgjua e ka ndjekur këmba - këmbës edhe në minare. Një ditë hoxha i katundit e takon përpara portës dhe që ta trembë satiristin i thotë plakut:

- O Xha Derallë, pse bre burrë nuk vjen në xhami t'i lutesh për mëkate Allahut?! A e di se një ditë, në atë dynja do të digjesh në zjarr të Xhehnemit?!

- Jo, o hoxhë! E ke gabim. Shkaku se, përderisa të vij unë në Xhehnm, ti do të shkosh atje bythekrye përpara meje, dhe do ta kesh shuar më zjarrin...

- Estagpirullah!... Estagpirullah, ti në Xhehnm do të përfundosh arnë kazani, i kërcnohet përsëri hoxha.

- E ti, o hoxhë mendon se gjithmonë do të jetë verë?! Po, çka do të bësh në dimër, do të vish të më kërkosh pak zjarr! Jo, nuk do të të jap, rri do të të them, mërdhiu në Xhehnet!...

- Xha Derallë, më në fund u binda se ti je vetë Shejtani!

- Hi-hii-hiii... Jo, o hoxhë! Shejtan më të madh se ti nuk ka as në këtë dynja, e as në atë dynja...

- Estagpirullah! Estagpirullah, iku hoxha me të katra nga porta e Xha Mazllëmit, dhe u mbyllë me çelës në xhami.

Dhe, plot anekdota të tjera që i ka krjuar gojë më gojë nëpër vite e shekuj populli shqiptar për hoxhën. Tashti, e shoh edhe shkakun e gjithë këtyre anekdotave. Hoxhës, populli shqiptar më së shumti ia kishte parë dhe ia sheh ende sherrin. Hoxha, përveçse që i është kërcnuar popullit shqiptar me zjarrin e Xhehnemit, i është kërcnuar edhe me Hyqymetin. E ka spiunuar dhe e spiunon edhe sot e kësaj dite te pushteti.

Im Atë, shpeshëherë ma përsëriste një thënie të një neriu të mençur (Mahmut Dumani), që e kishte thënë në kohën e Luftës së dytë botërore: Këtë popull gjithmonë e kanë shitur njerëzit e “ditur”, hoxhallarët dhe intelektualët e shitur. Herët a vonë, përsëri do të vijë koha kur këtë popull do ta shesin toptan si dhenë në pazar njerëzit e “ditur”...

Dhe, ja për çudi erdhi ajo kohë. Popullin shqiptar në kohën e komunizmit me ndihmën e hoxhallarëve, serbët e përzunë në Turqi. Hoxhallarët kishin qenë ata që kishin dhënë e mbledhur nënshkrime pas lufte se, ky popull dëshiron të jetojë nën Jugosllavi, nuk do të bashkohet me Shqipërinë. Shkurt, ky popull, gjithmonë ia kishte parë sherrin hoxhës, njeriut të Allahut. Shembull: si puna e zogut që i besoi njeriut me çallmë, po ai ia theu krahun me gur. Dhe, në gjyq nuk ka kërkuar asnjëfarë dënimi. Vetëm, hoxhës t’i hiqet çallma! Shkaku se, do të marrë edhe shumë zogjë të tjerë më qafë.

Im Atë, shpeshëherë ma rrëfente edhe këtë anekdotë për hoxhën: Një hoxhë, pas faljes së teravisë e kishte vizituar si shpesh një vejushë. Vetëmse, një ditë e dikton i biri i vejushës. Djali nga zemërimi i thotë plot inatë të ëmës:

- Nënë, do ta vras hoxhën!...

- Mos, bre bir, përmbaje veten e lutë e ëma! Fakirin, mos e merr më qafë! Hoxhën një ditë do ta dënojë vetë Allahu...

Djali më në fund, pas lutjeve të së ëmës hoqi dorë, vendosi ta dëgjoj të ëmën. E priste Allahun që ta dënojë hoxhën. Prit një ditë, një javë, një muaj... po, Allahu nuk e dënonte hoxhën. Edhe më keq, hoxha tashti e vizitonte edhe më shpesh të ëmën e djalit, vejushën.

Një ditë prej ditësh, djalit më i erdhi te hunda. Vendosi t'i hakmerret hoxhës, të mos e pres më Allahun. E priti të hipë hoxhën në minare ta thirrë mesditën. Tinës xhematit, u përvodh shkallëve të minares dhe ia ngriti hopa, në hava këmbët hoxhës...

Në mbrëmje, kur u kthye i lodhur në shtëpi, nëna ia priti:

- A, të thashë bre biri nënës se, hoxha një ditë do ta gjejë belanë nga vetë Allahu?!...

- Po, oj nënë! E vërtetë. Vetëm se, edhe unë i ndihmova pak në minare Allahut...

O BURRGRUA, NËSE NUK KE PUNË

TJETËR LUAJE SË PAKU REZEN E DERËS

(*Ose: "Me thasha, nuk vritet Pasha" - populli*).

Letërsia popullore shqiptare është shumë e pasur, është krijuar para syve të armiqëve shekullor, tytave të armëve nëpër vite brez pas brezi. Dhe, jo rastësisht letërsia e shkruar shqipe është e arrirë artistikisht, rri krah për krah me letërsinë e popujve të tjerë të botës. Shkaku: i ka rrënjët e thella në letërsinë popullore, saqë nuk ka mundur dhe nuk mundet ta shkulë dot edhe gjatë dimrave me dëborë, asnjë stuhi, asnjë shtrëngatë. Furtunë, që e ka sulmuar herë pas here pas shpine. Gojën plot them: Letërsia shqipe rrënjët i ka thellë në tokë e degët në qiell.

Rilindasit tanë i kanë mbjellë arat me kohë. Vit për vit i kanë lëruar, mbjellur me hebe në krah. I kanë pastruar nga bari i egër dhe ferrat. Në fund, pasi e kanë fshi lëmën me grurë, edhe nga byku. Thasëve, ua kanë lidhur mirë grykën, i kanë shpie në mulli. Mullisi plak gjithë natën e ka bluar drithin, që të nesërmen t'ua ngarkojë në qerre fshatarëve. Mielli, kur ka ardhë në Katund, nëpër shtëpi, magjetoret i kanë përveshur duart dhe e kanë gatuar bukën.

Vallë, a nuk u gjason me bukën edhe letërsia shqipe?! Shkrimtarët me magjetoret. Po, atëherë, pse e luani rezen e derës?! Rexhep Qosja ka thënë: Letërsia shqipe nuk është ngjitur në nivelet europiane. Ismail Kadere: Rexhep Qosja është Revolucioni i vonuar demokratik.

Punemadhe, çka ka thënë Rexhep Qosja. Punemedhe, çka ka thënë Ismail Kadere. Nuk u bë nami për shqiptarët. Mund të thonë, çka t'u teket atyre në kokë. Tekefundit, prandaj edhe janë shkrimtarë. Profesionit i tyre i shkrimtarit ua lejon të thonë çdo gjë, por jo edhe ne lexuesve. Kotnasikoti të merremi me thëniet e tyre, në vend që të merremi me punën e tyre, librat. Gabimi më i madh i këtyre dy personaliteteve në jetë, është se: që të dy janë përpjekur të merren edhe me politikë. Fatkeqësisht, që të dy nuk janë parashikues, prandaj edhe kenë dështuar në politikë. Megjithatë, pasuri e madhe është që letërsia shqipe i ka këta dy gjeni. Dhe, vaj halli për ne shqiptarët t'i kishte vetëm këta, po ka edhe të tjerë që secili e ka vendin e vet në historinë e letërsisë shqipe. Merreni me mend, sa të varfër do të ishim ne shqiptarët sot po ta kishim vetëm Naimin!? Po, kemi edhe Jeronim De Radën, Asdrenin, Çajupin, Seremben, Filip Shirokën, Ndre Mjeden, Luigj Gurakuqin, Fishtë, Hil Mosin, Fan Nolin, Faik Konicën, Lasgushin, etj.

Frikë ke sot t'i hapësh gazetën. Faqet e internetit: Kadare është shkrimtar më i madh se Rexhep Qose. Rexhep Qose është më i madh se Kadare. E bëni veten nëpër mjetet e informacionit për pesë para. E shani kë mundeni dhe arrini me një fjalor rrugaçësh, që nuk u ka hije shqiptarëve. Vetën e fshihni pas pseudonimeve. Herë pas here shkruani mbarëprapë edhe në emër të personaliteteve publike. Edhe emrat e tyre pa fije turpi i merrni nëpër gojë. Shembull konkret: në emër tim personal shkruani dy komente ofendues

teknefes te Zemra Shqiptare, pas të cilëve nuk qëndroj unë si autor. Edhe pse e dini se, lexuesi i shkrimeve të mia fare lehtë mund t'i hetojë se nuk janë të stilit tim, natyrës sime të shkrimtarit. Lexuesit ia ngatërroni trutë, i bëni lëmsh. Lesh harapi. Thashetheme, jeni bërë si ato plakat e këqija pas gardhit.

Edhe Kadare, edhe Qose jetuan, u shkolluan, vepruan dhe u afirmuan në komunizëm. Njëri i lindur në Shqipëri, e tjetri në Jugosllavi. Vetëmse, kjo nuk do të thotë se këta dy gjigantë të letërsisë shqipe nuk kanë vlera të arrira artistike. Edhe sistemi komunist i Enver Hoxhës dhe ai i Shokut Tito kanë dhënë gjeni. “Demokracia” e soçme, pritet të shohim nesër, vetë një ditë do të flasë koha. Dhe, që të dy i kanë vlerat e veta si personalitete shqiptare. O burrgrua, ku do të ishte ajo e mirë sot, po t'i kishim edhe dy - tre Kadare, dy - tre Qose, ne shqiptarët! Pse jeni rrokur kokë më kokë me brinja mbi urë të lumit si ato dy dhitë kryeneçe të përrallës sonë popullore?! Humbasni kot kohë, kur ne shqipëtarëve na presin plot punë të mëdha. Përmëkeq, siç duket i keni harruar edhe vargjet e Çajupit:

*Shqipërin' e mori Turku,
i vu zjarr!
Shqipëtar, mos rri, po duku,
Shqipëtar!
Mjaft punove për të tjerë,
o fatkeq!
Kujto vendë tek ke lerë
dhe tek heq!*

*Të ka bërë Perëndia
Luftëtar
Si s'të lodhi robëria,
Shqipëtar!*

Natë e ditë trumbetoni nëpër gazeta. Faqe të internetit. I shani të vdekurit e të gjallët. E në anën tjetër, e harroni letërsinë shqiptare. Botërore. Shembujt e asaj letërsie se, për së gjalli pak artistë kanë gëzuar famë botërore. Pasuri. Rrezik i madh është për artistin, që për së gjalli gëzon famë botërore. Shumica e gjenive kanë vdekur si qentë në rrugë edhe pa bukën e gojës. Nuk ka pasur njeri t'i shti edhe në varr, hedhë një grusht dhe mbi kokë. I tillë ishte Asdreni. Rilindasit tanë nëpër botë. Uolt Uitmeni. Sharraxhi. Autori i librit me poezi: *Fije bari*. Që, librin e tij të vetëm e botoi me para të veta, ndau nga kafshata e gojës. Kritikët amerikanë e shanë më së shumti si shkrimtar. E ai në atë kohë iu përgjigjë: O Amerikë, unë jam Uolt Uitmani i madh! Budallai, thanë kritikët e “mëdhenj” të asaj kohe. E kanë lënë krejtë mendtë, ato të shkreta. I çmenduri paska shkalluar përtej çdo kufiri. Mëshirë, o Zot!

Uolt Uitmeni një ditë vdiq. Plot pas njëqind vjetëve, *Fije bari* e pushtoi botën. Edhe këtë nuk e besoni?!

Veten e paçit në qafë...

KALI TROJËS NA POLLI

NË BIT - PAZAR

E di. Edhe këtë “trim mbi trima”, nuk e njihni në barkun e Kalit të Trojës nëpër Bit – Pazar. E them se, atë ditë kur unë ia ngrita Kalit të Trojës bishtin në libër, edhe ky hyri me shokë në bark të kalit. Kalin e Trojës, atë ditë na e lanë “vëllezërit” pas porte, në Bit – Pazar. DoktorZiu doli natën, e tërhoqi për freri dhe na e futi kalin e drurit me gjithë “patriotë” kuqezi brenda në Qytet.

Është mirë që nuk e njihni si “patriot” melez. Dhe, fitore e madhe që nuk e njihni nëpër Bit – Pazar duke i përdredhur bythët. E shihni për çdo ditë në syrret në gazetën e tij partiake. Edhe në shkrimet e tija patetike. Teknefese. Edhe njëherë përsëritem, mirë që nuk e njihni këtë “patriot” melez, që lufton për Shqipëri Etnike. Vërtetë, duhet të jeni të lumtur dhe t’i falemnderoheni Zotit.

Dhe, çka u duhet ta njihni PatriotZiun?! I dëmshëm për familje. I dëmshëm për shoqërinë. I dëmshëm për letërsinë. I dëmshëm për Shqipëri Etnike...

E kush është, PatriotZiu?!

PatriotZiu, është shkrimtar Oborri. Gazetar partie. Publicist Qeverie. Analist politik. Politikan. Rrufjan. Dumdum i Partisë Komuniste në atë kohë, i shëtitur nëpër redaksi komuniste, e sot maz katundi i Partive Politike Shqiptare, që na e polli Kali Trojës, gjatë Natës së Madhe “demokratike”, në Bit – Pazar.

PatriotZiu, sot u ndërsehet Partive Politke Shqiptare, kur nuk i japin ndonjë post zëvendës drejtori. Ministër në Qeveri. U ndërsehet manifestimeve tona kulturore. Revistave letrare. Shkrimtarëve shqiptarë disidentë duke i denoncuar te “vëllezërit” si të rrezikshëm për shoqërinë. Dhe, Shtetin.

E ka thënë një herë populli. Dhe, nuk kam çka t’i shtoj unë më tepër kësaj thënie popullore kaq të përkryer: Qeni i keq ta bie Ujkun në Shtëpi. Vetëm, “patriotëve” të Kurvës Parti, mund t’u shes dushk për gogëla. Vërtetë, janë gjysëmanalfabetë. Nuk e di, a posedojnë ndonjë diplomë të shkollës së mesme, apo jo. PatriotZiun e di, i ka kryer sa për bela nja tre vjet shkollë ndërtimtarie në gjuhën e “vëllezërve”. Nuk është rritë me librat e rilindasëve tanë në Shtëpi. Dhe, kurrë nuk i ka mësuar vjershat e tyre përmendësh në shkollë. Edhe kjo nuk ka rëndësi. Mjerim.

Vëretë, më vjen keq për këta kalemxhinj, që përpiqen dhe shterzojnë si lopa kur e pjellë viçin, t’i hedhin dy fjalë bashkë në gazetën e tyre të “pavarur” partiake. Vështirë e kam, edhe t’i fajësoj më tepër në këtë libër, fajin e ka “pasur” koha. Sistemi i atëhershëm komunist, që i ka mashtruar në shkollat e “vëllezërve” me gjuhën e perspektivës, ardhmërisë.

Gjatë këtyre viteve “demokratike”, përsëri polli Kali i Trojës në Bit – Pazar. Çarshia e Vjetër u mbush plot me maza patriotë të palëpi. Hingëllonin. Turreshin mbi Urën e Gurit, matanë Vardarit. E ngrenin bishtin mbi shpinë, sa herë që i ndiqte pas *Zekthi*. Herë pas here qitnin edhe

shqelma. Ditën nën Rrap, pinin çaj rusi. I luteshin Zotit në xhami për mëkate. E natën dilnin matanë Vardarit, kokë më kokë me “vëllezërit”. I kullosnin dhentë e nënkryeme që i kishin në kokë. I lëshonin edhe maleve. Ujë u jepnin te Qeveria “demokratike”, nën Kala.

Ujku i priste këmbëkryq te Ura e Gurit. Qengji i vogël me një zile në qafë varë, më kot u përpoq të pi ujë te Lumi. Ujku i kishte vënë pusi. E akuzoi:

- Hej, ti vogëlush që pi ujë në Lumë, pse ma trubullon ujin?!

- Unë, nuk ta turbulloj ujin, o burrë! Uji rrjedh teposhtë nga ti tek unë. Vetëm ti mund ta turbullosh ujin që pi mbi mua, në Qeveri! E jo, unë në Katund.

- Atëherë, me siguri vitin e kaluar ma ke trubulluar ujin, gjatë zgjedhjeve parlamentare të Pyllit. E di unë këtë pabesi, më ka treguar PatriotZiu.

- Jo, o zotëri! Unë kam lindur këtë vit, mezi iu përgjigj Qengji duke u dridhur purtekë nga frika në breg.

- Në mos ti, atëherë Babai yt ballist, i bërtiti Ujku. Edhe për këtë pabesi më ka treguar PatriotZiu. Dhe, i kërceu Qengjit në shpinë...

Përralla popullore thotë: Që, atë ditë te Lumi, Ujku dhe qengji kurrë më, nuk u bënë miq. Ujku e ka mik besnik, DoktorZiun. PatriotZiun. Qenin e Sharrit. Këlyshin e Llagut. Këlyshin e Sharrit. Edhe Buçën e Katundit... Po, jo edhe Qengjin me një zile në qafë varë. Që, sipas vjershës së Rexhep Hoxhës: *me dy brinja dap e dap, do të më*

*qes mua në trap. Po, nuk më qet se, më ka shok.
Prandaj, jemi të dy tok...*

Ujku e Qengji vite me radhë janë armiqë shekullor. Edhe pse, Ujku i thotë se e ka mik. E do Qengjin shumë, si vëlla besnik. Vit për vit e fajëson se, ia turbullon ujin nën Urën e Gurit... E gjykon te Lumi...



**RA “MAKEDONSKA ENCIKLOPEDIJA”
DHE I NXORRI “PATRIOTËT” E VONUAR
NË SIPËRFAQE**

Eh, lexues i nderuar, kurrë nuk e kisha ditur se kemi kaq shumë “patriotë” të vonuar në fushën e mejdanit. E dija një: Patriotin e vonuar melez. Edhe nja dhjetëra të tjerë anë e mbanë trojeve etnike të Atdheut. Po, tek tashti e shoh se qenkan shumë, me qerre. Dhe, çuditem në “demokraci”, prej nga sot na dolën gjithë këta “patriotë”?! Zjarr e flakë nxjerrin nga goja: për gjuhë shqipe, shkollë shqipe, kulturë, për të drejta kombëtare... Shqipëri Etnike. E në anën tjetër, gjithë jetën mbetën argatë, lypsa te Ura e Gurit për të drejta kombëtare. Ecin në vend. Ose, bythëprapë në rrugë.

Faji qenka te “vëllezërit” sllavomaqedonë. Nga gjumi shekullor na zgjojnë vetëm ata kur të duan, na nxjerrin në rrugë. Përndryshe, ne do t’ia futnim gjumë edhe një shekull të tërë në kokërr të shpinës. Them: shyqyr Zotit që i kemi “vëllazërit” e Njerkës. Herë pas here na e hudhin grepin me nga një krimb në lumë. Na e prishin gjumin dimëror. Dhe, ne turr i madh e i vogël pas krimbit bythekrye në grep: njëri e kthen çmimin e Akademisë. Tjetri, anëtarësinë nga ku e merr për çdo muaj taxhinë. I treti: e ngre më këmbë të madh e të vogël në protesta, e nxjerrë në rrugë. DoktorZiu: akademik, shkrimtar, eseist, kritik letrar dhe përkthyes shqiptar nga Maqedonia do të thotë: “s’ka kuptim të jem anëtar nderi i AMSHA së, kjo enciklopedi nxit urrejtje dhe racizëm. Prej

vitesh kam njëfar lidhje me këtë institucion. Pasi mbaj titullin anëtar nderi i kësaj Akedemie. Por, tashmë jam gati të jap dorëheqjen. Pas këtij skandali nuk ka më asnjë kuptim të vazhdoj të jem në këtë pozicion, deklaron “akademiku”. Sllavoshqiptari tjetër, do të deklarojë: “nëse ndaj kësaj vepre nuk merren masa përkatëse nga Akademia, atëherë do të distancohem nga ky institucion. Dhe, fajin ua hudhë partive politike shqiptare: vetëm partitë nuk reagon”. Tjetri, alamet akademiku: “Edhe unë i kam afruar Akademisë realisht t’i ndihmoj që të formohet pse jo një njësi e veçantë që do të studioj gjuhën, kulturën shqiptare si dhe historinë që ka munguar deri më tani.”(???!!!...) E pse jo, pyes unë: Akademi Shqiptare???!!!.. Patrioti i vonuar melez do të arrijë kulminacionin e marrëzirave: “Shqiptarët ta djegin enciklopedinë në mes të Shkupit”! O Imzot, përpara syve të botës librin pa asnjëfarë faji e dënojnë si dikur në Mesjetë shtrigën, në turrën e druve. Thashetheme. Fjalë dhe vetëm fjalë. Veprat, dihet i bëjnë “vëllezërit”.

Nuk i përmend këtu edhe këlyshët e tyre me zgjebe që qajnë e vajtojnë, ngase ata gjithë jetën kanë derdhur lotë krokodili në mjetet e infomacionit, po jo edhe punë. E “vëllezërit” nuk qajnë, nuk derdhen lotë, ata punojnë natë e ditë. Vajtocat shqiptare, ende nuk e dinë se me vajtime nuk fitohet lufta. Vite me radhë bëjnë gjumë arushë në prehërin e partive politike. Dhe, kur u vjen veja te bytha, turren si pula me piskamë e kakarisje të arrinë te koteci, e lëshojnë në lëmë.

E “vëllezërit” sllavomaqedonë si gjithmonë rinë këmbëkryq në Qeveri, përderisa shqiptarët merren me reagime e protesta në rrugë për gjuhë shqipe, shkolla shqipe, flamur e të drejta kombëtare, e përvetsuan ekonominë. Shtetin. Përditë e më shumë investojnë në arsim dhe kulturë. Ndërtojnë shkolla, shtëpi opere, teatro, shtëpi kulture edhe nëpër katunde. Manifestime kulturore brenda e jashtë vendit. Kohën e fundit edhe Encikopledi maqedonase, ku shqiptarëve u thonë se kanë zbritur nga mali. Kaçakë, që i kanë rrëmbyer pasuritë e “vëllezërve” të tyre sllavomaqedonas. E çkamos. Falë Zotit, vetëm që nuk thonë se ua kemi rrëmbyer edhe gratë nga shtrati. Ku ta dish, nesër mund t’u teket edhe ky “zbulim shkencor” në kokë, e fusin në Enciklpedinë e tyre sllavomaqedonase. Të nesërmen, bërtitë ti kot sa të mundesh nëpër gazeta e rrugëve të Shkupit. Gjygin e drejtësisë. “Vëllezërit” e shkruajnë historinë. Kush të ka ty faj, që gjithë jetën u more me thashetheme, vajtime: gjuhë shqipe, shkolla e flamur. Gjatë ndryshimeve “demokratike” me “vëllazërit” i ndave lugët e enët. E atyre ua le Shtëpinë. Pasurinë e patundshme.

Dhe, hop papritmas një ditë ra “Makedonska enciklopedija”, dhe na i nxorri “patriotët” e vonuar në sipërfaqe me gjithë kravata kuqezi, tespi kuqezi. Shqip: me bythët na, palare në diell.

O Imzot, po ku kishin qenë deri më tani gjithë këta “patriotë” të vonuar, ku e kishin futur kokën?! Vite e vite nuk ua kishim dëgjuar zërin.

Shumica e tyre gjatë kohës së Luftës (2001), ikën në Kosovë. Shqipëri. E pas lufte u kthyen si huta me veshë, doli së kishin luftuar maleve për liri. Trima pas lufte. U rreshtuan te Partia “Demokratike” për poste. Vende pune. Edhe në xhami, u turrën të parët t’i luten Zotit për mëkate para këmbëve të Hoxhës. Shkurt, ti me shokë nuk arrite me kohë i pari, mbete te dera. Edhe te Partia “Demeokratike” mbete i fundit. Rrugaçët kuqezi veç më i kishin zënë vendet e para. Edhe te Shtëpia e Allahut, xhamia mbete në oborr. Hajdutët veç më faleshin, i luteshin Allahut. Koha është të pajtohesh me fatin. “Patriotët” e vonuar, vërtetë në politikë janë të pa aftë, ama në këto vrapime maratonike pas posteve, nuk ua kalon njeri. Partitë i ndërrojnë si kurva burrat. Dhe, nuk është kurvë gruaja që shkon burrë më burrë, po kurvë është “patrioti” që shkon parti më parti politike.

Dhe, pse çuditësh sot, ku ishin strukur deri më tani gjithë këta patriotë të vonuar me tapi partiake, me qerre?! Gjithë këta politikanë. Gjithë këta ministra. Gjithë këta akademikë, gjithë këta shkenctarë, gjithë këta shkrimtarë, gjithë këta gazetarë?! Përsëri thua, duhet të na zgjojnë nga gjumi “vëllezërit”?! Argatët tanë kur t’u teket t’i nxjerrin me reagime të “ashpra” në gazeta, protesta, në rrugë.

Jo, them unë. Shkaku se, me vite ishin strukur në Qeveri. Minisitri. Kabinete. Redaksi. Gjumë arushe bënin në kokërr të shpinës në shpellat e “vëllezërve”. Verës dilnin fshehtas pas mjaltit.

E pushtojnë Universitetin Shtetëror të Tetovës çdo katër vjet me partizanët e tyre partiak, kur e marrin pushtetin e argatëve. Patjetër, në këtë Universitet thonë, duhet të ketë rend e rregull. I punësojnë partizanët e tyre partiakë gjysëmanalfabetë. Familjarët. Miqtë. Kopeisht me në krye DoktorZiun e uzurpuan edhe Seminarin e vetëm të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të këtij Universiteti, që ende plagët i kullojnë gjak. U fotografuan në rendin e parë me ish Komandantin e UÇK – së krah për krah me DoktorZiun. Mjerim kombëtar. Zot, mos e bë më keq! Sofrën e iftarit e shtruan gjatë muajit të Ramazanit nëpër parqe me ilahi. Drekën e Bajramit të Madh e hëngrën në hotelin e “vëllezërve”. U fotografuan përpara kamerave televizive me “vëllezërit” qafë për qafë. E bënë para syve të popullit Shqipëri Etnike...

Fati madh i tyre, që Muhamedi a. s. nuk është ende gjallë se, me një të rame me shpatë kokën do t’ua hudhte para këmbëve haramëve... Edhe Skënderbeu, nga zemrimi do ta humbëte më durimin, do ta nxirrte shpatën namëmadhe nga brezi: mjaftë më u përjagët për liri para këmbëve të kalit tim në Bit - Pazar!... Argatë të përjetshëm brez pas brezi, që nuk dini ku e keni kokën e ku bythën...

Në fund, pas gjithë këtyre reagimeve, vajtimeve të “patriotëve” me qerre them: E pamundshme është t’i ndodhë një fatkeqësi e këtillë një populli?!...

Hi-hi-hiii... Po, ja që i ndodhi. Edhe do t'i ndodhë, përderisa i ka ende në ballë këta “patriotë” të vonuar me kokat nën sjetulla...



VETËVRASJA POLITIKE

(Shkas: intervista e një politikani dhe tre akademikëve, në TV Klan Kosova).

Vetëvrasja. E njohur si fenomen, qysh moti në shoqëritë botërore, po ja kohën e fundit edhe në shoqërinë shqiptare. Dihet, nuk është e natyrës shqiptare. Shkaku: ngase nuk e kemi në gjak. Shpirt. Vetëvrasjen, nuk e lejon edhe Kurani. E bëjnë individë me karakter të fortë në letërsi. Shkencë. Ne, të tjerët, që nuk e kemi këtë karakter, notojmë në oqeanë, ende jemi gjallë. Po, ja që kohën e fundit edhe ne përballohemi me këtë dukuri të sëmurë shoqërore. Vetëvrasjen e bëjnë njerës të politikës, shkencëtarë, shkrimtarë, gazetarë, edhe të tjerë.

E rëndësishme është se kemi dy lloje të vetëvrasjeve:

- Vetëvrasje të njerëzve që kanë përfunduar në varr dhe:

- Vetëvrasje politike të njerëzve që ende janë gjallë mes popullit.

Unë kësaj radhe do të merrem me individë, që bëjnë vetëvrasje politike dhe ende janë gjallë në Qeveri. Burra, që nuk i do edhe Zonja Vdekje. Varri. Shkaku se: për të ardhë deri te një përfundim i këtillë, unë kam ardhë falë mikut tim Poet (nuk do t'ia përmend emrin, lexuesi i shkrimeve të mia e di rebelin), që e vazhdon jetën në varr. Botën tjetër qiellore.

Tjetër, janë vetëvrasjet e karakterit të intelektualëve. Dhe, karakterit të politikanëve. Politikanët i ka vrarë Partia, ose ndonjë

kundërshtar politik. Spiun. E thashë: që në fillim se, nuk do të merrem kësaj radhe me individët intelektualë, që i ka vrarë shoqëria. Shteti. Po, do të merrem me individët që i ka vrarë spiuni, DoktorZiu... Kurva Parti... Shteti “demokratik”.

Fatkeqësi kjo, e jona kombëtare. Populli e ka thënë: kurrë mos shko pas gomarit, po pas ujkut, tigrin, luanit... Dhe, të bie të plasësh gazit nga kurrizi, kur i sheh në skenën politike, politikanë të paaftë që kanë dalë në ballë të popullit dhe i shkojnë pas gomarit. I fryjnë zjarrit euforik të popullit. Qafë për qafe fotografohen përpara kamerave nëpër seminare shkencore, emisione televizive. Propagandave të kurdisura politike edhe në këtë kohë moderne për hapjen e Universiteteve Shtetëror e privat. Degëve të Universiteteve Shtetëror nëpër qytete e katunde. Fabrika prodhimi të gjysëmanalfabetëve me diploma universitare. E harrojnë se, ne tashti nuk kemi studentë, profesorë Universiti. Tekste universitare. Dorën në zemër, ne nuk e kemi më problemin e hapjeve të universiteteve si dikur në kohën e komunizmit famëkeq e të “vëllazërim – bashkimit” jugosllav.

Shtriga plakë, përsëri doli nga Shpella e akademikëve. E panë me sy të gjithë banorët e “Oazës së paqës”, bota. Na i trembi fëmijët edhe kësaj radhe në gjumë, natën. Don Kishoti ynë me tre Sanço Panço shqiptar, më kot i dolën para matanë kufirit politik të Atdheut. Heroikisht, përpara popullit demonstuan “mençuri e trimëri” në rolin e Dragonit të përrallave popullore. Rrëfenin përralla të moçme shqiptare para

kamerave televizive. Fatëkeqësisht, asnjëri nuk pati guxim me armë historike, t'i dalë në dyluftim ballë për ballë Shtrigës, rrokë për flokësh. Dhe, ta hudhë në turrën e druve përpara syve të botës. Flaka e zjarri t'i shkojë përqielli... Piskama... Tekefundit, së paku t'ia plotësonin dëshirën Patriotit të vonuar melez: Shtriga duhet të digjet në turrën e druve, në mes të Sheshit.

Shtriga edhe në të ardhmen do të vazhdoj të na i trembë fëmijët natën. Herë pas here do të dalë nga Shpella akedemike si kulshedër me dy koka duke vjellë zjarr e flakë nga goja. Edhe atë: në mes të Ditës. Në mes të Natës. Në mes të Verës. Në mes të Dimrit. Fshisës i ka hipur moti në shpinë dhe fluturon me vite mbi kokat tona, arat tona, malet tona. Tamerrmendja, edhe do të fluturojë si kalorëse e arratisur mbi kokat tona deri atë Ditë, përderisa nuk i delë për mejdani Dragoi soçëm i përrallave të moçme shqiptare me shpatë në dorë, ta hedhë bythekrye në turrën e druve, në zjarr.

O Imzot, ua kthe në kokë! Nëse, është nevoja do të vij edhe të lutem në xhami e kishë! Përpara këmbëve të Hoxhës e priftit do t'i ngrëjë duart e bythët në hava, për mëshirë! Ndez qirinj për të vdekurit e të gjallët. Edhe pse, nuk kam kohë, pesë vakte t'i falë në ditë, në xhami. Vetëm e vetëm, mos u thuaj se duhet të shkojnë pas gomarit. Nuk e duron këtë natyra ime, gjaku i shqiptarit. Shaku se: kurrë brez pas brezi nuk kam shkuar pas gomarit.

E them këtë se, çdo gjë ka kufi. Vetëm se, a e di gomari kufirin?!... DoktorZiu?!... Jo, nuk e

di. Gomari e di samarin. Dhe, taxhinë e përditshme, një torbë për qafe. Në fund, shkopin bythëve. Në mes të udhës të shtrihet në pluhur dhe të pëllasë si gomar. Pse?! Edhe ai nuk e di vetë, si gomarë me samarë. E di vetëm një gjë se: e thërrasin në dasëm. E kurrë nuk i shkon mendja se, nuk e thërrasin pse është i mençur ose i bukur, po e thërrasin për të bartë në shpinë ujë për dasmorët. E populli thotë: i mbyturi kapet edhe për një fije kashte. Megjithatë, kësaj radhe nuk shpëtoi nga rryma ujore, po u mbytë me gjithë shpëtimtarët në hurdhë.

E, çka di DoktorZiu?!... E di, ku e ka kokën, po bythën, ë?!... Bythën, dihet te “vëllezërit” e Njerkës. Atëherë, binu duarve shuplakë për kokën e tij në hale!...

Edhe DoktorZiut, nuk dua t’ia përmend emrin se, dua të vjellë! I kam vjellë edhe zorrët, po nuk kam më çka të vjellë...

PATRIOTI

Nuk e di çka mu kujtua sot, pas kaq vitesh Patrioti me kësulën e bardhë në kokë. Dhe, ajo kohë revolucionare e viteve të '72 - ta, në Prishtinë. Fajin me siguri do ta kenë gazetat tona në gjuhën shqipe. Librat e “rrezikshëm”, që në atë kohë qarkullonin dorë më dorë. Ose, faqet e internetit plot sharje e ofendime.

Nuk ka rëndësi për lexuesin kjo histori ditore. E rëndësishme është se, në atë kohë komuniste të “vëllazërim - bashkimit”, ne shqiptarët për një fjalë goje ndiqeshim këmba - këmbës për nacionalizëm e irrendetizëm. E Patrioti me kësulën e bardhë në kokë shëtiste lirishtë rrugëve të Prishtinës. Nuk i jepte pesë pare. Përpara hundëve të sigurimit e mbante në kokë kësulën e bardhë. Edhe na përshëndeste, për inatë me krenari: Tungjatjeta!

Tungjatjeta, ia kthenim ne me frikë duke vazhduar rrugën me të katra drejtë Fakultetit Filosofik. E lakmonim shenjën e Skënderbeut, që e mbante ai haptas në setre. Edhe kësulën e bardhë në kokë. Po, nuk na e mbante bytha, nuk kishim guxim ta pyesnim ose bisedonim më gjatë për kësulën e bardhë, Patriotin e Prishtinës. Punën e tij patriotike legale e mirrnim si shaka të kohës. Provokim për ne studentët ilegalë, ose pushtetin e egër të atëhershëm sllavokomunist që na rrinte si sëpatë mbi kokë.

Përditë e shihnim rrugëve të Prishtinës Patriotin me kësulë të bardhë. Kohë kjo, kur kishim frikë të zgjohemi në mëngjes, të dalim në rrugë. Në çdo hap provokime. Spiunë që na ndiqnin pas shpine në Universitet. Menzën e

studentëve. Edhe në Bibliotekë se, çfarë librash lexonim mes atyre raftimeve për atë kohë të dyshimtë. Në mesin tonë kishim edhe të atillë “studentë”, që bashkëpunonin me sigurimin. Nga njëra anë na e jepnin romanin *Tradhtia* të Kapllan Resulit që qarkullonte në mënyrë “ilegale” dorë më dorë, e nga ana tjetër të nesërmen na denonconin në polici. Përmëtepër, përveç çotekut i hanim kot edhe pesë vjet burg. Vetëm e vetëm, pse na e kishin gjetur mes librave në banesë, romanin e “rrezikshëm”. Fatmirësisht, unë gjatë kohës së studimeve, nuk e mora këtë roman nga “lexuesit” e sigurimit me arsyetim se nuk kisha kohë për lexim, isha i zënë me provime. Nuk e di pse më kishte hy në kokë si pykë se, atë roman sigurimi e kishte hedhur si grep për ne studentët shqiptarë. Shkak ky, që i shpëtova edhe burgut famëkeq komunist të Goli Otokut. Vetëm një e thirrur në rrugë: Kosova republikë, të nesërmen na kushtonte hiç më pak, pesë vjet burg nëpër zandamet e famëshme të Jugosllavisë komuniste.

Vite më vonë, përsëri në kohën e komunizmit famëkeq jugosllav, rreth viteve të ’80 - ta, kur më unë u ktheva në Shkup, u habita me romanin e “ndaluar” *Tradhtia* që e gjeta në raftet e Bibliotekës Popullore Universitare: “Sv. Kliment Ohridski”. Përçudi, në këtë Bibliotekë universitare, atëherë i lexova edhe librat e tjerë të “ndaluar” të këtij autori “antijugosllav”, që kishte “ikur” nga burgu në Shqipëri: *Ushtima e Korabit*, *Gjarpëri* etj. Vetëmse, kësaj radhe nuk mi jepte “lexuesi patriot” i sigurimit të atëhershëm jugosllav, po bibliotekistët e Shtetit

sllavokomunist. E dija se, edhe këtu mbanin evidencë se kush çka lexon, po kjo nuk ma lodhte shumë kokën. Fundi i fundit, librat e “ndaluar” i lexoja në Bibliotekë. Dorën në zemër, kjo Bibliotekë Universitare ishte shumë e pasur me beletristikë, sidomos me libra të botuar në Shqipëri, që ne në atë kohë vështirë i shtinin në dorë me të cilët e kalonim natën. Fatkeqsisht, Biblioteka Universitare e Kosoëvës në krahasim me këtë bibliotekë ishte shumë më e varfër. Asaj kohe, unë kisha dëgjuar nga të burgosurit politik, që e kishin vuajtur dënimin në Idrizovë se, në Maqedoni: bibliotekë shumë më e pasur edhe se kjo universitare “Sv. Kliment Ohridski”, është ajo e burgut famëkeq të Idrizovës.

Vite më vonë autori “antijugosllav” i romanit *Tradhtia* do të bie në burg, si spiun jugosllav i dërguar në Shqipëri. Pas ndryshimeve demokratike do të dalë nga burgu dhe do ta tregojë fytyrën e vërtetë të shkrimtarit, vjellë çkamos kundër shqiptarëve. Gazetave dhe librave të vet teknesë, do të hedhë gurë e dru kundër shqiptarëve. Në një gazetë në Shqipëri edhe do të botohet një shkrim se: autori i romanit *Tradhtia* nuk është Kapllan Resuli, po Mahmud Dumani. UDB-a, pasi e kishte burgosur Mahmud Dumanin, kishte kurdisur edhe plot raste të kësilla e shkruar libra. E kujtoj një bisedë rasti në gazetën e atëhershme “Flaka e vëllazërimit” (Shkup), ku punonte Adem Gajtani si redaktor i botimeve. Poetin, në atë kohë e sulmonin si spiun të UDB -ës jugosllave. Shkaku se: poeti ia kishte rrëmbyer gruan shokut të tij besnik, Kapllan

Resultit. Papritmas, në besim mes të tjerash ku më tha: pa të drejtë mua këtu më sulmojnë si spiun e tradhtar i shokut. Po, shpejtë do të vij koha dhe e vërteta do të dalë në shesh, do të flasë shumë me argumente për këtë kurdisje, vepër spiunazhi jugosllav. Nuk i vura gjithaq rëndësi kësaj bisede rasti në atë kohë. Edhe pse, edhe unë vetë dyshoja në një vepër të këtillë gatimi në maxhe të UDB-ës jugosllave. E kishin punuar me tru, aq bindshëm për popullatën shqiptare, sa që nuk të lente asnjëfarë shteg dyshimi. Ngjarja që të jetë për atë kohë sa më bindëse, njërin e kishin “ikur” në Shqipëri, e tjetrin e kishin detyruar që t’ia marrë gruan. Nuk shkoi shumë kohë dhe i gjithë plani i UDB-ës jugosllave doli në sipërfaqe. Kapllan Resulin e rrasën në burg si spiun jugosllav. Edhe fjalët e Adem Gajtanit për këtë kurdisje me aq mjeshtri, dolën të vërteta për opinionin shqiptar. Me siguri, po të ishte gjallë sot poeti do të fliste shumë për atë kohë policore. E vërteta e asaj kohe u varros bashkë me poetin në varr.

Vërtetë ishin kohë të vështira ato të UDB-ës jugosllave, kur siç thoshte populli: nata kishte sy e muret veshë. Trim mbi trima në atë kohë ishte Patrioti i Prishtinës, që e mbante kudo kësulën e bardhë në kokë. Dhe, shenjën e Skënderbeut me dy brinja në setre. Pesë para s’i jepte për romanin *Tradhtia*. Nuk e di, a është ende gjallë rrugëve të Prishtinës me kësulë të bardhë në kokë. Shkaku se, edhe pse herë pas here shkoj në Prishtinë, nuk e kam parë atyre rrugëve plot jetë e kujtime. Vërtetë, edhe më ka marrë malli për atë Patriot historik e largpamës!

E sot?! Edhe sot kemi plot “patriotë” nëpër gazeta. Faqe të internetit. Ndonjëri, në syrret del edhe me kësulë të bardhë. Shqiponjën dykrenare në ballë. Mjerim shqiptar! Natë e ditë “punojnë” për Atdheun. Shqipëri Etnike. Po, nuk e di pse nuk më duken aq trima, nuk ma mbushin mendjen si Patrioti i atyre viteve, gjatë studimeve në Prishtinë?!...



**DOKTORZIU ME VULË
NË BALLË**

"Nëse dikujt i janë çrregulluar jo vetëm shqisat, por edhe gjykimi intelektual, madje përtej masës së zakonshme dhe përherë, vetëm atëherë themi se ai nuk është larg tërbimit..."

Roterdami

Populli në shumë raste është sikur edhe i mbyturi, që rroket edhe për gjarpëri dhe mundohet duke i lëvizur këmbët, duart e kokën të dalë në breg. Por, gjarpëri është gjarpër që di vetëm të kafshojë dhe të të fundosë në fund të hurdhës. Më kot do edhe një herë të dalësh mbi ujë, ta mbledhësh veten me forcat e fundit, ta nxjerrësh vetëm pak kokën, t'i hapësh sytë. Helmi e ka bërë të veten nëpër gjak, e ka marrë rrugën nëpër damarë drejtë zemrës e kokës. Sytë dalngadalë fillojnë të të mbyllen duke e parë në breg bishtin e gjarprit sesi bëhet kulaç në diell. Herë pas here e ngre kokën, nxjerr gjuhën dhe dikur, pasi pështyn, e palon përsëri mbi bar. Dhe ti, derisa bën luftë për jetë a vdekje, ky "Shpëtimtar" i njerëzimit e bën një sy gjumë në mesin e luleve... Këngëve të zogjëve...

Dy herë radhazi je fundosur i pavetëdijshëm e ke dalë përsëri mbi ujë. Herën e tretë i ke vënë në përdorim të gjitha forcat që të mos fundosesh prapë, sepse, kjo ka qenë ajo e fundit, dhe po të zhyteshe edhe një herë, nuk do të dilje më kurrë përsëri në sipërfaqe. Këto janë Tri rregullat e të mbyturit, që fatkeqësisht deri më sot asnjë shkrimtar nuk ka mundur t'i shpirtëzojë, t'i servojë me aq mjeshtri në libër. Por, kjo nuk do të

thotë se, këto veprime të vetë natyrës për ty janë të huaja, nuk i ke të njohura këto vrapime maratonike për në Baba Tomorr. E them këtë se, gjithmonë atypari ka kaluar DoktorZiu nga “Unioni i viçave”, që ta ka shtrirë dorën për ndihmë. Edhe ti ia ke zgjatur vetëm e vetëm që të mos mbytesh, por nuk ke pasur kohë t’ia shohësh fytyrën. Gjatë kohë, ashtu dorë për dorë, keni ecur nëpër Shkretirë pa bukë, pa ujë. Në rrugë e sipër diku larg i ke dëgjuar Trumbetat e Dexhallit. E ke zgjatur qafën të shohësh matanë Shkretirës, po qafa jote e shkurtër, që s’ka ditur të shoh më larg se para këmbëve, i ka parë vetëm disa eshtra njeriu. Aty për aty të janë marrë mendtë, ke dashur të vjellësh sa që t’i nxjerrësh jashtë edhe zorrët. Por, vrik të ka tërhequr pas DoktorZiu (Shërbetori i Dexhallit) duke të prirë nëpër Shkretirë, drejt zërit të trumbetave mes maleve.

Pas gjithë asaj rruge të gjatë, që ke bërë nëpër Shkretirë, s’di sesi e ke ngritur kokën ta shohësh DoktorZiun (Shërbetorin e Dexhallit) në fytyrë, i cili vetëm të ka prirë për në Baba Tomorr pa e hapur gojën gjatë gjithë rrugës. Po, ç’të shohësh, tragjedi: DoktorZiu (Shërbetori i Dexhallit) me dy gropa në ballë e ka luajtur rolin kryesor në skenën Shkretirë. Perdja është hapur, keni luajtur role, keni dëgjuar muzikë, por për çudi asnjëri nuk u ka duartrokatur. Vetëm tani e ke kuptuar këtë lojë, pse njeri i gjallë nuk u ka rënë duarve shuplakë. E ke shtënë kokën në mes të duarve, je ulur këmbëkryq në rërë dhe ke dashur të plasësh nga inati. Gjatë gjithë rrugës të ka prirë DoktorZiu (Shërbetori i Dexhallit), e ti i

ke ecur pas si dhelpra dashit me këmborë. E gjithë kjo nuk të vjen çudi sa ajo tjetra, si e keni gjetur rrugën, nuk keni rënë në ndonjë gropë. Ja, edhe kush të ka shtënë që mëtej të të mos prijë DoktorZiu (Shërbetori i Dexhallit) nëpër Shkretirë. Vetëm se, tash është vonë. Trumbetat dëgjohe në rrugë... Dexhalli u pri para me një shami... E hedh shaminë, e ngre këmbën, përdridhet dhe u mëshon me sa mundet trumbetave... Qytet më qytet sillet e trumbeton veten i Shpëtimtar i njerëzimit... E të gjithë atyre që mashtrohen, dalin në rrugë t'i dëgjojnë trumbetat e tij, ai u vë nga një vulë në ballë...

Por, mos harroni shpërblimin: Tri ditë para Kiametit, pas trumbetave të Dexhallit, del edhe Xhebraili me shpatën e pamëshirshme ta pastrojë botën nga njerëzit me mëkate, shërbetorët e Dexhallit me vulë në ballë...



Fitore DERALLA

II ZGJOHUNI TË VDEKUR SE NA MBYTËN
TË GJALLËT

QENMELEZ SHARRI NATËN LEH NË IRIQ

E vërtetë, kam shkruar për DoktorZiun, Patriotin Melez, Këlyshin e Llagut, Këlyshin e Sharrit, Buçën e Katundit...

Dhe, lexues i nderuar, pse të mos shkruaj edhe për Qenmelez Sharrin?! “Mikun tim besnik”, që më priste pas porte dhe më ndiqte gjithë ditën e natën pas shpine. E kishte ndërsyer Qoftëlargu, që në kohën e komunizmit duke ia hedhur vetëm një copë buke. Ditëve të pazarit ia flukte edhe ndonjë asht. E ky si Qenmelez besnik i Qoftëlargut lihte pas meje rrugës për në Baba Tomorr. Dhiareve, kur ulesha të pushoj pak nën hije të ndonjë lisi, e shihja të shkretin me një copë buke në gojë, i strukur matanë përronit. Përpiqeshte ta fsheh bythën shkurreve, mos e shoh unë se më ndiqte rrugës pas shpine. Edhe atë, i shitur vetëm për një copë buke, ose një asht. Nuk e di, pse më duket mua si shkrimtar se, këtij besniku të “gazdallarëve” (zotërinjve) i kam mbetur borxh, që gjithë ditën e gjithë natën leh në Iriq. Megjithatë, ja kësaj radhe po shkruaj edhe për Qenmelez Sharrin. E kam vendosur t’i dal borxhit si Qenmelez “besnik” i librave të mi kokë më kokë në bibliotekë.

Besnik është si Qenmelez Sharri, nuk e luan topi. E sidomos kur janë në pyetje “gazdallarët” (zotërinjtë), vetëm ia hudhë një copë buke, dhe leh gjithë ditën e gjithë natën në Iriq.

E ngre këmbën, si ajo bretkosa e anekdotave popullore shqiptare, kur e ka parë se mbathet kali

në Qytet. Nallbani, kur ia futi gozhdën thellë me çekiç, e çuditi malin. Qesharake, ë?! Edhe trim edhe frikacak.

O Imzot! Edhe ti, u beson këtyre qenmelezëve me brekët nëpër këmbë?! Që, dje ishin komunistë me yll të kuq në ballë! E sot, ballistë me shqiponjën dykrenare në kësulën e bardhë. Bythët i ngrejnë në xhami përpara këmbëve të Hoxhës, i luten Zotit për mëkate! E nesër, një Zot e di në cilin grazhd me një torbë taxhi përqafe do të përfundojnë si qenmelezë.

Nuk më besohet! E di se, e ke përgjigjen e Muhamedit a.s. se: *pa Vatan, nuk ka iman*. Vetëm, edhe unë nuk pritoj të të përgjigjem: Qenmelezët, që luten nateditë për mëkate në xhami përpara këmbëve të Hoxhës, nuk kanë as Vatan e as iman...

I mëshiro, o Zoti Madh! Feja e këtyre qenmelezëve, është taxhia...

E pse?! Shkaku se Lepur Veshëgjati nuk mund të dalë vetë te porta, nuk ka bythë mejdani. Vetëm mos harroni, ky ka bythë ta dalldisë Qenmelez Sharrin. E Qenmelez Sharri për të dalë në syrret, turr me gjithë bishtin nën këmbë te porta. Qenmelez Sharrin, kur është në pyetje politika sllavomaqedonase, duhet ta pyesin diplomatët e Shqipërisë. Pse, jo edhe ata të Kosovës. Edhe amabasdori i Shqipërisë në Shkup. Shkaku: i ka thënë kështu Lepur Veshëgjati me kokën në Redaksi e bythën në Qeveri. Dhe, nuk ka problem, ai vetëm ia bën me gisht duke e fshehur veten pas murit.

Dhe, u shet mend Qenmelez Sharri: Shqipërisë, Kosovës... Neve, si lexues të gazetave. Fatkeqësi kombëtare. Qenmelez Sharri, ky “trim” mbi trima që vite me radhë i del zot taxhisë në grazhd.

O burra! Ia hidhni edhe një torbë taxhi të shkretit në Qeveri! Vetëm e vetëm, të mos e dëgjoj më se si përjaget mjerani, përdredh bythën pas porte.

E ju si lexuesë të mi besnikë, do të vazhdoni të më pyesni: E, a e ka frikë Ujk Malin?! Kush, pyes unë?! Qenmelez Sharri, pra! E ka. Po, si nuk e ka. E sidomos natën, kur i vjen tinës te porta si “mik”. Bishtin nga frika e fut nën këmbë, kur e dëgjon ulërimën e Ujk Malit. Gjuhën nga vapa e nxjerrë jashtë, dy pëllëmbë. Frika i ka hyrë në bark. Këmbët i dridhen si purteka. E lëshon shurrën nga frika në brekë, në mes të lëmës. I shkreti qenmelez, do pak të jetë trim me bishtin mbi shpinë, t’u dalë zot “gazdallarëve” (zotërinjve), po ja që e ka frikë Ujk Malin.

Halli?! Halla, edhe kësaj radhe do burrë. Qenmelez Sharrit, fluki një copë buke! Ose, ndonjë asht në livadh. Dhe, ai leh me bishtin nën këmbë, në lëmë pas porte. Vetëm, kurrë mos pritni që ai të dalë matanë portës, në rrugë. Ujk Malit t’i turret pas si Qenmelez Sharri me një torbë taxhi përqafe.

E dini pse?!

Jo, nuk e dini. Qenmelez Sharri është stërnip i Mikales të Brodit. Melez me tapi. Qenmelez i tërbuar, fisi i të cilit natën na ka rënë në kulla. Katundit ia ka vënë zjarrin. E ka bërë shkrum e hi

deri në themele. Pleq, fëmijë, gra e burra na i ka djegur të gjallë. Piskama për ndihmë u ka shkuar për qielli. Shkurt, katundet tona i ka rrafshuar me tokë. Flakës dhe zjarrit nuk i ka shpëtuar njeri i gjallë. Edhe sot flasin nën ato gurë gjurmët e atyre katundeve shqiptare, që kanë mbetur sot vetëm gërmadha të mbuluar me bar e hitha. Edhe sot e kësaj dite janë pa jetë, nuk u tymon oxhaku.

Dhe, në fund, them: Qenmelez Sharri brez pas brezi e ka frikë Ujk Malin. Shkaku se: është Qenmelez, nuk është ai Qeni i vërtetë i sojit të Sharrit, që krah për krah me Bariun na i ruan dhentë maleve.

Qenmelezi soçëm i Sharrit, për të cilin e kam fjalën, gjithë ditën e gjithë natën leh në Iriq... Edhe atë: vetëm për një copë buke... Asht...



**PROPAGANDA SHQIPTARE
E SHITUR PA PARE**

Në botë propaganda, qoftë ekonomike, qoftë politike, qoftë artistike, kushton shumë shtrenjtë. Vetëm tek ne shqiptarët, propaganda është pa pare. E kanë thënë moti këtë zbulim shkencor gjermanët për ne shqiptarët. Heret, qysh në Luftën e Dytë Botërore: ne, gjermanët kudo në botë kemi paguar shumë para për spiunët. E për çudi, këtu shqiptarët qenkan spiunë pa pare.

Artistët botërorë, shumica kanë dhënë dhe japin shumë para, që vepra e tyre të ndalohet nga shitja, hiqet nga libraritë. Edhe shqiptarët e bënë një veprim të këtillë me enciklopedinë maqedonase. Patrioti melez shkoi edhe më larg, të digjet në turrë të druve në mes të Sheshit. Tjetri, që e mori Partia nga sharrimi i dërrasave dhe i dha diplomë universitare në Qafë Thanë, për të doktoruar në Bullgari, do ta ngre zërin si analist politik kudo në mjetet e informacionit brenda e jashtë Atdheut. Vjellin e shesin mend para kamerave televizive, në pyetjet e gazetares po të këtij niveli “artistik” e dërguar për një emision debativ në Çarshi të Vjetër, në mes të Shkupit, përpara këmbëve të Skënderbeut. Po, kush janë këta argatë primitiv pa tru, që e shajnë Shqipërinë e Kosovën?! Çfarë bagazhi politik ose latrar kanë këta “patriotë” melezë, që deri dje nuk e dinin gjuhën shqipe. E sot belbëzojnë në gjuhën shqipe, marrin guximin t’i shesin mend Shqipërisë dhe Kosovës si “patriotë” të Mëmëdheut. Zjarr e flakë nxjerrin nga goja si patriotë të vonuar. Merreni me mend, emisionin e kanë pagëzuar: “Shqipëria e Maqedonisë”. Çka duan të thonë me këtë parullë, Dumdumët?! A e dinë? Për Zotin, jo!

Shkaku se, kokën e kanë te bytha e këmbët në qafë. Melezët, që kokën e kanë te torba me taxhi e bythën te “vëllezërit”. Edhe fesë myslimane i dalin zot me tespi kuqezi. E nuk kanë haber nga kjo fe, nuk i dinë as shartet e myslimanizmit. Ruana Zot, nga këta “myslimanë” me veshje arabe e gjuhë turke, që janë më myslimanë se arabët e turqit nga të cilët e kemi marrë ne fenë myslimane. E në anën tjetër harrojnë, se ne jemi gjallë, ende i kemi të freskëta veprimet e tyre që gjatë komunizmit famëkeq ua kanë kurdisur shqiptarëve. Bërllokun e këtij soji, komunizmi e ka marrë nga organiazatat e ndërtimtarisë, kooperativat bujqësore të katundit, sharrimi i dërrasave në Drenovë dhe i ka shëtiur nëpër redaksi komuniste e organizata “humanitare” si antishqiptarë me nga një hajmali përqafe. Debilat, që mezi e kryen një shkollë të mesme edhe atë në gjuhën sllavomaqedonase. Arsye se, kjo gjuhë për këta tokmakë vathe, ishte gjuha e perspektivës, ardhmërisë. Shkaku i këtij soji edhe, “Makedonska enciklopedija” u rrëmbye i gjithë tirazhi brenda natës. Debilat, përsëri nuk u ndalën me këtë aktivitet “patriotik”, vazhduan të bëjnë propagandë në mjetet e informacionit e në Qeverinë e “vëllazërim-bashkimit”. E thirrin ezanin në minare përmes misionerëve të tyre me tre vjet shkollë e përvojë pune në ndërmarrjen e ndërtimtarisë së betonit e sharrimin e dërrasave në Drenovë. Ulen këmbëkryq ballë për ballë me personalitete para kamerave televizive, që kanë një bagazh të madh kombëtarë, jo vetëm brenda kufinjve të Atdheut, po edhe nëpër botë. E këta të

mjerë në rolin e “analistëve” politik shesin pordha patriotike, pavetëdije se janë me qindra kilometra larg nivelit intelektual të atyre personaliteteve të dëshmuar në Shqipëri e Kosovë.

Fotografohen përpara kamerave, marrin poza debilësh: Shqipëria (Mëmëdheu, sipas Patriotit melez), Kosova nuk i njihka këta alamet “patriotë” (muta). E në anën tjetër, nuk e dinë se këta butakë nuk i njeh edhe katundi i tyre rrëzë malit. I njeh, po i njeh ndryshe si argatë të “vëllezërve”, që na kanë shitur me vite pa pare te policia letrare. Të mjerët, kujtojnë se ne nuk i ruajmë deklaratat dhe intervistat e tyre, që në atë kohë i kanë dhënë si sllavomaqedonas besnikë nëpër gazeta. E kanë sharë popullin shqiptarë edhe më shumë se armiqtë e përбетuar shekullor. Përsëri, a nuk i shihni këta trusakatë se na e shajnë Shqipërinë, Kosovën?! Vallë, në shërbim të kujt janë sot?! Për dje, e dimë. Edhe për sot e dimë se, nuk janë në shërbim të shqiptarëve.

E them këtë se, lehjet e tyre pa tru kundër Shqipërisë dhe Kosovës, nuk kanë haber nga shqiptarizmi. Përmëkeq, unë këtë nuk e them, ata vetë me veprimet e tyre e thonë bindshëm se, janë në shërbim të halldupit. Edhe unë jam mysliman, po nuk mund të them: e dua myslimanizmin më shumë se këta debilë. I falë të pesë vaktet në xhami. Ndoshta, edhe do t’i falë një ditë, kur të bëhet xhamia shqiptare. Ashtu siç e ndau Noli i madh kishën shqiptare. Unë e dua fenë, që është në shërbim të kombit tim dhe Shtetit, Shqipërisë. Feja që nuk është në shërbim të kombit,

Shqipërisë, për mua është e huaj, armike brez pas brezi nëpër shekuj.

Dhe, pse çuditemi: “Enciklopedia maqedonase” me të madhe shpërndahet dhe shitet, është bërë materiali më i kërkuar dhe i preferuar tek qarqet intelektuale, studentët dhe nxënësit, të cilët duan të dinë dhe janë bërë kureshtarë për këtë “vepër”, që shqiptarët duan të hiqet nga përdorimi. Enciklopedia shpërndahet me të madhe edhe përmes DVD dhe disqeve nxënësve, studentëve, shkollave e universiteteve.

E gjithë kjo do të thotë se: përmes këtyre mashave shqiptare, shqiptarët pavetëdije i bënë propagandë “Makedonska enciklopedija”, që nuk do t’ia bënte asnjëfarë mekanizmi propagandues më i madh botëror. Përmëkeq, edhe atë: pa pare.

Propaganda shqiptare e shitur pa pare nuk përfundon këtu, po vazhdon ende të propagandojë në shërbim të politikës sllavomaqedonase. Shembull më i freskët është, Paniri i librit Tetova 2009. Edhe kësaj radhe organiaztorët këmbekrye janë në shërbim të politikës sllavomaqedonase, duke mos pranuar dështimin e tyre organizativ, përpiqen fajin t’ua hedhin doganierëve në Qafë Thanë. Përmendin dy - tre botues të vegjël nga Shqipëria, njëri tregtar i librit e tjetri autor botues se u janë ndaluar librat në pikën kufitare. E pabesueshme?! Shkaku se, ç’nodhi me shtëpitë e mëdha botuese: Onufri, Toena, Skanderbegbooks, Camaj – Pipaj, Buzuku, Faik Konica etj, kush i ndaloj këta botues në Tiranë, apo e bojkotuan panairin?! Ose, me Pnairin e improvizuar të Shkupit para disa muajve në Bit-Pazar, që ishte

dështim i plotë, fund e krye. Që, fatkeqsisht nuk arriti as nivelin e librarive të “vëllezërve” në rrugë, që i kemi për çdo ditë në breg të Vardarit. Edhe kësaj radhe i ndaluan në kufi botuesit nga Shqipëria e Kosova, në Qafë Thanë?!

Jo, zhurmaxhi kulturorë të shkolluar nëpër parti politike. Ditë e përditë ju bëni propagandë politike në dëm të shqiptarëve. E shumë pak manifestime e ngjarje kulturore. Aktivitetet e juaja “kulturore” janë të improvizuara dhe plot zhurmë e propagandë politike - fetare. E keni më shumë të dukeni krah për krah me aktivistët e partive politike në pushtet se, sa t’ia hiqni ferexhen kulturës shqiptare.

Dhe, në fund mos i fajësoni të tjerët (shkijet) për dështimet e juaja organizative, po vetevetn si të paaftë për organizime kulturore mbarëshqiptare. Truri i juaj nuk pjellë, e keni shterpë. Është koha ta mbyllni gojën, t’i përvesheni punës, nëse vërtetë jeni shqiptarë dhe patriotë që t’ju dojë siç thoni ju Mëmëdheu (unë them: Atdheu)...

PLLAKA E PRISHUR E GRAMAFONIT

Gjatë kohës së studimeve në Prishtinë, përveç librave kam pasur andej - këndej nëpër dhomë edhe shumë pllaka gramfoni në gjuhën shqipe, sllave dhe në gjuhët e botës. Veç letërsisë, e kam dashur shumë edhe muzikën. Shkurt, dua të them: jam rritur me muzikën e Beatles, Rolling Stones, Led Zappelin, Jimi Hendrix, Jennis Japlin, Tina Tajner, Adamo, Mireille Mathieu, Charle Aznavour, Johnni Hallyday, Vaçe Zela, Nexhmije Pagarusha, Qamili Vogël, Fitnete Rexha, Trio Zajazi etj. Ose, siç them unë shpesh mes miqve: e mbaja veten gjallë mes atyre mureve. Frymë kam marrë në mesin e librave dhe pllakave të gramafonit. I ruaja pllakat e gramafonit, që në atë kohë ishin të rralla dhe vështirë gjëndeshin në treg si sytë e ballit. Përditë i fshija nga pluhuri, i mbaja nëpër rafte kokë më kokë me librat. Zemroheshja, kur ndojë pllakë prisheshte, gjilpëra rrotullonte në të njëjtin vend dhe e përsëriste të njëjtën fjalë. Nevoja më detyronte ta shtyj me dorë, të vazhdojë fjalën e radhës, këngën e adhurar të asaj kohe.

E përçudi, sot pas shfletimit të gazetave të ditës seç m'u kujtua pllaka e prishur e gramafonit e një patrioti të vonuar (analisti melez). Në atë kohë herë pas here në gramafon e lëshoja për ta dëgjuar edhe atë pllakë në gjuhën sllave. Gjilpëra (pena) e tij rrotullohej në të njëjtin vend, në të njëjtat fjalë. Vetëm se, për dallim nga pllakat e prishura të gramafonit të asaj kohe, sot këtë nuk mund ta shtyj me dorë ta vazhdojnë fjalën e radhës. Këngën, kësaj radhe në gjuhën shqipe. Rrotullohen e rrotullohen nëpër gazeta të njëjtat

mendime, të njëjtat fjalë. E njëjta “këngë patriotike” në gjuhën shqipe. Vetëmevete them: edhe kjo pllakë është bërë si pllakat e prishura të gramafonit në kohën e komunizmit.

Dorën në zemër, këta janë pllaka të prishura të gramafonit. Pllaka që në kohën e komunizmit janë rrotulluar nëpër kabinete. Pllaka, për të cilën e kam fjalën në atë kohë ka kënduar në gjuhën sllave, e sot përçudi këndon në gjuhën shqipe. Partia e ka shëtitur nëpër poste. Zyra të kryeredaktorëve. Kabinete nëpër Minsitri. Jatakë të ish Partisë Komuniste. Që, kurrë nuk kanë shkuar në punë, po kanë marrë rroga mujore. Honorare të majme. Shkurt, si “kuadër deficitar” vendosin për arsimin dhe kulturën shqiptare. Cili do të shkojë në Ministrinë e Kulturës. Cili në Ministrinë e Arsimit. Universitet. Kush do të përpilojë planprograme shkollore. Tekste shkollore. Lektyra shkollore. Antologji të poezisë së pastër e të përlyer shqipe. Cili do të punojë në redaksinë e gazetës, cili në radio e cili në Televizion. Kush do të marrë pjesë në Mbrëmjet e Pozisë në Strugë. Përpilimin e listës së shkrimtarëve shqiptarë në “Makedonska knizhevnost”. Manifestimet kulturore brenda e jashtë shtetit. Cilëve do t’u jepen çmimet letrare. E të tjera e të tjera shpërblime për ”flijime artistike” nëpër kabinete.

Përçudi, edhe sot po e njëjta pllakë rrotullohet në gramafon edhe pse e prishur edhe në kohën e soçme “demokratike”. Vetëmse, kësaj radhe kjo pllakë këndon në gjuhën shqipe. Përmëkeq, në të njëjtin vend me të njëjtat

mendime, veçse për dallin nga ajo kohë me fjalë shqipe. Dhe, nuk ka bir nëne që e shty me dorë, lëvizë të mos i përsërisë të njëjtat fjalë. Vend t'u lë pak edhe pllakave të reja, që ende nuk janë prishur, nuk i përsërisin fjalët e këngës së huaj, nuk na e sakatojnë muzikën shqiptare. Shqip, mos na i shurdhojnë më veshët. Përditë të na e kalbin trurin me marrëzira meleze.

Dhe, frikë kam se si do ta gëdhijmë një ditë të nesërme me këtë pllakë të prishur gramafoni, që sot gjoja këndon në gjuhën shqipe! Gjilpëra (pena) e të cilit vite me radhë i përsëritë të njëjtat fjalë të një kënge të huaj patriotike me lalëlule. Përderisa, ende nuk delë në shesh, në fushën e mejdanit një burrë nëne, t'i përveshë duart deri në bërryla dhe ta flukë në kontejnerët e bërrlokut...



BEQARESHA PARTIAKE

Hanëm Firdesi është një grua e rreth viteve të dyzeta. Nuk e di a ka të kryerë ndonjë shkollë fillore katërvjeçare. Vetëm e di se, nuk ka shkollë të mesme. Nuk ka rëndësi kjo stoli partiake. E rëndësishme është se, e ke në Qeveri... Ministri... Universitet... Redaksi...

Hanëm Firdesin e njohin të gjithë. E njoh edhe unë, më ka pri disa herë me radhë të zyrat e Partisë... Ministri... Universitet... Redaksive, për ndonjë intervistë në emisionet kulturore. Shkurt, ajo e kryen detyrën për mrekulli: mysafirët, secilin e dërgon në kohë dhe vend të duhur, te zyrat e sheficave dhe shefave të redaksisë.

E çuditshme është se, Hanëm Firdesi kurrë nuk vonohet në punë. Nuk shet mend si shoqet tjera azgane. Nuk zihet me kolegët e punës. Nuk e shanë Qeverinë... Partinë.. Vetëm se, edhe Hanëm Firdesi e ka një të metë, nuk është e përkryer. Punemadhe, do të thoni ju: edhe Shkespieri nuk është i përkryer. E ku më, Hanëm Firdesi. Megjithatë, Hanëm Firdesi me këtë ves së paku nuk është e dëmshme për shoqërinë... Qeverinë... Shtetin... Hanëm Firdesi i sheh sheficat e saja se si përdridhen korridoreve dhe do t'i imitojë, do të vishet si ato zonja të rënda të salloneve. Fustane mini... Frizura bjonde... Grime lloj-lloj ngjyrash. Thonj të gjatë e të ngjyrosur. Dhe, gji na, hakaret pak të nxjerrë për mejdani. Pse jo, edhe ajo të mos ketë një dashnor si sheficat e saja azgane?!... Edhe dashnorët kohën e fundit janë në modë. E sidomos ata partiakë me poste: ministra, deputetë, drejtorë, partizanë partie...

E takova një ditë, përsëri Hanëm Firdesin në Ministri. E hijshme dhe e pispilosur ashtu siç di Hanëm Firdesi më, sipas modës së fundit të sheficave azgane. E lyer dhe e përlyer alla shefice me të gjitha stolitë partiake.

Një ditë tjetër, përderisa më printe për në zyrat e Ministrisë, mora guximin dhe e pyeta:

- Cilën modë të fundit e ndjek ti Hanëm Firdes?!

- Modën artistike të sheficës sime partiake bjonde, m'u përgjigj. Të pëlqen, ë?!

- Po, edhe atë shumë. Patjetër.

- Është moda më e re e fundit e sheficës sime partiake. Qeshi. Rrush i tharët do të thuash ti për veteranët e luftës?!

- Jo, po çuditem në cilat vreshta të Atdheut plot bereqet e vjelë Nëna Parti këtë rrush të zi kokërrmadh?!

- Te Çifligu i Xha Derallës... Qeshet. Përdridhet, Hanëm Firdesi.

- Mos mendon edhe ti të bëhesh sheficë, e pyes dikur me ironi?


- Po, më përgjigjet plumb. Ta merr mendja, zoti shkrimtar. Çka kanë ato kokone më shumë se unë si grua gjylvetare?!... Shkollë?!... Tru?!... Pasuri të tundshme?!... Apo, përvojë partiake?! ... Qesh.

- Po, Hanëm Firdes ato shefica azgane i kanë nga njëzetepesë - tridhjetë vjet. E ti i ke klauar të dyzetat?!...

- E di, më përgjigjet. Po, ato kanë burra, unë jam e pamartuar. Nuk kam burrë. Ende jam

beqareshë. E pres Nënë Parti, pasi më gjeti punë,
të ma gjejë më në fund edhe mua një burrë!...

Hi-hii-hiii...



ODA E MIQVE

Fëmijë kam qenë atëherë, në ato vite. Dimëra me dëborë. Kohë qorre, menjëherë pas lufte. Ende lëmës sonë i vinte era barot. Kopshtit. Livadhit. Kasollave në lojë e sipër, ku gjenim bomba të kuqe italiani. Fishekë. Plumba. Eh, sa herë si fëmijë kemi kërcyer bythekrye mbi ato bomba të mbuluara me kashtë! I kemi marrë nëpër duar si lodra, në xhepa si dardha, në çantë bashkë me librat, fletoret. Gjithë ditën e gjatë luanim nëpër livadhe me to sikur të ishin topa llastiku. Zoti, siç duket atëherë na ka pas në dorë. Na ka ruajtur nga të ligat, nga ato lodra të rrezikshme që i hasnim në çdo hap, i shqelmonim me këmbë. Përmëkeq, ndonjëherë na prisnin edhe si mollët e kuqe në oborrin e shkollës.

Dhe, nuk di çka m'u kujtua sot Oda e miqve. Im Atë me mustaqet vesh më vesh. Ballin plot rrudha si të çarrit. Nagantin me nëntë fishekë dhe dy bomba kashikara në brez. Mauzerrin verë e dimër varë në një gozhdë pas dere. Kollanë me fishekë. Eh, sa dëshirë kam pasur atëherë t'i marr nëpër duar ato armë misterioze, të luaj pak me to në lëmë. Po kot, ne fëmijët i kemi pasur të ndaluara rreptësisht nga Babai. Nuk janë lodra fëmijësh për ne hutaçët. I kemi librat, thoshte: Lapsat. Fletoret dhe gomat, që mund të luajmë gjithë ditën e natën në shkollë. Lëmë. E livadhe si qengja me një zile në qafë varë.

Sot. Kur e kujtoj Odën e miqve, vërtetë para meje shfaqet një film i tërë i atyre ditëve. Burra me mustaqet vesh më vesh. Tirqi e xhamadanë.

Kësulën e bardhë në kokë. Nagantin dhe bombat në brez. Mauzerrin përqafe. Natën vinin te ne si miq. I varnin armët pas dere. E kalonin natën. Dhe, iknin para agimit ditën. Nuk mund ta merrni me mend sa kureshtarë kemi qenë ne hutaçët të dimë se çka bisedojnë ata burra pushke. Po, jo. E kemi pasur të ndaluar nga im Atë t'i dëgjojmë bisedat e tyre të rrezikshme pas dere.

Ditë kanë kaluar që atëherë, asaj kohe. Vite. Shi ka rënë me shtamba në Livadhin tonë të fëmijërisë. Breshër. Dëborë e madhe. Vetëmse, kurrë nuk kanë mundur t'i fshinë kujtimet e odës së miqve. Gjurmët e tyre nëpër lëmë. Fatkeqësiht, që pas kaq viteve, unë i biri i tij edhe pse kam dy shtëpia në Shkup, ende nuk kam Odë të miqve.

Eh, lexuesi im i nderuar ta dini ju, sa më mungon ajo odë e miqve! Bisedat e tyre kokë më kokë pas darke. Burrat e asaj kohe...



NJERKA DHE KOPILAT E SHITUR

NJË TORBË TAXHI

Unë pas Luftës së Dytë Botërore erdha në jetë duke bërëtitë e qarë, ashtu si të gjithë fëmijët, siç lindin edhe sot e kësaj dite. Nëna më lindi duke punuar në arë pas një mullari me bar në mes të Dimrit. Dhe, nga andej doli me gjithë mua në grykë, foshnje duke ia dhënë në dorë Babait.

Babai nga gëzimi në mes të fushës qiti pushkë. Edhe në familjen tonë më në fund lindi djalë. Lajm i ri ky për familjen. Katundin. Murgu lehu në lëmë. Gjeli i përplasi fletët dhe hipi në gardh. Këngës i dha zjarr.

Vite më vonë, pas lufte, Burri i Njerkës ma përzuri në pabesi Nënë, matanë detit. Babain e rراسi në burg. Përkujdesjen time, tashti e mori në dorë Burri i Njerkës dhe Njerka. Vite të vështira ato, kur unë fillova të rritem nëpër livadhe, bëj hapat e parë në Shkollë. Nuk kisha libra, nuk kisha fletore, nuk kisha laps, nuk kisha çantë si Kopilat e Njerkës. Unë e kisha një gjysëm libri, disa fletë fletoreje, një gjysëm lapsi dhe një copë gome nga çizmet e Babait. Megjithatë, në një dorë gjysmën e bukës në dorë, e në tjetrën librin, rroksha pas bishtit të Sagjinit që më tërhiqte zvarrë rrugës pas kullosave për te Zabeli i Çelike. E pak më vonë me dhenë edhe qafë për qafe me oqiçin me këmborë te Përroni i Thanës.

Vite të vështira ishin ato në atë kohë në prehërin e Njerkës. E kaloja ditën me bukë thatë e natën pa gjumë me ëndërra të merrshme mes

xhindeve që më hidhnin dorë më dorë mbi çatia majë lisave. E në mëngjes, pak para agimit më kthenin në shtëpi. Tjetër jetë bënin Kopilat e Njerkës. Tambël pinin me kusi sa t'u dojë barku. Mish hanin gati për çdo ditë. E mua m'i hidhnin eshtrat që t'i lëpi pak, matanë sofrës.

Edhe kur u rrita, unë u rrita pa Nënë. Njerka më tepër kujdesej për Kopilat e vet në shtëpi. U rrinte gati pas çdo kërkese. E mua më dënonte me punë. Herë pas here edhe pa bukë. Kopilatt e saj kishin edhe para. U jepte bursa për t'u shkolluar brenda e jashtë shtetit. E mua më thoshte: ti shko mëso te hoxha!

Vitet ikën njëri pas tjetrit me varfërinë në shpinë. Edhe unë u rrita me shumë mundime dyerve të hallkut në Shkup e Prishtinë. Përndjekjeve të Njerkës që të bëhem djalë i mirë e me besë. Një ditë e kreu edhe shkollimin. Dhe, duheshte të gjej punë. Njerka përseri më morri në mbrojtje, më tha: ti duhet të punosh si mësues në malësi. Shkaku se atje, për ty kemi më së shumti nevojë. E kopilat e vetë i punësoi në Qeveri. Ministri. Redaksi. Edhe kësaj radhe e dëgjova Njerkën, shkova si mësues në malësi.

Gjatë ndryshimeve “demokratike” kur më isha bërë burrë me mjekër dhe shkrimtar, kisha krijuar familje, Njerka përseri më këshilloi, tha: ti duhet ta duash “Tatkoto”. E ke babë. Edhe mua, Njerkën si nënë!

E kundërshtova. E Kopilat e tu, që natë e ditë më rrinë mbi kokë. Përditë më spiunojnë në Polici?! Edhe sot në “demokraci” si dje në komunizëm vendosin për Lirinë dhe të drajtat e

mia: gjuhën, shkollën, historinë, kulturën... Gjithë jetën e kanë shitur veten një torbë taxhi. Në emër të shqiptarëve luftojnë për Liri, arsim, kulturë... Shqipëri Etnike. Argatë bëhen në botimin e “Makedonska knizhevnost... Makedonska enciklopedija...” Dhe, të nesërmen më thonë mua, ti dil protesto në rrugë. Ashpër reago në mjetet e informacionit. Edhe ata t’i dua! Po. Patjetrër, duhet të reagosh, më tha Njerka. Kopilat e mi janë akademikë. Anëtarë të Akademisë së Shkencave Maqedonase.

Jo, iu përgjigja. Problem nuk kam me sllavomaqedonasit, po me sllavoshqiptarët. Fundi i fundit, pa e pastruar së pari Oborrit tim, nuk do të mirrem me pastrimin e Oborrit të Kojshisë. Unë kurrë nuk ju kam dashur e as mund të ju dua juve si prindër të rrejshëm. Unë e dua Babain dhe Nënë time të vërtetë!

Hë, lexues i nderuar si thoni ju?! A duhet Burri i Njerkës (Tatkoto), Njerka dhe Kopilat e saj pas gjithë këtyre dënimeve?!... Përndjekjeve... Burgosjeve... Vrasjeve... Shitjeve... Falsikimeve të historisë...

Jo. Atëherë, natën e mirë! Dita vjen nesër... Dita... Ikni nga sytë – këmbët! Kokën po të doni, futeni në hale! Sytë, lani me gjiriz!...

Njerka, kurrë nuk bëhet Nënë... Kopilat, akedemikë...

**DJALIN E VOGËL NË SHKUP
E SOLLI LEJLEKU**

Bora e madhe, që ra papritmas në mars, në Maqedoni u përpoq ta mbulojë bërlllokun. Kontejnerët, që me vite na rrinë para dere. E nuk mundemi kurrësesi t'i heqim qafe nga oborri. Rruga. Megjithatë, edhe kjo borë nuk mundi t'i mbulojë manipulimet, keqpërdorimin e votës së "lirë demokratike" të shqiptarëve në Maqedoni.

Në Maqedoni ende vazhdon të manipulohet me shqiptarët. E manipulojnë partitë politike shqiptare, e manipulojnë partitë politike maqedonase. Shteti. Ende ky popull shumicë në Maqedoni vazhdon të trajtohet si pakicë me 25 % nga vetë partitë politike shqiptare, nga vetë shteti. E në realitet, ky popull është shumicë me mbi 40 % shqiptarë në Maqedoni.

Në Maqedoni jetojnë shqiptarët, bullgarët, maqedonasit, turqit, serbët, vlllehët, romët, boshnjakët etj. Dhe, nga këta popuj, politika komuniste përpiqet të lind edhe një popull të ri maqedonas. Herë e emëron sllavomaqedonas. Herë maqedonasë antikë. Pasardhës të Aleksandrit të Madh të Maqedonisë. Vetëm e vetëm, që të mos e marrin pushtetin në dorë shqiptarët shumicë në këtë shtet "demokratik".

Dhe, vazhdojnë manipulimet në këtë shtet. Keqpërdorimet. Edhe pse, ky popull me shekuj jeton në këto troje, e ka mbushur shtëpinë me fëmijë. Lëmën. Shtetin. Fatkeqësisht, një numri të madh të shqiptarëve edhe sot e kësaj dite nuk i jepet nënshtetësi. Vite me radhë i vidhet vota e "lirë demokratike". Gjuha. Shkolla. Liria...

E them këtë me plot gojën. Shkaku: se, në këtë shtet kurrë nuk ka pasur regjistrime të realta të popullatës shqiptare. Edhe mua, edhe djalit tim Asdrenit, gjatë zgjedhjeve të fundit presidenciale dhe lokale, këtë vit na u mor e drejta e votës së “lirë demokratike”. E kjo të shtyn të mendosh dhe dyshosh, edhe sa shqiptarëve të tjerë u ka hyrë tinëz hajduti me çizme në lëmë, ua ka vjedh votën e “lirë demokratike“.

Bora e madhe, që ra paritmas në mars, vërtetë e mbuloi Maqedoninë, por jo edhe vjedhjen e votës së “lirë“ të shqiptarëve. Me siguri në listat e votimit kanë munguar edhe shumë emra të shqiptarëve, e janë regjistruar shumë emra të të vdekurve. Edhe mua që kisha vdekur disa herë me radhë e isha ringjall, shteti “demokratik“ gjatë këtyre zgjedhjeve presidenciale dhe lokale më shpalli të vdekur. Përmëkeq, në listë përveç që nuk e gjeta emrin tim, nuk e gjeta edhe emrin e djalit, Asdrenit. E gjeta vetëm emrin e djalit të vogël Agonit, që në Shkup sipas “shtetit demokratik“ e kishte sjellë lejleku. Gruaja atë ditë votoi në tjetër adresë. Agoni, nuk votoi fare. Shkaku: se, sipas tij është i papunë dhe nuk ka kujt t’ia jap votën e tij të “lirë demokratike“.

E rëndësishmja, këto zgjedhje “demokratike“, po kalojnë pa incidente. Viktima. Aktivistë partiakë të plagosur nëpër spitale.

Urime “fitoren“ Maqedoni!...

SI RROTAT E PALYERA TË NJË QERREJE

Përkthimi është rikrijim. Dhe, mund të bëjnë përkthime të arrira vetëm ata që janë krijuesë, e pasurojnë gjuhën me fjalë e shprehje të reja duke i qëndruar besnik autorit, gjuhës dhe stilit të tij pa e sakatuar librin. Përkthim, nuk i thonë përkthimit fjalë për fjalë. Lexuesi të ngulfatet mes faqeve të librit me fjalë dhe shprehje të kota, të paqëlluara artistikisht. Gjuha letrare shqipe mbi të gjitha është gjuhë e popullit shqiptar plot fjalë të vjetra e shprehje popullore brez pas brezi. Përmëtepër, flitet, shkruhet dhe krijohet në disa shtete: Shqipëri, Kosovë, IRJ e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Diasporë. Vërtetë flitet, shkruhet dhe krijohet brenda kufinjve të ndryshëm politik, po gjuha letrare shqipe nuk njeh kufi. Pasuri e madhe kjo, për një gjuhë letrare siç është sot gjuha shqipe.

E vërtetë, se çdo përkthim është mirë të ketë edhe një redaktor letrar, po jo këtë punë ta bëjë një përkthyes nëse nuk është edhe krijues letrar. Shkaku se, libri i përkthyer keq, fishkëllen si rrotat e palyera të një qerreje, që mezi e tërheqin qetë, dhe e godet në kokë lexuesin si me çekan.

Edhe përkthimi do talent, është dhunti, ta jep ose nuk ta jep Zoti (Natyra). Habitem, kur kujtiteket merr guximin të përkthejë vepra letrare. E në anën tjetër çalon mes faqeve të librit, përkthen përgjumshëm shkel e shko: *“automati i kafes pështynte pikëza uji”*...

Edhe pse kam lexuar shumë libra të përkthyer në gjuhën shqipe nga letërsia botërore, nuk më ka ra rasti të lexoj kësi gabimi të rëndë logjik. E nga ana tjetër trumbetoni për “gabime”, dhe kërkonin që pas një libri të qëndrojnë dy përkthyesë. Jo, nuk mendoj si ti i nderuari përkthyes. Shkaku se, e thashë edhe më lartë: për mua përkthimi është rikrijim. Nuk e di si mund të qëndrojnë dy përkthyesë pas një libri, individë të dy karaktereve të ndryshëm dhe moshave. E të mos flasim për aftësitë përkëthyesë - letrare. Shkollat e kryera brenda e jashtë vendit. Bagazhin e përkthimeve. Prandaj, jam i mendimit që në një libër të mos figurojnë sa për sy e faqe dy përkthyesë. Mund të figurojë një redaktor letrar, po me një kusht: pa këto gabime të “specialistit”. Përmëkeq, edhe kur ngul këmbë se, përkthimi yt do të dalë i përkryer?! Jo, mik! Jo. Unë nuk mendoj ashtu se, ti e njuh gjuhën letrare shqipe më mirë se unë. Edhe atë, se ti je nga Tirana e unë nga Shkupi.

Latërsia dhe shkenca nuk i njohin këto dallime (ligje), po aftësitë krijuese. E përsëris edhe njëherë: Zoti (Natyra) o ta jap, o nuk ta jep këtë dhunti. Edhe pse, ma bën me dije se keni qenë përkthyes një kohë të gjatë (1980) në Sh.B. “Naim Frashëri”, kjo nuk mund të më bind për përkthime të arrira letrare. Shkurt, se je përkthyes i mirë dhe një i ri nuk mund të përkthej më mirë se ti edhe pse me përvojë përkthimi të dhjetra librave të gjinive të ndryshme letrare.

Gjuha letrare shqipe nuk duron Zot mbi krye. Zot është vetëm ai që i jep gjak dhe shpirt.

Edhe Shekspiri nuk është i përkryer. Vetëmse, Shekspiri është Shekspir. Shkurt: “me sëpatën e madhe”, siç i themi ne në Kërçovë, si Shtëpi botuese, të cilën e udhëheq unë, nuk lejoj të figurojnë në të njëjtin libër dy përkthyes. Ti po të mendosh se mund ta përkthesh librin më të arrirë gjuhësisht dhe artistikisht, urdhëro dhe botoje një ditë në tjetër shtëpi botuese! Lexuesi është gjykatësi më i mirë, që mund ta ndajë grurin nga byku në lëmë...

Edhe një e vërtetë. Ju jeni dy përkthyesë të ndryshëm për nga mosha dhe shkollimi. Dhe, vini nga dy vende të ndryshme të Shqipërisë. Që, do të thotë edhe nga gjuha dhe letërsia popullore dalloni mjaftë, edhe për nga shkollimi. E mos të flasim për nga aftësitë përkëthyesë - krijuese. Dorën në zemër, mua nuk më kujtohet të kem lexuar ndonjë përkthim nga ti, edhe pse kam lexuar dhe njoh mjaftë përkthyesë nga Shqipëria: Lasgush Poradeci, Vedat Kokona, Perikli Jorgoni, Aurel Plasari, Jorgo Bllaci, Petraq Kolevica, Llazar Siliqi, Prokop M. Gjergo, Sotir Caci, Enver Fico, Aleko Ballauri, Ilia V. Ballauri etj.

Me këtë dua të them: ne si Shtëpi botuese për herë të parë në gjuhën shqipe e kemi sjellë Ujkun e Stepës, Demianin, I gjallë është vetëm ai që dashuron të H. Hesse, Perëndimi i përçarë dhe Midis natyralizmit dhe religjioneve – J. Habermas, Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit – E. E. Schmit, Vizita e Zonjës Plakë dhe Fizikantët të F. Durrenmatt, Politika si profesion i M. Veber, Stiler të M. Fisch, Hyzmeçari të R. Walser, Klasa

fluturuese dhe Konferenca e Kafshëve të E. Kastner etj.

Edhe një herë e them: më vjen keq kur thua se, ne kemi “kërkuar argumentet e specialistit”. Gjuha letrare shqipe nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk duron mbi kokë të vetëquajtur “specialistë”. Gjuha letrare shqipe zhvillohet, pasurohet dhe krehet përditë në të gjitha trojet shqiptare. Fundi i fundit ti e di se, gjuhën e krijojnë shkrimtarët dhe jo përkthyesit.

E përmend dhe: “se nuk kam asnjë ambicje për çështjen e emrit. Libri le të dalë me dy përkthyesë: sikur të kemi një punë të barabartë”.

E thashë njëherë. Unë nuk pajtohem me një mendim të këtillë “specialisti”. Buka nuk duron ta gatuajnë dy magjetore. Dhe, ta fusin në çerep, nën saç. Edhe përkthimi është si buka.

Dhe, në fund: i lexova me vëmendje shembujt “gabimet”. Përkthimi yt është i rëndë dhe plot gabime logjike, më bie me çekan në kokë. Edhe atë, vetëm në këto pak faqe, e merre me mend po ta lexoj gjithë librin.

Vetëm disa shembuj: E para: libri nuk përkthehet fjalë për fjalë. E dyta: nuk herret nga shprehjet tona popullore, në të cilën i ka rrënjët gjuha letrare shqipe dhe letërsia artistike : “*Shiu trokëllinte mbyturazi.*”

Jo, përkthyes i nderuar! Shiu nuk trokëllin mbyturazi! Shiu bie litar. Shiu bie si me shtamba. Shkaku se, bie nga qielli, e ka lirinë e vet, rrugën e natyrës. Dhe, nuk mund ta kap askush për fyti...

Ose: *E lëre më kur e bëje me qëllim.* / Ti: *veç po ta bëje me qëllim.* Unë nuk shoh këtu

asnjëfarë dallimi në mendim dhe dëmtim teksti. E para është një shprehje popullore që është gjallë edhe sot e kësaj dite. E dyta: një përkthim gjoja në gjuhën letrare. *Sirtari i librave*. / Ti: *etazheri i librave*. (???!!!) Përçudi, ende nuk e shoh “specialistin”...

Përfundimi, pas këtyre shembujve, nuk kam më forcë të vazhdoj me krahasimin e përkëthimeve të “specialistit”. Pështyma dihet se çka është. Dhe, “*automati i kafes nuk pështyn pikëza uji...*” Nuk i përmenda fjalët e tepërta që i fut ti në përkthim pa nevojë e u ka ikur përkthyesi tjetër pa e dëmtuar tekstin dhe me dëshirë që të mos e maltertojë kotnasikoti lexuesin besnik mes atyre faqeve të librit...



**E PASHË “NOVA GODINËN”* ME NJË
FËMIJË PËRDORE NË SHKUP**

Vite me radhë herë pas here, kur jam në Shkup, kthej te restoranti “Miracoli” për t’i marr “ilaçet” e mia të mëngjesit. Kohë kjo, që zgjatë nga vitet ’80 -ta, pas kthimit tim nga ushtria famëkeqe jugosllave. E nis ditën me dy uzo, ose raki rrushi. E më vonë mundet ndonjë kafe, birra ose shtambë me verë. Që nga ajo kohë, unë nuk përdori hapa (aspirina), as edhe për kokën. E mos të them se shkoj te mjeku. Librezen e shëndetsisë e kam hedhur moti diku mes librave. Shkurt, vështirë se mund ta gjej po të kem nevojë ndonjë ditë. Zoti do ashtu, dhe unë nuk kam nevojë, e kam nxjerrë nga përdorimi qysh para shumë vitesh në Katund.

Edhe sot u ula si zakonisht te “Miracoli”. Ganiu, kamarieri i restorantit nuk vonoi shumë dhe pa më pyetur ma solli “ilaçin” tim me akull. E di Ganiu punën e vet dhe shprehinë time të mëngjesit për marrjen e “ilaçeve”. Përderisa pi “ilaçin” dhe shfletoj gazetat e ditës, padashtas e ngrita kokën. Dhe, e dini çka pashë?! Jo, nuk e dini. Mendja ju shkon për së prapthi, siç e kani zakon ju “miqtë” e mi të propagandoni për mua përpara gotave të çajit: E ke parë ndonjë personazh të librave të tu, që këtë mëngjes i përdredh bythët rrugëve. Ose, ndonjërin nga ato Miket e tua me dy shtamba verë, që edhe të vdekurin e ngrejnë nga varri. E tashti, kur i ka ardhë koha për burrë, edhe kësaj si të tjerave aktiviste partiake, ia ka gjetë një burrë partia.

Përçudi, pas kaq shumë vitesh e pash “Nova Godin” me një fëmijë përdore në Shkup. Atë “Nova Godinën” kuqezi të Kërçovës, që moti ecte lartëposhtë ditëve të pazarit me një fëmijë përdore. Ose, siç na thonte neve fëmijëve Xha Duli i Cërvicës, kërkonte burrë.

E pabesueshme! Shkaku se, moti nuk e kisha parë atë grua Shëngjergji rrugëve të Kërçovës. Unë vazhdova shkollimin në Shkup. E më vonë studimet në Prishtinë, ku edhe jetova disa vite “çmendurie”. E pas ushtrisë, përsëri në Shkup rrugëve të këtij qyteti me gurë e xhamia, minaret e të cilit e shponin qiellin. Hoxhallarët ku fluturonin mbi qytet si azreti Isai në qiell. Çafkat, ku kishin zbritur nga lisat nëpër sokaqe. E serrat shëtisnin lirshëm natën. Nuk do të thotë kjo se nuk e vizitoja vendlindjen, po ja nuk e takoja më si dikur “Nova Godinën” kuqezi me një fëmijë përdore rrugëve të Kërçovës. Shpesh ma thoshte mendja, ndoshta “Nova Godina” është shpërngulur edhe ajo në Turqi. Ndohtë, e ka ndërruar edhe Qytetin. Me siguri ka gjetur ndonjë qytet më të bukur e plot rrugë, hije për të marrë lirishtë frymë. Nuk doja të mendoja asesi keq se, “Nova Godina” edhe pse e shtyer në moshë, e lyer e përlyer mund edhe të ketë vdekur në ndonjë rrugë çorre të Kërçovës. Përmëkeq, të mos i dihet varri. Nuk vdesin jo aq lehtë nuset siç visheshte ajo me “lule - lale” kuqezi e lloj lloj stolishë gjatë ditëve të pazarit në Kërçovë.

Kurreshtja nuk më la rehat. E lash “ilaçin” mbi tavolinë dhe iu vura pas me të gjitha forcat nëpër Qendrën tregtare. “Nova Godina” kuqezi e

stolisur me “lule - lale” e fëmijë përdore kishte ardhë në Shkup, e unë të mos i dalë përpara si dikur në kohën e fëmijërisë ta ngacmoja pak me ndonjë fjalë, nuk bën kurrsesi, këtë veprim nuk e do edhe Zoti.

Dhe, e zura “Nova Godinën” përpara derës së një librarie. E kishte ndalur në rrugë një shok imi, që e hiqte veten edhe ai si shkrimtar. Nuk më erdhi mirë, nga e njihte ky “Nova Godinën”?! Fundi i fundit, ky nyk kishte asgjë të përbashkët me “Nova Godinën” time të fëmijërisë. Iu afrova ngadal tinës pas shpine. Dhe, e dini çka pashë?! Jo. Përsëri nuk e dini: dëshprimin. O Imzot! Për pak desh plasa nga inati atë ditë. Nuk ishte “Nova Godina” e fëmijërisë sime, po ish Tellallja e Kurvës Parti...

• “Nova Godina” (Viti Ri) - Grua e çmendur, e veshur kuqezë, që të shtunave (ditëve të pazarit), shëtiste me një fëmijë përdore nëpër çarshi të Kërçovës. Dhe, kërkonte burrë...

ZGJOHUNI TË VDEKUR SE

NA MBYTËN TË GJALLËT

Eh, lexuesi im i nderuar, sikur këta politikanë shqiptarë, këta akademikë, këta intelektualë, këta shkrimtarë, këta gazetarë, këta patriotë me kësula të bardha në kokë e pa to, të punonin e reagonin me kohë për arsimin në gjuhën shqipe, kulturën shqiptare! Vërtetë, do të hapte një faqe të re historia shqiptare. Nuk do ta lodhnim shumë kokën me “Makedonska enciklopedija” e marrëzira të tjera se, a jemi kaçakë dhe a kemi zbritur nga mali. Gazetat t’i mbushim kotnasikoti plot reagime e vajtime. Popullin ta thirrim në protesta në rrugë. E në të vërtetë, ai është në rrugë me vite, i papunë falë partive tona politike. Po, ja që nuk reagojnë burrat e botës në gazeta, nuk protestojnë në rrugë me parulla e pankarta në duar për arsimin e politizuar deri në palcë, nuk e ngrejnë zërin për liri. Përmëkeq, me të gjitha forcat reagojnë për “Makedonska enciklopedija”. Punë e madhe. Pamfleti politik, që na e dhuruan “vëllezërit”, duam s’duam ne, do të përfundojë në Bibliotekën Popullore Universitare të Qytetit: “Sv. Kliment Ohridski”, ose nëpër shtëpitë e lexuesve sllavomaqedonas e shqiptarë. Nuk më pengon kjo, dhe as që kam kohë të merrem me një pamflet të këtillë sllavokomunistë me fletët e të cilit nesër torbeshët do të shesin fara.

E rëndësishme është se, më pengon vetëvetja, politizimi katastrofal i arsimit shqiptar dhe kulturës shqiptare. Fatkeqësisht, e kemi nën nivelin e pas kohës së Luftës së Dytë Botërore.

Ne nuk kemi arsim shqiptar, ne nuk kemi kulturë shqiptare. E në anën tjetër, kemi kohë për të harxhuar energji për një pamflet politik sllavomaqedonas.

O shqiptarë, mjaftë më punuat e luftuat për sllavomaqedonasit! Shtetin e shokut Tito, që pas Luftës së Dytë Botërore e polli Jugosllavija e sot, e përkundin serbët në djep me ninulla shoveniste - nacionaliste. Popullin artificial pakicë të prodhuar nga shqiptarët, bullgarët, serbët, vlllehët, turqit, torbeshët e romët. E ktheni kokën pas një herë edhe për shqiptarët, popullin shumicë në këtë Shtet, që me plot arsye u takon të udhëheqin me Qeverinë. Pse jo, le t'u kërkojnë shqiptarëve një herë edhe sllavomaqedonasit gjuhë amtare, shkolla, flamur, Universitet, Akademi të shkencave e të drejta kombëtare. Vetën le ta provojë edhe ky popull artificial në rolin e lypsit të Ura e Gurit. I bindur jam se, shqiptarët do t'ua jepnin me të dyja duart të gjitha këto të drejta kombëtare. E nesër?! Nesër, shohim e bisedojmë në Kuvendin shqiptar se, sa banorë sllavomaqedonas do të ketë ky shtet multietnik, që me këmbëngulje duam ta ndërtojmë ne shqiptarët. Edhe njëherë them: ktheni kokën, shikoni prapa në lëmë! Arsimin e keni në gjendje katastrofale si në kohën e komunizmit, me pak shpirt. Ende nuk keni shkolla fillore. Tekste shkollore. Lektyra shkollore. Abetare.

E këndeji, ia futni pordhë politike në mes të ditës kundër enciklopedisë sllavomaqedonase. Gojën plot e them: ju jeni edhe kundër fëmijëve të juaj në bankat shkollore. Vite me radhë i keni

lënë pa lokale shkollore. Tekste mësimore. I keni lënë edhe pa mësuesë...

E them këtë se, më ka ardhë më deri në fyt. E kam vjellë ushqimin. E kam vjellë politikën. I kam vjellë edhe zorrët. Dhe, nuk kam më çka të vjellë nga barku.

Poezinë nuk e vjellë. Edhe librat. E di, politikanët trusakatë duan t'i vjellë edhe këto dhunti të Zotit, po ja që unë nuk dua t'i vjellë. Unë e vjellë politikën e tyre teknefese. Unë i vjellë argatët e tyre trusakatë brez pas berzi. Dhe, unë i vjell me gjithë zorrë spiunët e tyre shekullorë. Pse, do të thoni ju si lexues?!

Nuk ka problem edhe këtë fshehtësi do t'ua rrëfej si shkrimtar. Vetëm, nesër nuk dua të më ankoheni te partitë politike. Nëna e juaj Njerkë. Shkaku: ngase Nëna juaj Njerkë, nuk u jep qumësht si Nëna e juaj e vërtetë. Djepin nuk di ta përkund me ninulla shqiptare deri në mëngjes. Nuk ju merr në gji si Nënë.

Punemadhe, do të thoni ju burrat e mejdanit me brekët nëpër këmbë. Nuk është ashtu, lexues i nderuar. Nuk është njësoj të pish qumësht te Njerka dhe të thithish gji nga Nëna. E them këtë se, thirrem në ligjet e Natyrës. Vërtetë, është e përkryer. Kot mundohemi ne artistët t'i bëjmë konkurrencë. Natyra është ajo, që momentalisht është a pakalueshme me kryevepra. Nesër nuk dihet, del ndonjë burrë nëne dhe e kalon edhe Nënë Natyrë.

Fatkeqësi kombëtare! Partitë politike, nesër kush do t'i marrë në gji?! Kush do t'i përkund në djep?! Kush do t'u jap tagji?! Kush do t'i nxjerrë

në rrugë çdo katër vjet në zgjedhjet lokale e parlamentare. Tyme flakë do të nxjerrin nga goja. Zërin do ta ngrej në lartë nëpër fushata zgjedhore për Gjuhë shqipe. Universitet shqiptar. Akademi shqiptare. Shqipëri Etnike. Punemadhe. Edhe kësaj radhe le t'u jap Njerka gjë me shtamba. Vetëmse, një gjë duhet ta pranojnë: janë kopila. Kopila edhe do të vdesin brez pas brezi, hyjnë në varre. Profetike, ë?!

Kopilat, dihet e kanë Njerkën. Dhe, Babën e rrejshëm. Vetëm, nuk e kanë qumështin e Nanës. Gjirin, që edhe të vdekurin e çon nga varri. Qumështi i Nanës është jeta. Shpirti. Gjaku. Lufta që e bëjmë nëpër shekuj brez pas brezi për liri. Edhe më doni të ju flas, shkruaj marrëzira?! Mjerim. Po, kur do të ju dalë gjumi shekullor, ngrisni zërin si shqiptarë?!

Nesër. Ose, pasnesër. Vonë. E them këtë se, nesër më do të keni vdekur, gërhisni në varr. Ndodhë të sharroni shëlgje. Ndonjëri, ndodhë të bëjë edhe çerepë. Saç me shpuzë nuk do të keni ta piqni bukën në mes të odës. Saç.

O Imzot, edhe kësaj radhe mos ua merr për të madhe! Nuk shohin. Nuk dëgjojnë. Nuk dinë. Ua ke dhënë sytë, po nuk i shohin shenjat. Ua ke dhënë veshët, po nuk e dëgjojnë lodrën. Ua ke dhënë kokën, po nuk e kanë në qafë...

Halli?! Edhe një lutje: ua kthe në kokë! Nuk e bëjnë këtë se duan, po nuk dinë. Patjetër, duhet dikushi t'u pri në ballë. Rrok për dore. Tjetër është ajo se, këtij populli i prinë në ballë partitë politike. Gjysëmanalfabetët. Edhe një herë ju

lutem në emër të Krishtit e Muhamedit, mos i merrni më qafë!...


Dënimi duhet vuajtur gjithësesi, dëgjova një zë nga qielli. Atëherë, së paku le të jetë sa më i lehtë, pa dhimbje. Nëse është nevoja le të digjemi në zjarr të Xhehnemit! Njëherë e përgjithmonë t'i lajmë mëkatet si popull i zgjedhur nga Zoti.

Jo, përsëri bërtiti zëri nga qielli. Juve si popull, u ka nemur Turku. E nama, përderisa të zë vend fluturon në qiell e tokë. Fatkeqësisht, kësaj radhe zbriti në tokë, në mesin e shqiptarëve. Këmbëkryq u ulë në rendin e parë, në xhami. Hoxha thirri në minare.

Ndihmë! Ndihmë, o Zoti Madh! Na shpëto edhe kësaj radhe nga robëria pesqindvjeçare anadollake! Asimilimi. Ti e di se ne më nuk kemi edhe një Skënderbe, që të na çlirojë nga halldupët, heqi prangat. E patëm një, po edhe këtë duan të na e marrin sllavomaqedonasit. U kemi dhënë mjaftë. Po, këta siç duket e kanë barkun e madh tinar. Thesit nuk janë duke ia lidhur grykën. Përmëkeq, e kanë një thes me arna. Specat u bien udhës. Patlixhanat.

Mëshirë, o Zot! Ecin e flasin jerm. Ndonjëri ka përmirë edhe në sofër të xhindeve. Rrugës flet vetmevete. Babashehu kot i fry në Tyrbe. Hoxha kot përpiket t'ia këthejë në kokë me një hajmali për qafe. Nuk e zënë magjitë, xhindet e kanë në dorë. Natë për natë e hedhin dorë më dorë mbi çatia. Majë lisave. Nuk e dinë ku e kanë bythën e ku kokën. E sa di unë, bota do kokë e jo bythë...

Zgjohuni të vdekur, se na mbytën të gjallët!...



III LUFTA E TRURIT ME B -në E MADHE
TË SHYTYPIT

LUFTËN E FITOJMË - PO NË TAVOLINË NA QEPIN STRUKE

Dera u hap dhe hyri im Atë në dhomë. Kësulën e bardhë ende e kishte në kokë. Sahatin me qystek, përqafe në xhep. Tirqit me vragja... Xhemadanin me sumbulla... Struken si gjithëmonë e kishte hedhur krahëve. "Nagantin" me gjithë fishekë në brez...

- Edhe kësaj radhe e keni nisur luftën... I keni rrokur armët maleve...

- Po, baba. Nuk patëm tjetër rrugë, na detyruan t'u ngjitemi maleve... Majave me borë ta kërkojmë shtegun... Lirinë...

- Eh, o bir! Edhe më 1912 -tën, edhe më '41 -in i rrokëm armët. Ia vumë zjarrin Ballkanit. Po, në fund e pamë se kishim qenë të mashtuar, mbetëm nën zgjedhë. Frikë kam se, edhe kësaj radhe do t'ju mashtrojnë në tavolinë. Ne e fitojmë luftën, po në tavolinë na i fusin gërshërët, na qepin struke...

- Nuk e besoj, se një gjë të tillë mund ta bëjnë edhe në të 2001 -in. Mjaft kemi mësuar nga gabimet e atyre viteve, nuk u zëmë më besë...

- E di, o bir! E di. Frikë kam se edhe kësaj radhe do të na përsëriten gabimet... Shqiptarëve po u përsëritet historia... Gjithmonë jemi vonuar. E sëmura e Ballkanit, kur e humbi luftën, ne e kërkonim Baba Dovletin... Gjermania kur e dorëzoi Berlinin, ne ende lyftonim maleve të Zajazit për Shqipëri Etnike... Komunizmi, kur ishte në rrezik edhe në Rusi, ne me fotografitë e

shokut Tito në ballë u prinin demonstratave të viteve '81 të studentëve në Prishtinë...

- Edhe një herë e përsëris, nuk e besoj se do të na e hedhin edhe në demokraci. I kemi dhënë dhe po i japim mjaft gjak Lirisë...

Kësaj radhe do ta zgjidhim me armë. Nuk e kemi ndërmend t'ua lëmë këtë barrë fëmijëve tanë, si ju që na e latë neve, në gjysëm të rrugës kočinë me nuse mes maleve...

- Dhashtë Zoti! E mbylli bisedën im Atë duke ma lënë "nagantin" në duar, e përplasi derën dhe doli me mauzerrin krahut në Lëmë...

E mora "nagantin" dhe ia futa fishekun në gojë. Matanë Urës së Gurit, turma ishte tërbuar duke kërkuar armë dhe thyer dyert, xhamat e parlamentit. E grisi edhe flamurin e tyre me rreze, vendosi tjetër flamur. Muaj më parë kishin paralajmëruar "Natën e gjatë", kur Çairit do t'ia vënin flakën. Shqiptarët do t'i përzenin matanë kufirit, në Shqipëri. E unë mes librave i prisja me "nagantë" në dorë që pesëdhjetë vjet. E shi sonte po mi dërgonte Zoti dhuratë, t'i pres me të gjitha nderimet, ashtu siç e kemi pasur zakon nëpër shekuj ne shqiptarët. I dëgjova edhe krismat e para... Shpërthimet... Po, nuk e pash turmën. Edhe pse, e prisja edhe në Shkup Manastirin: Shtëpitë dhe dyqanet e shqiptarëve në zjarr e flakë në mes të ditës...

Telefoni cingërroi dhe më zgjoi nga mendimet dhe pusia nën dritare. E ngrita kufjen. Matanë telit e dëgjova zërin e Patriotit të Vonuar.

- A ende nuk ke ikur, nuk e ke braktisur Shkupin?!...

-
- Jo. E kam shpallur Rrapin, Zonë të lirë...
- Budallai. Kurrë, nuk u mbushe mend. Po, së paku ç'faj kanë fëmijët... Gruaja...
- Edhe babain deshën ta përzënë në Turqi, po nuk e luajti këmbën nga pragu. Një xhandar që për çdo ditë e pyeste në çarshinë e Kërçovës: A ende nuk ke shkuar në Turqi? E di si e shpërbleu... Jo, nuk e di. E zbythi qotek... E la me gjysëm shpirti në mes të xhades...
- Histori. Kohë të tjera ishin ato, e kohë të tjera janë tashti, kur mbi kokë e male na fluturojnë helikopterë rus... Avionë...
- Edhe e gjithë Rusia të fluturojë mbi malet tona, fusha e qytete, nuk do ta lëviz këmbën asnjë hap nga pragu...
- E kam ditur, ty të kanë shkalluar librat... Më dhimbesh, por nuk kam se si të të ndihmoj, iku koha e hoxhallarëve... Hajmalive...
- Nuk ka nevojë, unë nuk mund të ik nga Rrapi e sidomos tashti kur e kam shpallur edhe si Zonë të lirë... Ti ecë kur të duash, mua do të më gjesh nën Rrap, në Shkup...

PATRIOTI I ARRATISUR DHE PARULLA

E “VËLLAZËRIM – BASHKIMIT”

(Shkas: Gjuajtja e gurit dhe fshehja e dorës).

ZEKTHI: Kush është Patrioti i Arratisur?

PATRIOTI I ARRATISUR: Ballist. Në kohën e ish Jugosllavisë edhe komunist. I arratisur politik dhe veteran lufte. Edhe shkrimtar. Rrufjan. Kohën e fundit merrem frontalisht me të kaluarën. Nuk merrem me të tashmen e as me të ardhmen. Njëherit, ua bëj me dije se jam edhe “kujdestar i kombit”.

ZEKTHI: Polic i kombit?!

PATRIOTI I ARRATISUR: Jo, nuk u kuptuam, “kujdestar i kombit”. Thirrja ime e fundit ishte: ta shpëtojmë kulturën shqiptare!

ZEKTHI: Ëhë, tashti e kuptova. “Vëllezër”, ta sakatojmë kulturën shqiptare!... Tjetër?! Edhe ndonjë vepër patriotike!

PATRIOTI I ARRATISUR: Çka tjetër, mora pjesë në Mbrëmjet e poezisë strugane në vitin 2001, kur poetët e tjerë shqiptarë nuk deshën të marrin pjesë shkaku luftës që shpërtheu në këto anë. I rrëmbeva disa shpërblime për “flijime artistike”. Edhe honorare... Udhëtime zyrtare...

ZEKTHI: E qartë, keni qenë aktivist i Policisë letrare...

PATRIOTI I ARRATISUR: Po. Kryetar Dege në Katund. Edhe gjatë luftës së 2001 -shit kam qenë komandant lufte. Përderisa ti rrije nën hije dhe e kishe shpall Rrapin Zonë të lirë, unë dola kaçak me armë në dorë...

ZEKTHI: E në cilën anë bëre luftë, në katundet e Kumanovës, apo në Tetovë?

PATRIOTI I ARRATISUR: Në bregdetin shqiptar...

ZEKTHI: E sa di unë atje, nuk u zhvillua asnjë luftë për Liri?!...

PATRIOTI I ARRATISUR: Po, lufta nuk zhvillohet vetëm me armë...

ZEKTHI: Ëhë, tashti e kuptova. Ti paske punuar në Ilegalitet...

PATRIOTI I ARRATISUR: Po pra, në Ilegalitet.

ZEKTHI: E sot, ç'punë bën në Liri?!...

PATRIOTI I ARRATISUR: Rrotullime akrobatike – politike... “Pëllumb Postier” në postë, merrem me shpërndarjen e dosjeve. Vuajtjet e mia për Atdheun nuk janë shpifje dhe sulme të një polici letrar, po veprime kombëtare. Vendimet e mia letrare në Sllavomaqedoni nuk janë veprime të një kasapi letrar, patrioti që vazhdon të bëjë ndarjen e krijuesve shqiptarë në Sllavomaqedoni me metoda të njohura komuniste. Flamuri i luftës që ngrej unë, armët e luftimit dhe “metodat letrare”, janë të shkolluara në Strofka kabinetike të dajallarëve nga ku kurdisen plane dhe ndiqen krijuesë të padëgjueshëm – rebelë dhe shpërblehen krijuesë servilë të Oborrit ose të mjerë.

ZEKTHI: Zoti Patriot, kemi përshtypjen se jeni nga ata “intelektualë”, të cilët në të gjitha kohërat askushi nuk ia ka drejtuar gishtin. Përmëtepër, jeni shpërblyer me poste partiake e shtetërore nëpër redaksi e ministri... Çka do të thotë kjo, aftësi intelektuale, apo meritë e dajallarëve...?

PATRIOTI I ARRATISUR: e pranoj, nuk e mohoj si disa krijuesë rebelë se nuk kam qenë i

përgëdhelur nga Partia Komuniste dhe i shpërblyer në atë kohë të artë me bursë për studime nga APJ, poste në zyrat e kabinetet e një Organizate punuese “ndërtimtarie” të dajallarëve. Vetëm, të mos keqkuptohemi, tashti erdhi koha përsëri, që të ju prij në fitore të reja nga Kabineti i “vëllezërve”, Strofka ime Ilegale...

ZEKTHI: E kemi të njohur nga mjetet e informacionit se je më besniku i “vëllazërim – bashkimit”. I keni marrë edhe disa çmime letrare partiake nga vojvoda?

PATRIOTI I ARRATISUR: E vërtetë, tashti më, duhet të bindeni se unë jam vizioner. E shihni, përsëri erdhi koha e “vëllazërim – bashkimit”... Bashkëjetesa...

ZEKTHI: E kemi bindjen se je i vetmi që nuk e vajton të kaluarën. Sistemet ndrojnë, partitë, qeveritë... po, ti kurrë nuk bie poshtë... Krah për krah me “vëllazërit” dajallarë në fitore të reja...

PATRIOTI I ARRATISUR: Nuk trembem ta them haptas, nuk e vajtoj të kaluarën, atëherë kur me shokë e sakatova letërsinë shqipe, që vështirë e keni t’ia mbyllni plagët edhe sot e kësaj dite. Dhjetra krijuesë vdiqën pa botuar asnjë libër, e ndonjëri mezi arriti të botojë pas vdekjes. Shoqata e Shkrimtarëve të Maqedonisë sot numron mbi 400 anëtarë. E di, ju shqiptarët kërkonin së paku t’i keni gjysmën e anëtarëve të asaj shoqate, po nuk ju duhet një bandë e tillë rebelësh. Ose, siç thonë “vëllezërit” dajallarë: Lidhje e Shkrimtarëve Shqiptar paralele...

ZEKTHI: Në fund, çka do të na thoni zoti Patriot? Ndonjë porosi?!...

PATRIOTI I ARRATISUR: Shqiptarët ndaj meje kanë ende borxhe. Shkurt, duhet të më japin një shpërblim mbarëkombëtar...

ZEKTHI: Hi-hii-hiii... Shpërblimin e fundit zoti Patriot, e ke pas dere... Ia pafsh hajrin!...



**POETËT VIJNË ME SHI
DHE IKIN ME POEZI**

Herën e fundit në Shkup dhe Kërçovë, në Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, në Shkup dhe Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë, që i organizon Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar, poetët erdhën me shi. Dhe, ikën me poezi. Unë i kuptoj si poet, shenjat e Hyut, që na i dërgojnë të vdekurit nga mesi i varreve. Tyrbja e Babashehut, në Baba Tomorr. Po, nuk e di a i kuptojnë politikanët?! “Burrat” e grave, që janë fundosur bythekrye në kolltuqe. Kabinete të Qeverisë... Ministri...

E kanë harruar arsimin. E kanë harruar kulturën shqiptare. Themelet e një shoqërie. Populli. Shteti. Fare nuk e çajnë kokën. Jo, e çajnë kokën, po e çajnë për B -në e madhe të shtypit. Punamadhe, që populli vuan edhe për bukën e gojës. B -ja e madhe e shtypit, nuk e ka këtë problem barku. B -ja e madhe e shtypit e ka problem të shkojë në hale. Aty e ndjen veten më të sigurtë, mes gjirizit.

E ti, siç do të thoshte poeti i madh shqiptar, Frederik Rreshpja: *“me një copë buke në dorë do të kalosh para dyerve të Partisë”*. Ndodhë, nën dritaret e tyre me kitarë të këndosh edhe serenatë.

Vitet vijnë e ikin njëri pas tjetrit. Edhe Frederik Rreshpja, papritmas iku nga mesi ynë një ditë. Shkaku: u lodhë më në mesin e këtij bërlloku, që përditë e më shumë na ka rrokur për fyti, na e zë frymën. Tashti, fillon dyluftimi: poetët qysh moti i kanë hequr kufijt politik në mes të shqiptarëve. Gjatë kohës së komunizmit, librat e tyre kalonin kufirin mbi gomarë ilegalisht

me thasë dorë më dorë. Në “demokraci”, erdhi koha edhe vetë poetët ta kalojnë kufirin politik. Edhe pse “demokracia”, përveç kufirit politik që kishin shqiptarët me Shqipërinë, u vuri edhe kufij të rinj politik. I ndau me kufij edhe Shqiptarët e IRJ të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës Lindore, që në Jugosllavi së paku nuk kishin kufij politik në mes vete si popull shqiptar me Kosovën. Poetët, qenë ata të parët që i hoqën qafe kufijt politik. I bashkonte poezia, e jo politika. Erdhën vetë nga të katër anët e botës me librat e tyre nga të gjitha viset e Atdheut: Tirana, Shkupi, Prishtina, Podgorica, Çamëria e Presheva. Politikanët i ndanë shqiptarët me kufij të rinj politik edhe me Kosovën. Që, në kohën e komunizmit ecnin dhe komunikonin lirshëm, shkolloheshin e jetonin në Prishtinë. Megjithatë, poetët qenë ata që kurrë, nuk njohën dhe njohin kufij politik. Edhe pas këtyre kufijve të rinj, që u vunë politikanët, plot rreziqe erdhën nga të gjitha viset e Atdheut në Shkup e Kërçovë: Pano Taçi, Hida Halimi, Bardhyl Londo, Ledia Dushi, Fadil Curri, Radije Hoxha, Gjon Gjergjaj, Irena Gjoni, Xhelal Tosku, Nehas Sopaj, Beatrice Balliçi, Kristaq Shabani, Ilaz Bobaj, Nuhi Vinca, Llesh Ndoçi, Kujtim Agalliu, Mariana Shkurti, Petro Dudi, Remzi Salihu, Dashnor Selimi, Dino Çiço, Xhelal Ademi, Agron Shele, Melda Ribaj, Festim Tomorri, Begzat Rrahmani, Rami Kamberi, Nuri Koleci, Rexhep Bajrami, Safet Hyseni, Adem Xheladini etj.

Në Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA në Kërçovë, poeti dhe artisti Ali

Qerimi do të recitojë poezinë e Ali Asllanit: *Hani, pini dhe rrëmbeni*. Salla do të dridhet nga vargjet e poetit të rebeluar që në atë kohë. Edhe e sotmja, sa i përngjan asaj të djeshmes të Ali Asllanit! Muret do të shkunden nga pluhuri. Kufijt politik edhe një herë do t'i dyndin, lëvizin nga vendi vetë poetët. Poezia nuk njih kufij politik. Të pranishmit do t'u bien duarve. I lumtë Ali Asllanit. I lumtë artistit, që na i solli këto vargje në mesin tonë për pak çaste. Edhe pse, politikanët nuk i kanë lexuar në libër, nuk i kanë mësuar përmendësh në shkollë, nuk kanë veshë t'i dëgjojnë edhe gjatë kësaj Nate të Madhe. Punë tjera më të mëdha kanë "burrat" e grave. Natën i vizitojnë Shtëpitë publike, e ditën gërhasin në gjumë në Qeveri. Ëndrra arushe shohin syçelë në mes të ditës. Gjithmonë, mendojnë se do të jetë ditë. Dielli do t'u rri mbi kokë. Po, natën?! Natën, ku do ta fusin kokën të mjerët, kur Hëna do të dalë mbi mal?! E lakuriqi do të turret gjithë natën nëpër errësirë. Zogu i keq do të na këndojë këngë kobi mbi shtëpi. Dielli, do të zbres një ditë më këmbë nga Çelëvjollca. Jo, thuani. E kemi frikë Dexhallin. Xhindet, që natën na hudhin dorë më dorë mbi çatia. Majë lisave të Çukës së Cërivicës të Xha Derallës, në Kërçovë.

Pajtohem. Mirë, po kush i hedhë potët dorë më dorë?! Përsëri, do të më përgjigjeni: xhindet. Jo, vështirë e keni të më bindëni me këto marrëzira moderne. Prandaj, u përgjigjem: Nusja me pashterkë të kuqe i ka mbështjellë lyrekë. Burrë, që e ka politikanin. Ditënatë i shëtit për dore rrugëve çorre. Herë pas here i nxjerrë edhe

te Pazari Grave. Në mes të ditës ua varë për qafe nga një hajmali mos t'i zënë magjitë. Të shenjtët poetë, që vargjet jua kanë lidhur politikanët nyje për qafe. I kanë rrokur për fyti me të dyja duart.

E kuptoj: poetët janë gjaku i popullit. Vijnë me shi. Dhe, ikin me poezi. Po, kush janë politikanët?! “Burrat” e grave, që nuk i do shiu, nuk i do poezia, nuk i do populli, nuk i do Atdheu. Jo, do të thoni ju. Edhe ata i do dikushi në këtë botë.

E vërtetë. Pajtohem. Kush pra, thuajeni?! Partia, ore burrë! Partia i përkund në djep. Edhe gjë u jep ajo Kurvë, kur qajnë për qumësht lope. Ninula u këndon mbi kokë t'i marrë gjumi. Që, nesër të rriten “burra” mejdani. Shpatën e Skënderbeut, çdo katër vjet gjatë zgjedhjeve parlamentare ta nxjerrin nga brezi. Ndonjëri, më guximtari t'i hip në shpinë edhe kalit të Skënderbeut. Zot t'i dalin Atdheut. Edhe nesër të na ndajnë me kufij të ri politik...

Poetët vijnë me shi. Dhe, ikin me poezi...

INTELEKTUALI I RREJSHËM

“Dhe Feridi faqe ndrron

Dje shante, sot lëvdon...”

Fan NOLI

Nuk e kam pasur mendjen të shkruaj për gazetë, ta ngre zërin, ta them mendimin tim të shkrimtarit për Intelektualin e Rrejtshëm, me të cilin nuk jam pajtuar dje, nuk pajtohem sot dhe nuk do të pajtohem as nesër. Një: nga shkaku se kam menduar se atij një ditë do t'i ngihet syri. Dy: do të pendohet për mëkatet e bëra dhe tre: do të bjerë në “din e iman”... Shkurt, do të heshtë, do të pajtohet me fatin dhe do të tërhiqet atje ku e ka vendin, me “plot plagë në trup” të presë pleqërinë... Zonjën Vdekje. Po, me që asnjëra nga këto të tria nuk ndodhi me këtë Intelektual të Rrejtshëm, ngase ai kohën e fundit na doli në skenë edhe me maskën e patriotit, qeshë i detyruar, se ndjej njëfarë përgjegjësie morale, përsëri të rrok lapsin... Mëngët t'i përveshi deri në bërryla... Lapsin ta nxjerr nga brezi... Lexuesve të mi besnikë, të cilëve gjithmonë jam përpjekur t'ua them të vërtetën edhe kësaj radhe t'u dal borxhit... Edhe pse, unë, ç'është e vërteta, Intelektualin e Rrejtshëm e kam marrë shpeshherë si personazh negativ nëpër krijimet e mia letrare edhe në kohë më të vështira dhe e kam zhveshur para syve tuaj krejt pis e lakuriq. Vetëm se, Intelektuali i Rrejtshëm si duket, nuk lexon gazeta, libra, nga karrierizmi i janë terruar sytë... Ose, kur është fjala për këto shkrime, i fut gishtat në veshë, bëhet i shurdh, e merr gjumi. Megjithëse, pa i lexuar ata, vite me radhë ka ditur të më dënojë

dhe të më shpallë si nacionalist, separatist e irredentist. E vazhdon hujin e vjetër, edhe pse herë pas here e ndërron qimen. Pse?

Intelektuali i Rrejshtëm që deri dje me zemër e me shpirt besnik i marksizmit dhe bolshevizmit... Në emër të këtyre siguroi disa punë, rrogë të madhe, veturë, dy - tri banesa. Shtëpi në Brezovicë, Prishtinë e... dhe karrierë politike. Me ermin e tyre në gojë binte në shtrat, lutej, shihte ëndrra dhe zgjohej nga gjumi. Por, me lulëzimin e partive të reja politike, Intelektuali i Rrejshtëm ndyrshoi krejtësisht brenda një nate. Ai turret i pari të anëtarësohet, ta tregoj veten në ndonjë parti politike. E shanë partinë komuniste që, deri dje për merita të mëdha si i dëgjueshëm, ia mundësoi, të gjitha privilegjet: redaktor në redaksi, profesor universiteti në Shkup, Prishtinë e Tetovë, anëtar i tre akademive të shkencave, anëtarë i disa komisioneve, këshilltar partie i të gjitha partive politike shqiptare, njeriu numër dy i Ibrahim Rugovës... Dhe, i cili në fund përfundon në Kabinetin e Kiro Gligorovit... Pse e bënë këtë? E bën se e di cili është, nuk ka besim në aftësitë e veta krijuese. Me përdimin e partisë moniste, që brenda një nate si mik UTB -ashi siguronte vende pune, e me ardhjen e këtyre të tjerave në skenë, ai e di se ato vende pune do t'i humbë edhe brenda një nate. Mu për këtë, ky Intelektual i Rrejshtëm para zgjedhjeve turret si pa kokë, ia hedh këlyshit të tij melez besnik me zgjebe një asht, e rren mendjen se me "aftësitë e tij krijuese" që posedon, do të uzurpojë përsëri vende të tjera pune. Pasuri. Këshilltar në ndonjë Parti politike

shqiptare. Bythekrye do t'i imponohet bërlllokut komunist në hapjen e panairëve të librit: në Ulqin e Tiranë. O Imzot, ç'e gjeti të shkretin! Ki mëshirë për të si për besimtarin e dëgjueshëm, sepse e mashtroi Shejtani... Falja mëkatet!... Se, ai nuk diti që këmbët e huaja nuk të shpiejnë larg, të lënë në baltë. Për të hipur në Baba Tomorr nuk duhet të kesh vetëm këmbë, por edhe guxim e zemër. Po, edhe aq më tepër të duhen forca për të qëndruar në majë. Se, fryejnë erëra të forta, bie shi, breshër, shtie rrufeja... E ky Intelektuali ynë i Rrejshëm mendoi se gjithmonë jetohet me rrena... Pazarllëqe... Përralla... Harroi se ndryshojnë kohët, vargjet nga poema “Vaji i bylbylit” e Ndre Mjedjes: /” *Bylbyl? Ky shekull or' e ças ndrrohet: /Bijnë poshtë të neltit, i vogli çohet...*”/ E harroi se vërtetë lindin parti të reja politike, po ne njerëzit jemi po ata të njëjtit, nuk kemi ndryshuar edhe sot e kësaj dite. Ai vetë deri dje që në radhët e para të Partisë Komuniste, çirrej e trumbetonte për liri, barazi, “vëllazërim-bashkim”... E po ky Intelektual i Rrejshëm sot ulërin, derdh lot e shan të tjerët për krizën politike e ekonomike. Ky Intelektual i Rrejshëm që hartues i planprogrameve mësimore në arsim, përpilimit të teksteve shkollore, lekturave shkollore, klasave të përziera, diferencimit të punëtorëve të arsimit, institucioneve kulturore, Enciklopedisë maqedonase... E shante popullin shqiptar në mjetet e informacionit... Nuk e donte flamurin e “huaj” shqiptar... E po ky Intelektual i Rrejshëm, sot ngre zërin për popullin shqiptar: nëpër parti politike, shoqata e unione të vëçave... I

bie tavolinës me grushta, ngre duart lart dhe mezi e zbresim nga podiumi ku lexon “poezi” patriotike. E kërkon flamurin, hapjen e shkollave shqipe, universiteteve shtetëror e privat, kthimin e punëtorëve të diferencuar në punë, nënshkruan peticione... Vjell, e çka nuk vjell Intelektuali i Rrejshëm në emër të popullit dhe për popullin. Vallë, pse e bën këtë??? Thua, pse e do popullin shqiptar? Jo. Nuk ma merr mendja. Se, mu ky Intelektual i Rrejshëm dje e shante dhe e dënonte këtë popull. Atëherë? Dihet. Intelektuali i Rrejshëm kurrë nuk e ka dashur, as mund ta dojë popullin shqiptar. Ai gjithmonë e ka dashur, e do kolltukun, paratë. Karrierën politike.

Pas Natës, vjen Dita... Lind Dielli... Gurgullon Lumi... Vjen Pranvera... Çelin lulet... Kthehen dallëndyshet... Këndojnë zogjtë... Është koha edhe pas teje të lindë dikush, o Intelektual i Rrejshëm! Mjaftë më na prive nëpër “beteja të përgjakshme”! I ndërrove maskat. E ngrite zërin. Derdhe lot krokodili. Nuk është koha e karnevaleve... E “roleve pozitive” në teatër... Populli e di rrugën e vet qoftë Dimër, qoftë Verë... Ai i njeh fare mirë bijat dhe djemtë e vërtetët edhe nëpër errësirë... Larg, shumë larg ua dëgjon zërin... Hapat... Tellalli kurrë nuk i ka prirë këtij populli. Po, burrat e pushkës e të penës... Tërhiq nga lakmia për karrierë politike në kurriz të popullit shqiptar sa nuk është ende vonë, sa nuk të ka dënuar Zoti... Rehatohu pak, shtrihu në shtrat, dhe prite Zonjën Vdekje! E di se, është nisur me qerre, vjen rrugës... Lëre popullin të marrë lirisht frymë, t’i zgjedhë vetë

më të zotët. Ai këtë e di më së miri, për këtë e ka
mësuar edhe historia. Mos dil të rrahësh gjoks për
trimëri atje ku nuk e ke vendin, pranë oxhakut, në
ballë të popullit! Po, lëshoju rendin edhe të
tjerëve, le ta thonë mendimin e vet, le t'i tregojnë
zotësitë, se me siguri edhe më mirë se ti dinë t'u
prijnë punëve nëpër beteja për fitore. Se, ky
popull gjithmonë tradhtarët, sot ose nesër, i ka
nxjerrë në sipërfaqe si kungujt mbi ujë...



Cun GELI (Adem KASTRATI)

“PATRIOTI” I VONUAR

E kam ditur, po nuk e ka ditur “ABAZI” i Malit, “Patriotin” e Vonuar. E mori nga shkolla politike e “Koperativës Bujqësore” dhe i dha post politik. E ai, gjithë ditën e natën fotografoheshte para kamerave televizive me emrin e tij në gojë: Ali Ahmetin e kam mik. Nesër, po të thotë “ABAZI”, unë bëhem edhe shërbëtor.

Kohë tjera ishin pas lufte. “ABAZI”, ende nuk i njihte mirë njerëzit e fushës. E pas lufte, dalin shumë trima. Nuk e ka thënë kotë populli: Trima pas lufte. Edhe komandantë kishim, u mbushën malet e fushat. Edhe Qeveria më vonë, pas zgjedhjeve parlamentare. Ministritë. Kabinetet. Mjerisht, vetëm një “Asker”, që pas lufte nuk kërkoi dekorata e as poste partiake, u kthye në Katund. Prandaj, edhe “komandantët” tanë pas lufte si ministra, deputetë e politikanë, i ndërronin partitë brenda një nate si kurva burrat. Edhe “Patrioti” i Vonuar si gjithmonë, që nga koha e komunizmit, shkonte nga fryente era. I ka ndërruar deri më sot disa burra e parti politike “demokratike” derë më derë.

E sot, era nuk fryn nga shkon “Patrioti” i Vonuar me shokë. Shkak ky, që edhe e ka humbur rrugën në mes të ditës në oborr, përpara shtëpisë. E ka ngatërruar “ABAZIN” me Ali Ahmetin. E ka dashur dikur shumë “ABAZIN”, edhe më tepër se babain, po ja kohën e fundit, shkaku i Ali Ahmetit, edhe “ABAZI” i delë nga zemra. E pabesueshme!? E di, ju do të pyesni: PSE????!!! Deri dje, kudo i shihje qafë për qafe dhe krah për krah me Doktorziun dhe Nusen kuqezi në rendin e parë nëpër manifestime të

Akademive përkujtimore të dëshmorëve të kombit. Festave shtetërore. Zbulimin e përmendoreve. Shënimin e përvjetorit të Skënderbeut... Ditën e flamurit... E shi sot, i paska “tradhtuar” Ali Ahmeti. Nuk i dëgjon më sot këta “patriotë” të vonuar, siç i dëgjonte dje “ABAZI”. Dorën në zemër, kanë deri diku edhe të drejtë. Vërtetë, kohën e fundit nuk i dëgjon këshillat e tyre Ali Ahmeti, siç i dëgjonte dikur “ABAZI”. E këta “burra” fisi, që nga koha e komunizmit, veten e kanë hequr si këshilltarë dhe baballarë për të ardhmen e kombit. Edhe të mençur. E si është e mundur, sot të mos i dëgjoj Ali Ahmeti këta “profetë” në të gjitha sistemet?! E kërkojnë “ABAZIN”, që pas lufte me shokë zbriti nga malet. Vitet pas lufte, kur këta të parët me shokë si kuadër “deficitar” u turrën me të katra për poste në Parti e Qeveri. E përgëzuan për guximin si komnadant lufte. E përqaftuan me të dyja duart si shpëtimtar i kombit shqiptar. Ia rrahën krahët dhe ia uruan “fitoren” e luftës. U ngutën të parët ta këshillojnë që të formojë parti politike. Edhe e dalldisën, i thanë: ti duhet të jesh kryetari i partisë politike që zbriti nga mali. I afruan listat e anëtarëve që duhet t’i ketë kjo parti politike. E pagëzuan edhe me emër evropian BDI. Fundrrinat e të gjitha partive politike shqiptare të mëhershme i mbëlodhi Partia e Ali Ahmetit. Dhe, dolën në zgjedhje krah për krah me flamuj partiak e kombëtar.

Populli shqiptar i etshëm për liri ua dha votën. Edhe fitoi krah i luftës (UÇK) në zgjedhjet parlamentare. Rast i rrallë ky në histori,

e dha provimin politik populli shqiptar dhe doli mbi nivelin e politikanëve. Dihet, hynë në Qeveri plot gëzim dhe i ndanë postet e fituara me gjak. Rast ky, që nuk ndodhi me popullin shqiptar të Kosovës, që pas lufte në zgjedhjet e para parlamentare pas lufte, fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, e humbi Krahu i Luftës (UÇK). Që, do te thotë: Përderisa, në Kosovë populli shqiptar hyri në politikë pa bagazhin e luftës, në IRJ të Maqedonisë hyri edhe shumë më i fuqishëm me gjithë bagazh lufte. Ja, shkaku pse politika e shqiptarëve në këtë anë të Atdheut ka pasur një përparësi më të madhe për të bërë politikë dhe korrë fitore historike. Vetëmse, me komunistë të djeshën e “demokratë” të sotshëm teknefesë, fundrrina të mbetura nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, nuk bëhet politikë.

“ABAZI” me shokë, që zbriti pas lufte nga malet, këtë jo vetëm që nuk e dinte, po as edhe e parashikoi, kur themeloi parti politike dhe hyri në Qeveri. Edhe filloi të merret me politikë. Ali Ahmeti gjatë këtyre viteve e mësoi politikën, po vonë pasi iu thye rrota e qerres në mes të rrugës. Ose, siç thotë populli: erdhën mendtë, po ikën dhentë. E pasi të thyhet rrota e qerres, gjenden plotë rrugë për në shtëpi.

E tashti, ku është problemi që “Patrioti” i Vonuar me shokë e kërkon “ABAZIN”, e nuk e do Ali Ahmetin?! E qartë: Katundi që shihet nuk do kallauz. Ali Ahmeti këtë vit i mbush dhjetë vjet që merret me politikë. I pa njerëzit e fushës. Edhe u mësua të bëj politikë. Kohën e fundit ka filluar edhe të mos i dëgjoj “trimat pas lufte” dhe

t'i pastroj radhët nga bërlloku i skaduar politik, fundrrinat komuniste. Edhe bënë mirë dhe punë me mend. Përndryshe, nëse vazhdon kështu me këtë politikë ditore, duhet sa ma parë ta pastroj veten, laj duart nga politika. Rrugën, veç më ia kanë treguar kundërshatarët e tij politik: të kthehet në vendlindje, Zajas. Ose, të ikë nga ka ardhë, në kurbet (Zvicër).

E "Patrioti" i Vonuar me shokë? Mos Zot më keq! Vërtetë, më vjen keq për "Patriotin" e Vonuar! Edhe po të dua nuk kam si e shpëtoj përpara stuhisë së pamëshirshme politike. I ndërroi që nga koha e "artë" komuniste duke dhënë shpirt e deri më tani në këtë kohë "demokratike" disa vende pune. Redaktor me dytri vende pune në redaksinë e një gazete komuniste të "vëllazërim-bashkimit". Fat i tij, këtu e mësoi edhe gjuhën shqipe. Në prag të "ndryshimeve" demokratike i shëtiti disa organizata "humanitare" e të donatorëve të huaj. Vitet e fundit, e provoi edhe "ABAZIN". E merreni me mend ky "patriot", po ta ngrente zërin për ndryshime demokratike që në atë kohë! Heshti, në kohën komuniste. Heshti, në kohën e ndryshimeve "demokratike". Heshti, edhe në kohën e "ABAZIT". Tashti, i doli gjumi pasmesnate si "analist politik". Nëpër gazeta e para kamerave televizive shkruan e fol jerm vetmevete. Është "Patriot" i Vonuar. E vetmja rrugë e shtpëtimit i ka mbetur dhe është: "ABAZI". Tekefundit, ai edhe i donte shërbetorët dhe servilët në politikë. Ali Ahmeti, kohën e fundit i do ujqërit dhe luanët.

“ABAZI”, ishte i malit... E ky Ali Ahmeti, që nuk e do sot “Patrioti” i Vonuar me shokë, është i fushës...



“KAJGANA”

Erdhi koha të shënohet edhe Dita e Pavarsisë së Republikës të Maqedonisë. Drekë festive, Qeveria shtronte në hotelin më të njohur “Aleksandër Palas”, në Shkup. Mes fytyrave të elitës (ajkës) politike të Maqedonisë, edhe mua si kryetar i LSHSH më në fund ma kishin dërguar një ftesë formale.

Nuk do mend, vendosa të shkoj në këtë dasëm festive edhe atë, më tepër shkaku se bëhej fjalë për Ditën e Pavarsisë së Maqedonisë. I madh e i vogël, pa dallim feje e kombësie plot gëzim si te ajo kënga e vjetër popullore shqiptare në kohën e komunizmit: *“Me gëzim po shkoj në punë”*, turrevrap te hoteli “Aleksandër Palas”. Dihet, si gjithmonë unë vonohem në kësi manifestimesh politike. Dhe, arrij i fundit. Shkak ky, që mbetem te dera. Nuk kishte vend nëpër tryeza, si zakonisht edhe nëpër festat e partive politike, ose para këmbëve të hoxhës për Bajram. U ula në mesin e gazetarëve, te dera. Padashtas, sytë më ikën te një politikan i yni i madh, patriot. Thashë, me vete: mirë qenka puna pasi e kanë ftuar edhe këtë politikan patriot, me siguri edhe gjendja e shqiptarëve do të ndryshojë më në fund, njëherë e përgjithmonë në këtë shtet “demokratik”.

Politikan patriot ishte ai, që gjithmonë e ngrinte zërin lart për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Parlament. Edhe në Bit – Pazar, shpeshëherë para zgjedhjeve lokale e parlamentare, këtë burrë pushteti e kisha parë me megafon në dorë duke kërkuar liri dhe barazi kombëtare hipur edhe mbi karroca të hamallëve.

E shi, sot e shihja pera meje në tryezën festive me këmbën përmbi këmbë. E kishte lënë çantën e lëkurës të politikanit pranë vetes në një karrike. Politikani ynë sipas madhështisë i kishte zënë dy karrike. Edhe kërpeshin e kishte kuqezi. Këpucët, nuk mundja t'ia shoh nën tavolinë, me siguri i ka pasur të kuqe me çorapë të bardhë. Fundekrye, politikan i përgaditur për një drekë madhështore festive.

Papritmas, erdhi edhe kamarieri me një bllok shënimesh dhe laps në dorë. I pyeste me rend të pranishmit se, çka do të porosisnin për drekë. Njëri, porosiste: “ramstek”. Tjetri: “biftek”, “pastramka”... I erdhi radha më në fund edhe Politikanit tonë të Madh.

-Ti, zotëri?

Politikani ynë i Madh e ngriti kokën:

- Ende nuk kam vendosur, mendohem... Pak më vonë. E, në anën tjetër tha me vete: Tashti, do të shihni ju se kush është i Madhi. Edhe atë, jo vetëm nëpër tubime të ndryshme parazgjedhore, tryeza të rrumbullakta, tribuna e debate televizive, po edhe në tryeza festive ku maten burrat e mejdanit.

Politikani ynë i Madh, pasi i dëgjoi edhe kërkesat e këtyre kolegëve, përsëri tha me vete: Asgjë speciale, mish viçi. E kjo tjetra: mish mëzati. Mish kau. Mish lope. Mish qëngji. Edhe kjo tjetra, nuk është për t'u duartrokatur: “Pastramka”. Peshk. Eh, edhe katundarët sot hanë peshk. Lumenjt janë të tyre, zbresin nga katundi. Jo. Jo, unë do të porosis drekën mbretërore, që këta kalamaj politikanë, jo që s'e

kanë hëngër, po as edhe kanë dëgjuar për atë specialitet. E lëre më, ta kenë provuar gjatë karrierës së tyre politike...

Edhe njëherë kamarieri kaloi para Politikanit tonë të Madh me meny në dorë.

- Hë, zotëri! A vendosët më në fund se, çka do të porositni për drekë?

- Jo, ende. U përgjigj Politikani ynë i Madh. Dhe, vazhdoi me shfletimin e menys faqe pas faqe mbi tavolinë duke i ndërruar syzat.

- Mirë, tha kamarieri, vazhdoni me zgjedhjen, do të kthej përsëri më vonë, zotëri. Dhe, vazhdoi me mysafirët e tjerë të radhës politkanë, akademikë dhe alamet doktora të universiteteve. Porosiste secili sipas dëshirës së vet dhe mendjes së barkut: “Medalioni”, “peçeno jagne”, “losos na skara”...

Kamarieri edhe një herë ktheu para Politikanit tonë të Madh.

- Zotëri, a vendose më në fund për drekën?!

Politikani ynë i Madh, pasi u shkund një herë nga krahët, pasi më në fund ia kishte qëlluar drekës mbretërore, e ngriti kokën dhe tha:

- “Kajgana”!...

Kamarieri mbeti i shtangur nga një kërkesë e këtillë befasuese. Përpak, t’i bie të fiktë. Edhe një herë e pyeti Politikanin tonë të Madh:

- Zotëri, më falni nuk ju dëgjova mirë! Nëse ka mundësi, ma përsëritni edhe një herë porosinë tuaj për drekë!

- “Kajgana”, bërtiti edhe më i sigurtë me krenari Politikani ynë i Madh.

Kamarieri uli kokën dhe përpara se të ikë përmes tavolinave, mori guximin ta pyes edhe një herë këtë politikan kaq të “veçantë e origjinal”:

- E, për pije?

- Çaj rusi!...

Kamarieri, kësaj radhe vetëm e shkundi kokën në shenjë habie. Dhe, iku me të katërta përmes mysafirëve drejtë kuzhinës.

Në ndërkohë, erdhi edhe “kajgana”. Specialiteti i ushqimit të zgjedhur me aq mund i këtij burri të mejdanit. Politikani ynë i Madh, kur i pa vezët e fërguara para tij, gati i ra koka mbi tavolinë si cung shelgu në livadh. E përmbajti veten, hodhi edhe një sy nga enët e kolegëve të tjerë politikanë: ata me mish viçi, qëngji e peshku, cakrronin gotat me verë shoku me shok në këtë Ditë feste.

Edhe, m’u drejtua mua pas shpine: Epo, kështu është kur nuk të kuptojnë “vëllezërit” në politikë. Vite me radhë, unë u them: gjuha shqipe duhet të jetë në përdorim në të gjitha nivelet e shtetit. E, “vëllezërit” dhe shqiptarët e shitur: jo, gjuhë e dytë zyrtare. Jo, vëllaçko! Jo. Gjuha shqipe duhet të jetë, jo gjuhë e dytë, po gjuhë e parë zyrtare, e barabartë në këtë shtet. Mjaftë më me fajin e tyre gjithë jetën hëngra “kajgana”: në kohën e Turqisë, “kajgana”, në kohën e Serbisë, “kajgana”, në kohën e Gjermanisë, “kajgana”, në kohën e komunizmit, “kajgana”. Edhe në kohën e sotshme “demokratike”, u dashka përsëri: unë të ha si laraskë vetëm “kajgana”?!...

**LUFTA E TRURIT ME B -në
E MADHE TË SHTYPIT**

Një popull që t'i arrijë qëllimet e tija kombëtare, patjetër i duhen rrugës për në Baba Tomorr: njerëzit e ditur, pas tyre vijnë të pasurit. Dhe, në fund populli.

Populli, që i ka me vete këto tre faktorë të rëndësishëm, a mund të ketë problem për t'i realizuar qëllimet e tija shekullore? Jo. E them këtë se, një populli i duhen këto tre faktorë të rëndësishëm për të Nesërmen.

E, a i ka populli shqiptar këto tre faktorë për të Nesërmen? Jo. E them me plot gojën. E ka vetëm faktorin e tretë, popullin. Po, jo edhe njerëzit e ditur dhe të pasur, që qëndrojnë në ballë të popullit.

Popullit shqiptar, në ballë duhet t'i pri Truri e jo B -ja e Madhe e shtypit. Fatkeqësisht, deri më tani (hiq rilindasit), populli shqiptar në ballë e ka pasur B -në e Madhe të shtypit. E, jo Trurin. B -në e Madhe të shtypit e ke në Qeveri. B -në e Madhe të Shtypit e ke në Parti Politike. B -në e Madhe të shypit e ke në Ministri. B -në e Madhe të shtypit e ke gjithëkund: në internet, gazetat e tyre partiake, emisione televizive, debate. B -ja e Madhe e shtypit ka edhe "Facebook -un" me më shumë miq të regjistruar edhe se liderët e partive politike. B -në e Madhe të shtypit e duan partitë politike. E do Qeveria. E do Shteti. Vetëmse, fatkeqësi kombëtare: B -në e Madhe të shtypit nuk e do vera, poezia. Dhe, gratë.

Ditën e Madhe, kur ky popull legjendar do të ketë në ballë Trurin e jo B -në e Madhe të shtypit, besoj se nuk do të ketë problem t'i realizojë aspiratat e tija shekullore brez pas brezi.

Edhe Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, ne e organizojmë falë vullnetit të poetëve. Fuqi mendore dhe shpirtërore kjo, në ballë të popullit, që më së shumti është goditur në këtë kohë “demokratike” nga B -ja e Madhe e shtypit.

E, për sa u përket partive politike Shqiptare, Ministrisë së Kulturës në IRJ të Maqedonisë, ky manifestim kulturor tradicional, është përpjekur të ngulfatet qysh para dy vjetësh. Shkaku: e ka rrokur për fyti B -ja e Madhe e shtypit.

Megjithatë, ne jemi poetë që kemi dalë në ballë të popullit. Nuk lejojmë që ky manifestim kulturor tradicional ndërkombëtar, që e futi i pari vargun shqip edhe në kohë të vështira lufte në Çarshinë e Vjetër në Bit – Pazar (1997), në zemër të Shkupit, të shuhet për tekat e dikujt me brekët nëpër këmbë dhe partive politike që na e sjellin koçinë nga malet pa nuse në Katund.

Për inatë me forcat tona, ne këtë vit do t'i mbajmë dy manifestime kulturore, njëri pas tjetrit: TAKIME NËN RRAP, në Shkup dhe Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. E qartë, ne u tregojmë atyre partizanëve të partive politike, që e nëpërkëmbin kulturën shqiptare, dimë të veprojmë edhe ndryshe, i shpallim luftë me poezi B -së Madhe të shtypit.

Truri duhet të jetë në ballë të popullit. E, jo B -ja e Madhe e shtypit. Fatkeqësisht, te ne

paguhet me para të thata B -ja e Madhe e shtypit e jo Truri. Qesharake, ë?! B -ja e Madhe e shtypit të vlejë më shumë se Truri! E pabesueshme! Kjo nuk ndodh askund në botë, në shtetet demokratike. Po, ja që ndodhë tek ne ballkanasit e vjetër, në IRJ të Maqedonisë. Popujt, që e kanë përzier edhe gjakun, pjellin melezë.

Halli?! Halla, do burrë! Në rregull, e kush do të ishte burri?! Natën e Madhe ta fusim me këngë Nusen në dhomë. Cucat pas dere copë-copë t'i bëjnë dajret. Im Atë edhe një herë të ngrihet nga varri, nxjerrë mauzerrin nga hatullat dhe të shti në Hutin me veshë që na këndon natën mbi çati këngë vdekjeje.

Dhe, më pyesin “miqtë” e mi, ku e kam vendin e punës. Qeshë. U përgjigjem: në Tavernë. Nën Rrap. Faj, nuk u kam se mua më do vera, poezia. Dhe, gratë E ato i do Partia. Qeveria. Shteti. I ka dënuar edhe vetë Zoti, në podrume. Natë e ditë ua shuan dhe ndez dritat të dalin në sipërfaqe, mbi tokë. Përmes të vdekurve u dërgon shenja. Yllit të mëngjesit. Diellit t'i dalin për mejdani. Natës, që i ka kapur në grusht. Mureve, që i shtrëngojnë natë e ditë mes librave. Hënës, kur del mbi mal pas mesnate. Pulës me zogj në qiell, që e thërret Gjelin të hip në gardh. Heret, ende pa zbardh agimi, ta thirrë me këngë mëngjesin. Diellin, që zbret më këmbë nga Çelëvjollca.


Tekefundit, ne bëjmë luftë kulturore me poezi: Truri me B -në e Madhe të shtypit. Brez pas brezi në luftë me B -në e Madhe të shtypit. Të mos keqkuptohemi, ne bëjmë luftë me tru dhe

penë. Vdesim në fushën e betejës me armë në dorë. Ringjallemi. Muza na jep gji mes maleve. Fuqi për luftë.

Përfundimi: Truri e vazhdon luftën me B - në e Madhe të shtypit.

Patriotët e vonuar e kanë gjetur Lëmë. E në Lëmë fshi edhe Kali edhe Gomari. E rëndësishmja është: Kali dhe Gomari nuk fshijnë njësoj në lëmë. Era nuk fryn nga malet e Drenovës për ta hedhur grurin në ajër Nusja me pashterkë të kuqe, pastrojë nga byku. Halli?! Halla, edhe kësaj radhe, përsëri do burrë mejdani.

O burra, nxirreni Gomarin nga Lëma se, na latë pa grurë në Dimër!...



MJEKËRBARDHI NJËQINDEDYVJEÇ: XHA DERALLA

Vite me radhë jemi përpjekur të organizojmë një manifestim kulturor: Ditët e Humorit dhe Satirës, në Kërçovë. Po, nuk e deshi Zoti deri në vitin 2003 t'ia hedhim themelet. Vendimin e morëm si Shoqatë e Shkrimtarëve Shqiptar që në vitin 1999, në Shkup. Pse, e zgjodhëm si qytet mu Kërçovën? E zgjodhëm se, në Cërvicë të Kërçovës ka jetuar dhe vepruar njëri ndër humoristët dhe satiristët më të mëdhenj shqiptar: Xha Deralla. Nasradin Hoxha nuk dihet me siguri a ka jetuar dhe n'çvend, dyshohet se është personalitet i trilluar nga populli. Xha Deralla ka vendlindje dhe krijime humoristike e satirike. Dy: në Kërçovë më shumë se në çdo vend tjetër ka shkrimtarë që merren me humor dhe satirë.

Në vitin 1999 plasi edhe lufta në Kosovë. Probleme kombëtare, politike dhe vështirësi ekonomike, të cilat i përballonte në atë kohë me vështirësi Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë. Përveçse me organizimin e jetës kulturore në IRJ të Maqedonisë, duheshte të merret edhe me strehimin e shqiptarëve kosovarë të dëbuar nga trojet e tyre etnike. Reagimeve me anë të kumtesave kundër dhunës në mjetet e informacionit dhe deri tek organizatat e ndryshme botërore. Përkrahjen që i dha vite me radhë Universitetit të Tetovës. Organizimin e manifestimeve kulturore tradicionale

ndërkombëtare: “Ditët e Naimit për Kosovën” dhe “Takime nën Rrap”, që i kishte mbi shpinë. Edhe atë, dihet në mes të dy zjarreve: nga njëra anë sllavomaqedonase dhe nga ana tjetër mashave shqiptare, që i ngatërroheshin nëpër këmbë. Megjithatë, qëllimi dihej: Rruga për në Baba Tomorr. Patjetër, duhej hip në Baba Tomorr. Vendin e Perëndive: Tyrben ku pihet vera, shkruhet poezi dhe bëhet dashuri. SHSHSHM -së qe, e para që vite me radhë edhe në krizë lufte i tuboi shkrimtarët nga të gjitha trojet etnike dhe Diaspora.

Dhe, kështu nga viti në vit shtyhej ky manifestim kulturor. Nuk e donte Zoti të hipim në Baba Tomorr. Në vitin 2001 plasi lufta në IRJ të Maqedonisë. Edhe një vit humbje. Dhunë. Flakë. Frikë. Varfëri. Viti 2002, me probleme edhe më të mëdha politike e ekonomike. Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar, përsëri ballafaqohej me vështirësi të mëdha ekonomike e politike. E vazhdonte jetën mes dy zjarreve, si Lidhje e Shkrimtarëve Shqiptar paralele në IRJ të Maqedonisë, (sipas sllavomaqedonasve), ku gati për çdo vit konkuronte në Ministrinë e Kulturës sipas konkursit të hapur me programin e vet. Në mes të tjerave edhe me këtë manifestim kulturor, Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Po, fatkeqësisht nuk ndihmohej ky manifestim kulturor i vetëm në IRJ të Maqedonisë, ku vetë një manifestim të këtillë nuk e kishin sllavomaqedonasit. E shi, sipas tyre donin ta organizonin shqiptarët. Vite me radhë u shpeshuan sulmet ndaj Lidhjes së Shkrimtarëve

Shqiptar. U angazhuan edhe mashat shqiptare të strukura në Ministrinë e Kulturës. Programet e Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar edhe pse ndihmoheshin me shuma materiale qesharake, përsëri paguheshin të cingura dhe me vonesë të madhe. Ose, nuk paguheshin fare.

Në fund, i përveshëm vetë duart deri në bërryla dhe në vitin 2003 për herë të parë i shtimë themelet manifestimit të parë kulturor, Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Erdhën satiristë nga të katër anët e Atdheut. Kërçova ato ditë kishte festë poetike. Katundarët e Xha Derallës në mes të fshatit e shtruan edhe Drekën poetike - satirike. Poezitë e tyre i lexuan penat më të njohura të humorit dhe satirës shqiptare. Artisti popullit për disa çaste në mesin e fshatarëve i solli për herë të parë edhe vargjet satirike të Ali Asllanit: *“Hani, pini dhe rrëmbeni...”*

Dhe, ja pas kaq vitesh lufte për kulturë shqiptare, me forcat tona, ndihmën e miqëve, Klubit të Shkrimtarëve “Mugullimi”, në Kërçovë dhe mbështetjen minimale materiale të Ministrisë së Kulturës, pronarit të Hotelit “Kërçova”, z. Vllado Toleski dhe Xhemës, pronarit të lokalit “Roma”, ky manifestim kulturor arriti të mbahet për herë të dytë në Kërçovë. Njëherit të tubojë penat më të njohura të humorit dhe satirës nga të gjitha trojet etnike shqiptare dhe Diaspora, me një qëllim: të bëhet tradicional dhe ndërkombëtar, të ketë jetë të gjatë, sa vetë satiristi Xha Deralla brez pas brezi në popull. Edhe, sa vetë Çifligu i Xha Derallës, te Përroni i Thanës, ku zogjtë i kanë

ndërtuar çerdhet dhe për çdo pranverë ia thonë këngës mes atyre maleve.

Dhe, dhashtë Zoti, vitin tjetër që vjen, në fshatin Cërvicë, vendlindjen e Xha Derallës e zbulojmë edhe përmendoren e tij, vendin e preferuar të tij gjatë verës, te Ureja, ku rrinte te porta plaku mjekërbardhë njëqindedyvjeç dhe u kishte vënë pusi me anekdota xhandarëve të serbit, rrëzë maleve të Çelvjollcës...



**“PATRIOT POETI” QË NË PLEQËRI
SHKRUAN POEZI EROTIKE**

Fjalën kësaj radhe e kam për “Patriot Poetin”, burrin e botës që dikur në poezi tym e flakë nxirrte nga goja. Gazetat dhe librat i mbushte plot pushkë, plot barot: Skënderbegë, Mic Sokolë, Bajram Currë, Mefaila, “askerë”, Shotë Galica e Sulltana Qafa . “Patriot Poetin”, që veç gruas së tij dhe lopës Larë, kurrë nuk ka pasur grua tjetër në dorë. Edhe atë, falë Zotit e martoi babai me shkues se, përndryshe edhe këto dy gra nuk do t’i kishte në jetë. Mirë, do të thoni ju, pajtohem me ty, nuk ka pasur dashnore në shkollë fillore, po mos na e rrasë mendjen me kësi marrëzish se nuk ka pasur edhe në shkollë të mesme. Jo, u them unë me plot bindje se, e njoh mirë “Patriot Poetin” edhe gjatë studimeve në Prishtinë. Edhe në Prishtinë nuk ka pasur dashnore. E thashë njëherë pak më lart, “Patriot Poetin” e martoi babai me shkues në Katund. Përndryshe, “Patriot Poeti” kurrë nuk do të shihte grua me sy në shtëpi.

“Patriot Poeti” ishte i “moralshëm”. Edhe fëmijët që i lindi me gruan e vet, nuk i bëri ai vetë, po ia solli lejleku. Gurë e dru hidhte mbi poetët që shkruanin poezi për dashuri. E sidomos kundër grave poete, që merrnin guximin të botojnë në gazetë ndonjë poezi për dashuri, ose libër. I sulmonte me fjalët më të egëra: ato janë kurvarë dhe kurva. Dhe, “Fakti”, i atëhershëm, gazetë e përditshme e “pavarur” në gjuhën shqipe, që kurrë nuk ka ditur se, ku e ka kokën e

ku bythën, ia botonte pa asnjëfarë problemi ato shkrime. E “Patriot Poeti”, të nesërmen fryhej si biban në Katund, ndonjëherë hipte edhe në avli se, edhe ky merrej me “kritikë letrare”. Nesër, me kritikën e tia teknefese do ta kalojë edhe kritikun e madh, DoktorZiun. Koha, që është armiku më i madh i mediokriteteve, e vulosi parashikimin e “Patriot Poetit”. E hodhi bythekrye në bërlllok me gjithë “kritikën e tia patriotike”. Poezitë e “dashurisë”, që i shkruante pasmesnate posa dilte hëna e plotë mbi mal: vetëm e vetëm për të pasur një grua asgane në shtëpi. E kur i thosha unë se, letërsinë në botë e kanë krijuar “kurvarët” dhe “kurvat”, i hapte sytë si viç i palëpi në mes të livadhit. Merre ti me mend, kush kanë qenë Çajupi, Naimi, Lasgushi, Uolt Uitmani, Bajroni, Jesenini, Hajne, Pushkini, Safo, Ana Ahmatova, Virgjinia Vulf, Marina Cvetajeva... “Kurvarët” dhe “kurvat” më të madha që me artin e tyre e kanë çuditur dhe pushtuar botën. Përsëri kot, sipas mendjes teke të “Patriot Poetit”, krijuesë janë vetëm ata që poezitë dhe librat e tyre i kanë plot shpata, pushkë, barotë e Mic Sokolë.

Eci koha. Eci edhe “Patriot Poeti”. Përmëkeq, tashti “Patriot Poeti” një ditë mbeti edhe pa grua. Fatkeqësia më e madhe ishte se, tashti më nuk ishin gjallë babai e as nëna, që ta martojnë edhe njëherë me shkues. Dasëm më dasëm, “Patriot Poeti” t’i gjejnë një nuse. E lopa Larë, moti kishte shkuar në botën tjetër me lule. Ose, te kasapi. Shokët i gjenin ndonjë grua, ama ia gjenin pasi e kishin provuar vetë së pari, e ia përgadisnin me pajë për nuse. Një natë, pasi nuk

fjeti gjithë natën e gjatë, “Patriot Poeti” duke menduar për frymëzime, i shkrepri në mendje: edhe unë do të shkruaj poezi dashurie për Miken. Nuk qenka edhe ajo punë burrash: me shpata, pushkë e topa të Mic Sokolit, vështirë u gjetka një grua për shtëpi.

Dhe, nisi “Patriot Poeti” në pleqëri të shkruaj poezi erotike. Vargje e vargje shkruante nëpër gazeta, revista elektronike. Dihet, edhe këto si ato poezitë patriotike plot patetike, parulla të thata e pa gjak. Përshkrime: Gjithëçka gjeje te poezia e “Patriot Poetit”, po jo edhe art, gjak e shpirt. “Patriot Poeti”, kishte dëgjuar se të tjerët shkruanin poezi erotike, po nuk e dinte marifetin e atij vargënimi. Ditenatë mbyllej në dhomë, e hapte dritaren dhe çirrej në errësirë mbi Katund me ato vargje plot patetike: unë jam poeti më i madh shqiptar i dashurisë i të gjitha kohërave! E imagjinonte Muzën me dy shtamba verë, se kishte dëgjuar se poetët e mëdhenj që kanë shkruar për dashuri kanë pasur edhe muzat e tyre, po më kot, nuk i shkrepse pushka, më falni pena. Vargjet i dilnin me zor, shterzonte si një lopë në mes të lëmës kur e pillte viçin. Koha e soçme e mori edhe në qafë. Katundarët më tashti nuk mbanin si dikur edhe lopë nëpër livadhe se, “Patriot Poeti” me siguri në ndonjë livadh do ta gjente një Muzë asgane. Penën do ta nxirrte nga brezi dhe të nasërmen, poezitë si lumë me plot dallgë do t’i rridhnin në libër. Katundarët do t’u binin duarve shuplakë: edhe ne më në fund e kemi poetin e madh të mëhallës. Tym e flakë nxjerrë nga goja. Përderisa, dikur me poezi patetike na bënte

Shqipëri Etnike, tashti e tutje në Katund do të kemi edhe Shtëpi publike!...

Punemadhe, them unë: pas kaç viteve. Edhe “Patriot Poeti” e ka vendin e vet në Historinë e Letërsisë Shqiptare. Lopët, kur nuk kanë barë, hanë edhe kashtë. Pse, atëherë edhe lexuesit ndonjëherë të mos hanë kashtë?!...



**B -ja E MADHE E SHTYPIT
PJELLË VIÇA TË PALËPI**

E di, vështirë do t'i besoni këtij rrëfimi. Edhe unë që vetë e shkruaj mezi i besoj si shkrimtar. Pse, do të më pyni ju mes këtyre rreshtave?! Nuk e di. Vështirë ndonjëherë njeriu i beson realitetit. E do rrenën. Jeta, siç duket e ka fajin. Vetvetiu, na mashtron rrugës, hedh dorë më dorë pasmesnate. Ditën e nesërme na ka dalë gjumi, po shumë vonë në mesditë. Dielli më ka lind mbi Çelvjollcë. Tekefundit, ndoshta edhe jemi mësuar me rrenën. Ose, ku ta dimë ne se, e vërteta është më e mirë se rrena?! Nëse është kështu, atëherë pse e duam rrenën?!

Thotë: kam qenë në Tiranë, në Panairin e librit. E kam pasur përrurimin e librit tim të shekullit. Dhe, për çudi gazetarët e Shqipërisë ishin “arabizaur”. Nuk morën pjesë në përrurimin e librit tim, përveçse dy - tre shkrimtarë. E rëndësishme, them unë: është, mori pjesë Doktorziu, promotori yt si shkrimtar Oborri. Punemadhe, nëse nuk kanë marrë pjesë shkrimtarët e Shqipërisë. Pse brengosesh ti aq shumë si “shkrimtar i madh” për këtë punë, apo të vret ndërgjegja se, je apo nuk je shkrimtar i madh. Edhe kjo nuk prish punë, kritiku më i “madh” mbarëshqiptar, DoktorZiu ka thënë se, ti je shkrimtar i madh. Dhe, Mëmëdheu, Shqipëria sipas “kritikut” ka vetëm një shkrimtar: Patriotin e Vonuar Melez. Edhe ne, sipas fjalëve të tij që i thotë nëpër përrurime, i shkruan në gazeta dhe

libra, të besojmë se je “shkrimtar i madh”. Punë tjetër është ajo, se ai shkruan kritika të porositura për librat e tu sakatë, e ti shkruan libra teknefes për të se, si “... *ecën njeriu*” patriot në jetë.

Vetëm, një gjë nuk ju falet: rreni. Edhe ti si shkrimtar, edhe ai si kritik letrar. E kuptoj rrenën e shkrimtarit në letërsi për të shkruar ndonjë libër. Fantazinë e bujshme për t’i zbukuruar personazhet mes atyre faqeve. Hajmalinë e Hoxhës për qafe. Thirrjet, drejtuar Zotit në minare. Po, kurrësesi nuk mundem ta kuptoj rrenën e kritikut latrar, publicistit, kështu siç ke dëshirë ta heqish veten ti nëpër udhëpërshkrimet e tua teknefese nëpër Shqipëri. Lexuesi, ndoshta edhe mund të të besoj si gazetar melez, që nuk e njeh mirë Shqipërinë. Vetëm, unë jo si shkrimtar. Shkaku: mos e teproj mes këtyre rreshtave, unë jam në Shqipëri gati për çdo muaj nëpër manifestime të ndryshme kulturore. Nuk është ashtu siç e përshkruan ti Shqipërinë, rrugët plot gropa. Fatkeqsisht për ty, vitet e fundit rrugët i kanë edhe më të mira se ne, në IRJ të Maqedonisë. Pse e bën ti këtë trumbetim tellalli, është punë e jotja si shkrimtar i Obrorrit. E dimë historinë tënde “patriotike”, prandaj së paku mos pjellë viça të palëpi! Edhe, nëse je i paguar një torbë taxhi, përsëri edhe kjo është punë e jotja si rrogëtar besnik i punëdhënësit në Vetëshërbimin e “vëllazërim-bashkimit”.

Punemadhe. Paska qenë alamet shkrimtari në Shqipëri! Edhe atë, në Panairin e librit: Tirana 2009. Dhe, e ka bërë përurimin e librit të tij një shtëpi botuese me renome neokomuniste.

Fotografinë tënde të bukur, në përmasa të mëdha e ka vënë në ballë. Pavetëdije, e ka fshehur librin tënd të “gjeniut” mes librave tjerë kokë më kokë. E kush është kyfarë alamet shkrimtari, për të cilin nuk kemi dëgjuar ne, pyet lexuesi shqiptar?! Askushi. Përgjigjem, unë autori i këtij shkrimi. Shkrimtari, që deri dje nuk e dinte edhe gjuhën shqipe. Tashti ka filluar ta flas e shkruaj me çalime, po jo aq sa edhe të shkruaj libra të arrirë artistikisht. Shkaku: se, gjuha është arma kryesore e shkrimtarit. Hidhni një sy gjuhës së tij plot arna, sintaksës së tij gjoja në gjuhën shqipe. Nuk e kuptoni, ë?! Ose, u janë çërruar sytë, u janë shurdhuar veshët.

E shkruan se ke takur rrugës tek udhëkryqi, edhe një lypës pa një këmbë. Përsëri vështirë e kam të të besoj si shkrimtar, që në Shqipëri jam gati çdo muaj. Fatmirësisht, vitet e fundi në Shqipëri nuk shoh edhe lypës. Pse nuk shkruan ti për lypësit e Shkupit, te Ura e Gurit, që përditë u vënë pusi kalimatrëve si “lypësa” e ua zbrazin xhepat si hajna?! Ky është problem i yti si publicist, që gati për çdo ditë kalon te Ura e Gurit, matanë Vardarit, e një herë në vit, edhe atë në Panir të librit shkon në Tiranë. Ë? Përmëkeq, edhe atë, si mysliman “ehamdurila” që i falë të pesë vaktet në xhami para këmbëve të Hoxhës?! Nuk të duket pak e çuditshme?! Qesharake?!

Prandaj, zoti shkrimtar i KritikZiut, përpara se ta pastrosh oborrin e komshisë, pastroje oborrin tënd nga bërlloku... Nuk e them këtë unë, e thotë: Populli...



B -ja E MADHE E SHTYPIT

PARA TRURIT

Nuk e luan as topi i qershisë. E kam thënë: shqiptarët kanë problem me vetëveten. Përderisa, nuk pastrojnë me vetëveten, kurrë nuk do të mund t'i pastrojnë "hesapet" edhe me armikun shekullor nën të njëjtën çati.

Vetëm i hidhni një sy punës së shqiptarëve! Edhe atë: nëpër shekuj! Gabimet po na përsëriten herë pas here me vite. E dini pse?! Jo, nuk e dini. Them: shqiptarëve nuk duhet t'u pri B -ja e madhe e shtypit, po truri. Provojeni një herë në jetë të ju pri edhe truri! Dhe, do të shihni se shumë gjëra do të ndryshojnë brenda një nate.

Një popull për të arrirë te qëllimet e tia shekullore, i duhen tre faktorë! E përsëris në këtë libër. Nën një: në ballë njerëz të ditur. Nën dy: njerëz të pasur. Dhe, nën tre: populli. E, a i ka populli shqiptar këta tre faktorë?! Jo, nuk i ka. Njerëzit e ditur nuk i ka në ballë. Edhe faktorin e dytë, njerëzit me para nuk i ka në çetë. E ka vetëm faktorin e tretë: popullin. Mjerim kombëtar! Nuk e di se si mund të arrijnë shqiptarët te qëllimi shekullor, vetëm me faktorin e tretë: popullin. Kurrë! E them këtë se, shqiptarët gjithmonë e kanë pasur popullin me vete edhe atë: mbi nivelin e partive politike. Shqiptarët, e kanë pasur popullin në ballë nëpër shekuj për liri. Momentalisht, këtij populli i mungon faktori i parë dhe i dytë. E, nëse ky popull një ditë arrin t'i ketë edhe këta dy faktorë me vete për qëllimet e tia, kurrë nuk do të ketë

probleme kaq të ngatërruara për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan.

E tmerrshme, ë?! Lokalin ku ti e kalon ditën edhe natën. E ke shkruar me gjak dhe shpirt poezinë. E ke pritur Miken. Bërlloku shqipar me ndihmën e “vëllezërve” e ka pushtuar brenda një nate. Edhe atë: ai që i ndërron përditë partitë politike shqiptare. Kalbet me vite në Qeveri. Edhe në krye të shtetit, si përfaqësues i shqiptarëve.

Publikisht, përpara kamerave i shet “flijimet e tia patriotike” në Çarshi. E di ti, po nuk e di populli. Edhe atë: pasi fotoqafohet në një lokal përpara një firme, ku në ballë i shkruan kirilicë. Aty për aty, kur e sheh në këtë “derexhe” të villet. Po, çka ke ti të vjellësh?! Në bark nuk ke asgjë. I ke vjellë edhe zorrët. Përmëkeq, do edhe të ikë me të katra: mendon se nuk e ka parë askushi, njeri i gjallë. Të vdekurit e kanë parë, po ky “burrë mejdani” nuk trembet nga të vdekurit që bëjnë gjumë të rëndë mes varreve. Shkupi e di këtë bërllok shqiptar, po ja, ia ha mendja se mund të ikë pa e parë ti, pena yte rebele nën Rrap.

O Imzot! Bërlloku që do t’i pri në ballë popullit shqiptar, a mund ende të fotoqafohet me deklarata si analist politik para kamerave televizive?! Jo. Bërlloku nuk duhet kurrësesi t’i pri këtij populli në ballë! Atëherë?! E kam një ftesë për përrurërimin e një libri të shokut tim të penës, i them: Falemnderit. E kam vendosur të mos shkoj më pas gomarit. E di edhe pse: pesëdhjetë vjetë i kam dëgjuar me të njëjtat deklarta, mendime shterpë, veprime “artistike”. Nuk mundem më t’i dëgjoj me orë të tëra të mi

shkerdhejnë trutë. Mundësisht, ma gjeni një ujk,
tigër, ose luan mali!

O burra shqipëtarë, përpiquni t'i keni këto
tre faktorë për realizimin e qëllimit shekullor
kombëtarë nëpër shekuj:

Përderisa, B-ja e madhe e shtypit i pri Trurit
në luftë me shpatën e Skënderbeut!...



IV RRUFËJA NUK SHTI NË FERRA

PAZARI GRAVE

Mëngjes. E ngarkova veten në shpinë përmes sokaqeve me gurë deri te Rrapi. Në një degë të tij sot kisha vendosur t'i varë armët. Nën hijen e tij do ta lidhja Gjokun. E dija se më pret një luftë e përgjakshme mes këtij bërlloku, që dita – ditës ma zente frymën. Vetëm, nuk e di pse ende nuk vinte Mikja të më jap gji nga ato dy shtamba. Me siguri do të ma kthente fuqinë si Mujit e Halilit, që shtatë ditë e shtatë netë të mos i zbres Gjokut nga shpina. Shpatën ta ngrej lartë në dorë për liri, rrotulloj në ajër. Shtatë ditë e shtatë netë të pi verë me shtamba. Shtatë ditë e shtatë netë t'i shterë herdhet në këtë Shtëpi Publike. Shtatë ditë e shtatë netë ta vazhdoj luftën me penë nën Rrap...

*Deven kur e kanë pyetur
kur e ke pasur më së vështiri
në jetë?
Është përgjigjur:
kur më ka pri gomari.*

*E mua po të më pyesni
në këtë Shtëpi Publike
do t'ju përgjigjem:
kur më pri Trusakati
dhe Maxhupi me dajre
t'i dalim zot Atdheut
me çifteli e poezi patetike...*

Hi-hi-hiii... E kanë lidhur për Rrapi... Miken ia kanë përzënë në Lindje... Ferexhen ia kanë hudhur mbi kokë mbi varrin e Baba Shehut... Natë e ditë kanë lenur lesh Arapi... E kanë vendosur, nën Rrap ta mbysin me verë...

- Heu Dashnor Delia, pse fol kështu me vetveten?!

- Hi-hii-hiii... Më mirë të flas me vetveten se sa me Rrospitë Meshkuj. E kam frikë Nusen me pashterkë të kuqe... Frikë... Frikë... Nuk e di ti, sa është ajo e rrezikshme në shtrat... Gjithë natën e gjatë kur të dhunon mbi çati... Majë lisave...

- Dashnor Delia, ngreja bythët në hava!...

- Hi - hi - hiii. E kam bërë moti planin. Vetëm, frikë kam se, ajo e para do t`mi ngrejë mua bythën në ndonjë livadh...

- Dashnor Delia, nuk e besoj, ti di t`a përdorish trurin... Armën...

- Hi-hi-hiii... E di. Vetëm, atë shtrigë nuk e zë plumbi...

- O Dashnor Delia, në mos e zëntë plumbi, do ta zë gjylja e topit...

- Hi-hi-hiii... E ke lehtë ti të flasësh ashtu, pasi ende nuk të ka shti në dorë... E kur të të shti në dorë, atëherë flasim si burrat... Po, t`i lëmë këto marrëzira, a do të ma qesish një kafe?

- Jo, Dashnor Delia pa ia ngritur bythët Nuses me pashterkë të kuqe në hava...

- E kam ditur moti. Mirë ta bënë Trusakati... Maxhupi me dajre... Nusja me pashterkë të kuqe mbi çatia...

- Dashnor Delia, ia qëlllove me një plumb...
Tashti e meriton një kafe... Porosite!...

- Jo, nuk dua kafe nga ti, he burrë...

- Dashnor Delia, pije një kafe!...

- Jo, kafe ti pi me armiqtë, që gjithë ditën e gjithë natën bëjnë plane si të të vrasin, të të bëjnë atentat... Helmojnë... E di se, për ta e kam shkruar edhe një poezi...

- Jo, Dashnor Delia. Gjithëçka kam ditur për ty, o trim mbi trima, po jo edhe se shkruan poezi!

- Eh, zoti shkrimtar, këtu është gabimi... Hataja... Ti mendon se, vetëm ti di t'i shkruash Mikes poezi... E nuk e çanë kokën për poezitë e mia rebele, që i shkruaj rrugëve të Bit-Pazarit...

- Vërtetë, ke të drejtë Dashnor Delia. Po, lexoma njerën!... Edhe ashtu moti nuk kam lexuar ndonjë vlerë të arrirë artistike...

- Vetëm me një kusht. Që të mos i tregosh askujt, njeriu të gjallë se, po mori vesh Nusja me pashterkë të kuqe do të më shkep dajak gjithë natën mbi çati...

- Jo, or Dashnor Delia. Jo. Lexoje poezinë!...

- Atëherë, hapi mirë veshët edhe sytë... Poezia është antologjike. Ndodhë Kritik Ziu ta përfshijë në antologjinë e ardhshme të Pazarit të Grave...

*Gjithë ditën - natën
bëjnë plane për atentat
me porosi të Kurvës Parti.
E shajnë e vrasin
nëpër çajtove e redaksi
herë si patriot herë si tradhëtar.*

*Të nesërmen nën Rrap
me te hanë e pinë.
Vallë, athua hoqën dorë
apo nuk kanë armë...*

- Hi-hi-hiii... A të pëlqeu vjersha?

- Nuk e di, Dashnor Delia... Nuk e di...
Vendin në letërsi do t'ia caktojë Kritik Ziu.
Ndodhë me këtë poezi patriotike të hysh edhe në
projektin e Qeverisë: "Makedonska knizhevnost".

- E kam ditur se, nuk merr vesh nga
vjershat. E sa i përket Kritik Ziut, ai duhet t'i ketë
herdhet na, si vorba deri në fund të këmbëve në
përpilimin e antologjisë. Fatkeqësisht, herdhet e
tij janë sa të gjelit... E kupton tashti, ku qëndron
arti... Vlerat e arrira artistike... Ja, edhe arsyeja
pse gjithëmonë t'i kanë ndërsyer Tun Batunët...
Këlyshët me zgjebe... Buçat e Katundit...

- Hi-hii-hiii... Jo, i kupton vlerat artistike
Maxhupi me dajre. Fakiri me Arushën e tij asht e
lëkurë për dore, që vinte në Katund të na shesë
vlera artistike. E ne si fëmijë, turr te porta, ta
fusim në lëmë me gjithë partalla.

Maxhupi i biente dajres. Dhe, Arusha
kërcente, hiqte valle në mes të Lëmës. Ne u
bienim duarve shuplakë, kënaqeshim me vallen e
Arushës. Maxhupi me dajre i përdridhte bythët.
Në fund, na e shtrinte dajren para nesh, t'ia
paguajmë artin. Dhe, ne ia mbushnim dajren me
para metalike.

Maxhupi me dajre e merrte Arushën për
dore, dilte në rrugë. Ecte duke i rënë dajres me

Arushë për dore. Dhe, hynte në tjetër lëmë. E shiste artin e tij me para.


E kujtova këtë ngjarje të fëmijërisë, shkaku se: sot nuk e kemi këtë Maxhup me dajre me Arushën e tij për dore nëpër Katund. Po, e kemi sojin e Maxhupit, që edhe ky përpiqet të shesë art, vlera artistike. E shtri dajren e arnuar përpara spektatorëve, po fëmijët e soçëm nuk i josh më arti i tij, nuk ia mbushin dajren me para. Koha e soçme e ka maxhupin e vet modern, jo me dajre, po me trumbeta. Edhe Arushën nazemadhe, që na e heq vallen si dikur në mes të Sheshit. Për dallim nga ai Maxhupi i djeshëm me dajre, ky Maxhupi i soçëm me trumbeta shkruan edhe vjersha sakatike në prehërin e partive politike...

Hi-Hii-hiii...



MEHMEDALI HOXHA LARGPAMËS DHE BURRË I PENËS

E kam thënë disa herë nëpër takime letrare, tribuna të ndryshme kulturore: Kosova siç e kishte pas Luftës së Dytë Botërore Esad Mekulin, Maqedonia e ka pasur Mehmedali Hoxhën. Tashti e them edhe publikisht në mjetet e informacionit: Mehmedali Hoxha ishte largpamës dhe burrë i besës, fjalës dhe penës. E gjithë kultura dhe letërsia shqiptare në Maqedoni, pothuajse u zhvillua nën përkujdesjen e tij dhe nëpër duart e këtij burri patriot.



MEHMEDALI HOXHA
WWW.ZEMRASHQIPTARE.NET

Mehmedali Hoxha (1924 – 1991) lindi në fshatin Ladolishtë të Strugës dhe ndërroi jetë në Shkup. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Shkup.

Në fillim ka punuar mësues, pastaj në redaksinë “Flaka e vëllazërimit” gazetar dhe radaktor. Nga viti 1953, kur për herë të parë doli ravista për fëmijë “Fatosi”, Mehmedali Hoxhën e gjejmë kryeredaktor të saj derisa u pensionua. Është ndër autorët e parë që u paraqit para lexuesve me libër vjershash për fëmijë.

Vetëm hidhni një sy veprimtarisë të tij letrare: libri i parë për fëmijë “*Vjersha*” (1952) së bashku me Lutfi Rusin, kryeradaktor i “*Detska Radost*”, themelues dhe baba i Gëzimit dhe

Fatosit (revista për fëmijë), autor i disa librave për fëmijë: *Te kroni* (1960), *Kur fryn era* (1962), *Atje mbi kodrinë* (1974), *Ditët tona* (1979), *Këngë shkollore* (1984) *Kur linda* (1971), *Në sytë e Majit* (1973), *Vashëzat shkollore* (1976), *Qepallat e verës* (1985) *Ma thuaj emrin* (1989), (përzgjedhje, Prishtinë), *Një brez livadh* (1990) (përzgjedhje, Tiranë) etj. Mësues i shumë krijesve të rinj që sot janë emra të dëshmuar në letërsinë shqipe: Abdylazis, Islami, Vahit Nasufi, Kalosh Çeliku, Fadil Bektashi, Ramadan Zejneli etj. Dhe, e dini si përfundoi ky burrë i kulturës dhe letërsisë shqiptare në Maqedoni në kohën e soçme, me heshtje - harresë. Kulturofagët për të nuk e thanë asnjë fjalë nëpër tryeza të rrumbullakta që i organizojnë përditë për t'i fotografuar fytyrat e tyre të policisë letrare.

E them këtë se, më ka ardhë te hundët me këta zhurmaxhi të arsimit dhe kulturës shqiptare. Organizimi i tyre me veshje partiake fundekrye, në dëm të arsimit dhe kulturës shqiptare, i ngushtojnë radhët e tyre me gjysmanalfabetë duke organizuar me direktiva partiake aktivitete arsimore e kluturore, përrurime të librave, tekste shkollore, antologji poetike, akademi përkujtimore... E ngrejnë zërin, protestojnë, reagojnë në mjetet e informacionit se, të tjerët “vëllezërit” ua sakatojnë arsimin dhe kulturën shqiptare. E në realitet mu këta kulturofagë janë kasapët më të rrezikshëm me thika në dorë pas shpine, që i sulen arsimit dhe kulturës shqiptare.

Kokën, vetëm ktheni pas, dhe hidhnu një sy “veprave të tyre patriotike”: emrat e kujt

qëndrojnë pas planprogrameve shkollore, teksteve shkollore, abetareve, lektyrave shkollore, revistave për fëmijë, Enciklopedive maqedonase, Letërsisë maqedonase, antologjive të pastra e të përlyera... Shitjes së diplomave universitare, titujve shkencor, komisioneve arsimor e kulturor, përrurimin e librave të tyre sakatë me direktiva partiake e para të Qeverisë...

Dhe, dërdëllisin këta “doktorë” shkence nëpër tryeza të rrumbullakta, fotografohen para kamerave pa fije turpi, po nuk thonë asgjë për problemet e vërteta që i ka arsimit dhe kultura shqiptare në Maqedoni. Bërlloku shqiptar përgjumshëm na i emron sipas propozimeve partiake me emra familjarë, klanorë, miqësor, policor edhe emrat e rrugëve, shkollave, përmendoreve që duhet të rrinë ballëllartë në sheshin e Shkupit, rrëzë Kalasë.

O Imzot! Vërtetë nuk dinë, apo ishin informatorët e këtyre personaliteteve në kohën e komunizmit, që edhe sot i kanë frikë t’ua përmendin edhe emrat, mos u çohen nga varret dhe me dy - tri shpulla t’i përzënë haramët në shtëpi. Megjithatë, siç duket do të jetë kjo e fundit: policët letrar, mullinxhinjt, çobanët, loparët dhe kurvarët me diplomat e blera universitare, janë armiqtë kryesorë të arsimit dhe kulturës shqiptare.

Po, deri kur do t’i lëmë të sheshin “mend” për çështjen shqiptare këta gjysmanalfabetë?!... E kujtoj portretin e këtij burri, Mehmedali Hoxhës gjatë takimeve në redaksi. Takimeve letrare.

Vizitave miqësore. Vërtetë, ishte i madh si poet dhe njeri i fjalës dhe besës.

Vite më vonë, do të shoh se, unë do të ndiqem këmba – këmbës edhe shkaku i tij, që vetëm e vetëm pse e kisha patur mik dhe mësues të penës. Shkaku: takimeve të shpeshta në redaksi edhe pse me karakter pune. Bisedave letrare në Tavernë. Iku me një dëshirë të paplotësuar që: edhe pse u përpoq me mish e shpirt, nuk arriti të ma lë trashëgim revistën për fëmijë që e udhëhiqte: *Fatosin*.

Vonë, shumë vonë do ta kuptoj edhe se sa i “rrezikshëm” kishte qenë për pushtetin e atëhershëm komunist, Shtetin. E kishin rrasë edhe në burg si kryeredaktor i “Detska radost” se, pas Luftës nuk mund të pajtoheshin sllavomaqedonsit që Shtëpinë më të madhe botuese maqedonase për fëmijë t’ua udhëheqi një shqiptar, edhe atë nacionalist. Akuza: duke pi konjak Skënderbeu dhe shikuar nëpër dritare në prezencë të disa shkrimtarëve shqiptar e sllavomaqedonas kishte thënë: do të vij koha, kur ju sllavomaqedonasi do t’i fshini rrugët e Tiranës.

Dhe, vallë nuk e shihni se erdhi ajo kohë. Maqedonasi i kalojnë pushimet në Shqipëri. Një numër i madh kërkojnë edhe vende pune. Përpiqen ta mësojnë gjuhën shqipe. Ndonjëri kthehet edhe te rrënja e baballarëve. Çka presin kulturofagët, informatorët e djeshëm komunistë dhe të soçëm “demokratë”?!

Rëndësinë e këtij vizioneri dhe burri të penës do ta kujtoj më vonë: kur Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar, në vitin 1998 organizoi një Akademi

përkujtimore për këtë poet për fëmijë në vendlindje. E dini se, përderisa u organizua ajo Akademi përkujtimore, kam hequr siç thotë populli të zitë e ullirit. E sabotonin nga të gjitha anët, na venin ndërkëmba që të mos mbahet Akademia përkujtimore për Mehmedali Hoxhën. Dhe, në fund e dini si përfunduam ne miqtë e poetit, që kishim ardhë në Strugë nga të gjitha anët e Atdheut, na helmuan të gjithëve me ushqim në restorant.

Edhe sot dalin revista për fëmijë. Përçudi, mbi dhjetë revista për fëmijë edhe atë vetëm në një qytet, Tetovë. Vetëm, fatkeqësisht hidhnu një sy: janë nën nivelin e revistave për fëmijë *Fatosi* dhe *Gëzimi* që i udhëhiqte ky burrë i penës në atë kohë të cenzurës.

Patjetër, jam i detyruar në këtë shkrim përkujtimor për Mehmedali Hoxhën ta përmendi edhe një rast: kur posa isha kthyer nga Kosova në Shkup, dhe isha i caktuar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Maqedonisë bashkë me një shkrimtar maqedonas, që të marr pjesë në Mitingun e Poezisë, në Gjakovë. Ende ishin vitet e para nëntëdhjetës, kohës së komunizmit. Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës ishte Ibrahim Rugova. Gjatë gjithë manifestimit, ky maqedonasi nuk mu nda nga shoqërimi. E më pyeste herë pas here se, a është larg nga këtu kufiri me Shqipërinë. E unë si student i Prishtinës që kisha qenë dhe kisha studjuar e punuar rreth dhjetë vjet në Prishtinë, pothuajse i njihja të gjithë shkrimtarët e Kosovës. Edhe kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugovën.

Në një rast, kryetari Rugova na siguroi edhe makinë për “mikun” dhe mua që të shkojmë në Deçan për fli. “Miku” u befasua me gjestin dhe sjelljen e Rugovës në mikpritje. Herë pas here më thoshte: si është e mundur, kur kishte dëgjuar e lexuar shumë reagime të ashpra të Rugovës në atë kohë me shkrimtarët serb.

Ditë më vonë, pasi u kthyem në Shkup, unë do të mësoj nga vetë poeti Mehmedali Hoxha një të vërtetë të hidhur: në Mitingun e poezisë në Gjakovë, unë kisha marrë pjesë me një poet maqedonas, që kishte qenë në gjyq dëshmitar i Mehmedali Hoxhës.

E tmerrshme, deri ku arrinte ai aparat burokratik policor! Edhe sot, po i njëjti aparat burokratik policor vepron dhe informon si dikur në kohën e komunizmit me këlyshët me zgjebe që na ndërsehen pas shpine...

POETI NUK KA NEVOJË PËR HORRA E MORRA KOMUNISTË

(Frederik Rreshpja - Mbret i poezisë)

E kam njohur që nga vitet e studimeve në Prishtinë, libri i tij me poezi: *Enise, Enise* (1975), botuar në atë kohë nga Ndërmarrja gazetare, botuese e grafike “*Rilindja*”, në Prishtinë, i cili



Frederik Rreshpja (1940 - 2006)

në atë kohë qarkullonte dorë më dorë. Mall e kishim, atëherë të kemi një libër të tillë aq të arrirë artistikisht nëpër duar, e sidomos të një autori nga Shqipëria. Kufijt politik e bënë të veten, po edhe ndalesa e atyre autorëve matanë kufirit. Rrezik ishte në atë kohë të të gjenin në dorë ose shtëpi ndonjë libër nga Shqipëria. E nëse ta gjenin, të nesërmen i haje kotnasikoti pesë vjet burg mes katër mureve.

Megjithatë, në atë kohë nuk e di pse më duket mua se, më së shumti lexonim libra. Shkaku, që ishin të ndaluar, apo nuk kishim aq shumë libra si sot, në çdo librari, në çdo panair të librit. Sidoqoftë, librin në atë kohë e gëlltisnim brenda një nate me një frymë. Edhe tashti e gëlltisim, po pak si rrallë dhe me vështirësi. Shpeshherë na mbetet në fyt. Siç duket, ndoshta

fajin e ka edhe politika ditore e partive tona politike. Personazhet e saj trusakatë, që nuk na lënë të marrim pak veten, hidhemi si dikur, i madhë e i vogël në përfaqim të librit.

Vite më vonë, Frederik Rreshpja erdhi edhe në Shkup. Ishin vitet e '90 -ta, pas ndryshimeve demokratike. Momente, kur unë nuk kam ndodhur në Shkup dhe jemi dëgjuar me anë të telefonit. Megjithatë, të nesërmen jemi takuar në Teatrin e Kombësive, në Shkup. Të kuptohemi, ishin vitet e '90 -ta, shqiptarët e Shqipërisë kur vinin të takohen me shqiptarët e kësaj ane (pjesën tjetër të Atdheut) dhe nuk kishin mundësi të paguajnë as edhe një kafe.

Frederiku, më kujtohet si sot, në atë kohë erdhi me makinë luksoze dhe shofer të vetin, një shoqëruesje poete dhe “djemt” e tij... Ashtu siç i kishte hije të vij në Shkup një poet i madh shqiptar. Përmëtepër, edhe me këmbëngulejn time, nuk më lejoi t'i paguaj drekë, as edhe një kafe miku.

Ditë më vonë, erdhi radha që unë të shkoj në Shqipëri, ta kërkoj Frederik Rreshpjen, në Tiranë. Dhe, e vizitova në shtëpi, shtypshshkronjën e tij, “*Evropa*”. Vetëm se, e kisha shumë vështirë të hyj në oborr, më lehtë e kisha të hyj në atë kohë te presidenti shtetit Sali Berisha, se sa te Frederik Rreshpja. Me megafon në derë e roje. U paraqita në megafon: Kalosh Çeliku. I urdhëroi rojet që të ma hapin derën. Dhe, ata para, unë pas tyre, më shpien në dhomë ku ishte Frederik Rreshpja pranë një arke të hekurt, në mes të gërmadhës së lekëve.

Poet rrebel, përtej kufiri. Ashtu siç e njihnin të gjithë krijuesit shqiptar. Kurrë në jetën time nuk kisha parë poet - mbret. Dhe, u gëzova që pash një të tillë në Shqipëri. Në atë moment ma dha edhe librin e tij me poezi të zgjedhuara, që e kishte botuar në shtypshkronjën e vet dhe që posa kishte dalë nga shtypi. Ende ishte i nxehtë, i dilte avull. Shkaku se: ende nuk e kishte shkruar në kopertinë emrin dhe mbiemrin e tij dhe titullin: *Lirika të zgjedhura*. Librin me poezi të zgjedhura ende e ruaj me xhelozë në bibliotekë. Edhe pse më vonë po atë libër do ta blej për vete e miqtë e mij në çdo panair të librit. Dikur, pas diskutimeve të ashpra për letërsinë, e thirri shoferin. Dhe, ikëm për drekë mbretërore në një restorant luksoz, pranë liqenit në periferi të qytetit. Fredrik Rreshpja mbi të gjitha ishte Mbret i poezisë.

Panairët e librit, vazhdojnë të mbahen në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Tetovë, Ulqin... Imzot, të duken si panairë libri të vendeve arabe, nuk e kanë të veshur petkun shqiptar. I ngjajnë gati për çdo vit si veja – vesë, njëri - tjetrit pazar të zarzavateve plot zhurmë e piskamë. Vetëmse, nuk dallojnë nga njëri - tjetri me risi kulturore. I organizojnë e i hapin individë të harxhuar që në kohën e komunizmit. Po, do të thuash ti: edhe organizatorët janë pjellë komuniste e asaj kohe. Në rregull, vetëm le t'u veshin pananireve të librit një petk tjetër kulturor, shqiptar. Nëse nuk dinë, le t'i vizitojnë dhe shohin panairët botëror të librit. Panairë libri, ku dyndet i gjithë shteti për një javë sa zgjatë panairi i librit. Bota. Ngjarje të vërteteta kulturore, të zhveshura plotësisht nga

politika e partive politike në pushtet, propaganda e feve. Mjaftë më e kanë mendjen vetëm te paratë, si t'i plaçkisin botuesit, lexuesit, shkrimtarët. E në anën tjetër shumë pak u afrojnë vlera të arrira artistike si konsumatorë të librit. Thashë: Panairët tona të librit janë si pazare të zarzavateve. Reklama të politikanëve. Shkrimtarëve të Oborrit. Partizanëve të partive politike. Hoxhallarëve...

Dhe, seç ma kujtuat një thënie të Frederik Rreshpjes të para disa viteve në Panairin e librit në Tiranë, kur tha i dëshpruar pasi e vizitoi panirin e librit në një gazetë: “përpara Pallatit të Kongreseve do ta vras veten...” Fredrik Rreshpja, një ditë iku edhe pa bukën e gojës. E dini pse?! Jo nuk e dini. Ja, po jua përkujtoj unë poezinë “**Partishmëria**” me vargjet e poetit:

*Nëpër portat e partive rrinë komunistët e
djeshëm,*

Më mësojnë mua kush është Marksi.

Nëpër emblemat aty – këtu,

Bronxi i thyer i Enverit shfaqet.

Komunistët e djeshëm me tituj

Të fituar në luftën e klasave

Më mësojnë mua ç’do të thotë disidencë,

Më mësojnë mua ç’janë prangat.

Komunistët e djeshëm, telefonat e djeshëm.

Veturat e djeshme lyer me bojë.

Kaloj para portave të partive i menduar,

Me bukën e ditës në dorë.

Matrapazët, që ende duan të rrasin barkun e jo trurin me librat e poetit, nuk e di unë çka janë: ish policë, ish oficerë ushtarakë, tregëtarë, hoxhallarë... Që, edhe sot duan të pasurohen në emër të poetit. Shkrimtarëve. Lexuesve. Që, gjithë jetën kanë qenë barrë e popullit. Po, kush kanë qenë dhe janë këta trusakatë?! Organizojnë panairë të librit sa për sy e faqe, plaçkisin popullin. I vjedhin shkrimtarët. Dhe, kanë arrirë që nëpërmes të artit dhe kulturës t'u shkojnë përmbropa komunistë të arratisur në këtë punë hajdutësh, t'ua hapin dyert e panairëve.

Manifestimet kulturore tradicionale, e dini ju, mbetën në mëshirën e trusakatëve: bozaxhinjëve, hoxhallarëve, baktaçinjëve, siç do të thotshte Noli i mdh, ose Ali Asllani: *hani, pini dhe rrëmbeni!*...

E ku mbetën krijuesit? Poetët, që në manifestimet e tyre kulturore nuk mund të shesin as stenda për panairë të librit e as buleta për koncerte?! Nuk rrëmbejnë para me të dyja duart si pjella komuniste. Edhe pse, është koha të pushojnë me këto veprime antikulturore, nisin një ditë të re, ta duan artin, poezinë. Përkundër, një ditë do të jemi të detyruar t'i godasim horrat e horrave me poezi e libra në kokë...

E ju, mburreni nëpër gazeta e para kamerave televizive se, Kritikziut i keni paguar honorare e shtruar dreka e darka me mijëra euro. Punemadhe. KritikZiu, nuk ka nevojë për ato dreka e honorare marramendëse. Në shtëpinë e tij hyjnë të ardhura mujore rreth njëzet mijë euro: nga pensionet e dy-tre shteteve, tre akademitë

shkencore, universitetet e Shtetit dhe privat, komisionet e ndryshme partiake e kulturore... E kurrë deri më sot, nuk e dha për kulturën shqiptare as edhe një kafe. Vetëmse, atëherë nuk i keni dalë zot Frederik Rreshpjes. I dilni sot, për karrierë politike - letrare. Ende t'i shisni librat e tij nëpër panairë të librit, të cilët poeti i botoi me lekët e vetë për së gjalli, ndau edhe nga kafshata e gojës. Thasët e xhepat t'i mbushni me lekë, edhe sot kur poeti më shkak u juaj nuk bën gjumë të rehatshëm as edhe në varr, zhurmës suaj të madhe demagogjike për librin.

Përfundimi: Thyeni qafën bythekrye në kontejnerët e bërllokut të historisë!... Poeti më nuk ka nevojë për horra... E morra komunistë... Lekët e juaj të përlyer me gjak...



Shpirti i burrit vdes
dhe ringjallet.
dashuron dhe
urren, bën atë që
duhet, çmendet pas
të paekzistueshmes
dhe... jeton.



PROTESTË TE PAZARI GRAVE

(Mikut tim, Fadil Bekteshit)

*Miku im, të vdiqën të Ri
para kohe se linde Poet
të çmendën me Dashuri
pse e ngrite nga varret Doruntinën
e shkrove „Filxhanin e dashurisë“
për ta shpënë në vend amanetin
e Vëllit të vogël në LUMELOT.*

*Miku im të vdiqën të Ri
Rrospitë Meshkuj në Shtëpinë Publike
që shkërdhehen si qentë te Pazari Grave
për një karrierë të sëmurë politike
e i shkruajnë Qeverisë letra dashurie
në rolin e Patriotit Melez
në kurriz të viktimave të Idrizovës
e dëshmorëve të Atdheut në Drenicë.*

*O Imzot, më pështyhet, më villet
kur i shoh si e tërheqin veten zvarrë
Rrospitë Meshkuj. Rrospitë
që gjithë jetën ta hëngrën shpirtin
he, hëngshin veten. AMEN!...*

Fadil Bekteshi lindi më 23 mars 1955 në fshatin Muhoc të komunës Bujanocit në Kosovën Lindore. Familja e tij në vitin 1960 u shpërngul nga ky fshat dhe u vendos në fshatin Llopat të komunës së Kumanovës, në IRJ të Maqedonisë. Mësimet e para



i mori në sh. f. “Jeta e Re” në fshatin Sllupçan, pastaj shkollën fillore e kreu në Llopat dhe Kumanovë, të mesmen në Kumanovë. Ndërsa, Fakultetin filologjik, Dega për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe e kreu në

Fadil Bekteshi (1955 – 1998)

Prishtinë, në vitin 1979. Punoi në Televizionin e Prishtinës në redaksinë për fëmijë, e pastaj në Shkup si lektor në revistat për fëmijë. U përjashtua nga puna, i etiketuar si “armik i shoqërisë”, si pasojë e ndjekjes permanente nga UDB-ja, iu montua procesi gjuqësor në Shkup nga prokurorë gjakpirës ushtarak dhe u dënua me 2,5 vjet burg, të cilin e vuajti në burgun famëkeq të Idrizovës (IRJ e Maqedonisë) në vitet 1984 – 1986.

Hovin më të vrullshëm letrar e publicistik ia ndërpreu më 1981 dora e zgjatur e UDB-së në redaksinë e gazetës “*Flaka e vëllazërimit*”, kur iu botua libri i parë (tregime për fëmijë) “*Baloni*”, por pas një muaji botimi, ende pa dalë nga depoja e kësaj redaksie, edhe libri iu anatemua, u përndoq si vetë autori dhe nuk u lejua të lexohet dhe të vlerësohet nga lexuesit. Më pastaj për nëntë vjet me radhë e kishte të ndaluar me dekret të policisë letrare botimin nëpër revista letrare e gazeta shkrimet e tija letrare – publicistike, kurse për të botuar ndonjë libër të ri, autori as që mund të ëndërronte në atë kohë.

Më 1991 arriti disi të punësohet në redaksinë e gazetës “*Flaka e vëllazërimit*” në Shkup, ku

konkuroi për të ushtruar detyrën e gazetarit në rubrikën e kulturës, porse u hodh, pa dëshirën e tij, në detyrën e punës së lektorit që të neutralizohej me çdo kusht dhe, që të mos mjaftonte kjo, redaksia në fjalë e kushtëzoi me punë “provuese”, për ta suspenduar pas gjashtë muajsh me etiketat më të paskrupullta dhe kriminale si “i rrezikshëm” për kolektivin e redaksisë!... Ndërkaq pas pesë muajsh, u rikthye në punë me rrugë gjuqësore dhe prapë ushtroi detyrën e lektorit në këtë gazetë të përditshme në gjuhën shqipe.


Fadil Bekteshi qe edhe kryeredaktor i revistës “*Doruntina*”, revista e parë letrare e pavarur ndër shqiptarët në IRJ të Maqedonisë. Gjithashtu, ishte edhe kryetar i Klubit të Shkrimtarëve të Kumanovës: “*Jehona e Karadaku*”. Dhe, njëri ndër themeluesit e Manifestimit Kulturor Tradicional: *Takimet e Karadaku*, në Kumanovë. Iku nga mesi ynë papritmas, më 30 maj 1998 në katundin Llopata të komunës së Kumanovës.

Fadil Bekteshi pas vetes la këto vepra letrare: *Baloni* - tregime (1981), *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, *Udhëtim nëpër skëterrë* - reportazhe letrare (1993), *Klubi i Shkrimtarëve*, Kumanovë, *Na ishte njëherë një gjeneral* - publicistikë (1995), *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, *Filxhan i dashurisë* - poezi (1995), *Klubi i Shkrimtarëve*, Kumanovë dhe *Dashni qyqare* - përzgjedhje poetike (2001), *Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar*, Shkup.

Letërsia shqipe edhe sot e kësaj dite e ndjen shprazhtësinë që e la papritmas shkrimtari në luftën me penë. Pena e tij prej kaçaku në fushën e letërsisë sa qe gjallë pa mëshirë i goditi Rrospitë Meshkuj. Librat e tij edhe sot u shtinë frikën dhe tmerrin

kulturofagëve që janë strukur nëpër redaksi,
kabinete e parti politike duke dhënë shpirt. Vargu i
tij fshikulloi dhe goditi për vdekje.

Zëri i kryengritësve e ngriti nga varri...



**ZJARR E FLAKË
MES VARREVE**

**Dhe një ditë ndërrojmë jetë
ne të pavdekshmit**

(*Mikut tim të penës: Shaqir Sadiku*)

*Dhe, ndërrojmë jetë një Ditë - Natë
Ne të pavdekshmit. Rebelët.
Që, me libra në duar iu sulëm Dijes
Lapsa në brez. Në Kërçovë. Gostivar.
Shkup. Dhe, në Prishtinë.*

*Ehu, vëllai im! Që, dikur në Kërçovë
Te “Elita” ma fale për grua amerikanen.
Dhe, më the: merre se ti shkruan libra
Unë e dua më shumë vendlindjen. Vendosa
T’i qëndroj besnik. Heq dorë nga poezia.
Vetë nuk deshe të bëhesh shkrimtar.*

*Dhe, ndërrojmë jetë një Ditë. Natë
Ne të pavdekshmit. Rebelët.
Që, ndezëm zjarre. Dhe, grua patëm Lirinë...*

Shkup, e shtunë 29 mars 2008

Shaqir Sadiku, lindi në vitin 1952 në fshatin Llagje të Kërçovës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Kërçovë e Gostivar (arsyeja e mbylljes politike të paraleleve shqip të



Shaqir SADIKU – SHAQA
(1952 – 2008)

gjimnazit të Kërçovës), ndërsa studimet i ndoqi në Universitetin e Prishtinës. Ishte ndër gjeneratat e para të kërçovarëve që studioi në këtë Universitet. Gjatë kohës përderisa studioi në Prishtinë, si student i degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, punoi edhe në Radiotelevizionin e Prishtinës si gazetar e redaktor i emisionit për Arsim dhe Kulturë. Shokët e tij të studimeve, rrëfejnë se pagën mujore, të cilën e merrte e ndante me ta me arsyetim se paratë ua jepte hua, dhe që ata kurrë nuk ia kthenin, ngase s’kishin se ku i gjenin në atë kohë si studentë. Veproi edhe në kuadër të shoqatës kulturore të studentëve “*Ramiz Sadiku*” në seksionin e dramës. Studentët kërçovarë, të cilët studionin në atë kohë në Prishtinë do të kujtohen se Shaqa, ka marrë pjesë në të gjitha dramat që përgatiste ajo shoqatë kulturore

studentore, ku gjithnjë ka luajtur rolin kryesor. Qysh herët, si gjimnazist, ra në sy të pushtetmbajtësve me referatin e lexuar në sheshin e Gostivarit të titulluar: “*Kush e vrau Sefer Selimin?!*” Zëri i tij kumbues, tmerroi skenaristët kobzi të komiteteve keqbërëse të sistemit sllavokomunist. Ai ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Jusuf Gërvallës, me të cilin në Pallatin e shtypit të “*Rilindjes*” do të botonte ilegalisht “*Lajmëtarin e Lirisë*”. Në redaksinë e Televizionit të Prishtinës ka punuar e përgatitur edhe shumë dokumentarë, me disa prej të cilëve ka marrë edhe çmime prestigjioze.

Në vitin 1981, për rrethana të njohura të asaj kohe, Shaqir Sadiku emigroi në Zvicër. Gjatë kohës të qëndrimit në Zvicër, ka bashkëvepruar me Jusufin, ku merrej me përgatitjen e bashkatdhetarëve dhe bashkimin e tyre në një trup të vetëm veprues për Atdheun. Involvimi i tij i thellë në kronologjinë e ngjarjeve liri-prurëse, si dhe vrasja e vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka më 1982, i dëshpruar dhe i zemëruar, po edhe i ndjekur nga armiqtë, e detyrojnë të braktisë Zvicrën dhe të kthehet ilegalisht në vendlindje. Në vendlindje bashkëpunonte ngushtë me studentët shqiptarë, me personalitetet e përpjekjes shqiptare dhe intelektualët e vjetër, ku hetohet dhe zbulohet nga policia jugosllave dhe burgoset diku në Serbi. Për sa kohë që qëndroi në burg ndaj tij torturuesit kishin përdorur shkopinjtë elektrikë por edhe mjete të tjera më çnjerëzore të dhunës. Figura e tij paraqet enigmën që ngërthente në vete shpirti i tij kryengritës.

Ehu, po kthehem pas me kujtime mbi pesëdhjetë vjet. Vite, kur ne si fëmijë gjatë stinës së verës me vapë laheshim te Lumi Zajazit. Edhe atë, në atë kohë pa brekë. Vetëmse, e kishim një zjarr në gji: Lapsin dhe Librin. Edhe kërcenim në hurdhë bythekrye pa e ditur se: një ditë do të kërcëjmë në zjarr e flakë me gjithë poezi e libra...

Vitet iknin njëri pas tjetrit me vapë e borë. Ne u njohëm më së miri në faqen e fëmijëve të “*Flakës së vëllazërimit*” (Shkup, 1965). Krahu botonim vjersha për fëmijë në atë kohë, qysh si nxënës të shkollës fillore. I prisnim me gërshtëri si vendas vjershat e botuara të njëri - tjetrit në gazetë edhe pse nuk njiheshim miqësisht dhe i ruanim me xhelozë mes fletoreve e librave të këndimit. Zoti e deshi që të njihemi edhe personalisht në vitin e parë të gjimnazit të Kërçovës (1967/68), paralelja e të cilit në gjuhën shqipe u hap me shumë përpjekje e mundime nga veteranët e atëhershëm të arsimit. Edhe, i ndiqnim mësimet krahu për krahu në një bankë. Paralele kjo, e posa hapur në gjuhën shqipe, ku të gjitha lëndët mësimore i kishim në gjuhën maqedonase me përjashtim të gjuhës shqipe. Edhe, ishim të “barabartë” në “vëllazërim – bashkimin” e asaj kohe komuniste, e kishim një lëndë më tepër se nxënësit maqedonë, gjuhën e “huaj” shqipe. Kohë ajo, kur na kositnin si barin në livadh profesorët shovenistë maqedonas.

Miku im i penës, ne me shokë e shoqe që në atë kohë ecnim nëpër zjarr e flakë. Flaka e tij na ndiqte këmba - këmbës si hije, dhe pas një viti papritmas në pabesi na ndau nga bankat

shkollore, i mbylli dyert e gjimnazit: unë ika në Shkup e ti në Gostivar. Megjithatë, nuk e ndalëm luftën me penë. Librat e paktë në gjuhën shqipe në bibliotekën e Kërçovës, që në atë kohë i numronim në gishta. Shumica të përkthyer nga gjuha serbo-kroate. Edhe letra i shkruanim njëri tjetrit plot mall, herë pas here edhe ndonjë poezi “idilike”.

E kryem edhe shkollën e mesme të ndarë, po na bashkonte poezia. Edhe flamuri kombëtar kuqezi, që e vizatonim vetë dhe e fshehnim në mesin e librave. Portreti i Skënderbeut, që ti edhe në atë kohë nuk trembeshe të m’i dërgosh me anë të postës bashkë me letrat në Shkup.

Fati e deshi që ne pas kryerjes së shkollës mesme të bashkohemi përsëri në Prishtinë. Vitet e studimeve. Edhe një vit ndejtëm së bashku në një dhomë, në një banesë. Edhe në këtë anë provokime, ndjekje, përgjime nga kolegët tanë që merrnin bursa për studime të APJ dhe shokut Tito... Ndonjëri, fatkeqësisht edhe i vendlindjes që në atë kohë përpiqeshte t’i bëj bashkë dy vargje sakatë në ndonjë revistë letrare të kohës si “patriot”. Ose, gazetë policore. Vetëmse, kurrë nuk u bë poet. Gjithë jetën për së gjalli mbeti këlysh patetik me zgjebe dhe i paruallave të thata nëpër gazeta dhe fjalimeve “patriotike” teknefese nëpër varre...

Një ditë pas studimeve ikëm edhe nga ky qytet. Shkaku: edhe pse punuam pak vite, unë si mësues i gjuhës dhe letërisë e ti si gazetar në RTP, nuk gjetëm strehim të sigurtë. Partizanët titist edhe këtu na ndiqnin hap pas hapi. Ti u

arratise nëpër botë, e unë u ktheva në vendlindje. Vite më vonë, ne përsëri u takuam edhe në Kërçovë. Përmëkeq, pas daljes nga burgu ti si i “çmendur” e unë gjithë natën i hedhur dorë më dorë nga xhindet majë lisave mbi çatia në Katund.

Eh, miku im poet! E di, edhe vetë ma ke thënë se, të kanë munduar shumë shkakun im në burg: të thuash ndonjë fjalë. Nuk dinin asgjë për mua si shkrimtar. Kolegu ynë “poet”, që në atë kohë na ndiqte këmba – këmbës, pas disa përpjekjesh me provokime policore, nuk ia kishte arritë qëllimit të më rras edhe mua në burg. Përmëtepër, isha dhe mbeta për ta enigmë. Nuk arriti edhe për mua ta marrë shpërblimin e merituar: një torbë taxhi. Ose, siç thoshte im Atë: gjithë jetën mbeta sahat me një akrep: nuk dihet, kur është 12.00 e kur 13.00.

Megjithatë, unë posa u ktheva në dhomën time me libra, kur mora vesh se ke rënë në burgun e Kërçovës, i dogja të gjitha ato letra, poezi patriotike. Frikë kisha mos më bastisin papritmas, të m’i gjejnë në shtëpi si “materiale të rrezikshme” kundër Shtetit. Eh, sot sa më vjen keq për ato “letra të rrezikshme, poezi idilike”!

Vetëm se, ti ishe i madh: nuk e hape gojën, nuk më shite një torbë taxhi. Edhe, pas gjithë atyre torturimeve të papara në burg. Premtimeve të vendeve të punës. Miqësinë vëllazërore dhe fshehtësinë tonë që e kishim që nga bankat e shkollës fillore e more me vete në varr...

Edhe një gjë: Që të dy nuk kishim para si të papunë. Edhe ti edhe unë, në atë kohë punonim për popullin shqiptar. Përmëkeq, shkruanim

vjersha. Shkaku: ishim rritur e edukuar me poezitë e rilindasëve. E populli, shumica në fillim punonte për Partinë Komuniste, e më vonë për partitë politike “demokratike” shqiptare. Zanatin e vjetër ia lamë vendasit tonë t’i shëtis dhe t’ju shkruaj “poezi dashurie” edhe këtyre partive politike “demokratike”. E di, ti e kishe më së vështiri në jetë. Unë e shisja nga një arë të Babait sa për ta mbajtur veten gjallë, botuar ndonjë libër, ose organiazuar ndojnë manifestim kulturor t’ju bëj ballë kulturofagëve, dal në dyluftim në fushën e mejdanit me këta “burra patriotë”. E gjithë kjo do të thotë: nuk kisha kohë të vij edhe në vendlindje. Kokë më kokë ta shtronim përsëri si burrat në Tavernën “Elita”, në Kërçovë. E shtronim ndonjëherë, po shumë rrallë. Shkaku, se: kishim barrë në kokë, zemër, mbi shpinë...

Papritmas, një ditë edhe ike nga mesi ynë, u arratise mes poezive...



ZHURMA E RROTAVE TË QERRES

(Shkas: 28 nëntori – Dita e flamurit, 2009).

Natë. Natë është sonte, kur jam shtrirë në shtrat dhe e lexoj *Librin e gabimeve*. E shfletoj faqe për faqe mundohem të lexoj edhe në mes rreshtave, po mjerisht në një rresht më mbyllem sytë. E këndej është ende herët për gjumë, në ndonjë faqe t'u dorëzohem ëndrrave të frikshme, xhindeve të më hedhin gjithë natën e gjatë, dorë më dorë majë lisave. E shtrydh trurin, mundohem vetëm pak t'i hap sytë, të shoh Kalin e bardhë me një këmbë të thyer, sesi e shalon Intelektuali i Rrejshëm. Po, kot, sytë nuk më binden, para tyre del Nusja me pashterkë të kuqe. E merr dajren në dorë dhe ma këndon një këngë. Vetëm tash e marr vesh se në shtëpi paskemi dasmë. Ngrihem në këmbë, hip shkallëve ta nxjerr pushkën e Babait nga hatullat. Në lëmë grupi i vajzave u bien dajreve, këndojnë këngë dhe heqin valle. Matanë xhamave dëgjohen zërat e natës... Zogu i Keq... E dikund në rrugë zhurma e rrotave të qerres, vijnë krushqit: djemtë e Shalës me koçinë e mbuluar me qilima...

E moti, shumë moti, kur kemi qenë fëmijë, më kujtohet se për ta pritur Nusen me pashterkë të kuqe, i kemi dalë para, kemi hipur edhe në kodër. Në pritje e sipër gati të gjithë e vendonim nga një mollëkuqe në majë të gishtit. E ndalnim edhe frymëmarrjen, prisnim se nga cila anë do të

fluturojë të na e sjellë nusen. Po, nganjëherë edhe zemroheshim, kur ajo nuk fluturonte, e ne më kot i frynim me gojë, e nxitnim t'i hapte krahët. Vërtet, atëherë dëshproheshim shumë, si fëmijë më, kishim frikë se do të mbesim si xha Cuti pa nuse... Nuk do të ketë kush të na e nderë zjarrin, të na i përkundë djepat në Katund...

Edhe ato ditë “të lumtura” ikën shumë shpejt, u tretën si fluska sapuni dhe nuk e di ku i varrosëm diku rrëzë kodrës ose në mesin e luleve. Erdhi “demokracia”. Pluralizmi. Sistemit monist i thamë njëherë e përgjithmonë lamtumirë. Ndonjëri nga ne më “i munduari” filloi edhe ta shajë, volli gjithë atë urrejtje që e kishte mbledhur me vite e vite kudo që i jepej rasti para popullit. Shpeshherë edhe çuditëshim se ç’po ndodhte me të, si ndryshoi brenda një nate, kur gati të gjithë e dinim se ajo parti bolshevike mu këtij martiri ia kishte përmbushur të gjitha kërkesat: vende të merituar pune, dy - tri banesa, shtëpi... Pozitë në shoqëri... Tre pensione... Nuk na shkonte mendja se mu ky do të jetë ai i pari, që do të shkurorëzohet aq lehtë nga sistemi komunist, kur vetëm ai, me gjithë “aftësitë” superintelektuale e kishte shëtitur “Mëmëdheun” karrige më karrige. Budallatë që kishim qenë, mendonim se në mes të dashurisë së tyre romantike alla Romeo e Zhuljeta mund të ndërhynte vetëm vdekja. Kurrë nuk mund ta merrnim me mend një gjë të tillë tragjike, si në veprat e Shekspirit, derisa “bijt” e saj “besnikë”, kush më i pari, u sulën të anëtarësohen nëpër partitë e tjera politike “demokratike”. Vonë, shumë vonë e pamë

qëllimin e këtyre “luftëtarëve të lirisë”, pasi na doli gjumi, kur filluan të dalin me diskutimet e tyre të zjarra në foltore për Shqipëri Etnike.

Natë e ditë i shihja këta kalorës të arratisur të “demokracisë” sesi u kishin hipur kuajve me bajrakun në dorë, kishin zhveshur shpatat dhe sesi u binin kokat në fushën e betejës. Vetëm se, ndonjëri çohet prapë më këmbë, e merrte kokën nën sjetull dhe sulej tym e mjegull përsëri kundër armikut për fitore. Merreni me mend si e ndieja veten kur i shihja, ashtu me koka nën sjetulla nëpër lumin e gjakut që u vinte deri në brez. Tani m’u kujtua edhe ai këngëtar i popullor që u këndonte trimave në fushën e betejës, ku ishte derdhur aq shumë gjak, sa mund të mbytej edhe kali. Po, ku të gjenim tani në një këngëtar të tillë popullor, të marrë çiftelinë në dorë dhe t’i këndojë këngë këtij “heroi” tonë legjendar të Bit – Pazarit. Vërtet duhet pranuar, nuk kemi sot këngëtar aq të denjë për këtë kalorës të arratisur, ose siç do t’i thosha unë ndryshe, Don Kishot shqiptar, që të gjitha ato beteja të përgjakshme nëpër sheshe të qyteteve i zhvilloi vetëm për Dylqinenë e Tobozës...

E dini, edhe çka m’u kujtua tani? Jo, ë? Vërtetë jeni të mrekullueshëm, ma kënaqët lapsin. Me vite e vite ju e keni pritur një përshëndetje historike të tillë të Intelektualit të Rrejtshëm. E di unë, para televizorit: “Dobro veçe Makedonijo!” (Mirëmbërëma, Maqedoni). Edhe deklaratën e analistit politik në një debat televiziv: banorët e vetëm në Maqedoni një ditë do të mbesin përmendoret. Unë asaj deklaratë do t’i shtoja:

edhe shqiptarët. Por, edhe pse ka qenë natë, ju nuk u ka marrë gjumi. U ka munduar eksponenti i “vëllazërim – bashkimit”. Mua, nëse më pyetni, edhe do t’iu përgjigjem: kam fjetur si qengj, nuk i kam dhënë pesë para. Vetëm tash e pata të qartë, pse ai kalorës i arratisur nëpër beteja u thoshte shokëve të tij të armëve, njëherë edhe në prezencën time, se ata nuk marrin vesh nga lufta trojane, po marrin vesh ato tre Sançot e tij shkrimtarë që me libra teknefesë, (vetëm për një kritikë sakate) e kanë shtënë në mes dhe e mbajnë për krahësh nëpër manifestime kulturore partiake festive para kamerave televizive të mos rrëzohet nga Rosinanti në baltë.

Vitet që atëherë kanë ikur njëri pas tjetrit, e unë me shokë ende në kodër e pres Nusen me pashterkë të kuqe. Vetëm se, tash ndryshe nga ato kohë, nuk i nisim mollëkuqet në rrugë të gjatë pas shtatë maleve e pas shtatë kodrave. Vetë u kemi hipur kuajve në shpinë, lapsat i kemi ngritur në dorë për ta grabitur Nusen me pashterkë të kuqe. E ajo ditë me siguri nuk është larg. Matanë kodrës e dëgjoj përsëri zhurmën e rrotave të qerres... Krismat e pushkëve... Këngën e krushqve: “ *O bini djemtë e Shalës*”... Që, nesër kur të më dalë gjumi, të zgjohem në prehërin e Nuses me pashterkë të kuqe... Nuk besoni, ë?! Pritni pak, mos u ngutni, se unë nuk u kam faj, duhet zgjidhur nyjën. Ja, ku e keni fijën. O burra, juve para koçisë u ka prirë Intelktuali i Rrejshëm. E ka marrë bajrakun në dorë dhe gjithë kohën ju ka kënduar këngë patriotike. Parulla bolshevike: “*haj – haj, kasolla me kashtë, sot një*

javë nja pesë – gjashtë!...” Përsëri, më duket se nuk më besoni, ë?!

Atëherë, veten e paçit në qafë...



Fitore DERALLA

TRUSAKATËT EDHE FLAMURIT KUQEZI IA NDËRRUAN NGJYRAT

E pabesueshme, ë?! Edhe unë e kam vështirë t'u besoj syve që atë ditë e pash në ekran të TVM, Programi në gjuhën shqipe: Lajme. Përmëkeq, Ditën e flamurit – 28 Nëntori: Flamuri shqiptar i ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër?! Edhe një herë them: e pabesueshme?! E them këtë se: po të ndodhte një “gabim” i këtillë në kohën e komunizmit (gjoja se teknik), përgjegjësi i këtij emisioni fluturonte nga puna, jo nga dera por nga dritarja. Dhe, jo vetëm kaq: nga puna fluturonte edhe redaktori përgjegjës, e gjithë redaksia. Po, ja që në këto kohëra “demokratike” për kësi gabimesh të pafalshme, jo vetëm që nuk jepet përgjegjësi, po edhe shpërblehesh me poste më të larta dhe mjete materiale për “flijime artistike”.

E tmerrshme! Edhe nga kush, nga partitë tona politike shqiptare. Vite me radhë u themi: mos dërgoni në emër të popullit shqiptar trusakatë në institucionet shtetërore të ulen në tavolinë ballë për ballë me sllavomaqedonasit! E ata, sikur për inatë na i mbushën institucionet shtetërore me injorantë shqiptar. E shkatërruan arsimin dhe kulturën shqiptare. Nuk lanë rrugaç e të paditur pa futur nëpër instucione shtetërore. Edhe hoxhallarët filluan të mos e kryejnë më dhe të harrojnë misionin e tyre të shenjtë dhe human. Edhe ata turr me të katra iu sulën institucioneve

shtetorëre të vendosin për arsimin e kulturën shqiptare ballë për ballë me “vëllezërit”!!!

Dhe, të nesërmen i sheh qaraman, kuku bëjnë si qyqe nëpër tribuna e medime: nuk kemi arsim, nuk kemi tekste shkollore, nuk kemi lektyra shkollore, nuk kemi kulturë shqiptare. Nuk kemi libra shkollor...

Trusakatët, më në fund publikisht na i ndërruan edhe ngjyrat e flamurit kombëtar në TVM. Po, deri kur do t’i durojmë këta trusakatë me brekët nëpër këmbë të na prinë për liri?!... Nëpërkëmbin nëpër manifestime partiake flamurin kombëtar. Natë e ditë të na shesin demagogji patriotike, bëjnë thirrje publike: nxirreni flamurin kombëtar në dritare, në pemët e oborreve të shtëpive! Ejani të gjithë te Sheshi “Skënderbeu” të festojmë, heqim valle! Këngë të këndojmë për flamurin kuqezi! Mirë them unë: po ne, flamurin kombëtar nëpër shtëpi, plepa dhe nëpër male e kemi ngritur edhe në kohë më të vështira, në kohën e komunizmit. Përpara syve të policëve sllavë me armë në dorë. Askush nuk na ka penguar në shtëpi, nëpër oda ta ngrejmë flamurin kombëtar, mes maleve nëpër katunde. Problemi ka qenë si ta zbresim të valojë siç i ka hije nëpër qytete. Institucione shtetërore. Edhe zyrtarisht të valojë lirshëm në ditë feste. Flamuri është simbol kombëtar i shtetit. Nuk është leckë, që kujt t’i teket ta vë ku të dojë si “veteran” lufte. Përmëkeq, të çirret e përjaget me çifteli përpara këmbëve të kalit të Skënderbeut. Ose, të fotografohet para kamerave televizive si “patriot”

kuqezi. Shkurt, të manifestojë përpara popullit propagandë patriotike të partive politke.

Kulminacioni i marrisë: E ti gjatë rrugës për të ardhë deri te Sheshi “Skënderbeu”, më kot i hap sytë nëpër shtylla, askund nuk e sheh flamurin kombëtar. Shtyllat e rrugëve pa zbukurime si në ditë feste. Xhamitë si gjithmonë me flamuj të huaj në minare...

E për çudi, Skënderbeu hipur në kalë me dorën e ngritur lartë: ndaluni burra, këtu është kufiri, nuk e nxjerr shpatën nga brezi. Hesht. Thotë në vete: Matanë Urës së Gurit valon flamuri i “vëllezërve”. Edhe për atë flamur shqiptarët kanë derdh pak gjak në Kuvend gjatë ndryshimeve “demokratike”. Është edhe i yni, shqiptarëve. Patjetër, duhet t’i dalim zot nëpër beteja. I duron gjithë këto pordhë e piskama patriotike para këmbëve të kalit të tij në Bit – Pazar. Këngë e valle për flamurin kombëtar. Flamur, që ende nuk valon lirshëm nëpër qytete shqiptare. Institucione shtetërore. Libra të këndimit. Minare të xhamive...

Nata është e gjatë në Bit - Pazar. Këngët dhe vallet zgjasin deri në agim. Hoxha edhe ai thërret në minare. Zoti e bëftë për hajër! E bëmë një natë Shqipëri Etnike me çifteli. Të nesërmen, përsëri kthehemi nëpër shtëpitë, që mezi e mbajnë njëra – tjetrën të mos rrëzohen në tokë. Çajtoret me tym duhani - mjegull. Kokë më kokë bëjmë politikë. Përgaditemi për vitin tjetër heroik, përsëri ta festojmë me këngë e valle Ditën e flamurit, ta nxjerrim në dritaret e shtëpive, majë plepave nëpër oborre.

Edhe vitin që vjen fëmijët tanë t'i lëmë pa libra në klasë. Shkollat pa çati t'i presin dimrat. Popullin pa bukë në shtëpi.

Rrofë 28 Nëntori - Dita e flamurit kombëtar!... Rrofshin Partitë tona politike "demokratike" shqiptare!...



**PERSONALITETE QË RRINË KRAH PËR
KRAHU ME BAJRAM CURRIN
DHE SHOTË GALICËN**

Populli shqiptar është një ndër popujt më të pasur për nga personalitetet historike nëpër shekuj. E kam të qartë si shkrimtar se, ky popull historikisht ka ecur dhiareve përmes maleve nëpër zjarr e flakë për në Liri. I djegur, herë pas here nga armiqtë shekullor dhe i rrafshuar me tokë. Këmbë e dur i lidhur me zingjirë. Megjithatë, të nesërmen, përsëri ka lind si feniksi nga hiri dhe ka ecur vetë më këmbë në histori. Nëpër vite është ndezur zjarr e flakë. E tjetër punë është ajo se, shumë pak është shkruar e bërë për këto personalitete historike legjendare. Përderisa, ndonjë popull tjetër është përpjekur t'i përvetsojë këto personalitete nga popujt e tjerë, shqiptarët nuk e kanë pasur këtë problem historik. Prandaj, edhe u kanë dhënë me të dyja duart popujve tjerë të Ballkanit. Edhe u japin edhe sot e kësaj dite për ta pasuruar historinë e tyre kombëtare. Nuk do t'i përmendi emrat. E di opinioni i këtushëm dhe ai botëror se, për cilët personalitete historike bëhet fjalë.

Problemi është se, ne si shqiptarë shumë pak kemi shkruar e bërë për këto personalitete historike me armë e penë në dorë nëpër shekuj.



Të tjerët: nga mësuesi i thjeshtë i katundit, kanë bërë legjendar, nga duhanvjelësi kanë bërë poet, nga hajduti – patriot, nga askushi hero. E kam fjalën: shqiptarët i kanë edhe dy personalitete historike të mëdha të rangut botëror, që mund të rrinë krah për krah me Bajram Currin dhe Shotë Galicën. Njëri është Kalosh Zajazi, që edhe ka luftuar me armë në dorë në vendlindje (Zajaz) IRJ e Maqedonisë, Kosovë e Shqipëri krah për krah me Bajram Currin. Dhe, tjetra: Sulltanë Qafa, një Shotë Galicë e dytë shqiptare, që me gërshtëri të dhenëve në mes të ditës tre komita ia ka vrarë Mikailit të Brodit, kur ia ka arrestuar në befasi babain në lëmë.

Kush ishte Sulltanë Qafa?: Heroina e ngjarjeve të masakrimit të vitit 1913 të popullatës

shqiptare në fshatin malor Qafë nga bandat kriminele serbosllave, të udhëhequra nga Mihajllo Josifoviçi, i njohur në popull si Mikaili i Brodit, që digjnin e shkretinin vendbanime të tëra shqiptare.

Sulltana e Mazllamit të Qafës, vajzë 18 vjeçare, në masakrën e tmerrshme të banorëve të këtij fshati, ku thereshin si shqerra e mbyteshin burra, gra e fëmijë, e ndër ta edhe i ati i saj, kryeplaku i katundit Mazllami, mbledh forcë e guxim dhe rrëmben gërshërët e dhenëve në gji e u sulet si Bubulina hordhive çetnike serbosllave duke luftuar me ta ballë më ballë. Në përleshje e sipër, Sulltana vret nipin e kryeçetnikut dhe dy çetnikë të tjerë, duke treguar kështu një trimëri të jashtëzakonshme, të cilën populli më pas e përjetësoi në vargje poetike lapidare:

KËNGA E QAFËS (SULLTANËS)

*Këta komitat, jalla ç'janë tërmou
Njer në Çafë derrat dun me shku
Burrat e Çafës, jalla, i kanë tërmou
N'shpëi t'Mazllamit, jalla, dun me i çou, vaj
Na dul sulltana, besa, n'at dollap
Naju ra durve, çyçja, më t'përflak
-Çyçja bre nanë, ene, në boet nji xhak!
N'boet nji xhak, mori nanë, ni xhaku i zi!
Në vrëiten burra, në vrëiten granëi, vaj!
Ç'u kthëy Sulltana hëyni në shpëi
Naj mourr gërshënët, çyçja, i shtëu në xhi
Na dul Sulltana, besa, moun më shkallë
-Gajret bre date mos u lidh i xhall-e!*

Tybe Sulltana s'ta le xhakun pa marrë, vaj!
Gajret Sulltanë he Zoti mo t'frëykt!
Se bashkë me daten ne në shkojmë shehëit!
Këcej Sulltana, besa, dul mor në lëmë
Ja guli komitit, besa, në xhebadan
Ja çiti derrit, besa, tej more m'at anë, vaj!
Hikën komitat, besa, tu çëllou mrapa!
Hikni bre shokë se na faroj Çafa!
Na faroj Çafa, jimi t'marrou
Se nja tre vetë naj ka vramun nji gru, vaj!
Gajret Sulltanë, moj, e bije xhalit
Sa mëir ja bone, moj, xhalit Mikajlit!
Oj, bre, erdh haberi, mor, në karakollë
Në karakollë, mor besa, n'atë Kërçovë
Në Kërçovë, besa, n'atë Gostivar
Çaj Mazllam Çafa bon trëimnëi-o me gra, vaj!

Në vitin 1993, me rastin e përkujtimit të 80 – vjetorit të kësaj ngjerjeje të shënuar historike, që është një pjesë edhe kjo e epopesë sonë kombëtare, në vendlinjen e saj Qafë, ku ra dëshmore, Sulltanës iu ngrit përmendore në bronz nga piktori Meli Zenku. Me rastin e këtij përvjetori kryetari i Shqipërisë Sali Berisha, heroinën e Qafës Sulltanën, bashkë me të jatin Mazllamin, i dekoroi me Urdhërin e klasit të dytë për veprimtari patriotike, që është kjo një mirënjohje e veçantë edhe për vetë Kërçovën heroike, që gjatë historisë ka pasur jo vetëm burra të shquar të mendjes dhe të armës, por edhe gra heroina si Shotë Galica.

Dhe, kush ishte Kalosh Zajazi?: Kalosh Dani – Zajazi ishte njëri ndër personalitetet më të

dalluar të Lëvizjes Kaçake shqiptare, simboli i lirisë kërçovare dhe mbarëshqiptare dhe kapidan i kaçakëve të Kërçovës, luftëtar shumë i shkathtë dhe strateg i madh, që zhvilloi luftëra të armatosura dhe u bëri rezistencë ballë me ballë okupatorit bullgar dhe pushtetit të borgjezisë serbomadhe gjatë lufëtës së Parë Botërore dhe midis dy Luftërave Botërore.

Emri i këtij trimi kërçovar dhe luftërat e tij heroike janë përjetësuar në këngë popullore, që këndohen me adhurim të veçantë në Kërçovë:

KALOSH DANI

(Variant, Zajaz)

*Pi në Dibër, more, në Tiranë,
Na ka dalë, hej mor një kapida'!
Kapidani, o more, Kalosh Dani,
Pret ke Gara, mor, përmy Bukujçan:
-Abedinit, or bonmi selam,
Pret Kaloshi, mor, një burr'i unjë
Mal e fousha, mor, na shkon si fjutër
Shkon si fjutur, more, na ka ra
N'male të Brodit, mor, na u boka nami
Ke liftonte, mor, Kalosh Dani!
Shumë imnat, mor, na i ep Ljazami
-Jalla ç'u bone, Ljazam, bre vëlla?
Se dibranët, mor, janë tuj na vra!
Tuj na vra, mor, dunë me na zanë!*

Në vitin 1993 Kalosh Dani - Zajazi dekorohet nga kryetari i Shqipërisë Sali Berisha

me urdhërin për veprimtari patriotike të klasit I-rë.

Tjetër punë është ajo se, nga treva e Kërçovës nga e cila vijnë këta personalitete, shumë pak është bërë në zbulimin dhe afirmimin e heroizmave të këtyre burrave e cucave heroike të popullit shqiptar. Kërçova ka edhe personalitete të tjerë të këtij niveli luftarak, po me zbulimin e veprimeve të tyre, luftrave të tyre për liri e Shqipëri Etnike, duhet të merren historianët dhe shkrimtarët. Fatkeqsisht, historinët kërçovarë ende janë në gjumë dimëror. Nuk kanë bërë pothuajse asgjë për këto fytyra historike. Përjashtim këtu bënë Dr. Halim Purellku, ka dhënë sadopak një histori (libër) për kaçakun e maleve Kalosh Zajazin, që luftoi krah për krah me Bajram Currin maleve për Shqipëri Etnike. Edhe ndonjë shkrimtar për Sulltanë Qafën. Dhe, Dr. Qemal Murati me librin e tij: *Këngë të moçme kërçovare*. Vetëm se, kjo është pak në krahasim me veprat e tyre heroike. Porosia e të cilëve përcillet edhe sot e kësaj dite brez pas brezi. E thashë pak më lartë: kaçaku i maleve, Kalosh Zajazi dhe Sulltanë Qafa rrinë krah për krah me Bajram Currin dhe Shotë Galicën në histori. Atëherë, çka presin shqiptarët, edhe këto personalitete historike t'ua rrëmbjenë popujt e tjerë pa histori. E pastaj të dalin te sheshi "Maqedonia", Ura e Gurit se: sllavomaqedonasit ua përvetsojnë personalitetet historike dhe e ngrejne zërin në protesta për të drejta dhe liri kombëtare në mjetet e informacionit...

Dorën në zemër, historikisht shumë popujve nëpër botë u kemi dhënë personalitete nëpër histori dhe mund t'ju japim edhe nesër, në të ardhmen. Vetëm, amani le të pushojnë më të vajtojnë se janë popull i rrezikuar nga shqiptarët. Ndonjërin e kemi bërë edhe Shtet. U kemi bërë unievrsitete. Gjuhë letrare. Edhe shtet, ja po i bëjmë në shekullin XXI, i nxjerrim në Evropë. Nuk e di çka duan më tepër nga shqiptarët?! Që, ne me bukë e ata me gurë te Ura e Gurit, përpiqen të na varrosin për së gjalli nën gërmadha me beton sllavokomunist gjoja si institucione kulturore antike.

Dhe, në fund: këto dy fytyra historike e kanë vendin krah për krah në Sheshin e Kërçovës mes luleve, rrëzë Çelvjollcës. Ose, në Kala mbi qytet. Pse jo, edhe në Sheshin e Shkupit “Maqedonia”, krah për krah me Filipin e Maqedonisë dhe Alaksandrin e Madh. Fundi i fundit, edhe në Kala të Shkupit mbi qytet, t'i fusin armët në brez pas barazisë dhe lirisë të plotë kombëtare...

Shkupit t'i bëjnë roje krah për krah me shokë të luftës, fshijnë djersët nga politika ditore. Trusakatët, që e kanë rrok për fyti qytetin dhe ia këne zënë frymën. E ngulfasin me projekte politike, këpurdha betoni, përmendore antike, demagogji e parulla patriotike neokomuniste...

SHTET I “MENÇUR”

Edhe pse, gati të gjithë shqiptarëve na ka dhënë rroga, po nuk na ka dhënë punë, është Shtet i “mençur”. Tekefundit, na ka marrë në gji si “nëna” fëmijën, pa dallim feje e kombësie(?!...). Edhe na ka lidhur në djep. Ninulla na ka kënduar mbi kokë: flej biro se të ban mirë gjumi, do të të baj Njerka plak katundi. Pesëdhjetë vjet me radhë na ka përkund nën hije të mollës. Edhe sot, gjatë ndryshimeve “demokratike” na përkund po me të njëjtën ninullë të “vëllazërim – bashkimit” nën çati të Qeverisë. Ndonjëherë, kur qajmë ose bëjmë ndonjë bela na e fut edhe ndonjë shpullë bythëve. Dihet, nuk na dhemb shumë se, është shuplakë e Njerkës. E di edhe atë se: qumështi i Njerkës është haram, nuk të bën burrë, nuk të bën shtëpi. Megjithatë, është i nevojshëm për jetën e përditshme të fëmijëve. E shqiptarët, vazhdojnë ta pinë këtë qumësht: në Qeveri, Parlament, institucione të Shtetit, mjetet e informacionit... Dhe, kurrë nuk e pyesin veten, pse Njerka ua jep gjithë këtë qumësht me kusi pa punë dhe djersë fare nëpër institucione të shtetit.

U thotë: ja, vende pune. Merrni rroga, dhe rrini në shtëpi! Po, ne duam të rrimë nëpër çajtore! Edhe, nëpër çajtore rrini, po jo në punë. Ne, duam të luajmë edhe domino! Edhe domino luani përnatë! Gjithë ditën. Po, të doni luani edhe filxhana nëpër oda të burrave. Ne duam të themelojmë edhe shoqata joqeveritare! Edhe

shoqata joqeveritare themeloni në këtë shtet “demokratik”. Vetëm, mos u merrni me politikë, arsim e kulturë! Punë këto, shumë të vështira për shqiptarët. E ju keni fat, që na keni ne “vëllezërve” për këto punë shumë të rënda nëpër kongrese botërore. Edhe honorare do t’ju japim nëpër komisione të ndryshme shtetërore, vetëm punën do ta bëjmë ne “vëllezërit” si profesoinistë. E keni shumë lehtë ju, që për shqiptarët punojmë ne “vëllezërit”. Ju vetëm merrni para dhe rrini në shtëpi! Kështu bëhet politika, arsimit, kultura në nivele shtetërore. Kështu, përpilohen planprogramet shkollorë nëpër kabinete, tekstet shkollorë, lekturat shkollorë, programi vjetor i ministrisë së kulturës...

Edhe një pyetje: vërtetë kemi fabrika të diplomave, po ne nuk kemi shkencëtarë me famë, shkrimtarë të mëdhenj, shtëpi botuese të librave. Nuk prish punë. Edhe këto do t’ua pjellë partia. Shembull më të freskët e keni Lidhjen e Botuesve Shqiptar në Maqedoni dhe karvanin e improvizuar të librit nëpër disa qytete sa për sy e faqe. Fundekrye formalitet kulturor. Mirë, po ata nuk janë botuesë: dy - tri shtypshkronja, një autoshkollë dhe hajdutë të librit që shesin botimet e shtëpive tjera botuese. Pse, këta të Shoqatës tjetër paralele janë botuesë?! Mos u mërznitni, edhe këta do t’i bëjë botuesë të “mëdhenj” një ditë Partia! Ama, këta janë debila kulturorë?! Punemadhe. Nesër, po të doj Nëna Parti mund t’i bëj edhe shkrimtarë. Edhe, mos e hidhëroni Nënëni Parti se, për inatë i bënë edhe politikanë: ministra, deputetë, ambasadorë, drejtorë...

Mirë, ta zëmë se më në fund më bindët me fjalë. Po, kush është ky bërlllok patriot shqiptar?! Çka ka bërë në jetë për së gjalli?! Jo, nuk ka bërë asgjë. E, a e njeh nëna vet këtë bërlllok shqiptar? Tekefundit, duhet ta njoh Katundi? Jo, nuk e njeh edhe ku rri me shtëpi. Atëherë, kur pritni të bëj ky bërlllok shqiptar diçka për Atdheun, pasi të vdesë nga varret?! Jo, shqiptarëve nuk u duhen “patritotët” e këtij soji, i hudhni në koshat e plehërave në Bit-Pazar!

Momenti i rastit, ma kujtoi edhe një ngjarje shumë interesante. Një ditë duheshte të dorëzoj në ministri një kërkesë për realizimin e një manifestimi kulturor tradicional ndërkombëtar. E hapa derën e Arhivës dhe u befasova për të mirë: përveç grave të zakonshme që punonin rregullisht në këtë zyrë, e zateka edhe një djalosh të pashëm. Aty për aty mu kujtua: Partia që këto ditë erdhi në pushtet, me siguri thash me vete ua ka dërguar këtë “përforcim” profesional. I hodha një shikim djaloshit, nga këmbët te koka: u binda se është edhe shqiptar. Edhe ky me siguri, thash me vete është punësuar me Marrëveshjen kornizë të Ohrit. Djaloshi, të mos e marr mësysh, plaste nga shëndeti. Duart e zhvilluara i kishte hedhur mbi tavolinë dhe pinte kafe. E mora me mend, ku ta dish këto duar të fuqishme me sëpatë sa dru kanë prerë në mal për dimër. Qind për qind isha i bindur se djaloshi, përpara se ta sillte partia në këtë ministri kishte përvojë pune si druvar. Nuk e lunate as topi këtë konstantim. Shkaku se, një kohë të gjatë kisha punuar nëpër fshatrat e malësisë së Shkupit si mësues. Vendosa pak edhe

t'i ngacmoj gratë: Tashti, siç duket u është paksuar dukshëm puna. Partia u paska dërguar edhe “përforsim kuadri deficitar”. Gratë, i pashë në fytyrë se desh plasën nga inati. Aty për aty, mu përgjigjën: Nuk e kemi atë gajle, jo që nuk di ta hapi as kompjuterin, po gjithë ditën nuk prek punë me dorë. Ndashhtë. Vetëmse, nuk durohet kjo dukuri e përditshme terrorizuese në punë: kur bëjmë kafe për vete, duhet t'i bëjmë kafe edhe këtij punëtori “deficitar”, që na e dërgoi dhuratë partia e koalicionit qeveritar në pushtet.

E, ec e mos i duaj tashti “vëllezërit” e Njerkës, që punojnë natë e ditë për ne shqiptarët. Na japin rroga, e ne rrimë në shtëpi. Ose, nëpër çajtoje. Jo, i duam, si nuk i duam “vëllezërit” e Njerkës. Kush e thotë këtë budallaki të shekullit?! Kush është ai bir nëne që do të na përçajë me “vëllazërit”, tashti t'i urrejmë kur duam të shkojmë së bashku edhe në Bashkimin Evropian?! Askund në botë nuk ka si “vëllazërit” tanë, ata punojnë e ne marrim rroga dhe rrimë në shtëpi. E kemi shtruar nën hije me dasma e çaj rusi si në kohën e Turqisë. Prandaj, mos u mundoni të na përçani me “vëllezërit” e Njerkës! Ne i duam “vëllazërit” tanë që na i polli Njerka! Dhe, do t'i duam gjithë jetën! Vëllaço, ku ke parë ti të marrësh rrogë dhe të rrish në shtëpi?! Organizosh panairë e karvane të improvizuar të librit me para të shtetit me të vetmin qëllim: të mos shesish libra në gjuhën shqipe. “Vëllezërit” për ty të punojnë natë e ditë. Askund. Prandaj, edhe e duam këtë Shtet “demokratik”. Nuk e ndërrojmë me asnjë shtet

tjetër në botë. Thyeni qafën rrufjanë, ne e duam këtë Shtet! Edhe “vëllazërit” e Njerkës, kot përpiqeni të na përçani, ndani me kufinj të rinj politik: “vëllai me vëlla”.

Një ditë, edhe me siguri do t’ju kujtohet qumështi i Njerkës, po jo edhe kulloshtira. Petullat me kos. Tashti, do të jetë vonë, qumështi u ka rritë viça të palëpi. Harami ua ka trashë qafat për thikë. Edhe do të përpiqeni të ikni në Lëmë, matanë gardhit. Përsëri, shumë vonë, kasapi me duart e përvjeluara deri në bërryla më u ka zënë për veshësh si viça të palëpi në fund të kopshtit, e ka nxjerrë thikën e kasapit, ua ka vënë në fyt: pëllitni për ndihmë!

Eh, viçat e mi të palëpi, që posa e shihni thikën e kasapit, vetë i zgjasni qafat. I zgurgulloni sytë. Lëkurën, kur ua rjepin për opinga. E mishin ua fusin nëpër konzerva, Vetëshërbime te Shtëpia e Mallërave, në Bit – Pazar.

Taxhia e “vëllezërve” me një torbë përqafe në grazhdin e Qeverisë, shumë vonë ua kujtoi atë thënien popullore: vetë vjen cjapi te kasapi...

Shtet i “mençur”, ë?! Hi-hii-hiii...

PROBLEMI ME VETVETEN

E ka thënë moti Faik Konica i madh: ... *O Zot, mbroje Shqipërinë prej shqiptarëve!* Një mik imi poet, Pano Taçi: *Për inatë të shqiptarëve, do të bëhet Shqipëria.* Edhe unë e kam përsëritur disa herë me radhë në libra: Armiku më i madh i shqiptarëve, janë vetë shqiptarët. Shqiptarët kanë problem jo me të tjerët, po me vetveten. Problemi me vetveten, është më i madhi. Nuk të lë të ngritësh më këmbë, nuk të lë ta vazhdosh rrugën pas Çuke. Këmbët t'i lidhë nyje në mes të rrugës. Dhe, fatkeqësia më e madhe u vjen shqiptarëve nga vetvetja.

Vetëm i hidhni një sy historisë! Burrat më të mëdhenj të Atdheut, i ka vlarë dora e shqiptarit. Edhe, i ka tradhtuar, i ka shitur lirë te armiku. Persëri, edhe në shekullin e njëzetënjë, shqiptari e vret shqiptarin. Shqiptari e spiunon shqiptarin. Shqiptari e tradhton shqiptarin. Shqiptari e shet shqiptarin. E populli e ka thënë një urti antologjike: përpara se ta pastrosh oborrin e shtëpisë së komshiut, pastroje oborrin tënd nga bërlloku para dere. Fatkeqësisht, shqiptarët kanë shumë bërllok, që u është grumbulluar me vite. Ndonjëherë, edhe e pyes veten: nga ku na ra gjithë ky mallkim mbi shqiptarët?! E kam dëgjuar nga pleqtë të thonë se: shqiptarët i ka mallkuar Baba Dovleti. Mallkimin e tij e marr edhe me mend e arsye, po pse ky mallkim të zgjasë kaq shumë gjatë me vite, edhe sot e kësaj dite?!

Ndonjëri thotë: shqiptarët pesqind vjet kanë jetuar nën Turqi. Vite me radhë nën Serbi. Viseve tona kanë kaluar edhe gjermanët, italianët, bullgarët... E pamundur është ky popull, gjatë kësaj “bashkëjetese” edhe të mos e ketë perzier gjakun, me dëshirë ose me dhunë. Kohën e fundit, në shekullin e njëzetentë serbët edhe njëherë e përdhunuan këtë popull, ia përzinë gjakun te pragu i shtëpisë.

Dhe, e gjithë kjo përçarje me popullin shqiptar nuk ndodhë rastësisht edhe në ditën e sotshme. Gjakun e kemi të prishur nga “miqtë” dhe armiqtë si popull trim, liridashës dhe i besës. Edhe në kohën e sotshme vazhdojmë ta përziemë gjakun me martesat e përzierra, me nuse nga Shqipëria e dhëndurë nga katundet e shkretë të Maqedonisë. Rrezik i madh për shqiptarët e këtyre trojeve, që do t’ia shohim sherrin pas disa viteve. Vallë, nuk ju kujtohen martesat e përzierra me qëllim gjatë historisë, që i bënin disa popuj për të pasur ushtarë melezë trima për luftë?! Shembull më të freskët i kemi martesat e shqiptarëve në kohën e komunizmit me gra serbe. Më kujtohet si fëmijë, vetëm katundi im, disa burra përveç grave dhe fëmijëve që kishin në katund, kishin edhe gra tjera serbe dhe fëmijë në Beograd. E të mos flasim për burra tjerë shqiptarë nëpër qytete e katunde të Maqedonisë, Kosovës e Malit të Zi. Dhe, gjatë Luftës së Kosovës (1999), ne nuk na vranë serbët, po na vranë “djemtë” tanë melezë. Nëpër trup na qarkullon gjak i huaj, gjak i prishur anadulli, gjak barbari. Një Zot e di me

cilët popuj pushtues e “vëllezër” jemi kryqëzuar, e kemi përzier gjakun nëpër shekuj.

Patjetër, duhet të them edhe një realitet, që ia kam borxh lexuesit shqiptar. Shkaku: prej nga gjithë ky bërlllok shqiptar në Shkup, që na e ka zënë frymën?! Shkupi i ka tre soje shqiptarësh: vendasit, shqiptarët e deklaruar pas Luftës Dytë Botërore si turq për t’u shpërngulur në Turqi. Dhe, spiunët e kohës së Rankoviqit kur humbi pushtetin në Kosovë kryepolici: bashkëpunëtorët e tij shqiptarë ikën e u strehuan në Maqedoni. Ja, shkaku: pse Shkupi nuk mund të çoj krye nga ky bërlllok shqiptar që e ngulfat dita – ditës, ia zë frymën qytetit.

Edhe një histori më vete për lexuesin: Një njeri i mençur, Mahmut Dumani që ka punuar dhe vepruar në Shkup ka thënë: Problem i madh është të punohet me këtë popull në këtë anë. Herët, a vonë me këtë popull do të kemi probleme në të ardhmen për Atdheun. Edhe u binda vetë: Pas viteve ’80 - ta u ktheva në Shkup dhe pesëmbëdhjetë vjet me radhë kam punuar si mësues nëpër fshatrat e malësisë së Shkupit. U habita me gjendjen reale që gjeta mes këtyre maleve. Fshatra të tërë gjatë sistemit komunist ishin të regjistruar si turq e nuk dinin asnjë fjalë turke. Fshati Tisovicë, ku punoja unë komplet ishte shpërngulur në Turqi, dhe pas dy javësh komplet ishte kthyer përsëri në vendlindje, mes maleve. Shumica e këtyre banorëve nuk figuronin në asnjë regjistër, nuk i thirrnin as edhe ushtarë. Poashtu, edhe shumë fëmijë që vijonin shkollimin në shkollë, nuk ishin të regjistruar në asnjë libër

të amzës. Regjistrimi i popullatës gjatë vitit 1981 do të ndryshojë shumë situatën e këtyre fshatrave shqiptarë. Banorët e regjistruar si turq, kësaj radhe u regjistruan shqiptarë. Edhe pse, Shkupi ende ka shumë banorë shqiptarë, që lindin e vdesin pa nënshtetësi, nuk dihet numri i saktë i shqiptarëve në IRJ të Maqedonisë.

Dhe, ja erdhi ajo kohë që na e bënte me dije ai burrë i madh: Mahmut Dumani. Elemente të këtij bërlloku shqiptar, kanë të gjitha partitë tona politike shqiptare. Dhe, nëse këtë bërllok shqiptar secila parti nuk e pastron vetë me kohë nga oborri i saj, shqiptarët kurrën e kurrës nuk do të mund të çojnë krye dhe të jenë të barabartë në këtë shtet të përbashkët “demokratik”.

E para: duhet flakur nga trupi ynë sa më shpejtë këtë gjak të prishur barbari. E dyta: kokat e huaja në qafë duhet hedhur në përrua. Nuk e di, si mund të eci rrugës një trup me kokë të huaj në qafë?! E ne, në mesin tonë kemi plot trupa, që ecin me koka të huaja në qafë. Koka të huaja kemi nëpër parti politike, institucione të shtetit, universitete, mjetet e informacionit... I vetmi popull në botë jemi që ecim këmbadoras rrugës me koka të huaja në qafë. Shkak ky, që na e ngatërron edhe trurin. Këmbët me të cilat zvarritemi rrugës për në Baba Tomorr.

Është koha e fundit, që populli shqiptar të fillojë me pastrimin e gjakut. Kokën e huaj ta heqi nga qafa. Zemrën ta freskoj me gjakun e vet, gjakun e pastër të shqiptarit brez pas brezi. Përndryshe, edhe gjatë kohë do të vazhdojë të eci ferrave me këtë samarë mbi shpinë. Bërllok

shqiptar në lëmë, që përditë ia zë frymën. E ka rrokur për fyti me të dyja duart nëpër shekuj. E ngulfat në mes të ditës.

O burra shqipëtarë! Hiqni bërlllokun nga lëma! Haletë pas shtëpive! Dhe, hudhni samarin e gomarit nga shpina! Mjaftë ndejtët më në guacë mbyllur, në fund të detit!. Edhe sot, edhe dje me eufori patriotike. Përveshni duart, futjuni punës! Mjaftë më e “vratë” shkaun me çifteli nëpër këngë popullore dhe poezi patetike! Fjalët dhe çiftelia, sot nuk bëjnë punë. Edhe armët.

Lufta sot, kërkon tjerë burra mejdani. Tjetër tru e gjak shqiptari...



Fitore DERALLA

RRUFEJA NUK SHTI NË FERRA

Dita si një nuse e bukur zbriti në Liqe. Matanë maleve dyndeshte një mjegull. E tërhiqte veten zvarrë dhe mundoheshte ta shqepë mëngën e setres me arna, që me siguri i kishte ngecur në ndonjë lis. Kësulën e bardhë e kishte në kokë. E tërhiqte veten. E tërhiqte. E dinte se në një përrua do të pi ujë...

Hë?! Frikë keni se mund të shti rrufeja. Hiqeni nga mendët! Qielli është i pastërt lot. Nuk shti rrufeja në ferra. Jo. E lisat nuk e ulin kokën. Rrënjët i kanë shti thellë me vite e vite. Nuk ka kush që i shkul nga Sharri Plak... Korabi... Çelëvjollca... Drenova... Baba Tomorri... Verë e dimër e kanë hapur gjoksin. Vetëm, një gjë e kam borxh t'ua them, mos ua shpaloni plagët!... E them këtë se, mund të rebelohen nga dhëmbjet. Shkunden nga dëbora... Nuk do të dinë në cilën lëndinë t'i pushojnë degët. Me cilët zogjë ta pushtojnë qiellin, kur ende është heret për këngë. E diellin e kemi larg... Larg... Larg...

Përsëri doni të më vëni në gjumë. E hiqni veten si një Nënë. E përkundëni djepin. E këndonin një ninullë:

*"Nina nana po të përkundi
do të të bëj nana plak katundi..."*

E dini çka? Nuk më merr gjumi. Djepi po ma vret shpinën. E kam bërë edhe shurrën... Mutin... Më zgjidhni nga pelenat!... Djepi... Vetëm pak t'i lëviz duart, këmbët. Vetëm pak të shpëtoj nga ninulat... Përkundjet... Ëndërrat e tmerrshme që më rrinë mbi kokë. Atëherë, do të shihni si do ta thej zgjedhën. Nuk do ta tërheq qerren nëpër Bit-Pazar...

Ec pas meje, më tërhoqi me forcë Ebu Dexhalli. Ti e ke humbur rrugën. Nuk e di në cilën dhomë ti kanë shti magjitetë. E ke rënduar veten me mëkate. Njëqind ditë duhet larë në një kusi me ujë. E di, ti do një fuçi me verë. Aty brenda ta kesh edhe një Mike. Vetëm, nuk i meriton gjithë këto shpërblime. E ke ende zgjedhën në qafë. Për samarin dihet, as edhe përpiqesh që ta heqish nga shpina. Edhe në varr do të hysh, po i ngushtë është varri. Nuk të zë me gjithë samar. Jo.

E di çka, i them: samari nuk ma vret shpinën. E kam grepin në gojë me të cilin më tërheqin dhiareve. Nuk besoni? Pse atëherë nuk e hudhni samarin?! Nuk e coptoni frerin. Nuk e thjeni zgjedhën?!... Trembeni nga samarë të rinj?!... Frerë... Zgjedha... O Imzot, si më ikët nga libri! Po, ç'të bëj unë pa ju mes këtyre bërthoqeve? Asgjë. Jo. Jo, nuk mundem edhe unë pa ju. Patjetër, duhet ta shkruajmë librin.

Nata më zuri në një faqe. E thirra në ndihmë E percolla Natën. Ebu Dexhalli më trokiti në xham. E ke kot: me mua do ta shkruash librin. Jo, më kërcnohet, me mua Shtrigani i Allahut! E kam këmbën e mbarë. Bythën e shpërlarë. Mjekarën si

të Dexhallit. Po, mua më duhet penë!... Penë... E
jo bythë si palare...

*Çudi, si se kemi ditur
se Patrioti lind
edhe atë jo në vathë
ose në Shtëpi Publike
po në odë të burrave.*

*E këndeje gjithë jetën
m'i keni shkërdhyer trutë
me vepra "patriotike"
aq sa më vjen t'ua pëshurrë
në Shtëpinë Publike...*


E hapa derën, në dhomë nuk më hyri njeri.
Dritaren kam frikë ta hap lumë miku. Frikë.
Oxhakun e kam të hapur se jam fis kaçaku. Nëse
ua mba, ecni kur të doni me shokë, qoftë ditën,
qoftë natën!...

Dera është e hapur edhe për mikun edhe për
armikun... Oxhaku për kaçakun... Kullën e kemi
edhe për luftë. Vjet për vjet na e kanë djegur
shkrumb e hi, rrafshuar me tokë. Por, pas çdo
djegieje e kemi ngritur përsëri edhe më të fortë.
Edhe me më shumë frenxhi... Mes këtyre maleve
dimërat janë të egër. E ngrijnë çatinë. E përplas
derën. Tymin na e kthejnë prapë në vatër...
Përpiqen të na e rrëzojnë oxhakun mbi çati...

Vetëm, oxhaku ynë gjithmonë tymon drejtë
qiellit. Dollapët kanë vjellë flakë. Trojet tona i ka
shkelur Mbreti... Krali... U kemi dalë para edhe
me sakica... Gërshërë të dhenëve... Mauzerre...

Nuk trembem unë nga këto këngë patriotike me çifteli, tha Buça e Katundit. Ec pas meje t'i dalish zot Atdheut me ilahi! Nuk e sheh se po hyn në varr pa din e iman. Ku i ke sytë? Ku i ke këmbët? Trutë nuk të duhen në kokë. Hë çka nuk të pëlqen? Apo nuk ta mban si njeri i kalemit? Fis i kaçakëve... Nuk je i vetdijshtëm se më shurdhove më me atë Mike. Edhe me verën... Rrapin... Vendin e ke në Xhehenem. Edhe atë, si arnë kazani... Rrapin duhet prerë me gjithë rrënjë!...

Hi-hi-hiii... Po, nuk keni sëpatë... Ju mendoni se gjithëmonë do të jetë verë... Po, çka do të bëni në dimër... Punë e lehtë, do të të kërkohmë ty një kaci shpuzë. Zjarrë?! Jo, nuk u jap zjarr. Jo. Rrini në Xhehenet!...



V NUK TË ZË NËMA E NJERKËS
PO NËMA E NËNËS

**GOMARIN QË E HANTE UJKU
THA: ËSHTË ËNDËRR**

E pamundshme, këtij rrëfimi nuk i beson njeri i gjallë në botë! E për sa u përket të vdekurve, atyre burrave e grave mes varreve, ndoshta po, ende kanë besë. Edhe po t'u thuash se, para njëzetë vjetëve këtë grep të sllavëve ua ka bërë me dije dikushi në Shkup, thonë është rrenë. E sot mu ata patriotë të vonuar, që në atë kohë hudhnin gurë e dru mbi atë shkrimtar, përçudi sot në mesditë u ka dalë gjumi. Sytë i fërkojnë me duar. E hapin dritaren. I mbushën gazetat e përditshme dhe mjetet e informacionit me lotë krokodili. Patriotizëm të vonuar, struktur brez pas brezi nëpër parti politike.

Shkrimtari u thoshte qysh në atë kohë nëpër shkrimet e tia mes rreshtave, librat e tij të “rrezikshëm” se: Shkupi është kryeqendra e shqiptarëve. Dhe, është qyteti i dytë i banuar me shqiptarë, pas Tiranës. Shkupi në të ardhmen, mund të bëhet edhe kryeqyteti i Shqipërisë. E patriotët kuqezi jo dhe jo, flet jerm ky shkrimtar: rrëfen përralla. E kemi në kryeqytetin e shqiptarëve: Tetovën dhe Zajazin. Edhe u futën nëpër kotecet e pulave të këtyre qyteteve e katundeve me gjithë parti politike. Universitete privat e shtetëror. Institucione kulturore. Shoqëri

kluturo – artistike. Xhami myslimane me dy e katër minare...

Shkrimtari vazhdoi me punën: shkrimin e librave, organizoi në Shkup disa manifestime kulturore tradicionale. Përuroi nën Rrap disa libra e revista letrare. E ringjalli Çarshinë e Vjetër, rrëzë kalasë që përditë e më shumë jepte shpirt. Njeri i gjallë nuk e rrokte çiftelinë, lapsin t'i thotë dy tri fjalë. Dhe, për herë të parë hyri vargu shqip në Bit – Pazar me poetë më të njohur nga të gjitha trojet etnike shqiptare. E ata, pësëri hodhën gurë e dru mbi këtë shkrimtar. E akuzuan: spiun, tradhtar e armik të Shtetit te Paria. U përpoqën t'i ngulfasin, shuajnë këto manifestime kulturore. Librat dhe revistat letrare t'i rrokin për fyti. Emrat edhe kësaj radhe nuk i përmend, e di lexuesi i shkrimeve të mia mes rreshtave këta heronj me një torbë taxhi për qafe. Vetëm, çuditem me këta patriotë të vonuar kuqezi, që me kaq vonesë e kanë kuptuar se, gomarin e hanë Ujku. Njëri pas tjetrit, sot radhiten në mjetet e informacionit, shtyhen me bërryla e bythë pa fije turpi e përgjegjësie si patriotë të vonuar kundër projektit të Qeverisë: Shkupi 2014. E gomarin që e hanë Ujku, ende përgjumshëm thotë: është ëndërr.

Përçudi, sot u ka dalë gjumi. Jo, o patriotë të vonuar kuqezi: nuk është ëndërr. Është realiteti që u ka lënë pa këmbë e bythë. Edhe ju, sot pas njëzet vjetëve e keni kuptuar se nuk është ëndërr. Vonë. Fatkeqësia, është pse nuk e keni kuptuar dje. Thirrjet që ua bënte me shokë përmes vargjeve ai shkrimtar nën Rrap. Është punë tjetër,

ajo thirrje nga varret me të cilën në të ardhmen do të merret historia.

Përmëkeq, ende jeni në gjumë: merreni me reagime e protesta në rrugë. Rrëzime të mureve të improvizuar te Ura e Gurit. Manifestime të politizuara deri në pacë, gjoja kluturore sa për sy e faqe para këmbëve të Skenderbeut. Ndërtimin e xhamive myslimane. Kohë, kur shkollat shqipe ende i keni pa kulm mbi krye. Nxënësit pa libra në klasë. Mësuesët pa planprograme shkollore...

E në anën tjetër, fotografoheni para kamerave televizive në tribunat “shkencore” që i organizon Unioni i viçave. Shisni mend nëpër gazeta. E ngreni zërin për Atdheun: shkau po ua zë frymën me beton, përmendore antike e ndërtesa kulturore mbi kokë...

Hi-hii-hiii... Viçat e mi të palëpi, që njëzetë vjet keni bërë gjumë arushe nëpër parti politke, Qeveri, ministri, universitete, kabinete... I bletë diplomat dhe titujt universitar ku mundët e arritët: në “Shën Kirili e Metodi”, në Qafë Thanë e Bullgari. Thoni: sot u ka dalë gjumi. Zjarr e flakë nxirrni nga goja për Shqipëri Etnike. E në anën tjetër, mu ju o viça të palëpi na keni shitur “toptan” për njëzet vjet rresht me radhë shumë lirë te “vëllezërit”. Ju, ishit ata që deri dje propagandonit “vëllazërim – bashkim”. Bashkëjetesë. Maqedoni të Madhe...

Vetëmse, përsëri vonë e kuptoni alarmin e kohës, nuk i dëgjoni thirrjet e shpëtimit para Kiametit – Përmbytjes së madhe. Nuk i lexoni shenjat, zërat që na i dërgojnë nateditë të vdekurit nga mesi i varreve. Ujku më, gomarit ia ka hëngër

këmbët dhe bythën. I kanë mbetur edhe veshët. E të shohim nesër pas zgjimit, a do t'ia shpëtojmë kokën gomarit...

Bishtin matanë Urës së Gurit ia kanë përvetsuar luanët në breg të Vardarit... Nesër, ku ta dimë ne mund t'i bëjnë edhe këtij heroi legjendar përmendore krah për krah me Alaksandrin e Madh në sheshin "Maqedonia". Ose: do ta thirrin në dasëm tu barti ujë komitave për beteja të reja heroike. Emër t'i gjejnë shtetit më të ri në Ballkan, pagëzojnë te kisha ortodokse: "Shën Nikolla", që është në ndërtim e sipër rrëzë këmbëve të urës së Gurit, në breg të Vardarit. Bythekrye të kërcejnë "patriotët" nga Ura e Gurit në lumë ta nxjerrin kryqin nga uji. Dyert t'ia hapin krah më krah për në Bashkimin Evropian.

Kokë më kokë të rri me ata burra mejdani me kuaj shale e më këmbë edhe Gomari ynë patriot me samar, në sheshin "Maqedonia"...



Fitore DERALLA

NË KOMUNIZËM “SHQIPTAR I NDRSHËM” “PATRIOT” NË DEMOKRACI

Në kohën e komunizmit, në periudhën më famëkeqe për shqiptarët e Jugosllavisë, kishim komunistë... Ballistë... Spiunë... Patriotë... Opurtunistë... “Shqiptarë të ndershëm”... Nacionalistë... Irredenistë... Separatistë... Dhe, armiqë të rrezikshëm brez pas brezi të shtetit...

Tashti në “demokraci”, kemi vetëm patriotë. Edhe atë: “pëllumba postier”, që në mes të ditës na i flukin kopilat pas dere. E mua, më ka marrë malli për spiunë... “Shqiptarë të ndershëm”... Jo, se tashti nuk i kemi prezentë në këtë shoqëri “demokratike”neokomuniste... Shtet policor... Parti politike... Institucione të shtetit... Universitete shtetëror e privat... Shkolla... Drejtori të manifestimeve kulturore... Mjete të informacionit... Gazeta... Internet... Libra... I kemi, si nuk i kemi... Edhe atë, me shumicë e pakicë, si patate të kalbura nëpër tezgja në Bit - Pazar... Po, tashti të gjithë e kanë vënë maskën e patriotit. Kësulën e bardhë në kokë. Flamurin kuqezi në dorë. Shkurt, gjatë ndryshimeve demokratike brenda natës u shndërruan në kamelonë. E kanë ndërruar ngjyrën, po jo edhe veprimet “patriotike”... Hujin e vjetër legjendar brez pas brezi si spiunë të Policisë Letrare...

Përditë i sheh nëpër mitingjet e partive politike... Zbulimin e përmendoreve të dëshmorëve të Luftës... Përpara këmbëve të

Hoxhës në xhami... Emisione dokumentarë të dramatizuar në MTV, që për nga “patriotizmi” e kalojnë edhe Skënderbeun, Ismail Qemalin, Bajram Currin, Isë Boletin, Fan Nolin, Hasan Prishtinën, Kalosh Zajazin, Sulltanë Qafën, Azem e Shotë Galicën, Adem Jasharin...

Krekosen, luajnë role të të përndjekurve politikë, aq shumë të “përvuajtur” në kohën e komunizmit si: politikanë, poetë, gazetarë, redaktorë e profesorë universiteti... Lotët u shkojnë rrëke për faqe, sa që edhe ne që i kemi njohur në atë kohë e i njohim sot këta dumdumë, na dhimben si “viktima” të komunizmit... Ndonjërin, e shohim të dalë në fushën e mejdanit edhe me ndonjë libër kuqezi me vjersha, ku u këndon prijësve të UÇK-së... Komandantëve të luftës, të gjallë e të vdekur duke i radhitur njëri pas tjetrit me vargun antologjik:

*“Të gjithë këta trima shqipëtarë
hynë në histori,
e dhanë jetën për liri...”*

Ose, tjetri duke vjellur zjarr:

*Derrat e Karpateve le të dalin në dyluftim
me mua që parti më parti u hodha si trim!*

*Mjaft më gjatë fushatave rash mes minash
mjaft më karakurva me kopila shkinash!
Erdhi koha të rrokem fytas me makosllavët,
si trimat e Prekazit ku luftuan Jasharët!*

*Gjithë jemi Mic Sokola, e rrokim për fyti topin
Sv. makosllavët n'Kaukaz, s'e japim Shkupin!*

E ngrejnë lartë në qiell zërin për liri...
Flamurin kuqezi... Gjuhë shqipe... Kosovë...
Shqypni Etnike... E vrasin dhe e presin shkaun...
Shkinat... Mezi i zbresim nga binat... Foltoret...
Emisionet televizive... Faqet e gazetave...
Interneti... Gjakun e derdhin lumë... E heqin veten
si te ajo kënga popullore: *Kaçanikut i raftë pika/
nëntë sahat u ther me thika!*... Jetën e “japin” për
liri e Shqipëri Etnike...

Dhe, të nesërmen nga ky zjarr i ndezur nga
“patriotët” e këtij soji, këngëtari popullor i Tun
Batunit nëpër oda e koncerte në sallë, e bënë
çiftelinë copë-copë... Tym e flakë nxjerrë nga
goja... E ka nxjerrë shpatën e Skënderbeut nga
brezi... Topin e Mic Sokolit për liri... Dy koburet
e Isë Boletinit... Mitrалozin e Adem Jasharit me
dy këmbë... E bën Shqypni Etnike...

E, Im Atë shpesh e përsëriste një urti
popullore: *uji që nuk ecën, nuk pihet!*... Dhe, unë i
biri i tij sot bëj një krahasim me partitë tona
politike shqiptare. Imzot, janë si uji që nuk ecin
mes shelgjeve. Vite me radhë janë hurdhja, ku
notojnë të njëjtit individë politik me brekët mbi
pantollona. E mirreni me mend, çka mund të
jetojnë në hurdhja. Gjithëçka, lloj-lloj gjallëresash
me dy e katër këmbë, përveç peshqëve.

Hurdhat tona janë mbushura me gjarpërinj...
Bretkosa... Mushkonja... Grerëza... Bumballa...
Breshka... E hanë njëri tjetrin për të mbijetuar në
hurdhë. Zvarriten nëpër kënetë... Shumohen... Herë

pas here dalin në diell... Rreziten... I kërcejnë njëri tjetrit edhe në shpinë... Ose, qafë. U pëlqen uji që nuk ecën, nuk pihet... Hurdha... Kallamishtet... Bërlloku... Xhirizi... Barishtet... Vendi ku gjallërojnë, marrin frymë dhe fshihen vite me radhë nga sytë e popullit... Luftojnë për pozita politike në Qeveri... Vite me radhë humbin e “fitojnë” në zgjedhjet lokale e parlamentare...

Përditë themelojnë parti te reja politike... Përsëri, dalin në zgjedhje... E “fitojnë” pushtetin... Brez pas brezi argatë në Qeveri. I ngrejnë gishtat në Parlament... E “sjellin” ligjin për flamurin kuqezi... Gjuhën shqipe... E realizojnë marrëveshjen kornizë të Hurdhës... I dalin zot arsimit... Kulturës shqiptare... Popullit... E kanë televizorin e vet të Hurdhës... Radion... Gazetat e pavarura... I hapin dritaret... Fotografohen qafë për qafe para kamerave televizive...

Dhe, këndojnë për liri: guak... Guak... Guak... E thirrin Lejlekun... Haxhibekun tonë që ia thotë këngës mbi oxhak... Lisa... Ka-ka-kaaa... ta pastrojë Hurdhën... Gjuetarin, që me çifte në dorë i turret pas një pate të egër...

E, im Atë, shpeshherë thoshte në odën e burrave: *uji që nuk ecën, nuk pihet...*

**PËR ÇFARË “REPUBLIKE TË TANUSHËS”
SHKRUAN KY DUMDUM MELEZ -
“SHQIPTAR”**

Shqiptarët nuk kanë nevojë më të bëjnë luftë e shpallin republika nëpër katunde të malësisë me dy-tre banorë. Shkaku se: kurrë deri më tani, nuk kanë shpallur republika nëpër katunde. I kanë shpallur dy republika: Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Në rrugë janë edhe Republika e Maqedonisë dhe ajo e Malit të Zi...

Problem i shqiptarëve është si të shpallet: Shqipëria Etnike.

E për çka shkruan në gazetë dhe derdh lotë krokodili ky Dumdum melez – “shqiptar”: “Republika e Tanushës”???!!!...

Jo, për inatë të Patriotit Melez nuk e shpallim “Republikën e Tanushës”. Shkaku se, i kemi në plan shpalljen e disa republikave në rrugë: Shqipëri Etnike.

Përditë i dëgjoni patriotët melezë: Njëri shpallë “Republikë të Tanushës”. Tjetri: “Janë të harxhuara politikat e Ali Ahmetit dhe Menduh Thaçit”. I treti: ... E ku ta di unë, çka mund t’u teket atyre trusakatëve të shkruajnë e deklarojnë në mjetet e informacionit. Vetëm, politikat e patritotëve melezë, flijimet e tyre “artistike” nëpër organizata “joqeveritare”, sipas tyre nuk janë të harxhuara edhe sot e kësaj dite.

Në rregull, them unë: Falë Zotit, që erdhi Dita e Madhe ta vëndojmë në sheshin

“Maqedonia” përmendoren e Aleksandrit të Madh me gjithë kalë. Po, çka kanë kundër BDI dhe Demokracia e Re?! Pse bëjnë ish, kur nuk u hy pula në arë?! Në vend, që ta përshëndesin këtë hap historik, t’i urojnë Aleksandrit të Madh mirësesrdhje në sheshin “Maqedonia” në Shkup, ata dalin me deklarata teknefese. Përmëtepër, duhet t’i përveshin pantallonat deri në gju, mëngët e këmishës deri në bërryla, edhe Skënderbeun ta nxjerrin nga parkingu i makinave në Bit – Pazar matanë Vardarit, të rri krah për krah me shokun e luftës siç i ka hije.

Çudi!? Përsëri them: Thyeni qafën patriotë të vonuar melezë! Nuk na duhen republika të katundeve pa banorë. Nuk na duhen parti të reja politike. Nuk na duhet luftë. Po, na duhet ekonomi e zhvilluar, arsim, kulturë!...

Maqedonia, duam ne ta pranojmë, apo nuk duam, është në gjysëm protektorat. Fatkeqësi e madhe që nuk e shohin këtë partitë tona politike shqiptare, e as analistët tonë gjysëmanalfabetë. Edhe Kosova e “pavarur” është në protektorat. Rrezik i madh është, që edhe Shqipëria të hyj një ditë në protektorat!...

O shqiptarë të ngratë, siç do të thoshin rilindasit tanë po të ishin sot gjallë, “leni kisha e xhamia”, po mblidhni mendtë në kokë! Dhe, bashkohuni në Ditën e soçme, që është e shqiptarëve! Protektorati është fundi i kësaj politike shterpë, siç është pika në fund të fjalisë. Njëzetë vjet nuk kemi pika, kemi vetëm presje, dy pika, tre pika. Prandaj, jam i mendimit t’i vëndojmë pikë politikës shterpë të partive tona

politike shqiptare, siç i vëndojmë në fund pikë fjalisë. Shkaku se, nuk jemi të barabartë me “vëllezërit”, as në ekonomi, as në arsim, as në kulturë. Nuk kemi çka të humbim më, ne shqiptarët. Humbje do të pësojë pala tjetër e përkëdhelur sllavomaqedone.

E nisim nga fillimi!

E ka thënë këtë edhe Menduh Thaçi: Maqedonia në protektorat! E ka zënë pulën në Lëmë. E dini pse e them këtë?! E them se, maxhatorja kur do ta zë pulën për ta therë, këpusë kokën për miqtë që i kanë trokitur në shtëpi, e ndjek në anën e kundërt drejtë gardhit. E thotë me vete: Dhashtë Zoti, do ta zë në këtë anë, në qosh të avlisë te pulaniku!

Maqedonia i ka harxhuar të gjitha letrat e lojës. I ka mbetur edhe letra e fundit. Me këtë letër të fatit edhe luan në tavolinë me Bashkimin Evropian. Fundi i kësaj letre të fatit mund të jetë katastrofal për Maqedoninë. Faji në fund, nuk duhet t’u mbesë shqiptarëve. Njëzet vjet përpëlitet në shtrat si e sëmura e Evropës. E ka kancerin. Dhe, nuk ka mjek që e shëron dot, e ngre më këmbë. Prandaj, ilaçi i fundit është: Protektorati i Menduh Thaçit. Ndofta e shpëton nga Zonja Vdekje. E çka duhet të bëjnë Partitë Politike Shqiptare? Asgjë më tepër, përveçse ta përkrahin protektoratin e PDSH – së, Menduh Thaçit për Maqedoninë, t’ia kthejnë shpirtin.

Ndofta e shpëtojnë Maqedoninë nga varri...

Vështirë e kemi edhe sot, ta hudhim qafe mentalitetin e halldupit pesqindvjeçar. E kemi pranuar si popull me dhunë apo me dëshirë fenë

islame. Një pjesë e popullit shqiptar edhe veshjen dhe zakonet. Fat i yni, që nuk jemi asimiluar plotësisht si popull. Kulminacioni: Edhe të sllavit, që ende e kemi mbi kokë e shpinë me vite.

Dhe, fundi: nuk do të merrem më, humb kohë me kësi dumdumësh melez - “shqiptarë”. Nëse, ndonjë ditë arrini të keni më të mençur se soji i këtillë melez “shqiptar” me brekët mbi pantallona, m’i dërgoni nëpërmejt mjeteve të informacionit: televizionit, gazetave, internetit...

Dhashtë Zoti i Madh, të jemi shëndosh e mirë! Dhe, me siguri edhe atyre “dëshmorëve” të Lirisë do t’ju përgjigjem një ditë...



HOXHA ME KËSULËN E BARDHË TË BAJRAM CURRIT

Fatkeqësisht, pas kësulës së bardhë, ngjyrave të flamurit kuqezi, historikisht, në shumë raste janë fshehur spiunët. Edhe ata pak patriotë që i kemi patur me kësula të bardha në kokë e ngjyra kuqezi, na i kanë marrë në qafë halldupët e Baba Dovletit. E më vonë edhe argatët besnikë të komunizmit. Kohën e fundit edhe partizanët e partive politike “demokratike”.

E mos të flasim për kësulat – lecka të zeza, të bardha e fesat e kuq të turkut, që edhe sot e kësaj dite i shohim se si shëtiten në rrugë, nëpër Qytet. Nuk kanë asgjë të përbashkët me kësulat e bardha shqiptare. Shkaku: nuk do të merrem në këtë shkrim me këto kësula të halldupit. E them këtë se: vetë e kam parë me sy dhe e kam njohur mirë një hoxhë patriot shqiptar, që në vend të çallmës, në kokë gjithë jetën e ka mbajtur me krenari kësulën e bardhë të Bajram Currit.

Shqiptarëve u duhen hoxhallarë të këtij niveli patriotik, që kanë pi ujë dhe kanë hëngër bukë me Asdrenin. Hoxha në fjalë ka punuar në Rumuni kokë më kokë me patriotët e atjeshëm rilindas shqiptar. Shkaku i këtij Hoxhe patriot, Asdreni në atë kohë edhe e ka vizitur Kërçovën, fshatin e Hoxhës me kësulë tëbardhë.

E kush ishte Asdreni? Poet dhe patriot shqiptar, që punonte, vepronte dhe jetonte me shokë të penës dhe mëndjes në Rumuni. Autor i

Himnit të flamurit kombëtar. Ende i mbaj mend vargjet e tij kushtuar Kosovës. Vjershë që në atë kohë, pas Luftës së Dytë Botërore tek ne nxënësist e shkollës fillore qarkullonte dorë më dorë. Dihet, në libra të këndimit me të cilët kishte mësuar im vëlla, pas lufte. Dhe, ja tashti më kishin rënë në duar mua si fillestar që posa i mësonte shkronajat e gjuhës shqipe. E qartë, nuk i kishim në shkollë ato libra: Këndimet e para në plan - programet shkollore, po ja fati im që mua më kishin rënë në dorë. Mes atyre faqeve për herë të parë jam takuar me Niamin, Fishtën, Asdrenin, Çajupin, Ndre Mjedën, Filip Shirokën, Luigj Gurakuqin, Hil Mosin, Ali Asllanin, Vaso Pashën, Fan Nolin... Dhe, Prej Shkëndisë, një pseudonim i asaj kohe në Librat e këndimit. Që, unë si shkrimtar edhe sot e kësaj dite nuk e di se, kush është fshehur pas atij pseudonimi letrar.

Kurrë, nuk mund t'i harroj edhe vargjet e Asdrenit kushtuar Kosovës. Vjershë të cilën unë më vonë më kot e kam kërkuar nëpër libra, qoftë në kompletin e veprave që i botoi "Rilindja" nën përkujdesjen e Rexhep Qoses në Prishtinë, e as nëpër libra e përzgjedhje që botoheshin më vonë në Tiranë. Vjersha, vëretetë ishte e fuqishme për Kosovën. Vargje të cilët unë në atë kohë si fëmijë, nën hijen e Lisit të midis livadhit i lexoja me zë, mes shelgjeve. Ende, pas pesdhjetë vjetëve i kam në kokë. Unë, që e pranoj publikisht se, gjatë shkollimit tim në Kërçovë, Shkup e Prishtinë, e kam patur problem t'i mësoj vjershat e poetëve përmendësh dhe të nesërmen t'i recitoj para mësuesit. Vetëm se ja, disa vargje të kësaj

vjershe, që kurrë nuk mund t'i harroj, nuk më hiqen nga mendja:

*Më një anë serbët, bullgarët
Grekët, duan emrin me ia zhdukë
Me e vdekë pa ujë e pa bukë.
O shqiptarë, kapni hunj e shpatë
Ta shpëtojmë Kosovën e ngratë!...*

Lexuesi i nderuar të më falë për gabimet teknike, ose ndonjë fjalë që mund ta kem harruar pas një kohe kaq të gjatë pesëdhjetë vjeçare. Shkaku se; ajo vjershë pas asaj kohe më kurrë nuk më ka rënë në dorë. E ka pasur edhe vargje të tjerë e strofa. Bastisjet e shpeshta të shtëpive në atë kohë kanë qenë të herë pas hershme, mos them të përditshme. Frika, që mos të na i gjejnë ato libra në shtëpi, nuk e di se kush dhe ku i arratisi si “libra të rrezikshëm”.

Edhe sot e kësaj dite i kam të freskëta fjalët dhe veprimet e atij patrioti shqiptar që kishte kaluar kohë kokë më kokë me Asdrenin. Rugët e tia patriotike katund më katund, ku shërbente edhe si hoxhë. E donin të gjithë: edhe fëmijët, edhe fshatarët. Fjalë miradije dëgjoje kudo për këtë hoxhë dhe në Strugë, edhe në Kërçovë, ku punoi me nderë gjithë jetën si hoxhë. Më kujtohet një rast, kur erdhi edhe tek ne në shtëpi, në Katund. E kishte sjellë rruga atypari duke u kthyer nga një fshat tjetër malor. Fëmijë kam qenë atëherë, posa i bëja hapat e parë në shkollë fillore. Nusja e vëllait, kur e pyeti sipas zakonit: Hoxhë efendi, a do një kafe? E ai iu përgjigjë

plumb: po, vetëm pas buke. Vëllai e kuptoi aty për aty përgjigjen e hoxhës. I tha së shoqesh: grua, vrik shtroje sofrën, vëndoi bukë hoxhës se vjen nga rruga!

Ende nuk mund ta harroj dot edhe këtë histori: një fshatar që kishte shkuar te hoxha t'i bëjë hajmali lopës, shkakun se kishte shterë, nuk kishte tëmbël. E dini si iu përgjigjë hoxha?! Jo, nuk e dini. I tha fshatarit, që me paratë e hajmalisë që kishte vendosur t'i jepte hoxhës, t'i blente një thes krunde për lopën. Dhe, pas një jave të vinte prapë te hoxha t'i rrëfente, a kishte lopa tëmbël ta mbushë kusinë, apo jo, atëherë do t'i bënte një hajmali.

Një rast tjetër, kur e pyet një fshatar në xhami: hoxha efendi, jemi në muajin e ramazanit. E unë me gomarët kam shkuar për dru. Në mal bënë vapë e madhe. Aty pari gurgullon një gurrë me ujë si loti. E mua më ka kapluar etja, më pihet ujë. A është haram të priset ramazani të pijë pak ujë? Jo, i përgjigjet hoxha. Nuk është haram. Tekefundit, është edhe sevapë të pish ujë në mes të malit. E rëndësishme është, familjes dhe fëmijëve t'u dërgosh dru në shtëpi për dimër.

Këshillën e Hoxhës me kësulën e bardhë të Bajram Currit, një ditë prej ditësh e dëgjon edhe Qeshafi, hoxhë me shumë autoritet për myslimanët në rrethin e Kërçovës. E pyet një besimtar nga xhemati në xhami: hoxha efendi, ndodhem në mal duke pre dru në muajin e ramazanit. Vapë e madhe. Papritmas, më kaplon etja, më pihet ujë. Para meje gurgullon burimi me ujë të ftohtë akull. A është haram të pij ujë? Po, i

përgjigjet shkurt, Qeshafi. Nuk priset agjërimi në ramazan, është haram. E Hoxha i Kërçovës me kësulën e bardhë të Bajram Currit u ka thënë në xhami xhematit se ka edhe përjashtime, mund të pini ujë, nuk është haram. Mos e dëgjoni çka thotë atë qafir, ai është hoxhë Rumunie e nuk është hoxhë Turkie!

Dhe, pas një kohe, një ditë Qeshafi e takon në rrugë Hoxhën me kësulën e bardhë të Bajram Currit. E ndal në mes të rrugës. Plot inatë i sulet me fjalët: pse bre hoxhë i ke thënë një besimtari të pij ujë në ramazan se, nuk priset agjërimi?!

Epo, si është sipas teje më haram, hoxha efendi?! Fshatari, që ka shkuar në mal për dru, të pijë ujë dhe t'i sjellë drutë në shtëpi për fëmijët e familjen për dimër, apo të mbajë ramazan e të vdes për ujë në mal?!

Qeshafi mbeti pa fjalë, e uli kokën. E pa se kishte të bënte punë me Hoxhën e Çelvjollcës. Patriotin, që në vend të çallmës mbante në kokë kësulën e bardhë të Bajram Currit. Burrin, që kishte pi ujë e ngrënë bukë kokë më kokë me rilindasët shqiptar në Rumuni...

Shtigranët e Allahut me çallmat e halldupit në kokë, kur e takonin në xhami ose rrugë, shpeshherë edhe e ngacmonin me fjalë Hoxhën e Çelvjollcës me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë: Ehu, bre Hoxhë efendi, si e dhatë mbesën te njeriu që vishet këmbë e kokë në të zeza?! Përmëtepër, mbanë edhe shapkë të zezë në kokë. Gunën e zezë deri në fund të këmbëve. Kulminacioni: edhe mjekër të zezë.

Hoxha i Çelvjollcës me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë, pasi buzëqeshte, u përgjigjej me ironi: kur ka qenë i ri edhe Muhamedi a. s. ka mbajtur mjekër...

Hoxha i Çelvjollcës, më ktheu prapa pesëdhjetë vjet, në kohën e fëmijërisë, ditët e para në bankat shkollore. E kisha patur fatin, që unë me shokë e shoqe ta kemi edhe si mësues të artit figurativ në shkollë filllore djalin e tij, mësuesin e artit figurativ, që nuk e fillonte orën e mësimit pa na i recituar vargjet e Çajupit për Sulltanin:

*Jam Sulltan, mbret i vërtetë,
Shoq të tjerë s'kam në jetë;
Gjakëtor e zemërderr,
Nga frika më bëjnë nder.*

.....
*Keshë kompn'e Shqipërisë
Direk i gjithë Turqisë,
Pse s'më priti sa të vdesë,
Pa të më dil i pabesë!
Me Shqipëri të luftonem
Kam frikë mos turpëronem,
Kam frikë nga Skënderbeu
Mos dalë prapë nga dheu!...*

Në fund: si t'i dua këta shtriganë të Allahut me çallma të halldupit në kokë edhe në këtë kohë, kur nuk m'i ka dashur katragjyshi, stërgjyshi, gjyshi, babai????!!!...

EDHE HOXHA VENDOS PËR VLERAT E SHKRIMTARIT DHE KULTURËN SHQIPTARE

Thashë: Trusakatët kulturën shqiptare e kanë bërë si gomarin e Nastradin Hoxhës. I zbret Nstradini, i hip Nastradinica. Në këtë rast, i zbret Bozaxhiu, i hip Hoxha. Edhe atë: Myslimani më i madh, Hoxha që kërkonte në sheshin “Makedonija” të ndërtohet Burmali Xhamia, më në fund u bë “shqiptar”. E shiti Burmali Xhaminë për një anëtar komisioni dhe vendosi të merret me vlerësimin e shkrimtarëve dhe kulturën shqiptare. Papritmas, u arratis në Minisitrinë e Kulturës si anëtar komisioni në një tavolinë ballë për ballë me dy shkrimtarë sllavomaqedonas në botimin e librave në gjuhën shqipe. Ose: fluturoi si Azreti Isai nga minarja e xhamisë në qiell.

Gabim. Gabim i madh, që nuk e tërheqin as qetë në Katund. Edhe Hoxha pas Bozaxhiut, vendos për vlerat e shkrimtarit dhe kulturën shqiptare?! Edhe një gjë nuk e kam të qartë: si ulen ata dy anëtarët tjerë shkrimtarë sllavomaqedonas në një tavolinë me një hoxhë?! Shkaku: çka i lidh këta kalorës të arratisur kokë më kokë të vendosin për kulturën dhe letërsinë shqiptare: tradita, zakonet, gjuha, kultura, letërsia, partia, interesi personal... Apo? O njerëz, u thashë: Qysh para një viti, mos dërgoni më trusakatë pa asnjëfarë bagazhi letrar nëpër institucionet e shtetit të ulen në një tavolinë, rrinë

ballë për ballë me personalitete të dëshmuara të kulturës sllavomaqedonase. Po, dërgoni ujqër në Ministrinë e Kulturës! Ujqër. Ujqër, në vend të këlyshëve me zgjebe. E ata, si për inatë: pas Bozaxhiut e dërguan edhe një Hoxhë pa asnjëfarë bagazhi letrar. O Imzot!: Hoxha sikur ta thirrte xhematin në Sheshin e Shkupit, siç e thirri në mjetet e informacionit për xhami: t'i luten Allahut për ndërtimin e shkollave shqipe! Edhe unë do të dilja t'i lutem Zotit për mëkate.

Mjerim. Mjerim i madh kombëtar. Çfarë di Hoxha për letërsinë dhe kulturën shqiptare, që kurrë në jetën e vet nuk ka shkruar së paku edhe një varg, përveç këndimit të ilahive?! Nuk di çka është letërsia: poezia, tregimi, romani, drama... E kënaqi në xhami me ilahi Haxhi ish Ministrin e Kulturës, e shi tashti i ka mbetur peng lufte partiake edhe letërsia dhe kultura shqiptare të sakatohet në qilimat e Persisë përpara këmbëve të këtij Hoxhe të Allahut.

Vërtetë, e ke vështirë të gjesh rrugë mes këtij bërlloku që ta zë frymën, kur Bozaxhiun një ditë e zëvendson Hoxha. Dhe, të duket e kotë në një shtet të këtill “demokratik”, shoqëri multietnike ta rrokësh penën në dorë për liri krijuese. Përpiqesh, të vëndosish rend dhe rregulla në kulturën shqiptare. Vlerat artistike, kur dumdumët i barazojnë me specat, patlixhanat dhe patatet nëpër thasë të grisur plot arna, në Bit – Pazar. I kanë rrokur thasët me të dyja duart për fyti gjysmanalfabetët, njerëzit e soçëm me tru të moçëm turku. Trusakatët me çallma në kokë e Kuran nën sjetulla.

Megjithatë, ti nuk je poet që flen rehat në shtrat, në kokërr të shpinës mes dy shtambave me verë të kuqe qafë për qafe me Miken. Bozaxhinjt dhe hoxhallarët, kur vendosin për vlerat e shkrimtarit dhe kulturën shqiptare. Shkaku se, gjithë natën nuk të merr gjumi. Dexhalli, pasmesnate të troket në derë.

Rrugaçët kuqezi, që përditë ndërtojnë xhamia në vend të shkollave. Edhe në rrugë i luten Allahut, i falin të pesë vaktet se gjoja, nuk i nxe Shtëpia e Allahut. E thirrin Allahun jo nga minaret, po nga shejtanarapët. E në anën tjetër, nuk kanë shkolla fillore. Mësuesë. Tekste shkollore për fëmijët e tyre, që ky dimër me gjithë borë u ka hyrë në palcë, u është ulur këmbëkryq edhe nëpër shtëpia.

Vëllaçko, lëri Muzetë e “Lirisë”! Institutin “Pjetër Bogdani”, Muzeun e Alfabetit. Xhamitë me dy e katër minare! Kishat ortodokse. Kryqin e madh në Vodno. Fëmijët tanë nuk kanë të hanë edhe bukë. Shkolla fillore. Mësuesë. Banka dhe karrige. Dërrasë të zezë. Libra... Punët shkojnë me rend, thotë populli. Të parët tanë, para së gjithash janë marrë me fëmijët. Ardhmërinë tonë të nesërme: shkolla, libra, fletore, lapsa... E pastaj për armë. Luftëra. Vatan...

Fatkeqësisht, politikën e keni kapur nga këmbët për bishti e jo nga koka, për brirësh. Provoni një herë ta kapni nga koka, për brirësh! E di, e keni vështirë me këtë kurvë azgane. Shkaku: i ndërron përnatë burrat. Dhe, të nesërmen ende pa dalë drita ua lë kopilat para dere.

Imzot, Hoxha vendos për vlerat e shkrimtarit dhe kulturën shqiptare????!!! Nuk e marr me mend se, si do të kapërdihej kjo bajgë partiake, po të ndodhte si problem i këtillë teknefes në botën demokratike perendimore. Përmëtepër, nëse “vëllezërve” ju dërgonte partia e tyre demokratike një tokmak vathe të këtillë, për vlerat e arrira artistike të shkrimtarit dhe kulturën sllavomaqedonase të vëndos prifti. Këlyshi i Llagut e di, do të thoshte: nuk ka problem, kur ka vendos bozaxhiu, pse të mos vëndosi edhe ky halldup i Allahut me çallmë në kokë. Vetëm, me një vendim të këtillë partiak nuk do të pajtoheshin kurrën e kurrës intelektualët sllavomaqedonas. Po, ja që intelektualët shqiptarë pajtohen: për shkrimtarin dhe kulturën shqiptare të vendos edhe Hoxha. E ka propozuar Nusja kuqezi e Partisë dhe aminin ia ka bërë Partia më e madhe “demokratike” shqiptare, të cilën e polli lufta për të drejta kombëtare dhe zbriti nga malet. Thirrjen e shenjtë në minare ta zëvendsojë me vlerësimin e shkrimtarit dhe kulturës shqiptare. Edhe atë, kur e di se në xhami e pret Haxhi ish Ministri i Kulturës t’i fali pesë vaktet e namazit. Xhemati, me tespihe kuqezi në dorë, poashtu pret t’i lutet Allahut përpara këmbëve të këtij Hoxhe “shkrimtar - shqiptar”.

Atëherë, çka kërkon ky shërbetor “besnik” i Allahut si argat i tretë në komisionin e botimeve në Ministrinë e Kulturës, vlerësojë letërsinë dhe e di, trusakatët do të thonë e ka dërguar Partia në pushtet (edhe ajo argate në Qeveri) për të vënë “rend e rregull” në kulturën shqiptare. Në rregull,

të themi se është ashtu: po pse nuk reagues "vëllezërit" sllavomaqedonas, Ministria e Kulturës?! Tekefundit, partia le ta marri në radhët e veta, dhe po të dojë le t'i falin së bashku edhe pesë vakte në ditë me bythët në hava në xhami, po le të mos e sakatojnë letërsinë dhe kulturën shqiptare. Natë e ditë le t'i luten Allahut për mëkate. Shkurt dhe shqip: Hoxha nuk e ka vendin në Ministrinë e Kulturës, në komisionin e vlerësimit të letërsisë dhe kulturës shqiptare. Nuk ka tru shqiptari ky hoxhë, e as bagazh letrar mbi samarë. Nuk di. Edhe ai e di se nuk di, po nuk di ku e ka minaren e xhamisë e ku Allahun. Rrugën e Zotit e ka humbur mes sokaqeve me kalldrëm në Bita – Pazar. Rreshtave të këtij shkrimi të Autorit duke e pritur një të nesërme mbi kalë: Djalin e Vejushkës t'ia ngrejë këmbët në hava këtij halldupi nga minarja e xhamisë.

Dhe, në fund: Hoxha i Allahut, nuk e ka vendin e shenjtë në Ministrinë e Kulturës të Maqedonisë, e ka në xhami. Edhe ku është i punësuar si hoxhë kokë më kokë me xhematin mbi qilima të Persisë...

NUK TË ZË NËMA E NJERKËS PO NËMA E NËNËS

Mushka, dikur në kohën e komunizmit ka “pjellë” edhe viça të palëpi. Vetëmse, atyre viçave të palëpi, u ka dhënë gji te pelat tjera nëpër livadhe. Shkaku, se: këta viça të palëpi dikushi ia ka lënë Mushkës para dere si kopila. E Mushka si kafshë e butë shtëpiake, patjetër është dashur t’i marrë në shtëpi, japë tambël nëpër kojshi, rrisi mëzetër, që një ditë “vëllezërit” t’i tredhin, bëjnë që ta tërheqin qerren me dy e katër rrota. E dini, lexues të nderuar ku e kam fjalën. Edhe këtij Viçi të palëpi, Mushka i ka dhënë gji te kafshët tjera shtëpiake: pela, lopa, delja, dhia, gomarica, buça, bullica... E ku ta di unë te të cilat kafshë tjera shtëpiake. Përçudi, e ky Viç i palëpi me zgjebe, tashti e shan Mushkën si nënë. Ia mohon përkujdesjen, tambëlin e gjirit. Taxhinë.

Qesharake, ë?! Viçi i palëpi melez pret të pjellë Mushka. E jo Lopa që e polli këtë Viç të palëpi melez, i dha tambël e rriti me shumë mundime nëpër dyert e hallkut. E bëri ka me brirë të thyer, që nuk është në gjendje ta tërheq qerren “demokratike” edhe sot si dje, në kohën e “artë” komuniste. Pllugun në arë.

Dhe, ky Viç i palëpi melez, sot nënën e tij që e rriti me mundime e quan Mushkë. Një mohim të këtillë, nuk e lajon as Bibla e as Kurani: Nëna të quhet Mushkë. Po, ja Viçi i palëpi, Nënë e vet e quan Mushkë. Dhe, pret që një

Ditënatë të Madhe, t'i pjellë në Lëmë vëllezër, viça tjerë të palëpi.

Jo. Jo, o Viç i palëpi melez. E di ti, apo nuk e di: Mushka e ka “pjellë” një Viç të palëpi dhe nuk “pjellë” më viça të këtij soji në Liavdh. Fatkeqësia yte është, që ti vërtetë ke lindur në Katund, po nuk i di ligjet e Natyrës. Problemi: ke punuar nëpër organizata ndërtimtarie brenda e jashtë vendit. Koperativa bujqësore. E më vonë nëpër organizata “humanitare”.

Katundin nuk e njeh mirë, edhe pse trumbeton se ke lindur në Katund. Kjo më shtyn të dyshoj si autor i këtyre rreshtave, ku ke lindur ti si Viç i palëpi, në cilën shtëpi?! Dhe, kush të la para dere te Mushka?! Që, ne katundarëve rrzë Çukës, të na e mbushish mendjen se, të ka “pjellë” Mushka. Shkurt, të të pranojmë si banor në Katund, shpresojmë se një ditë do të rritesh në ka dhe do ta tërheqish qerren e ngarkuar me ferra, rrugës përmes fushës për në Qytet. Atëbotë, edhe e deshe shumë Mushkën si nënë, që të polli një ditë Dimri. E flisje rrjedhshëm kudo nëpër livadhe edhe gjuhën e saj, të Mushkës si gjuhë nënë. Edhe shkollimin e kreve në gjuhën e nënës, Mushkës si gjuhë me perspektivë në të ardhmen. Në emër të nënës, pra Mushkës, i fitove edhe disa poste te Klubi i Tullumbave. E më vonë edhe nëpër disa Vetëshërbime të “vëllazërim – bashkimit” si argat me parashikime për një të Nesërme. Në një gazetë të Mushkës, ke dhënë edhe një intervistë se, i takon fisit të Mushkës. Fisit të zgjedhur sipas teje në atë kohë, që e pret një e nesërme me perspektivë Evropiane. I ke

hëngër me shokë plot mullarë me barë, hambarë me misër në emër të Mushkës, siç e quan sot ti Nënë tënde, e cila të dha gji dyerve të huaja, rriti me “varfëri” si Viç të palëpi.

Eh, Viçi im i palëpi, vonë të doli gjumi! Vonë. Hiç më pak je i vonuar pesëdhjetë vjet për këtë kohë demokratike. Argat ke punuar në tjetër arë. E ke harruar edhe poezinë satirike që në atë kohë ta kam përkushtuar ty, dhe e botova me qëllim në gazetën ku punoje ti me dy tri poste në Redaksinë e livadheve, si shpërblim që t’i dha komunizmi. Ndoshta, edhe i ke harruar ato vargje në stilin e popullit. Prandaj, jam i detyruar edhe njëherë të t’i përkujtoj si “mik”, pas njëzetë vjetësh në këtë shkrim:

**TY BRE KALEMXHI
TË KAM KALLXUE**
(Në stilin e popullit)

*Ty bre kalemxhi të kam kallxue
Nuk ta qet me u provu me mue.
Se, s’ke zemër me hy në luftë
Qe pesdhjetë vjetë je tuj u tutë.
Natë e ditë të kanë vu samarë
Argat ke punu në tjetër arë.
Zotnive tuj ua fërkue përditë
Mbylle më gojën, he jezitë!
Se të shkoi jeta me parulla t’ndyta
E kam lapsin me dy tyta...*

Ligjet e Natyrës janë të pamëshirshëm në jetë. Nuk e di, a ke ditur ti si Viç i palëpi këtë fuqi

natyrore?! Unë i kam vërejtur me kohë gjatë jetës sime, edhe tani i shtyer në moshë, plak me mjekër. Zoti gjithmonë na i ka dërguar shenjat. Nuk është me rëndësi pas kujt, misionerëve të tij, librave të shenjtë, apo ëndrrave. E problem tejtër është ai se, ti nuk ke ditur t'i lexosh ato shenja. Përmëtepër, shenjat nuk kanë ditur t'i lexojnë edhe viça të tjerë të palëpi në Livadh. E kanë dalldisur veten pas kullosës. Tërfojës. Taxhisë në grazhd, ose barit të njomë nëpër livadhe.

Dhe, përfundimi: nëse nuk di t'i lexosh shenjat e shenjta, nuk është ky problem i Zotit. Natyrës. As edhe i imi, si shkrimtar. Po, i yti, dhe sojit tënd, Kopesë me zgjebe, që e keni shitur veten një torbë taxhi nëpër livadhe. Që, gjithë jetën nuk keni ditur, ku e keni kokën, e ku bythën.

Populli thotë: Nuk të zë nëma e Njerkës (Mushkës, sipas teje), po nëma e Nënës me siguri të zë keq një ditë...



TEUTAT E SOÇME KUQEZI GRA “BESNIKE” NË PARTI

Ditë. Dielli dy shkopinj mbi Sharr e kishte kapur në grusht Qytetin e dy Universiteteve. Matanë maleve kullosnin dhentë. Ujku në një përrua u kishte vënë pusi. Bariu i biente fyellit. Ama, ia kishte marrë një kënge, që gjithë Qytetin sikur donte ta zgjonte nga gjumi:

*O çobani tatës, bre djal,
O çobani tatës, bre djal!
Holli dhentë kë në vathës. Medet-o
Haj, haaaj. Holli dhentë kë në vathës-o!*

Vapë e madhe. Rrugët në zjarr. Shtëpitë. Qielli në flakë. Nguteshin njerëzit si pa kokë. Ecnin. Një Zot e di për ku, në lindje apo vdekje. Me dy e katër këmbë. Ndonjëri e hiqte veten edhe zvarrë nëpër bërlllok. Lumi larg. Dielli larg. Liria edhe më larg matanë maleve...

- Hë, si të duket?! A ta mbusha syrin, që ta shkruajmë edhe librin e dytë: *Gratë e mia besnike*?! Më tha, Djemnusha me dy shtamba verë të kuqe përpara mbi tavolinë.

- Nuk e di. Me siguri siç duket, edhe Ty të ka përzënë Partia. Të provojmë.

- Partia, po. Vetëm ti me siguri nuk do të më përzësh si ajo kurvë?!...

- Jo, vogëlushe. Unë nuk jam i keq si Partia me atë kope “ patriotesh “ që vuajnë për Atdheun. E duan DoktorZiun...

Dhe, nisi lufta. Armët i nxorrëm nga brezi. Një Zot e di, sa viktima do të bien dëshmorë. Edhe tradhtarë. Patriotë të vonuar melezë... Hoxhallarë... Priftërinj... Imzot, me siguri do të ketë në këtë luftë heroike. Po. Edhe, secili më trim se i shoqi...

Dhe, heret në mëngjes në ora 6.00 me dt. 21 mars 2007, Ditën e pranverës më erdhi një mesazh në telefonin e xhepit:

O Zot! Ishalla e zbulon. Jo për të vazhduar bashkë. Por, më dhembë akuza e pabazë. Zot i madh, zbuloje atë njeri! Atëherë, do të të besoj pa kufi. Shpirt i gjyshes më ndihmo! Engjëlli im më mungon...

Shkup, 21 mars 2007

Dhe, në mëngjes u zgjova para Diellit. I fërkova sytë me duar, i bërtita Qiellit: Edhe unë jam i çmendur!...

- Hi-hii-hiii...

Im Atë, kurrë nuk pushoi së fantazuari për ta gjetur Lirinë...

- E gjeti?

- Punë përrallash. Ik, ore ëndërrime... Tashti e kuptova. Dhe, erdha në përfundim se, Liria qenka grua. Përmëkeq, një grua kurtizane, që me vite e shekuj i turremi përmbropa ne shqiptarët. E kam fjalën për burrat. Gratë nuk i turren Lirisë.

Shkaku se, nuk duan të jenë lezbejka të çmendura.

- Hi-hii-hiii... E ku e di ti se Liria nuk është lezbejkë?! Edhe atë, e çmendur përtej kufiri, që nuk e mba kandari...

- Jo, nuk e di. Po, them kot se, nuk do t'i turreshin burrat me pushkë në dorë e kollanë me fishekë përqafe përmbra me ditë, muaj, vite e shekuj nëpër male...

- Po.

- Dhe, ende nuk e zuri asnjë burrë në livadh... Fushë... Ose, mal...

- Jo, nuk e zuri...

- Dhe, e di se pse, asnjë burrë, grua nuk e rrëzoi në shtrat?!...

- Edhe këtë nuk e di. Po, a e di se, shumë burra e gra nateditë e kanë ndjekur edhe maleve me armë në dorë?!...

- E di. Kalosh Zajazi me mauzerr në dorë e ndoqi maleve të Kërçovës, në Kosovë e Shqipëri. Sulltanë Qafa me gërshërë të dhenëve. Bajram Curri, përpak ia ngriti këmbët në hava pas një gardhi. Edhe Isë Boletini i vuri pusi me dy kobure në Londër... Azem Bejta, po të mos e kishte me vete Shotë Galicën, Nusen e maleve me siguri do ta rrëzonte në shpellë...

- Hi-hii-hiii... Dhe, përsëri shqiptarët nuk e rrëzuan në shtrat...

- Jo. Edhe sot e kësaj dite. Iu turrën përmbra me të gjitha armët: shpatë, pushkë, bomba e topa... U ka mbetur pa e provuar edhe armën e fundit... Dhe, dhashtë Zoti një ditë e kapin në dorë maleve edhe këtë armë historike!...

- E, atëherë, Liria qenka kurvë?!... Buçë Katundi, që ku ta dimë ne me cilët kurvarë e lëvizë bishtin...

- Mundet. Tatëmadhja, njëherë i bëri edhe maxhi. E shkriu plumbin në një enë me ujë e eshtra... I fryu...

- Dhe, përsëri nuk e zunë magjitë?!

- Jo.

- Atëherë, duhet bërë hajmali te Hoxha i Katundit, që një ditë fluturoi nga minarja...

- Jo, ore... Lirinë duhet dërguar te Baba Shehu, në Tyrbe t'ia hudhë këmishën e gjatë të mëndafshit me oja e tel mbi kokë.

E përzura Nusen me pashterkë të kuqe dhe e mora Lirinë për grua. Nëna përsëri e rroku dajren te pragu i derës. Babai qiti pushkë në Lëmë. Edhe në këtë Shtëpi më në fund erdhi një grua azgane nga fisi, Liria... Zanë mali...

Një javë vetëm e pastrova mauzerrin e Babait. Rripat i mbusha me fishekë. Bombat i futa nëpër xhepa.

Dera u hap, dhe hyri im Atë i armatosur deri më dhëmbë. U tremba. Thashë me vete: Tashti më i ka ardhur te hunda me mua sugarin, do të mi shkrepë të gjitha në lule të ballit nga zemrimi...

Përçudi, buzëqeshi me ato mustaqe vesh më vesh. U ulë si gjithmonë në shkamin e vet me tri kambë, mbuluar me lëkurë dashi. Mauzerrin e mori në prehër.

- Dhe, më në fund erdhi edhe në këtë shtëpi Nusja e maleve... Liria...

- Po, baba. Ashtu thonë... Rrugë të gjatë bëri nëpër male...

- Edhe nëpër fusha... Dhe, e di se si e gjeti rrugën mes atyre shkurrave?

- Jo, baba. Edhe sot e kësaj dite. Nuk e di nga cila anë zbriti maleve...

- Mendohu pak, o bir! E ke thënë shpesh mes atyre rreshtave, nëpër libra...

- Kot. Nuk ma pret mendja gjithë ditën, gjithë natën... Prit pak, mu kujtua: është Çelvjollca, mali që prek qiellin...

- Çelvjollca është pra, dhe dëgjoje këtë rrëfim deri në fund, po të duash fute edhe në libër! E di ti, o bir se kush ka qenë Kalosh Zajazi, emrin e të cilit e mban ti si shkrimtar... Sulltanë Qafa... Dhe, Azem Bejta - Galica?...

- Po, e di, baba. Kaçaku i maleve.

- E Shotë Galica?...

- Edhe këtë e di: Nusja e maleve...

- Dhe, a e di se Azem Bejta, Shotën e mori me vete në male?

- Edhe këtë e di. Shkaku se i duhej grua edhe në male... E veshi edhe si burrë me tirqi e xhamadan... Kësulë të bardhë në kokë...

- E vërtetë. Po, po ta dinte Azem Galica se Shota do t'ia kalonte me trimëri në luftë, nuk do ta merrte me vete në malet e ashpëra me dëborë...

- Qindpërqind, baba. Burrat janë xhelozë ndaj grave...

- Mirë, ta zëmë se është ashtu siç thua ti shkrimtari... Po, nuk është ky qëllimi i ardhjes sime nga varret... Qëllimi im është se, shqipëtarëve u duhet një Teutë mbretëreshë. E di ti se, kur shqiptarët kanë qenë shtet i fuqishëm në botë me të gjitha nishanet?!...

- Po, e di. Moti, në kohën e Ilirisë... Teuta kur ka qenë mbretëreshë...

- Ehu, biro! Shqipëtarëve u duhet mu ajo Teutë, e jo këto Teutat e sotshme dhe Skënderbegat që i keni ju nëpër parti politike vetëm për poste, kabinete në Qeveri...

Dhe, pasi e tha këtë u ngritë i zemruar, e hodhi mauzerrin në krah dhe ma përplasi derën, doli në Lëmë...

Matanë hekurave të dritareve, në errësirë i dëgjova njëra pas tjetrës, tri krisma pushke... Jehonën e tyre majë lisave, përmes Livadhit te Guri i Zi, në Çukë ...

Dhe, lehjen e qenëve nëpër natë...



SHKUPI PËRPARA “TËRMETIT” TË PROTESTAVE SHQIPTARE

Njëzetë vjet me radhë shqiptarët e IRJ të Maqedonisë të drejtat e tyre kombëtare i kërkojnë me anë të protestave në rrugë. Kohën e fundit, edhe në male. Përsëri, mbetën me gishta në gojë: pa gjuhë, pa flamur kombëtar, pa barazi të plotë kombëtare. Partitë politike shqiptare, pas “fitoreve” të zgjedhjeve parlamentare, vite me radhë hynin e dilnin në Qeveri si argatë. Në fund, përsëri vendosën të drejtat e shqiptarëve t’i kërkojnë në rrugë si lypës te Ura e Gurit. E kur është në pyetje rruga, populli shqiptar edhe ashtu është i papunë, në rrugë. Problem këtë popull është ta fusish nëpër institucione, se sa për në rrugë e ke shumë lehtë ta nxjerrësh edhe vetëm me një thirrje, gjithë jetën e kanë dalldisur partitë tona politike “demokratike”.

Shqiptarëve po u përsëriten provokimet: rasti i Bit-Pazarit, afera e armëve, rasti i Ladorishtit, rasti i Sopotit, rasti i Brodecit... Qofshin këto nga Qeveria, qofshin nga opozita. Pse, të mos e themi haptas edhe nga shërbimet e ndryshme të fshehta informative e të spiunazhit, që në IRJ të Maqedonisë veprojnë si në bahçe të Babës. Edhe atë, gjatë ndryshimeve demokratike dhanë viktima të pafajshme. Shqiptarët, sipas mendimit tim nuk kanë më nevojë të japin viktima, po tru dhe hapa demokratik në fushën politike brenda institucioneve të shtetit.

Hoxha e thirrë xhematin për ta falur “xhumanë” në sheshin e Shkupit, te vendi i ish Burmali Xhamisë. E nxjerrë nga shtëpia e shenjtë e Zotit - xhamia, në rrugë. O Imzot, sa hije do t’i kishte sikur ta thirrte t’i luteshin Allahut për shkolla shqipe! Shoqatat joqeveritare, menjëherë pas tyre tri ditë, e thirrën popullin për të shprehur pakënaqësitë e shqiptarëve me moton: për drejtësi, në rrugë me mjete demokratike.

E çuditshme, po deri kur populli shqiptarë do t’i kërkojë të drejtat e tia kombëtare në rrugë dhe nëpër male?! Vite me radhë jashta institucioneve. Edhe atë, me rreziqe dhe viktima të pafajshme. Megjithatë, është koha populli shqiptarë të vetëdijësohet njëherë e përgjithmonë në jetë për krijimin e shtetit etnik shqiptar. Mjaftë më, aspiratat e tij dhe të drejtat kombëtare i kërkoj në rrugë me vite! Edhe kësaj radhe ka shenja se, ne shqiptarëve përpiqen të na e lënë fajin, kopilin pas dere.

Frikë kam se, këtë popull përsëri do ta keqpërdorin nëpërmes të partizanëve të tyre të strehuar nëpër parti politike, individë të papërgjegjshëm që do t’i ngjyrosin me flamuj partiak edhe protestat e shoqateve joqeveritare. Ose, do t’i fusin “aktivistët” e tyre ditën e protestave për t’u dhënë një karakter tjetër politik. Organizatorët e protestave duhet të jenë të përgaditur mirë dhe syçelë në këto të papritura që mund t’u kurdisen në rrugë. Shkaku se: ne shqiptarëve po na përsëritet historia dhe gabimet. Dhe, është koha që të mësojmë nga ato gabime e ajo histori e hidhur, që na ka ndjekur si hije nëpër

shekuj. E, sa do t'ia arrimë qëllimit, duhet të presim të flas koha një ditë.

Shkupi si “kryeqytet” i shqiptarëve gjatë historisë ka pasur shumë tërmete: natyrore, luftarake, kryngritje e protesta demokratike për liri të plotë kombëtare. E ka sulmuar Natyra e kanë sulmuar okupatorët. Edhe në këtë kohë, e sulmon Natyra, e sulmojnë okupatorët. Kurrësesi, kjo metropolë botërore nuk mund të ngre krye nga Natyra dhe okupatorët. Tërmeti çdo njëqind vjet e rrafshon me tokë. E ngrisin përsëri më këmbë njerëzit human nga mbarë bota. Partitë politike përsëri e sulmojnë në zemër me ndërtime jo funksionale: përmendore e ndërtesa që mbijnë si këpurdhat pas shiut. E ngulfasin, ia zënë frymën për qëllimet e tyre të ngushta individuale e propagandistike të partive të tyre politike. Edhe një gjë mos ta harrojmë si realitet: Shkupi nga të gjitha anët është i rrethuar me fshatra shqiptarë. Është qyteti i tretë me më shumë shqiptarë, pas Tiranës dhe Prishtinës. Përpara Luftës së Kosovës (1999), ka qenë i dyti pas Tiranës.

Përsëri, Shkupin edhe njëherë do ta “dridhin” protestat demokratike të shqiptarëve. Thashë: E kanë “dridhur” njëzet vjet me radhë edhe atë, matanë Urës së Gurit, Vardarit. E mbaj mend mu si sot, menjëherë pas ndryshimeve demokratike, kur Shkupin nga të katër anët me këngë shqiptare, flamuj kombëtarë, pankarta në duar e kësula të bardha në kokë, e “pushtuan” shqiptarët. Sheshi “Makedonija” nuk i nxente shqiptarët. Nuk mbaj mend që atëherë, në atë kohë shqiptarët të kenë bërë ndonjë protestë kaq

masive në rrugë. Protesta në rrugë kemi pasur edhe më vonë të organizuara nga partitë politike shqiptare, po kurrë jo të atij niveli masovik e madhështor. Shkaku se: sot shqiptarët janë të përçarë nëpër parti politike. Secili i sheh interesat e veta individuale e partiake e shumë pak interesat e popullit. Askund si te ne në botë, nuk i ka futur hundët kaq shumë politika: në ushtri, polici, në gjykatë, arsim, kulturë, institucione fetare. Vetëm, u hidhni një sy shkollave tona shqipe dhe universiteteve shtetëror e privat: ne kemi unione të nxënësve në baza partiake edhe nëpër shkolla fillore. Shoqata joqeveritare të grave e burrave fundekrye nën sjetullat e partive politike. E kemi ngulfatur rininë me politikë ditore të partive tona politike. E sa di unë, historikisht nëpër botë, revolucionet i kanë bërë nxënësit dhe studentët. Ndryshimet demokratike poashtu i ka bërë ajo rini revolucionare. E jo “demokratët” e sotshëm, komunistë të djeshëm që vite me radhë u janë ngatërruar nëpër këmbë partive tona politike shqiptare.

Në rregull: haj t’ju besojmë këtyre hapave demokratik, protestave në rrugë. Po, deri më tani nuk kanë bërë punë të hajrët. E si t’ju besojmë, kur ende e kemi samarin mbi shpinë. Fatkeqsisht, më vjen keq, po do ta them publikisht: shoqatave joqeveritare u mungon truri profetik. Dhashtë Zoti të jem unë gabim, e ata në të drejtë. Po, vështirë e ka ky tru “budalla” të pjellë një viç të palëpi në Livadh. Protestat e kanë qëllimin t’ia bëjnë me dije botës demokratike qëllimet e përealizuara të një populli. Bota, veç më i di

qëllimet dhe aspiratat e popullit shqiptarë. Atëherë, ende do ta provokojmë këtë popull e nxjerrim nga rruga e Zotit për Bashkim Kombëtarë duke e futur nëpër qorrsokaqe?! Jo! Rruga e vetme e popullit shqiptarë, është rruga për në Baba Tomorr. Vend i Perëndive. Tyrbja, ku pihet vera. Pasmesnate, ku shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri...

Dhe, ja pse kam frikë se edhe kësaj radhe do të jemi të manipuluar nga “misionarë” të partive politike. Në mos i kanë shti ende partizanët e tyre nëpër radhët tona, do t’i shtinë nesër, ose ditën e protestave. Dhashtë Zoti, nuk na dalin nga kontrolli edhe kësaj radhe në rrugë. Nuk është punë e lehtë dhe papërgjegjësi një masë kaq të madhe njerëzish ta nxjerrësh në rrugë. E kemi ende të freskët protestën e “Vetëvendosja” në, Prishtinë. Gjyqin që e pret organizatorin e atyre protestave. Prandaj, o burra edhe njëheherë bëj thirrje: Larg duart e partive politike nga këto protesta të shoqatave joqeveritare! E them këtë se: kam frikë se partitë tona politike edhe kësaj radhe këtyre protestave të qeta do t’u japin flamujt dhe ngjyrat e tyre partiake. Veç më, i kanë paralajmëruar orekset e pangopura politike me “përkrahjen” publike të këtyre protestave në mjetet e informacionit.

Zoti i shpëtoftë edhe kësaj radhe shqiptarët!
Amen...

KËRCNIME ANONIME

(Ose: për sa të vishet me të zeza dhe qaj Nëna ime mbi varr, më mirë le të qajë nëna e tyre).

Im Atë, shpeshëherë ma përsëriste një fjali artistike rreth zjarrit që ndizej me flakë drejtë oxhakut, në Katund: *për sa të vishet me të zeza dhe qaj nëna ime mbi varr, më mirë le të qajë nëna e tyre...*

Dhe, unë i biri i tij pas kaq vitesh në pleqëri, erdhi koha që më në fund të pajtohem me thënien e t'im Ati. Nuk e luante topi. Im Atë, kishte pasur të drejtë. Shkaku se: gjatë jetës sime me penë në dorë, disa dumdumë që më ishin shtier si miq, dolën kundër meje sa herë që i blente Qoftëlargu një torbë taxhi. Merreni me mend, “miqtë” që unë i kisha përkrahur, i kisha ngritur më këmbë, i mbaja gjallë në jetë, erdhi koha që të dalin kundër meje publikisht me theshetheme në mjetet e informacionit. Edhe këshilla më jepnin se, si duhet të sillem në letërsi, eci në jetë. Ndonjëri, edhe si duhet të shkruaj në gazetë. Libra. Mjetet e informacionit. Përmëtepër, njëri më i zëshmi, më trimi nëpër mbëledhje të ndryshme dhe takime kulturore, haptas deklaronte, më shtiheshte si “mik” se, është rritur në bankat e shkollës filllore me librat e mi për fëmijë. Fatkeqsisht, sot e shoh se ai nuk i paska kuptuar librat e mi për fëmijë, që në atë kohë ia ka dhënë mësuesja si dhuratë. Tjetri: edhe të më kërcnohet një ditë: ... *“dhe per fund kjo qe ti ke zgjedhur ket menyrr per te*

shkruar ne ket web faqe eshte karta jote e vetme, se sa per shkrimtar a poet te gjith e din sa i zoti je, kam edhe disa pyetj tjera per ju por ata jan pak me personale dhe do ti pyes nese do vazhdosh te sharrosh keshu sic ja ke nisur keto kohet e fundit (ose me sakte keto dy tre dekadat e fundit)”...

E unë si shkrimtar, moti jam mësuar me këto sharje banale në mjetet e informacionit. Kërcnime anonime. Telefonata primitive pasmenate. Nuk jam mësuar me lëvdata, jetë dumdumësh në kurriz të popullit. E përçudi, nga cilët më vijnë këto kërcnime, nga “miqtë” e mi, që unë ua kisha hapur dyert e jetës krah më krah, i kisha marrë në mbrojte, i kisha mësuar si ta përdorin lapsin në shërbim të popullit. E ata, “burrat” e mejdanit, lapsin duan ta shndërrojnë në frikë, plumb kundër meje si shkrimtar. E them: Lapsi (plumbi) i tyre u bëftë top! E pres kudo, dhe në çdo kohë.

Në jetë e pranoj vetëm një luftë: luftën e armës (lapsit) dhe punës artistike (aftësive krijuese). Lufta e shpifjeve pas shpine dhe kërcnimeve anonime, për mua është luftë e të dobtit, frikacakëve. Vazhdimi: e pranoj luftën e trimave që më dalin ballë për ballë me laps në dorë dhe dyluftimin në fushën e mejdanit. Frikacakët nuk i kam njohur deri më sot dhe nuk do t’i njoh kurrë, as nesër në jetë. Shkaku se, posa të më shohin ballë për ballë me sy, veç u ka rënë arma (lapsi) nga dora.

E mira e juaj, si kundërshtar i juaji, është të më luftoni me mjete demoktatike, e jo me

kërcnime primitive, që ta mbyll gojën. E dini pse: unë kurrë nuk jam trembur nga shpifjet dhe kërcnimet teknefese. Për mua kanë thënë çkamos, shpif e kërcnuar që në kohën e komunizmit. Edhe gjatë ndryshimeve demokratike, haxhuxhe të shitur një torbë taxhi. Po, mua nuk ma ka ndi për lehjet e tyre dhe kërcnimet ham - ham, edhe sot e kësaj dite. E kam kokën time në qafë. Dhe, jo kokat e juaja nën sjetulla të shitura shpeshherë edhe pa pare.

Vite më vonë, e mësova edhe ngjarjen e kësaj urtie antologjike se, si kishte ardhë im Atë deri te ky përfundim historik. Kohë e kaluar, mos të them edhe e harruar, pas Luftës së Dytë Botërore. Vite, që posa kishim dalë plot plagë nga lufta. E t'im Ati, gati për çdo natë i vënin pusi që ta vrasin, shkaku se nuk ikte si të tjerët me gjithë familje në Turqi. I kishin paguar tre vetë edhe me franga. Vetëm priteshte ekzekutimi i pabesë dita më ditë. E ruanin ditën rrufjanët. E ruanin natën.

Shenjat e para, heret i kishte hetuar im Atë: posa biente nata mbi livadh, lehnin qentë në lëmë. E dinte këtë pabesi nate se, nuk janë shenja të mira për atë kohë qorre. Përmëtepër, edhe atë për një kohë namqorre, që posa kishim dalë nga lufta. Kohë e pasigurtë, që shkoje kot si qeni në rrush. Vetëm për pak franga të vrisnin, dhe kurrë nuk e dije se kush të ka vra, nuk zbuloheshte kurrë vrasësi. Shkak ky, që im Atë ruheshte ditën, ruheshte natën. E kujtoj edhe sot e kësaj dite një thënie tjetër të atij urtaku: *ec dy - tri hapa para rrugës dhe ktheu, shiko kush të vjen mbrapa shpine!* Poashtu, më kujtohet edhe kur shkonim

në qytet, nuk ktheheshim natën të njëjtës rruge. Edhe për këtë fshehtësi, një ditë më rrëfeu im Atë. Armiku, kurrë nuk duhet ta di se cilës rruge do të kthehesh në shtëpi. Dhe, vërtetë për këtë kishte pasur të drejtë. Prandaj, edhe kurrë nuk ra në pritë. Nuk e vrau dora e pabesë e armikut. Ndërroi jetë vetë një ditë në shtrat, në mesin e familjes nga dora e Zotit.

Fat i t'im Ati, që gratë si gra gjithmonë i kanë bartur fjalët gojë më gojë. Gratë si gratë më, e hapin këtë fshehtësi edhe para nënës time gjatë një dasme, pa e ditur se ajo është gruaja e tim Ati. E populli thotë: *tre vetë e mbajnë një fshehtësi, nëse dy nga ata janë të vdekur*. Nëna, pas dasme vjen në shtëpi dhe gjithë këtë histori ia rrëfen t'im Ati fjalë për fjalë.

Im Atë, tashti kur e pa se sa është sahati, përpara se ata t'i vënë pusi, u zë pusi vetë i pari në fund të livadhit. Vrasësit pas darke vijnë t'i vënë pusi t'im Ati. Përçudi të tyre, binë në pritë të tim Ati, dhe vriten pa asnjëfarë mëshire si qenë në rrugë, te Livadhi i Xha Nefruzit, rrëzë Çukës.

Dhe, unë i biri i tij, pas kaq viteve u detyrova të përdor metodën e t'im Ati: *për sa të vishet me të zeza dhe qaj mbi varr nëna ime, më mirë le të qajë nëna e tyre*. I kam shpërblyer me: Një munitë heshtje armiqte e mi që më vënin pusi natën pas darke.

Im Atë kishte pasur të drejtë si burrë i pushkës, fjalës... Dhe, besës: *për sa të vishet me të zeza dhe qaj nëna ime mbi varr, më mirë le të qajë nëna e tyre...*

**MA KA LËN-E - MA KA LËN-E
NËNA AMANET-E**

E njohin gati të gjithë këtë personazh të këtij rrëfimi në botën moderne. I madh e i vogël. Shpeshherë edhe i duartrokisin kur e takojnë në rrugë: edhe një! Edhe një! Edhe një!... Jo, u përgjigjet artisti, për sot mjaftë e keni një. Shkaku se: mund të hani dru. Dru. Dru. Vite me radhë e këndon të njëjtën këngë “patriotike”, lyp dhe shëtitet duke u përkundur si endacak rrugëve të Shkupit. Tavernë më tavernë. Edhe në Tetovë del ndonjëherë pas lekut. Askushi, ose pak vetë e dinë se kujt kombi i takon: i flet disa gjuhë të rrethit ku jeton rrugëve të Shkupit. Nuk ka urrejtje ndaj mesit, popujve me të cilët e kalon ditën. Nuk i takon asnjë partie politike. Nuk shkon në xhami t’i falë të pesë vaktet si Haxhi Deputeti përpara këmbëve të Hoxhës. Nuk shkon as edhe në kishë t’i rrëfeket Priftit. Sytë i shkrepin xixa dashurie. Ndoshta, di edhe ndonjë gjuhë botërore. Ku ta di unë. Nuk është kjo aftësi gjithaq e rëndësishme, aq sa është kënga e tij “patriotike” në gjuhën shqipe nëpër Bit – Pazar.

Lypës i rrallë, që ditënatë kërkon lekë dhe këndon në gjuhën shqipe: *ma ka lën-e, ma ka lën-e nëna amanet-e...* Përmëtepër, këtë këngë e këndon të përcjellur edhe me gjeste e përdredhje të trupit e bythëve në gjuhën shqipe. E merreni ju me mend, shqiptarët me çka krenohen më së tepërimi si popull?! Nuk ma lejon goja, dhe nuk

ma shkruan dot lapsi mes këtyre rreshtave si shkrimtar gjoja i “moralshëm”.

Dhe, dorën në zemër, personazhi im i këtij rrëfimi të pazakonshëm e ka goditur në shenjë me këtë këngë “patriotike”. Prandaj, edhe fiton më shumë se lypësit tjerë lekë. Ec, e mos i jep lekë këtij heroi të ditëve tona në Bit – Pazar, kur e shtri dorën me këngën: *Ma ka lën-e, ma ka lën-e, nëna amanet-e...* I përdredh bythët, këputet në midis, paket duke bërë me duar gjeste artistike, thua ti se është duke e bërë atë punë të grave në mes të rrugës, para kalimtarëve.

E çuditshme, ky lypës nuk është si lypësit e tjerë të zakonshëm që i shohim përditë se si enden rrugëve të Shkupit: te Ura e Gurit, në ndonjë kënd të rrugës ku u kanë vënë pusi kalimtarëve, ose para derës së xhamisë ditën e xhuma (premtë), kishës të dielave. Është lypës i veçantë, origjinal. Kryevepër e kësaj kohe shterpë, që di të pjellë vetëm viça të palëpi. E provokon kalimtarin e rastit, e sidomos shqiptarin që mezi pret ta takoj ballë për ballë në rrugë. Ndonjërit, që nuk e kupton këngën e tij patriotike, ose ia shan para syve, ia bën me shenjë të dorës në fyt, improvizon se ia pret kokën. Dihet, kjo sjellje këtij lypsi ose të çmenduri, i thuani ju si të doni, shpeshherë i sjellë në rrugë si shpërblim edhe ndonjë shqelm të mirë bythëve. Po, jo nuk mërzitet shumë lypësi i ditëve tona heroike “demokratike”. E di ky burrë lojën e përditshme për të fituar bukën e gojës se, çka ka në gjak më së shumti shqiptari. Edhe e kënaq publikun e tij në rrugë duke dhënë shenja profetike me dorë e

këmbë, si një artist i përkryer rruge. E besoj se, lexuesi i nderuar e di ku e kam fjalën. Shkaku: e përsëris edhe njëherë, nuk ma lejon “moralin” im i lartë i shkrimtarit t’i përshkruaj aq me besnikëri ato shenja “patriotike” në mes të rrugës. E dini ju, edhe unë jam shqiptar shumë i “moralshëm”, aq sa nuk bëj asnjë mëkat edhe me gruan time më të mirë në botë me të cilën e ndaj shtratin. Fëmijët, si të gjithë shqiptarëve edhe ne, na i ka sjellë lejleku. E them këtë se: ne shqiptarët mbi të gjitha jemi shumë të moralshëm dhe besnikë ndaj grave. Megjithatë, ata që e njohin dhe e kanë parë këtë lypës rrugëve të Shkupit, e dinë se ku e kam fjalën. Dhashtë Zoti, nuk u shkon mendja për keqkuptime, po e zgjidhin këtë rrëfim të lidhur nyje, ashtu siç i ka hije.

Lypësi im këngëtar i këtij Qyteti është edhe shumë intelegjent: nuk i kërkon lekë çdo kalimtar, i di ai klientët e vet besnik. Përmëtepër, edhe nuk vjedh si “lypësit” e tjerë, që u vënë pusi kalimtarëve të Ura e Gurit. Ua zbrazin xhepat. Kundërshtarët, i provokon edhe më keq: me shenjën e heqjes së kokës.

Ë?! Vërtetë kemi të bëjmë me një lypës të pazakonshëm, modern të kësaj kohe. Hero buke të rrugëve tona nëpër Bit – Pazar. E kam shëtitur botën, po ja që nuk më ka ra rasti, zënë syri të shoh sojin e këtij lypësi evropian.

Lypësit, që kërkon lekë duke shitur artin e tij modern sokaqeve nëpër Bit – Pazar të Shkupit. Dhe, këndon këngën: *ma ka lën-e, ma ka lën-e, nëna amanet-e...*

VI RRUFJANI GËRHET PËR LIRI

SHKUPIN NGA QEVERTË “DEMOKRATIKE” DO TA SHPËTOJË NATYRA

Shkupin këtë metropolë botërore, historikisht herë pas here çdo njëqind vjet nga Qeveritë “demokratike” e ka shpëtuar Natyra. Hoxhallarët dhe priftërinjt do të thonë: Zoti. Nuk ka rëndësi kjo në këto momente historike, kur ky qytet e ka më së vështiri të lëshoj shtat ashtu siç i ka hije një qyteti buzë Vardarit. Qyteti si qytet, pesqind vjet ka qenë nën sundimin e turqve. Disa ditë e kanë çliruar edhe shqiptarët. Kohën e fundit është nën sundimin dhe lulëzimin e sllavëve.

Nuk ka kjo rëndësi në këtë shkrim të vonuar pas kaq viteve. E rëndësishme është se si: Qeveritë, Partitë politike vite me radhë këtij qyteti ia kanë zënë frymën. Shkupi me vështirësi ka marrë frymë edhe: në kohën e Turqisë, në kohën e Serbisë, në kohën e Italisë, në kohën e Bullgarisë. Edhe në kohën e komunizmit. Nuk është problemi: te gishtat, këmbët, duart, koka... po e sulmojnë në zemër.

Popuj intersant për studim shkencor jemi në këtë qytet, që edhe sot e kësaj dite nuk mbushemi mend. Përditë, përnatë vërejtjen na e tërheq Natyra. Zoti. Edhe shenja na dërgojnë përmes të gjallëve e të vdekurve. Përsëri, ne nuk i shohim, nuk i dëgjojmë ato shenja, ato zëra. E vazhdojmë me tonën, luftojmë kundër ligjeve të Natyrës...

Zotit... Fatkeqësia më e madhe është se: me këtë problem shoqëror nuk merret edhe shkrimtari dhe analisti më “i madh” politik shqiptaromaqedonas. Natëditë merret me ministrat dhe zv. ministrat e partisë shqiptare në pushtet dhe kryetarin e partisë shqiptare në opozitë. E në anën tjetër, Shkupi po ngulfatet edhe nga shkrimtarët e “mëdhenj e analistët politik”, që i kemi me kamiona. Ende merren me të drejtat kombëtare: flamurin, gjuhën shqipe, gjuhën maqedonase, shkolla shqipe, tekste shkollore... Bizniskoncerte humanitare...

Vetëm i hidhni një sy Shkupit në ato kohëra të shkuara, dhe i hidhni tashti në këtë kohë “demokratike”! Sheshi i Shkupit, fatkeqësisht përditë e më shumë po ngulfatet nga betoni, nuk merr frymë nga ndërtesat që lindin si këpurdhat pas shiut pa shije ballë për ballë mes bërllokut. Skulpturat pa vlera artistike se si kërcejnë nga këmbët e Urës Gurit me bythët në hava e kokën në ujë, në Vardar. Përmendoret antike më këmbë e kuaj të gozhduar në atë pak hapsirë krah për krah në Shesh, gati t’i kërcejnë njëra - tjetrës në shpinë. Edhe: askush nuk e ngre zërin për këtë beton që hudhet me kamoina pa mëshirë në Sheshin e Shkupit, brigjeve të Vardarit. Mure betoni dhe skulptura gjoja antike pa kokë, përditë e rrokin për fyti Shkupin. Drunj të priten, zhduken parqet e gjelbërta që Shkupit ia fali Natyra. Kalaja vazhdon të gërmohet, rrënohet në themele me pretendime për të nxjerrë në sipërfaqe kisha sllavomaqedonase e gjurmë të paraardhsëve maqedonë antikë. Përditë, e nxjerrin një hoxhë para kamerave televizive se, gjoja ai kërkon:

Burmali Xhami në Sheshin e Shkupit. E thirrë në mjetet e informacionit xhematin në Sheshin “Makedonija” t’i luten Allahut. E ai veç më e ka shitur te “vëllezërit” Burmali Xhaminë për një vend anëtarë të komisionit në veprimtarinë e botimeve në Ministrinë e Kulturës.


Përmëkeq, të gjithë heshtin: mjetet e informacionit. Partitë “demokratike” politike. Edhe njerëzit e këtij shteti në barkun e Evropës, që këto ditë pritet bashkë me grekët t’i vëmë emër në Kishë. Kryqit të madh në Vodno, që natën na e ndriçon Shkupin t’i dalim zot. Krahu për krahu me “vëllezërit” të shkojmë në Evropë. Dallimi nga e djeshmja: protestojnë edhe më shumë në rrugë, ta rrokin për fyti, t’ia zënë frymën qytetit: njëra palë, sllavomaqedonase kërkon të ndërtojë kishë ortodokse! Tjetra palë, shqiptare: xhami myslimane. E Shkupi prej dy babash, siç thotë populli, vazhdon të mbetet pa kësulë. Edhe ashtu, me dy mushkëri të përgjysmuara e sëmura nëpër shekuj, të ndara nga Vardari natyror mezi merr frymë, e pret të nesërmen këmbëkryq nën kala para këmbëve të Skënderbeut me shpatën në brez e dorën e ngritur lartë përpara “Ilindenit”. Që, u thotë shqipëtarëve: ndaluni, o burra! Nesër do ta kalojmë Urën e Gurit, do të dalim matanë Vardarit si shqiptarë. Krahu për krahu t’i bëjmë roje Shkupit me vëllain tim, Aleksandrin e Madh të Maqedonisë. Kuajt tonë të luftës t’i bëjmë kokë më kokë edhe në këtë betejë për liri.

Përditë e më shumë në të dy anët, ndërtohet me të madhe: ndërtesa, skulptura antike pa kokë vend e pa vend. Në anën shqiptare hidhet edhe

më shumë beton: Teatër maqedonas, Operë maqedonase, ndërtesa maqedonase pa shije që ua zënë sytë, fytyrën e frymën atyre të mëpërpashmeve që u përballuan viteve e luftrave, nuk i rrëzoi në tokë as edhe tërmeti katastrofal. E kanë rrethuar Skënderbeun me kalë në disa pëllëmbë vend në Bit – Pazar nga të katër anët me kisha e xhamia. I uzurpojnë sheshet e kësaj ane shqiptare, parqet, rrugët, drunjtë që i presin me rrënjë, gjelbërimin që i kishte hije brez pas brezi këtij Qyteti. Dorën në zemër, ditënatë me hove ndërtimi shumë më të madha nga ana shqiptare. Ndërtesa ia zë diellin ndërtesës. Fytyrë më fytyrë. Derë më derë. Parqet e bukur me karrige dhe drunjtë përreth Vardarit, që i ndërtoi me shumë mund e para sistemi komunist, i gëlltiti brenda natës si kulshedër “demokracia”. Të nesërmen, në vend të tyre shpërthen si pyll me lisa në pranverë betoni në të dy anët e sheshit të qytetit. Banorët e vdekur brenda natës më këmbë e me kuaj shale ua zënë vendin atyre të gjallëve. Dita – ditës të gjallët i përzënë me dhunë në Qytetin e varrezave, në periferi të qytetit. Shkupi, përçudi përsëri e mban veten gjallë, nuk jep shpirt. E gëdhi, përsëri të nesërmen me Qeveri “demokratike”, që e mbulon me beton e ndërtesa që lindin përditë si këpurdhat pas shiut. Kontejnierë me bërllok mbi shpinë. E një armatë të lypsëve në Çarshinë e Vjetër, te Ura e Gurit...

Shkupi mezi po merr frymë në ”demokraci” mes kishave ortodokse e xhamiave myslimane. E unë pres në Shkup: xhami shqiptare. Edhe kësaj

radhe, siç duket nuk do ta shpëtojnë Qeveritë
“demokratike”, po Natyra...



NUSJA ME PASHTERKË TË KUQE QË NUK E ZBRITËM NGA KOÇIA

Gjithë jetën je fshehur në dimi të grave. E në realitet me “veprat” e tua sakate të kemi pasur kudo, na je ngatërruar nëpër këmbë. Asgjë nuk ke bërë për arsimin dhe kulturën shqiptare. Përmëtepër, në emër të tyre së paku t’i jepje dikujt një kafe. Veten e ke shitur në Vetëshërbim për një torbë taxhi. Dhe, sa herë që ta kanë bërë me gisht pronarët, je ndërsyer me të katra kundër personaliteteve publike. Edhe më keq: ke lindur këlysh dhe do të cofish një ditë qen me zgjebe.

Edhe kjo është punë “artistike”. Nuk kam asgjë kundër, bile edhe paguhet shumë mirë në këtë Shtet “demokratik”. E sidomos, kur u ndërsehesh pas shpine intelektualëve shqiptarë. Personaliteteve tona, që ende nuk e kanë shitur veten për një asht shpërblim. Kurrë nuk ke pasur probleme sociale në jetë. Fëmijët pa bukë t’i vësh në gjumë. Të nesërmen, pa libra t’i dërgosh në shkollë. E ke pasur grazhdin plot me taxhi. Edhe torbën e mbushur me grykë përqafe. Arsyë, që ti ua jep hakun kundërshtarëve: ua ndërsen këlyshët me zgjebe, që nuk kanë të hanë as edhe bukë. Brekë në bythë. Mjerranët, që lehin rrugëve me një asht në gojë shpërblim. Bishtin e fusin nën këmbë. Gjuhën e kanë nxjerrë jashtë dy pëllëmbë nga vapa. Jargët u shkojnë çurg para dyerve të hallkut, “vëllezërve”. Përmëkeq, i keni harruar rilindasit tanë se ishin bejlerë. Burra të pushkës,

besës dhe penës. E shkrinë gjithë pasurinë e tyre për arsimin e kulturën shqiptare. Atdheun, kur ishte në rrezik. Çfarë pasurie do të shkriini ju o trusakatë, përveçse kontejnerëve të bërllokut në rrugë. Grazhdin ku e keni futur kokën dhe i keni ngritur bythët pa brekë në hava. Asgjë. Asgjë nuk keni në emër të juaj personal, mos e teproj shumë në këtë shkrim, as edhe brekë në bythë.

Eh “miku” im qen me zgjebe! E di se, unë edhe e kam çmuar profesionin tënd të përzgjedhur në jetë?! Besnikërinë tënde ndaj pronarëve të Shtëpisë Publike. Flijimet e tua “artistike” nëpër Vetëshërbime të “vëllazërim - bashkimit”. Edhe më tepër do ta çmoja, po të ishe në shërbim të popullit dhe Shtetit shqiptar. Fatkeqësisht, ti kurrë nuk ke qenë në shërbim të popullit dhe Shtetit shqiptar. Gjithë jetën e ke shitur veten shumë lirë përpara Vetëshërbimeve të “vëllazërim – bashkimit”, të mos them: pa pare.

E di, edhe pse nuk del si burrat në fushën e mejdanit, nxjerrish lapsin nga brezi, po fshihesh në dimi të grave. Gjithë jetën me shkarravina anonime arnë mbi arnë. Shpifje. E kërcënime. Shkaku se: asgjë nuk ke bërë të hajërt në jetë. Populli thotë: E hedh gurin dhe e fsheh dorën. Natë e ditë në pusi pas porte duke na i ndërsyer këlyshët me zgjebe edhe për një asht shpërblim. Frikë kam se, një ditë do të të shoh edhe me pashterkë të kuqe. Shami kuqezi me oja mbi kokë. Ferexhe të zezë deri në fund të këmbëve. E di ti fortë mirë se, çka do të thotë për mua Nusja me pashterkë të kuqe. E kam kudo si personazh letrar andej – këndeje nëpër librat e mi që rrinë

kokë më kokë në bibliotekë. Kopilat e saj, që në kohën e “artë” komuniste na i lenin para dere, të pragu i shtëpisë. Edhe në kohën e soçme “demokratike” na i lënë para dere lyrekë me nga një biberon në gojë. Vallë, kurrë nuk të ka shkuar mendja se, mu ti mund të jesh ajo Nuse me pashterkë të kuqe?!

Nusja me pashterkë të kuqe në komunizëm, edhe në kohën e soçme në “demokraci” në ballë të partive tona politike, që shumica i janë turrur dhe i turren përmbropa se: i ka mashtruar me bukuri. Edhe, na e ka bërë me sy pas perdeve të dritareve të vogëla të haleve në Katund. Shami të kuqe. E kemi marrë nuse me shkusë. Krushq e koçi të mbuluar me qilima të qëndisur me këmbë arushe. Këngën e njohur të krushqëve para koçisë nëpër dasmat tona shqiptare:

*Hajdeni bini djemtë e Shalës
Përmes Sarajeve të Pashës!...*

Ose, Xha Habibi para koçisë me flamur në dorë:

*Haj – haaaj, kasolla me kashtë
Sot një javë nja pesa - gjashtë!...*

Natën e Madhe, kur kemi hyrë dhëndër në odë, ia kemi hequr shaminë, gati na ka rënë të fikët kur e kemi parë se na e kanë ndërruar nusen. Cucë tjetër na kanë nxjerrë pas perdeve në dritare, e cucë tjetër na kanë futur në koçi si nuse.

Përçudi, pasi e kemi rrëzuar në shtrat... Ose: ia kemi ngritur këmbët në hava nëpër errësirë, na ka dalë kurvë...

Dhe, të nesërmen i jemi ankuar Xha Habibit: pse bre burrë me këngë, pushkë e gjithë ata krushq na e fute këtë nuse - shtrigë në Shtëpi?! Plaku me mustaqet vesh më vesh, pasi buzëqeshi na u përgjigjë me ironi: Vallahi - bilahi, ç'këtë punë nuk e kam ditur, se po ta dija në mes të udhës do ta zbrisja me gjithë krushka nga koçia...



TËRBIMI I KALEMXHIUT MELEZ PARA VITIT TË RI

Intelektuali shqiptar, edhe pse jeton në kushtet më të vështira dhe të ashpërsuara deri në pikën kritike, përsëri nuk mund të rri anash pa u rrokur fytyra me trusakatët, pseudoshkenctarët dhe intelektualët e rrejshëm. Ose, siç do të thosha ndryshe, Kalorësit e arratisur që i kanë hipur Rosinantit dhe trillojnë akuza nga ato më të rëndat se, gjoja i kemi të gjitha, nga çerdhet e fëmijëve e deri te universitetet edhe nëpër katunde: gazetatat e përdtishme, shtëpitë botuese, Teatrin Shqiptar, Radiotelevizionin Shqiptar, Institutin “Pjetër Bogdani”, Muzetë e “Lirisë”, Muzeun e Alfabetit...

Vallë, a mund t’i mbyllë sytë Intelektuali shqiptar para gjithë kësaj propagande dhe dhune të partive politike shqiptare, që e sakaton pa mëshirë arsimin dhe kulturën shiptare. Jo. Ama, si t’u ndalet turri këtyre Don Kishotëve shqiptarë që e vazhdojnë sulmin po me të njëjtat metoda komuniste, duke i thelluar masat antishqiptare, kur shqiptarët afirmohen nën parullën demagogjike të “barazisë së plotë kombëtare”, “vëllazërim – bashkimit”, ndonse këtë parullë mashtruese tanime e ka kuptuar i tërë populli shqiptar?! *Me: punë – punë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë*, siç do të thoshte Naimi. E, a ka punuar Intelektuali shqiptar natë e ditë? Me siguri po. Atëherë, pse Maqedonia sovrane është

Trekëndshi i Bermudeve, nuk e afron Intelktualin shqiptar, nuk e merr pranë vetes në gji? E di vetëm një gjë, se fushata e organizuar mirë nga aparati burokratik, gjeti edhe më fuqishëm shprehje mu në demokracinë e temrrshme neokomuniste. Intelktualit Shqiptar nuk i ofrohet përsëri vendi i merituar i punës, nuk e thërrasin nëpër tryezat e rrumbullakta, nuk e ftojnë nëpër simpoziume shkencore, manifsttime kulturore, në përrurimin e librave... Me sopatën e madhe shtyp rebelimin e ideve të tyre dhe i dënon të punojnë, të marrin frymë jashtë institucioneve shtetërore. Autorin e këtij shkrimi si të padëgjueshëm, e degdis dhe e dënon edhe më tej të punoj si shkrimtar me profesion të lirë, i cili tashmë nuk do t'i shpëtojë as edhe cenzurës partiake, ndjekjes frontale nga gjysmakët dhe gjysmanalfabetët (shkrimtarët e vetëquajtur), Intelktualët e Rrejshëm dhe Komunistët e arratisur nëpër parti politike, unione dhe shoqata neokomuniste. Përderisa, shkrimtari kryengritës do të ndiqet dhe dënohet si i papërmisueshëm në shtetin "demokratik", Këlyshi i Llagut po në të njëjtin shtet si "patriot" dhe i përshtashëm do të rrokulliset bythekrye nëpër brekët e partive politike deri te posti më i lart, kryetar dege në Katund, ku edhe do të shpërblehet për merita të "pakapërcyeshme" nga partia në pushtet me një vend pune si "pëllumb postier". Vetëm, fatkeqësisht partia nuk të bënë shkrimtar. Trusakati melez këtë e kuptoi shumë vonë, kur e përzunë nga radhët e veta me një shqelm bythëve të gjitha partitë politike dhe, kur e kuptoi se nuk

ia ka dhënë Zoti dhuntinë e shkrimtarit, tymeflake nxorri nga goja e bytha. Tërbimi, kalemxhiut melez ia ka krimbur trutë, qorruar të dy sytë në ballë. Fajin e kërkon në komunizëm, demokraci si argat partiak, e harron se është pa talent, i zhveshur lakuriq nga vlerat artistike. I papjekur ende jeshil, si kungull Stambolli mes avlive të Përtejzallit. Kalemxhi me brekë të arnuara arnë mbi arnë nëpër parti politike. Mosmirënjohës ndaj partisë politke, që së paku për “vlerat artistike” që ka, i dha një torbë taxhi, e punësoi si “pëllumb postier” province të mos vdes edhe për bukën e gojës. Tekefundit, asaj edhe duhet thënë felemnderit për këtë gjest human.

Durim, mos qaj pse nuk mund të bëhesh shkrimtar i madh! Edhe shumë të tjerë si ti nuk ia kanë arritur qëllimit, po si ti nuk vajtuan, nuk derdhën lotë, nuk u tërbuan duke shpifur e hedhur gurë e dru mbi shkrimtarët e talentuar që posedojnë dhunti hyjnore. Ose: për sojin e kalemxhiut melez, janë profetë. E di edhe se ti nuk ke faj, fajin e ka partia që të dalldisi me taxhi se, ti mund të bëhesh një ditë edhe shkrimtar. Po, edhe ajo nuk ka gjithaq faj. Shkaku se: nuk e ka ditur se nga e ke genin ti si fis i mullinxhijve. Thonë, edhe se je nip Poreçje (fshat serbo-sllav). Nuk ka kjo rëndësi, po ka rëndësi se artin nuk e ke në shpirt, në gjak. Nuk të japin gji ty Tri Zana të maleve. Fuqi për luftë si Mujit e Halilit. Prandaj, mos e pritë më Muzën që u takon bejlerëve e aristokratëve, kthehu te puna e “pëllumbit postier” në Katund, ose mullinxhiut që e ke trashëgim nga babai!

Vështirë nuk e ka edhe tipi intelektualit shurdhmemec, i cili do të pëlqejë rehatinë, kolltukun dhe vendin e merituar të punës në Qeveri, Ministri ose në redaksi të gazetave dhe radiotelevizioneve partiake, duke u kënduar himne e duke u duartrokitur neokomunistëve të arratisur, strehuar nëpër parti politike, unione e shoqata “humanitare”. Tipi tjetër i intelektualit servil me shokë, kur ta lypë nevoja (sa herë që t’i thotë partia), do t’ia ndërsejë këlyshët e tërbuar tinëz pas shpine shkrimtarit rebel dhe herë pas here do të shkruaj ilahi për Ramaznin në faqe të parë nëpër gazeta fetare, do të bëjë intervista me veteranë fetarë për hapjen e medreseve dhe ndërtimin e xhamive me dy e katër minare nëpër Maqedoni, sa herë që ta dojë policia fetare, tash: “me Zotin përpara” nën moton e “demokracisë”... Edhe atë, në këtë kohë kur fëmijët tanë nuk kanë godina shkollore, libra gjatë këtij viti shkollor që është në ikje, dhe atij të Riut që vjen me thes të zbrazët në krah pa dhurata.

E, të mjerët, fatkeqësisht, ende vazhdojnë të jenë nën fronin e shërbimit direkt të shefave të Vetëshërbimit të mallit “kulturore dramaturgjik” në Bit –Pazar, të cilët, më shumë se aparati i specializuar për ndjekjen e ideve, me ndihmën e partive politike shqiptare i mbajnë ende frerët e cenzurës së fshehtë të vlerave ideoartistike.

E gjithë kjo tregon se, intelektualit shqiptar në Maqedoni është ende i ndjekur, i reduktuar në minimum, duke ia mbyllur të gjitha dyert e “Qendrës tregtare”. Vetëm jo, edhe Këlyshi Melez i Llagut me shokë. Nuk duhet harruar këtu

pa i përmendur edhe mashat e tyre – këlyshët me zgjebe, që brenda një dite i luajnë disa role: edhe të politikanit, edhe të patriotit, edhe të shkrimtarit, edhe të kurvës... E pas tyre edhe kritikun e Mëmëdheut Doktorziun, që natë e ditë i mbanë gjallë nëpër mjetet e informacionit si shkrimtarë me perspektivë, që këta më në fund ta propozojnë nëpër komisione të Qeverisë, Parti politike, universitete dhe si anëtarë komisioni në ndarjen e çmimeve tradicionale në nivel republikan. Dihet, pasi ta kenë arnuar me shumë mundime ndonjë libër teknefes, i kanë shkrur njëri – tjetrit letra dashurie.

Natë e ditë çirren sa munden nëpër gazeta, internet e dritare këta burra të pushkës e penës për demokraci, arsim, art e kulturë. Nuk njohin kufij, as mure në Bashkimin Evropian... E harrojnë se përsëri si dje, edhe sot rrinë në pusi pas porte t'ia ndërsejnë pas shpine Këlyshin e Llagut autorit të këtij shkrimi.

Ajme, këta “gjeni” liberatorë, do të bërtiste, po të ishte gjallë Fan Noli. E unë do të vazhdoj po me vargjet e Nolit të madh: “*Ku e lam e ku na mbeti, Vaj Vatani e mjer mileti*”?! Edhe këtë Vit të Ri: Komunitetëve të arratisur, Intelektualve të rrejshëm, Eksponentëve të “vëllazërim – bashkimit”, Shefave të Shtëpisë publike, Këlyshëve me zgjebe, Kalorësve të arratisur...

Që, nëpër betejat e “përgjakshme” për liri edhe nesër si dje të brohorisin nëpër foltore: ja vdekje – ja liri, të cilët turren të ulen në rendin e parë, para këmbëve të hoxhës me tespihe kuqezi t'i luten Allahut...

POPULLI E THOTË: NUK BËHET SI THEM UNË

E vërtetë, nuk e luan as topi. E thotë populli: *nuk bëhet si them unë*. Nuk e them unë, autori i këtij libri. Edhe atë, secilin që e takon në rrugë dhe e pyet: Çka do të bëhet me ne shqiptarët?! Aty për aty të përgjigjet: nuk bëhet si them unë. E populli shqiptar historikisht ka qenë popull luftëtar, i besës dhe i paqës. Edhe shkrimtar. Kurrën e kurrës nuk ka qenë popull pushtues. Fatmirësisht, populli ynë ka plot thënje të këtilla antologjike. E ka edhe një thënie, që nuk e ka shopen në Letërsinë popullore: *si të kruan dora jote, nuk të kruan dora e tjetrit*.

E tjetër punë është ajo se, ne i kemi besuar të na kruaj dora e huaj, tjetrit. Përmëkeq, edhe i besojmë edhe sot e kësaj dite. Nuk e di, prej nga gjithë ai besim, kur ne si shqiptarë, vështirë i besojmë edhe këmishës sonë me arna të veshur në trup, fisit, gjakut. Megjithatë, vazhdon të na kruaj dora e huaj me vite. Arsye kjo, që edhe i kemi punët, përsëri siç thotë populli: lesheli deri në këtë derexhe. Muhamedi a. s. do të thoshte ndryshe: *pa vatan nuk ka iman*. Dhashtë Zoti, edhe kësaj radhe nuk mendoni për shtëpia dhe gra nëpër Lëmë. Pejgameri ynë i fundit, gra dhe shtëpia ka pasur sa t'ia dojë qejfi. Tjetër problem ka pasur ai burrë mejdani.

Po, çfarë populli qenka ky populli ynë, që ende është gjallë nëpër shekuj, popull

antologjik?! Dhe, për çudi, si është e mundur një popull si ky kaq trim e fisnik, të jetë edhe sot e kësaj dite i coptuar nëpër histori edhe në robëri?! E çuditshme, ë? Unë nuk e kam të qartë. E ju?! Vërtetë, nuk di ku ta hudh fajin e ku gurin matanë kodrës në lëndinë. Popullit shqiptar, jo se jo. E ka dhënë provimin nëpër shekuj, në luftë herë me Kral e herë me Mbret. Atëherë?! Dihet, edhe një herë do ta përsëris një thënie të t'im Ati: këtë popull, gjithmonë e kanë shitur njerëzit e “ditur” dhe hoxhallarët. Përsëri do të vij koha, që këtë popull një ditë ta shesin “toptan”: njerëzit e “ditur” dhe hoxhallarët.

Populli im trim dhe i besës, që nuk e di ende kush të ka hipur në shpinë. E në shpinë të ka hipur armiku shekullor, “vëllai” yt, halldupi. E ti përpiqesh ta vazhdosh rrugën dhiareve me gjithë këtë barrë mbi samarë. Prandaj, edhe rrugës të mirren, ngatërrohen këmbët. Mezi e kalon urën matanë Lumit. Rrëzohesh. Ngritesh përsëri me gjithë barrë në shpinë për ta vazhduar rrugën për në Baba Tomorr.

O Imzot! Është koha ta hudhish barrën nga shpina. Edhe samarin. Ose, përpiqu këtë samarë t'ia vësh në shpinë “vëllait” të Njerkës, le të shohi sa është i rëndë nëpër shekuj. Edha barrën, ngarkoja mbi shpinë! Po. Po, edhe barrën me gjithë samarë se, ky “vëllai” yt, gjithë jetën barrën ta ka ngarkuar ty mbi samarë. O, burrë! Hidhe samarin me gjithë barrë në lumë! Edhe një herë e përsëris: Është koha të shpëtosh përgjithmonë nga samari. Dhe, barra që ta kanë ngarkuar të huajt me shekuj mbi shpinë.

Im Atë këtë e thoshte pranë oxhakut, zjarrit të ndezur me flakë në Katund dhe ma përcillte mua si pasardhës i brezit në këtë shtëpi, Ditës së nesërme. Pa e ditur, edhe pse mua ma kishte lënë emrin e kaçakut të maleve: Kalosh Zajazit. Burrit të pushkës e besës, që kishte luftuar krah për krah me Bajram Currin edhe në Kosovë edhe në Shqipëri për Atdhe. Në bisedë e sipër një ditë i erdhi te hunda, edhe më tha plot inatë: gjatë kohë prita kot, nuk u bëre trim si Kalosh Zajazi, kaçaku i maleve, po u bëre shkrimtar. Përmëtepër, nuk e shkrepe as edhe një fishek nga pusia. Unë vetëm buzëqesha. Shkaku, nuk guxoja t'ia kthej fjalën tim Ati. Edhe pse kisha të drejtë se një ditë, atë që e bëri Kalosh Zajazi me pushkë për Atdheun, unë do ta bëj të nesërmen me penë në letërsi.

Vite më vonë u binda: erdhi koha, që këtë popull përsëri ta shesin njerëzit e “ditur” dhe hoxhallarët. Edhe e shitnin shumë lirë: për një post në Qeveri, për një tender në biznes, për një anëtar komisioni në Akademinë e Shkencave, për një anëtar komisioni në ministri, për një banesë luksoze, për një vend pune në kabinet...

Dhe, tek tashti e kuptoj pse im Atë thoshte: *për pleshtin e djeg jorganin*. Dorën në zemër, im Atë kishte të drejtë. Përderisa ne shqiptarët, për pleshtin nuk e djegim jorganin, ende do të na shesin trusakatët toptan te “vëllezërit” e Njerkës. Gjithë jetën do të punojmë argatë në arat tona pjellore të trashëguara brez pas brezi. Nata do të na zë në fushë me vegëla pune. E dita mbi varre, qafë për qafe me të vdekurit. Ende pa lind dielli me hebe në krah, në mes të fushës. Farën ta

hedhim mes atyre ugareve me sorrat mbi kokë të Dardha Gorrice, që të kemi bereqet për Dimër.

Politikanët tanë, fatkeqësisht ende: *për pleshtin, nuk e kanë djegur jorganin*. Realiteti ynë, që nuk na hanë pleshtat, po na hanë morrat. Megjithatë, populli e ka një forcë natyrore. Edhe atë, patjetër duhet ta përdorë gjatë zgjedhjeve të ardhshme demokratike. Nuk duhet t'ua jap më votën e shenjtë partive politike, që vite me radhë e shesin “toptan” në Qeveri. Edhe atë, shumë lirë: një torbë taxhi.

Vite e vite është dashur të kalojnë dhe unë të bindem, pse im Atë thoshte: *për pleshtin e djegur jorganin*. Unë e dija se, ai kishte nderuar gjithë jetën këmbëkryq në sofër me mauzerrin në prehër, e kishte pritur agimin me burra pushke e të ditur, djemë trima të Atdheut, që i kishin kryer Akademitë ushtarake në Itali e nëpër botë. E mësoi historia. Mësuesë patriotë që në atë kohë kur ka qenë ministër i arsimit Ernest Koliqi, kishin ardhë vullnetarë në këto vise të Shqipërisë si mësuesë për të përhapur shkronjat shqipe dhe dijen edhe në këto anë mes maleve. Po ja, që ende nuk e dija se, pse ky burrë i pushkës dhe besës: *për pleshtin e digjte jorganin*.

Dhe, plot pas pesëdhjetë vjetëve në “demokraci”, u binda një ditë se, pse im Atë: *për pleshtin e digjte jorganin*. Shkaku se, edhe mua autorit të këtij libri më erdhi koha një ditë: *për pleshtin ta djeg jorganin...*

RRUFJANI GËRHET PËR LIRI

Hi-hi-hiii... Përsëri zgjimi. Zgjimi, që pas një nate të gjatë, më shkundi në agim. E ngarkova Vetën në shpinë, e lidha nje dhe këmbadoras u nisa dhiareve për në Baba Tomorr me këtë këngë:

*Unë nuk e dua këtë Shtet. Ferrparajsë
Që e duan trusakatët. Rrugatët kuqezi.
Rrospitë Meshkuj. Dhe, Doktor Ziu.*

Unë e dua Mëmëdheun! Dhe, Atdheun.

*Unë nuk e dua këtë Shtet policor. Ferrparajsë
Ku ma dhunuan Mëmëdheun. Dhe, Atdheun.
E shtiret se më do shumë Mua Poetin rrebel
Pusi më vë pas ferre. Rrugën mos ta vazhdoj
Për në Baba Tomorr. Atdheun e perëndive:
Vera ku pihet. Shkruhet poezi e bëhet dashuri.*

Unë e dua Mëmëdheun! Dhe, Atdheun...

Rrezik është, kur Këlysh Melezi me zgjebe në mes të ditës gërhet për liri. Policia letrare me lëvizjet që bëjnë pas shpine, nuk shquhen aspak për bukuri të përjetshme. Dhe, nuk e kanë as kuptimin e të përjetshmes. U mbetet vetëm t'i dëgjojnë këlyshët e tyre me zgjebe nëpër mjetet elektronike të informacionit, të shkruajnë nëpër gazetatat dhe revistat e tyre policore, internet, ose t'u duartrokisin: "sa bukur! U lumtë!" Po, vallë, a

nuk ju duken se kërkujnë forma mosletrare për të mbuluar paaftësinë e të shkruarit, të bërit art. O Imzot, sa esëll janë në letërsi dhe politikë, në atë që e shkruajnë dhe e thonë nëpër mjegull...

Me plot gojën e them: Thyeni qafën nga politika, kultura dhe arti i shpirtit! Kultura shqiptare është si zjarri. Djeg dhe spastron, hedhë në gjyqin e vlerave. Gjiriz.

Pjella e keqe që nuk ka pi ujë në Burimet e pastërta të maleve tona: Baba Tomorr, Drenovë, Sharr, Çelëvjollcë, Bjeshkët e Nemura... po në Kënetat dhe Hurdhat sllave, pas Karpateve... dhe, e urren artin e vërtetë, sheh fundin e vet të mjerë, e kanë ngritur bishtin dhe kudo dhesin kakërdhia nëpër livadh...

Shqiptarët duhet të hapin një rrugë të tyre drejtë maleve. Burimeve. Patjetër, duhet të hipin në Baba Tomorr. **Atdheun e Perëndive. Tyrben ku pihet vera, shkruhet poezia dhe bëhet dashuri...** Shkurt, t'i dalin zot vetes... Besës... Trimërisë... Atdheut... Rrugë kjo, që kalon përmes mohimit dhe Vdekjes...

Aparati burokratik komunist, e ka pjellë Policinë letrare. E ka shpallur Kulturofagun kryepolic të letrave shqipe, për të mbajtur nën zingjirë krijuesit e vërtetë, duke ua ndërsyer këlyshmelezët me zgjebe... Edhe në Kosovë... Edhe në Shqipëri... E ka zgjëruar rrjetin policor, mbledhur informata, që më vonë të kthehet në kabinet, shtoj numrin e Policisë letrare për të mbajtur nën zingjirë kulturën shqiptare dhe talentët e "rrezikshëm" për shtetin...

Hidhni sytë përreth! Vështroni! Dhe, çka shihni?! Gazeta dhe revista policore. Kudo mbijnë si këpurdhat pas shiut. Edhe atë, në provincë. Katund. E lëvdojnë njëri - tjetrin, e ngrejne në qiell. I thurin hymne. E bëjnë artin e arnimeve me arna të vjedhura. Asgjë origjinale. Kombëtare... Hale katundi...

Policia letrare që e ka ndërsyer Këlysh Melezin me zgjebe, di të kujdeset edhe për gjeneratën e re të shkrimtarit, studjeuesit dhe shkenctarit, që të mos infektohet nga “armiqtë e shtetit“. Përpilon planprograme shkollore. Tekste shkollore dhe lektyra shkollore me vlera sakate duke i flakur nga institucionet shkollore vlerat e vërteta të arrira letrare e kombëtare.

E pyes veten: Kush do të jetë prijësi që do të na e kthej Atdheun?!... Populli shqiptar është i pamposhtur. Historikisht, gjatë ndryshimeve demokratike, ka qenë mbi nivelin e liderëve politikë. E dëshmoi këtë edhe gjatë ndryshimeve demokratike; edhe gjatë Luftës së fundit të UÇK-së në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. E di rrugën e vet drejtë Lirisë. Jo, pse edhe kësaj radhe në këto momente të vështira do t’u prijë trusakatëve, këtyre këlyshëve melezë të Kalit të Trojës pas porte...

Askujt, të mos i shkojë mendja se populli shqiptar e ka humbur rrugën. Atdheun. Shpejt do të vij Dita, agimi i freskët, lindja e Diellit... Dhe, pasi të flakë gjendjen e fatkeqësisë së gjatë, do t’i këpusë zingjirët e robërisë shekullore.

Rrezik! Rrezik është Këlysh Melezi me zgjebe të të ndërsehet pas shpine me shpifje,

etiketime e rrena patriotike. Në rrugë, jargët t'i nxjerrë pas porte. Ditën të lehi në iriq. Ose, ta nxjerri gjuhën nga vapa dy pëllëmbë. Bishtin ta shti nën këmbë pas porte: **Gërhasë në mes të ditës për liri...**

- Zgjohu! Zgjohu, më shkundi fortë Njëra Meleqe. I hapa sytë. Dy Meleqet tjera më rrinin mbi kokë.

- I zgjuar jam...

- Atëherë, ç'bënë?! Pse fol jerm?!...

- E pash një ëndërr të keqe ditën...

- Hi-hii-hiii... Ne nuk mund të shohim ëndërra natën. E, ti sheh ditën...

- Epo, këtu qëndron magjia... Unë ëndërrat i shoh ditën...

- Tybeistifa! Mëshirë, o Zot! E paskan pushtuar xhindet...

- Edhe më rrahin, më mbytën dajak. Dorë më dorë gjithë natën më hedhin majë lisave... Çati më çati...

- Lidhjani duart! Edhe këmbët! E kanë çmendur kurvat... Edhe tri herë duhet përshkuar te Dy Lisat e Çukës...

Dhe, më përshkuan njëherë... Edhe njëherë... Edhe njëherë... Një hajmali ma varën përqafe. Thanë: Mos të munden t'i afrohen xhindet... Nusja me pashterkë të kuqe me dy shami lidhur për brezi...

-Tashti, tha Njëra nga Tri Melaqet duhet nxjerrë në Diell te Guri i Zi. Nëntë ditë e nëntë net duhet ta terim vetëm me një këngë të grave...

Dhe, më nxorrën në Diell te Guri i Zi në majë të Çukës. E nisën orgjinë. Unë në kokërr të shpinës, përsëri ia thash këngës:

*Nuk e shihni si lehin pas shpine. Ndërsehen
E nxjerrin gjuhën dypëllëmbë. Përjagen në
Mjetet e informacionit. I japin njëri tjetrit guxim.
Edhe lëvdata. Turren me të katra deri te porta.
E kthej pas kokën. Më dhimbsen mjeranët
Kur i shoh kaq të vegjël. Këlyshë me zgjebe.*

*Mund t'i ha kur të dua meze. Pi me Miken
Dolli me verë. Po, nuk e meritojnë këlyshët...*

- Edhe një!... Edhe një!... Edhe një!...
Duartrokisnin Tri Meleqet...

- Jo. Mjaftë e keni një!... Tjetrën do ta dëgjoni Ditën e dhjetë...

- Po, ne nuk e kemi ndërmend të të mbajmë në Diell dhjetë ditë...

- E di, ju do të më terni në Diell nëntë ditë e nëntë net... Ditën e dhjetë do të fluturoj në Baba Tomorr... Vendin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia... Dhe, bëhet dashuri...

- Hi-hii-hiii...Mjaftë fole më jerm!... Marrëzira... Edhe Ditën... Edhe Natën... Nuk e di, kur je në gjumë... E kur, i zgjuar...

- E di, kur jam në ëndërr... U thash, njëherë: Unë ëndërrat i shoh Ditën...

- Budallai... Prapë me ëndërra... Ne nuk mund t'i shohim Natën... E ky na i shihka Ditën... Të mjerat ne, si do t'i primë para në këtë

gjendje për në Baba Tomorr... Tyrbe... Varrin e tij me libra...

- Lehtë... Xhindet mi përzeni!... Nusen me pashterkë të kuqe... Me gjithë këta shtriganë në shpinë nuk mund të hip në Baba Tomorr...

- Ne t'i përzëmë Ditën... Po, ti përsëri i thirr Natën...

- Jo. Unë nuk i thirr as Ditën...E as Natën... Ato vijnë vetë...

- Hi-hii-hiii... Vijnë vetë, ë?!... E kush i thirr me poezi?!...

- Unë, jo! Kalosh Çeliku...

- E, kush është ky që e terin në Diell?!...

- Kalosh Çeliku...

- Edhe këtë e kanë pushtuar xhindet?!...

Nusja me pashterkë të kuqe...

- Po. Edhe atë, e hedhin dorë më dorë majë lisave... Çati më çati... Pak para agimit e kthejnë mes Tri Meleqeve...

- Hi-hii-hiii... Po, ne jemi ato Tri Meleqe... Njëra të pri para... E Dy të tjerat të mbajmë për krahu...

- E di. Edhe atë, sa ditë rresht do të më terni në Diell...

- Edhe tri ditë e tri net... Tashti futi edhe një sy gjumë!... Ëndërr... Poezi...

Imzot, Këlysh Melezi me zgjebe gërhet për Liri????!!!...

KALAJA MERRET NGA BRENDA

Amani, u lodha më me gjysmanalfabetët, rrugaçët e partive politike shqiptare kuqezi - “demokratë”, ma hapni derën të ik nga sytë këmbët! Njëri kërkon: federalizimin e vendit. Tjetri: Gruevski kryemnistër deri në qershor! I treti: Iliridë. Më vjen keq, po ua them publikisht: analistët i keni gjysmanalfabetë. Kalorësit e arratisur, që nuk e kanë gjetur veten: nëpër redaksitë e gazetave të “pavarura”, partive politike si zëdhënës të tyre, “shërbetor besnik” ose, partizanë partiak me një torbë taxhi për qeafe... Poashtu i keni gjysmanalfabetë edhe këshilltarët, komunistë të shkolluar në Kumrovec që në “kohën e artë” të shokut Tito. Këlyshët me zgjebe, poashtu: nuk dinë ku e kanë kokën e ku bythën. Vetëm se, e dinë taxhinë që i pret në grazhd. Thashetheme: Njëri: “nuk do të hyj në qeveri nëse eventualisht BDI del prej saj. Tjetri: kurrën e kurrës nuk do të hymë në qeverinë e Gruevskit, nëse BDI del nga qeveria.

E unë autori i këtij shkrimi them: BDI duhet të rri në Qeveri, aty ku e ka edhe vendin! Shkurt, ende nuk i ka paguar borxhet ndaj popullit shqiptar, nuk duhet ta lëvizi as këmbën matanë pragut! Ose: të dali në Lëmë, heqi valle. E di ajo: i ka borxhe të mëdha këtij populli: katunde të djegur deri në themele, ara me grurë, male me lisa, pasuri natyrore... Barazi të plotë kombëtare... Shtet shqiptar... Përmëtepër, edhe

gjak. E gjaku: nuk paguhet me para. Tjetër, është ajo: nëse, shqiptarët kanë ndonjë faktor të nesërm politik, që nuk e kanë provuar deri më tani në fushën e mejdanit për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan. Faktorët e deritanishëm politik shqiptar i kemi provuar edhe me nga dy mandate në Qeveri. Dhe, i hidhni një sy politikës shqiptare pas viteve nëntëdhjeta: që nga dalja e partisë politike shqiptare PPD në skenë, e deri te partia më e re politike shqiptare, Demokracia e Re! Nuk e shihni se, janë shkollë politike dhe kuadër i PPD- së, të njëjtit trusakatë njëzetë vjet me radhë i ngatërrohen nëpër këmbë, parti politike popullit shqiptar?! Është koha, të dalë një faktor tjetër politik shqiptar në IRJM -së. Edhe atë: I përgaditur profesionalisht për politikë. Fusha e mejdanit kërkon burra me mustaqe, trima të ditur dhe të aftë në përdorimin e armës politike. Politika nuk është si lufta me armë në dorë katundeve të Kumanovës, në Haraçinë dhe maleve të Sharrit, Përveshni duart deri në bërryla! Edhe këmbët deri në gjunj!... Populli thotë: një ditë të vret tambëli i Nënës ...

Edhe sipas një shkrimi tjetër, në gazetën e “pavarur” të përditshme: Dihet kush është “gazdë e kush “hyzmeqar”... Hi-hii-hiii... Mjerim. Shkruani budallaki: “vetëm deri në ora 12 kanë funksionuar të premeten institucionet shtetërore, në ditën e Premtes së Madhe, që ishte festë për maqedonasit. Nëpunësit dhe funksionarët shqiptarë nëpër institucione shtetërore kanë qëndruar deri në ora 12, e pastaj kanë shkuar nëpër shtëpi. Çka mund të bëjmë ne kur jemi më


pak se 10 përqind në institucionin ku punojmë. Erdhëm në punë dhe bëjmë sefa. Kot kemi ardhur, sepse shumica e të punësuarve janë maqedonas, kurse ata mbajnë edhe postet kyç, deklaroi për LAJM, një nëpunëse shqiptare, e cila nuk dëshiroi ta bëj publik identitetin e saj. Edhe ata nëpunës shqiptarë që kanë qëndruar pas orës 12.00 (zerot i shtoj unë, shkaku se: as autori i shkrimit e as redaksia nuke e shohin të nevojshme të shtohen zerot), kohën më të madhe e kanë kaluar nëpër kafene. Përdallim prej festave të maqedonasve, kur pushojnë nëpunësit shqiptarë pa problem funksionjnë me kapacitet të plotë të gjitha institucionet shtetërore.”

E këtu, është problemi: shqiptarëve orari i punës nuk u përfundon në ora 12.00, po në ora 16.00. Përmëtepër, them: shqiptari që të arrij deri te qëllimi kombëtar, duhet të punojë jo vetëm shtatë orë, po njëzetekatër orë ditënatë. E dyta: shqiptarët nuk është koha të bëjnë “sefa”, kur kuadri më i mirë profesional dhe kombëtar endet rrugëve i papunë. E treta: shqiptarët “kohën më të madhe nuk duhet ta kalojnë nëpër kafene, kur funksionjnë me kapacitet të plotë institucionet shtetërore”, po të ulen ballë për ballë me “vëllezërit” maqedonas nëpër vendet e punës.

Edhe e fundit: kësaj radhe nëse është për të dalë nga Qeveria, duhet të dalë VMRO – DPMNE, e jo BDI... Tekefundit, kush i pyet sot shqiptarët?! Edhe “maqedonasit” më, nuk i pyet njeri në këtë shtet “demokratik”.

E përsëris edhe në këtë shkrim: Maxhatorja (kësaj radhe nuk ia përmend emrin), pulën do ta

zë te koteci në qosh të Lëmës... Dhe, do t’jua
përgadisi, shtrojë në sofër shqiptarëve për darkë,
Ditën e Shëngjergjit...



KATUNDI DIGJET E PLAKA KRIHET

E hap gazetën e përditshme të “pavarur” që del në Shkup: *Treshi përsheshi gërhet për Liri*. Edhe me fotografi, pozojnë para syve të lexuesve me ato facat e tyre kulturo-policore të shëmtuara. Thonë: “Unë shpresoj që një ditë do të përfundojë durimi i shqiptarëve. Mendoj se do të ketë padëgjueshmëri ose refuzim të vendimeve të qeverisë...” Tjetri: “kryetari i BDI-së Ali Ahmeti viktimizohet së tepërmi dhe është jo shumë i përgjegjshëm në këtë aspekt.” I treti: “nëse vjen deri te ndarja e Shkupit kjo përfundimisht thotë ndarje edhe të Maqedonisë”.

E unë, e kthej filmin e kujtesës prapa pesdhjetë vjetëve, në kohën e tyre të artë komunsite. Po, ky Tresh Përsheshi: doktoronte, punonte në Universitet, redaksi, kabinete të Qeverisë komuniste. Dje komunistë, sot “demokratë”. Në atë kohë si komunistë fitonin tituj universitar, vende pune dhe para me thasë. Sot në “demokraci”, shesin tituj shkencor, vende pune, me tre pensione shtetërore dhe libreza kursimi brenda e jashtë vendit. Përmëtepër, edhe vajtojnë, derdhin lotë krokodoli për çështjen shqiptare, integrimin e Maqedinisë në Bashkimin Evropian. E shajnë Maqedoninë, që dje e donin me mish e shpirt. E kishin Atdhe, nuk e dinin gjuhën shqipe, po gjuhën “maqedonase” si gjuhë

me perspektivë në të ardhmen. Edhe librat e tyre i shkruanin dhe botonin në këtë gjuhë me perspektivë sipas tyre, në mjetet e informacionit, deklaroheshin si shkrimtarë maqedonas. Tjetër punë, që sot në “demokraci” mezi e mësuan edhe gjuhën shqipe dhe shkarravisin edhe në këtë gjuhë “vepra artistike kombëtare”. Gurë e dru hedhin mbi Maqedoninë. “Luftë” bëjnë për Shqipëri Etnike. Patriotët e vonuar që i shëtiten të gjitha partitë politike “demokratike”. Në fund, u ka mbetur edhe një Parti politike “demokratike” pa e shëtitur si “patriotë” të vonuar melezë. Dhe, ajo është: Partia demokratike e Varrit...

I mjeri Dhëndërr, që para emrit ka titull shkencor: Dr. dhe ende është brëlllok në një shoqëri “demokratike”, i hedhur nëpër kontejnerë bërlloku që nga koha e komunizmit. I mjeri DoktorZiu, që nuk la vend pa i futur hundët, i ka mbetur edhe një çerdhe “irredentistësh” pa e zbuluar: Haleja. I mjeri Patriot i vonuar, këlysh melez me zgjebe i DoktorZiut, që gjithë jetën nuk u rrite në qen, të lehis pas Ujikut edhe matanë portës, në Katund...

Vallë, a nuk e keni mjaftë më, me deklarata teknefese?! E patë edhe koha e juaj e artë komuniste. Hëngër fiq dhe vdiq. Tekefundit, bëtë çka bëtë në atë kohë të “artë” komuniste. Tashti, leni pak rehat të rinjtë të na prinë në këtë kohë, shekull të ri mes maleve!...

Ligje të Natyrës, më thotë një zë brenda vetes sime natë e ditë mbi libra. Këlyshët me zgjebe duhet të lehin pas Ujikut. Nuk kanë punë tjetër në jetë, përveç lehjes pas Ujikut. Shkaku:

Ujku, është Ujk. Dhe, Këlyshi melez me zgjebe nuk di tjetër zanat, përveçse ndërsimit dhe lehjes pas shpine.

Përsëri shkaku: E kanë në gojë një copë buke. Ose, ndonjë asht. Ua kanë hedhur “vëllezërit.” E Këlyshë melezët me zgjebe si këlyshë, janë shumë besnikë ndaj zotërinjëve. E ndjekin “armikun” këmba këmbës, matanë Lëmës. Edhe përtej Livadhit, deri te Jasakët e Tikeve. Majë maleve...

Fatkeqësi kombëtare: Treshi Përsheshi vazhdon të fotografohet para kamerave televizive. Në gazetatat e përditdhme të “pavaruara”. Shetë mend. Nuk u lë vënd edhe të tjerëve në kohën e soçme të thonë ndonjë fjalë, diç të re për politikën shqiptare. I kanë uzurpuar mjetet informacionit, njësoj si në kohën e komunizmit. Përditë i ngushtojnë radhët e tyre me trusakatë. Nuk duan të dëgjojnë një zë tjetër të ri pas Çuke. Veshët i kanë shtupuar me copa gazetash. Pambuk. Dhe, flasin marrëzira nëpër gazeta, debate televizive të Unionit të viçave. Ndonjëherë, edhe nëpër tryeza të rrubmbullakta të nivelit komunal e republikan, që i orgnizojnë gjysmanalfabetët për marketing politik. Hiqen si të mençur, ua ngatërrojnë punët edhe partive politike shqiptare. E thonë: populli i dytë, gjuhë e dytë zyrtare... Nuk e di pse, nuk mund të pajtohem me këta deklarata sakate. Unë mendoj ndryshe: popull i barabartë, gjuhë e barabartë zyrtare... Shqipëri Etnike...

Edhe: jo, fedarilizimit! Është zgjidhje e përkoshme për çështjen shqiptare. Them: problemi zgjidhet përgjithmonë: me Shqipëri


Etnike. Koha është të mos krijojmë më kombe artificial, shtete të vogëla artificiale si në kohën e komunizmit. Shkaku: nuk e kemi zgjidhë problemin shqiptar në Ballkan, po vazhdojmë ta zvarrisim nëpër vite. Përsëri marrveshje maqedonase - shqiptare. Edhe një gabim. Shqiptarët në mes të dy Luftërave botërore e kanë një marrveshje historike: shqiptaro - bullgare. Sipas mendimit tim nuk shoh arsye, që shqiptarët të bëjnë edhe një marrveshje shqiptaro-maqedonase. Shqiptarët mund të bëjnë edhe një marrveshje politike, po jo me një komb pa indentitet, që është duke dhënë shpirt, po me bullgarët.

Unë nuk mund t'i besoj këtij Treshi Përsheshi politik, shkaku se: Pesëdhjetë vjet me radhë ende e kam të freskët veprimtarinë e tyre “patriotike kombëtare” për Atdheun. Edhe sot, pas kaq viteve. Në fund: këtij Treshi Përsheshi, nuk mund t'i besoj asgjë se: flet jerm. Përgjumshëm. Edhe në mes të ditës, shohin ëndrra. Nuk i shihni si përjagen për Liri?! Shqipëri Etnike...Vetëm pak përcillni me vemendje çka flasin në mjetet e informacionit: përralla patetike. Theshetheme dhe asgjë më shumë në këtë kohë, kur na digjet zjarr mbi krye. Ose; si te ajo anekdota popullore: Katundi digjet e plaka krihet.

E pabesueshme, me gjithë këtë “tru patriotik kombëtar”, shqiptarët të jenë edhe sot e kësaj dite në këtë gjendje hutie, nën zgjedhë?! Po, ja që jemi se, Treshi Përsheshi prodhon vetëm deklarata patetike e jo punë, veprime atdhetare.

Treshi Përsheshi ende i ngatërrohet popullit shqiptar nëpër këmbë. Edhe në shpinë i ka hipur ky bërlllok policor, e populli shqiptar kurrësesi t'i hedhë nga shpina me gjithë samarë. Trusakatët, që janë shkaktari kryesor ende të jemi nën zgjedhë, edhe sot na detyrojnë ta tërheqim qerren e ngarkuar me kunguj Stambolli nëpër Bit – Pazar për në Baba Tomorr.

Dhe, patjetër këtu në këtë shkrim duhet ta përmendi: maxhatoren dhe pulën. Edhe ne: shqiptarët dhe maqedonasit jemi në rolin e pulës. Hiqemi se bëjmë politikë. Politikën e bëjnë të huajt (paqsorët). Vite me radhë e ndjekin pulën nëpër Lëmë. Thikën t'ia vënë në qafë për mikun që e kemi sonte në darkë. Shkurt: Maxhatorja na ndjekë të na zë te hambari, po në realitet mendon të na zë te pulaniku...



GOMARI E KA MENDJEN TE KASHTA DHE SAMARI

E kam shumë lehtë të merrem me Bariun: e kuptoj dhe më kupton si shkrintar. E lexoj dhe më lexon mes këtyre rreshtave, faqeve. Po, shumë vështirë e kam të merrem vesh me gjysmanalfabetët: nuk më kuptojnë, nuk i kuptoj, nuk më lexojnë, nuk i lexoj në Ditën e sotshme “demokratike”.

Halli?! Populli thotë: Halla do burrë! E këtyre gjysmanalfabetëve në këtë kohë, ec e gjeju një burrë! Jo, nuk ka. Nuk ka burrë me mustaqe për këta “gra” me pashterka të kuqe, që mund t’i nxjerrësh ta heqin vallen në Lëmë. Pragun e Shtëpisë ta fshijnë heret në mëngjes, ende pa dalë drita. Edhe atë: duke kënduar këngë. E hequr valle me dajre. Bërllokun të na e flukin matanë portës, në kontejnerë.

Unë u them e shkruaj tjetër e ata, diçka tjetër: “kodër mbas bregut”. Mendjen e kanë te kashta dhe samari. O gjysmanalfabetë, nuk e dua kashtën, as edhe samarin! Gjithë jetën po i bie me thupër samarit, që t’i teket Gomarit. Fatkeqësisht, Gomari me të dyja këmbët në batak, e ka mendjen te kashta... Dhe, samari...

Unë u them: nuk dua punën time ta vlerësojë Bozaxhiu dhe Hoxha! Shkaku se: nuk dinë, nuk e njohin kulturën dhe letërsinë shqiptare. Edhe ata e dinë se nuk dinë, po ja i ka zënë në befasi natën vonë partia me qerre në

rrugë. Dënimi i partisë është i rëndë, duhet të jenë të lumtur që nuk kanë përfunduar në Qeveri... Ose: në ndonjë ministri, kabinet... Fati madh i tyre, që kanë përfunduar në Ministrinë e Kulturës. Merreni me mend, të përfundonin në Ministrinë e Shëndetësisë, rroknin thikat në dorë si kasapët dha ta sakatonin njerëzimin, ashtu si dikur në kohën e komunizmit, Hoxha i Çelëvjollcës që i “shëronte” banorët e Kërçovës. Që, ua rrate me të dyja duart gjilpërat ku mbërrinte: çka të dhemb ty, koka? futja, në kokë! Ty, veshi? Rrasja në vesh! E ty tjetrit, syri? Edhe këtij, rrasja në sy! I sakatoi pacientët mu si doktor Adham-uti i Çajupit disa vite me radhë banorët e kësaj ane, përderisa nuk i ranë një ditë në gjurmë policia. Dhe, kur kishin shkuar në shtëpinë e Hoxhës, çka të shohin, gati i lanë mendtë: një dhomë plot me barëra, injeksione dhe thika të operacionit?! Interessant, nuk kishin gjetur asnjë hajmali. Edhe pse, hajmalitë do t'i kishin hije këtij “doktori” popullor.

Hoxha vite me radhë e kishte ushtruar profesionin e mejkut në Kërçovë, njësoj si këta kasapët tanë “letrar” me thika në dorë, që i janë turrur kulturës dhe letërsisë shqiptare. E kanë sakatuar për vdekje, po falë Zotit ende është me pak shpirt, ndoshta e kthejmë një ditë të nesërme në jetë, para se ta varrosin të gjallë këta “doktorë” kulturor të partive tona politike. Tekefundit, pasojat edhe nuk janë aq shumë të mëdha, saqë mund të ishin në Ministrinë e Shëndetësisë, fundekrye katastrofale.

E trusakatët: “Kalosh Çeliku shtiret, ka mjaftë tituj të librave. Është kundër myslimanizmit, hoxhallarëve dhe minareve të xhamive”. Dhe, përmendin shifra marramendëse, flasin e shkruajnë jerm.

O trusakatë, e thashë edhe më lartë: nuk dua të më vlerësojë Bozaxhiu dhe Hoxha! Nuk kam kurgjë kundër këtyre individëve e as profesionit të tyre, po nuk kanë “haber” nga kultura dhe letërsia shqiptare. Përmëkeq, nuk e njohin edhe gjuhën shqipe. Shkollimin, në bazë të komenteve që i shkruajnë me pseudonime, plot gabime gjuhësore e drejtshkrimore, me siguri e kanë kryer në gjuhë të tjera duke blerë diploma të rrejshme. E ata, përsëri i bien të njëtit teli të çiftelisë me dy tela: nuk dimë çka kërkon Kaloshi. I kemi dhënë mjaftë tituj të librave kët vit, edhe kashtë...


Jo, nuk është këtu problemi: ma dërgoni një Çoban katundi, se me siguri është mbi nivelin e juaj intelektual! Tekefundit, ai së paku di t’i ruaj delet, kullosë në male, mjelë me kusi, qethë me gërshërë te stanet... Edhe t’i bie fyellit nën dardhat gorrice te Përroni i Thanës...

Dhe, seç ma kujtoni përsëri tim Atë, herë pas here ma thoshte edhe këtë urti: “*Mos u bë morr, po bëhu plesht!*” Përçudi, tash ma kujtonte këtë mençuri një lexues – komentues. E kuptoj lexues-komentuesin: nuk është e thënë t’i pëlqejnë shkrimet e mia, t’u duartrokisë shuplakë si në kohën e komunizmit. Përmëkeq, kam frikë se ky lexues-komentues e ka gjetur veten në këtë shkrim, siç edhe e zbuloi veten pavetëdije duke

hequr ferexhenë në shkrimin tim tjetër: *Edhe Hoxha vendos për vlerat e shkrimtarit dhe kulturën shqiptare*. Ose, i ka, gjetur shokët e tij tokmakë Anadoli, që e mbajnë përkrahu të mos rëzohet rrugës në baltë.

Nuk ka rëndësi kjo për lexuesin, e rëndësishme është se shkrimi im i është dukur përslesh. E harron se, specialiteti i ushqimit kryesor i Skënderbeut ka qenë: PËRSHESHI ME KOS... Përseshi është specialitet shqiptar, “miku” im Halldup. Nuk është bakllava me arra, sutliashi, e as tullumba me bozë... Është: përseshi me kos...

Dhe, në fund: Gomari e ka mendjen te kashta dhe samari...



DUM DUMI

Anekdotën e Nastradinit dhe gomarit e dini, nuk ka nevojë mes këtyre rreshtave t'ju marr kohë. Ose: me theshetheme t'ju shurdhoj veshët. E kam përsëritur disa herë nëpër shkrimet e mia parashikuese për Ditën e nesërme me Diell në Baba Tomorr.

E tashti ka ardhë koha, gomarit t'i hipë Nastradinica. Pse Nastradinica, do të pyes lexuesi im besnik?! Hi-hii-hii... Nastradinica e ka radhën t'i hip gomarit. I ka hipë Nastradini, pse të mos i hipë edhe Nastradinica?! Ama, ju do të thoni Nastradini me gjithë tesha i ka 55 kg. E merreni me mend kur t'i hip në shpinë Nastradinica me 120 kg. mbi samar?! Ë?!

Patjetër, këtij gomari duhet t'i hipë edhe Nastradinica me 120 kg. në shpinë! Vetëm, atëherë ky gomar do ta ndjej barrën mbi kurriz. Edhe do t'ia di vlerën barit në livadh. Hë për hë, ky gomar i Nastradinit asht e lëkurë, nuk e ndjen barrën në shpinë pa i hipur edhe Nastradinica me 120 kg. mbi samar me një thupër thane bythëve.

Politikanët tanë bëjnë luftë për pushtet. Njëjtë si Nastradini dhe Nastradinica, kush t'i hip gomarit. Amani, na mbytën kulturofagët! Gjysmanalfabetët, që i ndërrojnë partitë politike si kurva burrat: herë sekretar partie, herë ministër, herë deputet, herë ambasador, herë professor universitar, herë analist politik... Përditë i shoh në rrugë duke i përdredhur bythët, e shesin mend me

deklarata: para kamerave televizive, në gazeta, tribuna shkencore, debate për librin... Edhe si analistë në gazetën e tyre të “pavarur” partiake me kolumna. Thonë: Partia na ka dhënë poste, fabrika për prodhimin e diplomave, doktora shkence, shkrimtarë, gazetarë me thasë... E vërtetë, na ka dhënë edhe na jep me kamionë. Edhe tipin e veçantë origjinal të Dum Dumit. Që, edhe pse sot nuk është në post partiak, merr rrogë në Qeveri pa shkuar fare në punë. E, merreni me mend, kjo Qeveri sikur t’u jepte rroga shkrimtarëve. Dhe, ata kurrë të mos shkonin në punë. Tërmete të papara do të bënin në letërsi. Shkaku se, shkrimtari në kohën e sotshme është më i nënçmuari në shoqëri, më i nëpërkëmbi nga partitë politike. Po, jo. “Nëna Parti” u jep rrogë gjysmanalfabetëve, partizanëve të tyre teknesës, që mezi e gjejnë rrugën për në shtëpi.

Përditë e shoh Dum Dum in që kalon pranë kafenesë ku rri unë me përshëndetjen e tij të zakonshme: Tungjatjeta! Unë e njoh mirë këtë Dum Dum. Edhe e di kush është si kameleon partiak. E di, edhe në cilin grazhd e ha taxhinë. Fatkeqësia është se, ky Dum Dum na i ka ndërsyer pas shpine këlyshmelezët me zgjebe që s’kanë asgjë të përbashkët me shqiptarët.

Edhe ky Dum Dum kalon shpeshë përprara kafenesë ku i marrë unë “ilaçet” e mia të përditshme. Edhe i përshëndet kalimtarët e rastit: Tungjatjeta! Edhe njëherë e përsëris përmes këtij shkrimi: ky Dum Dum vërtetë i ka peng “intelektualët” shqiptarë, po kurrë nuk mund ta shes arsimin dhe kulturën shqiptare. Përpak,

harrova edhe diçka t'ia bëj me dije këtij Dum Dumi: Mjaftë më me demagogji “patriotike” të “vëllazërim – bashkimit”! Këlyshët e tu me zgjebe nuk mund të vendosin për kulturën dhe letërsinë shqiptare. Vetmevete shkruajnë e flasin jerm pasmesnate.

E zakonshme. I marr “ilaçet” e mia natyrore. Kamarieri ma sjellë uzon me akull përpara mbi tavolinë pa e porositur fare. E di ai punën e vet. Në ndërkohë, unë nga çanta e zezë mbi tavolinë i nxjerr gazetat e përditshme. Dhe, i shfletoj faqe më faqe. Asgjë. Materiale fundekrye nga interneti. Padashtas, duke i shfletuar këto gazeta, unë e derdhi uzon në tavolinë mbi gazeta.

Kamarieri vjen dhe ma sjellë gotën tjetër me uzo plot me grykë. Them: O burra, i keni përzi profesionet. I keni bërë lëmsh. Edhe miku im besnik Princ Bixhi, nuk mund ta zgjidhë këtë lëmsh. Fundekrye bërllok. Edhe atë, bërllok shqiptar. I nxjerrë gazetat e lagura me uzo t'i terë në diell mbi tavolinë. Dhe, tri gazetat e tjera nën hije. Asgjë. Gazeta interneti.

Përpiquni të bëni gazetë! Unë jam i informuar se çka ndodhë në botë, po më intereson se çka ndodhë në “Oazën e Paqës”. Nuk keni informacione kulturore, vetëm zhurmë politike. Fotografii dhe deklarata të politikanëve teknefesë. Atëherë, pse mirreni me këtë profesion?! Unë e di. Edhe të huajt e dinë këtë çorbë... Po, nuk e di populli... Ndoshta, edhe e di...

E tmerrshme, ë?! Qeveria po t'u jepte rrogë shkrimtarëve. Dhe, ata të rrinin në shtëpi me orar

Kalosh Çeliku

pune prej 24 orësh, të shkruanin libra. Shteti, me siguri nuk do të ishte në agoni, para vdekjes.

Dhe, ja pse tashti e ka radhën t'i hipë gomarit Nastradinica...



VII PLAGA E DHJETË E BABAIT

PASHTERKËKUQJA

E di, Pashterkëkuqja më ka dhunuar në mesin e librave që në kohën e Turqisë. Përmëtepër, edhe ka dashur të më përzë nga Atdheu. Poashtu, në kohën e Serbisë. Në kohën e Gjermanisë. Në kohën e Komunizmit. Vazhdon të më dhunojë mes librave edhe sot e kësaj dite gjatë ndryshimeve “demokratike”. Edhe, a ka fund ky dhunim pasmesnate në errësirë, në mesin e librave nën çati?!

Jo, nuk ka fund. Pashterkëkuqja vazhdon ta dhunojë shkrimtarin. Nuk i jep vend pune. E ndjek këmba - këmbës. Edhe e dënon në shtrat: ke botuar libër. Armik je i shoqërisë. Shtetit. Miqtë e mi, thotë Pashterkëkuqja janë të gjithë ata që merren me drogë dhe shitjen e armëve. Fatkeqësia, shkrimtari nuk është i aftë të merret as me drogë e as me shitjen e armëve. Halli?!

Halla do burrë. E kush është ai kaçak mali, që Pashterkëkuqes mund t'i gjej një burrë? Jo, nuk ka. Shkaku: Pashterkëkuqja është me teke. E ka ngjeshur për mjedisi pashterkën e kuqe me pala. Anash, dy shamia me lulelale lidhur për brezi. Edhe: do të thuash se nuk ka burrë për Pashterkëkuqen?! Jo, nuk e besoj, ka si nuk ka burrë. Edhe për Pashterkëkuqen ka burrë. Vetëmse, e rëndësishme është se kush ia gjen burrin me tirqi e xhamadan me dymbëdhjetë

gajtana. Edhe me mustaqe vesh më vesh. Dihet, edhe herdhët na, gati sa dy vorba t'i ketë deri në fund të këmbëve.

Dhe, vazhdon kjo që nga koha Turqisë. Pashterkëkuqes si t'ia gjejmë një burrë. Burra e burra i janë renditur shkusë te oxhaku Pashterkëkuqes, si t'ia gjejmë një burrë katërliqesh me mustaqe. Jo, nuk ka. Pashterkëkuqja na mbeti vejushkë gjithë jetën në Katund. Nuk ka burrë nëne që Pashterkëkuqes t'ia ngrejë këmbët në hava mes livadheve. E vejushka si vejushkë, i di të drejtat e veta statutare në shtrat për liri.

Nuk e di shqiptari se, Pashterkëkuqja e di edhe kasollën me kashtë. Përsëri, më ngatroni mes këtyre rreshtave. Këmbët m'i lidhni nyje. Edhe pse, nëpër shekuj i kam të lidhura këmbëkryq në mes të odës burrave. Përmëtepër, nëse doni të dini: o burra, Pashterkëkuqja do burrë me mustaqe vesh më vesh!

Në rregull. Edhe ne e dimë se, Pashterkëkuqja do burrë. Po, ec e gjeja një burrë që Pashterkëkuqes t'ia çoj këmbët në hava. Jo, nuk ka. Halli?!

Pashterkëkuqja do burrë. Epo, këtu është edhe problemi. E dimë të gjithë se, Pashterkëkuqja do burrë. Në rregull, edhe unë them: Pashterkëkuqja do burrë. Amani, ia gjeni një burrë! Natë e ditë le t'ia ngrejë këmbët në hava. Edhe po të dojë, le të pjelli kopila. Tekefundit, natën lyrekët edhe le t'na i lë si kurva pas porte.

E vërtetë, Pashterkëkuqen nuk e kam parë që nga ajo ditë, kur edhe kam shkruar në gazetë për të një shkrim. Humbi. Ose, siç thotë populli: humbi si shkuma e sapunit në lumë. E, shi për çudi, sot e pash në një shkrim në gazetë. Fundekrye edhe me fotografi: Pashterkëkuqja. Flokët lidhë tubë lulesh pas koke. Edhe qafën si gjithmonë me jakën të bardhë. Përmëtepër: shkrunate “kolumna”, u shiste mend burrave. “Analiste politike”. E në anën tjetër harronte se, nuk është e aftë të mbajë së paku edhe një burrë. Kohë kjo, kur gratë e sotshme në botë, jo që mbajnë burra, po edhe dy - tre dashnorë në të njëjtën kohë. Përndryshe, si do të merren me politikë. Probleme familjare të shoqërisë. Shtetit. E çuditshme, Pashterkëkuqja, që jo nuk diti të mbaj burrë, po edhe dashnor, sot në gazetë u shiste mend burrave. Edhe atë: shqiptarëve. Popullit më “fanatik” në botë. Burrave me mustaqe, që kurrë nuk i kanë dëgjuar gratë. Përmëtepër, për gratë kanë thënë edhe: flokët e gjata, mendtë e shkurtëra. Edhe Pashterkëkuqja me gjithë pasuri të tundshme i ka flokët e gjata mbështjellur tubë lulesh, mendon se nuk ia shohin burrat pas qafe në fotografi edhe në gazetë.

Edhe një gjë, kur e dimë se Pashterkëkuqja i ndërron burrat përnatë. Nuk flasim këtu për dashnorët, ata mund t’i ndërrojë në çdo orë. Punë e saj, nuk përzihemi këtu në jetën private. Në realitet, Pashterkëkuqja gjithmonë flokët i ka pasur tubë lelesh në jetë. Shenjë kjo, që të shtyn të mendosh a ka pasur ndonjë burrë nëne shqiptare, që Pashterkëkuqes ia ka përzier lëmsh

flokët në shtrat. Nuk e di. Përmëkeq, ka menduar se kështu do t'i mashtrojë burrat shqiptarë. Gabim. E ka mashtruar dashnorin. Edhe burrin. Vetëmse, shqiptarët me flokë lidhur tubë lulësh pas koke, nuk mashtrohen aq lehtë, Zonja Pashterkëkuqe me një fëmijë për dore.

Edhe: shet mend në gazetë. Përmëtepër: O Imzot! Ende, duhet kohë që këta burra ta qesin kaun në vijë, që t'i lërojë arat. Pashterkëkuqja me litarë përdore t'u prijë para qeve nën zgjedhë ugareve. Mëzati e then zgjedhën. Prandaj, edhe e tredhin me litarë, e fusin nën zgjedhë t'i lërojë arat, tërheqi qerren në Katund.

Dhe, më leni rehat një sy gjumë të bëj mes librave!...



PALAÇOT E SOTSHËM TË OBORRIT

Dikur, i ka pasur Pallati Mbretëror rreth e rrotull tij përpara këmbëve në Oborr. Edhe Mbreti me kurorë. Në përgjithësi, kanë qenë artistë Oborri, që me “artin” e tyre e kanë bërë Mbretërinë të qeshë dhe të lumtur në ato momente të vështira, krizë lufte.

Nuk kanë qenë këshilltarë të Mbretit. Truri i Mbretërisë. Megjithatë, kanë qenë buka, ushqimi kryesor i Perandorisë. Fatkeqësia, edhe në kohën e sotshme i kemi me pakicë e shumicë Palaçot e Oborrit në Qeveri. Nëpër Partitë tona politike “demokratike”. Vetëmse, jo aq të mençur dhe artistë të nivelit botëror si në kohën e Baba Dovletit. Aristokroacisë. Përmëtepër, në atë kohë, ata kanë bërë art dhe kanë marrë rrogë mbretërore. Sot, këto Palaço nuk bëjnë art, po marrin rrogë hyzmeqari. Edhe në punë nuk shkojnë përditë si Palaçot e Oborrit të Mbretit. Gjithë ditën e gjatë rrinë nëpër çajtoje, ose në shtëpi: ministra, deputetë të popullit, analistë politikë profesorë universiteti, shkrimtarë, gazetarë të Oborrit të Partisë, këshilltarë në Qeveri, zëvendësministra, drejtorë, administartorë nëpër ministri pa vende pune e me rroga, sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohërit.

Edhe, vazhdojnë ta “argëtojnë” Oborrit me budallakitë e tyre politike. Anda ta ka t’i dëgjosh nga foltorja diskutimet e tyre të zjarra në

Parlament. Mjetet e informacionit me deklarata “patriotike”. E të mos flasim për debatet e shpeshta politike e kulturore, që i organizojnë në dobi të shoqërisë dhe Shtetit.

Nuset shqiptare, që kohën e fundit ngjallin fshatrat maqedonas, ma kujtuan fshatin malor Baçisht, afër Kërçovës. Përpyekjet, që ky fshat i ka bërë në kohën e komunizmit për të hapur shkollë shqipe. Edhe Nijazi Limanin (me plotë prapashtesa të mbiemrit: ov, oski), që kërkonte me këmbëngulje këtë fshat ta bindi dhe shpalli si fshat “makedonski muslimani”. I përdori të gjitha metodat dhe veprimet e mundshme dhe të pamundshme komuniste. Në fund, pasi nuk i bindi që të pranojnë shkollë në gjuhën maqedonase, u premtoi shkollë në gjuhën turke. Edhe pse, asnjëri nga fëmijët e këtij fshati nuk dinin as edhe një fjalë të vetme në gjuhën turke.

Dhe, e dini si përfundoi ky “misioner” i arsimit në atë kohë komuniste?! Jo, nuk e dini. Nijazi Limanovski (ov, ni) shkoi në Baçisht për herë të fundit me të vetmin qëllim, gjoja për shënimin e diltëlindjes të shokut Tito. Fshatarët, i madh e i vogël e pritën sipas zakoneve të asaj ane. I thanë: mirë se na ke ardhë! Ne vërtetë jami të varfër, nuk kemi pasuri, ama për shokun Tito e therim edhe kaun e qerres. Shkurt, duam të të themi: për festa të këtilla të na vish gjithmonë, por për hapjen e shkollës në gjuhë maqedonase, mos na vish më kurrë! A, e pe kur hyri ajo nusja që e solli kafen se ishte e veshur me veshje kombëtare shqiptare dhe të foli në gjuhën shqipe?

Po, mezi u përgjigjë “mysafiri”. Atëherë, ville kafen! Iu kërcnua i zoti i shtëpisë.

“Mysafiri” i shpeshtë i këtij fshati në kohën e komunizmit, iku me bishtin nën samarë dhe kurrë më nuk erdhi në këtë fshat malor. E harroi hapjen e shkollës në gjuhën maqedonase. Erdhën ndryshimet demokratike, dhe fshatarët e kësaj ane për herë të parë hapën edhe shkollën e tyre në gjuhën shqipe.

Ose: Në atë kohë të “artë” komunsite, të gjithë turreshin të botojnë poezi për shokun Tito. Edhe, po të kish libri ndonjë poezi në fillim, përkushtuar shokut Tito, nuk kish redaktor nëne ose reçenzent që e kthente prapë si jovlerë nga redaksia. Ende e kam të freskët, kur shkoja në vendlindje një shtëpi të posandërtuar në mes të fushës te Gara, që ishte ndërtuar pa leje. Katundari i mençur, që të mos ia rrëzojnë shtëpinë, fotografinë e Shokut Tito nuk e kishte vëndosur në dhomë, po në dritare edhe atë: me fytyrë nga rruga.

Askushi nuk guxoi jo vetëm ta rrëzojë atë shtëpi, po edhe t’i afrohet te pragu, në Lëmë. Edhe sot e kësaj dite asaj shtëpie në mes të fushës, te Gara i tymon oxhaku.

Vërtetë, janë të mrekullueshëm, “artistë” të të gjitha kohërave! Talentë të rrallë që do t’ua kishin lakmi edhe Palaçot e Oborrit Mbretëror të asaj kohe. Po, jo Palaçot tonë të Oborrit që janë modern, i kanë tejkalar ata artistë të shekullit, atë kohë. Gjithë ditën e gjatë rrinë në çajtove dhe shtëpi. E nga andej me “artin” e tyre gjenial e

argëtojnë Qeverinë e “vëllazërim-bashkimit”.
Popullin.

Punemadhe, kush qesh sot më së shumti me “artin” e tyre fantastik, Qeveria, apo Partitë politike?! Populli, nuk qeshë. Me siguri: Kryeminsitri, qeshë. Vojvoda, që u ka hipur në shpinë luanëve antikë dhe i ka shaluar në sheshin “Makedonija”. Edhe Goce Dellçevin krah për krah me Nikolla Karevin i ka hipur në kalë dhe i tërheq për freri te Ura e Gurit. Nuk ka rëndësi që këta “heronj maqedonas” kurrë në jetën e tyre për së gjalli nuk kanë hipur në kalë. E rëndësishmja është: kryeministri i ka hipur të vdekur. Ose, i ka ngjallur lugetër. E ata, nëse në këtë kohë nuk dinë të rrinë mbi shalë, nuk dinë ta shalojnë edhe kalin. Edhe kjo, shumë pak ka rëndësi. Mund të mësohen te këmbët e Urës së Gurit. E, nëse nuk mësohen, Vardari është afër, mund të kërcejnë bythekrye në lumë? Edhe kjo ka shumë pak rëndësi. E nesërmja është në prag. Skënderbeu në Bit – Pazar mes patriotëve të vonuar ”turqë” e ka shaluar kalin me shalë. E ka ngritur edhe dorën: ndaluni burra shqipëtarë! Nesër do të dalim matanë Urës së Gurit edhe në atë anë, t’i mësojmë “vëllezërit maqedonas” se si rrihet mbi shalë në kalë me shpatë në dorë. Shkaku: Skënderbeu e ka shpatën në brez. E këta “trima maqedonas” janë pa armë. “Maqedoninë e madhe” krah për krah me “vëllezërit shqiptarë” e bëjnë pa luftë, me dialog politik. E unë si “nacionalist” pyes: ku mbeti “Shqipëria e Madhe”?! Hi-hii-hiii... Nëpër kabinete të

“vëllezërve”. Gazetat e tyre të “vëllazërim-bashkimit”. Muzetë e Lirisë...

Në rregull. Përsëri unë pyes si “nacionalist”: a qeshë edhe Ali Ahmeti?! Ose, siç e thirrë ai Patrioti i Vonuar: “Abazi”?! Jo, nuk qeshë. Atëherë, paskemi probleme në Shtëpinë e përbashkët të “vëllazërim-bashkimit”. Patjetër, duhet të qeshë edhe Ali Ahmeti! Ose, siç e thirrë nëpër kolumna ai Patrioti i Vonuar: “Abazi”. Përndryshe, na mori lumi.

E ai, si për inatë nuk qeshë. Burra shqipëtarë, edhe atë duhet ta shtini të qeshë! Patrioti i Vonuar siç duket nuk e ka kryer detyrën në Oborrin Mbretëror. Çfarë palaçoje Oborri është ai që nuk e ka shti të qeshë edhe Ali Ahmetin, “Abazin”?! Bërlllok. Shenja të Kiametit.

Populli, mbi të gjitha qeshë i fundit me gojën vesh më vesh. Edhe, u bie duarve shuplakë gjatë “fitoreve” të tyre si argatë të përjetshëm në Qeveri. Edhe unë, kam vendosur miku im lexues besnik, që kësaj radhe të qesh i fundit. Zoti e bëftë për hajër!... Dhe, na shpëton nga Palaçot e sotshëm të Oborrit...

ZEZAKU I VOGËL ME ÇIFTELI

E mbylla gazetën dhe dola te Rrapi. Gjokun e lidha nën hije, i vara armët në një degë. Vapë. Uji i Shadërvanit gurgullonte gur më gur. Kamarieri m'i solli dy shtamba me verë. Matanë rrugës rrallë, shumë rrallë kalonin kalimtarë të rastit. O Imzot, sikur t'i kishte përbirë toka. Po, ku humbi i gjithë ai popull?! Shumica i kishin mbyllur edhe dyqanet. E kishin braktisur qytetin pa pritur e kujtuar duke ikur nga sytë këmbët...

- Alo, tungjatjeta! Me kë kam nderin të flas në telefon?
- Me të ashtuqajturin Kryeterrorist... U përgjigja, pasi e njoha zërin e Patriotit të Vonuar...
- Ehë... Ehë... E këndeje telit, Patrioti i Vonuar... Ja, sa u ktheva nga Kosova...
- E si kalove, zoti Patriot?
- Shkëlqyeshëm. E kreu një punë me rëndësi. Po, kur u ktheva këtu e gjeta belanë me katundarët primitivë...
- Hë, çka është puna?
- E kanë përhapur nëpër qytet se, unë kam ikur nga lufta...
- Fjalë. Edhe atë për cilin, Zoti Patriotin e Vonuar...
- Jo, vetëm kaq. Po, gjoja se unë e paskam lëshuar edhe mëzatin nëpër kopshtet e hallkut nëpër katund...

-
- E pamundur?! Nuk e thotë Zoti: Patrioti Vonuar një gabim të tillë ta bëjë në këtë kohë... Tjetër?
 - Nëna Parti ka mbajtur edhe mbledhje për mëzatin...
 - Hi-hi-hiii... E paskan tepruar në politikë... A kanë bërë edhe ndonjë marrëzi?
 - Po...
 - E çka?!...
 - Në katund, në emër të UÇK-së i kanë dërguar edhe 70 qefinë... një nga ato edhe mua si Patriot...
 - E pamundur. Sigurisht e kanë bërë këlyshët e Nënës Parti për t'i përçarë shqiptarët...
 - Jo, vetëm te ne, po edhe në disa katunde të Kërçovës i kanë dërguar, diku 50, diku 40 e diku 30 qefinë...
 - E, çka bëre ti me qefinin?!...
 - Dihet, ia lidha mëzatis për brinjësh. E meritonte dënimin, kishte bërë dëme. Ja, edhe pse duhej ta shihte e gjithë bota si tradhtar...
 - Hi-hi-hiii... Nëna Parti me siguri paska vendosur edhe ta dënojë me vdekje, ta dërgojë në Qeveri...

E mbylla telefonin dhe u arratisa në mendime. Provinca e mirrte njeriun në qafë. Njerëzit nuk kanë me çka të merren, ku ta humbin kohën. Në rend dite të mbledhjeve të Nënës Parti e shtinin edhe mëzatin. E dënonin për dëmet që kishte bërë gjatë luftës... I kishte shkelur rregullat e Nënës Parti... Fat, që në këtë parti politike nuk është anëtar "i ashtuquajturi" Destan Balli se, do

t'ia lexonte dënimin para popullit: thikën në qafë. Dhe, për tri ditë rresht do ta hante me Djemtë e Ballit...

Natë. Terri jashtë çdo gjë e ka mbështjellë me ferexhe. Edhe me shami të zezë në kokë. Hoxhallarët fluturuan nga minaret e xhamive si shejtanët e Dexhallit. E zbritën veten Ditën e Madhe në mes të xhematit për të përhapur "shqiptarizëm". Fytas u rrokën me Haxhi Deputetin, (ish Ministrin e Kulturës) që i luteshte Zotit për mëkate, në rendin e parë, përpara këmbëve të Hoxhës. I vunë në përdorim grushtat në vend të Kuranit të shenjtë se, cili do ta falë xhematin në Shtëpinë e Allahut. E kujt është Xhamia e Madhe. Allahu me keqardhje, vetëm i shikoi nga qielli këta "besimtarë myslimanë". Përçudi, nuk u zemrua me këta shejtanë arapi, që tinëz i kishin hyrë në xhami, t'i kapi "toptan" me gjithë xhami t'i hedhë bythekrye në Vardar, t'i përcejellë me lumin në Greqi. Haramët, që nuk dinë ku e kanë kokën e ku bythën. Përditë si halldupë turku i ngrej në bythët në hava edhe në mes të rrugës. E në anën tjetër: ditënatë e torturojnë popullin me kërcnime, vjedhje, drogë, spiunim e vrasje pas shpine. Në emër të Allahut punojnë për shërbime të huaja sekrete antishqiptare. Përmëtepër, policia i merr në mbrojtje gjoja si misionarë fetar që përhapin dashuri dhe paqe përpara syve të tyre në xhami.

O Imzot! A ka ndonjë Ferr më i rëndë se ky i sotmi, në Shtetin "demokratik"? Jo, nuk ka. Shkaku se: ky nuk është dënimi më i vështirë i Zotit. E dini pse?! Edhe këtë nuk e dini: dua pash

më pash t'i bie Ferrit! Myslimanët e vërtetë le të thonë: Xhehenemit...

Edhe dy-tri fjalë si te ajo kënga popullore shqiptare: Përpara se shpirti i ka dalë, i ka thënë dy tri fjalë... Shqiptarët nuk hanë bar. Dhe, vazhdo ta lëvdosh ish Minisitrin e Kulturës (Haxhi Deputetin) në gazetë si të "sukseshëm" para këmbëve tua si "hoxhë"! Unë e di edhe një histori të dhimbshme, kur Haxhi Deputeti yt "mysliman" ka qenë Ministër i Kulturës dhe ia ka "blerë" dy piktura profesorit dhe mikut tim të nderuar: Adem Kastratit. Pikturat edhe sot e kësaj dite janë të papaguara. Miku im, me "honorarin" e atyre dy pikturave iku nga mesi ynë në kushte të vështira ekonomike pa e pirë edhe një kafe nga Ministria e Kulturës. Përmëtepër, përsëri futni edhe një qotek të mirë këtij "besimtari mysliman" të Allahut, që para këmbëve të Hoxhës i falë të pesë vaktet në xhami! Shkaku se: e ka pak qotekun, ai me shokë ka vendosur t'i lajë mëkatet, jo në atë Dynja, po në këtë Dynja, edhe atë: në xhami.

Pasmesnate, aty – këtu bën dritë ndonjë fener rruge, që ende nuk e kanë thyer rrugaçët e Çairit. Njerëzit, herët janë mbyllur nëpër banesa. Ndërtesat kanë humbur në errësi. Rrallë, shumë rrallë ndonjë dhomë ende ka dritë. Ora një pasmesnate. Dhoma ime ende bën dritë. Përpiqem t'i shtij edhe ndonjë fragment këtij libri për luftën. Kot, kur "besimtarët" e Allahut përhapin tmerr dhe frikë në popull. Katër pasmesnate. Shumica në gjumë. Matanë dritares

dëgjohet një rafal automatiku. Lehja e qenëve matanë gardhit. Përsëri, heshtje.

Errësirë. Edhe njëherë dëgjohet automatiku. Heshtje. Qetësi, varri që i futet natës si pykë. E marr në telefon Miken me ferexhe...

- Alo, urdhëroni?!
- Mirëmëngjes. Hë, a ta prisha gjumin?!...
- Po, a të kam thënë që pasmesnate të mos më paraqitesh në telefon? Nesër, herët jam në punë...
- E di, po thash të ta dëgjoj zërin... Çka bënë pasmesnate...
- Ja, po kërcej... Mbrëmë e kam bërë atë punë... U kapa...
- E poshtër, kurvëz... Vazhdo të kapesh!...
- E ti, a u ktheve nga mali?!
- Po, vendosa ta përfundoj romanin për luftën...
- E si i ke punët me lekë? A ke nevojë të të dërgoj ndonjë thes...
- Katastrofë. E kam thënë moti unë se, mua më duhet një grua pasanike, e ty një burrë sheik. Ose, hoxhë me çallmë turku. Shkaku: Hoxha me kësulë të bardhë në kokë e ka vështirë të të mbajë Ty si grua putane kombëtare...
- E, a ta gjej unë një burrë asgan, që të na mbajë të dyve?...
- Jo, ta gjej unë një grua aristokrate, që të na mbajë të dyve...
- I poshtër... Kurvar... E kam në disponim një arap... Katran është i zi...
- Edhe ky na mungon tashti t'i dalë zot Atdheut me çifteli... E kënaqën hoxhallarët e

Allahut. Tashti i ka mbetur radha edhe këtij trimi t'i rroki armët në dorë. Merre me mend, zezaku i vogël se çfarë patrioti... Shtatë vjeç djalë, e bënë copë-copë çiftelinë duke i kënduar Skendërbeut... Flamurit kuqezi ... Atdheut...

- Hajde më, boll i dole zot Rrapit... E shpalle edhe Zonë të lirë, dil në aksion, nëse nuk do t'i këndojë zezaku Mëmëdheut me çifteli...
- E poshtër... Nesër do të nisem edhe më këmbë, vetëm e vetëm që zezaku të mos i këndojë Mëmëdheut me çifteli...
- Nesër?! Atëherë të të pres, ta përgadis fushëbetejën...
- Patjetër. Gjallë a vdekur, nesër do t'u bie Sarajeve të Pashait... Ditën e mirë!...
- Ditën e mirë!...

E mbylla telefonin dhe i hoqa perdet e dritares. Matanë maleve të Çelvjollcës zbriste më këmbë agimi. Dielli. Edhe njëherë e përçolla Natën...

SHKRIMTARI E FITOI LIRINË: IKU NGA FERRI DHE U ARRATIS NË PARAJSË

E kam njohur Zyhdi Moravën heret si shkrimtar përmes librave, po më vonë me hapjen e kufijve politik për popullin shqiptar edhe personalisht nëpër takime letrare. E kemi pasur një ndër miqtë e parë poetë nga Shqipëria të Manifestimit Kulturor Mbarëkombëtar: TAKIME NËN RRAP, në Shkup. Pse të mos e them haptas: Edhe në themelimin e Takimeve nën Rrap (1998). Zyhdi Morava ka qenë edhe njëri ndër poetët e parë që ka marrë pjesë në këtë manifestim kulturor, që në ato kohë të vështira ekonomike e politike, përpiqeshte t'i shti rrënjët në Shkup. Manifestim ky kulturor, që i pari e futi vargun shqip gjatë ditëve të verës me vapë në Bit – Pazar, në Shkup. Edhe atë: lirishtë të marrë frymë dhe jehojë shqip, rrëzë Kalasë. Poeti dashurisë në Manifestimin Kulturor Mbarëkombëtar, që pak më vonë do të bëhet edhe tradicional ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP” do të marrë pjesë gati për çdo vjet. E kisha edhe mik të penës. Ndoshta, edhe na bashkonte poezia e dashurisë. Ose: Miket. Nuk e di pse ma thoshte mendja, ishim tre poetë të veçantë në jetë e letërsi: Zyhdi Morava, në Tiranë, Gani Xhafolli në Pishinë dhe unë Kalosh Çeliku në Shkup.



Në fotografi nga ana e majtë: Kalosh Çeliku, Dhimitër Pojanaku, Ramadan Sinani dhe Zyhdi Morava, në Manifestimin e parë Kulturor Mbarëkombëtar: TAKIME NËN RRAP (1998), në Shkup.

Kohë kjo, kur shumica e shqiptarëve e vrisnin shkaun me çifteli e vjersha patetike. E bënëin gjakun deri në gju, saqë mbytej edhe kali. E shumë pak i këndonin dashurisë.

Nuk ka kjo gjithaq rëndësi, në këto momente zie, kur ai më nuk është në mesin tonë si shkrimtar. E humbëm papritmas edhe një penë rebele, një mik që vërtetë ishte origjinal në jetë dhe letërsi. E rëndësishmja është se: gjithë jetën do të na mungojë nëpër manifstimet tona kulturore: Tiranë, Korçë, Elbasan, Poradec, Prishtinë, Shkup e Tetovë.


Përmëtepër, Zyhdi Morava në manifestimet tona kulturore tradicionale ndërkombëtare: TAKIME NËN RRAP i ka rrëmbyer edhe disa çmime letrare: në themelimin e këtij manifestimi kulturor me një poezi për Dritëro Agollin, Çmimin për vepër erotike, botuar brenda dy takimeve. Dhe, për poezi më të bukur erotike në Dibër.

Shkrimtari, Zyhdi Morava siç shihet ka dhënë mund, djersë dhe gjak për letërsinë shqipe. Nuk do të hyj këtu për vlerat e arrira artistike, kjo i takon kritikës letrare që patjetër do të merret me këtë shkrimtar në të ardhmen. Mbi të gjitha: ai gjithë jetën është marrë me krijimin e vlerave dhe zhvillimin e letërsisë shqipe, për ta nxjerrë në rrugë drejtë majës malit të Perëndive, në Baba Tomorr.

Zyhdi Morava e provoi edhe burgun. Edhe “Lirinë” gjatë ndryshimeve “demokratike”. Fatmirsisht, ka qenë edhe kryetar i LSHASH. Edhe, atë për pak kohë: ngase, unë e kuptoj më së miri çka do të thotë të jesh kryetar i shkrimtarëve shqiptar, kur politika ditore u pri në ballë vlerave letrare e kombëtare. Ose: siç e kam thënë unë shpesh nëpër shkrimet e mia letrare, kur të pri para gomari.

Fatkeqësisht, siç duket: Shqiptarëve në të shumtën e rasteve u prijnë gomarët edhe në kohën e sotshme “demokratike”. Përndryshe: do t’i këputnin prangat. Kufijt politik, që i kanë ndarë shqiptarët copë – copë dhe shpërndarë nëpër botë si Kashta e Kubarës.

Zyhdë Morava i këputi prangat e Robërisë shekullore. E fitoi Lirinë: iku nga Ferri. Dhe, u arratis në Parajsë...



ME RROSPI MESHKUJ E KURVA NUK BËHET POLITIKË

Dorën në zemër, kemi Rrospi Meshkuj. Edhe atë: aq sa kanë të hanë edhe qentë e rrugëve. Edhe kurva, gra me pashterka të kuqe. Edhe pse, grave u ka hije të jenë kurva, po jo edhe burrave. Megjithatë, me Rrospi Meshkuj e gra kurva nuk bëhet politikë. E sidomos, kur janë në pyetje “vëllezërit” me të cilët jetojmë në një shtëpi të përbashkët me vite e vite.

Megjithatë, ne shqiptarët nuk mbushemi mend nëpër vite, megjithëse na përsëritet historia. Edhe në këtë shekull vazhdojmë të bëjmë politikë me Rrospi Meshkuj e kurva politike. Ndoshta, edhe jemi populli i vetëm në botë, që këtyre “vizionerëve” ua kemi hapur derën krah më krah të na bëjnë shtet kombëtar. E ata, si për inatë të shqiptarëve haptas bëjnë dashuri me “vëllezërit”, na tradhtojnë nateditë në Shtëpi Publike. Edhe, pasmesnate mbesin me barrë. Kopilat i pjellin ditën dhe na i lënë natën pas dere lyrekë me nga një biberon në gojë.

Të nesërmen, kopilat na qajnë pas dere. Zëri u shkon për qielli. I marrim i fusim në shtëpi. I lidhim në djep. Edhe qumësht lope u japim me shishe. I përkundim në djep, i rrisim që të nesërmen të na vrasin në shtëpinë tonë, të trashëguar brez pas brezi. Një ditë hidhërohemi dhe hedhim gurë e dru mbi ta: na tradhtuan kurvat. Kopilat na shitën “toptan te vëllazerit”.

Patriotët e vonuar të armatosur deri më dhëmbë me kolumna e deklarata, dalin nga birucat e tyre partiake në dyluftim në mjetet e informacionit: Hapni gojën – vjen erë baroti, Këshill koordinues mbarëshqiptar, Atdheu që të ekzekuton, Jankullovska e madhe përballë Rexhepit të vogël, Gruevski s’e ka ndërmend t’i pranojë kërkesat e shqiptarëve, Bajram, martohu me Jankullovsken, BDI ka ku shkon nëse del nga Qeveria!...

Përçudi, këta patriotë të vonuar kërkojnë edhe luftë! Zjarr e flakë nxjerrin nga goja e bytha. E vrasin shkaun me fjalë nëpër çajtores e çifteli nëpër këngë popullore në dasma e manifestime partiake. Gjakun e derdhin deri në gju, sa që mbytet edhe kali. Përpiqen të ndezin zjarrin në “Atdheun” e Ali Ahmetit dhe “Mëmëdheun” e Patriotit Melez të vonuar me kolumna e deklarata pakrye duke hedhur benzinë në vend të ujit mbi shpuzë. Pavetëdije se, në atë shpuzë do të digjen edhe vetë si “luftëtarë trima”, bien dëshmorë në fushën e betejës, në hale. Ndonjëherë, të shkon mendja se gjithë këtë luftë e bëjnë për një “okë drithë” në llogari të shërbimeve të huaja sekrete e të vendit në dëm të popullit shqiptar. Mendjeshkurtërit e dorëzgjaturit, ndofta edhe për pushtet: Nuk mund të merremi vesh me komitat, e kemi më lehtë me partizanët neokomunistë. Kokëshkretët, që nuk kanë memorje, i kanë harruar rastet e montuara edhe të këtyre “probatimave” neokomunistë gjatë ndryshimeve demokratike. Mashat shqiptare, që gjithë jetën e kaluan nëpër duar të “gazdallarëve”. E ata, kurrë nuk i dogjën duart. Edhe sot e kësaj dite

vazhdojnë ta mbajnë nën zgjedhë shekullore këtë popull heroik me masha të ndryshkuara neokomuniste shqiptare.

E vërtetë, shqiptarët kanë bërë luftë nëpër shekuj, por jo edhe për çdo vjet sa herë që t'i teket ndonjë katundi. E bënë Luftën e Kosovës (1999), Luftën e 2001- it, në Maqedoni. Luftëra të cilat ende nuk kanë përfunduar ballë për ballë në tavolinë. Përmëtepër, vazhdojnë të zhvillohen flakë më flakë nëpër institucione të shtetit me tru dhe mjete demokratike. E si do t'ia nisnim edhe një luftë, me çfarë armësh?! Bota e sotshme bënë luftë me tru, e jo me bythë...

O shqiptarë, mblidhni trutë në kokë dhe bëni politikë të shëndoshë nëpër parti politike! Qeveri. Parlament. Institucine të shtetit. Kohë të tjera kanë qenë dikur në vaktin e Turqisë, kur dilje me një pushkë në dorë kaçak maleve, e kohë të tjera janë sot: nuk bëhet luftë me shpatë turku, pushkë serbi e bomba italjani. Bota më nuk bënë luftë me këto armë primitive, po me tru dhe veprime politike. Nuk bëhet shtet etnik me fjalë të kota nëpër çajtoje dhe deklarata boshe, në mjetet e informacionit. Edhe me çifteli, duke "vrrarë" shkaun nëpër këngë popullore, bërë gjakun deri në gju aqsa të mbytet edhe kali. E, as me Rrospi Meshkuj e kurva politike.

Eh, sa të mençur kanë qenë pleqtë tanë me mustaqe vesh më vesh. E ne atë mençuri të tyre e kemi kuptuar sot, me kaq vonesë. Edhe, kur kanë vjedhur, kanë ditur të vjedhin natën, Edhe, kur kanë vrrarë, kanë ditur të vrasin në pusi. Edhe kur kanë falur, kanë ditur të falin në odën e burrave.

Edhe, kur kanë dhënë besë, kanë ditur ta mbajnë fjalën. Edhe, kur kanë bërë shtet, kanë ditur t'i dalin zot në male. Dhe, në tavolinë në Londër: Isë Boletini me dy kobure. Edhe kur kanë bërë politikë, kanë ditur të bëjnë politikë. Në politikë, nuk ka singeritet dhe besë. Politika është kurvë. Edhe rrenë: më rrene të rrena. Politikë bëjnë ata burra, që: tjetër thonë, tjetër mendojnë dhe tjetër veprojnë. E çka bëjnë “patriotët” e vonuar të sotshëm me shekuj: nuk dinë të vjedhin, nuk dinë të vrasin, nuk dinë të falin, nuk kanë besë. Nuk dinë të bëjnë shtet.

Asgjë. Koha është, duhet t'u themi këtyre “patriotëve”: rrini në shtëpi! Mos na u ngatrroni nëpër këmbë si krënde të thata nëpër lëmë! Fundi i fundit, bëni ndonjë punë të hajrët! E dini se, plot punë mund t'i bëni shumë më mirë, që edhe bota t'ua ketë lakmi. P. sh.: tullomba, bozë, tambëloriz, këpucë, struke, çorapë me një shtizë... Ose, limunadë. Fundi i fundit, shkoni edhe në xhami! I falni të pesë vaktet, lutuni Allahut për mëkate, ndërtoni edhe xhamia! Pse jo, ndonjëri edhe të fluturojë nga minarja e xhamisë si azreti Isai. Punemadhe, që nuk keni shkolla për fëmijët tuaj bythëgrisur. Nuk u duhet juve e ardhmja, juve u duhet e djeshmja dhe e sotshmja në xhami. Xhehneti. Xhehnemin nuk e doni, edhe pse nesër vendin e keni në Xhehmem. Arnë kazani. Zjarri i tij do t'ju djeg natë e ditë. Shkaku: e keni keqinterpretuar Kuranin. Librin e Allahut. Nuk e keni dëgjuar pejgamberin e fundit a.s. Muhamedin: Pa Vatan, nuk ka iman. Nuk i keni dashur fëmijët tuaj, të ardhmen e nesërme. Edhe

një porosi: Vetëmse, kurrë mos u lutni për shkolla shqipe! Përsëri, edhe në këtë shkrim unë pyes: pse merreni me punë për të cilat nuk jeni të aftë dhe nuk keni haber nga ky zanat, që ta jep vetëm Zoti. Ose: që nuk e keni tarshëguar brez pas brezi.

E dini se, na morët më qafë?! Jo, nuk e dini. Përndryshe, po ta dinit: Zotit do t'i luteshit për shkolla shqipe. Fajin, u dashka ta kërkojmë në tjetër adresë, në tjetër shtëpi. Unë e di, edhe ku është furriku i pulës. Vallë, a e dinë shqiptarët?! Me siguri e dinë. Atëherë, o burra ua futni nga një shqelm bythëve këtyre halldupëve, që na e kanë zënë shtegun e Livadhit. Diellin me rreze në qiell. Hënë kur del mbi mal. Dhe, kur i thotë këngëtari ynë popullor: Ulu mal të dalë Hëna! Përmëtepër, edhe qelben haramat. Bërllok, që na e ka mbuluar oborrin dhe me të cilin nuk mund ta kalojmë as pragun, lumin. Më kot i zëmë hundët, gojën... Edhe veshët. Bërlloku, përditë po na lulëzon në oborr. Edhe atë: lule haleje.

Edhe shqiptarët si të dalin nga hajdutllëku?! Profesione për të cilin e fajsojnë armiqtë shekullor. Vështirë. E them këtë se: historikisht, fajin ua lënë shqiptarëve. Te ne në katund thonin: kali që zihet në livadhin e huaj, futet në lëmë. E, deri kur ne shqiptarët do t'i fshimë lëmat e huaja, hallkut?! Nuk zë besë, ai që nuk ka besë. Trim është frikacaku. Luftën e fiton i treti. Fjalën e kam këtu, për jorganin e Nastradinit. E nga ana tjetër: gjithmonë nëpër shekuj i hudhet faji një populli, që kurrë nuk ka qenë nacionalist e as pushtues. Fatmirësisht, një popull që i ka dhënë më së shumti botës: shtete, pashallarë, agallarë,

kryetarë shteti, artistë, universitete (Sirisë), gjuhë letrare (turqëve)... E shumë pak vetëvetes, shtetit shqiptar.

Edhe sot e kësaj dite vazhdon të punojë për të tjerët, i bënë shtet. E ata, “vëllëzërit” ia japin pelën përdore. I thonë: ti je hajduti. E bëjnë fajtor, shkaktar dhe armik të shtetit. Herë pas here ia lënë edhe kopilin pas dere. Përditë e burgosin, e vrasin, e përzënë nga Atdheu. E ky si për inatë ringjallet, nuk ikë, nuk asimilohet. Përmëtepër, edhe rebelohet me një çifteli e pushkë në dorë.

E di, cili i pri para në rrugë: Skënderbeu. Hije, kush i ecë pas shpine. Megjithatë, herë pas here e kthen prapa kokën. Populli thotë: ec dy-tri hapa para dhe ktheu shiko prapa shpine. Ferrës në rrugë mos i zë besë. Është e vogël, po mund të fsheh lepur të madh. Pse jo edhe ujk. Ose, arushë me dajre. E ka thënë moti ky popull edhe diç të madhe: Edhe këmishës tënde mos i zë besë. Ose: pyet njëqind vetë, e puno siç di vetë.

Populli që i kujton gjithë këto urti të trashëguara brez pas brezi, nuk bie në pusi të armikut. Dhuratën që ta jep tjetri, e merr me rezervë. Nuk e shtri dorën ta fus dhuratën në xhep, përpara trurit në kokë. E vazhdon rrugën pa dhurata, duke mos e nënçmuar çdo kaçubë. Ferrë në rrugë. Ecë dy-tri hapa. Dhe, kthehet shikon mbrapa.

Me Rrospi Meshkuj e Kurva, nuk bëhet politikë...

PLAGA E DHJETË E BABAIT

(Shkas: Rrugaçi “mysliman”, që duke bërtitur si i tërbuar mu ndërsye pas shpine: Ti e ke ofenduar pejgamberin Muhamed! Dhe, në mes të Shkupit i përzimë kësulat. I mjeri këlysh me zgjebe, i ndërsyer nga shërbime sekrete antishqiptare ta “mbrojë” pejgamberin Muhamet a. s. nga një shkrimtar, që armë të vetme e ka penën me dy tyta...)

Ditën e Madhe, përsëri u ula nën Rrap. Zonën e lirë... E hoqa setren... Gjokun e lidha nën hije. Armën e vara në një degë. Shtambat me verë i porosita mbi tavolinë. E hodha nga shpina samarin... Frikën... Ndjekjet... Presionet... Kërcnimet telefonike... Linçet intelektuale e fizike... Aferat e ndryshme politike... Bisedat informative në polici... Helmimet... Zjarret në banesë... Vdekjen klinike në Voskopojë... Aksidentin e komunikacionit, në Qafë Thanë...

Truri papritmas e ktheu prapë shiritin e filmit, ma rikujtoi Plagën e dhjetë të Babait. E shkunda veten edhe njëherë nga gjethet e Vjeshtës... Bryma... Dimri... Vërtetë, kur linda më 13 shkurt të vitit 1951 në Katundin Cërivicë të Kërçovës, siç më tregonte shpeshëherë Nëna, im Atë shkrepri pushkë. E bëri me dije Katundin. Dy

vite më vonë ai në brez do të më shtinte një “hanxhar“, të cilin e kishte punuar vetë me dorzë të larme, për të ma dhuruar mua për ditëlindje. “Hanxharin“ gjatë kohë nuk e hoqa nga brezi, pothuajse me të edhe bija në shtrat. Zgjohesha. Vetëm, lakmi e kisha “nagantin“ e Babait, që ai ditën e mbante në brez e natën nën jastëk. Një ditë edhe ma dha në duar duke më mësuar se si ta përdorë. Dihet, vështirë e kisha t’ia tërheq këmbëzën me një gisht, prandaj deri vonë ia tërhiqja me dy gishta...

Ditën e parë, kur im Atë më përcolli në shkollë e qiti edhe një pushkë. Vite më vonë, gjatë studimeve në Prishtinë, në bisedë e sipër ai ma zbuloi edhe një fshehtësi, se si ma kishte lënë emrin Kalosh. Bir, të pagëzova me emrin Kalosh, që të bëhesh trim si kaçaku i maleve: Kalosh Zajazi. Po, ti në vend të pushkës, rroke penën. Po, iu përgjigja. Edhe atë: përderisa Isa Boletini hyri në Londër me dy kobure, unë do të hyj në Qytetin e qyqeve me shtatë. Qeshi. Ku i ke?! Ja, e hapa çantën e zezë: katër, ia tregova stilolapsat. Edhe tre të tjerë, i kam nën sjetull. E hapa njëren anë të gunës së zezë deri në fund të këmbëve...

Im Atë, vite më vonë kur do të martohem unë, do të shkrepë pushkë edhe në mes të Prishtinës. Vite ato, kur unë ecja me shtatë kobure në brez. E ende nuk e kisha shkrepur asnjë fishek. Çudi! Edhe sot e kësaj dite më kujtohen shtatë koburet e mia dhe ajo e teta: “naganti“, që ma kishte dhuruar im Atë për ditëlindje. Vetëm, një gjë kam harruar t’ua them: im Atë gjithë jetën

“nagantin“ dhe mauzerrin nuk i hoqi nga brezi e krahu. Ja, pse edhe unë e vazhdoj traditën e tim Ati, i cili shpeshëherë më thoshte: “arma është miku më besnik i njeriut, nuk të trathton kurrë, vjen një ditë kur ajo ta shpëton kokën... E paguan veten dhjetëfish...”

Im Atë, në vitin 1984 vdiq nga kanceri. I kishte kaluar mjaftë beteja. Luftë pas lufte kishte hëngër plumba... E përballoi luftën... Presionet për të ikur në Turqi... Robërinë... Po, jo edhe sëmundjen, Zonjën Vdekje. Pak përpara se t’i dalë shpirti, si tek ajo kënga e njohur popullore shqiptare: **“Çka po i thotë Dema Kadrisë/ a ia din-o rendin burrnisë**, ma bëri me shenjë që t’i afrohem, të më lë ndonjë amanet. Iu afrova te shtrati. Po, u pendua, i gëlltiti fjalët...

Vite më vonë (1999), kur fushata e paparë kundër meje do të arrinte kulminacionin, do të më ndërseheshte pas shpine Kopeja me zgjebe, do të më kujtohet edhe amaneti i tim Ati, të cilin e mori me vete në varr: Mauzerri. Im Atë, para se të jepte shpirt, donte të ma lente mua amanet edhe pushkën. Tashti e kam të qartë pse edhe i gëlltiti fjalët. Vallë, athua pak para vdekjes e kuptoi se unë i kisha shtatë dhe një të tijën “nagantin“ – tetë... Nënët plagë i pati Gjergj Elez Alia... Plagën e dhjetë e mori me vete në varr...

Kulturofagu, Buça e Katundit, Patrioti i vonuar dhe këlyshët e tyre me zgjebe me nga një asht në gojë, ende më ndërsehen pas shpine. Njëri (Rrugaçi “mysliman”), këto ditë në mes të Shkupit me mua i përziu edhe kësulata: gjoja ia paskam ofenduar pejgamberin Muhamed a. s.?! I

mjeri këlysh anadolli - aziatik me zgjebe, që mu ndërsye tinëz nga shërbime sekrete antishqiptare ta “mbrojë” peygamberin nga një shkrimtar, që armë të vetme e ka penën. Muhamedi a. s. nuk ka nevojë t’i dalin zot këlyshë me zgjebe të sojit halldupit me bishtin nën këmbë. Langaçë të ndërsyer nga shërbime sekrete antishqiptare vetëm për një asht shpërblim. Këlyshë rruge të përjagur, që duan ta ngulfasin fjalën e lirë shqipe. Përditë propagandojnë gjuhë, veshje dhe kulturë të huaj turko-arabe në këto troje, që nëpër shekuj kanë qenë dhe janë shqiptare. Përpiqen të mbjellin frikë dhe torturojnë popullin shqiptar me pëllitje “myslimane” nga minaret e xhamive të Allahut. E në anën tjetër, harrojnë se ky popull ka edhe hundëleshë, që të rrokin për krahërori dhe të bëjnë të të shpëtojë në brekë, t’i ngrajnë këmbët në hava nga minarja e xhamisë.

Punemadhe, atë punë kanë trusakatët e Dexhallit, le të lehin pas Ujkut. Përjagen. Nxjerrin gjuhën dy pëllëmbë. Edhe pse, më dhimben si soj bubi aziatik, ashtu të mjerë me nga një asht në gojë rrugëve të Bit - Pazarit... Langaçë... Coftina... Shkak, që edhe kësaj radhe nuk i vrava me “nagantin“ e Babait, por me armën time të nëntë me dy tyta: penën...

Armën e dhjetë do ta marr me vete në varr...

ASKUSHI

Vështirë është ta duash një shtet që granaton popullatën e vet nga toka e qielli. Fshatrave ua vë zjarrin... Shtëpive... Shkollave... Xhamive... Pasurisë së shqiptarëve... Nëse do, të duan... Nëse urren, të urrejnë... Nëse vret, të vrasin... Këto janë ligje të natyrës. Nuk mund të shkohet kundër natyrës. Rrymës së ujit të lumit... Ai që i kundërvihet natyrës, është i dënuar të zhduket nga faqja e Dheut. Vallë, nuk i keni parë disa insekte se si e marrin ngjyrën e rrethit ku jetojnë, marrin frymë. Thua, ata këtë e bëjnë me dëshirë. Jo. Atëherë, pse u përshtaten atyre ligjeve?! U përshtaten, ngase duan të jetojnë, vazhdojnë luftën me natyrën. Jeta është luftë. Mjerë ai që i dorëzon armët dhe e pret vdekjen në mes të udhës...

Natën, pasmesnate bie në gjumë dhe zgjohem me Zonjën Vdekje. Nuk e di kush cilin e dhunon, e detyron të bëj dashuri. Vetëm një gjë e di, rrëzë Çukës më prët varri. Nën hije të Rrapit, shtambat me verë. Gjoku i lidhur nën hije. Arma e varur në një degë... Cuca Boheme...

- Hi-hi-hiii... Tungjatjeta, zoti Shkrimtar!...
- Tungjatjeta, Cuca Boheme... Ku je nisur sot kaq herët?!...
- Në mal... E kërkoj një burrë për grua... Nuk ka këtu burra, zoti Shkrimtar. Jo. Burrat janë në male...
- E vërtetë... Jo vetëm burrat, po edhe gratë...

-
- Atëherë, çka presim?! Zonjën Vdekje të na gjejë në Shtëpi?!... Shtrat...
 - Lumë ai, zoti Shkrimtar, që Zonja Vdekje nuk e gjen në shtëpi... Shtrat, në gjumë... Pasmesnate, u ktheva në shtëpi dhe e varrosa veten mes librave... Shtambave me verë... Në një faqe më kishte zënë gjumi...

Mesditë. I hapa sytë. Dielli më kishte hyrë në dhomë. E kisha bërë gjumin e të vdekurit. Trung. Asgjë nuk kisha parë, asgjë nuk kisha dëgjuar me veshë gjithë natën.

Edhe ëndrrat më kishin harruar në dhomë. Një libër ma kishin vënë te koka, një te këmbët... E mora veten në shpinë dhe e zvarrita deri te Rrapi. Varri im me dy shtamba verë... Tyrbja e Babashehut...

- Heu, Kalosh Çeliku, po sa varre i ke ti, më bërtiti matanë rrugës Cuca Boheme?!...
- Nuk e di... Një, dy, tre varre...
- Hi-hi-hiii... Dy varre i ka pasur Ali Pashë Tepelena...
- E di. Po, Kalosh Çeliku i ka tre varre: kokën në Shqipëri, trupin në Maqedoni, zemrën në Kosovë...

Dy ditë nuk dola nën Rrap. E mbylla veten mes librave... Shtambave me verë... Në këtë libër, nga i cili kërkoja shteg për të dalë në male... E hiqja veten zvarrë mes shkurreve, te Guri Zi, tek Dy Lisat në Çukë ku do ta përshkoja veten, ta shpëtoj nga magjitë... Marrëzirat... Xhindet që më mbytën çotek natë e ditë... Ndalem dhe e pyes veten: ende jam gjallë mes kaq shumë

spiunësh?!... “ Patriotëve “ të vonuar... Po, kujt duhet ti falemnderohem, vetes apo Zotit?!...

Vazhdoj me mendimet e rrezikshme që më sillen lëmsh në kokë. E tërheqin njëri tjetrin në këtë libër. Ndonjëri merr edhe malet. Nuk më dëgjon. I kanë rrokur armët. Zërin e ngrej në për liri...

E unë, që e vura në shërbim të Atdheut veten dhe pasurinë. Unë që vite me radhë i shëtisja rrugët e Shkupit me xhip, tashti ecja më këmbë. Gjithë pasurinë e trashëguar nga im Atë e kisha shndërruar në libra. Askushi, hiç i hiçit, me gen spiun brez pas brezi, tashti shëtiste me makinë luksoze dhe shiste mend përpara kalimtarëve në këto ditë lufte. E unë atij i kisha dhënë bukë, e mbaja gjallë, më kishte borxhe...

Askushi ma tregon edhe rrugën për në Baba Tomor. Gabimet gjuhësore. Dhe, ma bën me dije se: kam vdekur për së gjalli?!

Hi-hii-hiii... I mjeri, Askushi. Unë kam vdekur tri herë me radhë në jetë. Dhe, jam ringjallë si Krishti. E kam thënë qindra herë nëpër libra: burgu është vend për misimi. Pak vetë kanë dalë nga burgu njerëz normalë me trutë në kokë. Shumica kanë dalë spiunë... Pederë. Ose, të çmendur. E ndonjëri, edhe patriot... Koha është, shqiptarët më të mos krenohen me burgun, po me diploma universiteti, vepra letrare e shkencore.

Gabimet teknike, që mund të ndodhin në gazetatat e përditshme, internet, nuk janë edhe të autorëve. Edhe, nëse ndonjëri e ka bërë me qëllim, ose e ka harruar ndonjë presje, i ka shtuar fjalës ndojnë ë, që ashtu edhe ashtu i kemi nëpër

fjali me shumicë e pakicë. Punemadhe. Gjuha nuk ka kufi. Me sëpatën e madhe: janë gabime teknike. Askushi, çohet dhe bërtet në rolin e të gjithditurit, shet mend si gjeli kur ia thotë në pleh: gabime fillestari! E ka “zbuluar” Amerikën. Askushi nuk merret me vepra të arrira jetësore, po merret me thashetheme pas gardhit. Prandaj, edhe them: merruni me fenomene, e mos u merrni me cikrrime, individë!

Askushi e ka stazhin e të burgosurit politik: i numron vitet e “studimeve” në burg. Vuajtjet dhe maltërimet. Dërrasat, që i mungojnë në kokë. Fare pak librat nëpër rafte në bibliotekë. Edhe, ka lexuar ndonjë libër të “rrezikshëm” në bibliotekën e burgut. Në “liri”, pas vuajtjes të dënimit u është rrekur edhe studimeve të gjuhës dhe letërsisë në Universitet. Dikushi edhe e ka dalldisur, i ka dhënë përpara pampurrit: patriot. Gjenerali - gjuhëtar. Askushi të nesërmen, që është larg tyre me qindra kilometra, hedhë gurë e dru mbi shkrimtarë e studjuesë me bagazh letrar e shkencor: nuk e njohin gjuhën letrare, nuk dinë të përpilojnë fjalorë drejtshkrimor, fjalorë të gjuhës së sotme shqipe. Edhe Kongresi i Drejtshkrimit (1972) për “gjenium-patriot”, është pjellë komuniste. E në anën tjetër harron se, gjuhën letrare standard e kanë krijuar dhe e krijojnë shkrimtarët.

Askushi, i përpunuar nëpër burgje sllave, që deri dje lumit i ka thënë: “rekë”...

PAPAGALLI KAFAZIT

Papagallin e Kafazit e ka çdokush në shtëpi. E ka edhe shteti “demokratik”. Partitë politike. Qoftë njeri, qoftë shpend. E kanë edhe gazetat e “pavarurura” të “vëllazërim – bashkimit”. Herë pas here paraqitet me kolumna politike. Natë - ditë “këndon” nëpër shtëpi. Edhe nëpër gazetat e “pavarura” me një torbë taxhi shpërblim përqafe. Është polici besnik i Shtëpisë. E spiunon gruan te burri, e spiunon burrin te gruaja. Politikanin te Partia. Ministrin te Qeveria. Kryetarin e Partisë politike te populli. Edhe, ec e bë një hap në jetë para syve të Papagallit të Kafazit. Polici – zog, çdo gjë regjistron në kokën e tij “gjeniale”. Perditë “këndon” te “vëllazërit” posa hapet dera e madhe e Shtëpisë. E ka huj të vjetër që nga koha e “artë” komuniste. Sistemi i atëhershëm, që brenda natës e shëtiste nëpër vende pune në redaksi, kabinete, organizata “humanitare” e poste të partive politike. Nuk ka rëndësi kush është “mysafiri”, Papagalli i Kafazit e spiunon gjithë Shtëpinë. Edhe partinë politike. Gjithë shtetin “demokratik”. Përmëtepër, hiqet edhe si i mençur, “roje” e Shtëpisë. “Demokrat” i të gjitha kohërave që ia do të mirën njerëzimit. Dikushi, do të thotë: po mirë, Papagalli Kafazit qenka edhe shkrimtar. E vertetë, Papagalli Kafazit është edhe shkrimtar. Edhe poet. Edhe gazetar, analist politik. Edhe politikan katundi. Papagalli Kafazit është edhe artist i Bit – Pazarit. Që, një ditë me

“aftësitë” e tia të zogut - polic mendon të themelojë edhe Partinë e vet politike “demokratike”, t’u dalë zot shqiptarëve. Maqedoninë ta shpëtojë nga aspiratat e “pangopura” të shteteve fqinj, që e kanë në gojë e u ka mbetur nëpër dhëmbë. Përpak, të na fusin edhe në një luftë. Punemadhe, që nga ajo luftë “për të drejta kombëtare” gati dolëm edhe pa brekë. Kësaj radhe me Luftën e re për Shqipëri Etnike, mendonin edhe këto lecka arnë mbi arnë të na i heqin nga trupi skelet. E dalldisnin popullin e stërvuajtur shqiptar me republika nëpër katunde e këngë me çifteli ta fusin edhe në një luftë për Liri. Përndryshe, si do të rrinin rehat në kokërr të shpinës në Qeveri. Rrugëve të Shkupit të vozisin makina të mëdha e luksoze duke i parkuar edhe nëpër semafore duke i dërguar porosi popullit: e shihni, ne jemi forca e shekullit të këtij shteti. Makinat tona mund të rrinë në semaforë gjithë ditën e gjithë natën. Shkaku, se: ne kemi shtruar dreka e darka festive në emër të të vdekurve e të gjallëve. Dhe, nuk ka çka na bën ne policia e shtetit, e ku më populli edhe pa brekë në bythë. E kemi fituar këtë “liri” me gjak. Partia jonë zbriti nga malet. Edhe: mos u përpiqni kot të na e rrëmbeni Partinë. E japim jetën, po jo edhe Partinë. Postet e fituara me gjak në Qeveri. E kemi trashëgim nga të parët tanë me armë në dorë, veteranë lufte të Partisë Komuniste.

Papagalli i Kafazit kujton edhe sot se, shqiptarët hanë bar si dikur në kohën e “artë” komuniste. Edhe, kujt t’i teket dhe kur të dojë mund t’i fusë edhe në një luftë për bashkim

kombëtar. Ose, me gjuhën e Patriotit të vonuar, për Shqipëri Etnike. E në anën tjetër harron se, kokën e ka te partitë “demokratike” politike e bythën në Kafaz. Ani, në këtë shtet “demokratik” të papagallëve të Kafazit ka vend edhe për parti të tjera politike. Punemadhe, që i kemi me dhjetra, edhe nëpër katunde.

Nuk është këtu qëllimi i këtij shkrimi lexuesi im i nderuar që gjumi me vite të zë rrugëve, në punë, mbi libra. Ose, flen mbi shkrime me një sy të hapur nga dera e madhe e Shtëpisë. Papagalli i Kafazit, i ka shëtitur me rend të gjitha partitë politike shqiptare. Në emër të tyre edhe ka fituar poste partiake. Mjete materiale, dihet sa herë që na ka shitur te “vëllezërit” e Njerkës. Edhe nëpër “shoqata joqeveritare” e fondacione “humanitare” ka qenë i pari me torbën e taxhisë përqafe. Me të dyja duart e këmbët sa ka mundur ka rrëmbyer mjete materiale në emër të popullit shqiptar. Vërtetë, e ka dashur shumë këtë popull ky Papagall i Kafazit. Merreni me mend, me paratë e popullit u ka paguar dreka e darka “vëllezërve”, i ka pritur vëllezërit e “gjakut” në Qafë Thanë për vizita “ miqësore patriotike kulturore-atdhetare”. Edhe pse, brenda Kafazit ka bërë karrierë politike dhe intelektuale. Zot, mos më keqkupto për të gjitha këto “marrëzira” që shkruaj mes këtyre rreshtave: me paratë e popullit ka blerë banesë shtetërore dhe ka ndërtuar edhe shtëpi moderne në disa kate, në Katund. E ka ngritur zërin nga Kafazi, sa herë që ia kanë bërë “vëllezërit” me gisht pas porte: kapeni “nacionalistin shqiptar”! Edhe në dritare ka dalë shpeshëherë, krah për

krahu me sojin e tij të “analistit politik” për të shitur mend në gazetata e “pavarura” dhe para kamerave televizive, duke kënduar “këngë patriotike” shqiptare me çifteli. E ka kot ky Papagall i Kafazit, ku me ditë çka të bëj mes shufrave të hekurit, është Papagall Kafazi. Dhe, nuk ka Zot që e nxjerrë nga Kafazi në Liri. Shkaku se, ky Papagall edhe e do Kafazin. Fundekrye, duke harruar veten se është vetëm një Papagall Kafazi, të cilit edhe i pëlqen kjo Shtëpi me shufra hekuri edhe më shumë se Liria në male. Ndoshta, ku ta dimë ne edhe i këndon Robërisë.

Edhe “këdon” në Kafaz: E fituam Lirinë! E fituam Lirinë! E fituam Lirinë! Fletët i përplas nëpër kafaz nga lumturia. Këngë e bukur, thotë patriotike me çifteli. Punemadhe, që vetëm kopjon zëra, këngë banale, mendime papagalli nga Kafazi. Asgjë nuk ka të veten origjinale. Dirigjent e ka pronarin e Kafazit. Shkopin e tij e përcjell lartë - poshtë në ajër me admirim. Gjithë vlerat artistike të kompozimit ia mvësh atij si artist sakat plagiator. Edhe këngën për Skënderbeun te Sheshi i Shkupit në Bit – Pazar. E sulmon me krrokama Kafazi, edhe Gjenium e muzikës popullore shqiptare. Autorin e tekstit të këngës luftarake, pa të cilin Skënderbeu, kurrë nuk do të hynte në Bit – Pazar. E jo më në këngë, edhe atë hipur mbi kalë shale me armët e luftës në brez në mes të Bit - Pazarit.

O Imzot, na shpëto nga ky soj i papagallit, që natë e ditë nga Kafazi na “këndon” këngë

patriotike patetike në Shtëpi! Edhe atë, në stilin
plagiat të Papagallit Kafazit...



QERBELAJA SHQIPTARE

E kam pritur Dexhallin e Allahut natën, pasdarke. Pasmesnate. Diku, para agimit. Edhe ditën. Po, jo në mesditë, në mes të Ditës Madhe. Derën, dihet e ka pasur të mbyllur me shul. Dritaret, poashtu me hekura. I vetmi shteg i mbeti oxhaku. Dexhalli Allahut erdhi në pabesi, në mes të Ditës Madhe. Krahu për krahu me shokë hyri edhe në xhami. Edhe atë: në xhaminë më të madhe në Shkup: Isa Beu. Shtëpinë e Zotit, ku i falte të pesë vaktet para këmbëve të Hoxhës, ish Minsitri i Kulturës: Haxhi Deputeti. Edhe: ndodhi Lufta e Qerbelasë. Haxhi Deputeti (ish Ministri i Kluturës në IRJ të Maqedonisë) ra “shehit” duke mbrojtur Shtëpinë e Allahut: xhaminë Isa Beu, në Shkup. Poeti ynë i madh Naimi, atë luftë heroike e qau me vagje te vepra e tij: *Qerbelaja*. E ne, sot nuk kemi poet këtë Luftë të Qerbelasë shqiptare ta vajtojë me poezi, në ndonjë libër. Këngëtar popullor me çifteli. Ose, cucë ta vajtoj me dajre nëpër dasma shqiptare.

Dhe, përderisa shqiptarët mysliman, xhaminë Isa Beu e kanë shndërruar në Qerbela, matanë, dhe në këtë anë të Urës Gurit, rrinë krahu për krahu misionarë fetar grek (mitropolitë Beogradi) me kryqa e bibla në duar dhe heronj bullgarë mbi kuaj me shalë. Në anën e shqiptarëve: në krahun e majtë, përballë meje i përshëndes nën hije me një birrë Shkupi: Shën Klimentin dhe Shën Naum Ohrin. Në anën e

djathtë: Shën Kirili dhe Medodi. Dhe, matanë Vardarit në anën “maqedonase”: në anën e majtë Dame Gruevin, në të djathtën Goce Delçevin hipur mbi kuaj me shalë. E kërkoj me sy Karposhin, udhëheqsin hajdut të Kryngritjes maqedonase, që pas tërheqjes së aradhave austriake nga Maqedonia, kryengritja u shua dhe prisin e tyre turqit, pasi e kishin ngulur në hu, e hodhën në Vardar. Hajduti harambash, në kohën e komunizmit jetonte në përmendore me duar të lidhura te këmbët e Urës Gurit, në Shkup. Nuk e shoh askund. Kësaj radhe siç duket e kishin hedhur vetë “maqedonasit” në Vardar. Prandaj, le të mos mërziten shumë shqiptarët me këto ndërtime e përmendore partiake të përkohshme: koha e bënë të veten. Ligjet e Natyrës. Edhe sot, shumë heronj “maqedonas” që i shohim te të dy këmbët kryesore të Urës Gurit, në Shkup, nesër do të kërcejnë bythekrye në Vardar.

Tungjatjeta, o burra “maqedonas”! I përshëndes nën hije me një birrë Shkupi. E ku i keni gratë?! Mirë do të ishte te këmbët e Urës Gurit me vete të kishit edhe ndonjë grua heroinë. Mundet edhe bullgare. Europa, nuk ju do pa gra. Tekefundit, nuk ju kam unë faj, që piqeni në këtë diell vere. Fajin e ka politika ditore. Shqiptarët nuk i shoh askund, as te këmbët e urës e as te sheshi “Makedonija”. Edhe pse, edhe ne kemi pasur burra dhe gra me kryqa: Pjetër Bogdanin, Sevasti dhe Parashqevi Qiriazin, Pjetër Budin, Papa Kristo Negovanin. Josif Bagerin... Edhe me Hënë: Mehmet Pashë Derallën, Sulltanë Qafën, Dervish Carën, Hoxhë Tahsinin, Haxhi Zekën,

Dervish Himën... Përmëtepër, edhe burra pushke, që e kanë çliruar Shkupin nga halldupi: Bajram Curri, Isë Boletini, Kalaosh Zajazi, Pjetër Guri, Hasan Prishtina... Them me vete: me siguri këta burra mejdani i ka zënë vapa, janë nën hije, nën Rrap. Dhe, i presin partitë politike shqiptare për një gotë ujë.

O Imzot, ku janë shqiptarët?! Njëri më përshpëriti në vesh: matanë Urës Gurit, i luten Allahut për Burmali Xhaminë! Fatkeqësi e madhe! Po, shqiptarët nuk kanë shkolla shqipe?! Xhami, na ka dhënë Zoti me dy e katër minare, që në kohën e Turqisë. Edhe Serbia, vërtetë na i ndaloi shkollat në gjuhën shqipe, po kurrë nuk na i ndaloi xhamitë. Komunizmi, vërtetë na bënte probleme për hapjen e shkollave shqipe, po xhamitë me ndërmarrje të veta ndërtimore na i ngulte në mes të fshatit edhe me nga dy minare. “Demokracia”, dyert e xhamive na i hapi krah më krah në të gjitha trojet etnike shqiptare. Edhe të kishave me kryqa nëpër fusha e male. Problem, ne shqiptarët kemi me “myslimanët”. Nuk kemi myslimanë për në xhami.

Zemrohëm me të gjithë këta burra mejdani. Edhe te këmbët e Urës Gurit. Edhe në xhaminë: Isa Beu. Edhe në Qeveri. U them: nuk më hy uji nën këmbë për “myslimanët” e këtij soji anadollo-aziatik, po edhe mua më morët në qafë. Pse, bre burra të Zotit vazhdoni ende të ma pini birrën, hani bukën?!... Edhe pse, moti keni vdekur në histori, nuk keni nevojë për birra Shkupi nën hije, e as për bukë?!..

Unë sa di, ju nuk pini birra Shkupi, nuk hani as bukë. Shkaku se: moti keni vdekur nëpër institucione fetare e të Qeverisë. Kush drejtin tashti u ringjalli te këmbët e Urës Gurit të ma pini edhe birrën?! Hani bukën, dhe përmbysni kupën. Përmëtepër, kur e di se këtë urë e kanë ndërtuar dhe e mbajnë gjallë shqiptarët. E dini, ku e kam fjalën: pse na merrni në qafë ne të gjallëve?! Më përgjigjen: ne nuk kemi faj, në emër tonin bëjnë karrierë politike të gjallët. E ngrej zërin: deri kur me këta të vdekur do të bëjmë politikë shtetërore?! Populli kërkon bukë. E të vdekurit, rehati në varre.

Përsëri u them: nuk ndërtohet “vëllazërm-bashkimi” komunist dhe “bashkëjetesa” kështu siç e keni nisur ju: I keni pushtuar të dy këmbët e Urës Gurit. Edhe Sheshin “Makedonija”. Patjetër, duhet të bëjmë edhe një marrëveshje! E keni bërë një me Ali Ahmetin: Marrveshjen e Ohërit. Po, nuk keni bërë marrveshje me popullin shqiptar.

Dhe, e kam mendjen te Baxhi: maçorri im besnik, që e ndanë bukën dhe shtratin me mua shkrimtarin. Shkaku: nuk erdhi mbrëmë të ma zë shtratin natën, të shtrihet në kokërr të shpinës për shtatë palë qejfe. Përdredhë mustaqet. U tremba, thashë me vete: mos e kanë takuar natën në rrugë aktivistet e Nënës Parti, e kanë marrë edhe atë në Qeveri për ministër.

Bërlloku shqiptar “mysliman”, kërkon matanë Urës Gurit të ndërtohet Burmal Xhami. E nuk kërkon shkolla shqipe, në këtë anën shqiptare të ndërtohen përmendoret: e Bajram Currit, Isë Boletinit, Pjetër Bogdanit, Kalosh Zajazit,

Sulltanë Qafës, Pjetër Budit, Dervish Carës...
Thashë: Edhe ne i kemi kryqat tanë: Nënë
Terezën, Pjetër Bogdanin, Sevasti dhe Parashqevi
Qiriazin, Pjetër Budin, Papa Kristo Negovanin,
Josif Bagerin...

Eh, lexuesi im i nderuar! Jeta është e
çuditshme, çka nuk të bjen në jetë të provosh mes
këtij bërlloku maqedono-shqiptar. Edhe
pushtuesit. Edhe shtetin. Edhe Partinë Komuniste.
Edhe partitë politike “demokratike”. Edhe
pushtetin diktator. Edhe, policinë letrare. Edhe
vrasësit. Edhe hajdutët. Po, ja nuk të ka ra rasti të
të dalë në mes të ditës në rrugë Shtrigani Allahut.
Dhe, dorën në zemër të vjen inati, si të mos i
provosh edhe këta “shërbetorë besnikë” të Zotit.
“Shehitët” e Allahut, që gjithë natën vjedhin,
spiunojnë, vrasin dhe shpërndajnë drogë në
xhami. E të nesërmen, si një kope me zgjebe
përpara këmbëve të Hoxhës i falin të pesë vaktet,
i luten Zotit për mëkate.

Dexhalli është i madh. Dhe, një ditë ma
ndërseu në rrugë Shtriganin e Allahut. Merreni
me mend, një poeti që kudo ku ka shkuar: Tiranë,
Prishtinë e Shkup, njeri i gjallë nuk i ka kërkuar
as edhe letër njoftimi. E të mos flasim për
probleme të papritura, që mund t’i ndodhin në
rrugë. Po, ja Shtrigani Allahut, nuk di për këto
rregulla civilizimi. Në mes të ditës, në vend që ta
fali “Xhumanë”, ta zë rrugën. E ke ofenduar
pejgamebrin Muhamedin a. s. Edhe, të detyron në
vend të penës, t’i përdorish grushtat. Edhe atë: siç
thotë populli në mes të pazarit. Rrugaçët
“myslimanë” që pejgamberin duan ta mbrojnë

nga intelektualët fizikisht edhe në rrugë, e jo me veprime e lutje në xhami.

Vetëmse, Shtriganin e Allahut “mysliman”, kurrë deri në atë ditë nuk e kishte rrokur dikush për krahërori. Edhe, nuk ia kishte mësuar rregullat dhe teknikat e boksit. I mjeri rrugaç “mysliman”, që nuk e dinte se gjatë shkollës së mesme në Shkup, unë kisha ushtruar katër vjet me radhë boks në një sallë sportive në legjen e “Aerodromit” bashkë me kampionatin e boksit botëror Azis Salihun. Po, ja nuk e deshi Zoti që unë të bëhem bokser, u bëra shkrimtar.

Qe, si qe, te ne në Katund thonë: Deharet u dogjën. Vetëm, e pabesueshme është se, si është e mundur që këta rrugaçë “myslimanë”, i merr në mbrojtje edhe policia. Unë e di këtë histori të vjetër sllave. Brez pas brezi, kjo histori na ndjek ne shqiptarëve. Edhe në kohën e Turqisë. Edhe në kohën e Serbisë. Edhe në kohën e ndryshimeve demokratike. Armiqtë tanë shekullor, nëpërmes fesë myslimane e kanë luftuar shqiptarizmin. E kanë thënë Rilindasët tanë, nuk e them unë këtë zbulim të shekullit. Tekefundit, e ka vërtetuar edhe historia. Edhe një herë e përsëris: me nënshkrimin e hoxhallarëve pas Luftës së Dytë Botërore viset shqiptare në mënyrë “vullnetare” nuk i janë bashkuar Shqipërisë. Me “misionin e shenjtë” të hoxhallarëve të rrejshëm, shumë “turq mysliman” nga këto troje etnike, janë shpërngulur me gjithë familje në Turqi.

E kam fjalën: edhe e sotmja i ngjanë të djeshmes famëkeqe. Shkaku: edhe sot si dje haramët “mysliman” duan me zor dhe forcë t'i

bëjnë fetarë shqiptarët. I përdorin të gjitha metodat komuniste si dikur në kohën e Turqisë: me fe, mjete materiale dhe forcë policore të na asimilojnë e përzënë në Turqi. Ose: përsëri nën thundrat e Turkut, në robëri. Vallë, nuk i shihni, apo u janë qorruar sytë se, si e përhapin gjuhën e huaj, kulturën turko-arabe, veshjen e zakonet arabo-aziatike. Në vend të shkollave shqipe, ndërtojnë xhamia me dy e katër minare. Librat shqip i kanë zëvendësuar me qitapë arabë.

Përmëkeq, sllavët si dje edhe sot i përkrahin nëpërmes shërbimeve sekrete antishqiptare. E sidomos, kur janë në pyetje shkollat shqipe. Kultura shqiptare. Policia i merr edhe në mbrojtje si të rrezikuar nga “shqiptarët e pafe”. E them këtë me plot gojën se, mua më ndodhi një incident fetaro-policor: person i panjohur si i tërbuar më sulmon pas shpine në rrugë me pretext se: gjoja ia paskam ofenduar pejgamberin Muhamed a. s. Merreni me mend: njeri që nuk e njeh, nuk e ke shikuar keq, nuk ia ke shkelur rastësisht këmbën, nuk ia ke zënë rrugën. Po, ja sipas mendjes së tij turko-arabe dhe shërbimeve sekrete antishqiptare, ti këtij rrugaçi “mysliman” ia ke zënë Hënën.

Përmëkeq, ti kur e paraqet rasitn në polici se, papritmas je sulmuar nga person i panjohur, policia atë e merr në mbrojtje. Thotë: ty duhet të të bëjmë aktpadi se e ke provokuar i pari besimtarin e Allahut në rrugë.

Dhe, edhe pse e kam paraqitur rastin në polici, edhe sot e kësaj dite nuk është zbuluar ky veprim misterioz. Atëherë, ku është problemi: te

unë si shkrimtar, apo te rrugaçët “mysliman” si bashkëpunëtorë të policisë sekrete sllave?!...


Edhe, më afrohen plot punë: unë t’i gjuaj hajdutët në popull, t’i ushtroj rrugaçët “mysliman”, jo nëpër klube të boksit, po në rrugë. U them: unë kam punë. Edhe atë: 24 orë. Momentalisht, punoj për veten: libra. Vetëmse, punoj pa lek. Nuk e kam ende mendjen të shitem me para. Hajdutët i keni të punësuar në Qeveri. Edhe rrugaçët “mysliman”. I mbani gjallë qe njëzetë vjet me radhë: skertetarë partie, ministra, deputetë, ambasadorë, drejtorë, analistë politik... Fatkeqësisht, ndonjëherë ulen edhe me mua në tavolinë të pinë kafe. Më dhimbsen si të “papunë”, gjoja i ka harruar Nëna Parti t’i fus në listë. U paguaj edhe kafe. Por, kur i pyes se ku punojnë, më përgjigjen: në Qeveri. E mirë, a nuk mund të ndryshoni ju aty diçka me punësimet, mos dërgoni nëpër institucione të shtetit gjysmanalfabetë?! Përgjigjen: ne aty kemi shumë pak ndikime, nuk na pyesin, ne nuk shkojmë edhe në punë. Vetëm, i marrim rrogat pa punë. Tmerrohem, pse u kam paguar kafe, nuk e meritojnë haramët.

Ec, e mos pëlçit nga kurrizi, e jo nga barku! E provokoj shtetin “demokratik”, që e ka mbushur barkun e Kalit të Trojës plot “patriotë”. Ndonjëherë, duke ecur edhe kundër ligjit. Po, ky shtet “demokratik”, siç duket është i “mençur”. E kam thënë njëherë në një shkrim timin: “Shtet i mençur”. E provokoj nateditë që të më rrasin në burg. Edhe unë t’i provoj ato mure, t’i mbush me poezi! Përmëtepër, nga miqtë e mi ish të burgosur

politik kam dëgjuar se, burgu i Idrizovës e ka Bibliotekën më të pasur me libra në gjuhën shqipe në Evropë. Nuk do. Dhe, nuk do shteti “i mençur”, në gojë të Evropës.

E unë, edhe në këtë shkrim, vazhdoj ta provokoj këtë shtet “demokratik”: të më rras në burg. Shkaku: Unë jam në burg.

Dhe, dua të dal në matanë mureve në Liri!...



VIII XHADIA

SHTRIGANI ALLAHUT ME NUSKA PËRQAFE

E kam një të mirë në jetë: kurrë nuk i kam besuar pasqyrës. Përndryshe, kam plot minusa në jetë. Tek – tuk edhe ndonjë plus. Edhe pse, herë pas here jam i detyruar të qëndroj për disa minuta para pasqyrës: shoh fytyrën, krehi flokët, mjekrën, vë kësulën time karakteristike në kokë. Ndoshta, edhe e kam të vetmen pasuri trashëgim nga të parët, kaçakët që u ngjitën maleve brez pas brezi me pushkën krahut për Liri. Tjetër, nuk kanë pasur mundësi të gjithë shqiptarët ta shohin veten në pasqyrë. Ndonjëri, nëse e ka parë, e ka parë veten në një copë të thyer pasqyre ose xhamat e dritareve. Shqiptarët në ato kohëra nuk kanë pasur bukën e gojës, e ku më të mendojnë për ta parë veten se si duken në pasqyrë. Mjafton, kanë pasur mauzerrin. Nagantin në brez. Dhe, bombat nëpër hatulla. Pasuri me të cilën janë krenuar nëpër shekuj. E kanë ruajtur pragun e Shtëpisë. Megjithatë, ja dikushi edhe e përmend pasqyrën. Fatkeqësia, e përmend, por kurrë nuk e ka parë veten në pasqyrë. Ose, e ka parë, por kur e ka pyetur pasqyrën se: kush është më i bukur në botë, pasqyra e ka mashtruar atë ditë. I është përgjigjigjur ashtu si tek ajo përralla e bukur popullore “Borëbardha”: ti je “patrioti” im,

Shtrigani Allahut më i bukuri në botë. Posa e dëgjon këtë përgjigje Shtrigani Allahut, e shtrembëron kësulën leckë mbi vetulla. Mustaqet vesh më vesh, nuk ia rrëfen pasqyra. Më kot i hap syt, e improvizon situatën: burrat e këtij soji, patjetër duhet të kenë edhe mustaqe turku. I përdredh para pasqyrës gishtat në ajër sikur t'i kishte mustaqet. Punemadhe, që nuk i ka as këto mustaqe, edhe këto shenja burrërie ia rrëfen pasqyra. E në anën tjetër kërkon të tjerët burra, edhe atë, shqiptarët ta shohin veten në pasqyrë. Populli, që kurrë nuk ka pasur mundësi të ketë pasqyra nëpër dhoma, edhe pse e ka parë veten mbi puse në mes të kopshtit, para se ta lëshojë kovën e ujit. Ose, në ndonjë hurdhë te Mulliri i Arapit. Megjithatë, nuk i ka besuar asaj pasqyre. E ka ditur se është e rrejshme, pasqyrë Anadulli. Ndonjëherë, nuk e thotë të vërtetën. E shi sot ky, “analisti ynë politik”, do që edhe në kohën e sotshme shqiptarët ta shohin veten në pasqyrë si në kohën e Shtrigës Plakë. Dakord, e para shqiptarët nuk i besojnë më pasqyrës. E dyta: mvaret edhe kush ua nxjerrë shqiptarëve para fytyre atë pasqyrë, ose ua varë në mure të odave shqiptare. Dorën në zemër, mund t'ua nxjerrë dikushi i gjakut, po jo edhe melezi që nuk di kend e ka nënë e kend babë. Shkurt, t'i porosisë shqiptarët ta shohin veten para pasqyrës. I bindur jam se: ky në shtëpi nuk ka as qen, as mace. E si do t'i pri një Partie politike ky kungull Stambolli?! Për lopë, dele e kuaj, nuk flasim në këtë shkrim. Gjeli e di, kurrë duke i përplasur fletët nuk i ka kënduar në gardh, t'ia thirrë agimin

me këngë. Edhe këto kafshë shtëpiake nuk i ka Shtrigani Allahut.

E vërtetë, shqiptarët dikur nuk kanë pasur si sot pasqyra në mure. Tekefundit, edhe nuk kanë dashur ta shohin veten në pasqyrë. Ose, çdo shtëpi shqiptare e ka pasur pasqyrën e vet në mes të kopshtit. E kanë parë veten për çdo ditë para se ta nxjerrin kofën me ujë nga pusi në Katund. Vetëm e çuditshme, del sot një “analist politik”, dhe u thotë shqiptarëve: ju duhet ta shihni veten në pasqyrë. Përmëtepër, duhet t’i “përmbaheni parimit se, nëse kryetari të thotë se miu është luan, besoji kryetarit dhe jo syve...” edhe, “bariun nuk e bën të vlefshëm ajo që ka në kokë, por shkopin që ai mban në dorë...” I thotë: “Bariut” të maleve me dele e desh me këmborë me brirët disa herë rrotulluar rreth veshëve, që pasqyrën e mban me vete bashkë me bukën në janxhëk. Edhe shkopin e thanës me kërluk, Nagantin në brez me mauzerrin përqafe. Dhe, verë – dimër gunën e oqiçit krahëve në shi e borë.

Edhe: kush është më i mençur “bariu” apo qeni?! Gjithësesi Bariu, që e ushqen qenin me bukë. E qeni që nuk i del zot Shtëpisë. Kopesë me dhenë, haram i qoftë buka!

E ne në Katund edhe kuajve u varim përqafe nuska. Megjithatë, ata ishin kuaj shale, përdallim nga këta kujat e soçëm me nuska përqafe, shumë edhe më besnik. Kuaj me shalë që im Atë i shalonte në Katund. E sot, i kalëroj unë me një laps në vend të thuprës thanës në dorë nëpër libra...

E them këtë se: shqiptarët gjithë jetën e kanë parë veten në pasqyrë, po a e ka parë veten ndonjëherë në pasqyrë ky “analist” melez politik?! Jo, nuk e ka parë. Them unë: autori i këtij shkrimi. Shkaku se, po ta kishte parë veten, ky “analist politik”, kurrë nuk do ta hapte gojën në gazetë. E të mos flasim në mjetet e informacionit të thashethemeve, edhe sot si dje duke ua ndërsy policinë letrare krijuesve “të rrezikshëm” për shtetin. Megjithatë, është koha e thashethemeve. Koha, kur këtë “patriot” melez, pasi ia mësoi shteti gjuhën shqipe nëpër redaksi komuniste, e bëri edhe shkrimtar “disident”.

Dhe, “Bariu” që ka shkopin në dorë, me siguri i ka edhe mendtë në kokë. Përndryshe, dhentë do t’i ruante Shtrigni Allahut. Që fatkeqësisht, dje nëpër redaksi komuniste me dy-tre vende pune e ruante shtetin komunist nga “irredentizmi shqiptar” pa shkop e mend në kokë. Armët kryesore me të cilat “Bariu” i ruan dhentë nga Ujku. Vatha të mos jetë shesh i valleve të Shtriganit Allahut me shokë, po shtëpi e dhenëve që i ruan “Bariu”.

Edhe gjatë kohë shqiptarët do të vuajnë nga ky soj i “analistit politik” i thashethemeve, që e bartin me vite mbi shpinë si Nastradinicën gomari i Nastradinit. E i tërheq përdore me litar kanapi rrugës Shtrigani Allahut. Zoti i shpëtoftë shqiptarët nga vetvetja! Shtrigani Allahut me nuskat e Hoxhës përqafe, që natë e ditë rri para pasqyrës!...

SHKUPI DIGJET E PLAKA KRIHET NË KATUND

Vapë. Dhe, çdo gjë të djeg nën këmbë si shpuzë: Trotuari, asfalti, shkallët në oborr. Edhe parqet e Çairit plot bërlllok. Qyteti i betonit, Shkupi siç duket këtë verë ndizet në flakë. E djegin partitë politike. E djeg Natyra. Priftërinjtë dhe hoxhallarët, do të thonë: për inat edhe Zoti. Ikin kush si mundet dhe nga mundet në të katër anët e botës. Partizanët e partive politike në pishina. Brigjeve të ndonji lumi. Ose, në liqe. Politikanët në det. “Intelektualët” (me diploma e tituj shkencor universiteti të blerë në Bullgari e Qafë Thanë), pak si më “trima” me gjithë gra e fëmijë në Katund. Vetëm, populli nuk ka ku të ikë nga ky saç i skuqur politik, është strukur nëpër kolibet e tyre me këmishat e zhveshura arnë mbi arnë e një copë buke në dorë mes mureve gati të rrëzuar të shtëpive. E presin Dimrin me borë t’ua mbulojë çatitë, ndez zjarrin në oxhak.

Përmendoret në të dy anët e Urës Gurit, me kuaj shale e më këmbë, kush me kryqa e libra të shenjt në duar, hoxhallarët nga minaret e xhamive pesë herë në ditë duke e thirrur Zotin në ndihmë, më kot përpiqen ta shuajnë flakën që e ka kapluar Shkupin. Edhe Pjetër Guri, gjatë festimit të Kryngritjes të Ilindenit në Krushevë, kot nga atje hudhi gurë mbi zjarr. Shkupi vazhdon të digjet flakë nga politika “patriotike”.

Ali Ahmeti këtë verë ka ikur në Zajaz. Menduh Thaçi, rrëzë Sharrit në Tetovë. Imer Selmani nga Saraji piktoresk, u dërgon ndihmë “vëllezërve” përmes deputetes së tyre artiste Znj. Flora Kadriu: dredhëza me shporta. Sefedin Haruni i shkruan letra “dashurie” Ilir Metës. Komandant Hoxha na dërgon nga malet: dardha gorrice. Hysni Shaqiri, siç duket ka shkuar për pushime në “Zonën e lirë”, në Kumanovë. Bardhyl Mahmuti, rrezitet në diell përpara këmbëve të Xha Naimit, në Tetovë. Gruevski dhe Cërvenkoski i kanë nxjerrë shpatat nga brezi për luftë. Mjetet e informacionit i përcjellin për së afërmi “betejat e tyre të përgjakshme” për Maqedoni. I dalin zot Shkupit. Thonë nga “Meçki Kamen”, në Krushevë: “nuk duam askujt t’i marrim territore, as kulturë, as histori, asgjë që është e huaja. Po, nuk duam të na e marrin edhe neve atë që është e jona, patriotike”. Përpiqen, ta shpëtojnë nga zjarri Maqedoninë. Boshkovski, në këtë ditë madhështore edhe ai u vjen në ndihmë me disa komita: hedh benzin me kova mbi zjarr. Todor Petrov në shënimin e 2 gushtit të dy Ilindenëve, në katund e shpallë Greqinë fashiste.

Shkupi ende digjet në flakë. Ndërkombëtarët, përpiqen ta shuajnë nga toka e qielli me helikopterët e Rusisë që i bleu ish Qeveria gjatë krizës së Luftës të 2001- shit. Nga të gjitha anët i ka hyrë zjarri Maqedonisë. E vetmja, që mund ta shuaj këtë zjarr, hedhë një kovë ujë, është Greqia. Edhe pse, edhe asaj gjatë kësaj vere i ka rënë flaka. Shqipëria, ua dërgoi në ndihmë Ilir Metën, që mezi shpëtoi kokën në Bit - Pazar, përpak e

përbiu flaka. Bullgaria, matanë edhe ajo e feston Ilindenin e vet historik. Thotë: Maqedonia është bullgare dhe shqiptare. Nëna Serbi, nuk ka më tambël t'i japi foshnjes që e lindi në mesin e arave të kooperativës, i ka shterë gjiri. Taxhia. Hoxhallarët, me duva e hajmalia më kot përpiqen t'ia kthejnë tamblin. E ka thithë Bolla me flokë. Evropa, përpiqet ta fusë në vathë mes lopëve të "dërzhavës". Edhe hedhë një torbë taxhi, një krah bar në grazhd. Nesër, ta mjel me kusi në kooperativën bujqësore të (Tito) Velesit. Edhe pse, ajo qet shqelma, nuk do të milet si lopë. E kërkon shterren që i iku nga vatha. Ende mendon ta rrisë lopë katundi, ta mjelë edhe në të ardhmen me kusi në mes të Lëmës.

Punë e kotë, më thotë Mikja. E ka nemur Shoku Tito. Nuk bëhet shtëpi, nuk përkund djepa kjo Nuse kurvë. Tri Cucat gjylvetare që ia polli putanja dhe i rriti me shumë mundime, i përzuri nga shtëpia. I nxorri në sokak, i la dyerve të hallkut nëpër shtëpi publike ta shesin veten edhe për bukën e gojës. Secilit që t'i teket dhe kur t'i teket, t'i shterë herdhët. Pasmesnate, të pjellin kopila, e ditën të na i lënë pas dere. Merrni, i futni në shtëpi, janë lyrekët e juaj që i pollën gratë e juaja kurva!

Dhe, të nesërmen, përderisa Shkupi digjet flakë, këta kopila lëmë na i bënë shtëpitë. Në mes të odës hedhin valle. Edhe marrin nuse. Dasëm bëjnë me shtatë palë lodra e cingana. Krushqit i prinë koçisë me këngë. Krushkat me dajre na e zbresin Nusën në lëmë.

Dhëndrri e merr për krahu dhe e futë në dhomë. Pasmesnate, kur i del gjumi e sheh se ia kanë ndërruar Nusen. Tjetër cucë i kanë futur në koçi. Kunatat e marrin për krahu te bunari t'i japin ujë. Vjehrra e sheh nëpër sitën e miellit. E mua, nuk më vijnë miq të paftuar në banesë: të m'i shohin raftet me libra, shtratin e drurit, tavolinën e punës, llampën mbi kokë. Tekefundit, të ma shohin pasurinë e patundshme, se atë të tundshmen e dinë, e kanë për mejdani. Shkurt, të ma qajnë hallin, afrojnë vende pune, kolumna teknefese të shkruaj nëpër gazetat e “vëllazërim-bashkimit”, të më blejnë me para si kolegët e mi “patriotë”, shkrimtarë oborri.

Edhe pse, Shkupi digjet flakë, dasmat “patriotike” edhe gjatë kësaj vere i fryjnë zjarrit. E ndezin, i hudhin krënde të thata nga malet e Diasporës. Këngë tallava. Euro me torbë. Djersën disavjeçare që e kanë fituar shqiptarët nëpër dyert e hallkut me vite, e harxhojnë brenda një nate në dasëm. Edhe atë: kur fëmijët e tyre edhe në shekullin e XXI, nuk kanë shkolla, mësuesë, biblioteka, libra e fletore...

Përditë, ankohen në polici: ua kanë vjedhur banesat. Paratë. Stolitë e arit. E pabesueshme. Vite me radhë, unë banesën time përplot me libra, nuk e mbyll me çelës. E lë të hapur, edhe ditën edhe natën. Nuk duan të hyjnë hajdutët, dhe nuk duan edhe pse moti ua kam hapur krah më krah derën. Ose: më shumë i duan eurot. Stolitë e arit. E nuk duan libra. Ndodhë. Çdo gjë është e mundshme në këtë shtet “demokratik”, që i vjedh edhe shkrimtarët, dhe vetë maqedonët i hudhin

dru zjarrit ta djegin Shtrigën. Ose, siç duket janë hajdutë të ndershëm, nuk i vjedhin shkrimtarët, nuk duan libra.

Dhe, përçudi banesën time plot me libra në Çair të Shkupit, nuk e vjedh askush...



VAJTOJCAT E ZAJAZIT

Histori më vete: sa herë që sharronte në bërlllok ndonjë grua ose burrë, Nëna ime thoshte: është bërë për ta vajtuar me gra Zajazi. E vrisja mendjen nateditë, nga vinte deri te ky përfundim. Më në fund e gjeta shtegun: Nëna ime i kishte dajhtë e nënës në Zajaz. Edhe, siç duket kishte marrë pjesë në shumë dasma e varrime të asaj ane. Një gjë të tillë e dija edhe unë si fëmijë, duke shaluar një “kalë” shelgu përmes livadhit në Katund, rrëzë Çukës. Gratë e Zajazit ishin vajtojcat më të mira në rrethin e Kërçovës. Pse të mos e them haptas: edhe në rrethin e Gostivarit, Tetovës, Dibrës... E vajtonin kufomën aq bukur, sa të shkonte mendja se, a janë duke vajtuar, apo janë duke i kënduar të vdekurit mbi kokë. Ndonjëri, edhe thoshte: vajtojcat e kësaj ane mortin e shndërrojnë në gëzim. Varrimet në dasma shqiptare.

Kulminacioni, e di se një kope me zgjebe e shqiptarëve janë bërë për t'i vajtuar me gra Zajazi. Edhe atë: ditë – natë, jo me dajre, po me tepsia të arnuara magjupi. E them këtë se, dita – ditës po na vdesin “patritotët” e vonuar e nuk ka hoxhë me çallmë turku në kokë, e as njeri t'i shti në varr xhenazet e tyre partiake. Për marre të Zotit na mbetën mbi tokë. Hoxhallarët për shërbimin e tyre të varrimit kërkojnë lekë, varrtarët poashtu pagën e tyre të përditshme. Edhe, më kujtohet një rast që ka ndodhur gjatë

një varrimi: hoxhallarët kur janë zënë në mes vete se cili do t'ia këndojë mbi kokë të vdekurit “tallkinin”. Cili më i pari t'i rrëmbej paratë e ceromonisë së varrimit. Në mes të varreve janë zënë edhe me grushta shërbetorët e Allahut. Mezi i ka ndarë xhemati. Për pak ta lënë kufomën mbi tokë, pa e futur në varr.

Xhenazet e “parriotëve” të vonuar po na mbesin mbi varre. Edhe atë, në këtë kohë vere, përpara këmbëve të Urës Gurit, brigjeve të Vardarit. Në këtë vapë të madhe, kur dielli djeg si saç mbi kokë. Nën këmbët e kuajve me shalë të Goce Dellçevit dhe Nikolla Karevit. Kryqave të misionarëve fetar grek dhe Mitropolitit të Beogradit. Luanëve roje mbi urë, rrzë Kalasë me kokën në Qeveri e bishtin në Bit – Pazar. Edhe, kanë filluar të krimben, qelben. Era u vjen nëntë sahat larg. Përmëkeq, edhe kalben mbi dhe, pas vdekjes. Nuk i shihni: politikë teknefese, skandali në arsim me tekstet shkollore shtatë vjet me radhë jeton nëpër shkollat tona, merr lirisht frymë mbi banka përpara nxënësve. Edhe atë: me ministra e zv. ministra shqiptar të arsimit, universitete shtetëror e privat, akademikë, profesorë universitar, “ekspertë të arsimit”, që partitë politike shqiptare i kanë strehuar në Ministrinë e Arsimit e Shkencës (MASH), Byroja për Zhvillim e Arsimit (BZHA), me dy Lidhje të arsimitarëve shqiptar, me dy-tre Union-forume të “intelektualëve” shqiptar... Shtatë vjet pas me vonesë t'i shohin tekstet shkollore plot mangësi profesionale. Vallë, thua gjatë këtyre viteve nuk i

kanë pasur nëpër duar, apo nuk kanë punuar me to fare me nxënësit nëpër shkolla.

Heshtja e partive politike shqiptare me ministra, zv. Minsitra shqiptar, drejtorë, zv. drejtorë në Byroja për Zhvillim e Arsim e këshilltarë në Ministrinë e Arsimit e Shkencës, është për t'u vajtuar me gra Zajazi. Shkaku: shqiptarëve nëpër këto tekste shkollore u shtrembërohet dhe falsifikohet historia, paraqiten si cuba dhe ardhacakë me prejardhje të përzier sllave, çerkeze, turke, a rome. “Shoqëria” për klasat e pesta: me portretizimin e profetit Muhamd në mes të Shkupit “mysliman” me më shumë xhami se shkolla, me llogaritjen e Kosovës si “krahinë autonome e Serbisë”.

Përçudi, përmbajtja skandaloze e librave politizohet me shtatë vjet vonesë pa vetëkritikë të “profesionistëve” shqiptarë. Gjeografia e R. së Maqedonisë për vitin e dytë gjimnaz është i botuar që herët, edhe atë në vitin 2003, nga shtëpia botuese “Prosvetno Dello” - Shkup, grupë autorësh të gjithë maqedonas. E kanë përkthyer shqiptarët, e kanë lekturuar “profesionistët” me diploma universitare e tituj shkencor. Vite me radhë ky libër vazhdon të ribotohet dhe servohet për mësim jo vetëm në paralelet maqedonase, por edhe në ato shqiptare.

Skandali i teksteve shkollore në arsim, përveç defekteve të rëndomta në sistemin arsimor, po nxjerrin në sipërfaqe edhe neglizhencën e mësimdhënësve, nxënësvë, prindërve dhe sidomos studiusve të fushave përkatëse në arsim. Dhe, është pasqyra më e mirë

për ta parë veten partitë politike shqiptare duke punësuar me pakicë e shumicë partizanë të tyre gjysëmanalfabetë nëpër këto institucione me diploma e tituj universitar. Ndoshta, edhe e shohin si të arsyeshme, nuk kanë kohë të merren me këto theshetheme të “vëllezërve”, kur kanë punë edhe më të mëdha patriotike, turren pas diplomave universitare dhe titujve shkencor. Vendeve të punës me të cilat i shpërblen Nëna Parti si partizanë të “demokracisë”. E pyes veten: për çka na duhen gjithë këta universitete të politizuar deri në palcë edhe nëpër katunde, kur ne nuk kemi shkolla fillore. Planprograme shkollore në gjuhën shqipe. Tekste shkollore. Lektyra shkollore. Aty për aty edhe i përgjigjem vetes: për të prodhuar me pakicë e shumicë diploma universiteti me vula partiake. Trusakatë. Tituj politiko-shkencor, për t’i mbushur këto fabrika neokomuniste me kunguj Stambolli.

Habia: Heshtja e mësimdhënësve shqiptar të gjeografisë, të cilët kanë punuar, apo nuk kanë punuar gjithë këtë kohë me këta libra!? Ose, u del gjumi arushës pas shtatë vjetëve vonesë pa vetëkritikë. Kohë kjo, me këshilltarë të ministrave të arsimit. Përmëkeq, teksti shkollor ribotohet disa herë, edhe kur ministri i arsimit dhe shkencës ishte shqiptar, alamet patrioti me bagazh partiak.

Vazhdimi: Fajet i ka kryetari i BDI – së, Ali Ahmeti. Menduh Thaçi, i PDSH –së. Imer Selmani i DR, i cili gjatë muajit të Ramazanit merret me aktivitetet e hoxhallarëve: e shtron iftarin nën qiell të hapur. I gjithë faji, përpiqet të hudhet tek një person, parti politike në pushtet.

Po, të tjerët shqiptarë “patriotë”?! Kryesia e partisë politike, ministrat, zv. Ministrat, deputetët, këshilltarët në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës... Populli e ka thënë moti: Trimi i mirë me shumë shokë. E, a kanë shokë trimat tanë të sotshëm të partive politike shqiptare?! Jo. Fatkeqësisht, vite me radhë janë të rrethuar me trusakatë, gjysëmanalfabetë dhe hajdutë qeveritar duke shëtitur parti më parti, si kurva burrë më burrë në Shtëpinë publike.

Qëllimi ynë historik, nuk arrihet me këtë bërlllok shqiptar, që na e ka zënë me vite frymën. E kanë ngushtuar rrethin e tyre partiak me familjarë, miq interesi të biznesit e këlyshë me zgjebe, që moti e kanë shitur veten një torbë taxhi, ose një asht. Përditë i sheh se si “vuajnë” për popullin me makina luksoze, libreza kursimi nëpër banka jashtë vendit e shtëpi moderne në disa kate. Populli i shkretë, përsëri pas katër vjetëve ua jep votën haramëve, që janë duke e shti për së gjalli me gjithë lecka në varr.

Fajtorë: përsëri kryetari që zbriti nga mali, partia politike në pushtet. Partizanët e partive tjera politike, nuk janë fajtorë. Shkaku se, ata: çdo katër vjet e rrëmbejnë ajkën me bekimin e kryetarit dhe partisë argate. Punemadhe, që janë të paaftë të ulen ballë për ballë me palën tjetër në një tavolinë. Kryesorja, dinë të notojnë nëpër dallgët politike. Edhe, t’ua vënë gjoksin para “problemeve”, kur janë në pyetje postet në Qeveri, emërimet nëpër institucione të Shtetit. Zjarr e flakë vjellin nëpër tubime partiake, Akademi përkujtimore, shënimin e përvjetorëve të

personaliteteve shqiptare, zbulimin e përmendoreve të dëshmorëve të luftës para kamerave televizive.

Edhe unë, çka shkruaj tashti si shkrimtar?! I bie samarit, t'i teket gomarit. Punë që nuk është e imja, po e Ali Ahmetit me shokë. I di Meta, punët e veta. Po, ec e heshtë në këtë vapë të madhe të këmbët e Urës së Gurit, përpara heronjëve bullgarë e Mitropolitit të Beogradit. Shqiptarët, kur janë bërë si dhentë. Ose, si pula kur i vjen veja te bytha, turret të gjej furrikun në kotec, dhe e lëshon në mes lëmës. Gjithë kohën janë në gjumë dhe bëjnë sefa nëpër institucionet e Shtetit. E, kur u lindin problemet: Enciklopedia maqedonase, tekstet shkollore... Një dele kërcen në ujë, dhe gjithë kopeja pas saj njëra pas tjetrës bythekrye në lumë. Në skenë dalin alamet akademikësh, profesorë universitar, analistë politik, gazetarë të “pavarur” e shkrimtarë oborri. Gurë e dru hudhin mbi palën tjetër maqedonase, ato ua kanë fajin. Shoqatat “joqeveritare” edhe ato me kumtesa pas gjumit të arushës ngrejné krye në mjetet e informacionit, fotografohen para kamerave televizive. Mjerranët shohin ëndrra ditën. E gjithë natën, vite me radhë kanë gërhat në gjumë si arusha polare.

Përinatë, edhe këto ditë të nxehta gushti nuk bie shi, dezinfektojë xhenazet e tyre mbi varre, laj nga faqja e Dheut. Në fund, përsëri të dalë një Diell i nxehtë, djeg me gjithë eshtra. Nuk i duhet Natyrës, njerëzimit një pisllek i këtillë, të cilit i vjen era nëntë sahat larg matanë maleve. Qelbet me vite e vite.

Edhe shqiptarëve nuk u duhen këto qelbësira, që nuk gjendet njeri i gjallë t’i fus në varre, hudhë një kaci dhe në gropë. Unë sa për vete, do t’ju hidhja një qerre gjiriz. E kanë merituar këtë nderim varrimi “patriotët” kuqezi. Gjumin do t’ua kisha zgjatur edhe në atë jetë të amshueshme matanë Ferrit. Pse jo, edhe t’i mbuloja me ndonjë flamur partiak. Referate patetike të poetëve të Oborrit mbi kokë. Edhe atë, me shumë kujdes që të mos i përlyej duart me këto coftina, që gjithë jetën na janë ngatërruar nëpër këmbë. E, shi sot pas vdekjes: edhe me xhenaze mes varreve.

Amani, o burra së paku xhenazet e tyre i futni nën tokë! Edhe, i mbuloni mirë me dhe se, ndodhë të na ngriten pasmesnate lugetër nëpër Shtëpi. Rezen e derës të na e luajnë në hale. Kusia të na rrokullisin nëpër dhomë. Natën të na i trembin fëmijët në gjumë.

Dhe, në fund: Xhenazet e këtyre “ekspertëve” të arsimit me libreza partiake, me diploma universiteti e tituj shkencor të blerë në Bullgari e Qafë Thanë, nuk ka hoxhë e as njeri të gjallë mbi tokë t’i shti në varre, janë bërë për t’i vajtuar me gra Zajazi...



DY LUANË DHE DY KUAJ TROJE ME BYTHËTANKSE RUSI

Edhe, çdo gjë e ka fundin e vet një ditë: “vëllazërim - bashkimi”, “bashkëjetesa”, shteti multietnik. Kualicioni i partive politike shqiptare gjithë jetën argatë në Qeveri. Fatkeqsësia është se, shqiptarët këtë e shohin të fundit, pasi u është thyer qerrja në rrugë. Shkurt, nuk jemi parashikues. Politikanë, që e shohim të nesërmen. Ose, siç thotë lideri ynë politik Ali Ahmeti, që zbriti nga mali: jemi të sinqertë në politikë. Popull me besë. E në realitet, në politikë nuk ka sinqeritet e as besë. Politika, është kurvë që i ndërron burrat përnatë. Edhe rrenë, mvaret kush cilin e rrenë më bukur. Në politikë, tjetër thuhet, tjetër mendohet, e tjetër veprohet me palën kundërshtarë. Vetëm shqiptarët siç duket janë të sinqertë dhe kanë besë në politikë. Popujt e tjerë politikën e kanë profesion. E populli thotë: pasi të thyhet qerrja, gjenden plot rrugë për në Katund. Edhe shqiptarët, tashti më në fund gjetën shumë rrugë, po me qerre të thyer mes fushës.

E gëdhinë mëngjesin me “Shkupin 2014” edhe me dy luanë dhe dy kuaj Troje me bythëtankse rusi mbi urën “Goce Dellçev”. Siç duket, pak i kishin heronjt bullgarë me kuaj me shalë e misionarë fetar grek si Mitropolitë Beogradi. Përmëtepër, dy luanët e anës perëndimore me bisht - kokë gjarpëri. E di, çka ka simbolizuar dhe ka dashur t’u japë porosi

skulptori shqiptarëve me në krye ideologun Gruevski, po nuk e di, a e dinë këtë edhe Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi. Për dy “luanët” e tjerë, në anën veriore me bythëtankse rusi, nuk ka nevojë të thuhet asnjë fjalë, janë kuaj Troje në mesin e shqiptarëve. Përrjashtimi, përderisa Kali i Trojës ishte nga druri, këta dy kuaj Troje janë nga bronzi. Fatkeqësia: janë ndërtuar edhe me paratë e shqiptarëve. Gojëkëqinjte, mund të thonë se, këta dy luanë në anën veriore të Shkupit janë: Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi. Mos, o Zot! Unë, nuk e them këtë dezinformatë. Shkaku, se: nuk e di fantazinë e bujshme të skulptorit dhe premierit Gruevski. Vetëm e them: vërtetë janë artistë të kalibrit botëror. E mbushën Maqedoninë me “vepra artistike” të personaliteve antike e bullgare. Punemadhe, që Maqedonia ende nuk ka emër dhe popullatë sllavomaqedonase. Identitet. Nuk ishte e rastit ajo, që e publikuan te Gjeografia: shqiptarët janë: “ardhacakë, cuba me prejardhje maqedonase, turke, çerkeze dhe rome”. Fundi i fundit, nuk duhet marrë për të madhe “vëllezërve”, kështu edhe krijohet kombi më i ri në botë me shtet e pa identitet.

Nuk ishte e rastit, as edhe Enciklopedia maqedonase. Gjuha maqedonase që të mësohet nga klasa e parë fillore. Shqiptarët duhet të merren me diçka, përderisa Qeveria e Gruevskit merret me krijimin e Shtetit, emrit të Maqedonisë, identitetit si komb maqedonas. Edhe, të duket se Gruevski para syve të Evropës luan shah me Ali Ahmetin në një tavolinë të përbashkët, të ashtuquajtur Maqedoni. Menduh Thaçit, moti i


dha mat si “vojvodë” i shqiptarëve. Edhe pse, populli e njeh më së shumti këtë premier si boksier. Kohën e fundit në gjak e ka shahun. Tashti, luan kokë më kokë me Ali Ahmetin. I jep dy luanë, ia merr dy komandantë. Syrin e ka te Kali i Skënderbeut. Shah – mat do t’i japë edhe me dy luanë. Qëllimin e ka te Kali i Skënderbeut, në Bit – Pazar. Përpiqet ta mashtroj, duke i dhënë katër figura shahu - ushtarë. Në fund, i vardiset Mbretëreshës. Vetëm se, jo këtyre Teutave të sotshme kuqezi me rruza e shamia përqafe, po Teutës: Mbretëreshës Ilire.

Dhe, shqiptarët gjatë gjithë këtyre viteve “demokratike” janë marrë me gjuhën shqipe, shkollat, flamurin kuqezi, evidencën pedagogjike, Enciklopedinë maqedonase, tekstet shkollore, lektyrat shkollore... Përfundimisht, me të drejtat kombëtare, që i kishin edhe në kohën e komunizmit, ua dha shoku Tito . Ose, siç di unë të them shpesh nëpër shkrimet e mia: me lugët dhe enët. “Vëllezërit” e rrëmbyen me të dyja duart e këmbët pushtetin, pasurinë e patundshme, Shtëpinë, Shtetin. Edhe shqiptarët, tek tashti pas njëzet vjetëve e shohin se kanë mbetur me gishta në gojë. Qiraxhinj në Shtëpinë e tyre stërgjyshore, të trashëguar brez pas brezi që nga koha Ilire. Treni po u ik mes maleve, u ka mbetur edhe vagoni i fundit. Turren me të katra pas tij arave ta arrinë në kthesë ende pa hyrë në tunel, po kam frikë se edhe ky vagon pa dyer e dritare po na ik nga sytë matanë maleve. Këmbët na turren në vend përmes fushës me ferra.

Treni tjetër, nuk dihet se kur do të vij më këtyre anëve të nemura. Shqiptarët t'i fusë nëpër vagona. Ose, do të vijë një ditë, po nuk do të ketë vagona për udhëtarë të vonuar rrugës. Hije më hije duke bërë gjumë arushe. E shqiptarët, fatkeqësisht duan të voziten në vagonin e fundit për në Baba Tomorr.

Ose: t'u hipin në shpinë këtyre luanëve pa shalë, t'i shalojnë nëpër Bit – Pazar. Nesër, pse jo edhe t'i nxjerrin ne treg, shesin si kuaj Troje. Muzeu i Lirisë nuk është larg, mund edhe t'i ekspozojnë si plaçka luftime. Edhe Instituti i Trashëgimisë Kulturore: “Pjetër Bogdani” i pret dyerhapur për studime shkencore.

Zot, bëre ëndërr këtë që shoh e shkruaj unë Ditën! Dhe, e vjell Natën!... Amen!...



XHADIA

E kam thënë gati gjithë jetën nëpër libra. E përsëris edhe njëherë në këtë shkrim. IRJ e Maqedonisë ka mëkate ndaj shqiptarëve, që nuk i lanë dot as Vardari. Edhe atë: që nga koha “e artë” komuniste. Atëherë, kur ish Jugosllavija këtë Nuse e mbulonte me duvak dhe e nxirrte në mes të Lëmës ta heq vallen. Cucat duke kënduar copë - copë i bënëin dajret. Krushkat sa mundeshin hidhnin sheqerka të larmë mbi koçi. Babai, e nxirrte mauzerrin nga hatullat dhe shkrepse pushkë. Edhe në lëmën tonë më në fund zbriti Nusja me pashterkë të kuqe. Askujt nuk i kishte shkuar mendja se këtë Nuse, pasi ishte thyer rrota e koçisë mes maleve, na e kishin ndërruar komitat. Tjetër Nuse na kishin futur në koçi. I pari e hetoi dhëndrri, natën e martesës kur ia kishte hequr duvakun nga koka në dhomë, përpara se ta rrëzojë në shtrat. Aty për aty, e kapi macën që i hyri nga dera për fyti ta shqyej copë - copë me dorë para syve të Pashterkëkuqes. Nusja, kur e pa buzëqeshi, i tha: është dashur me kohë ta bësh këtë veprim patriotik, mos e merr macën në qafë! Ama, vëllai tjetër e ka bërë këtë vepër trimërie natën e martesës, dhe e dëgjon gruaja edhe sot e kësaj dite. E di, vetëm ti je vonuar në veprime luftarake.

Përmëteper, dhëndrri të nesërmen edhe e bëri problem, tha: nuk është kjo ajo Nusja që e pashë unë në male. U mbëlodhëm e gjithë familja dhe u

përpoqëm që ta pajtojmë, mezi e bindëm: megjithatë, na ka ardhë në shtëpi. Edhe sipas traditës shqiptare nëpër shekuj, jo mikut që troket te porta, po edhe armikut i hapet dera. E bindëm, më në fund dhëndrrin që këtë Nuse ta fus në shtëpi me gjithë rraqe.

Nusja, pasi u arritë marrëveshja familjare kornizë, herët në mëngjes doli në lëmë me fshisë në dorë. E pastroi lëmën fundekrye deri te kasolla. Edhe livadhin, ia largoi hedhurinat e shelgjeve. Erdhi te bunari nën ftua, dhe i mbushi shtambat dhe ibrikët plot me ujë. Ditën e parë të nusërisë, hyri edhe në magje. E gatoi bukën, e ndezi zjarrin në oxhak. Çerepin. Dhe, saçin me shpuzë ia vëndoi përsipri bukës. Herë pas here e zbulonte, hiqte me mashë saçin, mos i digjet buka. E poqi pogaçen. Edhe na e shtroi sofrën.

Përçudi, kjo nuk ndodhi edhe ditën e nesërme. Nusja, filloi të lazdrohet, pispilloset përpara pasqyrës, në mes të ditës ia fuste gjumë. Nuk e dëgjonte burrin, nuk e dëgjonte vjehërrin, nuk e dëgjonte vjehërrën. I dëgjonte gratë e kojshive, llafazane. Gjithë ditën e gjatë nën hijen e lisit midis livadhit pinte çaj rusi dhe tirtë llafe katundi: Filjana ka ikur nga shtëpia. Ajo, tjetra mbrëmë ia hapi derën jaranit. Partia, më në fund e martoi, ia gjeti një burrë me pantollona edhe asaj beqareshe plakë. Vërtetë, i shkojnë për dore punët e shkuesit Nënës Parti nëpër dasma.

Jo, moj motra, ndërhynte ajo tjetra, më azganja. Partia nuk duhet të merret me këto punë, po me politikë madhore. Burra e gra do të gjejnë vetë një ditë, na ka dhënë mjaftë Zoti. Lirisht,

mund të them me bollëk sa, kanë të hanë edhe qentë e rrugëve. Askushi deri më sot nuk ka mbetur e as që do të mbesë pa u martuar, pa gjetur një burrë me brekët mbi pantollona. E lëre më ne “myslimanet” me ferexhe, që i kemi në disponim njerëzit e Allahut, hoxhallarët. Vetëm, një hajmali për qafe, dhe e ke gati burrin, gruan besnike. Fati vjen vetë, si cjapi me zile te kasapi. Vështirë, është sot në këtë kohë të mbahet gruaja ose burri. Shkaku: gruaja ka shpenzime. E ka thënë këtë moti, Xha Cuti i Kërçovës.

Burra me brekët mbi pantollona na ka dhënë mjaftë Zoti. Po, ecni e gjeni një burrë me tirqi e xhamadan kësaj Nuseje xhadi. Kësulë të bardhë në kokë. Sahat me qystek për qafe. Nagant në brez. Jo, nuk ka. Moti vdiqën ata burra mejdani. Dorën në zemër, ata na bënë edhe shtet shqiptar. Përndryshe, po të ishte për ne patriotët e sotshëm, edhe sot e kësaj dite do të ishim nën Turqi. Serbi të Madhe. Burrat e sotëm, përditë marrin nuse me lodra në Qeveri. Fatkeqsësia: nusët e tyre, të nesërmen na dalin kurva. Halli?! Halli, Nusja, do burrë. Mirë, t’ia gjejmë edhe Nuses “me limona” një burrë. Edhe ia kami gjetur disa burra, po problem se Nusja jonë nuk di t’i mbajë burrat. Është xhadi. Ose: Nusja do t’i ndërroj burrat përditë. I ka mbetur shprehi që nga koha e komunizmit. Haptas, i do burrat që në Katund kanë vjedhur pula. Shkaku se: ata burra edhe në kohën e sotme vjedhin edhe në qytet, vetëmse jo më pula, po popullin që nuk ka as edhe brekë në bythë. Tjetër, është ajo se këta partizanë partiak, nëpër institucionet e shtetit “të përbashkët”

vjedhin me të njëjtat metoda të katundit. Ose, siç thonë “intelektualët e sotëm të pavarur” në Universitet me nga dy – tri vende pune, vjedhin me metoda klasike dhe i zënë të nesërmen policia me pelë për dore. Edhe i fotografojnë përpara kamerave televizive.

Nusja ende vazhdon t’i ndërroj burrat. Herë me njërin e herë me tjetrin kurvar. Gjithë jetën e kaloi nëpër duart e burrave. Edhe: ende nuk gjeti një burrë ta fus në magje, t’i përkund djepat. E të mos flasim t’i korrë arat, rrëzë Çukës.

Fatkeqësia: ende jetime. Kopilat natën ua lë shqiptarëve pas dere. Shqiptarët e martojnë këtë Nuse kurvë dhe e bartin derë më derë me koçi. Edhe bëjnë dasma. Shkrepin pushkë. E zbresin për krahu në lëmë me dajre. Valle heqin brez për brezi rreth bunarit. Edhe ujë i japin nga grushtat e një fëmije. E kotë, kur të shohish, të nesërmen me gjithë pajë e ferexhen krahëve, u ka ikë Nusja në kojshi. Edhe në këtë dasëm i ka plaçkitë, i ka gërryer ende pa dalë drita. E ka gjetur një tjetër burrë në kojshi.

Dhe, përfundimi: IRJ e Maqedonisë ecën bythëprapë. Shqiptarët nuk duhet më këtë Nuse xhadi ta fusin në lëmë. Dasëm të bëjnë me shtatë palë lodra. Maleve të shkrepin pushkë si në kohën e Turqisë. Nuk është kjo Nuse që i mjelë lopët, i përvesh duart të hyjë në maxhe, korrë arat me drapër, t’i përkundë djepat me ninulla shqiptare...

Shqiptarët, është koha tjetër Nuse të zbresin nga koçia në Lëmë...

DIZGËMADHJA

E di, më keni mashtruar gjithë jetën. Edhe keni bërë shtet: Shqipëri Etnike. Rrugë keni ndërtuar anë e mbanë Atdheut. I keni hapur gropat “demokratike” edhe me dy – tri lopata beton përpara syve të priftërinjëve dhe hoxhallarëve. Dhe, të nesërmen i keni harruar si përmendore të gjalla në mes të qytetit. Universitete keni hapur edhe nëpër katunde. Shkolla në gjuhën shqipe me çati të rrëzuara në tokë. Edhe atë: vetëm e vetëm për t’ju dhënë diploma fakulteti, tituj shkencor vajzave, djemëve dhe partizanëve partiak të juaj gjysëmanalfabetë. Edhe vende pune, si profesorë Universiteti. Falemnderit. Amani, vetëm mos thuani se nuk keni ndërtuar edhe xhamia me dy e katër minare. Vetëm, në katundin tim i keni përruruar tri - katër xhami. E vetëm një shkollë fillore, edhe ajo e ndërtuar qysh në kohën e komunizmit.

E them këtë se, çdo gjë ka fund një ditë. Vetëm, veprimtaria e juaj politike – “patriotike” në emër të popullit, si duket nuk merr fund. E “bëtë” shtet IRJ të Maqedonisë. Në njërën anë LSDM, në anën tjetër VMRO-DPMNE. E në anën tjetër, partitë politike shqiptare brez pas brezi argate: PPD, PDSH dhe BDI. Fitorja: njëzetë vjet me radhë ky popull ende ecën në vend, nuk e ka bërë përpara asnjë hap. Nuk ka parti politike që na nxjerrë në dritë nga ky bërlllok nëpër kontenjerët e historisë.

Edhe: gjeni rrugë! Unë si plakë kam vetëm një fuqi natyrore, ose siç u pëlqen juve të thoni: Zoti. Përditë u shoh dhe dëgjoj: e hapëm një fabrikë. E përruam një spital. E ndërtuam një xhami. E asfaltuam një rrugë. Edhe fotografoheni përpara kamereve televizive krah për krah me shokë. Kulminacioni, kur dilni në ekranin televiziv dhe shisni mend, dje si analistë politik e sot si ekspertë shtetëror. Alamet burra, të përpunuar nëpër kabinete qeveritare, merrni poza për vlerësimin e veprimeve politike të partive në pushtet. E parashikoni të ardhmen e tyre, ju trusakatët e askushit, që unë nuk ua kisha dhënë të m'i ruani as lopët. E ku më ju t'i prini popullit në këto ditë të vështira për në liri. Ose, siç thotë Fishta i Madh te poema satirike, Gomari i Babatasit:

*Ju rrugaça e sallahana
Vagabonda e shakllabana,
Rriqna t'ndyet, mikrobë të kqi,
Qi të mjerës moj Shqipni
Kthjelltë hi i keni në mushkni,
Pa dhimbë gjakun tuj ia pi,
Po der kur, bre batakçi!
Bre coftina, ka kalbë mbi dhe! –
Der kur ju, tu' u tallë nëpër ne,
Do t'na qelbni fis e atdhe?
Ah! bre ju... nuk dij shka u kjoftë,
Sa tash ma jemi tue u njoftë,
Se kush jini e se shka jini,
Se kah shkoni e se kah vini,
Plang e shpi se kah i kini*

*E sa pare u ban ju gjaku:
Se për ju, po, duhet laku.*

*Ani kush, pra, me i pri kombit
Ju, do pyka bijtë prej llomit
Qi "Shqiptarë" vedit thoni,
Jo pse ju Shqipninë doni.
Jo pse ju ndo'i send kuptoni
Shka asht Atdheu e shka asht Lirija.
Shka asht Vllaznija e Parasija
Përparimi e Qytetnia.
Por, veç pse ende der më sot
Një tyran s'po e gjeni dot.
Nën kambë t'cilit ju me u shtrua,
Se un ma tash jam regjë me jue.
E jau njof shpirtin der m'palc:
Pleh i ndytë, me u bartun m'shkalc
E me u qitë jashta Shqipnije...*

Nuk kam fuqi natyrore e as politike, vetëm e kam një fuqi personale: telekomanduesin e televizorit. Trraaaak! Aty për aty, ua mbyll gojën haramëve. Mjaftë më me demagogji patriotike! Nuk dua fabrika, nuk dua varreza kolektive, nuk dua përmendore me kuaj e më këmbë, nuk dua rrugë, nuk dua xhami, nuk dua kisha... E dini çka dua, bukë! Bukë... E ju vite me radhë më ushqeni me parulla patriotike, që nuk ma mbushin dot barkun e shtrënguar me dizgën e pashterkës.

Në doni të dini pak më tepër për mua: unë i kam dhënë kësaj shoqërie, këtij shteti. Edhe, atë: përveç punës në ara, edhe shtatë djemë. Dy - tre


doktora shkence, edhe puntorë krahu nëpër botë. I pyes publikisht: çka i dhanë kësaj shoqërie, këtij shteti këta politikanë teknefesë?! Dorën në zemër, i kanë dhënë, si nuk i kanë dhënë gjatë këtyre viteve. Erdhën pa brekë në bythë, dhe bëjnë politikë madhore, e gëdhinë mëngjesin me shtëpi personale në disa kate, dy - tri banesa e librezë kursimi nëpër bankat e shtetit e nëpër botë.

Dhe, në fund them: unë jam patriote. Unë Dizgëmadhja, që i kam dhënë këtij shteti edhe pasuri, edhe punë me djersë. Haramët, vetëm i kanë marrë dhe ia marrin me të dyja duart bereqetin. Fatkeqësia: përsëri unë armike e shtetit. Përmëtepër, edhe na shurdhojnë me demagogji. Përrurime të fabrikave. Përmendore mbi e nën Urën e Gurit. Punësime të reja në administratë sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohërit. Arrnimin e rrugëve nëpër katunde. Tekste shkollore falas për nxënësit. Ose, siç thotë populli: fëlterja në zjarr e peshku në lumë.

Mirë, po deri kurë do të zgjasë kjo demagogji patriotike e partive politike shqiptare?! Unë më jam plakë, nuk mund t'i lindi këtij shteti djem e vajza shkolle. E as punëtorë krahu për në kurbet. Edhe vota me thasë nga të katër anët gjatë zgjedhjeve parlamentare. Jetën t'ua zgjas edhe për katër vjet në Qeveri.

Shpëtimi: e kam gjetur si plakë Dizgëmadhe. Edhe pse më ka lënë forca, nuk mund të lëviz nga shtrati, e kam afër telekomanduesin: trraaak. Dhe, ua mbyllë gojën këtyre haramëve të popullit, që përditë pëllasin si gomari i Babatasit në televizor. Herë nëpër foltore, e herë si analistë politik,

ekspertë e kollumnistë patetik nëpër gazeta të
“vëllazërim – bashkimit”...



SHTETI MAFISË

Vendpushimet për frymëzime artistike i kam në tre lokale publike në Shkup. Edhe atë: “Rrapi”, “Miracoli” dhe “Firenca” (ish Parisi). Edhe, si çdo herë e pres “viktimën” letrare të librave të mi të “rrezikshëm”. Protogonisti i dyluftimeve të mia kësaj radhe vjen një “trim shqiptar”. Përhëndetet në gjuhën maqedonase dhe pa më pyetur ulet në tavolinën time duke u prezentuar si një i njohur i para disa vjetëve. Edhe, shtihet se më njeh mirë mua Ujkun plak të këtyre anëve. Vite më parë paska ndejtur me mua në një tavolinë. I përgjigjem: nuk më kujtohet dhe nuk besoj se njihemi që më parë si miq të vjetër. Jo, ngul këmbë, njihemi që në kohën e paraluftës së 2001 – shit, kur kam punuar në Itali. E porositë pijen: një ujë gline. Më vonë edhe më pyet se ku punoj, në cilën “organizatë”. I përgjigjem: po, ti pasi u ule pa më pyetur mua a është e lirë karrikja në tavolinën time, patjetër duhet edhe ta dish se ku punoj unë, me çka merrem gjatë kësaj kohe. Jo, po kemi ndejtur me ty edhe më herët si mik. E rrotulloj këtë rradake timen të shkrimtarit se kur kam ndejtur me këtë “mik”, nuk më kujtohet kurrsesi. I përgjigjem: nuk më kujtohet, djalosh. E merr guxin: unë jam shqiptar, më kërcnohet në gjuhën maqedonase. Paratë, ose shpirtin! Shpirtin, i përgjigjem plumb, unë kësaj radhe në gjuhën shqipe. Dhe, folë shqip! Nuk ka kjo rëndësi, që më drejtohesh në gjuhën maqedonase.

Po, çka e ke hallin? E zbutë tonin e bisedës: më duhen para, më drejtohet në gjuhën shqipe. E kam djalin në operacion në spital. Para më duhen për naftë në makinë.

Buzëqesh. Ti së paku paske edhe makinë?! Po, kam, më përgjigjet. Edhe, atë: mercedes. E unë, në do ta dish eci ende më këmbë. Edhe nuk posedoj në pronë timen, pompë benzini. Gabimisht, të kanë orinetuar tek unë eprorët. Para më duhen edhe mua si shkrimtar. E kam një roman timin para vdekjes në shtypshkronjë. Dhe, nuk gjëndet njeri i gjallë t'ia shpëtojë jetën.

Nuk e besoj se nuk ke para, nxirre kuletën! Djalosh, unë kurrë në jetën time nuk kam bartur dhe barti me vete kuletë. Në vend të kuletës barti me vete diçka tjetër në jetë. E kam edhe mikun më besnik. Kurrë deri më sot nuk më ka lënë në baltë. Nëse do, mund të ta nxjerri ta shohësh pak në vend të kuletës, vetëm se kam frikë posa t'ia shohësh sytë do të ikësh me të katra matanë Urës Gurit. Vërtetë, nuk kam para, ama kam karamela nëpër xhepa. Nëse të ka marrë malli, mund të të jap ndonjë për kujtim edhe atë: janë dum-dum karamela. Mos u tremb, fol he “trim shqiptar”! I ruaj për “miq” të sojit tënd në numër me pakicë e shumicë. Jo, nuk i dua ato dhurata, filloi të dridhet “trimi”. Unë kam nevojë për para, edhe atë: kesh në dorë!

Aman, vazhdon mos e ngre zërin, pije birrën! Shkaku se, unë jam budalla. Edhe, një kërcnim tjetër i radhës. Qesh. Pse, unë të dukem i mençur?! E unë, në do ta dish jam budalla edhe më i madh se ti si shqiptar. “Miku” e lëvizi

bythën në karrike. Përsëri, mori guximin të më pyes: E ku banon me shtëpi? Në Çair, i përgjigjem. E ti? Unë banoj në Butel, më përgjigjet me belbëzime. Megjithatë, më interson ku punon?! Unë, i sulem me fjalë edhe një herë flakë më flakë! Po, mu ti u gjete pas tridhjetë vjetëve jetese në Shkup të më pyesish se ku punoj si shkrimtar?! E di, ti pret të të përgjigjem: në Gjermani. Fatkeqësisht për ty, nuk punoj në kurbet. Dhe, pasi ke ngulur aq shumë këmbë, ja po të përgjigjem: unë punoj në polici...


“Miku” i panjohur që më ulet në tavolinë, posa e dëgjon këtë përgjigje, iku nga sytë këmbët pa më thënë as ditën e mirë. Tashti, unë e porosita edhe një birra. Thashë, me vete: edhe kësaj radhe shpëtova nga pyetjet detektive të këtij “budallai” shqiptar. Vetëm për këtë ditë, jo edhe nesër. Shkupi është i mbushur me hajdutë, kriminelë dhe spiunë. Nuk je i sigurtë në rrugë. Edhe në kafene. Shkurt, as në shtëpi. Gjithmonë, gjendet ndonjë “budalla”, që shëtitet lirshëm rrugëve të Shkupit dhe ta pret udhën. Ose, të ulet në tavolinë si “mik” i vjetër. Askush, nuk e di se çka të sjell e nesërmja. Shkupi, gjithnjë vjen e bëhet i pasigurt për intelektualët shqiptar. Rrugaçët i ke në çdo hap pas shpine. Hajdutët në çdo kthesë rruge. Kriminelët, kafene më kafene duke i përcjellur viktimat e ardhshme për t’i plaçkitur në mes të ditës. Edhe atë, para syve të policisë. Ose: kanë vendosur Shkupin ta shpallin Teksas. Mekë të Maqedonisë. Edhe në shekullin XXI përpiqen t’i përzënë intelektualët shqiptar në Turqi. Nuk e di kujt i shkon përshtati kjo pasiguri në këtë shtet

“demokratik”: maqedonasëve apo shqiptarëve. Kush cilin do ta përzë edhe në këtë kohë “demokratike” nga Atdheu. Partitë politike merren me punë biznesi. Nuk kanë kohë të merren me këtë dukuri negative që dita - ditës ia heqin dheun nën këmbë kësaj shoqërie, këtij Shteti të ri në Ballkan. Policia dhe ushtria që duhet t’i dalin zot, shpeshëherë i mbyllin sytë përpara këtyre dukurive negative. Ose, kur janë në pyetje shqiptarët edhe i ndërsejnë këlyshët e tyre me zgjebe duke e fshehur veten pas porte. Përpiqen t’ua fshehin gjurmët këtyre haramëve që e kanë rrokur për fyti shoqërinë shqiptare. E ngulfasin dita-ditës më shumë me presione, vjedhje e vrasje të porositura nga nëntoka kriminele maqedonase - shqiptare.

Në fund, kur vjen ta paguaj kamarieri dëmin, nuk e fut në llogari edhe ujin mineral të “mikut”. Veprim ky, që më shtyn të dyshoj se ky bërlllok i shtetit më të ri në Evropë, bashkëpunon edhe me kamarierët. E gjithë shoqëria kontrollohet nga kjo mafi shtetërore. Nuk të merr në mbrojtje as policia si banorë i këtij shteti. Vaj halli për ty, edhe nëse nuk je vetë i zoti ta mbrosh veten nga këta haramë, që përditë ta presin rrugën me lloj – lloj metodash primitive të njohura që nga koha e Turqisë. I them: në këtë tavolinë e kemi edhe një borxhë: pijen e “mysafirrit” të panjohur. E di, më përgjigjet, pse nuk më thirre ta përzë nga lokali. Jo, i përgjigjem, nuk pati nevojë. E përzura unë nga tavolina vetëm me një përgjigje “intelektuale”. Vërtetë, në këtë shtet

“demokratik” nuk e kemi forcën fizike, po e kemi trurin në kokë...

Dhe, bindem me atë thënie që qarkullon gojë më gojë ende në popull: Maqedonia është i vetmi vend në botë, ku Mafia ka shtet...



BLERËSI “PRODHIMEVE BUJQËSORE”

Shqiptarët brez pas brezi kanë qenë profesionistë: në përdorimin e armës, të penës, në bujqësi, në blegtori, në shkencë dhe në politikë. Shqiptarët, kur kanë pasur Universitet, të tjerët i kanë besuar dhe i janë lutur Lopës si Zot. Edhe: del në shekullin e XXI Blerësi që blen “prodhime bujqësore” me afate të skaduara: kunguj Stambolli, patate, specia, patlixhana... Edhe atë, i blen shumë lirë: 24 rroga mesatare me para të shtetit duke i përdhosur personalitetet kombëtare shqiptare. E blen Patriotin e Vonuar, e blen Këlyshin me zgjebe, e blen Këlyshmelez Sharrin, e blen Këlyshin e Llagut, e blen Halldupin, e i blen djemtë e shokut Tito... Fatkeqësia, i blen me paratë e shqiptarëve në emër të shtetit, që mezi i arnojnë ditët e nesërme.

Shqiptarët më nuk merren me kunguj Stambolli. Shalqi dhe pjepëra. Prodhime, që i kanë kultivuar që në kohën Ilire. Tashti, merren me prodhime të tjera bujqësore: shartimin e këtyre dardhave gorricë të egra, që na kanë mbi në Kopsht përpara Shtëpisë.

Edhe në këtë lëmi janë treguar profesionistë. Nëse nuk besoni, kur të doni ecni në vendlindjen e Xha Derallës: Jasakët e Tikeve. Vendin, ku ky burrë i ka shartuar dardhat gorricë. I ka shndërruar në mriza të Zanave të Fishtës. Dhe, do të bindeni se ata burra i kanë dalur zot bujqësisë, blegtorisë, pemtarisë. Shkurt: Natyrës.

Vetëmse, kohët e sotshme ende janë me mjegulla të arnuara që enden si kope të deleve të nënkryeme nëpër qiell. Dielli më kot përpiqet të zbres më këmbë nga Çelvjollca. Mjegullat ia kanë zënë rrugën. Sytë ia lidhin me shami. Blerësi “prodhimeve bujqësore” i ka vënë pusi Diellit: me kunguj Stambolli. Edhe atë, rrëfangat i kanë nxjerrë nga brezi për mejdani si topuzë turku.

Kungujt e Stambollit përditë na lulëzojnë në Kopsht. Edhe arave. Barkun e kanë nxjerrë cullak karshi qiellit dhe rreziten në Diell. I kemi me pakicë e shumicë, sa që kanë të hanë edhe lopët e shtetit. Vetëm, përçudi këta kunguj Stambolli kanë edhe rrëfanga. Edhe atë, rrëfanga si cungje shelgu që u mbesin lopëve në fyt. I ngulfasin lopët e shkreta në Kopsht, në mes të arës. Më kot bujku përpiqet t’ua heq nga fyti këto rrëfanga, kur ato më ua kanë zënë frymën. I kanë bërë t’i ngrejne të katër këmbët përpjetë në hava. Kasapi i shpëton këto lopë shterpa. Kasapi. Edhe atë, pasi tua vë thikën në qafë. E pasi t’u ketë dalë shpirti t’i varë në një degë shelgu, rjepë lëkurën për opinga. Mishin, dihet ta bëj pastërma për dimër. E dini ju, sa e shijshme është grosha kur piqet në vorbë pranë oxhakut me një copë pastërma në dimër?! Jo, nuk e dini. Nuk e dini ju, edhe përgjigjen e Xha Derallës, kur ka dhënë provime në medrese për t’u bërë hoxhë katundi. Komisoni i hoxhallarëve, kur e pyet se me çka hahet buka? Plaku u prgjigjet plot krenari: me groshë. E ata të befasuar me përgjigjen e plakut, ia presin: pak më mirë, edhe pak më mirë. Edhe dy – tri fjalë duhet shtuar kësaj fjalie përpara bukës. Eh, do të ishte

më e mirë sikur të kishte edhe një copë mishi, u përgjigjet plaku.

Komisioni, kur shohin se plaku është larg me përgjigje, vazhdojnë me pyetjen e dytë: Mirë, pasi nuk ia qëlllove pyetjes së parë, vazhdojmë me pyetjen e dytë: sa sharte i ka Islami? Plaku, pasi u thellua në mendime, i shkundi krahët dhe i vuri gishtin kokës, plot krenari u përgjigj: Njëqind. Njëri, që ishte edhe ai në provim për hoxhë, i përshpëriti ngadal plakut: thuaj pesë! Xha Deralla iu përgjigj plot zemrim shokut: Ky turku nuk pajtohet me njëqind, e do të pajtohet me pesë. Dhe, ja kështu Xha Deralla mbeti pa u bë hoxhë katundi në kohën e Turqisë.

Në oborrin e medreses, kur dolën jashtë i tha shoku Xha Derallës: a vërtetë nuk e dije se duhet thënë para buke: “Bismil lahi Rrahmani Rrahim”, apo luajte gogëla me komisionin e hoxhallarëve të turkut?! Xha Deralla, qeshi me ironi. E dija, si nuk e dija, po desha pak të tallem me kungujt e Stambollit, që rrisin barkun sa një lodër edhe arave tona, rrëzë Çukës.

E di, ju do të thoni një hoxhë më pak si lexues i këtij shkrimi. Po, nuk është këtu qëllimi, më mirë një hoxhë shqiptar si Xha Deralla se sa njëqind hoxhallarë turku. Edhe puna e këtij Blerësit të “prodhimeve bujqësore” është si puna e hoxhës turkut. Vetëm se, puna e këtij Kasapi kulturor dallon për nga strategjia. Sistem pas sistemi zvarritet edhe në kohën e sotshme “demokratike”. Edhe nëpër bar fshihet komunisti plak, ndonjëherë edhe duke ndrruar ngjyrën, merr parjen e ambientit ku e struk kokën. E veshë

setren e partive politike. Gjatë shënimit të përvjetorëve të personaliteteve kombëtare, fotografohet para kamerave televizive krah për krah në rendin e parë me prijësit e partive politike në pushtet. Edhe ferrave fshihet ky zvarritës helmues i “prodhimeve bujqësore” neokomuniste të “vëllazërim-bashkimit”.

Shpeshherë del edhe në pazar, me paratë e popullit në emër të Shtetit i blen “prodhimet bujqësore” me firma komuniste në ballë për njetekatër rroga mesatare mujore. E “prodhimet bujqësore” teknefese, që u ka kaluar afati i përdorimit se, janë kalbur nëpër arat e Kooperativave Neokomuniste, kënaqen dhe janë të lumtur me humanitetin e këtij Blerësi që edhe në kohën e sotshme “demokratike” i ngarkon në qerre këta kunguj Stambolli për t’i shpie në Evropë si prodhime bujqësore shqiptare ...



RRIQRAT POLITIKE

Vite me radhë i kanë ushqyer “vëllezërit” në shoqëritë tona “demokratike”. Edhe në komunizëm. Edhe në “demokraci”. Tekefundit, në komunizëm u kishte hije si “prodhime melezësh”, ashtu siç kishin dëshirë ta thirrnin veten nëpër institucionet e shtetit dhe vendosnin në emër të popullit shqiptar si “artistë profesionistë”. Prandaj, edhe nga ky soj edhe sot e kësaj dite nuk mund të lëvizim këmbën në rrugë si shqiptarë.

Rriqrat politike, që e mbytën shoqërinë shqiptare, në emër të shqiptarëve dhe shtetit “demokratik”: uzurpojnë poste partiake, fondacione botërore në emër të shqiptarëve. Dhe, vite me radhë punojnë për t’i përçarë shqiptarët edhe për një torbë taxhi. E kanë bërë këtë si misionarë partiak në Zvicër. E kanë bërë këtë në Gjermani. E kanë bërë këtë edhe në Amerikë. E bëjnë këtë edhe sot e kësaj dite edhe në radhët tona, në vendlindje. Mendojnë se, nuk i dimë?! E kanë gabim. I dimë me emra e mbiemra. Vetëm, kemi pritur se një ditë do t’u mbushet barku, fryhet syri. Kohën e fundit, siç duket po na humb durimi. Patjetër, nëse nuk e ndalin hapin duhet të dalim me emra dhe mbiemra. Haramëve të Allahut, tua mbyllim gojën se, na morrën në qafë si shoqëri shqiptare.

Ëndërr e tyre është, si t’i shohin shqiptarët me dy-tri shoqata joqeveritare paralele. Edhe atë:

në letër. Po, kurrë melezët nuk shkruajtën asnjë fjalë për këto shoqata joqeveritare, problemet me të cilat ballafaqohen për çdo ditë. Veprimtarinë e tyre, para të cilave këta rriqra neokomuniste i mbyllin sytë.

Shkaku: janë rriqra politike. “Vëllazërit” ua kanë hedhur një torbë taxhi. E kanë përqafe vite me radhë. Nuk i shihni, nëpër gazetën e “vëllazërim – bashkimit” plot reklama me “bagëti dhe bujqësi”?! Asnjë fjalë për arsimin, kulturën shqiptare, librin. Nuk kanë edhe faqe të arsimit dhe kulturës. Jo, do të thoni ju, kanë të fesë islame. Pajtohem. Aktivitetet politiko- kulturore formale po na e zënë frymën?! Edhe atë: se si e gjallërojnë Çarshinë e Vjetër në Shkup: me pesë ezane turko- arabe në ditë përmes altoparlantëve nga minaret e xhamive dhe çallgitë sllave dhe ringjalljen e haremeve të turkut. Asgjë shqiptare. Rriqrat politike, që më së shumti ia kanë vënë këmbën në fyt kësaj Çarshie të Vjetër shqiptare. Përmëtepër, duan ta bëjnë edhe manifestime kulturore multietnike me kryqa e xhami turko- arabe. Këmbekokë shkelin mbi ligjet e Natyrës. E sa dimë ne me një propogandë të këtillë plotë trumbetime kulturore të “vëllazërim – bashkimit” dështoi komunizmi, e ku më këta trusakatë që me veprimet e tyre “artistike” janë shumë larg aftësive “artistike” të komunizmit. “Demokracia” artistike krah për krah me rriqrat politike shqiptare, që e propagandojnë këtë “kulturë multietnike” këta melezë partiak, ka cofë që në bark të Kalit Trojës dhe ka lind si pjellë kopile para kohe. Nuk ka mjek në botë që e lind kopilin

dhe e shpëton Nënë e tyre Njerkë. Zoti, ose thoni si të doni ju, Natyra i ka marrë më në fund me kohë të gjitha punët në dorë. Rriqrat politike, e nxjerrin llapën dypëllëmbë në gazetatat e tyre të “vëllazërim-bashkimit” me parullat neokomuniste: kemi shumë Shqipëri. Edhe, këta “burra” me brekët mbi pantollona, qenkan vetëm për një Shqipëri.

Natë e ditë pëllasin në gazetatat e “vëllazërim-bashkimit” të melezëve. E në anën tjetër. Vetëm hapni gazetatat e tyre, edhe do të shihni: asgjë për arsimin e kulturën shqiptare. Problemet shekullore me të cilat merret kjo popullatë në trojet e veta etnike. Rriqrat politike merren, si nuk merren: me përçarjen e shqiptarëve. Edhe atë: e shesin veten një ashtë, ose një torbë taxhi. Sipas këtyre hadumëve, shqiptarët duhet t’i kenë dy-tri Shoqata të arsimatrëve në letër, dy-tri Shoqata joqeveritare të historianëve, dy tri Shoqata të shkrimtarëve. Dy-tri Unione të intelektuave... E plot tekste shkollore sakate. Enciklopedi maqedonase teknefese. Ose: kurrë të mos shkruajnë për problemet me të cilat ballafqaohen këto shoqata joqeveritare shqiptare.

Rriqrat politike, me një sulm të këtillë duhet të përurojnë edhe “aktivitete” kulturore në Çarshinë e Vjetër, marrin taxhinë e premtuar një torbë për qafe. Fotoqafohen me aktivistët partiak krah për krah. Ose: legjitimojnë kryqat dhe luanët përpara xhamisë turko-arabe. Edhe atë: në këtë kohë kur ky popull nuk ka nevojë për cirkun e tyre “artistik” në rrugë, të zhveshur nga vlerat e arrira artistike botërore, por për bukën e gojës.

Punemadhe, që Patrioti i vonuar dhe Hoxha “qafir” i shpallur nga kryetari i BFI, kohën e ringjalljes së Çarshisë së vjetër e përcjellin bashkë me mua, matanë në tavolinën tjetër në kafene ballë për ballë me Shejtanin e Allahut. I lumtur është kamarieri, që ka myshteri. Kultura shqiptare, hë për hë me këta trusakatë duhet t’i laj duart në “Sofrën shqiptare”. E di, ju do të thoni: duhet të marrë “abdes”. Edhe këtë formalitet në vend timin e kanë kryer Patrioti i vonuar dhe Hoxha “qafir”, që rrinë kokë më kokë me shokë, matanë tavolinës. Problemi është: kush do të marrë “abdes” për arsimin dhe kulturën shqiptare. Atypari kaloi një “intelektual” i Unionit të viçave. E pata edhe një “intelektual” në tavolinë të atij soji të viçave të palëpi. Edhe ai, pasi e piu kafen iku dhe u përshendet me këta “burra” mejdani në një tjetër tavolinë. Këmbën edhe ky ia vuri arsimit dhe kulturës shqiptare. Haram, i qoftë buka! Halli?! Eh, e ka thënë moti populli shqiptar: Halla, do burrë.

Vetëm, amani mos më thoni se edhe këta “intelektualë” me brekët mbi pantollona duan burra! Edhe se, mos Zot më keq: janë kurva politike. Shkaku se: bythekrye mendimet do të m’i hudhni në përrua. E them këtë se, më ka ardhë te hunda: Rriqrat politike të këtij soji këmbën na e kanë vënë si dje edhe sot në fyt. Kurrë nuk kanë shkruar për një libër, aktivitet kulturor. Problem të shqiptarëve. Gjithë jetën janë marrë me theshetheme. Përçarjen e shqiptarëve.

Punemadhe, që këto shoqëri joqevritare nuk kanë asnjë të punësuar, nuk kanë lokale, nuk kanë

asnjëfarë buxheti shtetëror. Rriqrat politike nuk e kanë këtë problem. E kanë atë problemin tjetër: si të arrijnë t'i përfaqojnë shqiptarët. Edhe ia arrijnë qëllimit: me rrogatët e tyre që nuk dinë t'i bëjnë bashkë dy fjalë edhe nën kontrollin e tyre policor, publikojnë shkrime në gazetatat e tyre të “vëllazërim – bashkimit”.

Vallë, ende nuk i shihni Rriqrat politike?! Punën e tyre “patriotike” për shqiptarët duke thithur me ndihmën e Shtetit gjithë fondacionet botërore në emër të popullit shqiptar?! Ose: Shtetit multietnik. Arsimit dhe kulturës multietnike.

Veten e paçit në qafë!...



HALLDUPI

E vërtetë, jam rritur qafë për qafe me Qenin e Shtëpisë. Edhe me macjen, në Katund. Dorën në zemër, ishin kafshë besnike. Nateditë e ruanin Shtëpinë. Shkak ky, që edhe kujdeseshin Nëna dhe Babai, e gjithë familja për këto kafshë besnike shtëpiake. E ndanim me to së bashku edhe bukën e gojës. Vetëmse, këto kafshë asaj kohe kurrë nuk e tradhtonin Shtëpinë. E ruanin nga hajdutët, e ruanin nga Ujku, e ruanin nga minjt që në atë kohë na hiqnin valle gjithë natën nëpër Shtëpi. Prandaj, edhe jetonin bashkë me ne nën një çati si një familje e madhe.

Edhe, çuditë sot me Qenin Plak të Hoxhës me dy dhëmbë të kalbur në gojë: Natën leh në Iriq. Përmëkeq, edhe nuk i del zot Shtëpisë. Ndërsehet pas shpine sa herë që Hoxha ia bënë me gisht. Edhe atë pas miqëve. Armiqëve krah më krah ua hap portën. E kuptoj, Hoxha ia fluk nga një copë buke pas dere. Po, nuk e kuptoj se si ky Qen Plak i Hoxhës me dy dhëmbë në gojë, merr guximin të ndërsehet pas Ujkut të maleve. Edhe atë, tinës pas shpine nga pusia. E kishte ndjekur Ujkun e maleve ky Qen besnik i Hoxhës deri te autobusi urban, në stacion rrëzë Kalasë. Ujku, tek tashti e pa zgjebanin që edhe ai priste në stacion autobusin. I hodhi një vështrim të egër duke ia bërë me dije se të pashë, po nuk e kam mendjen të përshëndetem me ty si qen me zgjebe. Shkaku se: ne jemi fis ujqërish, vijmë nga malet

dhe nuk trembemi nga ndjekjet dhe lehjet e sojit të juaj pas shpine. E di, se jeni fis i yni nga gjaku, jeni “vëllezërit” tanë, po fatkeqësisht jeni melezë. Një Zot e di se me kë jeni kryqzuar pas ndonjë mullari me bar.

Dhe, nuk ia vuri veshin Qenit Plak të Hoxhës. Autobusi erdhi dhe hipi si të gjithë udhëtarët që prisnin në peron. U stacionua pranë disa grave, pasi nuk kishte vend të lirë për t’u ulur në karrike. Në ndërkohë, më këmbë edhe e shfletoi gazetën e “pavarur të vëllazërim – bashkimit”, në të cilën Hoxha shkruante kolumne politike: “U bë Shkupi Kaçanik!” Qesharake, ë?! Shkupi me gjithë këta heronj bullgarë, misionarë grek, luanë, kisha ortodokse, xhami e hoxhallarë në minare, kurrë nuk mund të bëhet Kaçanik. Shkaku, se: Kaçaniku është Kaçanik si te ajo kënga popullore shqiptare: ku, në një luftë flakë më flakë me pushtuesit osmanë, është derdhur gjaku deri në gju, sa që është mbytyr edhe kali. Nëntë sahat është therë me thika. E ka nemur turku: ***“Kaçanikut i raftë pika/ Që nuk di se çka asht frika/ Nantë sahat u ther me thika...”*** E në atë luftë dihet, nuk ka luftuar vetëm Kaçaniku, por e gjithë shqiptaria. Edhe: ku është ajo e mirë që Shkupi të bëhet Kaçanik. Hoxha nuk e ka gajlen e Shkupit, po gajlen e Kaçanikut shqiptar, që ia rrezikon thirrjen e ezanit në minare. Nëma e shqiptarit për Atdhe, është edhe më e rëndë se e turkut. Hoxhën me çallmë turku në kokë e ka mbuluar harami.

Papritmas, dikushi foli me zë të lartë pas shpine që ta dëgjojnë edhe udhëtarët: Marre duhet të të vij që më ke sharë në gazetë! Ujku plak e shikoi duke buzqeshur mjeranin trim me dimija turku. Asganin, që para pak kohe në stacion nuk e kishte atë guxim, e shi tashti pasi hipi në autobus i erdhi fuqia si te ato këngët kreshnike, kur Mujit e Hilit u japin gji Zanat e maleve, fuqi për luftë. Vetëmse, këtij “kreshniku” të Bit – Pazarit, tashti kush i dha tambël, me siguri jo Zanat e maleve po ndonjë ferexhezezë Anadulli. E ngriti bishtin mbi shpinë duke u shkundur mes grave. Qenisht filloi të leh mes udhëtarëve me zë të lartë halldupi.

Ujku Plak edhe një herë e shikoi egër këtë “vëlla” gjaku, po përsëri iu dhimbtë mjerani me zgjebe. Tha, me vete: sa trim duket mes udhëtarëve në autobus, kur e di se nuk do ta bëj copë – copë me gjithë tesha arnë mbi arnë. E sa i mjerë ishte në stacion, kur e priste autobusin me bishtin nën këmbë. E merre me mend se, si mund të duket ky Qen Plak besnik i Hoxhës në rrugë?! Ose, mes livadheve me një asht në gojë. E të mos flasim për në male, me siguri do t’i shpëtonte në brekë. E shkundi me habi kokën. I tha: dëgjo ti Qeni Plak besnik i Hoxhës, jemi në autobus se, po të ishim në tjetër vend, ndryshe me ty do t’i qëronim hesapet. Prandaj, të them ikë matanë, mos të të shqej me gjithë arna edhe këtu mes udhëtarëve! Unë vërtetë jam i kulturuar, po edhe kultura ka kufi në disa raste mes Kryeqytetit të Dardanisë. E sidomos, kur Halldupi shqiptar imponon me dhunë rrugë turkoarabe dhe sllave. Asnjëren. Vetëm shqiptare. Edhe: me halldupët,

që e kanë rrokur Shkupin për fyti, ia kanë zënë frymën me “flijime patriotike - kulturore” teknefese, nganjëherë të detyrojnë t’i përzish kësulatat edhe në mes të pazarit.

Halldupi, kur e pa sa është sahati, iku e u struk mes udhëtarëve në fund të autobusit. Dhe, në stacionin tjetër të radhës, zbriti me bishtin nën këmbë. Iku me të katërta me gjithë zgjebe matanë rrugës, drejtë e te Xhamia e Isa Beut...



PËRCJELLJA E NATËS ME POEZI DHE KËNGË DERI NË AGIM

Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, u themelua para trembëdhjetë vjetëve për të freskuar varfërinë e madhe kulturore që mbretëronte asaj kohe në Shkup gjatë muajve të verës. Edhe atë, me një karakter krejtë tjetër nga manifestimet e tjera kulturore që mbaheshin në IRJ të Maqedonisë, të politizuara deri në palcë. Jo rastësisht, e pagëzuan edhe TAKIME NËN RRAP, manifestim i veçantë dhe specifik i poezisë erotike, që do të mbahej për çdo verë nga fundi i gushtit në organizim të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë. Dhe, i zhveshur krejtësisht lakuriq, ashtu siç e ka lindur Nëna nga politika ditore e partive politike, por i veshur me art e vlera të arrira letrare - artistike.

Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, qe manifestimi i parë poetik, që në vitin 1997 në Shkup e zgjoi nga gjumi shekullor Çarshinë e Vjetër, rrzëzë Kalasë dhe i tuboi penat më të njohura nga të gjitha trojet etnike shqiptare, Diaspora dhe bota. Menjëherë, pas luftës së 2001 – shiit qe i vetmi manifestim kulturor që solli në Shkup aq shumë poetë (një autobus me targa TR), që kurrë nuk ka pasur në gjirin e vet ndonjëherë tjetër ky kryeqytet i vjetër i Dardanisë, ku u lexuan poezi erotike dhe patriotike në mesin e

tankeve. Megjithatë, edhe pse manifestimi është i veçantë dhe i vetëm, vite me radhë përballet me vështirësi të mëdha materiale e politike. Shkaku se, individët që merren me politikë te ne në IRJ të Maqedonisë, nuk kanë haber nga arti, e ku më ta duan poezinë. Mos të them, edhe se e luftojnë me të gjitha forcat dhe armët politike. Partive politike në pushtet, u duhen manifestime të politizuara, ku ata të munden të trumbetojnë lirishtë të arriturat e tyre demagogjike në politikë, arsim e kulturë. Fotoqafohen para kamerave dhe në mjetet e shkruara të informacionit gjatë hapjeve të këtyre manifestimeve kulturore si politikanë të “sukseshëm” e dashamirë të arsimit dhe kulturës. Fatkeqësisht, Manifestmi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, nuk ua ka mundësuar këtë reklamë politikanëve, po poetëve dhe njerëzve të kulturës. Ja, edhe arsyeja e vetme, që ky manifestim kulturor tradicional ndërkombëtar, edhe pse sivjet u mbajtë për të trembëdhjetën (XIII) herë me radhë, ende përballet me vështirësi të mëdha materiale e politike që i ngatërrohen me vite nëpër këmbë.

Vështirësitë, problemet dhe presionet e ndryshme ndaj këtij manifestimi kulturor tradicional ndërkombëtar, në vend që të zbuten pas Luftës së 2001 – shit, ato thellohen edhe më tepër, përpiqen ta ngulfasin këtë manifestim kulturor në zemër të Çarshisë së Vjetër, në Shkup. Edhe atë, me veprime trumbetuese për rrethin e vet të trusakatëve partiak, familjar, miqësor e klanor duke trumbetuar manifestime të

improvizuara të “vëllazërim – bashkimit” në Çarshinë e Vjetër, në Shkup.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre vështirësive e presioneve u mbajtën dhe po vazhdojnë të mbahen këto takime për të trembëdhjetën (XIII) herë me radhë. Edhe atë, mu në zemër të Shkupit, Çarshinë e Vjetër, në të cilin edhe kësaj radhe muarrën pjesë poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare: Pano Taçi, Hida Halimi, Fazlli Haliti, Gani Xhafolli, Seida Beganoviq, Perikli Jorgoni, Reshat Sahitaj, Nehas Sopaj, Iliaz Bobaj, Vahit Nasufi, Irena Gjoni, Remzi Salihu, Etleva Tafa, Todor Çallovski, Dashnor Selimi, Bejtush Memeti, Bardhyl Maliqi, Xhelal Tosku, Fadil Curri, Delvina Kërluku, Mustafa Spahiu, Besnik Lena, Kujtime Kica, Rami Kamberi, Mimoza Vasku, Valdet Andoni, Klodiana Kullolli, Petrit Mënaj, Xhelal Ademi, Arben Ibrahimimi, Safet Hyseni, Rrahim Ganiu, Ali Qerimi, Adem Xheladini, Fatos Rushiti, Xheladin Muça, Sheqir Podvorica, Dilaver Asani etj.

Natën e dytë, në restorantin “KALABRIA” nën moton: E përçolla Natën me poezi dhe këngë deri në agim, ku kantautori i mirënjohur nga Kërçova, Ferid Abdiu me zërin e tij karakteristik u bënte konkurrencë poetëve, u ndanë edhe çmimet letrare tradicionale. Juria profesionale në pëprërje të tre anëtarëve: Gani Xhafolli (kryetar), Remzi Salihu (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndau këto çmime letrare: Çmime speciale morën poetët: Iliaz Bobaj, portretin e Lekës Madh të punuar në argjend nga skulptori Ymer Koka, dhe Fazlli Haliti dy shtamba me verë. Për poezi më të

bukur lexuar gjatë dy netëve të takimeve: Etleva Tafa dhe Besnik Lena. Ndërsa, çmimin letrar për vepër erotike, botuar mes dy takimeve: Pano Taçi, i cili njëkohësisht rrëmbeu edhe një pikturë të piktorit Ymer Bajrami, në të cilën shihet Rrapi me poetët nën hije mes Çarshisë Vjetër, në Shkup. Çmimin letrar për vepër jetësore “RRAPI”, kësaj radhe e meritoi Hida Halimi nga Prishtina.

Gjatë kësaj nate u bë edhe përrurimi i numrit më të ri të revistës letrare STILI 97 dhe librave, botime të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar: Thashë është Hënë (poezi) i Rexhep Bajramit, Ëndërr e fshehur (hajku) të Besnik Lena dhe Mbretëria imagjinare (dramë) të Arben Ibrihamit. Nata e arriti kulminacionin me portretin letrar për Pano Taçin, kur për poezinë e këtij autori të veçantë në lirikën shqipe folën krijuesit: Perikli Jorgoni, Bardhyl Maliqi, Petrit Mënaj dhe Fadil Curri.

Vërtetë, Ali Ahmeti me shokë e solli në Shkup Skënderbeun, po ne poetët qemë ata të parët që me vargje i hapëm udhë mes maleve me kalë shale e shpatën në brez. E kaluam në mes të ditës në kufi pa pasaportë. Ne qemë ata të parët që e futëm për oxhaku vargun shqip në Bit – Pazar të Shkupit, që në vitin 1997 nëpër Qafë Thanë e Bllacë, nga të gjitha anët shqiptare. Poetët qenë ata, që me libra kokë më kokë u strehuan nën Rrap me vargje përfaqe në pusi në vend të kollanëve me fishekë. Vargu i tyre nuk ishte vdekjeprues, po jetëdhënës e paqedashës. Varg i dashurisë. Varg që i afronte popujt, e jo të

vazhdojë t'i ndajë ende me kufinj politik. Prandaj, këta "plumba" dum-dumë të poetëve i ulën edhe tytat e tankave të tërbuar gjatë luftës së 2001 -shit, që na kishin rrethuar natën gjatë një manifestimi kulturor: TAKIME NËN RRAP, në Shkup nga të katër anët. Rastin më mirë e di dhe ende e ka të freskët poeti ynë Pano Taçi me poetët e tjerë pjesmarrës në manifestim, kur dy policë si të tërbuar hynë në autobusin me targa TR dhe ia rrëmbyn kamerën nga duart me të cilën e kishte regjistruar mbarëvajtjen e Manifestimit Kulturor Tradicional: TAKIME NËN RRAP. Në atë kohë lufte, poeti ynë i mirënjohur Visar Zhiti, pjesmarrës në ngjarje do të shkruaj dhe botojë në gazetën "Dita" të Shqipërisë edhe reportazhin emocional nga Shkupi: *Të lexosh pozi pranë tankeve.*

Edhe plot pusi e atentate i kaloi ky manifestim kulturor nga mashat shqiptare për të arritur deri te Dita e sotme, nën hije të Rrapit ta lidhë Gjokun krah për krah me Skënderbeun, në Shkup. Edhe, presë Miken me dy shtamba verë, t'u japë gji poetëve që nuk ikin nga Atdheu, fuqi për luftë me penë...

HAPJA E DYERVE TË FANTAZISË

Përditë i shoh haramët se si i përdredhin bythët nëpër Çarshi. Edhe rrinë pas faljes së namazit në pusi me tespi kuqezi në duar. Përcudi, me qindra vjet janë prapa në veprime, unë jam një shekull përpara tyre, që në kohën e Turqisë. Ja, që haramët duhet të cofin një ditë me një asht në gojë pas ndonjë koshi të mbeturinave. E them këtë se, ashti u ka mbetur në fyt. E këta haramë, nuk janë në gjendje t'i fusin gishtat në gojë, ta vjellin as ashtin, e as taxhinë me një torbë përqafe.

Halli?! Është koha të cofin me gjithë asht në fyt në mes të rrugës. Ose, torbën e taxhisë përqafe. Një ditë, pas ndonjë koshi të mbeturinave t'i ngrejnjë të katër këmbët përpjetë nga qielli. Dhe, njëherë e përgjithmonë populli shqiptar të shpëtojë nga pusitë e tyre që ia vënë me vite në rrugë. Samarin e historisë ta hedhë në përrua me gjithë barrën shekullore brez pas brezi.

Dhe, unë dita më ditë kaloj nga pusia në pusi. I hap krahë më krahë dyert e fantazisë.

Edhe: falemnderit Zotit...

Rastësisht, jam ulur në kafene me një mik të studimeve në Prishtinë. Edhe përkras bisedës rreth letërsisë jemi duke pi birrë. Në ndërkohë, mikut i bie zilja e telefonit. E hap, dhe pasi bisedon për disa minuta, ma jep mua aparatën. Urdhëroni! Zëri matanë, kërkon t'i jap një deklaratë për librin. I përgjigjem: o burrë, unë

posa u ktheva nga rruga. Nga gjithë ata shkrimtarë dhe botuesë të librit, më gjete mua “viktimë”. Jo, po kanë dhënë disa deklarata edhe filani, edhe filani. I përmend me emër e mbiemër “burrat” e botës. Fatkeqësi kombëtare, i përgjigjem. Edhe ti gjete, të më shtish mua në një thes me këta armiq të librit: banane, specat të kuq, domate, patate, kunguj Stambolli, dardha të qullta... Jo, po më duheshte një deklaratë për të mbushur programin e mëngjesit të radios. Zotëri, i them: unë posa kam ardhë nga rruga. Dhe, nuk mund t’ju jap asnjëfarë deklarate. U kam dhënë kolegëve të tu disa deklarata përmes telefonit dhe i kanë keqpërdorë të nesërmen. Një kolege e ytja edhe ajo pak më parë për një gazetë të “pavarur të vëllazërim – bashkimit”, kërkonte një deklaratë për Poetekën. E di, si iu përgjigja?! Jo, nuk e di djalosh. Unë përmes jush informohem se mbahet ai manifestim kulturor. Asgjë nuk di më tepër për këtë manifestim poetik. Fundi i fundit, ju gazetarët e kësaj ane më me dëshirë dhe përpikmëri i përcillni ngjarjet kulturore ose botimin e ndonjë libri të ri në Kosovë dhe Shqipëri se sa te ne në Maqedoni. Nuk e di ku është problemi. Ndoshta, fajet i ka interneti. Jo, ti je në komison të manifestimit poetik, më përgjigjet zëri matanë. Qesh, me këto dezinformata sakate që policia letrare i përhapë nëpër qytet. Zonjë, i them: ju siç duket si gazetarë dini edhe më shumë se unë për këtë manifestim kulturor. Nuk jap më deklarata përmes telefonit. Na falni, që ju shqetsuam përgjigjet zëri matanë me keqardhje.

Një javë më vonë, po këto mjete të informacionit lajmërojnë se në manifestimin kulturor Poeteka, që sivjet do të mbahet në Tiranë, marrin pjesë nga Maqedonia edhe këta poetë: Ferid Muhiq që prezanton Bosnjën (???!!!!...) dhe Ali Aliu me Salajdin Salihun nga Maqedonia. Për pak, desh pëlcita nga gazi në kokërr të shpinës. Edhe atë, merreni me mend, nga kurrizi. Më në fund, gazetarët mezi e kishin gjetë anëtarin misterioz të komisionit të Poetekës: Don Kishotin shqiptar me Sanço Panço mbi gomar. Dylqineja e Tobozës i priste në Tiranë. Vetëmse, ku t'u gjejmë mullinj ere në Shqipëri këtyre kalorësve të arratisur, të rroken fytyra në fushën e mejdanit për "flijime artistike".

Të nesërmen, më merr në telefon gruaja: jam me përgjegjësin e emisionit të mëngjesit të Radio Shkupit, ja do të flas diçka me ty rreth programit. E marr telefonin: urdhëroni! Dje kemi ndejtur me ty në "Tivoli", karshi Sheshit Skënderbeu dhe e kemi lënë një takim pune. Qeshem. Prezentohuni, i them bashkëbiseduesit! Mezi e thekson vetëm emrin nëpër dhëmbë. Djalosh, unë e di me cilin kam ndejtur dje në "Tivoli". Dhe, fatkeqësisht me ty nuk kam lënë asnjë takim pune. Hallin, çka e ke më trego bre burrë! Jo, unë nuk kam asnjëfarë halli, më përgjigjet. Atëherë, edhe unë nuk kam asnjë hall që të lë me ty takim pune.

Djalosh, në fund unë së paku e di se me cilët rri në kafene. Dhe, lë takime pune. Tashti, patjetër pas kaq viteve duhet edhe unë ta pyes veten: në cilin shtet jetoj si shkrimtar, në shtetin e të mençurve, apo në shtetin e budallenjëve?!...

Lidhja telefonike papritmas u ndërpre në mes të ditës, sikur e goditi rrufeja. Edhe pse, qielli ishte i kthjellët pa asnjë mjegull. Dielli i kishte hapur sytë mbi qytet. Unë vazhdova me birrën përpara në tavolinë duke pritur provokimin e radhës. Një Zot e di, çka mund të më pyesin nesër. Ose, emërojnë pa dijen time nëpër komisione të ndryshme poetike anë e mbanë Atdheut. Amani, vetëm mos më bëni deputet të popullit! Ndonjë ministër Qeverie. Shkaku, se: nuk u jap rastë, nuk rri vonë rrugëve të errëta pa drita nëpër Bit - Pazar që të më zë në pritë Partia...



DYLUFTIMET E PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE SI PUNA E JORGANIT TË NASTRADIN HOXHËS

Vërtetë, njëzet vjet të merresh me vetëveten gjatë ndryshimeve demokratike, është për librin e Ginisit. Edhe atë, të bësh luftë për pushtet, kur gjatë gjithë kësaj kohe vite me radhë ke qenë argat politik në Qeveri. Përmëtepër, tashti më kur arrihet kulminacioni i tërbimit në skenën politike. Populli thotë: derdhet grosha. Shqiptarët, ende edhe në këtë kohë merren me spiunim. Dosjet si në kohën komuniste, ende ua lënë si kurva kopilat pas dere. Në momentet më të vështira për popullin shqiptar si dikur, për një armë, për një vend pune, për një post në qeveri vazhdojnë ta spiunojnë vëllain edhe më zi se në atë kohë famëkeqe.

E kanë thënë gjermanët gjatë pushtimit të këtyre trojeve etnike: ne për spiunët kemi harxhuar shumë para. E këtu shqiptarët, qenkan spiunë pa para. Dhe, vërtetë: shqiptarët vazhdojnë ta spiunojnë njërin - tjetrin pa para edhe në kohën e sotme “demokratike”. ”Pëllumbat postier” edhe sot si dikur me ndihmën e “vëllezërve” sllav ua flukin “dosjet” pas dere. Të nesërmen, shqiptarët gurë e dru mbi njëri - tjetrin se, ka qenë spiun i shërbimeve sekrete sllave. Po, kujt i hynë kjo sot në punë?! Shqiptarëve me siguri jo, po “vëllezërve” sllav. Shqiptarët këtë dukuri negative të ngulitur në gjak e kanë pagur edhe me

burgje. Jetë. Robëri shekullorë. Sot, nuk duhet gjithaq t'u interesojë e djeshmja, po e sotmja dhe e nesërmja. Shkaku se, i kanë paguar në atë kohë me një çmim të lartë borxhet historike. E me të djeshmen, kush dhe çka ka qenë në atë kohë ferri, patjetër do të merret historia. Prandaj, edhe nuk duhet të bëjnë gara: cili ka qenë dhe është spiuni më imadh. Tashti më, kur është koha, shqiptarët të merren me të sotmen dhe të nesërmën, me punë dhe veprime strategjike për çështjen shqiptare. Gjurmët që kanë lënë pas vetes gjatë këtyre ndryshimeve demokratike. Gjurmë, që nuk i fshi dot asnjë stuhi, nuk i mbulon dot asnjë borë. Me çfarë argumentesh mund ta bind Një politikan popullin shqiptar se, është spiun më i vogël se Tjetri?! Ose, i Treti e i Katërti me shokë?! Fare s'dua të merrem me rastin e fundit, "pëllumbin e vogël postier", që e ka lënë Kaçanikun dhe është shpërngulur në Shkup për të ikur në Turqi, ose për t'u strehuar nga "rreziku" i shqipatrëve me humbjen e pushtetit policor të Rankoviqit në Kosovë. Edhe pse, Kaçaniku ka qenë edhe në atë kohë dhe është Kosovë. E kam thënë disa herë nëpër shkrimet e mia dhe e them prapë se: Shkupi ka qenë stacioni kryesor prej nga janë shpërngulur shqiptarët me dhunë për në Turqi. Poashtu, Shkupi ka qenë edhe jataku i bashkëpunëtorëve të Rankoviqit, kur e humbi pushtetin policor në Kosovë. Shkak ky, që shqiptarët edhe sot, nuk është koha të lejojnë që t'u përsëritet historia. Edhe sot si dje, ta dalldisin veten me veprime përçarëse - vëllavrasëse: Demonstratat e '81-shit ua bënë shqipatrëve

serbët. Edhe Luftën e fundit, të 1999 dhe atë të 2001-shit ua bënë serbët?! Serbët sipas këtyre dumdumëve e paskan ndërmend t'i bëjnë shqiptarët edhe Shqipëri Etnike. Dikushi do të thotë: po, qenkan të mirë këta “vëllezërit” serb të Njerkës, e shihni se duan të na e bëjnë me zor edhe bashkimin kombëtar. Shqipëri Etnike.

Ndoshta, trusakatët nisen edhe nga ky parim: bashkëpunimi me serbët do të na sjellë edhe Shqipëri Etnike. Prandaj, o burra sulm mbi njëri - tjetrin se kush është spiun më i madh! Dhe, të shtien të dyshosh se, shqiptarët gjatë gjithë jetës së tyre kanë qenë vetëm spiunë. Edhe sot si dje, kur pushteti i atëhershëm ia japte shqiptarit armën për ta vra vëllain për një gardh, për një kufi në arë, për një dele. E dalldiste permes hoxhallarëve se ai është mysliman, dhe atdheu i tij është Turqia. Nuk duhet fare të mërzhitet për të nesërmen se, i ka “vëllezërit” serb. Gjithë jetën nën hije në kokërr të shpinës, shqiptarët kanë pritur serbët t'i bëjnë shtet etnik. Edhe, “vëllezërit” kur kanë dashur ua kanë hedhur grepin me një krimb. Shqiptarët, bythekrye turr pas krimbit, dhe përpulitu pastaj si peshku në zall. Në fund, dihet edhe në fëltere për të ngritur dolli me verë “dasmorët” nëpër sallone të Evropës demokratike. Nusen ata të na e hipin në koçi. Pse jo, edhe të na e zbresin me krushka në Lëmë. Copë – copë t'i bëjnë dajret. Shqiptarët janë trima, kanë besë. Dhe, pse të mos u besojnë edhe “vëllezërve” të Njerkës, që Nusen “probatimat” t'ua sjellin në shtëpi me koçi, krushq, këngë, valle e krisma pushke nëpër Katund.

Në tavolinë ndryshon situata, na i fusin gërsërët. Ose, siç thotë populli: na qepin struke. Mëngët na mbesin në Serbi. Arna me të cilën ajo e qep gëzofin nëpër histori në Dimër. Ponemadhe, që shqiptarët me fajin e tyre ende i presin dimrat me struket krahëve pa mangë. Maleve të Sharrit i bien fyellit. E ujku një nga një po ua hanë delet.

Anekdotën e Nastradin Hoxhës me jorganin e dini me siguri. Megjithatë, është mirë edhe një herë t'ua bëj me dije: Nastradini kthehej nga pazari me një jorgan nën sjetull. Rrugës i takoi dy veta, që ishin rrokur fyt për fyti përpara xhamisë. E la jorganin anash dhe u përpoq t'i ndaj belaxhinjtë. Në fund, pasi i ndau e pa se nuk e kishte jorganin. E kuptoi se, e gjithë puna kishte qenë për jorganin e tij, që ia vodhën hajdutët.

Edhe ku ta dish, vërtet serbët mund të na bëjnë një ditë Shqipëri Etnike. Vetëm, unë e kam një brengë: kam frikë se dyluftimet e Partive tona Politike Shqiptare janë, si puna e jorganit të Nastradin Hoxhës...

LAKURIQI I NATËS DHE I DITËS

Katundi e ka një të mirë të përrjetshme: e di Lakuriqin e natës dhe Lakuriqin e ditës. Që të dy janë namqorra. Që të dy shohin vetëm natën. E asnjëri ditën. Fatkeqësia, edhe që të dy përplasen në mes të ditës kokë më kokë mbi urë si ato dy dhitë kryeneqe te ajo përralla popullore në Abetare. Mjerë ti, nëse je nisur në rrugë për në Baba Tomorr dhe takohesh ballë për ballë me këta dy lakuriqë të shekullit. Fitorja: me viktima të pafajshme dhe shkatrrimin e shtetit shqiptar. Dëshmi: 1997 -ta dhe tashti kohën e fundit 2011 -ta. Personazhet, ose si të doni thoni ju heronjtë legjendar, janë të njejtit patriotë kuqezi: Mic Sokola që e rrokin topin për fyti.

E çuditshme, shqiptarët njëzet vite me radhë merren me shkatrrimin e atij gjysmështeti që e krijuan me shumë mund Rilindasit. E çka krijuan lakuriqët e natës dhe të ditës: Kombin kosovar?! Kosovën republikë?! Vëllavrasjen?! Serbët, moti na i kanë dhënë këto të drejta kombëtare. Në atë kohë (komunizëm), nuk i kemi dashur ato dhurata të “vëllazërim – bashkimit”, i kemi refuzuar njëzëri, shkak se: kemi qenë një komb shqiptar. Moti serbët na kanë lutur që ta pranojmë kombin kosovar, e ata të na shpallin republikë nën Jugosllavi, të themi se nuk kemi asgjë të përbashkët me ata matanë kufirit, vëllezërit e Shqipërisë. Dhe, ja e pranua vetë në mënyrë

vullnetare kombin kosovar pas Luftës së fundit të Kosovës (1999), Kosovën e shpallëm republikë. Vallë, a nuk është mjaftë më për shqiptarët! Ende ky popull duhet të përgjaket më shumë nga vetëvetja se sa nga armiqtë shekullor?!...

Faji nuk është te Lakuriqi i natës dhe Lakuriqi i ditës. Po, te populli shqiptar. Patjetër, duhet të vetëdijsohet një ditë ky popull. Nuk ka nevojë i madh e i vogël të dali të protestojë në rrugë, kërkojë liri, japë viktima, shkatërrojë pasurinë e Atdheun që është krijuar me djersë. Përmëkeq, zgjasë jetën për pushtet Lkuriqit të natës dhe Lakuriqit të ditës. E ka vetë në dorë armën vendimprurëse për nesër: zgjedhjet parlamentare. Edhe, e vendos fatin e vet njëherë e përgjithmonë si popull demokratik. Shqipërisë i duhet një gjak i ri t'i qarkullojë nëpër damarë! Fuqi e re demokratike. Gjaku që i qarkullon sot nëpër trup, është gjak komunist.

Edhe pse, rrëzë Kalasë së kaçakëve të Zajazit, ende vonohet Pranvera. Nuk këndojnë zogjtë, nuk fluturojnë dallëndyshet, nuk kanë ardhë lejlekët. E në anën tjetër, Patriotët e vonuar anë e mbanë Atdheut ende nuk zbresin dot nga bina. Sheshi. Pushteti. Rrëzë kalasë, përpara Muzeut të Luftës ende vazhdojnë t'i skuqin sheshet me flamuj kuqezi. Këngë patetike patriotike. E shpalosin programin e tyre zgjedhor përpara zgjedhjeve parlamentare. Radhiten njëri pas tjetrit me kravata kuqezi në rendin e parë, secili më trim se shoku, fotografohen para kamerave televizive, ndizen zjarr... Ndërtojnë rrugë... Fabrika... Ujësjiellësa... Salla sportive...

Varre... E bëjnë Shqypni Etnike... Ndonjëri, shkon edhe më larg: gjatë një fushate parazgjedhore në një katund u tha me plot gojën të pranishmëve në shkollë:

- Ne do t'ju ndërtojmë rrugë evropjane... Ujësjiellës... Xhami me katër minare... Salla sportive... Edhe shkollë moderne...

- Po, ne nuk kemi fëmijë. U dëgjua zëri i një fshatari diku nga fundi i sallës.

- Edhe fëmijë do t'ju bëjmë ne, burrat e Partisë Demokratike...

- Hi - hii - hiii... Qeshën disa të rinj kopila, me flamuj partiak në dorë.

Dhe, vërtetë në qytetin e Kalosh Zajazit - Kaçakut të maleve, çdo katër vite e bënin Shqypni Etnike. Majë plepave nëpër katunde valonte flamuri kuqezi. Jehonin këngët patriotike me çifteli, dajre e lodra:

Vjen Valiu, or pi Manastëiri:

Ju Zajazaz, bre , ku më jini?

N'Karbunëicë, more, pusëi kini!

Sefer Kaçakun ju çauash e kini

Kadri Dangën bylykbash më kini.

More, Sefer, bre, musteçeverdhë

Shkruj një letër, more, ta çojmë n'sher

T'na çojnë xhephane, t'na çojnë fishekë

Se me komita, jalla, liftojmë vetë!

More komit, bre, i bugarit

A i njef trëimat e Zajazit?

T'apin plumjin, jalla, permes ballit!

Mor komita, bre, komita të rëi,

S' kini pa ju, shyptar me sëy,

Ta majnë houtën, jalla, drejt në sëy!

E në realitet, vendlindja e Kaçakut të maleve - Kalosh Zajazit binte e zgjoheshte nga gjumi me Robërinë mbi kokë. Liria nuk e donte këtë vend të ashpër malor. Çerdhe kaçakësh brez pas brezi: Sadin Selmani, Sulltanë Qafa, Sefer Zajazi, Sulë Jetimi, Xha Nefruz Çeliku... Që, nëpër shekuj nuk arriti dot ta bëj zap, ta fusë nën zgjedhë as Mbreti e as Krali. Nëpër shekuj kishte bërë kryngritje, nga një luftë e kishte nisë për çdo vjet, herë me Mbret e herë me Kral.

Xha Nefruz Çeliku fillkat vetë në malet e Garanës, në Çelvjllollcë kishte bërë luftë flakë më fkakë me bullgarin, e kishte vënë vetë me gur kufirin në mes Bullgarisë dhe Shqipërisë. Burri i fuqishëm dhe trim pas fitores duke u kthyer në fshat, rrugës me dorë për fyti e kishte mbytyr edhe një ujk. Sulltanë Qafa, që me gërshërë të dhenëve te shkallët ia vrau tre vetë Mikales së Brodit, për t'i dalë zot pragut të Shtëpisë. Katundit të nemur nga Sulltani e Krali mes atyre maleve me dëborë verë e dimër.

Dhe, sot ne jetojmë ende nëpër dasma, fushata zgjedhore me emrat dhe luftërat e atyre burrave të penës e pushkës. Trimëritë, që ende i mbanim gjallë nëpër këngë, e në të vërtetë ende nuk ua kishim bërë as varret. E të mos flasim ndonjë rrugë, ose shkolle t'ua vënim emrat e tyre. E ku më në mes të katundit ose qytetit t'u ngrisnim edhe përmendore. I thirrnim sa herë që ishim në zor, kur na duheshte vota e popullit, fuqia e tyre për luftë me protesta "demokratike".

Të nesërmen, posa i vendosnim bythët nëpër kolltuqe në Qeveri, nëpër ministri e kabinete, ua harronim edhe emrat.

Përsëri duheshte të kalojnë katër vjet, që ne përsëri t'i ngrejmë nga varret ata burra të penës e pushkës. Ne me këngë e çifteli, e ata me penë e pushkë gjatë fushatave parazgjedhore përpara popullit për ta dalldisur të na i japë votat me propagandë demagogjike. Edhe nëpër libra: O burra, zgjohuni nga varret! Rrokni penën e armët se, na mbytën të gjallët në “demokraci”!...

Në fund, pasi i fitojmë zgjedhjet parlamentare, përsëri ia fusim gjumë dimëror të arushës. Argatë e hyzmeqarë në Qeveri... Lypës te Ura e Gurit mbi Vardar me torbën përqafe...

I presim nën mrize, dardha gorrice zgjedhjet e ardhshme parlamentare...



SKËNDERBEU NESËR SHALON KALIN MATANË URËS GURIT

Dimër i madh në Shkup. Bora nga të katër anët e maleve zbret në qytet. E gjithë natyra duket se ka ngri akull. Permendoreve të “Shkupit 2014” u rrëshqasin këmbët. Edhe kuajve të kalorësve në të dy anët e Vardarit. Luanëve bythët te të dy këmbët e urës si saja. Mjegullat nateditë u rrinë mbi kokë. Përçudi, në këtë acar Skënderbeu ende nuk e ka nxjerrë shpatën nga brezi. Vetëm politikanët në Kuvend, ama ia kanë thënë këngës pranë zjarrit në oxhak. Edhe ndonjë qen rruge nëpër Bit-Pazar me bishtin ndër këmbë dhe kokën në koshin e plehrave.

Skënderbeu, që në sheshin e vet e kishte futur shpatën në brez dhe kënaqej me këtë copë livadh të mbjellur me beton, që mezi ia nxente kalin me shalë, shikimin e kishte hedhur matanë Vardarit. Tamerrmendja, ngushtë e kishte në këtë “brez livadh”, aq sa një vrap kali. E priste të nesërmen ta kalojë Vardarin, ose të hip në Kala. Vendi i tij më i preferuar gjatë luftërave të ndryshme, kishin qenë kalatë. E pse sot, pas kaq shekujsh përsëri të mos jetojë kalave, po ta zbrezin me dhunë pasardhsit e tij nëpër sheshe, ndonjëri edhe në një pëllambë beton. Ose: pse të mos e shalojë kalin matanë Urës së Gurit, në sheshin “Makedonija” krahu për krahu me Aleksandrin e Madh?! “Vëllezërve” tanë u duhen heronj, histori. Atëherë, pse shqiptarët tregohen kaq

shpirtngusht, nuk u dalin në ndihmë “vëllezërve”. Edhe ashtu, janë duke i bërë shtet. E shteti kërkon popull me identitet, histori. I kanë heronjtë e të parëve të tyre, do të thoni ju, në të dy anët e Urës së Gurit: Metropolitët e Beogradit, Shën Kirili dhe Metodi. Matanë Urës Gurit i kanë heronjtë bullgar mbi kuaj: Dame Gruevin dhe Goce Dellçevin. Edhe katër luanë i kanë në të dy anët e urës “Goce Dellçev”, rrëzë Kalasë. E di, po u duken pak “vëllezërve”, nuk u ngihet syri. Patjetër, edhe ne duhet t’u japim disa personalitete historike. Ne u japim, po nuk u japin partitë politike shqiptare. Thonë: atëherë, ne heronjt e gjallë me cilët heronj të vdekur do të bëjmë fushata zgjedhore?! Dhe, sa herë që kaloja pranë kalit të tij me bishtin përjetë, e shihja se është i zemruar me ne stërnipërit, që sa herë dilnim përpara popullit e nxirrnim shpatën e tij famëmadhe dhe çdo katër vjet bënim Shqipëri Etnike. Fytyra i rrinte errë e zi. Mjekrra i dridheshte nga zemrimi. Përmëtepër, çuditesha me “patriotët“ kuqezi sa herë që kalonin pranë tij, si nuk hanin ndonjë shuplakë. Shqelm kali. Ose, s’e nxirrte shpatën nga brezi dhe me një të rame t’ua hedhë kokën përpara këmbëve të kalit si cung shelgu...

Mendime të këtilla më mundonin ditën. Natën. Në shtëpi. Në rrugë. Herë pas here më binin sa mundeshin me grushta. Zgjohu! Nuk është koha për gjumë. Merre kokën tënde nën sjetull dhe dil në Çarshi, te Sheshi i Skënderbeut!...

Dhe, nuk e di pse, sa herë që kaloja pranë atij Sheshi, mendoja se një ditë nuk do ta shoh Skënderbeun mbi kalë. Mendja ime prej shkrintari ma thonte se: një natë Skënderbeu për inatë tonin, të shqiptarëve, duhet të ikë nga ky shesh dhe të dalë matanë Vardarit. Ose, të hip me gjithë kalë me shalë në Kala...

Kalin e kishte me gjithë shalë në drejtim matanë Vardarit. Shpatën, ende në brez. Dorën e ngritur lartë: Ngadalë, o burra! Mos u ngutni, durim! Edhe pak të presim të shkrihet bora. Akulli. Dimri të ikë majave të malit Sharr. Nesër do ta kalojmë Varadrin, matanë Urës së Gurit. Atëherë, së paku çka priste që nuk e këpuste frerin dhe të hip në Kala me gjithë kalë me shalë?!...

- Hi-hii-hiii... E pret Moisi Golemin... Qeshi matanë rrugës Tata e Madhe, një poete e çmendur duke u rënë mureve me shkop nëpër Çarshi, në Bit – Pazar: Zgjohuni!... Zgjohuni, o harama nga gjumi, i dilni zot gjithë këtij bereqeti në mes të fushës! Pasurie të tundshme, se ua mori shkau në mes të ditës...

Rrapi, përsëri bleroi, shpërtheu gjethe në pranverë. Nën hije i kishin ardhë mysafirë nga të katër anët e Atdheut. Poetë, që kokë më kokë lexonin poezi. Çarshisë së Vjetër dalëngadalë po i dilte gjumi. Vargu i hipte në shpinë kalit...

Tata e Madhe me ferexhen krahëve dhe shkopin në dorë, u përzi në mesin e poetëve. Tashti, më në fund ma keni bërë qejfin, Çarshinë do ta zgjojmë nga gjumi. Mjaftë fjeti më, rrzë Kalasë. Nën këmbët e kalit të Skënderbeut. Gurët

e këtyre mureve. Rrugët e ngushta me kalldrëm, fshehin e ndezin histori. Shadërvani, që me shekuj ia ujit rrënjët Rrapit të na bëjë hije ne poetëve për çdo pranverë të vonuar me vapë, rrëzë Kalasë me gurë mbi gurë...

Ora e madhe letrare filloi nën Rrap. Poetët i këndonin dashurisë. Gunës së tij me gjethe, që si zogjë i kishte marrë nën sjetull. Ndonjëri, edhe Atdheut. Pse jo, ky burrë e mbante më këmbë me kësulë të bardhë në kokë në mes të Çarshisë. Edhe Skënderbeut që matanë rrugës i bënte roje, me shpatën në brez e dorën e ngritur lartë, përsëri u thoshte shqiptarëve: Ngadalë, o burra! Nesër, do ta kalojmë Vardarin, matanë. Urën e Gurit, që është bërë si Kështjella e Rozafatit, ditën ndërtohet e natën rrënohet... E ne, nuk kemi Nuse ta varrosim nën ato themele, duke ia lënë një gji jashtë për poetët që nuk ikin nga Atdheu...

Vargu mori zjarr. Tata e Madhe e hodhi ferexhen. Shkopin. E nxorri vargun plumb nga brezi në mes të Shkupit:

*Koçia e Nuses na mbeti në rrugë - male
Krushqit pas shtatë maleve me koçi
U nisën ta marrin Nusen me këngë.
Dhe, ende nuk janë kthyer në Katund.
Dasëm të madhe bën Nëna në lëmë
Babai me shokë qet pushkë te porta.
Cucat në valle copë - copë i bënë dajret.*

*Dasëm e madhe ende bëhet në Katund
Krushqit dikush na i ka ngrirë mes maleve
Koçia e Nuses na mbeti në rrugë. Male...*

Duartrokitjet jehuan si pushkë nën Rrap. Brohoritjet e forta nën hije pranë ujit që gurgullonte gur më gur. Zogjtë fluturuan degë më degë. Çarshisë së Vjetër nën ata gurë turku, i doli gjumi. Tata e Madhe, që përpiqej me shkop vite me radhë ta zgjojë nga gjumi, nën ata mure, minare mbi qyetet, tashti e çoi më këmbë vetëm me një plumb poezi...

- Edhe një! Edhe një! Edhe një!... U dëgjuan zëra nga të pranishmit nën Rrap.

- Jo. Mjaftë e keni një për këtë takim letrar se, nesër ndodhë të më shpallin të çmendur dhe rrasin në birucë. Hajmalinë e Hoxhës të ma varin përqafe si torbë kali me taxhi... Thonë: e kanë pushtuar xhindet... Natë e ditë e tërheqin nëpër Bit-Pazar. Rrugëve flet vetmevete, marrëzira... Ndodhë, të ha dru... Dru... Dru...



IX LIRINË E ZBRITI NGA KOÇIA
NJERKA ME DAJRE

DJEMNUSHA

Djemnusha një ditë më tha: kohën e fundit flet marrëzira. Nëpër korridor shëtitesh lakuriq me rraquet për mejdani. Dhomën e gjumit e ke mbushur plot me libra, fletore... Fletë të shkruara për së prapthi, të hedhura andej - këndej nëpër dhomë, që vetëm një Zot di t'i lexojë ato faqe. Përmëtepër, një fletore dhe një laps e ke futur edhe në banjo, mbi pasqyrë.

E di si është, i përgjigjem: E pranoj se kohën e fundit jam i çmendur. Porositë për këtë libër më vinë nga të gjitha anët, nga toka e qielli. Shenja nga të vdekurit. Drita nga të gjallët. Gji nga Mikja. Fuqi për luftë. Dielli po ma tregon rugën me gisht për në Baba Tomorr. Hëna më tërheq për dore nëpër qiell...

- Nuk do, këtu filozofi, u ngutë Djemnusha. Çmenduria yte ka arrirë kulminacionin. Edhe njëherë e përsërisë, nuk ka fallxheshë, as hoxhë në këtë botë që t'i përzë xhindet...

- Punemadhe, iu përgjigja. Fundi i fundit edhe jam mësuar me xhindet... Nusen me pashterkë të kuqe që më rreh dajak pamëshirë për çdo natë deri në vdekje...

- E di. Prandaj, edhe shpesh të kanë futur në lëkurë dashi...

- Ta merr mendja. Çfarë shkrimtari i thua ti atij, që ende nuk ka hyrë në lëkurë dashi. Nuk e rrahin xhindet... Nusja me pashterkë të kuqe...

- Shkrimtaruc... Hi-hii-hiii...

- Eh, tashti e fitove luftën. Armët edhe nëse duhet t'ia dorëzoj dikujt, po t'i dorëzoj Ty si heroinë luftime. Tekefundit, po i dorëzohem një gruaje e jo një burri me brekët nëpër këmbë...

- Me këtë do të thuash se, e do Robërinë me fereuxe... E jo Lirinë...

- E kush ishte Liria?!...

- Liria, jam unë, ore i poshtër! Ende nuk e di?!... Ose, të mirret goja...

- Jo. Mbrëmë përpak desh më mbyti çotek Nusja me pashterkë të kuqe...

- E sheh, pra! Nusja me pashterkë të kuqe është Robëria... E unë Liria... Njëherë e përgjithmonë, futi në kokë më këto dy gra të rrezikshme që të rrëzojnë natë e ditë bythekrye në shtrat në mes të dhomës!...

- I futa.

- Dhe, çka?! Përsëri do të shkosh te Robëria t'i shterish herdhët...

- Jo, kurrë më!

- Nuk e besoj. Ti nuk ke besë...

- Edhe ti... Ne jemi të dy njësoj në huje, nuk kemi besë...

- E, atëherë pasi nuk paskemi besë, nxirre shpatën he burrë nga brezi!...

- E nxorra. Luftë dua në shtrat! Luftë, në fushë të mejdanit!... Luftë!...

Dhe, atë natë u bë një luftë e përgjakshme. Djemnusha me lulekaçe në dorë më rrëzoi në

shtrat. Nuk u përpoqa edhe një herë të ngrihem më këmbë, i dorëzova armët...

Natën e mirë!...

Ditën e nesërme, Nusja me pashterkë të kuqe u ngritë heret në mëngjes, i përveshi mangët e këmishës dhe hyri në magje. E fshiu shtëpinë. Lëmën. E gatoi bukën. Në fund e futi në çerep, nën saçin me shpuzë në mes të dhomës.

Buka u poq, si në Katund më, kulaç. Një nga një zbritën poshtë në kuzhinë edhe banorët e shtëpisë. Fëmijët të parët plot pordhë e piskamë u turrën te maxha duke kërkuar bukë. Edhe Nëna. Babai. U shtrua sofa. Buka. Lugët e drurit. Dhe, familja ditën e sotme e filloi me mëngjesin e zakonshëm, që pastaj secili të ikte pas punëve të tyre të ditës. Fëmijët në shkollë. Nëna t'i mjelë lopët dhe dhentë. Babai, heret me plug te ara...

Dhëndrri u ngritë hundë e buzë bashkë, që në mëngjes. Nuk i kishte pëlqyer Nusja. Ishte mësuar keq si beqar, për çdo mëngjes nga dy gota raki rrushi dhe kafja duheshte ta presin mbi kokë. E kjo, Nusja me pashterkë të kuqe sikur kishte të tjera huje, adete e zakone.

Një ditë i tha Nënës:

- Nënë, unë nuk e dua këtë Nuse!

- Pse, ore bir?! Nusja është e mirë, ngrihet që me natë të gatuj bukë. Është magjatore. Edhe fëmijë trima do të na lindë një ditë në këtë shtëpi me oxhak mbi çati!...

- E di. po, kjo nuk është ajo Nusja që e njoha unë në male...

- Tybeistifa! Mos folë marrëzira! Është Nusja që e zumë me shkues nga derë e agallarëve. E morëm me krushq... Koçi...

- Jo, oj Nënë! Jo, kjo nuk është ajo Nusja e maleve. Tjetër nuse na kanë futur komitat në koçi mes maleve...

- Qyqja unë! Qyqja, mos fol, o bir budallaki! Nusja jonë është nga derë e lartë, agallarësh... Nuse e maleve...

- Nënë, kjo nuk është Nusja e maleve, po Nusja me pashterkë të kuqe...

- E mjera, unë! Edhe këtë të zezë na e paskan bërë komitat?!...

- Po, oj Nënë! Në vend të Nuses së maleve, në koçi na e kanë futur Nusën me pashterkë të kuqe deri në fund të këmbëve...

- Fatkeqësi familjare! Nesër, kjo Nuse do të na e mbushi Shtëpinë, lëmën me kopila... Rrospi Meshkuj... Melezë...

- Po, oj Nënë!...

- E halli, o bir?!

- Halla, Nënë do burrë! Që nesër, unë do të dal përsëri në male, në Katund do ta sjell Nusën e vërtetë të maleve...

- Nisu, o bir sa më parë, hipi kalit!! Udhë e mbarë në male!...

Heret në mëngjes, u ngrita dhe i ngjeshja armët e luftës. I kërceva në shpinë Gjokut pullali. E shalova me të katra tymemjegull për në Baba Tomorr. Vendin e Perëndive: ku pihet vera... Pasmesnate, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri me Hënë e plotë...

Papritmas më zuri nata mes lisave. Rrugës malore u ndala në një Tyrbe. Dhe, thashë: sonte do ta kaloj këtu natën. Nesër do ta vazhdoj rrugën me dritë.

Hyra brenda. Dhomë plot me libra. Në një kënd, një tavolinë pune. Shtrati. Në mes të dhomës një varr. E mora me mend, ishte varri i Baba Shehut. I hoqa hebet nga krahu. Struken. U shtriva në shtrat me sy të hapur në tavan. Fotografi. Inserte të filmave, më kalonin para syve, që nga koha e fëmijërisë. Meditime. Sytë ia kisha ngulur fenerit, dritës së vetme mbi kokë.

E dëgjova një zhurmë. U hap dera. Hyri një grua e veshur në të zeza me qiri në dorë. Ecte si hije drejtë meje, shtratit. Unë, tashti nga frika e ndala edhe frymëmarrjen.

- Mirëse na ke ardhë, o mik!

Unë i hapa sytë edhe më tepër nëpërmes të asaj drite të zbehtë ta shoh fytyrën e kësaj gruaje.

- Mirëse u gjeta, zonjë! Belbëzova, duke u dridhur plot frikë...

- Kush të detyroi të ikësh në këto anë?

- Lufta. Pesëdhjetë vjet jam në luftë. Dhe, e kërkoj Lirinë!...

- Hi-hii-hiii... Po, unë jam Liria... Nuk më njeh, he burrë?!...

- Jo. Feneri nuk bënë më shumë dritë. Ia ngritë edhe pak fitilin!...

Gruaja ia ngriti fitilin. Drita, tek tashti ia ndriçoi fytyrën...

- O Imzot! E pabesueshme, po ti qenke Djemnusha?!...

- Po, unë jam Djemnusha.

- E kush të solli në këtë Tyrbe?!

- Erdha vetë. Që, kur në koçi në vend timin e futën Nusen me pashterkë të kuqe, vendosa të vetëflijohem në Tyrbe. Natë e ditë t'i shërbej Baba Shehut...

- O Imzot! Po, ky është vetëm një varr, dhe jo Baba Shehu?!...

- Jo. Është Baba Shehu. Dhe, unë jam Gruaja e tij besnike...

- O Imzot! Po, ti nuk qenke Djemnusha?!...

- Jo. Unë jam Liria...

- E pamundur. Ti je Nusja e maleve...

- Hi-hii-hiii... Unë jam Nusja me pashterkë të kuqe...

- Rrenë. Nusen me pashterkë të kuqe e kam në shtëpi. Ti je Liria...

Dhe, e rrëzova mbi varrin e Baba Shehut. Këmishën e gjatë të mëndafshit me oja ia hudha mbi kokë... Tyme flakë u rash Sarajeve të Pashait. Pasurisë të tundshme, që përpak desh ma mori shkau... Nuse me koçi ta përcjellë në tjetër katund... Shtëpi...

E bëra të qajë, derdhë lotë mbi varrin e Baba Shehut, në Tyrbe...

PËRCJELLJA E GOMARIT HAXHI NË MEKË ME DAJRE

Arat tona pjellore anë e mbanë Atdheut me hebe në krah, i mbollëm me grurë... Edhe malet: Tiranë... Prishtinë... Drenicë... Shkup...

Dhe, ato ara pjellore veç më e kanë rritur grurin. Kallinjtë e kanë kërrusur kokën nga buka. Anë e mbanë kanë dhënë frute. Atdheu, tashti vetëm i korrite. Qerret i ngarkonte me duaj dhe i hidhte në Lëmë. I zgjidhte duajt. Kali i hazdisur me një pasqyrë në ballë silleshte për ta fshi lëmën rreth strumbullarit. Qetë me zgjedhën në qafë ugarëve. I zgjuam malet me këngën popullore të krushqëve para koçisë:

*Haj-haaj, kasolla me kashtë
Sot një javë nja pesa - gjashtë!...*

Baballarët tanë për çdo verë i mbushnin hambarët me grurë. Thasëve ua lidhnin grykën me nga një kordhë kanapi. Dimrave u dilnin para me këngë e valle...

Ua ndërsenin qentë pas Çuke... Pushkët i nxirrnin nga hatullat...

Dhe, te pragu i derës e prisnim Pranverën... Koçinë me nuse...

Ende bërlloku shqiptar nuk e di se, ky popull vjen me penë e pushkë nga malet. U lindë mes maleve. U ngritë në male, në Kosovë me: Pjetër Bogdanin, Bajram Currin, Hasan

Prishtinën, Isë Boletinin, Shotë e Azem Galicën... Në Shqipëri: Skënderbeun, Ismail Qemalin, Naim Frashërin, Luigj Gurakuqin, Gjergj Fishtën, Fan Nolin, Faik Konicën... Dhe, në Maqedoni: Dervish Carën, Sulltanë Qafën, Kalosh Zajazin, Xha Derallën, Josif Bagerin... Përsëri, u arratisë me penë e armë në dorë maleve të Shkupit: në Karadak e Sharr mes lisave kokë më kokë.

Një qytet që fatkeqësisht, ende edhe në kohën e sotshme prodhon burra me pashterka me shumicë e pakicë në politikë... Burra me partalla (lecka) në kokë në vend të kësulave të bardha... Qyteti nuk ka jetë...

Bërlloku nuk është për ndryshime në shoqëri. Shtet. Brez pas brezi është për pushtet. Dhunë. Bërllokut i pëlqen kontejneri në rrugë... Mjegulla kur zbret në fushë... Haleja... Gjuetia e kundërshtarëve... Pusia pas ferre... Tradhtia... Torba me taxhi që ia ka lidhur përqafe si një hajmali hoxhe: Qoftëlargu...

E ti, patjetër duhet ta vazhdosh rrugën për në Baba Tomorr. Qoftë dimër, qoftë verë. Ditën, natën. Rrugës mos biesh në pusi...

Dhe, halldupët ende nuk e dinë se, moti e ke pushtuar Shkupin... Edhe atë, i ke hyrë natën si kaçak nga oxhaku...

Në mëngjes, pasi i pi dy gota me raki rrushi dhe kafen, del në hale ta dhjesësh ditën e djeshme me gjithë halldupë. Në ndërkohë, nga qielli të vjen porosia në kokë. Turrevrap me brekët nëpër këmbë, turresh në dhomën e gjumit. Gruaja

besnike, kur të sheh në këtë gjendje bërtetë e shashtisur nga kuzhina:

- Tashti më, e shoh se je çmendur plotësisht, nuk ka plakë fallxheshë, as hoxhë që t'i kthen ato të shkreta si zogjë edhe një herë në kokë. Fatkeqësia: të provokojnë me komente nën shkrime duke e fshehur veten nën dimia të grave me pseudonimin e halldupit: “Jasini”. Edhe atë, pasi e kanë gjetur veten lakuriq në ato shkrime.

E vërtetë, i përgjigjesh. Është halldupi me kokën në xhami e bythën te Partia Neokomuniste. Kurva politike, që gjithë jetën shkon burrë më burrë. Dhe, më në fund mezi e gjeti një burrë hadum me dimia të larme. Edhe këtë Dimër i luten Zotit për mëkate përpara Qeverisë “demokratike”. Njëri pas tjetrit rreshtohen te Partia Neokomuniste me duartrokkitje frenetike nga “vëllezërit”, burri i parë që ua grisi dimiat në mes të sheshit në Bit – Pazar e Gostivar. Gojën plot, i përcjellin mesazhe popullit: Ecni me ne te burri i parë besnik! “Namuzin” ta kërkojmë në rrugë. Nuk prish punë që deri më tani i kemi ndërruar disa burra pushteti namëqorra. Ne, nuk jemi kurva haremi, po gra besnike në këtë Shtëpi Publike. Ehu, Kurvat politike, që ende nuk e gjetën një burrë tiran, siç thotë Fishta. Këmbët t’ua çojë në hava mes livadheve. Piskama t’u shkojë për qielli.

Dhe, pasi e hedhë porosinë në libër, përsëri ulesh në hale. Vetëm se, kësaj radhe mbi pasqyrë e vendos edhe një fletore dhe laps, për porositë e ardhshme që do të të vijnë papritur nga qielli për të nesërmen...

E hap televizorin me frikë. Kanalin shtetëror, që një herë i hip në shpinë njëra Parti politike “demokratike“ e herën tjetër mbi samar, Kurva Parti. Në radhë pret t’i hip edhe Nusja me pashterkë të kuqe... Dhe, hë për hë të kujtohet anekdota e Nasradin Hoxhës me Nasradinicën duke shkuar ditën e shtunë në pazar.

Nasradin Hoxha, heret në mëngjes i hip gomarit. Nasradinica përpara duke e tërhequr për kërpeshi, nisen për në Qytet. Rrugës i takojnë kalimtarët e rastit pazaxhi:

- O Nasradin, zbriti gomarit se e cofe, le t’i hipë pak edhe Nasradinica!

Nasradini, nuk ua vente fjalëve veshin, vazhdonte rrugën mbi gomar. Ama, ia kishte thënë një kënge patriotike për kaçakun e maleve, Kalosh Zajazin.

Në mes të fushës, te Dardha Gorrice, Nasradinin e takoi edhe një tjetër pazaxhi me hebe në krah:

- O Nasradin, a nuk e sheh se e cofe gomarin? Zbriti pak, le t’i hipë edhe Nasradinica në shpinë!

Përsëri, Nasradini nuk ia vuri veshin, vazhdoi rrugën mbi gomar. Kësaj radhe ia tha këngës edhe me fishkëllimë:

*Çaqe poshtë te shtatë zymbylat
Ku ia thoshin shtatë bylbylat...*

Në hyrje të qytetit, te Kasolla e Ekremit, Nasradin Hoxhën e takoi edhe katundari i tretë me një mëzat katundi për dore:

- O Nasradin, a nuk e ka më mjaftë, bre burrë?! Zbriti gomarit se e cofe, le t'i hipë pak edhe Nasradinica!

Nasradinit, më nuk iu durua pa folur, i erdhi te hunda. Iu përgjigjë:

- Nuk cofë gomari me mua që i kam gjashtëdhjetë kilogramë me gjithë tesha, po do të cofë nëse i hipë Nasradinica, që i ka njëqinpesëdhjetë kilogramë.

Hi - hii - hiii... E ngjajshme me Partitë tona politike “demokratike“ duke i hipur mbi samarë: njëherë njëra parti, njëherë tjetra në shpinë popullit. E ky popull, kurrësesi ta flukë samarin nga shpina. Halldupët bythekrye t'i hedhë në lumë. Rrugën ta vazhdojë për në Baba Tomorr pa këtë barrë mbi shpinë...

Në një manifestim kulturor, që jepej drejtëpërdrejtë nga një televizion i “pavarur” privat përpara Qeverisë, gomarit për çudi i kishte hipur Nasradinica. I merreshin këmbët, rrëshqiste në akull. Udhëtarët e rastit, pazarxhinjtë e diplomave universitare, alametë doktora të shkencave natyrore e politike, profesorë univerziteti, intelektualë të vetëquajtur e politikanë, gazetarë teknefesë e analistë politik, që e promovonin Partinë Neokomuniste përpara zgjedhjeve parlamentare, e fotografonin veten me komente teknefese përpara kamerave televizive. Thonin: ne dalim në rrugë që të kthehemi në mesin e popullit. Edhe pse, populli vite me radhë nepër shtëpitë e tyre gati të rrëzuara e mbanin barkun me duar. Shkaku tyre, që ua kishte dhënë votat këtyre edepsësve t'u dalin zot të drejtave të

tyre nëpër institucione. E shanin rininë e sotshme përmes një televizioni të “pavarur” privat, pse nuk del edhe ajo në protesta në rrugë, t’u bashkohet halldupëve dhe ngri në këto ditë të ftohta dimri. Ndanin çmime letrare. Mirënjohje për shkolla të mesme. Bursa qesharake për studentët më të mirë. Recitonin vjersha patriotike. Pjesë teatrore teknefese para publikut. E thirrnin popullin ta shohi këtë cirkus shëtitës në rrugë, përpara Qeverisë. Merreni me mend, në këtë kohë kur bota i shihte këto “vlera artistike” nëpër institucione kulturore e arsimore të shtetit, sallone aristokrate evropiane.

Fatkeqësia, nuk ishte që kësaj radhe gomarit i kishte hipur Nasradinica me njëqindpesdhjetë kilogramët në shpinë, po fatkeqësia ishte se: gomarin e kishin rrëzuar në baltë përpara Qeverisë. Asgjë këtij gomari asht e lëkurë nuk i kishte mbetur në samar kombëtare. Kokën ia kishin lidhur me shami arabe. Këmbët me nalle të haxhilerëve. I kishin veshur një këmishë të bardhë e të gjatë me oja deri në fund të këmbëve. E përcillnin me duartrokitje përpara Qeverisë haxhi në Mekë me dajre...

LUFTA E PËRGJAKSHME PËR KALANË DARDANE

Fatkeqësisht, kohën e fundit mezi u binda se shqiptarët njëzet vjet me radhë bëjnë jetën e peshkut në këtë shtet “demokratik”. Pala kundërshtarë politike ua hedh grepin me një krimb në hurdhë... Dhe, ata turr i madh e i vogël bythekrye pas krimbit që të përpëliten si peshku në zall. E më vonë edhe në fëltere mbi zjarr. Nuk është ky grepi i vetëm që pavetëdije vite me radhë e kanë hëngër shqiptarët. Grep i këtillë me një krimb para do kohe ishte edhe Enciklopedia maqedonase... Librat e historisë... Dhe, ja grepi fatal i fundit: ndërtimi i një objekti të përbashkët “muze” sipas Qeverisë në kala. Këtë e vërtetoi se është ndërtim monumental i trashëgimisë kulturore edhe zëvendës ministri i Qeverisë Abdylaqim Ademi bashkë me disa deputetë të BDI-së duke u fotografuar para kamerave televizive në kala. Turr pas tyre me partizanë partiak të fotografohet edhe Imer Selmani me deklaratat: se në kala Gruevski ndërton kishë. Partia e Thaçit, PDSH -ja përmes zëdhënësit të saj edhe ajo me të katra në kala, duke u trembur se do të mbesë pas dere pa u fotografuar krahu për krahu para kamerave televizive në këtë fushatë parazgjedhore. LSDM -ja e përcillte gjithë ngjarjen tinëz nga pusia duke i fryrë zjarrin.

Edhe atë: në kohën kur televizioni i “pavarur” A1 i jepte lajmet në mes të dimrit

përpara Qeverisë. Partia opozitare më e madhe LSDM -ja më e kishte lëshuar Kuvendin dhe bënte politikë në rrugë jashta institucioneve: me duhanvjelësit e pakënaqur të Koço Racinit dhe televizionin e “pavarur” A1 të Velija Ramkovskit në burgun hetues për rrëzimin e Qeverisë të Gruevskit dhe Ali Ahmetit. PDSH-ja me gjithë plaçka në shpinë, moti kishte ikur në shtëpi duke marrë pa punë fare rroga deputeti dhe herë pas here duke i shkruar Qeverisë “letra dashurie”.

Televizioni i “pavarur” A1 vazhdonte në mes të dimrit t’i këndojë serenada nën dritare Gruevskit, të bëjë politikë “idilike” përpara Qeverisë. E thirrte popullin për mbështetje në luftë me parullën demagogjike: edhe ne jemi A1. Nateditë i shante studentët pse nuk i bashkohen fushatës së tyre kundër Gruevskit për ta rrëzuar Qeverinë. Alamet politikanësh, deputetësh, analistësh të “pavarur” politik... Përmëkeq, mes tyre edhe shqiptarë të mjerë - argatë pa pare: Imer Selmani me bandën e tij politike, “analistmadhi” i përjetshëm politik i kabineteve qeveritare, Patrioti i Vonuar melez... Këlyshë me zgjebe, që na e futën ujkun në vathë, në mesin e qëngjave. E kamerat e A1 -shit i jepnin para popullit vendimet e tyre historike se, edhe këta e lëshuan Parlamentin, dhe iu bashkangjiten Partisë Opozitare Neokomuniste, që problemet e popullit t’i zgjidhin me “rrugë demokratike” jashta institucioneve të shtetit, në rrugë.

E Gruevski dinak, perderisa LSDM -ja bënë luftë për pushtet me gjithë arsenalin e armatimit nga toka e qielli në rrugë, shqiptarët merren me

Enciklopedinë maqedonase, librat e historisë dhe “kishën – muze” në kala, vazhdon me ndërtimin e institucioneve kulturore dhe përmendoreve madhështore të heronjëve bullgarë dhe mitropolitëve të Beogradit në të dy anët e Vardarit duke pushtuar Çarshinë e Vjetër.

Fatkeqësia më e madhe: edhe pse ndërtimi i kishës u ndërpre përkohësisht, gripi me një krimb edhe një herë hidhet në hurdhë. Një grup funksionarësh shqiptar me disa aktivistë partiak, i zunë hajdutët duke punuar natën (punëtorët e organizatës punuese) në kala. Edhe, pasi i përzunë punëtorët e pafajshëm, filluan ta shkatërrojnë “kishën” si në kohën e Turqisë para kamerave televizive. Punë kjo me mend, që duhej ta bënin të nesërmen përmes institucioneve të shtetit, me luftë demokratike në Kuvend.

Organizata joqeveritare ZGJOHU, e trimëruar nga “patriotizmi” i pashoq i këtyre burrave të mejdanit, të nesërmen i thirri shqiptarët në protesta kundër ndërtimit të “kishës- muze” në Kalanë Dardane. Pala tjetër e komitave, në të njejtën kohë përmes internetit i thirrë partizanët e vet për t’i dalë zot kishës në Kalanë e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë. Edhe, papritmas nisi lufta politike-fetare fytyrë në kala për kisha e xhamia. Vendin, në të cilin kohë më parë ka pasur kishë katolike, e më vonë gjatë Perandorisë Osmane edhe xhami. E shi sot, këta burra mejdani donin ta kthenin të kaluarën e hidhur mesjetare edhe në këtë shekull demokratik para syve të botës përparimtare. Luftat t’i bëjnë si dikur me pushtimin e kalave. Grushtat dhe gurët

atë ditë i përdorën në vend të armëve. Vetëm u mungonin kuajt, mburojat dhe shpatat. Policia, dihet: i përdori shkopinj e gomës. E përgjakën kalanë e Shkupit. Dajakun e hëngrën, përsëri shqiptarët. Shkaku se, policët maqedonas gjoja se donin t'i ndanin grupet nga përleshja luftarake ndëretnike fetare i godisnin shqiptarët me shkopinj gome.

Fatkeqësia më e madhe: në këtë luftë për Kalanë Dardane merrte pjesë edhe zëvendësministri shqiptar i Punëve të Mbrendshmeve Xhevat Buçi me disa deputetë e aktivistë partiak në pushtet. Zëvendësminsitri bile i “shpëtoi” dy protestues shqiptar të “rrezikshëm” para kamerave televizive që policët maqedonas ua kishin vënë prangat për t'i marrë në “pyetje informative” në podrumin policor. E gjithë kjo “luftë heroike” zhvillohej para kamerave televizive dhe syve të ndërkombëtarëve. Vëzhguesit e huaj me keqardhje thonin: merreni me mend, se sa vështirë e kanë maqedonasit me shqiptarët, edhe pse duan dialog në Kuvend, institucione të shtetit, shqiptarët problemet politike kombëtare e fetare duan t'i zgjidhin me dhunë në rrugë. Edhe atë: duke ua rrëzuar “vëllezërve” edhe kishat. Nuk njohin as edhe shtet policor, institucione shtetërore, ligje e as fe. Edhe kush, vetë funksionarët e pushtetit bashkëqeveritar në këtë shtet demokratik... Deputetët e zgjedhur të popullit...

E gjithë kjo luftë e përgjakshme për Kalanë Dardane, ndodhi pak ditë para se Gruevksi të niset për në Amerikë. Shkaku dihet, është i qartë

për politikën maqedonase. Mjerisht, edhe, një herë e shpëtoi politika teknefese shqiptare e përçarë pa kokë, ia hapi krah më krah portën politike, rrugën qiellore me aeroplan special për në Amerikë. Ballë për ballë në tavolinë t'i shpalojë letrat e bixhozit, në sy tua qaj hallet edhe miqëve amerikan se me çfarë populli primitiv përpiqen të ndërtojnë bashkëjetesën, bëjnë politikë demokratike për zgjidhjen e çështjes së emrit për të hyrë në Evropë...



KOSOVA NJË GRUA E VEJË E SHITUR DY HERË

Ehu, Plaku ynë satirist i mirë dhe i urtë Xha Deralla! Burrë, që në pleqëri bukën e gojës ta shtinin në dhomë nëpër dritare. Shkaku, se: nuk të lejonin të dalësh jashtë shqiptarët, me “arsye” se e prish rininë e fshatit... Shoqërinë... Shtetin... Xhandarët e serbit në atë kohë i shëtite gjithë natën nëpër Katund. Të nesërmen, kur zbardhi dita ua tregove portën e Plakut të Katundit. Derën, që atë ditë ta mbyllën me çelës mos dalësh në rrugë. I kaloje ditët e pleqërisë i vetmuar në mes të katër mureve. Dhe, e prisje te porta Zonjën Vdekje si burrat. Edhe atë: burri me sharrë në krah, që gjithë jetën i kishte shartuar dardhat gorricë te Jasakët e Tikeve. Përroni i Thanës. Anegdodat e të cilit edhe sot qarkullojnë gojë më gojë nëpër botë.

Ende nuk mund ta harroj këngën popullore që na e këndoje në atë kohë, kur ta sillnim bukën e gojës majë shkopi nëpër dritare:

*... Ehu, rrahu teli në Tiranë
e ka shitë Turqia këtë Rumeli
Edhe atë: shtatë gjemi me alltan,
E ka ble ai Moskovi Zi...*

Edhe këtë ditë, ato vargje të asaj kënge popullore nuk mund t'i heq nga mendja, që më janë ngulitur në tru si pyka. Vallë, edhe sot

Kosova qenka një grua e vejë pa burrë?!... Shkuesit duhet ta shesin për poste e pushtet burrë më burrë?!... E ajo, edhe sot e kësaj dite ende të mos mundet ta gjejë një burrë me tirqi e xhamadan me gajtana?! Kësulën e bardhë në kokë. Sahat me qystek për qafe. Mauzerrin në dorë. Nagantin në brez. Bombat nëpër xhepa... Gjithë jetën ta kalojë burrë më burrë. E në fund, përsëri të kthehet te burri i parë, sadist me shajkaqë në kokë. Burri, që gjithë jetën e dhunoi, vrau dhe e masakroi për vdekje. Burri, që e përzuri me gjithë fëmijë edhe nga Shtëpia. Mezi e ktheu të alivanosur në shtëpi Amerika. E shi sot, vetë djemtë e saj e kthejnë te burri i parë, poligam. E martojnë me krushqi. Edhe një herë bëjnë dasëm me shtatë palë lodra.

O Imzot, Kosova siç duket pati vetëm një djalë. Edhe atë: Adem Jasharin. E di, ju më përgjigjeni, pati edhe djemë të tjerë trima. Burra pene e pushke: Bajram Currin, Isë Boletin, Hasan Prishtinën, Shotë e Azem Galicën, Sulltanë Qafën, Kalosh Zajazin... E vërtetë, po djemtë e sotshëm i dolën kopila. E shitën dhe e shesin Nënë e tyre burrë më burrë. Edhe seç ma kujtoni në këtë ditë të kobshme: Horrri e Prishtinës... Zekthin e Shkupit:

- *A ia ndjeve krismën, o Adem Jashari? E shpallëm pavarsinë e Kosovës...*

- Tybe, boll pak! E bëtë Shqypni me tupana, çifteli e dajre, e këndeje gjysma e popullit shqiptar mbeti nën Serbi, Maqedoni, Mal të Zi, Greqi... Dhe, e shpërndarë në të katër anët nëpër botë si Kashta e Kumbarës...

- *Qysh, nuk ia paske ndi zanin, o burrë? E gjithë shqiptaria u çue më kambë... Në Shkup, Skënderbeu e ngriti lartë në dorë flamurin amerikan... E ne nëpër katunde e ngritëm mbi avlia e plepa flamurin kuqezi me shkabën dykrenare...*

- *Paj, kur e shoh, he burrë se me Shqipërizë, me Maqedoni, me Kosovë... e bëtë Shqypni me tupana, çifteli e dajre, përpak me gjithë tabut në shpinë desh u ngrita nga varri...*

- *A nuk po sheh se sa trima u mbloodhën në Ditën e pavarësisë?! Ditën e Kongresit të Manastirit... Ditën e flamurit... Dhjetëvjetorin e UÇK-ës... Veç sa nuk po i lëshoi toka e Kosovës, Maqedonisë... Dhe, veç falë Zotit që nuk po iu gjuajtën me dorë Serbisë se po me i hi për një ditë në Beograd. Punemadhe, që ata na u sulen me dorë e me këmbë...*

- *Zoti ia ruajt Shqypnisë këta trima, këta mitingaxhi e këta këngëtarë, që e kthyen Shqypninë "mbarë" në ditë të sotshme, tue këndue e tue ba gjymysh, tue mbajtë fjalime e tue thanë "lavdi" mbi varre e nëpër sheshe, e masandej tanë natën me meze e me raki me pare të vjedhura nga populli nëpër çarshi!...*

- *Paj bre, Adem, mbasi shkaun e përzumë e ndoqëm prej këtuhit... tash duhet me ba i trohë sefa! Dasëm të madhe... Edhe ne më në fund morëm nuse...*

- *Kush e përzuni, ka e keni ndjekur?! Shuej bre, se e rroka prapë mitralozin me dy kambë! Ja... nime kund vend s'i keni lanë tue ikë, si lepujt. Tash vetëm bini çiftelisë e knone Isuf*

Hajdarin dhe shtynu se kush e ka nisë luftën ma i pari dhe kush ka ma shumë shpirta të vdekun për me qitë në kangë... Dhe, kush e solli Pavarsinë e Kosovës... E kush asht ma patriot...

- *O baca Adem, ngadalë, bre burrë, ti thuaj: shqyr që na ka ardhë dita me knue e me u gëzu... E me e ba Shqypni me çifteli...*

- Po, po... nime mbasi nuk po punoni kurgja, s'keni çka me ba, veç mbaroni vorre në vend të fabrikave, xhami në vend të shkollave, ndiqni përvjetorët e humbjet i shënoni me fitore, kush ka vdekur e kush asht varrue... Serbia për së gjalli nuk më përzuri në Turqi... E ju pas vdekjes më shpërngulët në një shesh të Stambollit, duke ma ngritur bustin në atë vend të mallkuar... Shpirti në paqë nuk më prehet kurrë: eshtrat nuk m'i lini rehat edhe në varr. Bustin ma shpërngulët në Stamboll, në Turqi. Por, dinie mirë se tue e teprue me kangë po na çitni në bisht të lahutës, po bani hajgare me ne. E zgjodhët edhe presidentin e ri të Kosovës... Kur po ndëgjojmë se si po na nderoni, veç s'po kemi si me dalë prej vorri e ma jau... këtu po durojmë mbasi s'po kemi çka me ba. Po sa herë po i lajmë, te kroni i shpirtave të vdekun, duart e sytë në ferk të sabahit, po jau shilojmë nantë mijë herë nanat!

- *Po me kanë ti gjallë sot çka kishe ba, o Adem Jashari?!*

- Çka, a? Paj, m'u kish dashtë me dalë edhe nji herë në mal kaçak prej jush shqiptarëve, ej e me e ba siç duhet Shqypni Etnike... Boll më e shitët Kosovën si një grua të vejë me krushqi e dajre te

Moskovi Zi... Dhe, e dërguat me koçi e krushka
nuse burrë më burrë si një kurvë!...



TANUSHA

Plot dy muaj njerëzit i shihja me nga dy koka. Vështirë i lexoja gazetat, ndonjë libër. Lëmsh shkronjat... Shkallët... Rrugat... Ndërtesat... Megjithatë, nuk shkova e nuk shkova më te mjeku. Fatkeqësisht, nuk ia pash të bijën. E lash ç`do gjë në duar të Natyrës... Zotit... Miqtë filluan të më vizitojnë... Edhe Cuca Boheme pas dy muajve. Një natë e nisa edhe romanin tim më “skandaloz”: *Gratë e mia besnike*. Çudi, për një muaj e hodha në letër. Truri si duket ishte pastruar nga marrëzirat... Patriotizmi i rrejshëm... Patetika... Lufta për karrige... Pushtet...

Në Tanushë nisi lufta. Çudi, sipas rrëfimit të një miku shkrimtar, pasi kisha vdekur në Voskopojë duke u ngutur që sa më parë të më shpien në spital në Korçë, rrugës kishin bërë aksidentë komunikacioni. Unë, atëherë kisha bërtitur: **LUFTË**... Miqtë që kishin humbur ç`do shpresë për shenja jete, vetëm tashti e kishin parë se unë ende jam gjallë... Ose, u ringjalla...

Vallë, thua unë e paralajmërova luftën në Maqedoni... Unë të isha njëfarë profeti... Ku ta di... Realiteti e bëri të veten mes maleve. Tanusha një fshat, që pakkush e dinte se ku gjendej, e ngriti zërin. E dëgjoi Europa. E dëgjoi edhe bota. Nënës Parti ia prishi rehatllëkun në Qeveri. Shkak ky, që do ta shti Menduh Thaqin me shokë publikisht t`i thotë Dosta Dimovskës:

“Bjeru motër se, kemi të bëjmë me banda kriminele ndaj të cilëve shteti duhet t’i marrë të gjitha masat e duhura”. Njëkohësisht, me shokë t’i drejtohen popullit shqiptar në mjetet e informimit: “Qeni i keq ta sjell ujkun në torisht”. E më vonë të komentojë për “FAKTI -n” rreth kërkesave politike të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare: “Mos t’u shkojë ndërmend se do të arrijnë që ta nënshtrojnë PDSH -në me veprime të “këtilla”. Le të flasin për vete dhe punët e tyre. Punët e PDSH-së dhe strukturës së saj janë të qarta...

... Mendoj se kjo është një listë dëshirash. Fundi i fundit një plagiat me ndryshime kozmetike e platformës dhe programit të PDSH -së. Sipas të gjitha gjasave projektantët apo demagogët që qëndrojnë pas këtyre njerëzve janë njerëz të cilët kanë pasur dështime të mëdha në politikën legale dhe legjitime të shqiptarëve të Maqedonisë, madje edhe në vendet tjera në Kosovë e kështu me radhë. Mendoj se mënyra e tërë veprimit është tejet e paarsyeshme dhe shumë e dëmshme për ardhmërinë e shqiptarëve në Maqedoni dhe në rajon. Këta njerëz sigurisht se nuk kanë legjitimitet të saktë dhe të qartë. Legjitimiteti i tyre është shumë i dyshimtë”, - deklaroi për “FAKTI -n” Menduh Thaçi, nënkryetar i PDSH -së, pas bërjes publike të kërkesave politike të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare...

“ FAKTI “ gazetë e përditshme e “pavarur” në Shkup, që kurrë nuk ka ditur se ku e ka kokën e ku bythën, në faqe të parë do të botojë editorialin: **“UÇK-ja duhet t’i dorëzojë armët”...**

Në një editorial tjetër të radhës edhe: "... Shqiptarët nuk duhet të bijnë në grackat e reja të interpretimit të gabueshëm të politikës. As Kushtetuta e as federalizimi, as regjistrimi i popullsisë nuk bëhet në male, prandaj çdo tentim për të futur në mal politikën shqiptare të Maqedonisë është tendencë e rrezikshme me pasoja të paparashikueshme. Njohja e sovranitetit dhe integritetit teritorial të Maqedonisë nuk mund të bëhet me maskë në fytyrë, sepse edhe ne që ecim pa maska njohim dhe respektojmë sovranitetin e Maqedonisë, prandaj edhe duhet të mos e humbim respektin dhe përkrahjen e aleatëve evropatlantik".

Nëna Parti do të organizojë në Shkup: **"Marshi për paqë dhe drejtësi":**

"... Është e qartë që përgjigjen në këtë pyetje, veçmas menaxhimin me krizën nuk mund ta lëmë në duart dhe mendjen e shoqatave minore, pa rëndësi dhe ndikim shoqëror, pa informata, kapacitet, kompetenca dhe përgjegjësi shoqërore..."

PDSH -ja si subjekt me përgjegjësi objektive-shoqërore dhe kombëtare me guxim politik dhe patriotik, duke u mbështetur në informatat që i posedon, nuk mund të rri anash, të bëj sehir dhe në mënyrë oportuniste të tentojë të përfitojë nga kriza ashtu si disa shoqata minore që synojnë të legjitimohen politikisht përmes fatkeqësisë të tjerëve.

PDSH-ja thotë haptas se **kjo luftë nuk lejohet, aq më pak të fitohet...**

Bërllok! Bërllok shqiptar që me vite më zinte frymën. Zorrët m'i kishte nxjerrë nga barku. Nëpër tubime Nëna Parti e kishte ngritur flamurin kuqezi. E kishin shaluar Kalin e bardhë me një këmbë të thyer nëpër Bit – Pazar. Përmendoren ia kishin ngritur në Sheshin e Tun Batunit “patriotët” kuqezi... E kishin bërë Kosovë... Shypni Etnike... E shi sot, përsëri vazhdonte me të njejtat kakërdhija... Vazhdonte të na e qelb lëmën... Atdheun...

Kryengritësit vazhduan luftën. Grupeve të tyre iu bashkuan edhe shumë të rinj. Mjetet e informacionit vazhdonin me propagandën... Terroristë... Banditë të hedhur nga Kosova, që ne gjatë egzodit në Kosovë i pritëm me bukë e ata me gurë... E ku ta di unë, çkamos... Në shtyp dolën edhe komunikatat e para të UÇK-së. Deklaratat e komandantëve: Hoxha... Sokoli... Mësuesi... Shpati... Mala... Baca... Teli... Leka... Gjini... Xhaxhi... Haxhi Baba...

Dhe, pas bombardimeve të rënda nga policia dhe ushtria maqedonase, mu kur priteshte të shuhet kryengritja shqiptare në Tanushë, ajo plasi edhe në fshatrat e Tetovës... Shipkovicë... Gajre... Kala...

Policia dhe ushtria maqedonase i sulmoi me armatime të rënda edhe këto fshatra. Demostroi forcë. Nuk i kurseu as fëmijët, as pleqtë, as shtëpitë. Çdo gjë u kall në flakë dhe u rrafshua me tokë... Po, kryengritja nuk u shua, jetoi në male. Edhe më keq, zbriti edhe në fshatrat e Kumanovës: Sllupçan, Orizare, Likovë...

Mjetet e informacionit në gjuhën maqedonase i mbushën faqet e tyre të gazetave dhe ekranet televizive me terroristë. E në realitet terrorizëm bënte policia dhe ushtria maqedonase mbi popullatën e pafajshme të cilët nuk i linin vatrat e tyre shekullore. Politikanët shqiptarë vazhdonin jetën e tyre në Qeveri, nëpër ministri me një asht në gojë. Deputeti i popullit të Karadakut H. Sh. mes këtij egzodi të paparë mbi popullatën që ia dha votat do ta lë parlamentin dhe do të dalë në mal, do t'i bashkangjitet UÇK-së. Grusht i rëndë ky për Qeverinë maqedonase... Nënë Parti... Mjetet e informacionit që me javë të tëra do të vazhdojnë t'i mbushin faqet e tyre me shkrime nga lufta... Ekranet televizive...

Kryengritja mori hov maleve. Popullata e fshatrave të Kumanovës si gjithmonë nëpër shekuj edhe kësaj radhe e dha provimin kombëtar, nuk i la vatrat e tyre, po u ngujuan nëpër bodrume. Qeveria mes mjeteve të informacionit u bënte thirrje, u caktonte afate. Po, ata nuk lëviznin asnjë hap nga pragu i shtëpisë... Varret e të parëve... U përballuan të gjithave bombardimeve të artilerisë së rëndë dhe helikopterëve që Qeveria i bleu me paratë e tyre nga Rusia.

Edhe hafiet e Qeverisë vazhdonin me propagandën. E dogjën Manastirin. Tashti radhën e ka Çairi... Çairin do ta kallim në flakë... Gjithë kohën cingërronin telefonat... Kërçnimet... Frika... Brenda një jave u zbraz i gjithë Çairi. Njerëzit ikën sa çelë e mbyllë sytë. Aty-këtu nëpër ndërtesa kishte mbetur ndonjë familje

maqedonase... Edhe Gazi Baba u zbraz... Edhe Bit- Pazarit... Lagjet, rrugët dukeshin si shkretirë. Pak njerëz, pak makina nguteshin si pa kokë...

E nesërmja erdhi si çdo ditë, me diell. Një qetësi e tmershme që të fuste frikën. Vdekje e parakohshme, pa zhurmë makinash, zëra fëmijësh... Qetësi varri...

Ngadalë u ngrita dhe e lëshova BBC-në, lajmet e para të mëngjesit. Komandant Hoxha jepte deklaratë se, nëse nuk i ndalnin goditjet e fshatit Haraçinë me raketa, predha e artilleri, do ta sulmojë Shkupin. Dy aradha ushtarake që i ka UÇK-ja në Karadak të Shkupit dhe Vizbeg, mezi e presin urdhërin e Shtabit të përgjithshëm për sulm.

UÇK-ja arriti në fshat duke u kërcnuar me bombardime në Shkup, nga 10 kilometra largësi në malet e Karadakut. Ajo çoi në armëpushimin e luhatshëm, bisedimet së shpejti u ndërpreu dhe forcat qeveritare hodhën çdo gjë që kishin në arsenalin e tyre për t'i zhvendosur guerilët, ose siç u thonë ata "terroristë të ashtuquajturës UÇK"...

Tri ditë më vonë trupat e NATO-s i evakuan guerilët më falni të "ashtuquajturit terroristë e të ashtuquajturës UÇK", për ta shmangur kërcnimit e luftës civile, pasi që një burim diplomatik e quajti atë, hap i turpshëm. Pjesa më e madhe e fshatit ishte e goditur nga raketat, predhat dhe artileria...

Mirëpo, evakuimi rezultoi në trazira dhe të shtëna para parlamentit në Shkup nga maqedonasit e mllefosur, të cilët besuan se

NATO-ja u ka ndihmuar guerilëve, “terroristëve të ashtuquajturës UÇK”, për t’iu ikur hakmarrjes së armatës e policisë maqedonase.

Kryetari Trajkovski duheshte të apelojë për qetësi dhe të pranojë se evakuimi i ”terroristëve të ashtuquajturës UÇK”, ishte pjesë e planit paqësor në bashkëpunim me perëndimin për t’iu shmangur viktimave ndërmjet trupave maqedonase.

Qeveria maqedonase duhet të kuptojë se nuk mund t’i fitojë kryengritësit, ose siç u thotë “terroristë të ashtuquajturës UÇK”, me granata dhe të shtëna me artileri ndaj luftëtarëve të cilët janë fshehur mirë, asaj edhe mëtej i mungojnë trupa të stërvitura për t’i zhbirosur pjesëtarët e UÇK-së, ose siç ka qejf t’u thotë “terroristë të ashtuquajturës UÇK -ës”, jashtë maleve.

Njësitë e forcave speciale maqedonase, Tigrat, Ujqërit dhe Shkorpionët janë kryesorët, mirëpo janë në numër më të vogël. Këta janë trupat më të mirë që i kanë, mirëpo ata nuk janë aq të mirë ballë më ballë me “terroristët e të ashtuquajturës UÇK...”

Televizioni në orët e vona në Maqedoni është përplot zjarr të pushkëve dhe ” heronj” aksioni, mundësitë supernjerëzore të të cilëve i tejkalojnë të gjitha kufinjt pa ndonjë kompromis.

Fatkeqësisht, shumë maqedonas mendojnë se jeta reale mund ta imitojë televizionin përplot Rambo, duke e mbushur ndjenjën e të dyja palëve të konfliktit etnik se rezultatet politike më së miri sigurohen me pushkë, tankse dhe mortaja... Helikopterë...

Fshati i bombarduar Haraçina, i bëri ballë sulmit të dështuar të Qeverisë për ta zhvendosur të “ashtuquajturën UÇK”, që lufton për të drejta kombëtare. Ata voziten nëpër kodra me xhipa pa kulm, kërcejnë nga xhipi përderisa ai është në lëvizje, gjuajnë me pushkë dhe granata në polici e ushtri, ata janë profesionistë. I mbushin bojlerët me eksploziv dhe i ngarkojnë në kuaj drejt pozicioneve të armikut. E lidhin nga një qen për dore që t’i tërheqë të plagosurit nga fronti i luftës...

Një Rrospi Mashkull në revistën e vet, deklaratën e përfaqësuesit politik të UÇK-së Ali Ahmeti e futë në kornizë në mes shkrimit të Dhëndërit të Doktor Ziut...

Vallë, a duhet njëherë e përgjithmonë të përfundojmë me këtë matrapaz letrar?!... Unë, moti kam përfunduar dhe i kam hedhur në bërlllokun shqiptar...

A duhet besuar ende një njeriu që rrit vetëm bark dhe bythë?! Jo. Kurrë Nuk e di pse në jetë kurrë nuk u kam besuar matrapazave. Shkaku: bytha e tyre gjithëmonë në jetë, si lulja e diellit që rrotullohet rreth diellit, është rrotulluar rreth rroçkodanit...

Gjithëmonë, në jetë na kanë detyruar për të drejta kombëtare, ta shtrijmë dorën në rolin e lypësit. E atyre, kur t’u teket të na e hedhin një asht. Jo, kësaj radhe që i kemi rrokur armët, nuk do ta shtrimë më dorën, po do të jemi ose të barabartë ose ata, pala tjetër tashti e tutje do ta shtrinë dorën. Provojeni edhe ju këtë rol, shihni si u duket vetja në rolin e lypësit. Megjithatë, ne

nuk do të biem në nivelin tuaj, me siguri do t'ju hedhim më shumë seç meritoni si lypës...

Fundi i fundit, ç'fuqi kam të bëj unë si shkrintar para këtij shteti pa shpresë, i mjerë dhe i shkretë, që kur t'i teket promovon “doktorë” shkence duke i shpërblyer me tituj, vende pune e dashnore e duke ua marrë gratë dhe “doktoresha” të shkencës, poashtu me vende pune e dashnorë duke ua marrë burrat?!...

Asgjë. Shtegun e shoh tek e ardhmja, që duhet t'i marrë punët në dorë. Njëherë e përgjithmonë duhet futur shqelmin servilëve, matrapazëve e kulturofagëve të paaftë, që brenda natës i ndërrojnë njëqind fytyra. Nuk na duhet më bërlloku nëpër parti politike, arsim, kulturë dhe mjetet e informacionit... Individë me zgjebe komuniste që kanë shëtitur parti më parti, si kurva burrë më burrë...

Nuk do të më vinte inatë, që këta matrapazë, bërllok shqiptarë të ishin politikanë. Po, fatkeqsisht, këta shiten si “intelektualë”. Inatë ky, që për çdo ditë më shti të vjellë, t'u bie me këmbë si konzerva të shprazura deri në varr...

Papritmas, im Atë e hapi derën dhe u ulë këmbëkryq pranë oxhakut. E hoqi mauzerrin nga krahu dhe e vëndoi në prehër. Kësulën e bardhë e shtrëmbëroi mbi vetullë.

-Erdha përsëri nga varret... Biro, frikë kam pasur se nuk do të ma kalosh mua si prind. Një urti popullore thotë: *t'i ngjash babës është adet, po t'ia kalosh marifet*". Edhe ti trembu nëse nuk ta kalon yt bir. Tashti e shoh se, aty ku e lamë ne, ju e vazhduat me penë e pushkë. E di se, na e

kaluat neve si prindër, prandaj edhe jam i lumtur, po edhe më i lumtur do të jem, nëse fëmijët tuaj do t'ua kalojnë juve si gjeneratë. Nuk do të numrojmë në vend, po do të ecim përpara brez pas brezi...

Shpërthime në Shkup. “Të mërkurën pak para mesnate në Qendrën tregtare ”Çairçanja”, në Shkup ka shpërthyer një mjet eksplozues, që përpos dëmeve të konsiderueshme të disa lokaleve afariste të shqiptarëve, nuk pati viktima, edhe pse në këtë qendër gjatë kësaj kohe mbliidhen të rinjtë shqiptarë...

Ndërsa gjatë natës në lagjen “Kisella Voda” të Shkupit kanë eksploduar dy bomba me ç’rast është plagosur një grua maqedonase.

Policia ka filluar me hetimet, ndërsa deri më tani nuk ka indikacione se kush ka mundur të jetë ekzekutuesi i këtyre shpërthimeve. Nuk ka njohuri nëse bëhet fjalë për shpërthime të njejta”...

Në fund, pasi i dëgjova lajmet, më erdhi në telefonin tim celular një përshendetje: “Në Çairçane bombë...” E kërkova numrin që ma dërgonte lajmin. Matanë, mu përgjegjë në gjuhën maqedonase një zë i dehur burri... E mbylla celularin. Pas një kohe, i njejti numër ma dërgonte mesazhin: “më falni – gabim”...

Dita e sodit nuk e kishte këtë barrë, prandaj edhe më dha kohë që ta shfletoj gazetën. Në mes të titujve ma tërhoqi vëmendjen: **“Plumba të argjendtë për politikanët shqiptarë.**

Me letra kanosëse UÇK-ja ka porositur deputetët shqiptarë në Parlamentin e Maqedonisë

që të marrin shembullin e deputetit Hysni Shaqiri, i cili para dy muajve iu është bashkuar aradhave të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Sipas shërbimeve të fshehta maqedonase, ka njohuri se pjesëtarët e UÇK-së tanimë disa muaj, nëpërmjet letrave apo thirrjeve telefonike, iu kanosen me likuidim edhe liderëve shqiptarë në Maqedoni.

Letra të tilla kanë marrë Menduh Thaçi dhe Arben Xhaferi, ndërsa këtyre u janë dërguar edhe “plumba të argjendtë” – që do të thotë dënim me vdekje.

Poashtu këto ditë letra dhe plumba të argjendtë kanë marrë edhe anëtarët e PPD -së, sepse kanë pranuar që të marrin pjesë në qeverinë e re. Gazeta “*Dnevnik*” shkruan se pikërisht për shkak të këtyre kanosjeve Naser Zyberi nuk ka pranuar të jetë ministër...

Pesë ditë e pesë netë e mbylla veten në dhomë mes librave. Shtambave me verë, që pasi i ngreja me fund i hudhja për dritarje. Njeri i gjallë nuk ma hapi derën. E rrotullova gjithë banesën bythekrye nëpër dhomë. E zbrasa frigoriferin. Byfenë, që nuk lash shishe alkooli më këmbë. Gjithë kohën të vetmen rrobe që e kisha, ishte një këmishë e bardhë deri në fund të këmbëve. Tri katër herë në ditë e zhvishja atë dhe e hudhja në mes të dhomës për të bërë banjo, larë djersët. E si për inat, këto ditë gushti vapa më shtrëngonte pamëshirë mes mureve. Herë pas here, edhe atë pasmesnate Zonja Vdekje ma hapte derën. E ngrënim me të së bashku nga një doll, lexonim poezi dhe hiqnim valle. Dikur nga mëngjesi, mua

kur do të më rrëzonte mes librave agimi, ajo do të përvidheshte tinës nga dhoma ime, do të ma mbyllte derën dhe do të dilte nëpër qytet...

Ora dymbëdhjetë. I hapa sytë, e kisha bërë gjumin e të vdekurit. E mora tabutin në shpinë dhe dola në oborr. Posa shkela në park, mu turr zhurma e fëmijëve. Gjallëri kjo, që më dukej se më kishte munguar me vite. Eca. Teposhtë rrugës e pash se edhe qyteti ishte gjallëruar. Ishte kthyer në gjendjen e mëparshme. Njerëz, makina turrehin si pa kokë në rrugë. Çudi, thash me vete me njerëzit. Edhe këta janë si dhentë, njëra të kërcejë në lumë dhe të gjitha njëra pas tjetrës në hurdhë. Posa ishin dëgjuar krismat e para në Tetovë, të gjithë kishin ikur nga sytë këmbët. E shi tashti, kur rreziku i luftës ishte edhe më i madh, UÇK-ja priste vetëm urdhërin dhe ta sulmonte Shkupin, ata ishin kthyer nëpër shtëpia. Vallë, thua ishin mërëzitur dyerve të huaja, apo ishin mësuar më me krismat e luftës. Nuk e di. Me rëndësi është që Shkupit përsëri iu kthye jeta. Lojërat e fëmijëve... Zhurmat e makinave... Frika dhe trimëria...

Edhe Rrapit i ishin kthyer banorët e zakonshëm. Në mesin e tyre edhe "patriotët" kuqezit. Rrospitë Meshkuj që i kishin munguar disa muaj. Trusakatët. Tashti, ata ishin ulur kokë më kokë edhe me trima duke rrëfyer për trimëritë e atyre të maleve. Ndonjëri edhe duke u lënduar se ka lidhje me ta, mbledh lekë dhe shpërndanë armë...

Unë që kryeja obligimet e rregullta mes shtambave të verës, që dija shumë gjëra dhe i

njihja këta “patriotë“ kuqezi, pak gjë u besoja rrëfimeve të tyre patriotike. Nën Rrap erdhi edhe Kulturofagu, që gjatë ndryshimeve demokratike me “vëllezërit”, tureshte qytet më qytet me moton: “*ejani të bisedojmë*”. Fatkeqësisht, këtij dialogu i printe një antishqiptar i tërbuar, Dhëndëri, hartues edhe i Kushtetutës së Maqedonisë. E shi sot, ky ”patriot” e ngrente zërin më së shumti në mjetet e informimit në duel me qëndrime të kundërta rreth disa temave, si rrezikut për një luftë qytetare në Maqedoni, propozimin e ASHAM për këmbim terriotoresh dhe popullatash, për zgjidhjen e konfliktit në Maqedoni etj.

Nën Rrap erdhi edhe Matrapazi me mjekër të Cjapit, që e fshihte fytyrën apo matrapazllëqet e tija në këtë kohë të vështirë. Matrapazi politik që ta bindë opinionin se në gazetën e tij të “pavarur” nuk ka cenzurë dhe është patriotike, i ftonte në debat publik në mes të tjerave edhe shkrimtarët për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë?!...

E dikur, kur kësaj “oferte“ nuk i përgjigjej asnjë shkrimtarë me përjashtim të ndonjë kalemxhiu, që pesëdhjetë vjet kishte punuar kundër vetëvetes e shi tashti, përpiqej të na shesë patriotizëm. Matrapazi politik edhe njëherë do të bëhet i gjallë po në gazetën e vet, te editoriali i njohur gjatë luftës: **“Intelektualeve shqiptarë, nuk u nevoitet Kushtetuta!...”**

O Imzot, më shpëto nga këta “ patriotë” kuqezi!... Rrospia Meshkuj... Kokat e tyre të mbushura me kashtë... Truri i tyre plot krimba. Bythët e tyre, që si lulja e diellit që sillet rreth

diellit ata sillen rreth roçkodanit... Haletë që ma zënë frymën, ma qelbin Rrapin!...

Përditë e më shumë vjell "patriotë" kuqezi... Rrospi Meshkuj... Trusakatë... Frikë kam se një ditë do të mbushet Rrapi... Bit Pazari... Shkupi... "Patriotizmi" i tyre do të më detyrojë të ik nga Rrapi... Atdheu... Liria...

Mëshirë, o Zot! "Patriotizmi" i tyre më ndjek kudo, në rrugë... Nën Rrap... Dhomën time me libra... Në një varg në të cilin e kërkoj varrin. Vetëm pak ma hapni dritaren, shtegun e maleve, të fluturoj drejt qiellit. Majën, nga e cila do ta thirr diellin... Shiun... Rrufetë...

Dita e Ilindenit të tretë 2 gushti 2001 në Shkup kaloi pa zhurmë, pa flamuj shtetëror. Mjetet e informacionit në gjuhën maqedonase bënë shumë poterë për Shkupin që e gëdhiu festën me dy-tre flamuj nëpër institucione. E të mos flasim për Tetovën pa asnjë, ku vendin e tyre e kishin zënë flamuj kombëtarë me shqiponjën e zezë dykrenare.

Reporterja e Televizionit maqedonas derdhte lotë krokodili edhe për të zhvendosurit që i kishin strehuar nëpër hotele, e asnjë organizatë humanitare nuk u kishte dërguar ndihma. E kur ishte rasti i refugjatëve kosovarë Qeveria i priti me banane, që mu ata sot të na e kthejnë pushkën...

Papritmas cingërroi telefoni celular:

-Alo, mirëdita...

-Mirëdita. Përsëri ishte Patrioti i Vonuar.

-Po, ku je ti që nuk më bën as një telefonatë?!

-Ja, nën Rrap, në Shkup.

-Ne, do të vijmë edhe në Shkup... Për të gjitha do të na jepni llogari... Po, si është atje situata?!

-Shkupin e kemi çliruar shtëpi për shtëpi... Kufirin e kemi te Ura e Gurit... Tashti na ka mbetur edhe Gostivari... Pastaj, përpak harrova të të tregoj se në “*Flakën e mjerimit*” një poete ta ka kushtuar një poezi...

-E, a e ke aty afër gazetën, lexoma ndonjë varg!

-Ja, me gjithë dëshirë:

*Ky “Patrioti “ një ballist i ri
Po lufton për Maqedoni
Për Maqedoni , o për Serbi
Po do me e bashkue këtë shkini...*

-Vetëm kaq, a?!...

-Jo, ka ende. Është e gjatë poezia...

-E pse nuk ma lexon gjithë, deri në vargun e fundit?

-Jo , më mirë kur do të vish vetë, e lexon varg për varg...

-Mirë, atëherë. Nesër, do të vij në Shkup...

-Patjetër, e kemi vendosur me poeten të të presim si hero lufte... Nuk është çudi edhe Nëna Parti të të bëjë ndonjë befasi... Ku ta di unë, ndonjë post më të lartë në redaksi... Ose, do të të emërojë ambasador në Bullgari...

-Çka?!...

-Nuk e di. Përshpëritet për një post në redaksi... Vetëm duhet ngutur, një koleg i yti i ka rënë në erë dhe i sillet rrotull Nënës Parti...

-E di unë atë komunist, është i poshtër. Por, kësaj radhe është vonuar në nuhatje. Veprime patriotike... Erdha nesër. Mirëupafshim!

-Mirëupafshim! Të presim...

Dialogu politik për dalje nga kriza në vend, në Ohër, që zvarritej me javë në mes të katër partive politike dhe të dërguesve specialë Fransua Leotar, Xhems Perdju dhe Maks van der Shtul nën ombrellën e kryetarit të shtetit Boris Trajkovskit ecte ngadalë, me këmbë të breshkës. Ngjarjet e fundit në Maqedoni ngjallën dyshim... Frikë... Luftë...

Sulmi në Karpallak rrezikoi dialogun. Tetovën e mori nën kontrollë UÇK-ja. Rrugët janë plotësisht të zbrazura, kurse dyqanet dhe institucionet shtetërore janë mbyllur që në mesditë. Lufta i mori me vete edhe disa të vrarë e të plagosur nga ky qytet...

Luftë. Shkupin nuk e merr gjumi... Kërcnime... Krisma të herëpashershme nëpër natë. Vrasje në gjumë... Protesta para Parlamentit maqedonas. Demolime dhe vënja e zjarrit dyqaneve të shqiptarëve. Thirrje për armë...

O imzot! Askush nuk e di çka fsheh natën ky qytet. E mbyll derën me çels dhe bie në gjumë me frikë. Nuk e di se si do ta gëdhish të nesërmen, me kafën e mëngjesit mbi kokë apo me tru të derdhur nëpër dhomë. Dyshimi sa që vjen arrin kulminacionin. Shtegu shumë larg, për të ikur frika. Zonja Vdekje për çdo ditë më turret pas këmbëve:

Nuk ke ku do të më ikësh, në mos sot, nesër do të ta zë udhën...

VAJE PËR POSTIN

(Partizanëve partiak në prag të zgjedhjeve)

Dhe, Djemnusha më shkruan në një mesazh para Vitit të Ri:

Ujk, deri në ora 18.00 jam në këtë Qytet... Eja para Vitit të Ri!... Babadimrit, me sajë e një thes dhurata...

Unë e vras mendjen çka t'i them, shkruaj Xhadisë? Nata më duhet mua të arratisurit! Nata. I përgjigjem me një mesazh:

Heeej, edhe njëherë, gëzuar Viti i Ri! Nuk deshi Zoti që sot të vij në Tyrben e Babashehut. Varrin e tij me libra. Dhe, t'i rrokullisim së bashku deri në agim disa shtamba me verë para këmbëve të Babadimrit... Vitit të Ri...

Megjithatë, Viti i Ri i ka 365 ditë...

Në ndërkohë, me telefon më paraqitet gazetari i rubrikës së kulturës, emisionit javor në Radio Shkupi.

- Alo, jam udhëheqësi i emisionit *Mozaiku Kulturor*. A kishe pranuar nesër mes telefonit të jesh mysafir i këtij emisioni. Tema është: *kultura shqiptare gjatë këtij fundviti*.

- Me gjithë qejf, po viti 2008 si Lidhje e Shkrimtarëve shqiptar, më tepër ka qenë si vit takimesh, reagimesh, e shumë pak organizimi të aktiviteteve kulturore. Vit i mbrapsht si Ditët e Plakave në fund të marsit...

- *Nuk prish punë. Me rëndësi është, nesër të jesh mysafiri jonë drejtpërdrejtë nëpërmes valëve të Radio Shkupit.*

Dhe, u pajtova. Shkaku se, ky ishte i vetmi emision kulturor në gjuhën shqipe, që i përcillte me rregull aktivitetet dhe ngjarjet tona kulturore. Njëherit, edhe i vetmi emision kulturor në IRJ të Maqedonisë që nuk ishte i politizuar gjër në palcë nga partitë tona politike “demokratike”.

Të nesërmen, heret gjatë emisionit: Mozaiku Kulturor, cingërroi telefoni:

- *Mirëmëngjesi! Moment, qëndroni në lidhje! Muzikë: një këngë popullore. Në fund të këngës u paraqitë gazetari: Mozaiku Kulturor, jeni në valët e drejtëpërdrejta të Radio Shkupit. Aktivitetet kulturore dhe sukseset e Lidhjes së Shkrimtarëve shqiptar, në Maqedoni gjatë vitit 2008?*

- *Tungjatjeta! Pikësëpari i përshëndes dëgjuesit e Radio Shkupit! Njëkohësisht, edhe realizatorët e këtij programi! Viti 2008 qe vit i mbrapshtë për Lidhjen e Shkrimtarëve Shqiptar në Maqedoni. Po, jo edhe për Kalosh Çelikon si shkrimtar, që ia vodha një poemë humoristike për fëmijë: *Dac Poeti i shkruan poezi Mamit, Ehu* (poezi) dhe *Gruaja besnike* (roman). Njëherit, edhe një çmim letrar “SEREMBE“, që e ndanë Komisioni letrar i Klubit të Shkrimtarëve të Laçit, në Shqipëri.*

Në IRJ të Maqedonisë çdo gjë është e politizuar. Edhe arsimit edhe kultura. Edhe buka. Edhe uji... Shtet, ku partitë politike shqiptare më shumë merren me “aktivitete kulturore” përpara

zgjedhjeve parlamentare, se sa me politikë. Vështirë e kemi ne si institucione kulturore të marrim lirisht frymë. Partizanët e tyre me yll të kuq në ballë, na kanë ngulfatur, rrokë me të dyja duart për fyti...

Në konkursin e shpallur nga Ministria e Kulturës në IRJ të Maqedonisë për vitin 2008, për manifestime kulturore dhe botimin e librave, ne si LSHSH konkuroam me dy manifestime kulturore tradicionale ndërkombëtare: TAKIME NËN RRAP, në Shkup dhe Ditët e humorit dhe satirës: XHA DERALLA, që organizohen në Kërçovë. Për shkak të një kritike që i bëme ministrit të atëhershëm shqiptar, Arifikmet Xhemaili, nuk u përkrah asnjë manifestim kulturor.

Dhe, jo vetëm kaq. Ne sipas konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës së Maqedonisë, konkuroam edhe me nëntë tituj në poezi e prozë dhe revistën letrare STILI 97, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar.

Fatkeqësisht, edhe këtu nuk gjetëm përkrahje, asnjë botim nuk u morë parasysh nga Ministria e Kulturës. Përmëkeq, nuk e përkrahën as revistën letrare STILI 97, që deri në këtë vit kishte pa dritën nr. i radhës, 49/50.

Shkurt, nga Ministria e Kulturës në IRJ të Maqedonisë me ministrin shqiptar në krye dhe tre këlyshët e tij me zgjebe, njëri shef kabineti (A. H.), tjetri këshilltar i ministrit (N. A.) dhe i treti anëtarë komisioni i botimit të librave (A. M.), gjatë vitit 2008 nuk lëshuan asnjë denarë në llogarinë rrjedhëse të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në Maqedoni, me seli në Shkup.

Përmëtepër, këta këlyshë me zgjebe, nuk e lanë me kaq, po iu hakmorrën edhe Shtëpisë Gazetare Botuese “ASDRENI“, e cila për programin e vitit 2008, kishte konkuruar në Ministrinë e Kulturës me rreth njëzet tituj në poezi e prozë dhe një revistë humoristike “ZEKTHI“, që këtë vit pritej të shënojë dhjetëvjetorin e daljes në dritë. Nuk e panë të arsyeshme si partizanë partiak të marrin për botim asnjë titull.

Megjithatë, si ngjarje e rëndësishme kulturore këtë vit që, mbajtja gjallë e revistës letrare: STILI 97, nr 49/50, që e ndihmoi materialisht im Atë: Emin Çeliku. Numri jubilar i përkushtohet poetit martir, Sadudin Gjura.

- *Në fund, çka prisni nga viti 2009?*

- Dhashtë Zoti, vitin që vjen, arsimit dhe kultura shqiptare zhvishet nga politika ditore partiake dhe vishet me vlera kulturore e arsimore!... Njëherit, juve si redaksi dhe dëgjuesve të rregulltë të Radio Shkupit ua uroj Vitin e Ri!...

Dhe, mirë u dëgjofshim e u pafshim në vitin 2009, që e kemi në prag!...

Ditën e nesërme, Ebu Fakirin e takova në rrugë. E ndali makinën. Unë i thelluar në mendime, kthehesha nga zyrat e Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar. Me siguri kishte menduar se shtihem, gjoja nuk e shoh dhe nuk dua t'i flas me gojë. Po, nuk ishte kjo e gjithë historia. Unë ecja rrugës më këmbë, ngase xhipin e kisha shitur për të mbajtur Manifestimin Kulturor Tradicional

ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, rrëzë Kalasë, në Shkup.

- Mirëdita! Unë nuk jam nga ata personazhet e tu nëpër libra.

- Jo, po nuk të pash. E gënjeva. Njeriu sheh me tru dhe jo me sy. Njëkohësisht, thashë me vete: si më kishte shpëtuar Ebu Fakiri pa e futur mes faqeve, në libra!...

- E di. Po, mu duk se nuk do të përshëndetesh me mua. Ti e di se unë nuk jam nga ata personazhet e tu nëpër libra.

- Dhe, u ndamë ftohtë me Ebu Fakirin. Personazhin, që ende nuk kishte hyrë si burrat me pashterka në libra.

Rrugës mu kujtua edhe libri im me satira: *Trumbetat e Tellallit*, që e pa dritën më vitin 1992, në prag të ndryshimeve demokratike dhe çoi mjaftë pluhur në koluaret e atëhershme intelektuale dhe politike. Libri, që më dërgoi edhe në një bisedë informative në polici. Poashtu, edhe shkrimi i mikut tim poet rebel Fadil Bekteshi, që e përshëndeti daljen e këtij libri në dritë me një reçension në revistën e tij të parë të pavarur letrare të asaj kohe, Doruntina.

Ebu Fakiri, atë ditë ma kujtoi edhe shitësin e gazetave, Musën, që e shiste këtë libër edhe nëpër Çarshi. Ebu Fakiri se si, e kishte ndalur në rrugë, i kishte thënë: e di se kush e ka finansuar këtë libër? Jo, ë, o trap!... Policia...

Musa, gazetëshitësi ma rrëfeu edhe këtë vepër patriotike të Ebu Fakirit. E kuptova se ishte këlysh me zgjebe, nëntoka e Mafisë letrare në Maqedoni.

Vitet kalonin, e Ebu Fakiri kurrësesi të dalë nga biruca e nëntokës, japë ndonjë shenjë, punonte në “ ilegalitet “. Një ditë, vetë do ta heq maskën e patriotit. Pavetëdije do të dalë bythekrye në sipërfaqe, lakuriq e pis ashtu siç e kishte pjell Kurvë Partia...

Ne shqiptarët, që Ebu Fakirit njëzet vite nuk ia kishim dëgjuar zërin, tashti në gazetë e nxorri bythën për mejdani. Edhe atë, kur iu rrezikua taxhia...

Njëzet vjet Ebu Fakiri na ishte shtirë me fytyrë Engjëlli, na kishte marrë në qafë, e në të vërtetë ai kishte qenë, vetë Dexhalli me brekët mbi pantollona...

Në një gazetë të përditshme, që delë vetëm para fushatave zgjedhore, do të botohet edhe ky shkrim teknefes: *Shqiptarët të “zhveshur“ nga buxheti për kulturë.*

U. S. : ... *“Gati thuajse shqiptarët do të mbeten të harruar nga kjo ministri, madje të nënçmuar, e cila tashmë pa ndonjë person vendimmarrës për kulturën shqiptare nuk do të ketë sinjale pozitive se do të ndryshojë diçka në këtë drejtim.“*

Viçat e palëpi. Përpiqen t’i dalin zot një ish miniministri gjysëmanalfabet (A. Xh.). Ish këshilltarit të tij, (N. A.), ish shefit të kabinetit të tij, (A. H.). Dhe, një viçi tjetër të palëpi, anëtarë komisioni në botimin e librave, (A. M).

Dhe, do të vazhdojë shkrimi teknefes:

A. H. : ... *“Sipas tij, derisa para dy viteve të kaluara 2006 – 2008 kur ishte ministri nga shqiptarët nuk ishte keq me aktivitetet kulturore të*

shqiptarëve dhe ndahej buxheti tamam në mënyrë proporcionale... Sipas tij, partia në pushtet dhe kuadrot e saj jo që nuk kanë angazhuar asnjë funksionerë shqiptarë në këtë minsitri, por edhe ata që ishin në udhëheqjet e njësisive apo sektorëve u degraduan, kështu që shqiptarët nuk kanë asnjë qasje jo vetëm në ministri të kulturës, por as në aktivitete kulturore...“

Jo. Jo, o viç i palëpi! Vdiq koha, kur ti me duar, këmbë e bythë, i harxhoje paratë e popullit për shëtitje private në emër të tij, e botoje librin tënd sakat në Bullgari. Gjatë një viti bëje pazarë për dramën e tua tekenfese, dhe të vëllait tënd të luhen në dy - tri teatro duke i blerë edhe çmimet letrare. Ti e fute veten në redaksinë e projektit të Qeverisë: Letërsia maqedonase (Makedonska knizhevnost) edhe vëllain tënd bashkë me shokun e juaj të shëtitur nëpër redaksi komuniste për ta emërtuar Letërsinë shqipe në Letërsi maqedonase dhe sakatuar deri në palcë. Ju, viçat e palëpi, (pa asnjëfarë bagazhi letrar), që mezi u njeh nëna e juaj, e ku më katundi...

Viça të palëpi, ju që u përpoqët ta shuani edhe të vetmin Manifestim kulturor Tradicional ndërkombar: TAKIME NËN RRAP, që mbehet njëmbëdhjetë vjet me radhë: në Shkup. E keni sakatuar vite me radhë Letërsinë Shqiptare me kokën te “vëllezërit“ e bythën nëpër parti politike...

Vajtoni natë e ditë në mjetet e informacionit. E derdhni lotë krokodili. E kërkoni të djeshmen. Kurvën Parti, që në kontejnerë të bërlllokut jep shpirt. Cofë. Dhe, ma kujtoni

poezinë e Çajupit: *Vaje*. Vargjet, ku Çajupi e vajton Evgjeninë. E ju, viçat e palëpi Kurvën Parti:

*Gjith' humbasin Kurvën, postin dhe sahanë
Po, ata që mbetën, si ju nuk qanë.
Të Vdekurën lotët s'e bien në jetë,
Po, lutuni dhe faluni t'i rrisni bythët vetë.
Doje dritë, oj Kurvë, moj pjellën trime,
Dhe, na e mbushe jetën plot me hidhërime!...
Tani rrojmë pa shpresë, s'duam të rrojmë
Se dhe Kurvë Partinë tani s'e besojmë!...*

Rrugës nëpër Çarshi e takova Tatën e Madhe me një shkop në dorë. E kishin bërë të flas vetmevete: **Dumdumë, janë fund e krye. Rrufjanë. Nuk i shohin shenjat, zërat që na i dërgojnë të vdekurit. Pulën me zogjë. Yllin e mëngjesit... Shkopin, që unë e kam ngritur në dorë rrugës për në Baba Tomorr dhe dua t'i zgjojë nga gjumi shekullor. Mendja ma thotë se, janë të vdekur, nuk ringjallen si Krishti... Ose, të fluturojnë si Azreti Isai nga minarja e xhemisë në Qiell...**

Dhe, kanë vdekur për së gjalli...

Tata e Madhe, posa më pa mua në rrugë e ngriti shkopin:

- Heu, Kalosh Çeliku! Cila është Gruaja jote besnike?!

- **Hi-hii-hiii... Kurva Parti!...**

VETËDIJA

Kurrë më shumë se deri më sot, nuk kanë pasur nevojë shqiptarët që të kenë një popull me vetëdije kombëtare. Nuk e them, që ky popull nuk ka vetëdije, ka edhe atë: e ka dëshmuar brez pas brezi nëpër luftëra, po është koha ta vë në përdorim edhe në këtë ditë të sotshme historike. Atdheu, kur është në rrezik! E them këtë se, vetëm hidhni një sy Shqipërisë Etnike: e coptuar copë – copë në disa shtete. Përmëkeq, shqiptarët edhe në këtë Ditë historike vazhdojnë ta vërtetojnë atë thënien e itajlanëve: “tuto albanezi, tuto komandanti”. Ose, atë thënien e popullit: dy shqiptar, tri parti politike.

Përmëkeq, shqiptarët edhe sot e kësaj dite janë të përçarë nëpër parti politike. Një Parti Neokomuniste gjatë njëzet vjetëve i polli me dhjetra parti të tjera kopileshta “demokratike”. Fatkeqësisht, të njëtit individë njëzet vjet me radhë bëjnë akrobacione politike duke shëtitur parti më parti si kurva burrë më burrë. Dorën në zemër, kurvës edhe i ka hije. Po, jo edhe këtyre rrospive meshkuj me pashterka të kuqe, që gjatë natës na i flukin kopilat pas dere. Ose, nga pangopësia përditë themelojnë parti të reja politike duke vazhduar ta përçajnë këtë popull edhe nëpër katunde. Fatkeqësia më e madhe: gjithë këtë e bëjnë në emër të popullit dhe për popullin shqiptar. Populli i shkretë, sot e ka humbur rrugën në oborr. Nuk di pas kujt të eci,

cilit t'i besojë ose t'ia japë votën e lirë. Kohë shterpë kjo, kur Gomari Babatasit i At Gjergj Fishtës i pri para këtij populli nëpër fushëbeteja për Liri. Rrugëdalja, pajtohet me fatin, ende t'i prinë këta hajdutë politikë duke e vjedhur me duar e këmbë popullin dhe pasuruar veten, një rreth të ngushtë familjar, miqsor e klanor, grupe interesi partiak nëpër kabinete të Qeverisë.

Burrat e botës e shkatërruan arsimin edhe më zi se në kohën e komunizmit. Kulturën shqiptare. Pasurinë e popullit. Intelektualëve të vërtetë ua kanë mbyllë të gjitha dyert e gojën. I kanë hedhur në rrugë si të papunë. I kanë mbushur radhët e tyre me patriotë të rrejshëm e gjysmëanalfabetë. Institucionet e shtetit me pseudointelaktualë, partizanë besnik të partive politike që turren me të katra pas posteve dhe pasurisë të popullit. Përditë në fabrikat e tyre universitare prodhojnë me shumicë e pakicë trusakatë me diploma universitare e tituj shkencor. Që, të nesërmen të kenë numra në kopenë e tyre me zgjebe për duartrokitje dhe votime “të lira demokratike”. Dele të buta, qafërjepura që t'ju prinë në “fitore” edhe katër vjet të tjerë nëpër beteja të “përgjakshme demokratike”. Gjatë zgjedhjeve lokale e parlamentare janë plot fantazi, çka nuk bëjnë si Parti Neokomuniste. Edhe të pamundshmen e bëjnë të mundshme si në përralla: ndërtojnë rrugë, hapin shkolla, universite, xhamia me dy e katër minare, kisha ortodokse, fabrika, vende pune, sheshe, përmendore... Ndonjëri, më “guximtari” (vojvoda) edhe pa fije turpi në këtë

“Shqipëri të Maqedonisë”, siç shkruan nëpër kolumnat e tija teknefese Patrioti i Vonuar thotë: Tashti e shohim se gjatë këtyre njëzet vjetëve kemi bërë gabime në politikë. Nëse, ne na e jepni votën e lirë, ne kësaj radhe në Kuvend shkiet do t’i ulim në të dy gjunjt. Tjetri: kur shkuan pas votave në një fshat malor u tha të pranishmëve mes të tjerave premtime edhe se: do t’ju ndërtojme edhe shkollë moderne me kabinate e sallë sportive. Fshatari i urtë duke mos e duruar më këtë demagogji të shekullit, bërtiti nga fundi i sallës: po, ne zoti kryetar nuk kemi fëmijë?! Edhe fëmijë do t’ju bëjë Partia, u përgjigjë kryetari.

Përçudi, populli shqiptar pas gjithë këtyre demagogjive të shekullit, kam frikë se edhe kësaj radhe lehtë do të mashtrohet, japë votën e lirë hadumëve. E ata, posa t’i “fitojnë” zgjedhjet do të ulen nëpër poste të vazhdojnë jetën e argatit në Qeveri. Lypsit te Ura e Gurit për të drejta të barabarta kombëtare me “vëllezërit”. Premtimet parazgjedhore i humbën rrugës, gjatë dyluftimeve të tyre për karrige. Pasurisë së patundshme. Tenderëve. Gurë e dru do të hedhin mbi ta si mashtruesë të popullit. Përsëri do t’i pagëzojnë me lloj-lloj epitete: tradhtarë, njerëz të shitur, spiunë, hajdutë, argatë, sahanlëpirës...

Turr nga Shqipëria Nënë në ndihmë, Kosova dhe Amerika t’i bashkojnë në një subjekt politik, të dalin bashkë në fushatën e parazgjedhjeve parlamentare. Paskal Milo në një përvjetor të shënimit të demonstartave të ’81 – shit, në Tetovë ua ringjalli xhaxhin Enver. Përpak ai burrë pushteti, kur i pa në këtë gjendje të

mjerueshme desh ua preu kokat edhe këtyre partizanëve të vonuar, por kësaj radhe jo mes kënetave të Maliqit me lopatë, po në sallë mes Tetovës duke ua hedhur para këmbëve si cungje shelgu. Mezi e ktheu prapë mes varreve, në histori plaku i urtë, Sabri Godo. Shoqata joqeveritare “REALITETI” Para zgjedhjeve parlamentare e gdhii veten në Parti politike. Ende pa filluar fushata zgjedhore përfundoi këmbekokë në PDSH duke fituar “pëllumbi postier” i tyre një kandidaturë deputeti në listën e Nënës Parti. Edhe Shoqata tjetër joqeveritare “ZGJOHU” me shkop në dorë e torbën në krah u përpoq t’i bindë liderët partiak që të dalin bashkë në zgjedhje duke trokitur derë më derë të partive politike shqiptare. Në fund, e dëshpruar ndoqi rrugën e “REALITETIT”, doli me një deklaratë para këmbëve të Skënderbeut në Bit-Pazar: edhe ne gjatë kësaj fushate parazgjedhore i bashkohemi në gara Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Bashkimit Demokratik për Integrim.

Qesha. Dhe, them me vete: po, në fillim të viteve '90 -ta, në prag të ndryshimeve demokratike, këta “burra mejdani” ishin bashkë si një trup e kokë në themelimin e PPD -së, në Tetovë. Përrjashtim këtu bënte vetëm Ali Ahmeti me shokë. Në atë kohë erdhën gra e burra nga të katër anët e botës nga toka e qielli me aeroplanë special në votime. Kurrë populli shqiptar nuk ka qenë më i bashkuar se atë ditë në atë kohë historike. Edhe Sheshin e Shkupit e mbushën me kësula të bardha e flamuj kombëtar kuqezi. Vetëm, tjetër është ajo se, ky bashkim kombëtar

nuk zgjati shumë kohë. Plasi sherri për interesa të ngushta personale, ose hyri Dreqi në mes të “patriotëve” kuqezi. Nëna Parti çdo katër vjet, gjatë zgjedhjeve të reja pillte kopileshta pas porte. E përçanë popullin shqiptar, mos Zot më keq! Njëzet vjet me radhë të njëtit “patriotë” kuqezi i ngatrron popullit shqiptar nëpër këmbë. I hipin për çdo katër vjet mbi shpinë si gomarit të Nastradinit nëpër beteja: herë i hip Nastradini e herë Nstradinica. E kanë rrëzuar me të katër këmbët në batak. E ky edhe sot e kësaj dite, nuk e hedhë samarin, barrën nga shpina. Bythekrye t’i hudhë trusakatët në baltë.

Halli?! Halli është, si të dilet nga ky batak që e kanë rrëzuar vite me radhë këtë popull heroik në baltë politikanët trusakatë?! Nateditë i prinë me premtime në Qorrsokak. Fare lehtë. Ende, nuk është vonë, ka rrugë. Nuk duhet të bëhet përpyekje më për t’i bashkuar këto parti politike teknefese në të ardhmen. Shkaku se, i ka pjellë një Nënë Kurvë pasmesnate në grazhdin e “vëllezërve” të Njerkës. Arsye që, edhe të nesrmen na dolën kopileshta, na shitën shumë lirë te “vëllezërit” pa pare. Tekefundit, edhe nuk ka burrë nëne që i bënë bashkë këta pjella mushke, përveç vetë popullit shqiptar.

Gjeniale. Vetëm populli shqiptar i bënë bashkë këto kurva politike duke mos ua dhënë më votën pas fushatës parazgjedhore partive politike, po kandidatëve që e kanë dëshmuar veten në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Patjetër ky popull, këta trusakatë një ditë në një të ardhme të shpejtë duhet t’i hedhë si bërlllok shqiptar në koshin e

plehërave të historisë. Dhe, të nesërmen të lindë një Shotë Galicë me burra të tjerë lufte për Shqipëri Etnike. Pse jo, edhe një Bajram Curr? Ismail Qemal. Isë me dy kobure. Ded Gjo Lul. Mihail Grameno. Sulltanë Qafë, Kalosh Zajaz e Adem Jashar me gjithë mitraloz me dy këmbë... Gjak i ri shqiptari, që edhe sot i qarkullon nëpër damarë këtij populli heroik nëpër shekuj.

Koha është, ky popull t'i dalë para Lirisë, pres Ditën e Madhe. Fatmirësisht, për inatë të partive politike shqiptare, ajo Ditë është duke ardhë rrugës me bajraktarin përpara koçisë. Dhe, këngën e Djemëve të Shalës, përmes Sarajeve të Pashait.

Nusen do të na e zbresin në Lëmë këta kurshq e krushka me pushkë, këngë e valle një Ditë. Edhe me dajre e lodra. E ajo ditë nuk është larg, zbret maleve. Ylli i mëngjesit (Adem Jashari) e paralajmëroi agimin. Diellin duke zbritur maleve. Ditën e Madhe Shqiptare...

HUMBËN SHQIPTARËT – FITUAN PARTITË POLITIKE

Dhe, e dini, çka?! Jo, nuk e dini. Madhështore është Dreka festive e “Fitores” pas zgjedhjeve parlamentare me një maçorr. Dhe, një mace nën Rrap. Asnjëri nuk kemi librezë partiake, nuk i takojmë ndonjë parti politike. Megjithatë, edhe ne i takojmë një parti më të madhe demokratike: Partisë Popullore të Shqiptarëve. Përmëtepër, maçorri dhe macja janë patriotë të dëshmuar në Bit-Pazar me mustaqet vesh më vesh. E duan Rrapin, komandantët e vet heroik të luftës. Shkaku se, vetëm nën Rrap kanë liri, ushqim ndonjë asht kur politikanët ua hedhin nën tavolinë si shpërblim.

Armiqtë më të mëdhenj të kësaj shoqërie, shtetit – kishin qenë “patriotët” kuqezit me një torbë taxhi për qafe. “Patriotët” analistë që nuk kishin ditur vite me radhë në “demokraci” se, cila Nënë i kishte pjellë në mes të Dimrit. Nuk prituan edhe kësaj radhe të shkruajnë (arsyetojnë veten si vizionerë), hedhin fajin popullit shqiptar në mjetet e tyre të “pavarura” të informacionit: **“Fituan shqiptarët, humbën partitë.”** Edhe atë: nga autori papagall (Patrioti deledash i vonuar). Autori i kollumnave, që gjithë kohën i thirrte shqiptarët në këto zgjedhje për bojkotim. Bërlloku shqiptar, që merr guximin ende të shes mend se kush ka fituar e kush ka humbur në këto zgjedhje parlamentare. Edhe thotë: “votuesit u

ndjenë të kënaqur, ngaqë jo vetëm që shëtisnin falas nga një qytet në tjetrin, por shumica e tyre morën nga 50 euro nga më shumë parti, e që pastaj të mos votonin për asnjërën. Madje, edhe pse më të dobëta se kudo qoftë, partitë shqiptare kanë një përparësi: të kushtëzojnë VMRO-DPMNE -në si kurrë më parë, ngaqë numri i përbashkët i deputetëve shqiptarë mjafton që partia opozitare maqedonase, ***LSDM-ja të vijë në pushtet***. Andaj, liderët shqiptarë partiakë, sikur të ishin të mençur, tani do duhej t'i kishin mbyllur telefonat celularë, me çka do e çonin Gruevskin t'i kërkonte nëpër fshatrat e Maqedonisë përëndimore e t'u premtonte se nuk është duke kërkuar vasalë të nënshtruar, siç i kishte gjer më tani BDI -në e PDSH -në, por bashkësundues të shtetit që do jenë të barabartë me palën maqedonase. Por sidoqoftë, t'i parashikosh gjërat në Maqedoni, është si të merresh me paragjykimin se kur një vullkan do mund të shpërthejë. Nëse ka diçka që gjer më tani është e qartë, ka të bëjë me zgjedhjet mirë të organizuara dhe me përfitimet e vogla që nxorën votuesit shqiptarë, duke marrë ndonjë lekë nga partitë konkurruese. Dhe shikuar nga ky këndvështrim, mund të thuhet se ***humbën partitë, por fituan shqiptarët.***”

Tjetri: “***Analizë pas zgjedhjeve: çka ndodhi?***” Dum Dumi shqiptar, që thirret në emër të shkencës dhe të “vërtetës shkencore” me çdo kusht do t’ju pri shqiptarëve për Liri. Edhe atë, shet mend: “Disa ditë pas zgjedhjeve, shumë medime bëjnë analiza, me të drejtë, se pse

rezultatet e anketave të instituteve dhe agjencive për matjen e pulsit të publikut gabuan në prognozimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 5 qershorit.

Edhe ne vetë si Institut, organizatë që meremi mes tjerash edhe me hulumtimin e opinionit publik e kemi për detyrë të analizojmë dhe të shohim se çka ndodhi, jo për hirë të asaj që të arsyetohemi e mbrohemi, nuk e kam ndërmend të bejë një gjë të tillë, por për hirë të shkencës, dhe hulumtimit të opinionit publik si një formë dhe proces i matjes së disponimit të qytetarve, dhe për hirë të së vertetës shkencore e jo të manipulimit publik dhe jepjes kahje të gabushme publikut se gjoja janë manipululu dhe abuzu anketat. Gjithësesi se une këtu mundem të flas vetëm në emër të Insitutit që udhëheq, dhe të argumentoj dhe analizoj atë që ne e prognozuam.

Si do që të jetë, parashtrohet pyetja se në të vërtet çka ndodhi? Ndodhën tre gjëra kyçe që ndryshuan gjithçka, e që me hulumtim nuk mundeshtë të parashikohet, me që efekti ishte psikologjik, e jo logjik.

Instituti ... edhe njëher thekson se kjo analizë nuk ka përqëllim të arsyetoj apo mbrohemi, por ti shiqojmë faktet, dhe elemetet që ndikuan në një rezultat që askush nuk e parashikoj.”

Deledashi shqiptar, që bashkë me liderët politik fotografoheshin para kamerave të “pavaruara” talevizive: edhe ne i paraprijmë fushatës parazgjedhore me anketa konfuzë. E unë them: ***Humbën shqiptarët - fituan partitë politike***. Vetëm populli shqiptar nuk hanë më bar.

Vdiq ajo kohë. Mjaftë më e përçatë nëpër fe e parti politike popullin shqiptar si “shpëtimtarë”! Vërtet, i humbi katër deputetë, ndoshta edhe më shumë, por vepron me kokë. E di se kujt duhet t’ia japë votën, besimin. Nuk është ai populli i sistemit komunist për të cilin ju derdhni lot nëpër debate televizive edhe sot e kësaj dite, të shkoj pas hoxhës dhe gomarit. Fatin e vet e ka në duart e veta, dhe një ditë do t’ia arrijë qëllimit. Patjetër!

Ose tjetri më azgani: “Adili i cili drejton aktualisht lëvizjen gjithëshqiptare Fronti Demokratik i Bashkimit Kombëtar (FDBK) me seli në Tiranë i ka bërë thirrje partive shqiptare që humbën në zgjedhjet e 5 qershorit, ti bashkëngjiten nismës së tij.

Ai thirrjen i`a ka dedikuar kreut të BDSH, Hysni Shaqiri (shtoj unë, me siguri është ndonjë gabim teknik, mendon për Bardhyl Mahmutin), kreut të DR-së, Imer Selmani, kreut të RDK-së, Rufi Osmani, kreut të BDK-së Hysni Shaqiri dhe kreut të PPD-së, Sefedin Haruni.” Them unë: Humbësve të radhës në politikë, që dy nga këta kryetarë të partive politike kanë dhënë edhe dorëheqje. Ende popullit shqiptar sipas Adilit edhe njëzet vjet të tjerë duke i mbajtur gjallë për krahu në politikë duhet t’i prinë këta “burra mejdani”, kësaj radhe me të në krye si komandant paqe nga Tirana.

Thirrje: “Bashkohuni rreth kësaj nisme së progresit shqiptar, e cila do të vjen shumë shpejt nga zoti Gafurr Adili nga Kërçova. Zgjedhjet e fundit edhe një herë ridëshmuan se ndarja e

potencialit kombëtar nëpër parti të vogla është dëm për kauzën shqiptare.

FDBK nga fillimi i këtij viti ka thirrur të gjitha partitë shqiptare nga Maqedoni që në Tiranë të formojnë Këshillin Kombëtar, por kjo nismë ka qenë e dështuar.”

Amani! Mjaftë më me themelimin e partive politike shqiptare! Këshillave kombëtar. Edhe ashtu i kemi me bollëk sa që kanë të hanë edhe qentë. Nuk kemi politikanë të aftë, nuk kemi intelektualë guximtar, nuk kemi vizionerë për një të nesërme. Ose i kemi, po nuk mund të vijnë në shprehje, ngrejnë krye nëpër parti politike e institucione nga dumdumët shqiptar, që vite me radhë na ngatërrohen nëpër këmbë.

Vazhdon parashikimi teknefes i “analistit” deledash: “Si konkluzion, pa mos hy në debat, se ku gabuam e ku jo, mudemi të themi se këto zgjedhje parlamentare, ishin me specifika që deri tani nuk i kemi pasur, dhe që rezulutan me fshirjen e partive të vogla, që në fakt vetëm dëmtuan votën opozitare, dhe krijimin e qartë të dy blloqeve politike në të dy kampet politike.”

Në rregull, të themi, o burra pushteti! Por, mos është për ju pak si vonë për zgjim kombëtar. E themelim të partive të reja politike shqiptare?! Pasi u thye qerrja, gjetëm plot rrugë. Po, pse nuk kërkuam rrugë para se të thyhet qerrja me gjithë këta parti politike, “patriotë” kuqezi, analistë politik e shoqata joqeveritare?

Realiteti: Prognozimet e Partive politike dhe analistëve me shumicë e pakicë që na i ka dhënë Zoti, fatkeqësisht këtë popull e fusin edhe më

thellë në huti, qorrsoak. Analisti i këtij soji neokomunist që me vështirësi jep shpirt, nuk di ku e ka kokën e ku bythën. E lëre më në ditën e sotshme, kur zjarr na digjet mbi krye, t'i pri në ballë popullit shqiptar.

Dhe, vazhdimi: “E njehta gjë ndodh edhe me njësinë 1 ku shqiptarët humbën 1 deputet, ndërkaq partitë e vogal maqedonase në njësinë e 4 humben 2 deputet.

Demagogji fantastike, gjoja në emër të shqiptarëve. E përsëris: ***Humbën shqiptarët – fituan partitë politike***: BDI: 15 deputetë, PDSH: 8 deputetë dhe RDSH: 2 deputetë. Kulminacioni: tashti do t'i shohim në Kuvend me diskutime të zjarrta patriotike, replika dhe bojkotim të Kuvendit. Edhe kësaj radhe të marrin rroga deputeti pa punë fare në shtëpi në emër të popullit. Shqiptarët edhe kësaj radhe le t'i përgadisnin çiftelitë me dy tela, kavallët, fyellin e Bariut të staneve të Sharrit, dajret dhe lodrat. Edhe, le t'i këndojnë “fitores” me këngën e njohur popullore: “Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola.”

Edhe, burrat e botës rrahin kot ditë e natë ujë në tavan. Njëri thumbit, tjetri patkonit. Dumdumët, që shqiptarët në Maqedoni gjithë jetën i trajtuan si pakicë shqiptare, me 25 përqind e popullatës. Gjuhën shqipe si gjuhë të dytë zyrtare. E kurrë nuk e ngritën zërin se, populli shqiptar në Maqedoni është shumicë. E them këtë, se: ende është populli i vetëm në botë që lind dhe vdes në këtë shtet “demokratik” pa nështetësi. E ka lehtë populli “vëlla maqedonas”

që e bëjnë popull shumicë dhe shtet: bullgarët, shqiptarët, vllahët, serbët, turqit, boshnjakët, romët, torbeshët...

Analistë të vonuar njëzet vjet me radhë që i përsërisin fjalët si papaglli në kafaz. E ka thënë këtë dikushi para njëzet vjetëve, në kohën e PPD –së, edhe atë, me një stil artistik: Gabimi më i madh i yni, shqiptarëve është që ne me “vëllezërit” maqedonas i ndajmë lugët dhe enët. E jo, Shtëpinë dhe arat. Vetëm se, fatkeqësia ishte se ju në atë kohë gërhisnit gjumë të thellë me nga dy-tre vende pune nëpër redaksi komuniste dhe institucione të shtetit. E dyta: pushteti dhe ekonomia merren me politikë dhe luftë. Shqiptarët e kanë provuar edhe politikën, edhe luftën. Përfundimi, shkaku paaftësisë politike, përsëri shqiptarët mbetën me gishta në gojë.

Rrugë?! Ende ka rrugë. Edhe atë, vetëm me një kusht që në të ardhmen mos i prinë në ballë politikanët humbës këtij populli! Shqiptarët për një kohë duhet ta flugin euforinë dhe “fitoret”: çiftelitë, dajret dhe lodrat duke i vajtuar familjarët dhe farefisin për së gjalli me këngë epike nëpër dasma e përvjetore. Koha është, i madh e i vogël t’i përveshin mëngët e këmishave deri në bërryla, pantollonat deri në gjunj. Hedhin në përrua interesat e ngushta personale e partiake. Trurin e këtij populli ta vënë në përdorim në vend të rrufjanëve. Edhe, do të shihni se si fitohet Liria. Shteti Etnik Shqiptar.

Shqipëri Etnike nuk fitohet me këngë tallava. Patriotizëm të rrejshëm. Parti Politike

Neokomuniste. Poezi patetike. Po, me punë.
Djersë. Dhe, tru...

Fundi i këtyre zgjedhjeve të parakohshme sipas analistit kuqezi që “lufton” për Shqipëri Etnike: *Fituan shqiptarët - humbën partitë.* (????!!!...)

Dhe, e nesërmja sipas autorit të këtij shkrimi: **PATJETËR, DO TË FITOJNË SHQIPTARËT – DO TË HUMBIN PARTITË POLITIKE...**



KOLLUMNA ME FEREXHE

Vërtetë, u lodha më me budallakitë e disa “analistëve politik” me tespi kuqezi në dorë. Halldupët “shqiptar”, që natë e ditë i luten Zotit në xhami. E në anën tjetër: pinë alkool, shesin drogë, vjedhin, vrasin vëllain pas shpine... Përmëtepër, nëse doni të dini edhe më villet. Vite me radhë jam duke i nxjerr jasht edhe zorrët. Më kot pres që ta mbyllin gojën, heshtin në mjetet e informacionit. Përyjagen mbi gardh si laraskat duke kërkuar ndërtimin e xhamive dhe kishave ortodokse, e nuk kanë shkolla shqipe për fëmijët e tyre, gjeneratën e nesërme. Realitet ky, që nuk besoj se shqiptarët kanë pasur kaq shumë xhami sa kanë sot, në kohën e Turqisë. Shkaku, edhe se: nuk kanë çka të thonë diçka të re, dërdëllisin nateditë si papagallë halldupi në kafaz. Edhe, si për inatë duan të dalin edhe në ballë të këtij populli me ndonjë parti politike me thirrjen: “për fe e Atdhe”. Edhe pse, në çdo shkrim të tyre teknefes thonë: “... autorin e këtij teksti ta ndiejë se mbase ka ardhur koha kur duhet heshtur dhe duhet lënë çdokush ta portretojë vetveten me ngjyrat e asaj që din e që bën. Ngjyra që do shihen gjithnjë e më qartë në të ardhmen, atëherë kur të gjithë neve do na “votojnë” gjenerata që vijnë.” Mjerani i Allahut, na kënaqi me kollumna me ferexhe dhe tashti pret të bëhet kryetar partie, deputet i popullit pas vdekjes. Ose: në atë botë të themelojë ndonjë “parti politike kuqezi”, edhe atë

vetëm e vetëm që të shpallet kryetar në Katund. Tjetri: “Dy Osmana një selam: Mbetet që gjithë politikanët aktual, edhe humbës edhe fitues, e edhe ata të ardhshëm potencial, ta analizojnë këtë fakt dhe të thonë një; alejkum selam.“ Halldupi i Baba Dovletit që i vjen mërzi të përshëndesë në gjuhën shqipe, them me plotë gojën. Njeri i sotshëm me tru të moçëm, siç ka thënë dikur për hoxhën Filip Papajani. Që, vështirë e ka edhe sot e kësaj dite t’ia përmend emrin heroit tonë kombëtar Skënderbeut, po takimet me shokët e “idealit” i lë “te kali”. Nuk i pengojnë mitropolitët e Beogradit: Shën Klimenti me Shën Naum Ohërin, Shën Kirili dhe Metodi te këmbët e Urës Gurit, po i pengon Pjetër Bogdani. Vendimprurja e vendosjes së përmendores të viganit të shquar shqiptar në këto anë për gjuhë e shkolla shqipe. Edhe atë: njësoj e lufton me të njëjtat metoda si në kohën e Serbisë kur hoxhallarët ngrenin zërin kundër gjuhës dhe shkollave shqipe, kur bënin thirrje për shpërngulje masovike me gjithë familje në Turqi.

Edhe, kur i kundërvihen shqiptarët me fakte thotë: “... Nga ana ime e konsideroj të mbyllur “rastin Bogdani”. Jo, Askushi! E mbyllë ti si halldup, po nuk e mbyllin shqiptarët. Unë nuk e di çka je me profesion: hoxhë, profesor universiteti, shkencëtar, poet, politikan, tullumbaxhi, rrufjan... Nuk ka kjo, edhe gjitha që rëndësi në këtë shkrim.

Që të flasësh dhe shkruash me fakte për Pjetër Bogdanin, duhet të jesh mbi nivelin e tij fetar dhe shkencor. E ti lëre që nuk je në nivelin e

tij, po nuk je as afër tij si halldup “shqiptar”. Burri i botës i ka njohur disa gjuhë botërore. Tezën e doktoraturës e ka mbrojtur në Romë. E jo si ti që ta kanë falur në Turqi, ose në shtetet Arabe. Punën e tij e ka vlerësuar lartë si patriot dhe shkencëtar e gjithë bota, dhe ka doktoruar për të edhe presidenti i parë i Republikës së Kosovës: Dr. Ibrahim Rugova. Tjetër punë është ajo se ti, nuk lexon shkencë shqiptare, po arabe ose turke. Unë jam i bindur që ti, jo që nuk je në nivelin e tij shkencor, por je aq larg me qindra kilometra. Shkak ky, që nuk mund ta mbyllësh ti budallakinë e shekullit, po do ta mbyllë populli shqiptar. Realiteti, ti nuk mund të matesh kurrë me Pjetër Bogdanin. Punemadhe, edhe nëse është siç thua ti se ka thënë ose shkruar në ndonjë libër Pjetër Pogdani. Arsyeja është se ti, nuk peshon në kandar as një gram e një rës herdhe të Pjetër Bogdanit. Shqip: ti je Askushi.

Edhe një herë shul e shqip: këtë popull pesqind vjet me radhë nuk mundi ta asimilojë Turqia, vite më vonë edhe Serbia. Prandaj, kotë e ka sot soji yt i ndërsyer i halldupëve – Askushi: njerëz të sotshëm me tru të moçëm, e përsëris edhe një herë thënjen e shkrimtarit shqiptar Filip Papajani për hoxhën.

Fatkeqësia kombëtare: turret me të katra të të dali zot edhe Vëllai i Shejtanit. Edhe ai shkruan kollumne: “... Mirëpo, këtë nuk duhet ta lejojnë partitë shqiptare, të cilat e kanë formulën fituese në dorë, sipas të gjitha parametrave demokratike, askush nuk mund t’i ndal të bëjnë qeveri me LSDM-në.”

“Kolumnisti sakat politik” i Allahut derdh lot rrëke për kohën e shkuar komuniste, kohën kur shqiptarët nuk i ndalte “shkjau” të shkojnë në xhami te hoxha, po i ndalte të shkojnë në shkollë te mësuesi. Shteti komunist u ndërtonte edhe nga dy-tri xhami në një katund, por jo edhe shkolla për fëmijët e tyre në gjuhën shqipe. Kulminacioni, edhe janë tërbuar partizanët e Dexhallit, kur partia në pushtet nuk ua hedh një asht si shpërblim, siç edhe ua ka hedhur në të kalurën për “flijime artistike për Mëmëdheun e Baba Dovletit”. Shkurt, nuk janë burra që mund t’i prinë këtij populli, se po të ishin dorën në zemër, që sot ua shtrij dorën e pajtimit. Edhe thonë: “*Jo poste por pozita*”. Vallë, ku jeton ky soj i njerëzve me dy e katër këmbë, në tokë apo në mars?! Pa poste, a mund të ketë pozita?! Me siguri, jo! Atëherë, pse nuk dalin nga kafazi?! Papagalli i këtij soji, nëse do të dalë në ballë të këtij populli, patjetër duhet të dalë edhe nga kafazi. E, a del nga kafazi ky soj papagalli?! Jo, nuk delë, pa sikur t’ua presësh edhe këmbët edhe kokën. E dini edhe pse nuk del? Jo. Edhe këtë nuk e dini! Nuk del, shkakun se në kafaz ka edhe bukë edhe ujë. Punemadhe, që nuk ka liri, këtij soji të papagallit halldup nuk i duhet liria, po buka edhe uji. Megjithatë, edhe nëse nuk keni kafazë dhe papagallë në shtëpi, i keni parë në kojshi. Papagallët nuk janë bilbila. Nuk këndojnë këngë për pranverën, por i përsërin fjalët e huaja patetike. Ose ndryshe: i spiunojnë banorët e Shtëpisë. Papagallët halldupë janë shpezë parazitë, soj i sorrave, çafkave të zeza, që duhet

t'i ushqejsh përditë, edhe përsërisin fjalët e “mysafirëve” të Shtëpisë. Mos them: janë spiunët e Shtëpisë.

Edhe çuditë!!! Jo, me popujt tjerë, po me shqiptarët. Edhe një herë e thirrë në ndihmë Vaso Pashë Shkodranin: *Feja e shqiptarit, është: SHQIPTARIA*. Kurrë në të kaluarën shqiptarët nuk e kanë pasur traditë t'i mbajnë dhe ushqejnë papagallët e kafazit në shtëpi. E di, e kanë mbajtur qenin dhe macen si kafshë besnike, po jo edhe papagallin - Zogkotin që nuk di asgjë në jetë, vetëmse të përsërisë fjalët e “vizitorëve” të rastit në Shtëpi. Vërtetë, pleqtë tanë kanë qenë të mençur në jetë. E kanë ditur kend ta duan, urrejnë, vrasin në pusi, ushqejnë, fusin në Shtëpi.

Koha e sotshme dallon shumë nga ajo kohë e pleqve tanë me mauzerrin krahut. Nuk mbajmë mece në shtëpi, nuk mbajmë qenë, ama mbajmë dhe i ushqejmë papagallët e halldupit. Edhe analistë teknefesë, që shkruajnë kollumna me ferexhe. Dhe, siç e kanë nisur me lutje e selame këta halldupë “shqiptarë”, një ditë pres që ta veshin me ferexhe edhe Maqedoninë e Gruevskit dhe Ali Ahmetit. Xhematin e kanë, vetëm ju duhet koçia e mbuluar me qilima persie dhe krushkat që ta shpien nuse, jo në Evropë po në Turqi. Edhe pse, kjo nuse Xhadi nuk do të hip në koçi, po në kalin e Goce Dellçevit.

Aleksandri i Madh me shpatën në dorë mes sheshit “Makedonija” është lart i paarrirë, gati fluturon në qiell me kalë shale, nuk ka shkallë për Xhadinë. Skënderbeun, poashtu me kalë e ka larg, edhe pse ky burrë lufte e ka futur shpatën në brez,

Xhadia nuk i zë besë Skënderbeut. Thotë: ndodh e nxjerr në dorë edhe në mes të ditës atë famëmadhe, mes parkingut m'i ngre këmbët në hava.

Përmëtepër, pasi t'ia bëjë atë punë të grave në mes të Bit-Pazarit edhe e hip Xhadinë me gjithë dollamë në koçi, flugë mbi qilima sheqera të larmë: udhaembarë, e përcjellë nuse me këngë e krushqi halldupë për në Turqi...

DELEDASHI

Matanë xhamave errët. Imzot, lehin qentë! Vetëm përtej çative shoh një dritë. E hap dritaren, është dhoma e Vjollca Rrapit. Me siguri e ka harruar dritën ndezur apo e ka marrë gjumi mbi libër! Po, dritaren? Dritaren a e ka lënë sonte hapur pas mesnate? Nuk e di. E shuaj dritën dhe shtrihem në shtrat. Rrokullisem lëmsh nëpër errësi. Dikur zgjohem, e hap përsëri dritaren dhe fluturoj mbi çatia...

Mëngjesi më gjen në shtrat. Rrotullohem herë në njërin krah, herë në tjetrin. Nata ka qenë e gjatë dhe e mundishme. Dita më e shkurtër për një sy gjumë. Mundohem t'i heq perdet, por nuk më dëgjojnë duart. E kam vështirë pas gjithë asaj beteje në shtrat ta marr veten dhe përsëri të ngrihem më këmbë. Megjithatë, lufta është luftë, nuk dorëzohen armët pa e shkrepur tekefundit edhe një fishek...

Vjollca Rrapi më puthi në faqe. Papritmas, kërceva nga shtrati dhe i hapa sytë. Dritë... Dritë... Dhe, dritë... E shikova orën, tre pasmesnate. O Imzot, ç'po ndodh me mua të pagjumin! Kush na rri mbi kokë natë e ditë? Kush më mban në gjumë kaq gjatë me dhunë? Me cilën do ta përcjellë Natën e do ta pres Ditën? Heshtje.

- Zgjohe, o i pagjumë! Ende mendon ta vazhdosh ëndrrën?

- Jo. Jo, - iu përgjigja duke u dridhur dhe duke i hapur sytë. O Imzot, ç'më panë sytë!

Deledashin me një dajre. Për dore e mbante Tatën e Madhe. E në shpinë Xhadinë, që i biente bythëve me një thupër, e shalonte me të katra nëpër Bit-Pazar. E dija se kishin ardhur para syve të më heqin një “valle patriotike”. Vetëm edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë se cilën valle e luajtën atë pasdite. Vjollca Rrapi, që më do mua dhe poezinë, tha se e kanë hequr Vallen e Vdekjes. Unë nuk i besova, i thashë se atë ditë e kanë hequr Vallen e Kaçakëve të Zajazit...

- Hi-hii-hiii... - qeshi Vjollca Rrapi. – E di, se edhe ty të kanë dhënë pak ujë Xhehneti, prandaj edhe flet jerm...

- Jo, e dashur. Më detyrojnë të heq një valle “patriotike”. E unë nuk di të luaj sipas ritmeve të tyre muzikore me lodra. Kam frikë t’i luaj këmbët, se mund t’u dukem si arusha e xhytit në katund duke hequr vallen me dajre para fëmijëve...

- Nxirre shaminë! Nxirre, mos ki frikë!

- Shaminë ma mori Pasardhësi i Zef Serembes...

- Hi-hiii-hiii... Edhe, ti do të më dush mua me zjarr, do t’ia kalosh Zef Serembes?!...

- Jo, e dashur. Zef Serembes deri më sot nuk ia kaloi asnjë shqiptar, pa edhe as unë me verë të kuqe nëpër tavernat e Qytetit të qyqeve.

Vjollca Rrapi qeshi. E dinte se nuk isha në gjendje t’i kaloj shtatë dete. E dinte se nuk isha në gjendje t’i humb të gjitha dorëshkrimet. E dinte se nuk jam në gjendje të mbytem për të as në Vardar, e ku më t’ia kaloja Zef Serembes. Vetëm një gjë e dinte. E them pa fije turpi se, unë isha ai

që tri ditë e tri net e dërgova në botën e çudirave. Unë isha ai që e laj me verë gjithë natën. Unë isha ai që pas gjithë këtyre ceremonive mistike e mbuloja me poezi. Unë isha ai që e bëra të pavdekshme nëpër libra. E pranoj, edhe ajo që ajo që nuk më la të plakem, m'i dha armët e luftës ta vras në libra Deledashin...

Juve më kot ju shkruaj në këtë shkrim se kush ishte Deledashi. Më kot mundohem t'ju trimëroj me fjalë nëse frika ju ka hyrë në bark. Ja, edhe arsyja pse me ju më nuk do të humb kohë. Jeta është luftë. E luftën e duan trimat. Frikacakët e duan robërinë.

Vallë, Deledashi është trim? Ku ta di unë. Ndodhë. Deledashi bën luftë për poste politike. Pasuri. Deledashi është komandant i ushtrisë së frikacakëve... Deledashi është armiku i Lirisë... E shërbetorët e tij me dy e katër këmbë? Shërbetorët e tij, janë pisa, këlyshë me zgjebe të Zotit, të cilëve duhet prerë kokën e këmbët...

Përsëri, pas gjithë kësaj, dua t'ju them edhe diçka në vesh! Po, si t'ju them, kur nuk keni shpirt! Veshë e sy. Apo, keni, por jua ka lidhur me shami Deledashi...

Lufta vazhdon me penë...

E thirr Miken në Parajsë. Ajo, për çudi, do ta shpie në Xhehnem... E do zjarrin... Urën e Xhehnemit... Deledashin "kuqezi"... Ja, arsyeja pse në këtë shkrim do ta lidhë me një fjalë kaçaku. Letërsia shqipe e ka Zef Seremben mashkull, por ende nuk e ka Zef Seremben femër. Ti, më thotë Vjollca Rrapi, nuk je në gjendje të ecësh këmbë as një mëhallë katundi. Ti nuk je në

gjendje të humbësh për mua as edhe një poezi. E ku më t'i biesh pash më pash me gjithë dorëshkrime Xhehnemit. Ja, edhe pse do ta krijoj Zef Seremben femër, në mos në jetë, së paku në këtë shkrim...

E di se e dini, Vjollca Rrapi është një Zef Serembe femër, por këtë nuk do ta pranojë para meje, jush, po as edhe në këtë shkrim. Edhe unë nuk ngul këmbë. E dua Vjollca Rrapin, po e do edhe Deledashi "kuqezi". E di se, edhe Deledashi i ka dërguar shkuesit dhe këto ditë pritet ta shpie nuse me koçi në Xhehnem. Zoti i ndihmoftë!...

"Zekthi" në një faqe e ka bërë nuse me ferexhe! E ka veshur sipas zakoneve dhe traditave të Xhehnemit. I duken vetëm sytë. Lexuesit, besimtarët e vërtetë të Zotit, nëse nuk e kanë frikë Deledashin, le ta shohin në këtë shkrim!...

E di, ju dhimbset edhe në këtë shkrim. Edhe mua më dhimbset, po ç'e do, deshi të bëhet Nusja e Deledashit. Edhe një herë e them me plot gojë: Zoti i ndihmoftë!...

Tri ditë e tri net nuk e pashë Vjollca Rrapin nëpër Qytet. Një natë vonë cingërroi telefoni. E ngrita kufjen dhe ia dëgjova zërin matanë telit.

- Hë, ende s'po të merr gjumi? – Qeshi nëpër natë.

- Jo, nuk më lënë personazhet e librave. Kohën e fundit kanë filluar edhe të zihen njëri me tjetrin, të rrihen me grushta...

- E di, fajet i ka shkrimtari. Nuk mund t'i pajtojë të gjithë në një libër. E aq më keq vetëm me një Mike...

- Po, hallin?

- Hallës duhet gjetur burrë!...

- E nëse halla deri më tash i ka ndërruar shtatë burra?...

- Hi-hii-hiii... E ke për detyrë t'i gjesh edhe një burrë me tirqi e xhamadan!... Kësulën e bardhë në kokë... Sahat me qostek për qafe... Nagantin në brez...

Qesha pas mesnate me Vjollca Rrapin, që nuk kishte gjumë e kërkonte që unë ta rrëzoj në shtrat. Vetëm, ku t'i lija personazhet e mia, që disa më tërhiqnin për dore, disa për setre... Megjithatë nata është e gjatë, iu përgjigja nëpër tel...

- E dashur, lëre dritaren hapur! Ku ta di unë pas mesnate vij e të futem në shtrat...

- Hi-hii-hiii... -Qeshi. Edhe oxhakun...

Zëri matanë telit u ndërpre, e unë për inat e hapu dritaren... E thirra Hënën... I thirra yjet... E nxora lapsin nga brezi...

- Hë, ende s'po të merr gjumi? – E hapi derën im Atë.

- Jo. Tashti më rreh Nusja me pashterkë të kuqe...

- E ç'të thotë, kaq vonë pas mesnate?

- Më detyron të bëj me të dashuri...

- Imzot! Biri im të marrë për grua një kurvë?!...

- Oh, jo! Baba, nuk e dua për grua...

- Ti nuk e do, por ajo të do ty, or bir për burrë!

- E si t'u shpëtoj epsheve të saj, baba?...

- E ke lehtë, o bir! Këmbët ngreja përprjetë në hava...

E tha këtë fjali dhe e mbylli derën. U turra pas tij, por e pashë që ngutej nga livadhi. E kishte edhe mauzerrin me vete krahut. E di, ju do të thoni ty ta la penën. E vërtetë, po Nusja me pashterkë të kuqe ndonjëherë do edhe pushkë...

Edhe këtë e di. Vetëmse, unë nuk trembem nga Deledashi që i ka dhënë gjì Njerka komuniste, as sot e as nesër. Kokën e ka futur në disa grazhde: Fondazione e shoqata “joqeveritare”. Edhe Doktorziu natë e ditë i jep tambël me kusi. Sorrat dhe çafkat e zeza fluturojnë në grupe. Laraskat nëpër lisa. Dhentë në kope, ecin pas bariut. Ujku, tigri dhe luani jetojnë dhe ecin verë e dimër vetë maleve. E doni edhe këtë t’ua them me plot gojën në këtë shkrim? Po, ë: Unë jam Ujk në letërsi...

- Hi-hii-hiii... Qeshi Vjollca Rrapi. Përderisa është gjallë Njerka dhe Doktorziu, Deledashi ende do të pi tambël me kusi... E ty, kush të jep gjì?

- Hi-hii-hiii... Tri Zana të maleve... Fuqi për luftë... Nëra më pri para, e dy të tjerat më mbajnë për krahu. Dallim i madh ky mes meje si Ujk në letërsi dhe Deledashit si soj i deleve “kuqezi” në mesin e Kopesë me zgjebe...

Natë. Dritat u ndezën në dhomë. U shuan. Muzika e fortë përplasej mureve. Rolling Stones i thyenin kitarat. Djersë. E mora pak veten dhe e tërhoqa nëpër errësirë. Duart e një femre filluan të më përkëdhelin, të m’i shpërthekojnë pantollonat... Më kot e kundërshtova, më mbuloi me puthje. Dritat u ndezën. Ngadalë i hapa sytë, e pashë se ishte Xhadia e Deledashit.

- Dorëzoi armët! E ke kot t'i shpëtosh këtij rrethimi, kësaj pusie!...

- E di, vetëm kush ta hapi derën?

- Hi-hii-hiii... - Qeshi Xhadia e Deledashit. Ende nuk e di?! Derën ma hapi krahu më krahu Deledashi. – Mjaftë më shkruajte poezi për Miken. E bëre të pavdekshme nëpër libra. E di se unë jam njëqind herë më e mirë se ajo në shtrat... Kur bëj unë dashuri, dridhet i gjithë pallati... Lagjja... Qyteti... Unë po të dua edhe të çmend nga goditjet me bark deri në vdekje në shtrat...

- O Imzot! Më shpëto nga Xhadia e Deledashit, se duhet të kthehem në shtëpi!

- Ti nuk ke shtëpi... E ke humbur rrugën në mes të ditës... Përderisa Deledashi me një këmbonë për qafe i pri Kopesë me zgjebe për Liri...

- E si t'i ik Deledashit "kuqezi"?!... Njerka atij i jep tambël me kusi... Doktorziu e ushqen në grazhd me taxhi, e mba për soj të Kopesë me zgjebe...

- Ec pas meje!...

Xhadia e Deledashit më mori për dore dhe më futi në një dhomë të errët. Papritmas, u ndezën dritat. Asgjë nuk pashë përveç librave dhe fotografive. Në mes të dhomës e pashë shtratin, por vetëm atëherë kur më rrëzoi në kokërr të shpinës Xhadia e Deledashit. Egërsisht ma hudhi jelekun, këmishën dhe pantollonat për dritare. Brekët as vetë nuk e di se si m'i hoqi me këmbë. Tërmet! Librat filluan të më rrëzohen mbi kokë... Fotografitë... Pikturat... Pllakat e gramafonit... Llamba elektike në mes të tavanit

luhatej andej-këndeje dhe prisja në çdo çast të më bie mbi kokë. Megjithatë, nuk u dorëzoja, u kapa për dy gjinj të e hazdisur gur të Xhadisë së Deledashit dhe i dhashë lopatës sa më thellë nëpër detin e tërbuar plot dallgë. Një dallgë e fuqishme për pak desh më hodhi nga barka, por më shpëtoi Xhadia e Deledashit. Edhe një herë i dhash forcë lopatës duke hyrë sa më thellë në det si një peshkaqen i përgjakur, të cilin e ndjekin me vite qindra gjuetarë. Dhe, në atë çast, kur u çmenda, e përmbysa barkën, i thyeva lopatat, dëgjova vetëm piskamën e pakontrolluar të Xhadisë së Deledashit. Edhe një herë u dridh fuqishëm pallati. Shtrati u bë copë-copë dhe ra në tokë. Qyteti mbeti pa dritë...

Pak para mëngjesit, kur u zgjova, e pashë Xhadinë e Deledashit sesi ishte paluar mbi mua si bollë shullani sa gjerë-gjatë në gjumë. Nuk e zgjova, me siguri shihte ndonjë ëndërr. Apo ku ta di unë, m'i mblidhte eshtrat nëpër dhomë!...

SHTEGU I KAÇAKUT

Deledashi kur e hapi derën, ne ende qëndronim lakuriq njëri mbi tjetrin në shtrat. E kishim kaluar natën, po edhe gjysmën e ditës. Me siguri do t'i nxirrnim edhe një herë armët për luftë, po siç duket, këtu përfundonte beteja. Xhadia kishte rënë dëshmore e demokracisë dhe këto ditë me siguri do t'i ngrihej shtatore nga ndonjë Parti demokratike “kuqezi”. Deledashi do të xhironte edhe ndonjë film dokumentar. E dinte ai se dashnoret e demokracisë i takojnë historisë. E ardhmja kërkon viktima, të kaluarës i dhamë mjaft gjak nëpër shekuj. E të tashmes i këndojmë me çifteli: *O delet e mia më të mirat në katund...*

E di, do të më pyesni pse ende nuk na tregon për reagimet e Deledashit? Çka t'ju tregoj, posa na pa, iu mor goja si kalemxihi me moral. E lëshuan këmbët në mes të dhomës vetëm me një emër: Ndihmë, Ebu Xhehli!...

Vjollca Rrapi tashti, pasi e dëgjoi këtë britmë, brofi nga gjumi. Vrik e vrik e veshi fustanin e zi me pika të bardha dhe doli në oborr. Unë mora një kofë me ujë dhe ia hodha në fytyrë Deledashit. Ai i hapi sytë, më shikoi mua si mëzat i tredhur dhe duke u dridhur paralajmëroi për motin nesër: me mjegulla dhe shi... Pasdite, priten edhe bubullima...

Miza në ekran. Pak muzikë. Disa reklama për agjencitë turistike. Një mishtore që shet mish “Mëzati”. Një klub që reklamon gurmanët më të

mëdhenj shqiptarë: një haxhi, një ministër, një deputet, një ambasador, një gazetar, një shkrimtar, një këngëtare... Dhe dikur, kur priten ende reklama, del reklama e të gjitha kohërave: Tata e Madhe.

-Teleshikues të dashur, mirëmbërëma! Unë jam Tata e Madhe, ndërsa ju jeni dele të buta me kësula të bardha! E fillojmë me lajmet. Kryetari i republikës sonë sot u kthye nga Kina. Atje, vizitoi Murin Kinez dhe një mur të këthillë, thotë, duhet ndërtuar edhe për shqiptarët. Mirëpo, gjatë rrugës i humbi një sanduk me rraqe. Aktivistët partiakë të një Partie të madhe shqiptare flasin se në atë sanduk ka qenë edhe zgjidhja e çështjes së të drejtave të shqiptarëve...

Vazhdojmë me lajmet. Xhaxhi kuqezi në një moment në foltoren e Parlamentit e shpaloj para deputetëve flamurin shqiptar. Në këtë rast reagan Kryetari dhe deputetët, por Xhaxhi kuqezi ua priti: Mos u trembni se nuk ju ha!...

Dhamë lajmet. Teleshikues të dashur, mirupafshim nesër në të njëjtën kohë!...

Një reklamë. Tata e Madhe kërkon të punësohet në kabinetin e një ministri. Tata e Vogël paralajmëron emisionin: “*Bisedë me gjenium*”, në të cilin kësaj radhe do të bëhet intervistë me Mëzatin e Tredhur. Edhe një reklamë. Dilinxhiu i Kumanovës i shpall dashuri një pele. Hamshori, për t’i dalë zot bukuroshes, e thirr në dyluftim Deledashin. Dashnorët e livadheve i përdorin armët, po asnjë i plagosur, asnjë i vrarë në fushëbetejë. Në ndihmë u del një Rrospi Mashkull dhe e bën pajtimin kombëtar...

-Teleshikues të nderuar, gjatë këtyre minutave mysafir të emisionit debativ e kemi Mëzatin e Tredhur. Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në emision!

MËZATI I TREDHUR: Mirëdita! (E nxjerr gjuhën).

TATA E VOGËL: Cilit profesion i takoni ju, zoti Mëzat i Tredhur?

MËZATI I TREDHUR: Politikanit, drejtorit, qibritxhiut, specaxhiut, bythaxhiut...

TATA E VOGËL: Vendlindja juaj më e dashur?

MËZATI I TREDHUR: Qyteti i qyqeve...

TATA E VOGËL: A keni marrë pjesë në ndonjë miting politik?

MËZATI I TREDHUR: Po, në Shkup dhe Tetovë...

TATA E VOGËL: Pas postit të deputetit në Parlament, çfarë ambiciesh të tjera politike keni, zoti Mëzat i Tredhur?

MËZATI I TREDHUR: Të bëhem president i Republikës!...

TATA E VOGËL: E gruan a e keni politologe?

MËZATI I TREDHUR: Po, më ndihmon në përgaditjen e referateve...

TATA E VOGËL: E keni me shallvare apo allafrenga?

MËZATI I TREDHUR: Gruan e kam myslimane. Havalen nuk e heq as kur bëjmë dashuri...

TATA E VOGËL: Sa fëmijë i keni?

MËZATI I TREDHUR: Gra e fëmijë s'kemi për t'u ngi...

TATA E VOGËL: Hi-hii-hiii... Vërtet qenke "gjeni"...

Teleshikues të nderuar, kjo ishte intervista ekskluzive që e bëmë me Mëzatin e Tredhur. Në emisionin e ardhshëm do ta kemi mysafir Gomarin Veshëpërpjetë. Mirupafshim!...

Pas mesnate: Nuk ndodhem në shtrat, nuk ndodhem në gjumë, ndodhem në rrugë. E ngas xhipin përmes Grykës së Kaçanikut. Qytetit të cilit këngëtari popullor i këndon me çifteli:

***"Kaçanikut i raftë pika
Që nuk di se çka asht frika
Nantë sahat u ther me thika..."***

E mashtroj gjumin edhe pas orës tre pas mesnate. Vetë i dyti turrem nëpër terr. Ec shpatave, pushkëve dhe grykave të topave. E përcjell Natën siç e përcolla plot para një muaji në Prishtinë. Vallë, mos ishte kjo nata e fundit në rrugë?! Nuk e di. Vetëm një gjë e di: ishim përsëri bashkë në xhip, në një orë letrare, në rrugë. E diku pas dy-tri javësh do të na takonte Ndarja. Verë, poezi... Kujtime... Natë e ftohtë kjo e fundit. Natë e pagjumë. Natë e mendimeve... E vjell, atëherë dëgjoj zëra... Dhembje... Lutje... Vetmi...

E di, pse nuk ngula këmbë? Vështirë e kisha ta shuaj gjithë atë zjarr që të ndizej në gji. Gjatë gjithë rrugës ta pashë flakën. E ku të gjej ujë?!... Ujë... Ujë... E ti e etshme. E pashë edhe se, nuk

do ta ndash ujin me Xhadinë. E mora me mend se për ty duhet edhe një lumë... Një liqen... Një det... Një oqean... E etshmja ime që së shpejti do të mbytesh në det dhe përsëri do të mbetesh e ethme... Megjithatë, unë jam me Ty edhe përtej varrit...

Mëngjesi tashmë zbriste mbi Qytet. E ndala xhipin përpara pallatit. Edhe një natë e përcolla matanë maleve. E prisja të lindë dielli. Vetëm edhe një hap edhe ai zbriste në tokë. E hapa derën, zbriti Hëna. Dielli iku mes luleve me një natën e mirë!...

Gjithë ditën e lume e kalova në gjumë. Edhe pse përjashta ishte dritë, unë isha në errësirë. Vonë, dikur pas mesnate, më zgjoi cingërrima e telefonit. E ndeza dritën, i hoqa perdet. Jashtë mbretëronte errësira. Të gjithë ishin në gjumë, vetëm unë u zgjova lugat...

Vapë e madhe. Matanë dritareve nga malet e larta zbrisnin shqiponjat. E kanë mbuluar qiellin. Herë pas here fluturojnë aq ulët mbi Qytet sa që të duket se në çast do të zbresin në Sheshin e Skënderbeut. Ndonjëra i ka hapur krahët përpara Universitetit. Zogjtë shqiponja u shkojnë rretherrtull, I përplasin fletët, sulen drejtë diellit. Përsëri lëshohen mbi Qytet, ulen pak mbi përmendore. E zgjasin qafën, ngulin kthetrat, i hapin krahët...

Sorrat që ka herë i kanë pushtuar rrapet dhe nëpër degët e tyre kanë ndërtuar çerdhet, vite me radhë e dhesin Qytetin. Sheshin e Skënderbeut e kanë mbuluar plot glasa. E këndojnë atë këngën e tyre të moçme krra-krraaa... E lumi e vazhdon

rrugën e tij mes këtyre glasave e këngëve që të hyjnë në kokë si pykë. Vetëm Sharri Plak e ka ngritur kokën. Verë e dimër nuk e heq kësulën e bardhë. Me keqardhje i sheh sorrat dhe qyqet sesi dita-ditës e pushtojnë Qytetin. E mbushin me glasa... Këngë krra-krraaa e ku-ku, ku-kuuu...

E hap dritaren krah më krah. I zgjas duart nga dielli. Vetëm për disa çaste dua të ik nga këto mure që më mbajnë në grusht. Vetëm disa hapa dua t'i bëj matanë hekurave. E di se diku është shtegu. Shtegu i kaçakëve që u ngjitën malit. Shtegu i Kalosh Zajazit, nëpër të cilin u vinte pusi zaptive të Kralit. Çelëvjollca, ku stërgjyshi vetë i bëri ballë bullgarit. Flakë më flakë luftoi me një ushtri bullgare dhe nuk e la për së gjalli të shkelë në tokën shqiptare. Stërgjyshi u vra në atë betejë, po kënga i këndohet edhe sot e kësaj dite.

Koha e bullgarit ishte ajo kur gjyshi me kalë shale e ruante kufirin. E kalonte natën zgjuar mbi armë, i dilte zot Atdheut. Kohë tjetër është sot, kur shqiponjat ende fluturojnë maleve, e në Qytet krrokasin sorrat, kukasin qyqet. E përdhosin Qytetin me glasa. E këndojnë vetëm një këngë. Edhe qyqet u ndihmojnë, edhe pse nuk u shkon zëri. Sorrat në Qytet vijnë truma-truma, sa herë që u errësohen e skuqen sytë. E qyqet? Qyqet më Qytetin e kanë zgjedhur si vendbanim për të pjellë zogj lakuriqë: sojin e Deledashit "kuqezi". Vite me radhë Qyteti e pret mëngjesin me këngën e sorrave dhe qyqeve.

Vetëm kohë tjetër është tashti, kur shqiponjat herë pas here zbresin nga malet dhe e mbulojnë Qytetin me flamurin kombëtar. E pastrojnë nga

glasat dhe këngët krra-krraaa e ku-ku, ku-kukuuu. I hapin krahët. Përditë e më shpesh fluturojnë mbi Qytet. E hedhin Vallen e kaçakëve. Nuk e di, pse sorrat e qyqet ende mundohen të na mashtrojnë me këngë. Vallë, nuk janë të vetëdijshme se kënga e tyre krra-krraaa e ku-kuuu na hyn në kokë si pykë. Nuk na hahet buka, nuk na pihet uji. Përditë e më shumë na villet... Villet... Villet...

Megjithatë, vazhdon jeta mes glasave dhe këngëve të sorrave dhe qyqeve. Jeta vazhdon edhe me fluturimin e shqiponjave... Vallen e kaçakëve... Vetëm, s’di pse në fund të këtij shkrimi nuk e pashë Pasardhësin e Zef Serembes. Hë, tashti mu kujtua, e pashë te Sheshi i Skënderbeut. Përsëri kishte hipur mbi kontejnerët e bërllokut dhe lexonte poezi. Tungjatjeta! –më përshëndeti. Hi-hii-hiii... Tashti, ti e ke radhën të mbajsh orë letrare mbi kontejnerë të bërllokut... Rrugëve të Qytetit të qyqeve ta kërkosh Miken... Deledashit “kuqezi” t’i dalish në pusi me penë. Unë kësaj radhe më nuk lexoj poezi për të dashurën, por për shqiponjat që kanë zbritur mbi Qytet:

***SHENJA E NISJES
OJ NËNË***

*Yjet tallen me zjarr
Qiellit i kërkoh fjalë!
Dita më bie me shuplakë...*

Shenja e nisjes, oj Nënë!...

Pas mesnate im Atë e hapi derën. Hë, ende nuk të merr gjumi? Jo, - iu përgjigja pa i hequr sytë nga dorëshkrimi i romanit “*Shtëpia publike*”. E di. Vështirë e ke t’i mbyllësh sytë mes këtyre zërave matanë dritareve... Glasave... Zogut të Keq, që ende na këndon mbi çati... Megjithatë, o bir, duhet vazhduar lufta. Këngës së tij i bashkohen edhe qyqet... Sorrat... Laraskat... Dy herë me radhë e çlirua Qytetin, po u kthyem përsëri në male. Shkaku, u dëshpruam: nëpër degët e lisave të këtij qyteti, ende jetonin qyqet... Edhe ju herën e tretë pa asnjë kryengritje u tërhoqët nëpër katunde. Sorrat e sulmuan grupe-grupe, e mbushën plot glasa. Ende nëpër lisa vazhdojnë të pjellin qyqet... Dhesin sorrat, derisa një ditë Qytetin ta çlirojnë shqiponjat... E sipas shenjave që ua dërgojmë ne të vdekurit, nuk është larg ajo ditë. Edhe ne moti, thashë, ia kemi hapur derën. Zogu i Keq duhet vrarë mbi çati se kënga e tij ndjell kob... E di, o bir, e kam pasur gjithë jetën mbi çati. E ndoqëm brez pas brezi me pushkë. E ndoqi edhe yt Vëlla, që vdiq para një viti. Tashti ti e ke radhën ta ndjekësh me pushkë...

Petjetër, o im Atë. Dhashtë Zoti, Zogu i Keq kurrë më nuk na këndon mbi Shtëpi. Nëse nuk e vras me pushkë, me siguri një ditë do ta vras me penë!...

ZOGU I KEQ

- HUU... HUU... HUUU...

- Është Zogu i Keq, e prishi qetësinë Vëllai.

- Le të këndojë, po të dojë, deri në mëngjes, nuk dua më për të ta lodh as kokën.

- E di, - tha Vëllai. – Kënga e tij, thonë pleqtë, ndjell kob. Me siguri do të vdesë dikush gjatë kësaj nate. E Babai më nuk është gjallë t'i dalë në lëmë ta trembë me pushkë...

Vërtetë, i atillë ishte im Atë. E shi tani, Vëllai pas kaq vitesh ma kujtonte duke e ndjekur gjithë natën e gjatë me pushkë Zogun e Keq. Vetëm, një gjë nuk e di dhe nuk jam i sigurt, kur vdiq im Atë, a e trembi atë dikush apo këndoi gjithë natën e gjatë mbi çati? Sidoqoftë, Zogu i Keq shpeshëherë na ka kënduar mbi shtëpi. Ende e kam të freskët këngën e tij që natë për natë e trumbetonte vdekjen nëpër errësirë. Po. Po, fare mirë më kujtohet edhe dëshira për jetë mes atyre mureve me baltë. Nuk e di as vetë, ku fshihej gjithë ai zjarr në ne, që përditë ndizej gjithënjë me flakë?! Sa më shpesh që dëgjohej kënga e Zogut Keq, ne aq më të fortë përballnim jetën. Të thuash se, ne më ishim mësuar me këtë këngë... Vdekjet... Lindjet... Ndoth, se edhe të mirën edhe të keqen ne e kishim pritur dhe përcjellë ballëllartë matanë maleve...

Ashtu i thelluar në mendime, u ngrita pritueshëm dhe u ula në tavolinën e punës. E hoqa letrën e bardhë, që ia kisha hedhur përsipër

makinës së shkrimit ta mbrojë nga pluhuri dhe i mora dy të tjera duke i vënë në të për të hedhur ndonjë fjalë... Por, e kisha vështirë të përquëndrohem në një pikë, ta kthjelloj trurin nga “mjegullat breza-breza” se, çka të shkruaj – poezi a prozë. Më dukej se dielli ishte shumë larg, diku pas maleve apo nuk kishte lindur fare mbi Çelëvjollcë. Yjet i kisha afër, afër mbi kokë, po ç’ e do kur nuk bënin dritë. Megjithatë, pa vetëdije shtypa shkronjat e makinës dhe lindi kjo poezi:

LËVORET E BANANEVE

*Zjarrit afër – larg luleve
Këmbët m’ turren pas një Fluturë
Keq u shava me Dr. Madhin
Kokën e huaj s’ e dua në qafë!*

*Saçin me shpuzë e putha i marrë
Ëndërr e pashë Trimin me kalë
Shpatën ma dha në dorë
Egërsirave t’ u vë kokë.*

*Këmbadoras eci një udhe
Vjollca Rrapi m’ i çmendti vargjet
Dr. Madhi m’ i lë vetëm lëvoret.
Rrëshqas. Kokën ta thyej në rrugë...*

Vargun e fundit e përfundova ashtu si në ethe dhe në fund, siç e shihni edhe vetë, ia rraha plot inat të tri pikat. Nuk e di as vetë, çka desha të them me këtë veprim, vetëm e pashë se, u lehtësova nga një barrë. S’ më zihej më besë se,

truri im kishte pështjellë diçka të tillë në kokë. E kishte bartur me vete nëpër ata damarë, nëpër gjakun e trupit tim me vite e vite, që një ditë ta hudhte jashtë si një bajgël. Më vinte inat, disa herë desha edhe të pëlcas, pse truri im gjatë gjithë kohës kishte bluar misër e askushi nuk ishte kujtuar t'ia kthejë një pikë ujë në lug. Kjo më shtyri ta prek me dorë shpinën, por aq tepër u tmerrova kur pashë se nuk munda ta prek samarin. E, në të vërtetë e dija se gjatë gjithë kohës dikë e bartja në shpinë. Dikushi ma mëshonte sa mundej me thupër këtyre rrugëve të ngushta nëpër Qytetin e qyqeve. Më kishte hipur dhe më shalonte për dikah, por qysh edhe mua nuk më shkonte kurrresi për dore ta hedh mu në mes të udhës në kokërr të shpinës. Dikur, kur i ngrita sytë, e pashë se Vëllai më rrinte mbi kokë.

- Hë, e shkrove edhe një vjershë?

- Po. – Mezi iu përgjigja, ashtu i thelluar ende në mendime.

- Vetëm se, tashti do ta kesh vështirë t'i gjesh botues, do ta presë gjatë kohë radhën mbi tavolina nëpër redaksi.

- Nuk ka rëndësi kjo, - i thashë. – Më kryesorja është që e hodha në letër.

- E di. E di, - më tha Vëllai, - por edhe ti nuk do ta kesh aq lehtë me një vjershë të këtyllë artistike të punësohesh në Qytetin e qyqeve.

- Edhe kjo s'ka rëndësi, jam mësuar me të keqen, ngase gjithmonë më ka ndjekur si hije, më ka hyrë nën lëkurë, dhe tani e kam vështirë të ndahem nga ajo në këtë moshë. Pastaj, më duket

se edhe krijimet e mia këtu vështirë e kanë të marrin lirisht frymë.

Vëllai më nuk e zgjati bisedën, po vetëm e shkundi kokën. Edhe unë e dita se ç'deshi të thotë me këtë gjest, mu për këtë nuk e lodha më me ndonjë pyetje. E pata të qartë se i kishte lexuar fund e krye vargjet e kësaj poezie. Po, unë për këtë nuk desha t'i lodh trutë, e kisha kokën time që më shpiente rrugës së drejtë nëpër shkretirë. Ai, pas një kohe, doli jashtë, në lëmë, ndërsa unë deri në këtë moment ku ta di sa herë e kisha lexuar këtë poezi. Ma thoshte mendja se në të, fundi i fundit kishte pak gjak, gurgullonte vrullshëm mes damarëve drejtë zemrës. Nuk më interesonte çka do të mendonin të tjerët për të, do ta lëvdonin ose do ta shanin pa mëshirë. Kryesorja, unë kisha mendime të mira për këto vargje. Mu këto vargje do të ishin ata, që unë një ditë do të ecja krenar nëpër Qytetin e qyqeve. Njerëzit do t'i hiqnin kësulatat dhe do të më nderonin me gjithë zemër, nuk do të ma shanin nënën, ndërsa zonjat e rënda do të më buzëqeshnin tinëz burrave. Kështu nga etja që ndieja për këto vargje i lexova edhe një herë dhe më në fund i lashë mbi tavolinë. U ngrita i kënaqur nga një poezi e këtillë, e veshja gunën e zezë dhe dola në rrugë.

Pas një kohe, u habita kur e pashë veten se qëndroja sikur të kisha ngulur rrënjë si një rrap qindravjeçar para Shtëpisë së mallrave. Nuk e di as vetë sesi kisha ardhur deri këtu dhe kush më pruri në këtë shesh me lule... U mundova ta kthjelloj trurin, po meqë nuk ia arrita qëllimit,

vendosa të hyj në Shtëpinë e mallrave. E hapa derën dhe hyra edhe unë në mesin e kalimtarëve, që disa silleshin në rreth e disa të tjerë hipnin shkallëve. Po gati mbeta pa mend, kur i pashë dy shitëse të bukura në një karrige, nën shkallë se si e shitnin mallin e patundshëm. Edhe pse sot këtu nuk hyra me qëllim që të blej gjë, vendosa së paku t'u marrë erë luleve. Harrova t'ju them pak më lartë se dy shitëset e bukura nën shkallë shisnin lule. E unë si adhurues i luleve, nuk doja ta lejoj veten të kaloj atypari pa e kthyer së paku kokën. Njëherit, u gëzova që ja më në fund edhe ne e kemi një Shtëpi të mallrave. A ka më gëzim dhe lumturi më të madhe sesa, kur blerësi më së pari takohet me tufat e luleve? Jo, nuk ka. E them këtë se lulet janë ato që na e sjellin pranverën, na e mbushin me erë dhomën, na e kënaqin zemrën...

- Zotëri, deshët diçka? – më pyeti shitsja e luleve.

- Po, t'u marrë erë luleve! Me siguri nuk do të keqkuptohemi, se përveç shkallëve të vogla i kemi edhe disa shkallë të mëdha... E mua pët t'u ngjitur lart më duhet energji...

Shitësja e bukur mori një lule në dorë dhe ma afroi para hundëve.

- Urdhëro Zotëri, merri erë!

- Po, bën edhe asaj tjetrës lule t'i marr erë? E di si është, unë e kam shprehur në mes të dy luleve ta shtie edhe kokën...

Shitësja e bukur, pasi buzëqeshi ëmbël, me dorën e lirë e rroku edhe tjetrën lule dhe që të dyja m'ia afroi para hundëve.

-Ja, fute kokën!...

E di, nuk do të më besoni që e kam futur kokën në mes të dy luleve dhe u kam marrë erë egërsisht, kam bërtitur si i marrë. Dy – tri herë, sa më kujtohet, kam lehur edhe si qen. Ju nuk më besoni as kur ju them se, aroma e tyre disa minuta më ka vënë në gjumë. Dhe, as se në mes të atyre dy luleve kam parë një ëndërr të bukur. Por ç'dobi kam unë nga ajo ëndërr e bukur, kur unë më s'e kam kokën në mes të atyre dy luleve! Apo t'ua them më bindshëm, nuk jam i marrë, nuk leh më si qen...

Aroma e atyre dy luleve të cilat e futa kokën më dha fuqi, më shtyri ta vazhdoj rrugën mes tryezave me mallra për në Baba Tomorr. Po, diku thellë në vete e ndieja se donte të më shpërthejë një energji, që si duket, me siguri ma dhanë ato dy lule. O Imzot! Mos vallë bukuria dhe aroma e tyre më kishte magjepsur dhe ndodh në ndonjë kënd të më vënte në gjumë?! Mes asaj rrëmuje të m'i shkëlqenin këmbët, trurin... të m'i mbyllnin sytë, ta vuaj dënimin.

Përfundimi: Urime përmendoren e Aleksandrit të Madh, në Shkup!...

AMANI, E HIPNI EDHE NJË GRUA NË KALË ME SHALË

U ngulfata në Shkup edhe këtë verë. Përditë e më shumë po më zihet fryma. Nga të gjitha anët përreth heronj meshkuj, kalorës me kuaj shale. Edhe misionarë fetar. Vetëm, nuk më zë syri asnjë grua me kalë shale: “*Për midis Pazarit Shkupit*”. Edhe atë, kur e dimë se në të kaluarën s’kemi pasur makina, ose nëpër vendbanimet e thella malore nuset i kemi marrë me kalë shale. E shi sot, në këtë kohë demokratike kur duam të shkojmë në Evropë, politikanët tanë nga të katër anët na mbytën me burra mejdani. Nga ta kthesh kryet, do të shohësh ndonjë hero me kalë, luan ose mëzat me brirë. Ndonjëri, edhe në mes të rrugës e ka shaluar kalin me shpatën në dorë për luftë.

Dorën në zemër, e kemi pasur lehtë gjatë stinës së dimrit, po çka do të bëjmë tashti në verë, në këtë vapë të madhe kur zjarr na digjet mbi krye. Edhe ne, shqiptarët e kemi Skënderbeun në Çarshi, po ai së paku në kohën e sotshme e ka futur shpatën në brez. E ka ngritur lart dorën, lufton për paqe: ngadalë, o burra! Fatkeqësisht, kur kalorësit e tjerë hipur mbi kuaj shale i kanë ngritur shpatat lart në dorë për luftë matanë Varadrit. Edhe luanët mbi urën “Goce Dellçevi” me bishtat nën shalë. Mëzetërit e patredhur i turren me brirë tinëz pas shpine. Nuk e ka lehtë as me halldupët “shqiptar” që në mes të Shkupit e

kanë shpallur si tradhtar. Edhe sot e kësaj dite e kanë vështirë t'ia zënë emrin në gojë, po kur lënë takime thonë: “te Kali”. Ali Ahmeti me shokë do t'ia sjellë në Shkup edhe një vëlla gjaku, Pjetër Bogdanin. Po, halldupët “shqiptar”, Askushi hedhin gurë e dru mbi këtë veprimtar të shquar të kulturës shqiptare, gjoja se te “Çeta e profetëve” ua paska fyer fenë islame dhe Kuranin.

Askund, nuk të zë syri ndonjë grua as për farë. Jo, të zë para ish Shtëpisë së mallrave në sheshin “Makedonija”, përpara këmbëve të kuajve të: Goce Dellçevit, Nikolla Karevit dhe Aleksandrit të Madh, po këto gra janë kalimtare rasti, gjysmëlakuriqe nga nevoja me nga një çantë në krah. Që, hajnat përnatë pasmesnate ua presin nga një dorë ose këmbë. E politika shterpë, turr të nesërmen t'ua kthejmë në vend dorën ose këmbën edhe këtyre “heroinave”. I falemi Zotit, që dikush nuk ua pret kokën. Shkaku, se: vaj hallit atëherë, ku t'ju gjejmë koka në qafë. Vështirë në kohën e sotshme e kemi t'u gjejmë koka burrave, e ku më edhe grave. E kemi lehtë t'u gjejmë këtyre “veprave artistike” ndonjë dorë, këmbë ose bishtin brigjeve të Vardarit, po shumë vështirë mes kësaj varfërie të përditshme materiale e shpirtërore e kemi t'u gjejmë edhe koka.

Edhe vazhdoj t'i lutem Zotit, liderve tanë politik në pushtet: Nikolla Gruevskit edhe Ali Ahmetit. Amani, ku të doni e gjeni edhe një grua heroinë! Nuk ka rëndësi, e krishterë ose myslimane. E hipni edhe atë në kalë me shalë! Besomëni, na mbytët në Shkup vetëm me burra, edhe atë të hipur në kuaj me shalë. Ku të doni e

gjeni edhe një grua: në Serbi, Bullgari, Greqi, Shqipëri, Rumuni... Vetëm le të jetë së paku grua heroinë. Historinë e popujve të tjerë e njoh shumë pak, ose nuk e njoh fare. Gjatë jetës sime kam lexuar nëpër libra ose dëgjuar për një Teutë Ilire, Zhan D'Ark, Elena Gjika, Safo, Shotë Galica, Ana Ahmatova, Bubulina Laskarina, Fransua Sagan, Virgjinia Vulf, Sulltanë Qafa... Ama, asnjrën nga këto gra heroina deri më sot nuk e pashë me kalë shale në Shkup.

Edhe një herë e përsëris: ku të doni e merrni një grua heroinë, qoftë e krishterë, qoftë myslimane! Dhe, sillnje me dëshirë ose me dhunë në Shkup! Nuk ka rëndësi, edhe a është hipur mbi kalë, më këmbë te Ura e Gurit ose në koçi. E rëndësishmja mbi të gjitha është, që të jetë grua heroinë. Edhe ne, këtu në Shkup si e gjithë bota përparimtare e demokratike të marrim lirisht frymë edhe në mesin e grave...

THASHË

Në disa shkrime të publikuara në mjetet e informacionit kam thënë: Dielli si një saç i skuqur, derisa unë kisha bërë një sy gjumë pas dere, ishte ngritur lart mbi male. Ku ta dish, ndoshta edhe sa herë e kishte zgjatur dorën të më zgjojë nga gjumi. Po ç'ë do, kur unë shihja ëndërr. I kisha hipur gjokut dhe fluturoja mes reve nëpër qiell. E shaloja kalin, po ende nuk e kisha flug gurin pas shtatë maleve. E ç'është më me rëndësi, e dija se nuk jam Gjergj Elez Ali, që në trup t'i marrë nëntë plagë, e të dhjetën ta kërkoj nëpër Qytetin e qyqeve. Edhe pse, gjë më jepnin për luftë Tri Zana. Ja, mu pse isha shtrirë pas dere, nuk kisha mundur të zgjohem nga gjumi.

Imzot! E zvarrisin veten natë e ditë dhe gërhasin në gjumë për Liri mes kontejnerve të bërrllokut, mes atyre plehërave nëpër thasë të arnuar vite me radhë te Pazari i Grave. Edhe atë: me shtatë palë qe e tërheqin qerren rrugëve me gropa dhe plot baltë. Fatkeqësia: qetë shtyhen njëri me tjetrin, nuk e tërheqin qerren para mes rrugës, po anash. Rrezik, që qerres t'i thyhen rrotat dhe të na lënë në mes të maleve. Rrugëdalje: Im Atë, kau që nuk e tërhiqte pllugin në arë, qerren para, po shtyheshite me shokun e tërhiqte anash, e nxirrte ta shesë ditën e shtunë në Pazar. Koha është pra, edhe ne këta politikanë, që njëzet vjet me radhë më shumë janë marrë me

njëri-tjetrin për poste në Qeveri dhe jo me zgjidhjen e çështjes shqiptare t'i nxjerrim ditën e dielë në Pazar. Mjaftë më e përçanë popullin shqiptar, e ngritën zërin për Liri, hipën në foltore, nëpër karrige të na rrëfejnë grushta në demokraci. Herë pas here në gazetë na shkruajnë edhe “letra dashurie”, se: si e kanë kaluar natën me rroshtë meshkuj qafë për qafe matanë Vardarit. Na shesin mend nëpër emisione debative televizive: “*Një temë një bisedë*”. Vëllazërim-bashkimin e ri që do ta ndërtojnë në Qytetin e qyqeve. Himnet e para partiake që do t'i shkruaj poeti Honxhobonxho. Kolumnat “profetike” Patrioti i Vonuar, “miku” i Abazit dhe armiku i Ali Ahmetit. Librin për të cilin do të çohet aq pluhur nga Kritiku Teknefes që nuk ka haber nga letërsia. Bibani Qafërrjepur se, si fryhet para kamerave televizive me një torbë në krah dhe “flijimet e tij artistike” se, si e ka shpëtuar Atdheun nga Përmbytja e Madhe...

Dhe, kur i sheh kaq të flaktë për Shqipëri Etnike, të vjen të pëlcasish jo nga barku, po nga kurrizi. Komunistët e djeshëm të Partisë Komuniste, “demokratë” të sotshëm me fjalime të zjarra e shkrime “bombastike” nëpër istikame kulturore e politike. Njëri me kravatë të kuqe mbi shkrimin patriotik, i ndezur zjarr e flakë. Tjetri: me shqiponjën e pergjysmuar dykrenare kuqezi mes flamurit me një gotë ujë përpara mbi tavolinë. “Disidenti” i Doktorziut në mjetet e informacionit po si Mic Sokoli duke e rrokur topin për fyti: “Shqiptarët do t'i zhgarravisin fletëvotimet, Marrëveshja e Ohrit ka vdekur, Pres që të ketë incidente të përgjakshme, Analisti i

kërkon falje popullit shqiptar, A duhet të bashkohet Kosova dhe Shqipëria (edhe Maqedonia e Mali Zi v. j.)”... Edhe, shesin mend: “ideologji deledash e partive shqiptare, presione shantazhe dhe kërcnime të partive politike”. Trusakatët që deri dje u bënin “temena” liderve partiak: Ali Ahmetit dhe Menduh Thaçit. Edhe ua fërkonin natë e ditë me dorë. E sot, kur këta i përzunë nga Partia si material shpenzues vetëm për një përdorim dhe i flugën në hedhurinat e kontejnerëve të berllokut, gurë e dru hedhin mbi këta burra mejdani. Fotografohen me shqiponjën e zezë dykrenare, qafë për qafe me Skënderbeun e dalin në syrret me kësula të bardha. E ti kur i sheh kaq të mjerë, kaq të varfër në tru, aty për aty të hidhet t’i duash këta liderë partiak. E merr guximin të thuash në këtë shkrim: po mirë ua bëjnë Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi. E sidomos ky i fundit, Menduh Thaçi është i pamëshirshëm për sojin e këtyre “patriotëve”, që janë shërbetorë të dëgjueshëm dhe i ndrrojnë partitë politike si kurva brenda një nate burrat. Vetëm edhe Menduh Thaçi nuk rri duarkryq, i “dogj” gjatë këtyre viteve patriotët e rrejshëm me kësula të bardha. Meritë e vetme kjo e këtij lideri politik shqiptar, që i zhveshi burrat e grave para syve të popullit lakuriq e pisa ashtu siç i ka lindur nëna pas dere një natë dimri. Trusakatët e këtij soji të zmëruar me liderët e tyre partiak, të nesërmen turr me shkrime e sharje të themelojnë parti të reja politike. Dumdumët, që pantollonat mezi i mbajnë me duar dhe u bien rrugës.

Përmëkeq, shqiptarët edhe sot e kësaj dite janë të përçarë nëpër parti politike. Një Parti Neokomuniste gjatë njëzet vjetëve i polli me dhjetra parti të tjera kopileshta “demokratike”. Fatkeqësisht, të njëtit individë njëzet vjet me radhë bëjnë akrobacione politike duke shëtitur parti më parti si kurva burrë më burrë. Dorën në zemër, kurvës edhe i ka hije. Po, jo edhe këtyre rrospive meshkuj me pashterka të kuqe, që gjatë natës na i flukin kopilat pas dere. Ose, nga pangopësia përditë themelojnë parti të reja politike duke vazhduar ta përçajnë këtë popull edhe nëpër katunde. Fatkeqësia më e madhe: gjithë këtë e bëjnë në emër të popullit dhe për popullin shqiptar. Populli i shkretë, sot e ka humbur rrugën në oborr. Nuk di pas kujt të eci, cilit t’i besojë ose t’ia japë votën. Kohë shterpë kjo, kur Gomari Babatasit i pri para këtij populli nëpër fushëbeteja për Liri. Rrugëdalja: pajtohet me fatin, ende t’i prinë këta hajdutë politikë duke e vjedhur me duar e këmbë popullin dhe pasuruar veten, një rreth të ngushtë familjar, miqsor e klanor, grupe interesi partiak nëpër kabinete.

Qesha. Dhe, them me vete: po, në fillim të viteve ’90 –ta, në prag të ndryshimeve demokratike, këta “burra mejdani” ishin bashkë si një trup e kokë në themelimin e PPD -së, në Tetovë. Përrjashtim këtu bënte vetëm Ali Ahmeti me shokë. Në atë kohë erdhën gra e burra nga të katër anët e botës nga toka e qielli me aeroplanë special në votime. Kurrë populli shqiptar nuk ka qenë më i bashkuar se atë ditë në atë kohë historike. Edhe Sheshin e Shkupit e mbushën me

kësula të bardha e flamuj kombëtar kuqezi. Vetëm, tjetër është ajo se, ky bashkim kombëtar nuk zgjati shumë kohë. Plasi sherri për interesa të ngushta personale, ose hyri Dreqi në mes të “patriotëve” kuqezi. Nëna Parti çdo katër vjet, gjatë zgjedhjeve të reja pillte kopileshta pas porte. E përçanë popullin shqiptar, mos Zot më keq! Njëzet vjet me radhë të njëtit “patriot” kuqezi i ngatrrohen popullit shqiptar nëpër këmbë. I hipin për çdo katër vjet mbi shpinë si gomarit të Nastradinit nëpër beteja: herë i hip Nastradini e herë Nstradinica. E kanë rrëzuar me të katër këmbët në batak. E ky popull edhe sot e kësaj dite, nuk e hedhë samarin, barrën nga shpina. Bythekrye t’i hudhë trusakatët në baltë.

E për sa u përket liderve të rinj partiak që gjatë këtyre ndryshimeve demokratike mezi i pollën me shterëzime partitë politike shqiptare: PPD, PDSH dhe BDI, nuk dua të flas mes këtyre rreshtave, kanë qenë vite me radhë shërbetorë të tyre “besnik” për një torbë tagji nëpër institucionet e shtetit. Edhe pse më shtini ta them haptas: ata “patriotë” kuqezi të cilët i ka djeg Menduh Thaçi, kurrën e kurrës nuk mund të bëhen liderë të sukseshëm politik shqiptar. Realiteti: me këtë dua të them, edhe këtu në këtë shkrim: Menduh Thaçit duhet t’i takojnë meritat si politikan shqiptar në pastrimin e haleve të partive politike shqiptare, e jo në avansimin dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare. Nuk do t’i përmendi emrat në këtë shkrim, i di populli shqiptar. Fatkeqësisht, ndonjëri nga pakujdesia ka shkuar edhe si qeni në rrush.

Njëzet vjet na kanë hipur e zbritur nga shpina si gomarit të Nastradin Hoxhës. Herë Nstradini e herë Nastradinica. Njëzet vjet na i kanë shitur lirë të gjitha të drejtat kombëtare. Njëzet vjet na i mohojnë të gjitha librat. Njëzet vjet na i helmojnë fëmijët nëpër shkolla me tekste shkollore e planprograme sakate. Njëzet vjet me radhë na e shtinë në dhomën e librave Zonjën Vdekje. Njëzet vjet... O Imzot, njëzet vjet na kanë ndjekur maleve, vetëm e vetëm t'ju bindemi urdhërave të tyre, të udhëtonim nëpër gjiriz mes hithërave. Kujt i hynte në kokë ose së paku të na dëgjonin se, ne i kishim frikë krimbat të na ecin nëpër trup. Atyre me rëndësi ishte t'u ndizet qiriri mbi oxhak. Tymi t'ju shkojë drejtë qiellit mbi çati. E për ne, kush e çante kokën se një ditë do të na e burgosnin edhe Lirinë brenda katër mureve. Fajin e patën vetë, do të thoshin nëpër emisione debative, ne u dolëm borxhit. Dhe, vërtet duhet pranuar nëse ka Zot se na “dolën” borxhit...

Dritat u shuan në tribinë. Në sallë shpërtheu një duartrokitje frenetike. Nëpër errësirë dëgjova edhe një zë femre. O Imzot, ama ia kishte marrë një kënge partizane! E përdridhte zërin, më thirrte me emër nëpër errësirë... Grupi i burrave me çifteli: Ne gjatë këtyre njëzet vjetëve kemi gabuar në politikë, por nëse tani na e jepni votën – shpërblimin e popullit, kurrë më nuk do ta gabojmë rrugën politike. Tjetri duke mbajtur ison: Kryetarin e Parlamentit, nëse fiton Partia jonë demokratike do ta kemi shqiptar! I treti me një parullë partizane të Partisë Komuniste: Liri ose vdekje...

Punemadhe. Them unë në këtë shkrim artistik - demokratik. Shqiptar e kemi pasur një kohë në komunizëm edhe kryetarin e Shtetit të Jugosllavisë. Edhe atë, shkrimtar. Poashtu, në Kosovë e Maqedoni, gjatë sistemit komunist kemi pasur poste të larta në nivele shtetërore. Edhe dy shtete shqiptare i kemi sot në demokraci: Shqipërinë dhe Kosovën. I treti e pret radhën pas porte. Që, nëpër dyluftime heroike për poste politike duam t'i ndajmë me litar jug-veri, siç e ndante gjatë një fushate parazgjedhore Xhaxhi Kuqezi Kërçovën. Edhe gjatë ndryshimeve “demokratike”, poste kemi pasur e kemi për burrat e mejdanit, po nuk kemi pasur e kemi shtet shqiptar: Shqipëri Etnike. Ekonomi të zhvilluar shqiptare. Barabarësi të plotë kombëtare me “vëllezërit” e Njerkës në këtë shtet të “përbashkët demokratik”. Shkaku se: ende shqiptarëve nëpër damarë u qarkullon gjaku komunist i vëllavrasjes. Vështirë e kanë në kohën e sotshme të gdhihen qafë për qafe si demokratë, këta burra mejdani me brekët mbi pantollona.

E thashë këtë mendim dhe u ula këmbëkryq mbi një varr. Vetëm se tani kukullat filluan të sillen në rreth, t'i rrahin duart herë pas here shuplakë. Kjo do të thoshte se u pëlqente muzika e rokënrolit në këtë festival ballkanik. Ja, edhe pse e këpusnin mjedisin, i rrotullonin sytë, përdridheshin para kamerave televizive. I venin në përdorim të gjitha shkathësitë, që para kukullave të ishin sa më bindës, sa më të zjarrrtë. Vetëm pak veta i besonin lojës së tyre, kishin frikë mos thyejnë ndonjë këmbë... Kokën... Nuk i

kuptonin përdridhjet e tyre, nuk e dinin ku i shpienin këta flamurtarë, në Liri ose Robëri . Një kukulle edhe i ra të fikët kur Vajza e Dr. Madhit një lojtari iu hodh në qafë. E mori për dore pas mullarit me bar dhe e rrëzoi nën qiellin e hapur me yje.

Edhe, them: BDI – në nuk mund ta rrëzojë nga pushteti ky kapacitet politik që e kanë shqiptarët në Maqedoni. Shembull: Deklarata e Rufi Osmanit se, vjen në skenën politike për ta rrëzuar nga pushteti Ali Ahmetin. RDK –ja në këto zgjedhje të parakohshme do të fitojë 17 deputetë. Ose: paszgjedhjet e parakohëshme parlamentare, ku Menduh Thaçi: singerisht e uron Ali Ahmetin për “fitoren”. Njëkohësisht, duke i porositur kopilat e PDSH -së që humbën në këto zgjedhje, t’i thonë lamtumirë politikës. Poashtu, edhe se do të jetë në të ardhmen një opozitë e fuqishme. Porosi kjo për BDI – në, që nëse nuk bënë reforma brenda partiake, pastroj radhët e veta nga bërlloku i mbledhur me vite para dere, as le të mos marrë guximin t’i masi forcat në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

E nesërmja është në duart e shqiptarëve...

NESËR KUSH DO T'JU PRI KËLYSHËVE ME ZGJEBE

Profetike, ë?! Patjetër. Nesër, çka do të bëjnë këlyshët me zgjebe të Doktor Ziut?! Ose: si do të përfundojnë të gjithë bythekrye në koshat e plehrave historik. E them këtë se, unë e di si në pëllëmbë të dorës Babashehut, në Tyrbe. E shoh edhe me sy të Nesërmen, që është nisur moti me koçi mes maleve. Po, nuk e dini ju, shërbetorët e Doktor Ziut, nuk i shihni hapat e juaj nëpër errësirë. Bythëprapë. Unë Shkupin e kam pushtuar para haramëve të Doktor Ziut. Tjetër, është deklarata: Shkupin e “çliruar” ne haramët e Doktor Ziut. Fatkeqësi kombëtare: iu turrën për poste në Qeveri e t’i mbushin xhepat e tyre të grisur e familjarë brez pas brezi.

Tmerr. Shumicën i shoh pa kokë. Ndonjërin e tërheqin për dore. Tjetrin me litar për qafe si qen. Patriotin e vonuar përpara dyerve të xhamisë me bythët e grisura në Diell. Doktor Ziun, arnë kazani të Xhehenemit. E koshi plehrave është larg, matanë Urës Gurit. Qoftëlargu, moti ua ka hedhur një asht në rrugë. Këlyshët me zgjebe me të katërta, kush i pari t’ia rrëmbej shpërblimin shokut nga goja. Lëmsh turren rrugës, edhe lehin njëri kundër tjetrit natën. Pordhë e piskamë. Ndonjëri, më trimi edhe e kafshon shokun pas shpine. I hap plagë. Ashti fitohet me luftë.

Matanë Urës Gurit, shpallet fitorja: Vera kulturore. Ndahen edhe shpërblimet. Në mënyrë

solemne jepet shpërblimi: një asht. Doktor Ziu është në krye të oxhakat për ndarjen e çmimeve. Ndonjëri, edhe i hidhërohet vendimit politik. Nuk e ka merituar ai dumtum, unë i pari arrita te ashti. Gjithë jetën kam punuar për një asht shpërblim. Jo, thotë Doktor Ziu. Nuk duhet të ziheni për një asht shkau. Secili, e ka rrishtun e vet në këtë betejë të përgjakshme për “bashkëjetesë”, ende kemi shpërblime partikake - politike. Ndonjërin do ta bëjmë poet të madh. Tjetrin, profesor Universiteti. Askushin, në Qeveri. Mirë, zoti Doktor Ziu, po unë nuk e kam as fakultetin?! Nuk prish punë. Edhe fakultet do të të japë Partia. Edhe doktoraturën. E rëndësishmja është, ju t’u bindeni urdhërave të mia si akademik i tre Akademive shkencore, që nga koha e Shokut Tito, truri i Partisë Komuniste. Puna tjetër është e imja se, si do të shpërbleheni ju në jetë në këtë konkurrencë të madhe mes partizanëve të partive politike. Në doni të dini më shumë, për të gjithë ju kam menduar nateditë me kokë. Edhe shpërblimet i keni në çantën time të lëkurës derri, që një student në atë kohë për një provim ma solli nga Gjermania. E di, ju do të thoni: nuk ka qenë e zbrazët edhe pa një kafe. E vërtetë, në të kishte të pish një kafe me shokë. Vetëm jo, edhe të bësh një shtëpi në bregdet. Unë jam ai me shokë, që ndaj në këtë jetë diploma fakulteti, vende pune, tituj shkencor, çmime letrare. Askush, tjetër në këtë botë nuk mund të ma marrë zanatin. E juaja është, t’u bindeni urdhërave të mia prej “akademiku” që në kohën komuniste. Punës suaj t’i dilni zot, t’u ndërseheni pas shpine

kundërshtarëve të mi, sa herë t'ua bëj unë me gisht. E di, ju do të thoni: mirë në këtë jetë do t'i marrim të gjitha shpërblimet për "flijime artistike". Po, na trego çfarë shpërblimi do të marrim në atë jetë?! Përgjigjet: E them haptas më se i sinqertë: për në atë jetë do të vendos Dëxhalli Allahut të cilit i luteni për mëkate përpara këmbëve të Hoxhës në xhami.

- Mirë, zoti "Akademik", të gjitha këto që i thua në xhami, ta zëmë se nuk i luan as topi. Po, nesër kush do të na marrë në mbrojtje, kur ti nuk do të jesh në jetë, mes xhematit. Ecish krah për krah me "vëllezërit". Cili do të na ndaj çmime letrare, diploma fakulteti, vende pune, tituj shkencor nëpër universitete shtetërore e private?!

- Edhe për këtë kam menduar si shkencëtar i të gjitha kohërave. E kam gjetur edhe pasardhësin tim në këtë vend pune, që ma besoi mua si nxënës komunizmi. Është kolegu juaj analist politik, ai që më së shumti i është turrur ashtit me të katra këmbët gjatë ndryshimeve demokratike. Edhe, sipas kriterëve të mia të profesinostit dhe "vëllezërve", i plotëson të gjitha kushtet për "flijimeve artistike".

- Na paske marrë në qafë. Vëllai ynë, nuk është artist demokrat. Është rrospi. I ka ndërruar deri më tash disa burra, më falni parti politike.

- Eh, po kështu e ka arti. Shkenca, politika moderne. Postet në Qevri dhe Akademi, vendet e punës i fitojnë gjenitë e partive politike. Edhe çmimet shekncore.

- E pabesueshme. Nesër, sipash jush Nëna Parti do ta bëj edhe deputet, ministër, drejtor, ambasador, hoxhë në xhami...

- Ta merr mendja. Shoqërisë dhe Shtetit i duhen gjenitë. Shkollarët, që i përpunojmë ne nëpër fabrikat tona neokomuniste me renome botërore.

- Mirë, sot e kryet detyrën. Po, nesër kush do t'i tërheq me litar këta këlyshë me zgjebe në ardhmëri? E kam fjalën, kur ti më nuk do të jesh në këtë jetë si akademik i tre Akademive shkencore. Shkaku se: edhe Natyra i ka ligjet e veta shkencore. Mos e teproj shumë: Zoti Madh. Tekefundit, edhe ti e di se je: me një këmbë në varr. Tjetrën, në livadh. Mund të cofish me bythët në hava në ndonjë kosh të plehrave, matanë Urës Gurit. Nesër, kush do t'u pri këtyre këlyshëve me zgjebe, tërheq me litarë për dore matanë Vardarit krah për krahu me "vëllezërit"?!

- Edhe për nesër kam menduar për këta këlyshë me zgjebe. E kam përgaditur mirë terrenin. Pasardhësi im besnik do t'i tërheq për dore, qes matanë Urës Gurit.

- Dhe, përsëri të vazhdojnë të na shesin te "vëllezërit": për një post në Qeveri, për një vend pune, diplomë fakulteti, titull shkencor?!..

- Dihet. Pse, çka mendove, t'i tradhtojmë "vëllazërit"?! "Probatimat", me të cilët e kemi ndarë edhe të mirën edhe të keqen nëpër shekuj.

Jo, po thashë: këta këlyshët e tu me zgjebe mos na bëjnë Shqypni Etnike. I ke stërvitur ti mirë pas ashtit nëpër kabinete akademike të "vëllazërim-bashkimit".

- Budallai. E ku ke parë ti këlyshi t'ia kalojë qenit. Populli e ka thënë: babës t'i ngjash është adet, po për t'ia kaluar duhet marifet.

- Më këtë do të thuash se ata, për të të kaluar ty duhet bërë marifet.

- Ta merr mendja. Mazi nuk del para pelës.

- E kam të qartë. Nuk të pyes më për vrapimet maratonike pas ashtit. Nesër, kur do të cofish ti me kokën në koshin e plehrave e bythët në hava të “vëllezërve”, matanë Urës Gurit, këta këlyshë me zgjebe me bishtin nën këmbë do të sillen rrugëve dhe do t'i ngrej në këmbët përjetë edhe për një copë buke. Shkaku se: janë të paaftë për jetë. Nesër nuk do të jetë Doktor Ziu t'i mbajë gjallë, t'i tërheq për dore, ndajë diploma fakulteti me thasë, vende pune, tituj shkencor, çmime letrare.

Edhe e sulmojnë: një – dy, tre këlyshë me zgjebe një itelaktual nga Shqipëria. Turr Banda e këlyshëve me zgjebe e Doktor Ziu, bythekrye në hurdhë: I dalin zot vëllait “gjeni”. E, harrojnë se janë këlyshë me zgjebe. Nuk kanë guxim dhe trimëri të lehin pas Ujku. O, Imzot, sikur këta këlyshë me zgjebe ta lëpinin ashtin, që ua ka hedhur Qoftëlargu, matanë Urës Gurit! Dhe, kurrë më të mos lehnin pas Ujku të maleve! Shkaku: këlyshin me zgjebe mysliman, Ujku i maleve ua ka bërë përrallë në gazetë. Vëllezërit e tij, këlyshë me zgjebe gjysëmanalfabetë, turr t'i dalin zot. E kotë. Ujku më ia ka lënë vetëm eshtrat në mes të lëmës. Nuk ka ferexhe të zezë që ia mbëledh eshtrat në një thes, t'ia varrosë në Mekë.

Fatkeqësia: këlyshët me zgjebe do të cofin nesër në mes të rrugës, në të njëjtën ditë me Doktor Ziun. Cuca, përgadisni dajret në lëmë! Edhe sheqerkat e larmë, t'i hedhin krushkat mbi koçi. Fëmijë, mos u shtyni në lëmë, për të gjithë do të ketë sheqerka të larmë nën koçi! Gra Zajazi, i vajtoni me dajre dëshmorët e fundit të "vëllazërim-bashkimit", ua këndonni këngët e dëgjuara të kësaj ane nëpër varrime!...

Problemi me shqiptarët: Thirrjet e përditshme nga minaret e xhamive në gjuhën arabe. Askund, nuk më lënë vend të zbrazët nëpër gazeta (fushë të bardhë), për t'i shënuar frymëzimet e përditshme në Tavernë. I kanë mbushur me raklama. Problem me shqiptarët patën turqit. Problem Serbia. Problem të madh pati Hitleri. Problem, xhaxhi Enver. Problem edhe shoku Tito në "kali të bardhë". Edhe unë, poeti.

Vallë, cili do të jetë ai burrë që nuk do të ketë problem me shqiptarët?! Dhe, në fund: problemit të shqiptarëve t'i vë pikë. E presim. Edhe habiten njerëzit: kush më ruan mua poetin mes këtij bërlloku që lulëzon edhe në mes të Dimrit?! Përderisa, ata gjithë ditën e lume të pesë vaktet i falin në xhami, përpara këmbëve të Hoxhës. E shurdhuan edhe qiellin. Dhe, ende nuk e dinë se: mua më ruan Zoti...

Dhe në fund

**MOS U TREMBËNI NUK DO T'JU LËMË
T'U HANË SORRAT**

Bërlloku shqiptar, Këlysh Melezi me zgjebe i paaftë për penë dhe grua e mbanë gajlen se ku do të varrosem unë: në vendlindje, apo sipas dëshirës së tij dhe “Çobanit” të Katundit pa asnjë ditë shkollë në Butel, varreza afër Shkupit.

Hi-hii-hiii... O bërllok shqiptar! Këtë problem duhet t'ia shtroni vetes, që nuk e keni dhënë për shoqërinë dhe kulturën shqiptare as edhe një kafe. Ju nuk keni siguruar as vend për varr, e jo unë që kam lënë për varreza një arë të tërë me mbi 2000 m², rrëzë Çukës në Katund. Në do të dish pak më tepër, e kam bërë vetë edhe varrin. Edhe epitafin mbi krye me katër vargje. Dihet, nënë hije të Lisit. Fatkeqësi e madhe për ju të mjerët, edhe në mesin e Tri mikeve: njëra që më pri para me dy shtamba verë. Dhe, dy të tjerave që më mbajnë për krahu gjatë rrugës për në Baba Tomorr. Vendin e Perëndive. Tyrben ku pihet vera. Lind poezia. Dhe, bëhet dashuri.

E për sa i përket “letrës” së “Çobanit” analfabet, të cilën ti Këlysh Melezi me zgjebe e shkruajte vetë se: u kemi vra dhe ua kemi rrëmbyer një bukuroshe për pesë javë dhe ua kemi kthyer prapë në shtëpi, mos u brengosni, bre “burra”! Përsëri, do t’ju vrasim dhe do t’ju q... përderisa nuk bini në din e iman, nuk do të

punoni për Vatanin. Shkaku se, fisi i juaj i mullinxhijve dhe çobanëve çka mund t'i japë tjetër fisit të kaçakëve: përveç rrunzave, një thesi me miell dhe ndonjë qengji për kaçakët e maleve. E ke harruar të ma përmendësh edhe një ngjarje: se im vëlla ta ka shkrep në ballë një karrikator të “nagantit” me fishekë, po ja fati yt mbete gjallë. Herën tjetër, të shohim a do të kesh fat, të kërcesh bythekrye në ferra me gjithë dhenë.

Këlysh Melezi me zgjebe është shartim i asaj kohe të “vëllazërim – bashkimit”. Xha Deralla, ai burrë i madh me sharrë në krah te Jasakët e Tikeve, e bënte shartimin e dardhave gorrice në Katund, në dardha turke. Megjithatë, deri dje vërtetë ishin dardha gorrice, po ja sot e kishin gëdhirë ditën si dardha turke. Dhentë i mrizonim verës nën hije ne hutaçët te Përroni i Thanës. Edhe i mjelnim me kusi në mesditë nën ato dardha me kokat në qiell. Herë pas here edhe u hipnim në majë atyre dardhave për ta mbushur gjirin me fruta. Publikisht, dua të them: ferra nuk bënë mollë. Murrizi nuk bën dardha. Molla bën mollë... Dardha bën dardha... Fatkeqësi e madhe për këlyshët melezë me zgjebe, që ende nuk e dinë se, këto janë ligje të Natyrës. E prej nga Këlysh Melezi me zgjebe është pjellë patriote sipas ligjeve të Natyrës?!...

O njerëz! Hiqni nga mendja këto marrëzira teknefese! Ligjet e Natyrës, janë zakone të trashëguara brez pas brezi. Këlysh Melezi me zgjebe nuk është ujk. Ashtu siç nuk bën anësh rrugëve një ditë, ferra mollë... Dardha, murriza... Shelgjet, rrush të zi... Ë, ligje të Natyrës?! Që,

nuk i ndryshon as politika ditore e partive tona politike. E as, njeriu... Megjithatë, i ndryshon një fuqi mbinjerëzore: Natyra.

Tjetër: ndihmë kërkon nga “Çobani” i Katundit. Fatkeqësisht, miku yt nuk është çoban. Çobani është zotëri, i mjelë dhe i ruan dhentë. “Çobani” yt është vrasës, gjaksor, kriminel që e ka vlarë tinës pas shpine bujkun e pafajshëm duke lëruar në ara. E ka vuajtur për këtë edhe dënimin me burg, në Idrizovë. E Idrizova nuk është Universitet, është vend përmisimi. E kam thënë këtë disa herë nëpër librat e mi, pak vetë kanë dalë normal nga ky burg famëkeq jugosllav. Shumica kanë dalë: të çmendur, spiunë, ose pедера... Vetëm, pash Zotin mos ma bënë edhe këtë “çoban” patriot ose ballist! Shkaku se: I njoh edhe më mirë se ti të gjithë patriotët, po në emër të tyre nuk i kam rënë gjoksit me grushta mbi avli dhe nuk kam bërë në jetë karrierë të sëmurë nëpër parti politike.

Ore, i mjerë: unë jam fis kaçakësh. Dhe, moti kam ikur nga Katundi nëpër botë. Vërtetë, nuk e ke ditur, apo bëhesh matuf se, fisi i kaçakëve brez pas brezi, së pari lë vend për varre e pastaj ara për bukë. Varrin e kam në Katund, në arën time rrëzë Çukës dhe ende nuk e kam shitur për bukën e gojës...

Këlysh Melezi im me zgjebe, tashti e shoh se kot kam humbur kohë me ty të rritesh në qen katundi. Qeni është kafsha më besnike e njeriut. Vetëm, fatkeqësia yte e madhe, ti mbete dhe do të cofish këlysh me zgjebe. Fajin e ke vetë. Vërtetë,

më vjen keq për ty si Këlysh Melez me zgjebe gjithë jetën me një asht në gojë!


Edhe brengoseni se: a do të varrosem me hoxhë, apo pop?! Hi-hii-hiii... Bërlloku shqiptar, që ma bartë edhe gajlen e varrimit. E thashë njëherë: ne jemi fis kaçakësh, që qefinin e mbajmë me vete rreth kësulës në kokë. Edhe varrin e bëjmë vetë për së gjalli sipas zakoneve dhe adeteve shqiptare. Edhe pse, shumë herë gjatë luftërave jemi mbuluar me dushk, gjethe të lisave. Shkaku: nuk ka pasur njeri të gjallë pranë nesh nëpër fushëbeteja të na shti në varr, e kemi bërë vetë varrin me dorë mes meleve si te ajo kënga popullore: *pasi shpirti i ka dalë, i ka fol dy – tri fjalë...* Të parët na kanë lënë çifligje e ara me bollëk. Edhe varreza, që nesër të jemi bashkë pranë tyre kokë më kokë edhe në atë jetë qiellore. Nuk e kemi pasur kurrë problemin e varrit. Edhe të bukës. Ne kemi ditur të kemi varr edhe në breg të lumit, mes maleve. E kemi pasur gjithmonë pranë për hije një lis mbi kokë. Çka ka pasur fisi i juaj, ore i mjerë?! Turp më vjen ta them mes këtyre rreshtave, prandaj mbylle më gojën! Ne jemi ngjitur brez pas brezi edhe maleve: luftë me Mbret e luftë me Kral. Brekët ju i keni zgjidhur para çdo pushtuesi. Edhe ua keni fërkuar herdhët me dorë. Ju, e jo ne fisi i kaçakëve. Ju e keni pëlqyer gjirizin me krimba. Halenë, pas shtëpisë me hithëra ku keni kërcyer bythekrye kryemëshehtas njëri pas tjetrit nga frika si “patriotë” shqiptarë.

Prandaj, është koha të kërkonit një varr! Mjaftë më vajtuat, kukatët sokaqeve të hallkut

(“vëllezërve”) si qyqe lis më lis, gjoja se e kërkoni vëllain. E derdhët lotë krokodili. Thoni se: nuk keni vend as edhe ku ta futni kokën? Përsëri i zgjidhni brekët. Nuk ka nevojë. Ngreni ato të shkreta plot arna lidhur përqafe me një kordhë kanapi te Mulliri i Arapit mes shelgjeve! Ne, përsëri jemi të mirë, ende kemi mjaftë ara, vende për varreza.

Nuk do t’ju lëmë në rrugë si coftina t’ju hanë sorrat...

Shkup, qershor 2011



Cun GELI (Adem KASTRATI)

Shënime për autorin

Kalosh Çeliku lindi më 13 shkurt 1951 në fshatin Cërivicë të Kërçovës (IRJ e Maqedonisë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme normale në Shkup, ndërsa studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Çeliku shkruan poezi e prozë për fëmijë e të rritur dhe gjer më sot ka botuar rreth dyzetë libra: *Zogu erdhi me një këngë* - vjersha (1982), *Lepuri me pushkë* - tregime (1983), *Shtëpiza e xixëllonjave* - tregime (1984), *Ferexhja e zezë* - dramë (1985), *Arusha pa bisht* - tregime (1986), *Dielli zbret maleve* - novelë (1986), *Varrimi i sorrave* - roman (1988), *Vite me borë* - roman (1990), *Trumbetat e Tellallit* - satira (1992), *Imzot, lehin qentë* - drama (1993), *Trimi shihet në vepër* - poemë (1994), *Çohuni trima shaloni lapsin* - rrëfenja (1994), *Sorraku i Qytetit* - pjesë teatrore (1994), *Kali i Trojës nëpër Bit - Pazar* - satira (1994), *Loja e syve* - poezi (1995), *Babi ka dy nuse* - roman, (1995), *Vjellja e zorrëve* - poezi (1996), *Qyteti i qyqeve* - roman (1997), *E përcolla Natën* - poezi (1998), *Mbrëmë fjeta me Vjeshtën* - poezi (1999), *Kopeja me zgjebe ndjek Autorin* - drama (2000), *Shtëpia publike* - roman (2000), *Si u ndava me*

Gruan time“ – satira (2001), *Gratë e mia besnike* – roman (2001), *Lamtumirë bërllok* - nëntë drama (2002, 2007), *Me tre varre* - roman (2002), *Vdekja më deshi më pak se Ti* - poezi (2003), *Edhe Ajo nuk ishte xheloze* - poezi (2004), *Repriza e vëllazërim - bashkimit* - dramë (2005), *Atdheu ky burrë pa Grua* - poezi (2006), *Kulturofagu* - antiroman (2006), *Burrat i përzë me burra e Mua me gra* - poezi (2007), *Engjëlli im është Grua* - poezi (2007), *Dimri, s’vjen me lule* - 5 poema (2007), *Ujku e di një lojë* - poezi (2007), *Kur bërtet “vojvoda“ e pjell Kurvë Partia* - satira (2008), *Dac Poeti i shkruan poezi Mamit* - poemë humoristike (2008), *Ehu* - poezi (2008), *Gruaja besnike* – roman (2009), *Djemnusha* – roman (2010), *Atdheu burrë pa Grua* - poezi (përzgjedhje, 2010) etj.

Që nga viti 1992 ai drejton Shtëpinë Gazetare - Botuese ASDRENI, në Shkup dhe është kryeredaktor i të vetmes revistë për humor dhe satirë **ZEKTHI**, që del kur t’i teket në IRJ të Maqedonisë. Dhe, që nga ky vit (2009) mbarëkombëtarë, është fitues i disa çmimeve të konkurseve letrare në poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Njëherit, edhe i çmimeve letrare: PERENDESHË E BUKURISË, në Netët e Poezisë Korçare (2003), në Korçë, Çmimin AS për letërsi (2007), në Kërçovë, “SYRI I KALTËR“ (2007), në Sarandë, “SEREMBE“ (2008), në Laç, “FLAKADANI I KARADAKUT“ (2009), në Viti, Çmim special për vëllimin poetik: EHU nga Simpoziumi Ndërkombtar “MUZA POETIKE”, “PEGASI”

(2009), në Gjirokastrë, “JEHONA E KARADAKUT” (2010), në Kumanovë, “SKAMPINI” në Festivalin Ballkanik të pozisë (2010), në Elabasan etj.

Drama *Ferexhja e zezë* është vënë në skenë nga disa teatro në Kosovë e IRJ të Maqedonisë dhe është mirëpritur nga publiku e kritika letrare. Edhe satira *Ndihma e shpejtë* u përgatit për t’u vënë në skenë me mjaft sukses nga Trupa teatrore “ Aleksandër Moisiu “ në Kumanovë dhe çoi pluhur nëpër kuluaret e oborrtarëve. Drama tjetër *Zorra qorre* dy herë me radhë u përgatitë për skenë, një herë në Kumanovë dhe herën tjetër në Strugë, po i ranë në gjurmë kulturofagët dhe nuk u shfaq para publikut. Një fat të këtillë kanë pasur edhe pjesët teatrore për fëmijë të shpërblyera me çmime letrare duke u luajtur në skenë dhe duke u emetuar përmes valëve të radiotelevizionit të Prishtinës (Kosovë) dhe Tiranës (Shqipëri).

Krijimtaria e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë: maqedone, gjermane, turke, bullgare, rumune, greke etj. Që nga viti 1992 – 1997, ishte nënkryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar dhe kryetar 1997 – 2001. Momentalisht është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në IRJ të Maqedonisë. Dhe, themelues i disa manifestimeve kulturore tradicionale ndërkombëtarë: Ditët e Naimit, në Tetovë, Takime nën Rrap, në Shkup (poezi erotike) dhe i Ditëve të humorit dhe satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Poashtu është edhe themelues dhe kryeredaktor i revistës letrare **STILI 97**, organ i

Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë.

Çeliku gjer më vitin 1995 punoi si mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenicë të Kosovës dhe Malësinë e Shkupit. Vitet e fundit punon dhe jeton në Shkup, tashmë në profesionin e lirë të shkrimtarit.

Lufta vazhdon me penë...

Përmbajtja

Prolog

Don Kishoti shqiptar / 7

I KALI TROJËS NA POLLI

NË BIT- PAZAR

Ujksha nuk e do burrë Këlyshin me zgjebe / 12

Mazi kur del para pelës / 18

Bozaxhiu kur vendos për vlerat e shkrimtarit dhe kulturën shqiptare / 21

Hoxha kur thërret në minare / 24

O burrgrua, nëse nuk ke punë tjetër luaje së paku rezen e derës / 27

Kali Trojës na polli në Bit – Pazar / 31

Ra “Makedonska enciklopedija” dhe i nxorri

“patriotët” e vonuar në sipërfaqe / 35

Vetëvrasja politike / 41

Patrioti / 45

DoktorZiu me vulë në ballë / 50

II ZGJOHUNI TË VDEKUR SE NA

MBYTËN TË GJALLËT

Qenmelez Sharri leh natën në iriq / 53

Propaganda shqiptare e shitur pa pare / 57

Pllaka e prishur e gramafonit / 62

Beqaresha partiake / 65

Oda e miqve / 68

Njerka dhe kopilat e shitur një torbë taxhi / 70

Djalë e vogël në Shkup e solli lejleku / 73

Libri i përkthyer keq fishkëllen si rrotat

e palyera të një qerreje / 75

E pashë “Nova Godinën” me një fëmijë për dore
në Shkup / 80

Zgjuhuni të vdekur se na mbytën të gjallët / 83

III LUFTA E TRURIT ME B-në

E MADHE TË SHTYPIT

Luftën e fitojmë po në tavolinë
na qepin struke / 89

Patrioti i Arratisur dhe parullat
e “vëllazërim – bashkimit” / 92

Poetët vijnë me shi. Dhe, ikin me poezi / 96

Intelektuali i Rrejtshëm / 100

Patrioti i Vonuar / 105

“Kajgana” / 110

Lufta e trurit me B-në e madhe të shtypit / 114

Mjkekërbardhi njëqindedyvjeç: xha Deralla / 118

“Patriot Poeti” që në pleqëri shkruan
poezi erotike / 122

B-ja e madhe e shtypit pjellë viça të palëpi / 126

B-ja e madhe e shtypit para Trurit / 130

IV RRUFEJA NUK SHITI NË FERRA

Pazari Grave / 133

Mehmedali Hoxha largpamës dhe
burrë i penës / 138

Poeti nuk ka nevojë për horra
e morra komunistë / 144

Protestë te Pazari Grave / 150

Zjarr e flakë mes varrve / 154

Zhurma e rrotave të qerres / 161

Trusakatët edhe flamurit kuqezi
ia ndërruan ngjyrat / 166

Personalitete që rrinë krah për krah
me Bajram Currin dhe Shotë Galicën / 170

Shtet i “mençur” / 177

Problemi me vetveten / 182

Rrufeja nuk shti në ferra / 187

V NUK TË ZË NËMA E NJERKËS

PO NËMA E NËNËS

Gomarin që e hante Ujku tha: është ëndërr / 191

Në komunizëm “shqiptar i ndershëm” –

“Patriot” në demokraci / 195

Për çfarë “Republike të Tanushës” shkruan

ky Dumdum melez – “Shqiptar” / 199

Hoxha me kësulën e bardhë

të Bajram Currit / 203

Edhe Hoxha vendos për vlerat e shkrimtarit dhe

kulturën shqiptare / 209

Nuk të zë nëma e Njerkës

po nëma e Nënës / 214

Teutat e soçme kuqezi – gra “besnike”

në parti / 218

Shkupi përpara “tërmetit”

të protestave shqiptare / 224

Kërcnime anonime / 229

Ma ka lën-e, ma ka lën-e nëna amanet-e / 233

VI RRUFJANI GËRHET PËR LIRI

Shkupin nga Qeveritë “demokratike”

do ta shpëtojë Natyra / 236

Nusja me pashterkë të kuqe

që nuk e zbritëm nga koçia / 241

Tërbimi i Kalemxhiut Melez

para Vitit të Ri / 245

Populli e thotë: nuk bëhet si them unë / 250

Rrufjani gërhet për Liri / 254

Kalaja mirret nga brenda / 260

Katundi digjet e plaka krihet / 264

Gomari e ka mendjen te kashta dhe samari / 269

Dum Dum / 273

VII PLAGA E DHJETË E BABAIT

Pashterkëkuqja / 277

Palaçot e sotshëm të Oborrit / 281

Zezaku i vogël me çifteli / 286

Shkrimtari e fitoi Lirinë: iku nga Ferri
dhe u arratis në Parajsë / 292

Me Rrospi Meshkuj e Kurva
nuk bëhet politikë / 296

Plaga e dhjetë e Babait / 302

Askushi / 306

Papagalli Kafazit / 310

Qerbelaja Shqiptare / 315

VIII XHADIA

Shtrigani Allahut me nuska përqafe / 324

Shkupi digjet e Plaka krihet në Katund / 328

Vajtojcat e Zajazit / 333

Dy luanë dhe dy kuaj Troje
me bythëtankse rusi / 340

Xhadia / 344

Dizgëmadhja / 348

Shteti Mafisë / 353

Blerësi “prodhimeve bujqësore” / 358

Rriqrat politike / 362

Halldupi / 367

Përcjellja e Natës me poezi
dhe këngë deri në agim / 371

Hapja e dyerve të fantazisë / 376

Dyluftimet e Partive Politike Shqiptare
si puna e jorganit të Nastradin Hoxhës / 380

Lakuriqi i natës dhe i ditës / 384

Skënderbeu nesër e shalon kalin
matanë Urës Gurit / 389

**IX LIRINË E ZBRITI NGA KOÇIA
NJERKA ME DAJRE**

Djemnusha / 394

Përcjellja e gomarit haxhi

në Mekë me djare / 400

Lufta e përgjakshme për Kalanë Dardane / 406

Kosova grua e vejë e shitur dy herë / 411

Tanusha / 416

Vaje për postin / 432

Vetëdija / 440

Humbën shqiptarët – fituan partitë politike / 446

Kollumna me ferexhe / 454

Deledashi / 460

Shtegu i Kaçakut / 468

Zogu i Keq / 474

Amani, e hipni edhe një grua

në kalë me shalë / 482

Thashë / 485

Nesër kush do t'ju pri

këlyshëve me zgjebe / 493

Dhe në fund

Mos u trembëni nuk do t'ju lëmë

t'u hanë sorrat / 499

Shënime për autorin / 505

Cip katologizimi në publikim Biblioteka popullore
dhe universitare « Sv. Kliment Ohridski », Shkup

821.18 (497.7) - 32

ÇELIKU, Kalosh

Xhadia: (Dyluftime gjatë rrugës për në Baba
Tomorr) / Kalosh Çeliku. - Shkup: Asdreni. 2011.
- 516 f.; 23 cm. - (Biblioteka: Xha Deralla)

ISBN 978-9989-174-53-7

COBISS.MK-ID 84610570

KALOSH ÇELIKU
XHADIA

Botues
ASDRENI

Korrektore
Fitore DERALLA

Formulimi kompjuterik
Irir EMINI

Tirazhi: 1.000 kopje

U shtyp në shtypshkronjën:
Tringa Design
Tetovë, 2011